L. N. TOLSTOI

RINGJALLJA

ROMAN

TIRANË, 1961

L. N. TOLSTOI



RINGJALLJA

Roman

E përktheu:
PETRO ZHEJ

N. Sh. BOTIMEVE «NAIM FRASHERI»
TIRANË 1961

PARATHENIE

Romanin «Ringjallja» L. Tolstoi e shkroi aty nga fundi i shekullit XIX-të në periudhën e fundit të veprimtarisë së tij letrare, atëhere kur shkrimtari, si preu çdo marrëdhënje me klasën e tij, me klasën e aristokracisë, kaloi në pozitat e fshatarësisë ruse. Në këtë periudhë, siç thotë Lenini, Tolstoi sulet me një kritikë të apasionuar kundra të gjitha institucioneve shtetërore, kishëtare, shoqërore dhe ekonomike të kohës që mbështeteshin në çfrytëzimin e masave, në mizerjen e tyre, në shkatërrimin e fshatarëve dhe të pronarve të vegjël në përgjithësi, në dhunën e në hipokrizinë që përshkon fund e krye të gjithë jetën e kohës. Në këtë kritikë të apasionuar të Tolstoit shohim protestën e egër dhe të papajtueshme kundra shtetit dhe kishës me të gjithë aparatin e tyre despotik e policor që karakterizohet nga një veprimtari e hapur grabitqare të aparateve shtetërore, të jezuitizmit fetar, të gënjeshtrës dhe të batakçillëkut.

Duke paraqitur institucionet shtetërore drejt për drejt, ashtu siç i shikonte vetë apo me syrin e Nekludovit, heroit të romanit, pas të cilit qoftë për nga anallogjitë e shumta autobiografike, qoftë përsa i përket bindjeve të tij morale, fshihet vetë Tolstoi, autori nënëvizon në mënyrë të vendosur karakterin klasist të këtyre institucioneve në shoqërinë kapitaliste.

Duke përshkruar gjyqin e gubernës që dënon pa të drejtë Masllovën, Tolstoi vë në dukje indiferentizmin e gjykatësve ndaj çështjeve që shqyrtoheshin në gjyqet e atëherëshme, sidomos ndaj të pandehurve, qëndrimin e tyre mospërfillës dhe të pandërgjegjëshëm në proçeset gjyqësore në përgjithësi, duke u bërë shkaktarë të dënimeve të padrejta kundrejt njerëzve krejt të pafajshëm.

Këto gjëra i vë re Nekludovi edhe në Petërburg, porsa bije në kontakt me sferat e larta burokratike të atjeshëme. Dhe kështu nga të gjitha ato sa kishte parë në gjyqin e gubernës dhe në Petërburg, Nekludovi arrin në përfundimin

se më se gjysma e njerëzve që dënohet nga gjyqet është e pafajshme, se keqbërësit e vërtetë nuk janë ata që rrinë në-për burgje, por klasat sundonjëse dhe rendi shtetëror në fuqi. Hajduti nuk është ay çunaku që vodhi ca shkorsa të vjetra që kushtojnë gjith gjith 3 rubla e 67 kopekë, por është fabrikanti që i vjedh puntorit punën, që i paguan atij një mëditje qesharake, qeveria që e grabit me të dy duart nëpërmjet taksave me anë të ushtrisë së nëpunësve të saj të mëdhenj e të vegjël, dhe çifligari «që e ka grabitur prej kohësh duke i marrë tokën».

Burgjet nuk i ndreqin, nuk i edukojnë keqbërësit por i shpien këta njerëz gjer në shkallën më të ultë, të vesit dhe të degjenerimit. Dhe kjo ndodh sepse nëpunësit që qëndrojnë në krye të këtyre institucioneve nuk mendojnë se kanë të bëjnë me njerëz, nuk shohin detyrimet që kanë ndaj tyre, «por vetëm shërbimin e tyre, kërkesat e të cilit ata i venë mbi kërkesat e marrëdhënjeve njerëzore». Këtij degjenerimi moral i ndihmon, na thotë Tolstoi, edhe kisha që është e lidhur ngushtë, si një mjet mashtrimi dhe dhune, me shtetin dhe që i justifikon e i bekon të gjitha padrejtësitë që bëhen në gjyqe e nëpër burgje. Priftërinjtë i hedhin pluhur syve popullit me «misterin» e shndrrimit të bukës dhe të verës në trupin dhe në gjakun e zotit, predikojnë varfërinë e në të njëjtën kohë vënë mënjanë për veten e tyre kapitale të mëdha.

Tablot e ndryshme të gjyqeve, të kishës dhe të burgut, që ka pikturuar Tolstoi, i përkasin një artisti të madh realist, i cili ka ditur të na tregojë në mënyrë konkrete esencën klasiste të organeve shtetërore n'atë kohë. Por nga ana tjetër, Tolstoi, duke i fshikulluar me kritikën e tij të pamëshirëshme të gjitha aspektet e rendit shoqëror në fuqi, kurrë nuk flet për një mundësi tjetër të qeverisjes: ai është në parim kundra shtetit në përgjithësi si sistem i organizimit të jetës shoqërore.

Heroin e romanit Tolstoi na e paraqet me disa tipare që nuk janë krejt tipike për klasën e tij. Gjer diku ai na kujton, ndonëse në një fazë zhvillimi moral më të përparuar, heronjt e tjerë të Tolstoit si, fjala vjen, Bezuhovin në «Luftë e paqë», Levinin në «Ana Karenina». Nekludovi ka të përbashkët me këta etjen e kërkimeve të pafund në fushën e ideve dhe të ndjenjave morale, orvatjet e palodhura për të qënë në paqë me veten e tij. Por Nekludovi (ashtu si edhe

vetë Tolstoi në kohën kur e shkroi romanin) shkon më larg në rrugën drejt çkëputjes nga klasa e tij, ai shkon gjer në mohimin e saj.

Duke na përshkruar hollësisht jetën e Nekludovit. Tolstoi na e paraqet atë në rini si një njeri akoma të paprishur nga ambienti i botës mondane që e rrethon, si një luftëtar të vendosur në zgjidhjen e çështjeve që kanë të bëjnë me shoqërinë, me moralin dhe me vënjen në praktikë të doktrinës së Henri Xhorxhit mbi tokën. Por dalë nga dalë rrethi familjar dhe më vonë ushtëria ku ai hyri pas mbarimit të universitetit, ushtrojnë mbi të një ndikim shkatërronjës gjersa, siç thotë Tolstoi, njeriu «shtazor» që rronte tek ay, triumfoi mbi njeriun «shpirtëror». Pikërisht në këtë kohë ai takohet me Katjushën, e mashtron dhe e braktis. Por ja, pas dhjetë vjetësh, kur në kujtesën e tij s'kishte mbetur më asnjë gjurmë nga ajo aventurë, do fati që ai të takohet përsëri me të. Takimi bëhet në gjyq ku Nekludovi mer pjesë në zhuri dhe Katjusha ndodhet në bangon e të akuzuarve. Kjo është ngjarja kr'yesore e romanit që shënon një kthesë rrënjësore në jetën e Nekludovit, dhe që Tolstoi ndën prizmin e pikëpamjeve të tij fetare e quan «ringjallja». Nekludovi vendos ta lajë atë «gjynahun» e tij kundrejt Katjushës. Ai bën një vlerësim të ri të jetës dhe nis ta shikojë botën me një sy tjetër. I revoltuar nga padrejtësia që zbulon proçesin e Katjushës ai vendos të japi dorëheqjen nga gjyqi. Kjo është pasoja e parë e «ringjalljes». Në fund të romanit, ai do të heqi dorë nga të gjitha gjyqet. Revolta kundra gjyqeve sjell me vete tek Nekludovi edhe revoltën kundra të gjitha formave të tjera të ushtrimit të dhunës (burgjeve, kishës etj.) Nga kjo kritikë e jashtëme, Nekludovi kalon në kritikën e brëndëshme të vetes së tij gjer në një analizë të thellë të jetës që ka për pasojë «spastrimin e shpirtit». Tek Tolstoi ky «spastrim» luan një rol të dorës së parë, duket si një simptomë e sigurtë që njeriu po vihet në rrugë të drejtë.

Duke shporrur nga vetja çdo gjë që është «e ultë», Nekludovi arrin dalë nga dalë në përfundimin se burimi i pashterrëshëm i të gjitha poshtërsirave që kanë hedhur rrënjë tek ay, duhet kërkuar në pozitën e tij të privilegjuar si fisnik e si pronar i madh tokash. Pra, duhet hequr dorë nga këto privilegje. Por Nekludovi lëkundet, ngurron, nuk është në gjendje të marri aty për aty një vendim që do ta

shpinte njëherë e mirë në çkëputjen nga klasa e tij, në mohimin e esencës së tij klasiste. Kështu duke u dhënë fshatarëve të Kuzminskojes tokën me qira, ai bën një kompromis me veten e tij dhe vetëm ndën shtytjen e një «spastrimi» të dytë të shpirtit në Panovo ai ua jep fshatarëve tokat pa asnjë shpërblim.

Heqja dorë nga e drejta e pronësisë e shpie Nekludovin në përfundimin se kryesorja në jetë është «ta ndjesh veten shërbetor e jo zot». Ky është pra qëllimi i jetës për Nekludovin. Kështu Nekludovi përqafon më në fund atë moral sklevërish që e ngadalësoi rrithmin e zhvillimit të njerëzimit me të gjithë shekujt e errësirës së mesjetës dhe që i hoqi të shtypurve dhe mjetin e vetëm për të ngritur krye: dëshirën për të ngritur krye. Në fund të romanit ne e shohim Nekludovin me ungjill në dorë duke moralizuar mbi të keqen që sundon në botë, duke lidhur në një fill të vetëm citate të ndryshme nga libri i shenjtë duke ëndërruar të ndërtojë me to një sistem utopik që do t'afrojë «vendosjen e mbretërisë së qiellit mbi tokë». Pas shumë kërkimesh, dyshimesh e lëkundjesh, Nekludovi arrin në bindjen e plotë se e vetmja rrugë shpëtimi nga e keqja e tmerrëshme nga e cila vuajnë njerëzit, është që njerëzit ta ndjejnë veten gjithënjë fajtor përpara zotit. Kështu Tolstoi nxjerr në shesh idenë e mos-mposhtjes të së keqes me anë të forcës, idenë mbi vetpërsosjen morale të njeriut si i vetmi mjet për ndryshimin rrënjësor të shoqërisë.

Kryma fetare përshkon tërë veprën e Tolstoit; romani hapet e mbyllet me citate nga ungjilli dhe mund të themi se nuk është tjetër në esencë, veçse një ilustrim i tij, një përshkrim i hollësishëm, konkret i atij momenti të veçantë të jetës psiqike që njihet me emërin «pendesë». Pas pendesës Nekludovi mbetet po aq egoist sa ç'kishte qënë përpara saj, me të vetmin ndryshim se tani përkujdesja për trupin është zëvëndësuar tek ay me përkujdesjen për shpirtin d.m.th. prap për veten e tij. Kështu n'asnjë nga përpjekjet që ai bën për të ndihmuar Katjushën shtytja nuk është dashuria e pastër, e vërtetë, e thellë për Katjushën por vetëm e vetëm preokupimi ngulmonjës, pothuaj i sëmurë për të larë mëkatin e tij. Posa Nekludovi ta lajë këtë mëkat ai nuk ka pse të interesohet më për Katjushën. Thelbi i «humanizmit» të Nekludovit është humanizmi fetar, një

humanizëm i rremë gjersa s'mund ta çlirojë njeriun nga guaska e egoizmit të tij. Krejt ndryshe është puna me Simonsonin, një i burgosur politik me të cilin Masllova bije në kontakt në burg. Atij nuk i duhet asnjë «heroizëm» për ta dashuruar Masllovën. Dhe ndonëse këtë Tolstoi përpiqet ta argumentojë me karakterin e çuditshëm, pothuaj anormal të Simonsonit, ne kuptojmë menjëherë se kjo duhet shpjeguar me humanizmin e tij të vërtetë, të shëndoshë.

Në fillim të romanit ne shohim tek Katjusha një vajzë të pastër, të padjallëzuar, me një besim të pamatur tek njerëzit me një dashuri të pakufizuar për jetën. Por ja e mashtruar dhe e braktisur nga Nekludovi, e dëbuar nga shtëpia e «bamirësve» të saj (të tetove të Nekludovit që e mbanin si vajzë për shpirt dhe e përdornin si shërbëtore) në shpirtin e Katjushës bëhet një kthesë e tmerrëshme që arrin kulmin në një natë të zezë vjeshte kur shëmben edhe shpresat e fundit të saj për tu takuar me Nekludovin në stacionin e trenit.. «Që nga ajo natë e tmerrshme ajo nuk besoi më në drejtësinë dhe në të mirën e kësaj bote.... Që nga ajo natë ajo u bind se të gjitha ato sa thuhen për zotin ishin gënjeshtra....»

Pikërisht kjo kthesë, kjo zbraztirë që ndjeu në shpirtin e saj Katjusha pas mashtrimit që iu bë, e rokullisi atë dalë nga dalë në tatëpjetën që e shpuri më në fund në shtëpinë publike. Historia e jetës së Masllovës i shërben Tolstoit për të nxjerrë në shesh tërë llumin moral të shoqërisë borgjeze, duke pikturuar tablotë e zymta të degjenerimit të legalizuar, të alkolizmit dhe të cinizmit. Por më të njëjtën kohë shkrimtari tregon se si tek Masllova e cila, ndën ndikimin e rrethanave të jetës saj të pafat, u shty në degjenerim dhe në cinizëm, ka akoma «diçka të rëndësishme e të papërlyer». Dhe duke zbërthyer këto kundërthënje që ekzistojnë tek Masllova, Tolstoi tregon se si hap pas hapi «njeriu shpirtëror» tek Katjusha e mposht «njeriun shtazor». Është po ay proces psiqik, po ajo «ringjallje» si edhe tek Nekludovi, po mbi një sfond faktorësh të tjerë: takimi me Nekludovin e penduar, afrimi në burg me revolucionarët.

Një vënd të rëndësishëm zë në roman përshkrimi i gjëndjes së fshatarësisë ruse. Këtu është fjala për fshatarsinë ruse «të çliruar» pas reformave të fundit të shekullit

XIX. Tolstoi e tregon qartë se çfarë i sollën muzhikut rus këto reforma: një skllavëri dhe një mizerje akoma më të rëndë dhe pa rrugë dalje. Mjaftón të lexohet për këtë ndërmjet të tjerëve, kreu i IV-të i pjesës së dytë ku përshkruhet udhëtimi i Nekludovit në Panovo.

Duke përdorur të tilla ngjyra të zymta në përshkrimin e gjëndjes së fshatarësisë, Tolstoi natyrisht nuk mund të linte pa përmëndur në roman edhe të gjitha ato çështje që ishin lidhur me atë grup shoqëror që i kishte vënë vetes për detyrë të luftonte për lumturinë e popullit. Por pozitat e tij ideollogjike pasqyrohen rrjedhimisht edhe në qëndrimin që ai mban ndaj këtij grupi. Pikërisht këto pozita të gabuara që përcaktohen nga doktrina e tij mistike mbi mos kundershtimin e dhunës dhe të keqes me anë të forcës, mbi evolucionin shoqëror në sajë të «vetpërsosjes» të secilit antar të saj, e shpunë atë t'i paraqiti revolucionarët, nden një dritë iluzore, të gabuar, jo reale. Kjo shihet fare mirë në tiparet që ai i ka dhënë përfaqësonjësit të tyre tipik, revolucionarit konseguent, Novodvorovit. Duke na pikturuar portretin e tij moral, Tolstoi vë në dukje në radhë të parë tek ay «mungesën e çdo vetije morale», «mëndjemadhësinë», përpjekjen për të dalë në krye e për t'u dukur në sy të njerëzve. Tolstoi nuk e pranon revolucionin si «ide», si një mjet për ta përmirësuar gjëndjen e shoqërisë, ai e justifikon atë vetëm si një tendencë spontane, si një dëshirë që ndizet në zëmrat e atyre më të mirëve për të mos u pajtuar me të keqen që qarkullon në botë, po tendencë e gabuar në pasojat e saja sepse shpie në krime të shëmtuara dhe pafryt.

Romani «Ringjallja» ashtu si «Lufta e Paqa» dhe «Ana Karenina» është një nga kryeveprat e Tolstoit dhe në të njëjtën kohë një nga kryeveprat e letërsisë botërore. Pa u ndalur në vlerat artistike të romanit, siç janë përshkrimi i karaktereve njerëzore në zhvillim e sipër, tablot e gjalla të realitetit rus, gjuha e pasur dhe kompozicioni perfekt, aftësia për të dhënë me detajin e jashtëm botën e brëndëshme të njeriut etj. janë karakteristika të artit të madh të Tolstoit. Duke patur parasysh përmbajtjen ideollogjike të romanit, kjo vepër e madhe e letërsisë ruse është shkruar në një kohë kur Tolstoi çkëputi çdo lidhje me klasën e tij, duke u hedhur përfundimisht në anën e fshatarsisë patriarkale të Rusisë së fundit të shekullit XIX.

Që këndej lind kritika e ashpër pa rezerva që ai i bën aristokracisë dhe të gjithë strukturës shoqërore në përgjithësi.

Asnjë sferë e jetës shoqërore n'atë kohë nuk i shpëton kritikës së pamëshirëshme të Tolstoit. Tolstoi ka arritur tanimë atë kthjelltësi, ta quajmë kështu, profetike, që i lejon të shikojë qartë se ç'fshihet pas idhujve, pas maskave. Dhe ai i shëmb pa mëshirë të gjithë idhujt, i çkul të gjitha maskat dhe na tregon se pas nëpunësit të lartë fshihet njeriu i vogël (senatorët), pas ruajtësve të ligjit, përdhunonjësit e tij (gjyqtarët), pas mbrojtësve të rendit publik, prishësit e saj (oficerat), pas dashurisë poetike mondane — proza bajate e kurvërimit të rafinuar dhe pas perendisë — vetë djalli (kisha). Është sundimi i gënjeshtrës. Dhe Tolstoi na i tregon me hollësi të gjitha veçoritë e këtij sundimi duke na përshkruar shtëpitë publike ku bëhet shndrimi i dashurisë në ves, kishën ku besimi merr trajtat e magjisë, familjen ku burri dhe gruaja mirren vesh heshturazi që ta tradhëtojnë lirisht njeri tjetrin, ku nëna ka turp ta shikojë të birin në sy dhe i biri mezi ç'pret që të vdesi që t'i trashëgojë pasurinë; duke na përshkruar armatat e panumurta të nëpunësve të mëdhenj e të vegjël që marrin rrushfet me të dy duart si edhe tërë atë shtrëmbërim të thellë e të gjithanshëme që kanë pësuar të gjitha çfaqjet e jetës ndën sundimin e plotfuqishëm të gënjeshtrës. Por ndërsa Tolstoi zbulon kontradiktat themelore të shoqërisë së tij, bie vetë në kontradikta. Kështu ai nga një anë kritikon fenë, kurse nga ana tjetër shikon tek njeriu dualizmin «njeri shtazor» dhe «njeri shpirtëror», që s'është tjetër veçse dualizmi tradicional fetar mes «trupit» dhe shpirtit». Tek Tolstoi këto janë dy forca të kundërta, të papajtueshëme ashtu siç janë edhe për fenë që me mekanizmin e thjeshtë të veprimeve të tyre reciproke pretendojnë të shpjegojnë të gjithë kompleksitetin e pasur të psiqikës njerëzore. Ky dualizëm themelor shpie në një varg dualizmash të tjera mes t'«mirës» e të «keqes», të «vërtetës», e «gënjeshtrës», të «bukurës» dhe të «shëmtuarës». I vetmi moral që mund të rrjedhi që këtej është morali kishtar për të cilën trupi është burg i përkohshëm i shpirtit dhe që të shpije (siç e shpuri në fakt Tolstoin) në idealin e asketizmit, të «kufomës së gjallë», të «tolstojanit», të intelektualit parazit e histerik rus që, siç thotë Lenini, rreh gjoksin e thotë: «Unë jam i keq, unë jam i poshtër, por unë do të merrem me vetpërsosjen time mo-

rale; unë tani s'e vë më në gojë mishin dhe qoftet kur i ha, i ha vetëm të gatuara me oriz».

Në dritën e këtyre kontradiktave duhet vlerësuar romani «Kingjallja» i Tolstoit. Duhet të flakim prej tij thelbin mistik reaksionar pas të cilit kapen me zell të madh teorisienët e letërsisë në perëndim, duhet të mbajmë kritikën e ashpër, të pamëshirëshme kundra të gjitha formave të jetës së shoqërisë borgjeze. Vetëm me këtë kusht romani «Ringjallja» nuk do ta humbasë aktualitetin edhe në ditët tona.

Petro Zhej

PJESA E PARË

Ungjilli sipas Matheut, kreu XVIII, rreshti 21. Atëhere i erdhi pranë Pjetri, e tha. Zot, sa herë të më fëjenjë im vëlla, edhe t'j'a fal ati? gjer më shtatë herë? 22. Jisuj i thot' ati, Nuk të them gjer më shtatë herë, po gjer mbë shtatëdhjetë herë nga shtatë.

Ungjilli sipas Matheut, kreu VII, rreshti 3. Edhe përse shikon lemishtenë që është ndë syt të t'yt vëllaj, edhe tranë që është ndë syt t'ent nuk e ndjen?

Ungjilli sipas Joanit, kreu VIII, rreshti 7... i pafajmi prej jush, ky më përpara le të hedhë gurin mbi atë.

Ungjilli sipas Llukajt, kreu VI, rreshti 40, Nuk ka nxënës përmbi mësonjësin' e ti; po çdo i mbaruarë nxënës, do të jetë si mësonjësi i ti.

I.

Më kot mundoheshin disa mijëra njerëz, të mbledhur në një vend të vogël, ta çkallmonin tokën ku jetonin, më kot e mbulonin dheun me gurë që të mos rritej mbi të asgjë, më kot e spastronin nga çdo fije bari, më kot e mbushnin ajrin me tym, më kot i pritnin pemët dhe dëbonin kafshë e shpendë. Të gjitha më kot, sepse pranvera prapseprapë shpërthente e lirë edhe në qytet. Dielli shkëlqente i ngrohtë, bari gjallërohej, rritej e jeshilonte kudo, e jo vetëm në postatet e bulevardeve por edhe ndërmjet gurëve të kalldrëmit. Mështeknat, plepat e qershitë e egra nxirrnin gjethet e tyre të lëmuara e kundërmonjëse; blirët frynin sythet e porsaçelura; harabelat e pëllumbat gatitnin të gëzuar, si çdo pranverë, foletë e tyre; mizat zhuzhitnin mureve e shullëheshin në diell. Të gjithë qenë të gëzuar: edhe bimët,

edhe zogjtë, edhe insektet, edhe fëmijët. Po njerëzit, — njerëzit e mëdhenj, të rritur, — vazhdonin të gënjenin veten e tyre dhe njeri tjetrin. Për njerëzit bukuria hyjnore e atij mëngjezi të ngrohtë pranveror që u falej të gjitha qënieve mbi dhe duke ndjellur kudo një dëshirë paqeje, miqësie e dashurie, nuk ishte e shënjtë, nuk ishte e rëndësishme. Të shenjta e të rëndësishme për ta ishin vetëm ato që kishin shpikur vetë për të sunduar mbi njeri tjetrin.

Kështu, për nëpunësit e zyrës së burgut të gubernës, ai ngazëllimi i madh i pranverës, që u dhurohej njerëzve e kafshëve, s'ishte as i shënjtë e as i rëndësishëm. E shënjtë dhe e rëndësishme për ta ishte ajo shkresa me vulë e me numër që u njoftonte se atë ditë, më 28 Prill, duhej të dërgoheshin, për t'u gjykuar në gjyq, tre të burgosur: dy gra e një burrë. Njëra nga gratë, si më e rrezikëshmja nga të tre të pandehurit, duhej të dërgohej vec. E ja, për të zbatuar urdhërin, që përmbahej në atë shkresë, kryegardiani hyri më 28 Prill, në ora tetë të mëngjezit, në koridorin e errët e të qelbur të burgut të grave. Menjëherë pas tij, hyri në koridor edhe një grua me një fytyrë të vojtur e me ca flokë të thinjur e të lëshuar, me një bluzë me mëngë të gjata e të qëndisura, që shtrëngohej në mes nga një brez i stolisur me ca shirita bojë qielli.

— Masllovën, kërkoni? — pyeti gruaja që ishte gardiania e burgut duke u afruar bashkë me dezhurnin tek dera e një qelie.

Dezhurni, duke tundur me zhurmë çelësat që mbante në dorë, e futi njërin prej tyre në bravë dhe, si e rrotulloi nja dy herë, hapi derën dhe thirri:

— Masllova, në gjyq!

Kështu i foli gardiani Masllovës dhe e mbylli përsëri derën e qelisë nga e cila kishte depërtuar jashtë një rrymë ajri akoma më e qelbur se sa në koridor. Masllova qëndroi një copë herë në pritje.

Në oborrin e burgut ajri ishte i freskët, jetëdhënës, ashtu siç e sillte era që frynte nga fushat rreth e rrotull qytetit. Por në koridor ishte i rëndë, mbytës, i nginjur me një erë të keqe ndyrësirash, katrani dhe myku, që të ndillte, menjëherë, porsa merrje frymë, një ndjenjë mërzie e trishtimi të pakuptueshëm. Pikërisht këtë ndjenjë provonte atë çast edhe gardiania që kishte qënë pak më parë në oborr, ndonëse ishte mësuar prej kohësh n'atë ajër të prishur. Kur



hyri në koridor ajo e ndjeu, befas, tërë trupin të lodhur dhe sytë iu mbyllën vetvetiu.

Brënda në qeli dëgjoheshin disa zhurma, disa zëra grash, disa këmbë që ecnin zbathur mbi dysheme.

— Masllova, hajt shpejt! Tundu, ç'bën ashtu dy sahat? — thirri gardiani te dera e qelisë.

Pas pak u dha në derë, me një hap të vendosur, një grua e re, me një shtat mesatar, me gji të mbushur e shumë të këcyer, me një kapotë të murme mbi bluzën dhe fustanin e bardhë. Gruaja doli nga dhoma, u rrotullua dhe iu afrua me një lëvizje të shkathët gardianit. Në këmbë kishte veshur një palë çorape dhe këpucët e burgut, në kokë mbante një shami të bardhë, nga e cila kishin dalë mbi ballë, gjoja nga moskujdesi, disa cullufe të zeza. Fytyra e gruas kishte marrë ngjyrën e zbardhulët të njerëzve që kanë jetuar një kohë të gjatë në një vend të mbyllur e që të kujton gjer diku filizat e patateve në bodrum. Po këtë ngjyrë kishin edhe krahët e shkurtër e të trashë dhe qafa e plotë që zbulohej herë-herë nga jaka e gjërë e setrës. Në atë fytyrë të zbehtë dhe disi të zeshkët spikatnin mirë dy sy shumë të zes e të ndritshëm, pak si të buhavitur, por shumë të gjallë, njeri prej të cilëve sikur vështronte pak vëngër. E burgosura i kishte dhënë trupit përpjetë dhe e mbante drejt duke nxjerrë përpara gjirin e saj të plotë e të bështëm.

Kur doli në koridor, bëri kokën mënjanë mengadalë, vështroi gardianin drejt e në sy dhe qëndroi në krah të tij si për të pritur ndonjë urdhër. Gardiani po matej ta mbyllte përsëri derën me çelës, kur që andej zgjati kokën një plakë me ca flokë të lëshuar e të thinjur e me një fytyrë të zbehtë, të vrazhdë e të rrudhur. Plaka diç nisi t'i thoshte Masllovës. Por gardiani e shtyu derën mbi kokën e plakës dhe ajo s'u duk më. Në qeli shpërtheu atë çast një e qeshur gruaje. Masllova vuri buzën në gaz dhe u kthye nga frengjia e vogël me hekura që ndodhej në pjesën e sipërme të derës. Plaka, nga ana tjetër e derës, u ngjit pas frengjisë e thirri me zë të ngjirur:

— Ki mëndjen sidomos të mos flasësh shumë. Ngul këmbë në tënden e hiç mos u trëmb!

— E pse do të trëmbem? Më keq s'ka ku të shkojë! Sidoqë të bëhet, për mua njëlloj është!

— Dihet, një lloj është e jo dy lloj, — tha kryegardiani rëndë rëndë duke u krekosur tërë qejf për atë shakanë e tij të hollë. — pas meje, marsh!

Syri i plakes qe perpiqej te vesntronte permes hekurave të frengjisë u zhduk. Masllova iu vu pas gardianëve me hapa të shkurtëra e të shpejta. Ata zbritën një shkallë të ndërtuar me gurë, kaluan pranë qelive të burrave ku zhurma qe më e madhe dhe era më e fortë e më e qelbur se sa ajo që të shponte hundët në burgun e grave dhe, të shoqëruar në çdo hap nga qindra vështrime që përgjonin nëpër frengjitë e dyerve dhe dritareve të vogla, hynë më në fund, në zyrën e burgut, ku po i pritnin dy ushtarë me pushkë. Nënpunësi, që ndodhej atje, diç shkruajti e, si i dha njerit prej ushtarëve një letër që mbante erë duhan, i tregoi të arrestuarën dhe i tha: «Merre!». Ushtari, një muzhik prej Nizhnigorodi, me një fytyrë vrarë-lije, e futi letrën në mëngën e kapotës dhe i shkeli synë shokut të tij, një djaloshi me mollëza të këcyera nga Çuvakia, duke i treguar me kokë të burgosurën. Ushtarët, bashkë me të burgosurën zbritën shkallët dhe duallën jashtë në rrugë.

Pasi kaluan derën e madhe të burgut dhe derën e gardhit që e rrethonte, ushtarët me të burgosurën dolën jashtë në rrugët e shtruara me kalldrëm të qytetit.

Karrocierët, dyqanxhitë, gjellbërësit, punëtorët e nëpunësit ndaleshin dhe i hidhnin sytë të burgosurve me kureshtje; disa tundnin kokën dhe thoshnin me vete: «Ja si e pëson kush nuk di të sillet!» Fëmijët e vështronin të burgosurën me tmer dhe i qetësonte vetëm mendimi që tani ushtarët nuk e linin më të bënte ndonjë të keqe. Një muzhik, që shiste qymyr në një qoshe të rrugës, iu afrua, bëri kryqin dhe i dha një kopek. E burgosura u skuq, uli kokën dhe diç mërmëriti.

Duke ndjerë vështrimet që i drejtoheshin asaj nga të gjitha anët, e burgosura shikonte me bisht të syrit rreth'e rrotull pa e kthyer kokën dhe i bëhej qejfi për atë vëmëndje që kishte ngjallur tek njerëzit. I bëhej qejfi gjithashtu kur thëthinte atë ajër të pastër pranveror, por i dhimbnin këmbët kur shkelte nëpër gurët e kalldrëmit me ato këpucët e rënda të burgut dhe hera herës ulte kokën e zgjidhte vëndin ku hidhte hapat. Kur kaluan pranë një depo mielli, përpara së cilës silleshin poshtë e lartë duke lodruar të çkujdesur disa pëllumba, e burgosura mënt e shkeli njerin prej tyre me këmbë; pëllumbi rahu krahët dhe u largua duke kaluar fluturimthi mu pranë veshit të saj. E burgosura vuri buzën në gaz, por pastaj psherëtiti duke sjellë ndërmënd gjëndjen në të cilën ndodhej.

II

Historia e të burgosurës Masllova ishte një histori shumë e rëndomtë. Masllova ishte e bija e një gruaje të ve, që bananonte e punonte bashkë me t'ëmën në një çiflik. Çifliku ishte pronë e dy motrave, e dy zonjushave të shkuara nga mosha, që rronin me të ardhurat që merrnin nga toka e nga bagëtia për të cilat përkujdesej gjyshja e Masllovës bashkë me të bijën. E ëma e Masllovës, ndonëse ishte grua e ve, lindte vit për vit. Ashtu siç ngjet zakonisht nëpër fshatra, foshnjen e pagëzonin, por pastaj e ëma s'çante më kokën për të, s'e ushqente dot dhe, pas ca kohe, fëmia vdiste.

Ishin ndarë kështu një pas një nga kjo jetë pesë fëmijë, që të gjithë të pagëzuar. Kjo do të ndodhte mbase edhe me fëmijën e gjashtë, që ishte vajzë e që kish pasur për baba një cigan endacak. Mirëpo deshi fati që njera nga të dy zonjushet plaka të zbriste vetë një ditë në haurin e kafshëve që t'u hiqte vrejtjen bareshave për ca djathë që mbante erë. Në haur lëngonte atë kohë lehona me një fëmijë të bukur e plot shëndet. Zonjusha plakë, pasi i qortoi gratë për punën e djathit si edhe për lehonën që e kishin lënë të lindte atje me kafshët, u mat të largohej, kur vuri re, papritmas foshnjën. Atëhere u zbut, iu afrua foshnjes, i buzëqeshi e tha se do ta pagëzonte vetë. Më vonë u përkujdes për të dhe i dha s'ëmës për ta ushqyer të holla e qumësht me bollëk. Kështu, siç i pëlqente ta thoshte edhe vetë, ajo e shpëtoi fëmijën nga kthetrat e vdekjes së sigurtë që i kish rrëmbyer një pas një të pesë fëmijët e parë.

Kur vajza mbushi tre vjeç, e ëma u sëmur e vdiq. Zonjat si e panë që gjyshja nuk i bënte dot ballë tani edhe punës, që e kishte të shumtë, edhe mbesës akoma të mitur, vendosën ta merrnin e ta rritnin vogëlushen në shtëpinë e tyre. Sytë e saj të mëdhenj e të zes, bukuria e rrallë e fytyrës nazike, gjallëria dhe shkathtësia që i shquhej në çdo lëvizje, ua rrëmbyen menjëherë zëmrën çifligareve. Më e reja, ajo që e kishte pagëzuar fëmijën, quhej Sofia Ivanovna dhe vinte më e urtë për nga natyra dhe më e dashur. Tjetra, më e madhja, që mbahej më rëndë e sillej më e rreptë, quhej Maria Ivanovna. Sofia Ivanovna e deshte vajzën sikur ta kishte të sajën dhe e mësonte si të vishej, si të stolisej, si të fliste e si të sillej. Maria Ivanovna, përkundrazi, kish vendosur ta bënte një kamariere të mirë, të shkathët e të bindur në punë, prandaj s'ja kursente qortimet e, ngando-

njëherë, kur s'ishte në qejf, të rahurat. Kështu, për shkak të këtyre sjelljeve, vajza kur u rrit, s'i përvetësoi gjer në fund ato mënyrat e përsosura të mirësjelljes e të veshjes të një fisnikeje të vërtetë, siç ëndëronte Sofia Ivanovna, as nuk mësoi dot të jetë e shpejtë dhe e bindur si një kamariere e vërtetë ashtu siç donte Maria Ivanovna. Kuptimplot, lidhur me këtë, ishte dhe emri që i vunë: s'e quajtën Katka dhe as Katjenka, por Katjusha. Ajo qepte e qëndiste, i fshinte e i vinte dhomat në rregull, u hiqte pluhurin ikonave e i përkonte me shkumës që të shëndrisnin, bënte kafenë e ndonjë shërbim tjetër të vogël dhe ngandonjëherë, rrinte bashkë me zonjat e u lexonte ndonjë libër.

Të dy zonjave u kishin vajtur kaq e kaq njerëz me krushqi me Katjushën, por vajza, e mësuar siç ishte me rehatet e asaj jete së çkujdesur, s'pranonte të martohej me asnjë nga ata punëtorë të varfër e hallexhinj që e kërkonin.

Kështu rrojti e qetë dhe e lumtur Katjusha gjersa u bë gjashtëmbëdhjetë vjeçe. Por, kur kaloi në të shtatëmbëdhjetët, erdhi në kështjellën e çifligarëve një nip i tyre, student e princ i pasur, dhe vajza ra në dashuri me të, ndonëse, nga turpi, këtë s'ja pohonte as vetes dhe aq më pak atij. Pastaj ndodhi që pas dy vjetësh princi të kthehej përsëri tek tetot. Ndënji këtu ndonja katër ditë para se të mbrinte repartin e tij që kishte shkuar në front. Një natë më parë përpara se të nisej, e mashtroi Katjushën dhe u largua si i lëshoi në dorë një kartmonedhë prej njëqind rublash.

Pas pesë muajsh ajo pati shënja të sigurta se ishte me barrë. Atëhere e humbi qetësinë dhe mendonte ditë e natë vetëm se si t'i shpëtonte turpit që e priste. U shërbente plakave pa qejf e pa zell, gjersa një ditë e tepëroi, pa ditur se si, me ca fjalë kaq të rënda që u tha, sa për këtë më vonë u pendua dhe vetë e u kërkoi ndjesë. Vendosi më në fund të largohej nga ajo shtëpi dhe kërkoi t'i jipnin ç'i përkiste për punën që kishte bërë.

Zonjushet plaka, shumë të pakënaqura kohët e fundit nga sjelljet e saja harbute, nuk u përpoqën ta mbanin. Kështu, pas ca kohe, Katjusha gjeti një punë tjetër si shërbyese në shtëpinë e një stanovoj [1]. Por në punën e re s'bëri dot asnjë muaj, sepse stanovoj, një mesoburrë mbi të pesëdhjetat, nisi t'i vijë rrotull dhe një ditë që filloi ta tepëronte me fjalë e

1) Stanovoj — kryetari i stanit. Stani në Rusinë e vjetër ishte aparati administrativ-policor i Distriktit (Shën. i përkth.)

me duar, ajo u inatos keq; iu kthye Stanovojt e s'i la gjë pa thënë. E shau «Hajvan» e «djall plak» dhe e shtriu përdhe me një grusht që i këputi në kraharor. Për këtë sjellje të papëlqyer e dëbuan. Pas kësaj ishte e kotë që Katjusha të lodhej për të gjetur ndonjë punë tjetër, sepse i duhej të mendonte për lindjen që do të kishte së shpejti. Shkoi për të lindur në një fshat, tek një grua e ve që bashkë me zanatin e mamisë punonte, nga nevoja, dhe tregëtinë e verës. Lindja qëlloi e mbarë, por mamia, që kish pritur ditë më parë një fëmijë tek një grua e sëmurë, i ngjiti Katjushës ethet e lindjes. U sëmurë edhe foshnja dhe vdiq, sipas asaj që tha mamia, në azilin ku e dërguan për ta mjekuar.

Kur u vendos për të lindur në shtëpinë e mamisë, Katjusha kish gjithësejt njëqind e njëzeteshtatë rubla: njëzeteshtatë që i kish fituar dhe njëqind që ja kishin dhënë princi pas mashtrimit. Por iku që andej vetëm me gjashtë rubla se s'dinte t'i ruante paratë; harxhonte për vete pa hesap e s'i bënte zëmra t'i kthente duarthatë ata që i kërkonin hua. Mamia, për çajin dhe për dy muaj që e mbajti me të ngrënë e i hoqi fjetjen e shërbimet e lindjes, i mori dyzet rubla; njëzetepesë rubla u dhanë për shtrimin e foshnjës të sëmurë në azil, kurse dyzet rubla të tjera mamia ja mori borxh për të blerë një lopë dhe njëzet rubla, veç këtyre, shkuan për fustane e dhurata. Kështu, kur u shërua, Katjusha u gjend pa të holla dhe prandaj duhej të kërkonte sa më shpejt ndonjë punë. Hyri pas ca kohe shërbëtore tek një rojtar pylli. Rojtari ishte një burrë i martuar, por, ashtu siç kishte bërë dhe stanovoi, iu qep pas Katjushës që ditën e parë. Katjusha e neveritur ca nga sjelljet e sidomos nga fytyra e tij e shëmtuar përpiqej t'i shmangej çdo takimi me të. Mirëpo ai ishte më i stërvitur e më dinak nga ajo. Veç kësaj, ishte zot shtëpie atje e mund ta dërgonte atë ku të donte. Kështu, duke përfituar nga një çast i volitshëm, ai e shtiu në dorë Katjushën. E shoqja i ra menjëherë erë kësaj pune, dhe një ditë kur e gjeti të shoqin në një dhomë me shërbëtoren, iu sul asaj që ta rrihte. Katjusha e kundërshtoi dhe, pas kësaj, pa i dhënë as hakun e punës që kishte bërë, ata e dëbuan. Atëhere Katjusha shkoi në qytet tek një teto e saj. I shoqi i tetos, që ishte libralidhës, dikur kish qënë në gjendje të mirë, por për shkak të votkës që e pinte pa hesap, s'ja kishte varur zanatit e kish humbur një nga një të gjithë myshterinjtë.

Tetua kish hapur në shtëpi një lavanderi të vogël dhe me të ardhurat e pakta që nxirrte prej saj rriste një tufë me

fëmijë dhe mbante të shoqin që s'ishte më i zoti as për veten e tij. Ajo deshi ta merrte Masllovën si rrobalarëse në lavanderinë e saj. Por Masllova, duke parë se sa e rëndë dhe e vështirë ishte jeta e rrobalarëseve, që punonin tek tetua, nguronte t'i jepte asaj një përgjegje të prerë në pranonte apo jo dhe, ndërkaq, shkonte zyrë më zyrë për ndonjë punë si shërbëtore. Hyri më në fund në shtëpinë e një zonje të ve që jetonte bashkë me dy djem të saj, gjimnazistë. Por më i madhi i tyre, një djalosh i rritur me një zë të trashë e me ca fije pushi të zes, që porsa i kishin dirsur mbi buzë, pa mbushur java, i vuri shkelmin shkollës e iu qep Masllovës, i vinte rrotull si ndonjë maçavel tërë ditën e ditës. Zonja ja hodhi fajin për të gjitha Masllovës dhe e përzuri. Duhej gjetur një vend tjetër. Por këtë radhë dukej se Masllova s'kish fat. Sidoqoftë një ditë, në një zyrë, ku kish shkuar për të kërkuar punë, ajo takoi rastësisht një zonjë të veshur me një fustan të çmueshëm; krahët e shëndosha i mbante krejt të zbuluara e me gjithfarë byzylyqe e unaza që i shëndrisnin në duar e në gishtërinj. Zonja, kur e mori vesh hallin e Masllovës, i dha adresën e saj dhe e ftoi në shtëpi. Masllova shkoi. Zonja e priti shumë mirë, e gostiti me pasta e verë të ëmbël, pastaj i dha kamarieres një pusullë dhe se ku e dërgoi. Atë mbrëmje erdhi aty një burrë shtatlartë, me ca flokë të gjatë e të zbardhur, që i vareshin mbi supe e me një mjekër të thinjur, me majë; plaku zuri vend pranë Masllovës, i buzëqeshi, nisi ta vështronte me sytë që i shkëlqenin e i bëri shumë shakara. Zonja e shtëpisë e mori mysafirin veç në një dhomë tjetër dhe Masllova e dëgjoi kur i tha: «Vjen nga fshati, është e freskët». Pastaj zonja e thirri Masllovën e i tha se mysafiri ishte shkrimtar, se i kishte paratë me thes e se nuk do t'ja kursente asaj po të qe se do ta pëlqente. Shkrimtarit, duket, i pëlqeu se i dha njëzetepesë rubla dhe i premtoi se do të takohej me të përsëri. Këto të holla u harxhuan menjëherë për të fshirë atë borxhin që Masllova i kishte tetos për kohën që kish banuar në shtëpinë e saj, për të blerë një fustan, një kapele dhe disa kordele për stolisje. Pas ca ditësh, shkrimtari i dërgoi fjalë të shkonte në shtëpinë e tij. Ajo shkoi. Ai i dha dhe njëzetepesë rubla të tjera dhe e ftoi të rrinte në një shtëpi që i kish zënë me qira.

Masllova bëri ashtu si e këshilloi shkrimtari, por pas ca kohe ra në dashuri me një agjent tregëtie, një djalosh të çthurur e qejfli, që banonte në një shtëpi aty ngjitur. S'ja mbajti të fshehur këtë shkrimtarit dhe, si i preu me të marrëdhë-

njet, u shpërngul në një banesë më vete, më të vogël. Mirëpo agjenti, që i kishte premtuar se do ta merrte për grua, e braktisi e u zhduk një ditë prej ditësh pa lënë gjurmë. Kështu Masllova mbeti vetëm. Deshi të banonte akoma në shtëpinë e vogël që kishte zënë me qira, por nuk e lejuan. Në polici i thanë se mund ta vazhdonte atë jetë që kish bërë pas njohjes me shkrimtarin, vetëm me kusht që të pajisej me patentën e prostitutës e t'i nënshtrohej kohë pas kohe kontrollit mjekësor. Atëhere ajo u ngrit e shkoi te tetua. Tetua, kur e pa të veshur me një fustan të modës së fundit, kur i pa peliçen lluksoze dhe kapelën e shtrenjtë mbi kokë, i bëri shumë nderime dhe nuk guxoi t'i propozonte, si dikur, që të hynte si rrobalarëse në lavanderinë e saj, duke menduar se ajo tani e kish flakur skamjen e qe ngritur në një shkallë më të lartë. As Masllovës vetë s'i shkonte më ndërmënd të punonte si rrobalarëse. I vinte keq e i coptohej zëmra tani kur i shikonte ato gra të zbeta e me krah të holla, ato gra të sëmura e të veremosura që lanin e hekurosnin tërë ditën e perëndisë përmes avujve të nxehtë e mbytës në një temperaturë gjer tridhjetë gradë, me dritare hapur dimër e behar. Vetëm parandjenja e turbullt se, mbase një ditë do t'i duhej edhe asaj të bënte atë jetë qeni, e tmeronte.

Por erdhi për Masllovën një kohë e vështirë; mbeti pa të holla, s'gjente punë, s'kishte më asnjë njeri që ta përkrahte. E ja, pikërisht në këtë periudhë të vështirë të jetës së saj, vjen e takohet me të një grua që mblidhte vajza për në shtëpi publike.

Masllova e kish nisur duhanin qëkur, por kohët e fundit, sidomos pas tradhëtisë së agjentit, i hyri dhe verës. Vera i pëlqente jo vetëm sepse i dukej e shijëshme, por më tepër sepse e bënte t'i harronte të gjitha ato që kish hequr, i jepte një lehtësi që s'e kishte kur ishte esëll, i mbante gjallë besimin në vetvete, e ndihmonte të mbyste në shpirtin e saj zërin qortonjës të ndërgjegjes. Kur nuk pinte, ndjente një brengë të pakuptuarshme, rrinte e ndrojtur dhe e turpëruar.

Gruaja i shtroi tetos një darkë dhe, si i dha Masllovës të pinte gjersa e dehu, i propozoi të hynte në një shtëpi publike, një nga më të dëgjuarat në qytet, duke i përmendur me këtë rast një nga një të gjitha të mirat që e prisnin. Masllovës i mbeteshin dy rrugë: ose të hynte përsëri diku si shërbëtore, të përbuzej, të përballonte ato sulmet e sigurta e bezdisës nga ana e burrave e të kurvërohej fshehurazi dhe

nga nevoja si dikur, ose të zgjidhte një kurvërim të përhershëm, të qetë, të hapur, të mbrojtur nga ligji dhe të shpërblyer me paga të majme. Ajo zgjodhi rrugën e dytë. I dukej se, duke vepruar kështu, do të hakmerrej një herë e mirë kundër atyre që e kishin mashtruar, kundra tregëtarit si dhe kundra gjithë njerëzve që i kishin rënë më qafë dhe i kishin bërë dëm. Një nga arësyet që e shtyri përfundimisht të anojë nga ky vendim, ishte dhe premtimi që pati nga gruaja e panjohur se do të mund të porosiste fustane gjithfarësh e si t'i deshte, prej mëndafshi apo prej liri, prej taftaje apo prej kadifeje, të zezë e dekolte. Pa ngurruar më, ajo i dha gruas letërnjoftimin e saj. Që atë mbrëmje, ndërmjetësja zuri një karrocë dhe e shpuri Masllovën në shtëpinë publike të Kitajevës, që ishte me famë në tërë qytetin.

Filloi atëhere për Masllovën ajo jetë e shkeljeve kronike të ligjeve hyjnore e njerëzore, që bëhet nga qindra e mijëra gra, jo vetëm me lejen, por dhe me mbrojtjen dhe përkrahjen e shtetit, e që përfundon, në shumicën dërmonjëse të rasteve, me sëmundje të rënda plot vuajtje, me një pleqëri e vdekje të parakohëshme.

Mëngjes e pasdreke, një gjumë i rëndë pas orgjive të natës. Aty nga ora tre-katër, bëhej ngritja me përtaci nga dyshekët e ndyrë. Fillonin pastaj kafeja dhe ca gllënka të gjata uji sifoni, të sjellurit rrotull nëpër dhoma me bluza e në rrobëdëshambra, të përgjuarit pas perdeve nëpër dritare; pastaj bëhej larja, lyerja me krem, parfumimi i trupit e i flokëve, provat e fustaneve dhe grindjet për shkak të tyre me padronën, të pispillosurit në pasqyrë, të lyerit e fytyrës e të ndrequrit e vetullave, të ushqyerit me ëmbëlsira e gjellë të yndyrëshme dhe veshja e një fustani prej mëndafshi, që linte zbuluar pothuaj tërë trupin. Më në fund, bëhej mbledhja në një sallë të stolisur e me drita të forta, pritej ardhja e myshterinjve, muzika, vallet, karamelet, vera, duhani dhe kurvërimi me të rinj e me burra të pjekur, me djelmosha të mitur e me pleq të falimentuar, me të martuar e me beqarë, me tregëtarë e me çirakë, me armenë e me çifutë, me të pasur e me të varfër, me të shëndoshë e me të sëmurë, me të pirë e të papirë, me burra të vrazhdë e me meshkuj të ndrojtur, me ushtarakë e me civila, me studentë e me gjimnazistë, me njerëz të çdo shtrese, të çdo moshe e karakteri. Sa britma e shakara, të rrahura e muzikë, duhan e verë, verë e duhan, muzikë, prapë muzikë, që nga mbrëmja gjer në të gdhirë! Dhe vetëm në mëngjes pas çlirimit nga ato mundime

vinte gjumi i rëndë. Kështu bëhej çdo ditë sa të mbushej java. Në fund të javës vinte kontrolli mjekësor; në një zyrë shtetërore, ngritur për këtë qëllim, nëpunës shteti e mjekë, herë herë çehrengrysur e me të rreptë, herë herë me të qeshur e me shakara, duke e përbuzur atë trupin e shenjtë që u është dhënë njerëzve e bile dhe kafshëve nga natyra si një mburojë e sigurt nga çdo ngasje e ndyrë, i kontrollonin këto gra lakuriq e u jepnin një patent që t'i përsëritnin krimet që kishin bërë bashkë me ortakët e tyre edhe javën tjetër. E kështu çdo javë, qoftë dimër apo behar; kështu çdo ditë, qoftë e kremte apo ditë pune.

Masllova e bëri këtë jetë shtatë vjet. Gjatë kësaj kohe kaloi dy herë nga një shtëpi publike në tjetrën e një herë u sëmurë e u shtrua në spital. Shtatë vjet pas hyrjes në shtëpinë publike në moshën njëzeteshtatë vjeç, Masllova ra në burg e ndënji atje me vrasës e hajdutë gjashtë muaj, gjersa u nxuar në gjyq.

III

Ndërsa Masllova, e lodhur nga rruga e gjatë, po i afrohej gjyqit e shoqëruar nga rojet, nipi i zonjave që e kishin rritur dikur për shpirt, princi Dimitri Ivanoviç Nekludov, pikërisht ai që e kish mashtruar Masllovën në të ritë e saj, ndonëse qe zgjuar nga gjumi, vazhdonte të rrinte në krevatin e tij të lartë me sustë e me një dyshek të butë prej puplash. Kish veshur një këmishë nate hollandeze, të bardhë borë, me ca pala mbi gjoks, që qëndronin si të ngrira. Me jakën e këmishës zbërthyer gjer poshtë ai po pinte një cigare dhe, me sytë që i kish ngulur diku përpara, mendonte për ato që i kishin ndodhur dje e për ato, që, mbase, do t'i ndodhnin sot. Duke sjellë ndër mënd mbrëmjen që kish kaluar një ditë më parë te Korçaguinët, tek ata njerëz të pasur me vajzën e të cilëve, siç pëshpëritej nga të gjithë, kishte ndër mënd të martohej, ai psherëtiti, dhe, si e flaku tej cigaren, që e kish pirë pothuaj të tërë, u mat të merrte nga kutia e argjëntë një tjetër. Por, pastaj, ndëroi mëndje. Vari poshtë nga krevati këmbët e tij të bardha, shkoi në to pantoflat dhe hodhi mbi shpatullat e bëshme një rrobëdeshambër të mënhdafshtë. U drejtua me hap të shpejtë e të rëndë në dhomën

e tualetit, që kundërmonte nga parfumet çponjëse të kolonjave dhe esencave të ndryshme, pastroi këtu me një pluhur të posaçëm dhëmbët, që i kish vënde-vënde të mbushura, e i shplau mirë me një solucion aromatik. Si i lau duart me një sapun me erë të këndëshme, si pastroi thonjtë e gjatë me një furcë të posaçme, lau fytyrën e zverkun e majmë në një lavaman të madh prej mermeri. Pastaj shkoi në dhomën e dushit. Atje spërkati trupin e tij tërë muskula, të shëndoshë e të bardhë, me ujë të ftohtë, e, si u fshi me një peshqir të trashë me push, veshi ndërresat, të lara e të hekurosura për qejf, mbathi çizmet e llustruara dhe u ul përpara tualetit. Mori në dorë dy vurca e nisi të krehë nga të dy anët mjekrën e tij të vogël, të zezë e kaçurrel si edhe flokët, disi të rralluara mbi ballë.

Të gjitha sendet që përdorte: ndërresat, rrobat, këpucët, kravatat, ishin të thjeshta e të lehta, por nga më të mirat, nga më të shtrenjtat e shumë të volitëshme në përdorim.

Pasi mori nga ndonja dhjetë kravata dhe karfica, që kish rrjeshtuar përpara, ç'i zuri dora (dikur kjo punë e tërhiqte dhe e zbaviste, ndërsa tani s'i bënte më asnjë përshtypje), Nekludovi veshi rrobat që qenë vënë me kujdes mbi një karrige dhe doli që andej për të hyrë në dhomën e bukës. E ndjente veten mirë, ca nga era dehëse që lëshonte tani trupi i tij i parfumuar, e ca nga dushi i ftohtë që e kishte freskuar. Dhoma e bukës ishte një sallë e gjërë, shtruar me një parket që shkëlqente nga të fërkuarit me nge që i kishin bërë një ditë më parë tre muzhikë të fortë e të stërvitur n'atë punë. Në një rrëzë, ngrihej një bufe e madhe prej dru lisi. Pak më tej vinte një tryezë nga ato që hapen e mbyllen e që kishte një pamje shumë hijerëndë e madhështore me këmbët e saj të skalitura si putra luani. Mbi këtë tryezë, ku qe shtruar një mbulesë e hollë e kollarisur, me ca theka të gjata që vareshin gjer poshtë, qenë vënë një kafetiere e argjënt mbushur gjer në buzë me një kafe të porsavluar, një vazo me sheqer, edhe kjo prej argjëndi, një enë porcelani me gjalpë të freskët, një shportë me kulaç të ngrohtë, me paksimadhë e me biskota. M'anën tjetër të tryezës, qenë vënë stivë letrat që kishin ardhur atë ditë, gazetat si edhe numuri i ri i «Revu des deux Mondes».

Nekludovi po matej t'u hidhte një sy letrave kur, nga dera e koridorit, hyri, ose më mirë të themi, shkau brenda ashtu si shket duke u lëkundur mbi ujë një barkë, një grua e plotë, e shkuar nga mosha, veshur me të zeza, me një kapuç

rrethuar me dantella që i mbulonte gjer në një farë vëndi vijën e të ndarit të flokëve të thinjura. Kjo ishte Agrafena Petrovna, kamerierja e princeshës plakë, s'ëmës së Nekludovit, që kish vdekur aty para ca kohe, n'atë shtëpi. Kamerierja i shërbente tani të birit të së ndjerës si nikoqire.

Agrafena Petrovna kish udhëtuar kaq herë bashkë me t'ëmën e Nekludovit në Europë dhe kishte të gjitha sjelljet, mënyrat e pamjen e një zonje të vërtetë. Ajo kishte hyrë në shtëpinë e Nekludovëve që së vogli dhe e njihte Dimitër Ivanoviçin qëkur e thërrisnin akoma Mitjenka.

— Mirë mëngjes, Dimitri Ivanoviç — përshëndeti amvisa plakë.

— Mirë mëngjes, Agrafena Petrovna. Ç'kemi ndonjë të re? — e pyeti Nekludovi me të qeshur.

— Ja, kemi një letër nga princeshat. Po s'e di kush e shkruan: e ëma apo e bija. . . E solli që në mëngjes kamerierja e Korçaginëve. Më tha se pret një përgjegje, — tha Agrafena Petrovna duke zgjatur letrën që mbante në dorë me një buzëqeshje gjithë djallëzi.

— Mirë, ja, tani; le të presë një minutë — tha Nekludovi, por kur vuri re, ndërsa merrte letrën, buzëqeshjen e Agrafena Petrovnës, u ngrys në fytyrë.

Buzëqeshja e Agrafena Petrovnës do të thoshte që letra ishte nga princesha e re Korçagine, me të cilën, sipas mëndjes së Agrafena Petrovnës, Nekludovi kish vendosur të martohej. Kuptimi i asaj buzëqeshje s'i pëlqeu Nekludovit, prandaj dhe u vrënjt.

— Atëhere po i them të presi, — tha Agrafena Petrovna dhe doli jashtë, gjithnjë duke u lëkundur si ndonjë lundër e duke rrëmbyer, ndërsa dilte, një vurcë rrobash të harruar mbi tryezë.

Nekludovi hapi zarfin e parfumuar që i solli Agrafena Petrovna, shpalosi letrën e trashë bojë hiri që gjeti brenda, lexoi shkrimin e parregullt, të hapur e me kthesa të mprehta:

«Ju jam zotuar që sa herë të harroni një gjë t'ua kujtoj. Pikërisht për të përmbushur këtë zotim, ju sjell ndër mend, që sot, më 28 prill, duhet të bëni pjesë në zhurinë e gjyqit të krimeve e, për pasojë, s'do të mundeni të vini bashkë me ne dhe Kolosovin, në ekspozitën e arteve figurative ashtu siç na premtuat, me atë mendjelehtësinë tuaj të zakonshme; moins que vous ne soyez disposé à payer à la cour d'assises les 300 rubles d'amende, que vous vous refusez pour votre

cheval [1]), për mosparaqitjen në kohë. Kjo m'u kujtua dje, kur ju porsa kishit ikur. Pra mos harroni.

Pr. Sha M. Korçagina.

Në faqen tjetër të letrës qe shkruar:

«Maman vous fait dire que votre couvert vous attendra jusque la nuit. Venez absolument à quell'heure que cela soit [2]).

M.K.».

Nekludovi vrënjti vetullat. Ajo pusullë ishte vazhdimi i orvatjeve të matura, por ngulmonjëse që po bënte princesha Korçagina gjatë atyre dy muajve të fundit, për ta futur atë, Nekludovin, në një rrjetë me njëmijë fije të holla të padukëshme që mblidhej vazhdimisht rrotull tij, duke e shtrënguar çdo ditë e më shumë. Nga ana tjetër, veç atij ngurrimi të natyrshëm përpara martesës që vihet re dëndur në njerëz të pjekur në moshë e që nuk dashurojnë me gjithë shpirt, ai kishte dhe një arësye tjetër që s'e lejonte, hë për hë, të martohej edhe sikur të donte. S'qe fjala për Katjushen që e kishte mashtruar e braktisur aty e dhjetë vjetë më parë. Katjushën ai e kishte harruar prej kohësh dhe as që mendonte kurrë se aventura, që kish pasur dikur me të, mund t'i sillte ndonjë pengesë në martesën me princeshën. Jo, jo, tjetër arësye e shtynte Nekludovin të mbante atë qëndrim e, pikërisht, marrëdhëniet e fshehta që kishte me një grua të martuar. Ç'është e vërteta, ato kohët e fundit ai kishte marrë vendim t'i këpuste këto marrëdhënie, por ndeshte në qëndresën e së dashurës që as nuk pranonte të bisedohej për një gjë të tillë.

Nekludovi ishte shumë i ndrojtur me femrat. Dhe pikërisht kjo ndrojtje e tij e theksuar, në marrëdhëniet me seksin e dobët i kishte ngjallur shpresën Maria Vasilievnës, gruas së një marshali të fisnikërisë [3]) ta bënte një ditë skllav. Kështu ajo e kishte tërhequr në një lidhje që bëhej për Ne-

---

1) Natyrisht në qoftëse nuk jeni i dispozuar t'i paguani gjobë gjyqit 300 rubla, të cilat, nuk doni t'i harxhoni për të blerë një kalë (frengj).

2) Mamaja më porositi t'ju them që tryeza do të jetë shtruar për ju gjer natën. Ejani pa tjetër në çfardo ore qoftë (frengj).

3) Në Rusinë cariste ai zgjidhej nëpërmjet votimeve si përfaqësonjës i shtresës së aristokracisë (sh. përk.)

kludovin përherë e më e vështirë për t'u këputur e që i dukej atij çdo ditë më e rëndë. Por sidoqoftë, fajin e kish pasur vetë, se s'kish ditur t'i kundërshtonte ngasjes që e kish hedhur në krahët e gruas së martuar dhe se, më vonë, duke e ndjerë veten fajtor përpara saj, nuk kishte pasur aq zëmër sa t'i këpuste ato lidhje pa pëlqimin e saj. Këto pra ishin arësyet që e bënin Nekludovin të mendonte se s'kishte të drejtë, dhe sikur të donte, të martohej me Korçaginën.

Po atë ditë i kish ardhur me postë një letër nga i shoqi i të dashurës së tij. Kur e pa mbi tryezë letrën, Nekludovi njohu shkrimin e vulën e u skuq në fytyrë duke ndjerë sakaq, ashtu siç i ndodhte kurdoherë përpara një rreziku, një shtim të papritur energjish. Por tronditja e tij qe e kotë, se i shoqi, marshalli i fisnikërisë në distriktin ku ndodheshin pronat kryesore të Nekludovit, i bënte të ditur Nekludovit se aty nga fundi i majit këshilli i zemstvos [1]) do të mblidhej në sesion të jashtëzakonshëm. Ai i lutej Nekludovit të vinte pa tjetër që t'u jepte «un coup d'epaule [2])» në zgjidhjen e çështjeve të rëndësishme që do të diskutoheshin në mbledhjen e zemstvos e sidomos në ato që kishin lidhje me shkollat e me hapjen e rrugëve, ku parashikohej një kundërshtim i fortë nga ana e partisë reaksionare.

Prefekti ishte një njeri liberal dhe, ashtu si shumë të tjerë të kallëpit të tij, luftonte kundër reaksionit që kish ardhur në fuqi në kohën e Aleksandrit III. Kaq qe dhënë pas kësaj lufte e kaq qe zhytur në të, saqë nuk i kish rënë kurrë ndër mend të vinte në dyshim besnikërinë e së shoqes. Nekludovi kujtoi, me atë rast, çastet plot ankth që kish kaluar dikur, atëhere kur dyshonte se mos marshali i kish rënë erë marëdhenieve të paligjëshme që ai mbante me të shoqen e tij. Ju kujtua se si një ditë, duke menduar se i shoqi i kishte marrë vesh të gjitha, qe bërë gati të ndeshesh me të në një dyluftim gjatë të cilit kish vendosur të shtinte në ajër. I doli përsëri përpara syve skena e tmershme që i kish ndodhur me të dashurën kur ajo, në dëshpërim e sipër kish vrapuar në një pellg në kopsht që të mbytej e ai i kish rënë pas si i marrë.

«Sot për sot nuk mund të shkoj e as që mund të marr ndonjë vendim gjersa ajo nuk më ka kthyer akoma ndonjë

---

1) Këshilla provinciale të zgjedhura nga radhët e fisnikërisë dhe pronarëve të mëdhenj të tokave në Rusinë cariste (sh. për.)

2) Goditje krahëve (shën. i përkth.).

përgjegje» — mendoi Nekludovi. Aty e një javë më parë ai i kish shkruar një letër, ku e pohonte veten fajtor karshi saj dhe tregohej i vendosur e i gatshëm për ta larë në çdo mënyrë fajin të tij, por e përfundonte duke thënë se, për të mirën e saj, marrëdhëniet ndërmjet tyre duhej të merrnin fund një herë e mirë. Kish kohë që e kish dërguar këtë letër, por akoma s'kish marrë ndonjë përgjegje. Kjo gjer diku mund t'ishte pjesërisht për të një shenjë e mirë, sepse, sikur ajo të mos pranonte këputjet e marrëdhënieve, do t'i kishte shkruar pa vonesë, ose do t'i kish çatisur në shtëpi, siç kishte bërë edhe herë tjetër. Nekludovi kish dëgjuar se atje tani kish vajtur një oficer që i vinte rrotull Maria Vasilievnës. Kjo e prekte thellë në sedrën e tij prej mashkulli të gënjyer, por në të njëjtën kohë ja ngrohte zëmrën me shpresën e një çlirimi të shpejtë nga ajo gjëndje sa e rëndë aq dhe e turpëshme për të.

Një letër tjetër mbi tryezë ishte nga kryeadministratori i çifliqeve. Kryeadministratori shkruante se Nekludovi duhej të shkonte atje pa tjetër për të marrë një vërtetim mbi të drejtat e trashëgimisë si edhe për të vendosur një herë e mirë mbi mënyrën e qeverimit të pronavet të tij në të ardhmen: në duheshin qeverisur ashtu si në kohën kur qe gjallë e ndjera princeshë, apo ndryshe. Administratori, për hesap të tij, ishte i mendimit që t'i grisnin kontratat me fshatarët e t'ua merrnin atyre të gjitha tokat që u kishin dhënë me qira. Për këtë ai kishte ngulur këmbë kaq e kaq herë pranë së ndjerës princeshë e merrte tani përsëri mundimin t'ja vinte në dukje edhe princit, birit të saj. Administratori shprehej i bindur se shfrytëzimi i drejtpërdrejtë i këtyre tokave do të shtonte në një përqindje të lartë të ardhurat e çifligjeve. Më në fund ai përfitonte nga rasti për të kërkuar ndjesë për vonesën e tremijë rublave që duhej t'i kish dërguar që më datën një të muajit. Por princi të mos bëhej merak, shkruante administratori, se të hollat në fjalë ja kish nisur. Vonesa qe shkakëtuar ngaqë fshatarët e kishin shpurë mosmirënjohjen e tyre ndaj mirësive të princit gjer në atë pikë, sa ta detyronin, për të mbledhur taksat, t'u drejtohej organeve shtetërore. Kjo letër i ngjalli Nekludovit ndjenjën e dyshimit. Nga njera anë, atij i vinte mirë ta ndjente veten zot të një prone të madhe, por nga ana tjetër, duke sjellë ndër mend se si dikur, kur kish qenë fare i ri, që treguar një dishepull entusiast i Herbert Spenserit e i teorive të këtij mbi pronën, i vinte turp tani nga vetja. Di-



kur, duke qënë dhe vetë një pronar i madh tokash, qe bashkuar me bindje të plotë me përfundimin në të cilin arrinte Spenseri në veprën e tij «Social Statics» d.m.th. që drejtësia dhe prona private e tokës janë dy gjera krejt të papajtuarshme. Me sinqeritetin e vendosmërinë e rinisë së parë, ai jo vetëm që kish pranuar se toka nuk duhet të jetë pronë dhe e kish mbrojtur këtë pohim në një vepër që kish shkruar kur kish qënë akoma në universitet por, për t'u qëndruar besnik bindjeve të tij gjer në fund, i kishte dhënë edhe vetë fshatarëve një pjesë të vogël toke që e kishte trashëguar nga i ati. Tani që, pas vdekjes të s'ëmës, kish trashëguar të gjitha çifligjet e saja të mëdha, atij i mbeteshin dy rrugë: ose të hiqte dorë nga prona, ashtu siç kish bërë aty e dhjetë vjet më parë, me ato dyqind desjatina tokë që i kish lënë i ati, ose të pranonte heshtazi që të gjitha bindjet e tij të mëparëshme kishin qënë të gabuara.

Që të zgjidhte rrugën e parë kjo ishte për të krejt e pa mundur, sepse, veç tokës, nuk kishte mjete të tjera jetese. Që të shërbente në ushtri, nuk i pëlqente e, veç kësaj, zakonet e rehatet e jetës mondane që bënte prej kohësh ishin ngulitur kaq thellë në shpirtin e në trupin e tij, saqë nuk besonte kurrë se do të mund të shkëputej, një ditë, prej tyre. Por kjo, fundja, s'qe as e nevojëshme, sepse ai nuk ndjente më në veten e tij atë forcë bindjesh, atë vendosmërinë, atë ambicjen dhe atë dëshirën për t'i habitur të gjithë që kishte patur kur qe i ri. Por po aq e vështirë ishte për të edhe rruga e dytë ngaqë s'ishte i zoti t'i kundërshtonte përfundimet jashtëzakonisht të kthjellta e bindëse që kish nxjerrë, lidhur me pronën e tokës, nga «Statika sociale» e Spenserit, e që provoheshin më së miri, sipas mendimit të tij, nga vepra e Henri Xhorxhit.

Ja përse letra që i dërgonte kryeadministratori nuk e kënaqi por i shkaktoi, përkundrazi, një mërzi të rëndë.

IV

Si piu kafenë, Nekludovi hyri në kabinetin e tij për t'i hedhur një sy lajmëthirjes që i njoftonte orën kur duhej të paraqitej në gjyq si edhe për t'i kthyer përgjegjen princeshës. Për të shkuar në kabinet duhej kaluar përmes një dhome të pajisur me të gjitha orenditë e një atelieri të

vërtetë. Këtu ngrihej, mu në mes, një kambalec e, mbi të, një tabllo e papërfunduar e kthyer me faqe nga muri. Për rreth qenë varur gjithfarë «etude». Pamja e asaj tablloje, mbi të cilën ai qe dirsur plot dy vjet, si edhe ajo e «etudeve» i rikujtuan Nekludovit ndjenjën e pazotësisë së tij për të ecur përpara në pikturë. Kohët e fundit ai po e provonte këtë ndjenjë me një ngulm të dyfishuar, por prapë e ngushëllonte veten duke menduar se me atë shijen e tij estetike tepër të hollë, ishte e pamundur të kënaqej me një temë kaq të rendomtë e të lehtë, siç ishte përmbajtja e tablosë që s'kish mundur ta mbaronte.

Aty e shtatë vjet më parë, ai kish dhënë dorëheqjen nga shërbimi ushtarak, i bindur se zotëronte prirje me të vërtetë të spikatura për pikturë. Nga maja e lartë e veprimtarisë artistike, të gjitha veprimtaritë e tjera i qenë dukur atëhere pothuajse fare të papërfillëshme. Mirëpo tani po kuptonte se nuk kishte qenë tamam ashtu, se prirjet e tija nuk kishin qënë aq të spikatura sa kishte menduar, se edhe veprimtaritë e tjera kishin rëndësinë e tyre e nuk mund të përbuzeshin. Prandaj edhe ai rikujtim që pati kur hyri në atelje, i ringjalli një ndjenjë pakënaqësie. Ai i vështroi me zëmër të thyer të gjitha pajimet luksoze rreth e rrotull dhe kur hyri në kabinet s'dukej aspak i qeshur. Kabineti ishte një dhomë shumë e madhe, me një tavan shumë të lartë ngarkuar me gjithfarë stolira, pajime e orendi të rahatëshme.

Nekludovi hapi sirtarin e një tryeze të madhe, nxori që andej dosjen e shkresave urgjente dhe lexoi lajmëthirrjen që e njoftonte se duhej të paraqitej në gjyq në orën njëmbëdhjetë. Si i bëri të gjitha këto, u ul përpara tryezës e nisi t'i shkruaj princeshës një pusulle me anë të së cilës e falënderonte për ftesën që i bënte në shtëpinë e saj dhe e siguronte që do të përpiqej të ndodhej aty për drekë. Por, pasi e shkruajti këtë pusullë, e grisi, sepse iu duk pak si tepër intime. Nisi një tjetër. Por edhe këtë e grisi, sepse iu duk pak si tepër e ftohtë. Më në fund hoqi dorë nga pusullat e i ra ziles. Menjëherë u dha në derë një shërbëtor mjekër rruar me baseta, i kaluar nga mosha, i ngrysur në fytyrë, me një përparëse të hijëshme prej kelenkori. [1])

— Ju lutem lajmëroni karrocierin të bëhet gati.

— Si urdhëroni, shkëlqesi.

---

1) Një lloj tekstili.

— Ju lutem gjithashtu t'i thoni kamarieres së Korçaguinëve se e falenderoj princeshën dhe se do të mundohem të mos mungoj.

— Si urdhëron, shkëlqesi.

«S'u solla mirë vërtet, po si t'ja bëj gjersa s'di si t'i shkruaj? Fundja s'prish punë, se takohem sot me të dhe i kërkoj ndjesë», — mendoi Nekludovi e shkoi të vishej.

Pasi u vesh, kur dolli jashtë në verandë, pa karrocierin që po e priste majë një «fiacre» shumë luksoze me ca rrota prej gome të butë.

— Unë dje erdha tek princërit Korçagin, jo se s'erdha, — tha karrocieri duke e vërtitur, me një gjysëm rrotullimi, në jakën e bardhë borë të këmishës, atë zverkun e tij të trashë e të pjekur nga dielli, — po ç'e do, se s'arrita në kohë! E pyes kamarierin e më thotë: «Sapo iku». E ja, kështu, u ktheva bosh.

«Këto marrëdheniet e mia me Korçaginët i paskan marrë vesh tani edhe karrocierët» — mendoi Nekludovi dhe përsëri i bëri vetes pyetjen që e mendonte vazhdimisht kohët e fundit dhe që priste prej tij një përgjegje: duhej apo nuk duhej të martohej me Korçaginën? Por kësaj pyetjeje ashtu si edhe shumë pyetjeve të tjera, që i lindnin në atë periudhe të jetës së tij, Nekludovi s'i përgjigjej dot as «po», as «jo».

Arësyetimet pro martesës përmblidheshin në këto pika:

E para: martesa, përveç kënaqësive të vatrës familjare, duke zhdukur një herë e mirë të gjitha çregullimet e jetës seksuale, jepte mundësitë për një jetë përsosmërisht morale.

E dyta: fëmijët, të paktën kështu mendonte Nekludovi, dhe familja do t'i jepnin më në fund një kuptim jetës së tij, që ishte gjer ahere fare bosh.

Këto ishin pro martesës në përgjithësi, kurse kundra martesës në përgjithësi qëndronte, në radhë të parë, frika e zakonëshme dhe e pavetëdijëshme që kanë të gjithë beqarët, kur nuk janë më edhe aq të rinj, se mos humbasin lirinë dhe, në radhë të parë, frika e turbullt dhe e papërcaktuar e çdo mashkulli përpara misterit të femrës.

Pro martesës në veçanti, d.m.th. pikërisht me Missin (princeshën e re të Korçaginëve e quanin në të vërtetë Maria, por, ashtu siç bëhej në të gjithë familjet e shquara të rendit të saj, në shtëpi e thërrisnin zakonisht me një paranom) arësyetimet rrjeshtoheshin në këtë mënyrë: në radhë të parë

ajo ishte e sojme dhe, veç kësaj, në çdo gjë, duke filluar nga fustanet e gjer tek mënyra e të folurit, e të ecurit, e të qeshurit shquhej, jo për ndonjë gjë të jashtëzakonëshme, por për atë korrektesën e saj me të vërtetë të rrallë. Kjo cilësi, që Nekludovi e kish pagëzuar kështu se s'kish ditur t'i gjente dot një emër më të përshtatur, ishte, në sytë e tij, nga cilësitë e shumta të Missit, ajo më e rëndësishmja. Në radhë të dytë, gjithmonë pro martesës me Missin, qendronte dhe një arësye tjetër; ajo e çmonte atë, Nekludovin, më tepër nga çdo njeri tjetër dhe kjo, sipas mendimit të tij, dëshmonte qartë se ajo ishte në gjendje ta kuptonte më së miri. Kjo aftësi për ta kuptuar, me fjalë të tjera, për t'i njohur atij cilësitë e larta me të cilat qe pajisur, s'i linte asnjë pikë dyshimi Nekludovit për mëndjen e saj të ndritur, për gjykimin e saj të mprehtë e të thellë. Kundër martesës, pikërisht me Missin, qëndronte, në radhë të parë, shpresa se mund të gjëndej një vajzë me merita edhe më të mëdha se sa Missi e, pra, edhe më të denjë për të si edhe, në radhë të dytë, dyshimi se, duke qënë tanimë njëzet e shtatë vjeçe, e pra jo më dhe aq e re, ajo mund të kishte dashuruar edhe një tjetër më parë — ky dyshim e brente Nekludovin ditë e natë. Krenaria e tij nuk mund të pranonte kurrë që gruaja e tij të kish dashuruar, qoftë edhe në të kaluarën e largët, një njeri tjetër. Vërtet, ajo nuk mund ta dinte se do të takohej një ditë me të e, pra, nuk qe për t'i vënë faj. Por, sidoqoftë, mendimi qe ajo kish mundur të dashuronte edhe një njeri tjetër, përveç Nekludovit, e fyente atë thellë në sedër.

Kështu arësyet pro e kundra, si për sa i përket sasisë ashtu edhe përsa i përket forcës së tyre bindëse, barazoheshin dhe Nekludovi, që s'dinte nga t'ja mbante, thoshte për veten e tij me të tallur se e kish pësuar tamam si ai gomari i Buridanit në përrallë.

«Sidoqoftë pa marrë një përfundim nga Maria Vasilievna (e shoqja e marshallit të fisnikërisë), pa e shkoqur mirë punën me të, s'kam si bëj dot asnjë hap» — tha ai me vete dhe ky arësyetim i pëlqeu sepse e justifikonte plotësisht atë gjendje ngurrimi, në të cilën ndodhej, duke i dhënë mundësinë ta shtynte marrjen e një vendimi për më vonë.

«Sidoqoftë të gjitha këto do t'i çkoqit kur t'u vijë koha» mendoi kur karroca e tij, duke shkarë lehtë dhe pa zhurmë mbi rrugën e asfaltuar, iu afrua gjyqit.

«Tani le t'i lë të gjitha mënjanë dhe le të mundohem

ta kryej me dorë në zemër e me ndërgjegje të plotë, ashtu siç bëj përherë, këtë detyrë të rëndësishme shoqërore që më është ngarkuar. Pastaj ngandonjëherë në gjyq edhe s'mërzitesh, sepse ka gjëra interesante», tha me vete tek kalonte pranë portierit e hynte në koridorin e gjyqit.

V

Kur Nekludovi kaloi prakun e gjyqit, koridoret qenë plot me njerëz. Gardianët, të ngarkuar me gjithfarë porosira e shkresurina, silleshin lart e poshtë, herë me vrap e herë me hap, duke i zvarritur këmbët me zhurmë. Policët, avokatët dhe gjyqtarët hynin parreshtur në një derë e dilnin nga një tjetër, paditësit dhe të padituri, që ishin lënë të lirë, baritnin të pikëlluar rrëzë mureve ose uleshin ku mundnin duke pritur radhën.

— Gjyqi i rrethit ku është? — pyeti Nekludovi një gardian.

— Ju kërkoni civilin apo atë tjetrin, të krimeve?

— Unë bëj pjesë në zhuri.

— Atëhere duhet të shkoni në gjyqin e krimeve. Kot sa s'ma thatë që në fillim. Ja, bëni nga e djathta, pastaj nga e majta, dera e dytë përballë.

Nekludovi bëri si i thanë.

Gjeti në derë dy njerëz që po pritnin: njeri syresh ishte një tregëtar i trashë e i gjatë, një burrë babaxhan që, me ç'kuptohej, qe rrumbullakosur mirë me vodkë e me mezera, sepse dukej çakërqejf; tjetri ishte një agjent tregëtar me origjinë çifute. Nekludovi i gjeti tek po bisedonin për çmimin e leshit. Iu afrua dhe i pyeti në ishte ajo dhoma e zhurisë.

— Kjo është, mor zot, kjo. Si, or vëlla, edhe ju nga të zhurisë qënkeni? — ja ktheu tregëtari babaxhan e i shkeli sakaq syrin tërë qejf. — E po ahere do të punojmë bashkë, — vazhdoi kur Nekludovi ja bëri po me kokë. — Bakllashov i gildës [1]) së dytë, — tha pastaj duke i shtrirë pëllëmbën e tij të gjërë e të butë që mezi përkulej. — pa punë s'bëhet gjë. Me cilin kam nderin të njihem?

Nekludovi tha si e quanin dhe hyri në dhomë.

---

1) Në Rusinë cariste para revolucionit një nga kategoritë në të cilat ndahej shtresa e tregëtarëve si pas pasurisë.

Në dhomën e vogël të zhurisë qenë mbledhur ndonja dhjetë veta. Porsa kishin ardhur e disa qenë ulur, kurse të tjerët silleshin rrotull duke i hedhur sytë njeri tjetrit e duke u njohur mes tyre. Atje ishin një pensionist me uniformë, disa zotërinj me rendigotë, të tjerë me setër e me pantallona dhe, nga të gjithë vetëm njeri qe veshur me padiofkë.

Ndonëse i kishin shkëputur nga puna dhe për këtë s'u kish ardhur mirë se qaheshin orë e çast, që të gjithë mbanin në fytyrë vulën e një kënaqësie të thellë për atë përgjegjësi të rëndësishme shoqërore që u ishte ngarkuar.

Anëtarët e zhurisë, si ata që kishin arritur të njiheshin ashtu dhe të tjerët, bisedonin për motin, për pranverën që kish ardhur herët atë vit dhe për punët që i pritnin. Ata që nuk qenë njohur me Nekludovin nguteshin të njiheshin me të duke menduar, me sa dukej, që ky ishte për ta një nder shumë i madh. Nekludovi, nga ana e tij, ashtu siç bënte përherë kur ndodhej me njerëz të panjohur, i pranonte këto nderime si diçka që i përkisnin me plot të drejtë. Sikur ta kishin pyetur përse e mbante veten më të ngritur nga njerëzit e tjerë, ai nuk do të kishte qenë në gjendje të përgjigjej, meqenëse në tërë jetën e tij nuk qe shquar ndonjë herë për ndonjë cilësi apo meritë të posaçme. Ç'është e vërtetë ai e fliste anglishten, frëngjishten dhe gjermanishten; ndëresat, rrobat, kravatat e pulsetat e këmishëve i blinte përherë në dyqanet më të mira e nga më të shtrenjtat; por, ashtu siç e kuptonte edhe vetë, kjo nuk ishte një arësye e mjaftueshme për t'u shquar dhe për t'u ngritur mbi njerëzit e tjerë. Me gjithë atë, ai nuk mund të mos besonte kurrësesi në epërsinë e tij mbi ata që e rrethonin dhe i pranonte nderimet që i bëheshin pa u çuditur, bile fyhej e zëmërohej kur nuk ja bënin. Pikërisht në sallën e zhurisë, atij i qëlloi ta provojë pas kaq kohe, ndjenjën e papëlqyeshme që i shkaktonte mungesa e respektit. Ndër anëtarët e zhurisë u ndodh edhe një i njohur i Nekludovit. Ky ishte Pjotër Gerasimoviçi (Nekludovi nuk kishte ditur kurrë se si e quanin, dhe këtë e pohonte edhe vetë me mburrje), që kish qënë dikur mësonjësi i fëmijëve të motrës së tij. Ky Pjotër Gerasimoviçi kish mbaruar universitetin e jepte mësim tani në gjimnaz si profesor. Familjariteti i tij i tepruar, e qeshura e tij e bujëshme që shkreptinte me vend e pa vend, fodullëku, që nuk mundohej ta fshihte dhe që nuk i lejohej një njeriu të sërës tij e sidomos «komuniteti» i tij, siç e quante e motra e Nekludovit, ja cytnin ligsht nervat Nekludovit sa herë që takohej me të.

— Ehe, edhe ju këtu, — i tha Pjotër Gerasimoviçi Nekludovit porsa e pa dhe ja plasi gazit. — E po si, nuk i bëtë dot bisht?

— As që e mendova një gjë të tillë, — ja ktheu Nekludovi me të rreptë e si i zëmëruar.

— Po kësaj i thonë trimëri, trimëri e madhe për besë, e jo e vogël. Po pritni sa të sharroni nga uria e të ngordhni për gjumë pa pastaj fjalosemi bashkë, — tha Pjotër Gerasimoviçi e ja plasi përsëri gazit me gjithë shpirt.

«Ky djalë i protodhjakut dalngadalë do fillojë të më drejtohet me ti», — mendoi Nekludovi e, duke i dhënë fytyrës një shprehje pikëllimi kaq të thellë sa të mendoje që atë çast porsa i kishin lajmëruar vdekjen e ndonjë njeriu t'afërt, u largua dhe u afrua tek një grua që dëgjonte gojhapur zotërinë mjekërr-ruar, shtatëlartë e hijerëndë. Ky po fliste atë kohë për proçesin që po zhvillohej në gjyqin civil e i tregonte të gjitha me hollësi, duke i përmëndur gjykatësit dhe avokatët e famshëm me emër e mbiemër tamam si një njeri që i di punët me rrënjë. Ai vinte në dukje kthesën e çuditëshme e të papritur, që kish ditur t'i jepte gjyqit një avokat i famshëm dhe që kish bërë në mënyrë që njera nga palët, një zonjë plakë, të detyrohej t'i paguante, fare pa të drejtë, palës kundërshtare një shumë të madhe të hollash.

— Ju them unë, ai është një avokat gjenial! përsëriste kohë më kohë burri i pashëm dhe hierëndë mjekrruar.

Të gjithë e dëgjonin me respekt të madh, disa orvateshin me të ndrojtur të bënin aty këtu ndonjë vrejtje, por ai i ndërpriste të gjithë e s'i linte të flisnin duke u treguar kështu se, me përjashtim të tij, asnjë tjetër nuk mund të shprehej mbi atë çështje me aq kompetencë.

Nekludovi qe paraqitur në gjyq vonë, por prapë iu desh të priste për një kohë të gjatë. Fillimi i seancës vonohej për shkak të një anëtari të gjyqit që s'kish ardhur akoma.

VI.

Kryetari erdhi në gjyq që në mëngjes heret. Kryetari ishte një burrë shtatlartë dhe i plotë me ca baseta të gjata e të thinjura. Ndonëse ishte i martuar, bënte një jetë krejt të çthurur pikërisht ashtu si edhe e shoqja e tij. Atë mëngjes ai kishte marrë një pusullë nga një guvernante zvicerane që

kish banuar dikur verës në shtëpinë e tij dhe që, duke kaluar rastësisht nga qyteti, për në Peterburg, i shkruante ta priste në hotelin «Italia» midis orëve tre e gjashtë të mbrëmjes. Për këtë arësye kryetari i gjyqit donte ta fillonte e ta përfundonte seancën e gjyqit sa më parë, i merakosur siç ishte, që të arrinte në kohë për t'u takuar me Klara Vasiljevnën, atë bukuroshen flokëkuqe me të cilën kish thurur një behar të tërë një roman të gjatë dashurie.

Si hyri në kabinetin e tij, ai e mbylli derën me çelës, nxori nga rafti i shkresave dy pesha të rënda e bëri ndonjë njëzet lëvizje lart e poshtë, majtas e djathtas, kryq e tërthor, gjersa, më në fund, si u përkul tri herë me një lehtësi e shkathtësi që iu duk e kënaqëshme, i ngriti peshat mbi kokë e i mbajti ashtu një copë herë pa lëvizur.

«Nuk ka gjë tjetër më të mirë për shëndetin se sa hidroterapia dhe gjimnastika», — mendonte, ndërkaq, duke pickuar me dorën e mëngjër, muskujt e dorës së djathtë. I kish mbetur akoma pa bërë figura e mullirit (këtë e bënte zakonisht kur parashikohej ndonjë seancë e gjatë); por atë çast dera lëvizi. Me sa dukej, dikush po mundohej ta shtynte. Kryetari u ngut t'i vinte peshat në vendin e tyre, të sulej ta hapte.

— Më falni! — tha.

Në dhomë hyri një nga anëtarët: një burrë me ca syza floriri mbi hundë, jo i lartë nga shtati, me shpatulla të gjera e me fytyrë të vrënjtur.

— Ai Matvej Nikitiçi s'na erdhi në kohë as këtë radhë, — tha anëtari, i pakënaqur.

— E di, e di, — u përgjegj kryetari duke veshur uniformën. . . Ashtu si ngahera, vonohet.

— Çudi e madhe me të, si s'e vret pakë ajo dreq ndërgjegje. Po duket s'ka fare! — tha përsëri anëtari dhe, si i vari turinjtë e ngrysi fytyrën, u ul në një karrige dhe nxori nga xhepi paketën e cigareve.

Anëtari i gjyqit, që ishte një njeri shumë i përpiktë, kish pasur atë mëngjes një grindje në familje. Ja se si kishte qënë puna: ai i kishte dhënë së shoqes një sasi të holla nga rroga duke i thënë që me ato duhej të kalonte tërë muajin. Por e shoqja i kishte bërë fyt paratë para kohe dhe i kishte thënë të shoqit që me aq sa i kish dhënë s'e nxirte dot muajin. I qe lutur t'i jepte të tjera, por ai s'kish dashur e kish ngulur këmbë që të bëhej si donte ai e jo si donte ajo. Dhe kështu kish ndodhur ajo grindja që thamë. Gruaja i kish

dhënë burrit ultimatumin duke i shpallur zyrtarisht se që atë ditë e tutje do ishte e kotë të priste më drekë në shtëpi dhe se do të bënte mirë të hante jashtë. Nga ato fjalë, burri i gjorë kish dalë nga shtëpia tërë ankth e frikë se mos e shoqja, me atë kokëfortësinë që ai ja dinte mirë, e mbante fjalën e i thante barkun. «E pastaj ec e bëj një jetë të mirë po deshe, një jetë të kulturuar, siç i thonë, — mendonte ai tani duke vështruar me zili fytyrën plot shëndet e të qeshur të kryetarit, i cili, si për inat, i kishte hapur krahët duke u mbështetur në bërrylet mbi tryezë dhe me duart e tij të bardha lëmonte basetat e dëndura e të përthinjura që i zbrisnin gjer poshtë nga të dy anët e jakës së kollarisur. — Ky s'do t'ja dijë hiç, dhe qejfin s'e prish fare, kurse mua të ziut s'më qeshi kurrë buza».

Ndërsa anëtari gërmonte thellë e më thellë në ato mendimet e tij plot trishtim, dera u hap e hyri sekretari. Ai i sillte kryetarit ca shkresa.

— Shumë falemnderit, miku im, — tha kryetari duke marrë shkresat e, si ndezi një cingare, e pyeti: — Që nga do t'ja fillojmë?

— Në më pyesni mua, unë them ta fillojmë nga ai rasti i helmimit, — u përgjegj sekretari duke u munduar të tregonte sikur për të ishte e parëndësishme nga cili rast do të fillohej.

— Mirë, po e fillojmë nga helmimi, — tha kryetari duke menduar se kishte të bënte me një çështje që do të mund të përfundohej para orës katër. — Po a nuk më thua, Matvej Nikitiçi akoma nuk ka ardhur?

— Jo, akoma.

— Po Breri erdhi gjë?

— Erdhi, — u gjegj sekretari.

— Atëhere ju lutem t'i thoni që do ta fillojmë nga helmimi.

Brevi ishte zëvëndësprokurori i ngarkuar me leximin e pretencës.

Sekretari doli. Në koridor takoi Brevin. Ky po ecte me të shpejt, thuajse me vrap, duke i përplasur takat e këpucëve me sa mund, me shpatullat të ngritura përpjetë, me kapajdallëk, me uniformë të zbërthyer, me çantë nën sqetull e duke e tundur e shkundur dorën e lirë në mënyrë që të rrinte përherë pingul me drejtimin e hapave të tij të ngutura.

— Mihail Petroviçi m'u lut t'ju pyes në jeni gati, — tha sekretari.

— Domosdo që jam gati. Kur s'kam qënë gati unë? — U përgjegj zëvëndësprokurori. — Po nga do ta fillojmë?

— Nga helmimi.

— Shumë mirë, — tha zëvëndësprokurori, ndonëse mendonte krejt të kundërtën. Ai s'kishte vënë gjumë në sy tërë atë natë. Kishin përcjellur një shok e, siç ndodh rëndom në të tilla raste, kishin pirë pa hesap e kishin luajtur kartat gjer në orën dy të natës, pastaj qenë ngatërruar me ca gra, pikërisht në atë shtëpinë publike ku, aty e gjashtë muaj më parë, kish punuar edhe Masllova. Kështu, për pasojë, nuk kishte pasur kohë t'i hidhte qoftë dhe një sy proçesit të helmimit e, natyrisht, tani kërkonte ta fitonte edhe kohën që kishte humbur. Sekretari, që e dinte fare mirë sa e kishte lexuar proçesin e helmimit zëvendësprokurori Brev, e kishte këshilluar kryetarin që të fillonin pikërisht nga ky proces. Sekretari ishte njeri me mendime liberale, për të mos thënë radikale. Brevi, përkundrazi, qe konservator dhe, ashtu si të gjithë gjermanët që kanë nëpunësira në Rusi, kishte një simpati të posaçme për fenë ortodokse. Nga kjo e sidomos ngaqë ja kishte zili vendin, sekretari e kishte halë në sy dhe, sido që këtë nuk e çfaqte, e urrente pa masë.

— Po ajo puna e «Skopceve» si u la? — pyeti sekretari?

— Gjersa nuk ka dëshmitarë, unë s'e marr dot përsipër; — u përgjegj prokurori, — kështu do të them edhe në gjyq.

— Po, sidoqoftë. . .

— S'e marr përsipër, dhe pikë! — ja preu shkurt prokurori dhe u ngrit e shkoi me nxitim në kabinetin e tij.

Brevi, që kishte hequr dorë nga proçesi i «Skopceve» me pretekstin e mungesës së një dëshmitari që ishte krejt i parëndësishëm e bile i panevojshëm, e kishte bërë këtë vetëm e vetëm sepse në një gjyq ku zhuria zgjidhej në pjesën më të madhe nga klasa intelektuale ishte frikë se mos proçesi përfundonte me faljen e të pandehurve. Ai arriti gjer atje sa ta nxisë e ta bindë kryetarin që t'ja përcillte këtë çështje ndonjë gjyqi të provincës, ku fshatarët që merrnin pjesë në seancat gjyqësore qenë më të shumtë, e, pra, qenë më të shumta mundësitë e dënimit të fajtorëve.

Lëvizja nëpër koridore sa vinte e shtohej. Shumica e popullit qe grumbulluar pranë sallës së gjyqit civil, ku zhvillohej ai proçes i çuditshëm për të cilin burri i pashëm me

baseta, u kishte folur pak më parë zotërinjve të zhurisë. U bë një pushim. Nga salla e gjyqit doli një grua plakë: ishte viktima e avokatit gjenial, që kish ditur t'ja merrte të gjithë pasurinë, gjer në kopejkën e fundit, për t'ja dhënë klientit të tij, që s'kishte mbi këtë pasuri asnjë të drejtë. Ndonëse këtë gjë e dinin edhe vetë gjyqtarët si edhe avokati i paditësit, strategjia e gojëtarit të famshëm kish qënë kaq e hollë e kaq elegante sa që ishte gjynah të mos i merrej plakës pasuria e të mos i jepet paditësit. Plaka ishte një grua e trashë, me një fustan të çmueshëm e sipas modës, me një kapelë ngarkuar plot e përplot me ca lulka të mëdha gjithfarë ngjyrash. Ajo kapërceu prakun e derës e, si u ndal në koridor, duke hapur e mbyllur kohë më kohë ato krahët e saj topolake, iu shkreh avokatit të saj:

— Ç'është kjo? Ku është parë kjo? Si u bë kjo punë?

Avokati sodiste i përqëndruar ngjyrat e ndezura të luleve mbi kapele, s'u hiqte sytë e, me sa dukej, diç bluante në kokë, sepse s'ja vinte fare veshin klientes së tij të pikëlluar.

Fill pas plakës, doli nga dera e gjyqit civil dhe avokati i famshëm që, me atë strategjinë e hollë që thamë, kish ditur ta linte plakën me gisht në gojë e, duke marrë nga klienti i tij dhjetëmijë rubla, i kish fituar këtij njëqindmijë. Fytyra i tradhëtonte një kënaqësi, një vetbesim të pamatur e një mburrje të tepruar. Zhileja, e hapur tejpërtej, lëshonte nga të katër anët një ndriçim verbonjës. Me qindra palë sy u drejtuan nga avokati, ndërsa trupi, fytyra, rrobat, dhe këpucët e tij dukej sikur merrnin vetvetiu një qëndrim si për të thënë: «Ju lutem, zotërinj, mos më humbisni kohë me çfaqjet e admirimit tuaj të bezdisëshëm!»

Kështu mbase mendonte avokati i famshëm, por s'tha asgjë e duke kaluar me hap të shpejtë përmes turmës, që u ça në dysh, për t'i hapur rrugë, u zhduk.

VII

Erdhi më në fund edhe Matvej Nikitiçi. Erdhi me të edhe ftuesi i gjyqit që ishte një burrë thatim, me një qafë të gjatë, me një trup gërmuq, me një buzë të varur e të këcyer.

Ftuesi i gjyqit ishte një burrë i ndershëm. Shkollën e kishte të madhe sepse kishte mbaruar universitetin, por ç'e do që nga puna e vodkës, që e pinte pa hesap, s'ngulej dot

në një vënd për një kohë të gjatë. Këtë vënd, që kishte tani, ja dinte një konteshe, një zonje shpirtgjërë e mbrojtëse të madhe të gruas së tij. Kushedi përse ai e kishte marrë me qejf këtë punë dhe, për çudi, po bëheshin tre muaj që s'kishte lëvizur që andej.

Kur hyri në dhomën e zhurisë, ai vuri mbi hundë syzat e, duke hedhur vështrimin mbi të, iu drejtua të pranishmëve e pyeti: — E po, zotërinj, a u mblodhën të gjithë?

— Të gjithë sikur janë mbledhur, s'më duket se mungon njeri, — tha tregëtari qejfli.

— Pa të shohim, — tha ftuesi e, si nxori nga xhepi një listë, nisi të bëjë apelin duke vështruar nga anëtarët e zhurisë.

— Këshilltari i shtetit J.M. Nikiforov.

— Këtu — u përgjegj zotëria i pashëm që hiqej i rrahur në çdo çështje gjyqësore.

— Koloneli pensionist Ivan Vanienoviç Ivanov.

— Këtu, — foli një burrë thatim i veshur me uniformën e pensionistit.

— Tregëtari i gildës së dytë Pjotër Bakllashov.

— Urdhëroni, — u përgjegj tregëtari me një buzëqeshje të padjallëzuar, ashtu siç ishte dhe vetë. — Gati jam!

— Togeri i gardës, Princi Dimitri Nekludov.

— Këtu! — u përgjegj Nekludovi.

Ftuesi i gjyqit, që ishte, siç thamë, një burrë i ndershëm, e vështroi mbi syzat e tij me një respekt e dashamirësi të veçantë e u përkul lehtë si për ta shquar në atë mënyrë Nekludovin nga të tjerët.

— Kapiteni Juri Dimitrieviç Dançenko. Tregëtari Grigori Efimoviç Kuleshov, — etj.

Mungonin vetëm dy.

— Tani zotërinj, ju lutem të urdhëroni në sallë, — tha ftuesi e me një gjest të këndshëm bëri me shenjë për nga dera.

Të gjithë u ngritën e, duke i hapur njeri tjetrit rrugën përpara derës, duallën në koridor e që andej në sallën e seancave.

Salla e gjyqit ishte një dhomë e gjërë dhe e gjatë. Në një cep të saj ngrihej një si podjum i lartë me ndonja dy a tri shkallë. Mbi këtë podjum, mu në mes, qe vendosur një tryezë e mbuluar me një cohë të blertë të rrethuar anash me ca theka gjithashtu të blerta, por në një ngjyrë pak më të mbyllur. Nga pas tryezës, ndodheshin tre kolltuqe me ca shpina

dru lisi të gdhendura e shumë të larta e, pas kolltuqeve, qe varur në mur një portret me një kornizë të praruar, ku paraqitej një gjeneral i krekosur e kapadai në uniformën e tij të re kër me ca kordona mbi gjoks e mbi bark, me një këmbë nxjerrë pak përpara e me një dorë mbështetur mbi shpatë. Në të djathtë, në një qoshe, qe varur një ikonë me fytyrën e Krishtit, me kurorën e gjëmbave mbi kokë dhe, po në atë anë, qe vendosur një karrige ku do të ulej prokurori. Në të majtë, tamam ballë për ballë me karrigen e prokurorit, ishte tryeza e vogël e sekretarit dhe më pranë publikut, një parmak prej dru lisi të skalitur, pas të silit ndodheshin bangot akoma bosh të të pandehurve. Në krahun e djathtë, mbi podjum qenë rrjeshtuar me radhë një sërë karrigesh të gjitha me shpinë të lartë për anëtarët e zhurisë, ndërsa pak më poshtë vinin tryezat e avokatëve. Të gjitha këto qenë vendosur në pjesën e përparme të sallës që ndahej më dysh nga parmaku. Pjesa e pasme qe zënë tejpërtej me bango që vinin duke u ngritur gjer në fund. Në pjesën e pasme të sallës, në bangot e para, qenë ulur katër gra që për nga pamja linin të kuptohej se punonin diku si punëtore në ndonjë fabrikë apo si kameriere në ndonjë shtëpi pasanikësh; pas tyre kishin zënë vënd dy burra, me sa dukej, edhe këta punëtorë e që, të mahnitur mbase nga madhështia e sallës së madhe, rrinin të ndrojtur e diç pështëritnin me zë të ulët njeri me tjetrin.

Fill pas zhurisë, hyri në sallë edhe ftuesi i gjyqit, i cili me një zë të fortë sikur të donte t'i kallte tmerrin të gjithëve pa përjashtim sa qenë aty, thërriti:

— Seanca hapet!

Të gjithë u ngritën në këmbë. Gjyqtarët u ngjitën në podjum: në krye ishte kryetari një burrë tërë muskla, bukurosh, me baseta të gjata; pas tij ai anëtari përherë fytyrëngrysur e me gjyslyqe floriri. Ky i fundit tani dukej edhe më i ngrysur se zakonisht dhe me hak se, pak para fillimit të seancës, kishte takuar të kunatin që punonte edhe ai në gjyq, i cili i kishte treguar se kishte qenë tek e motra dhe se kjo i pat thënë se atë ditë nuk kishte ndërmënd t'u gatuante gjë për drekë.

— Me sa duket do hamë në restorant sot, unë e ti, — i kish thënë kunati duke qeshur.

— E pse zbardh dhëmbët? Ç'ka këtu për të qeshur? — I qe shkrehur anëtari që mbahej rëndë-rëndë.

Vinte më në fund anëtari i tretë i gjyqit, pikërisht ai Matvej Nikitiç që s'mbahet mënd të kishte ardhur ndonjëherë në

orar. E, meqë e zumë në gojë, po themi edhe për të nja dy fjalë. Ishte një burrë me mjekër e me dy sy të padjallëzuar që, kushedi përse, kishin prirje të vështronin përherë përdhe. Matvej Nikitiçi ynë vuante nga një katarre [1]) në stomak dhe po atë ditë, i këshilluar nga mjeku, kishte filluar një regjim të ri mjekimi që, ndërmjet të tjerave, e kishte detyruar atë mëngjes të rrinte në shtëpi më tepër se çdo ditë. Kur u ngjit në podjum, kishte një pamje të përqëndruar. Kjo ndodhte sepse ishte i zhytur në disa arësyetime që kërkonin t'u jepnin një shpjegim të kënaqshëm disa çështjeve të ndërlikuara, të cilat anëtari i gjyqit me sy të padjallëzuar i bluante në kokë vetëm e vetëm sa për të kaluar kohën. Atë ditë ai kishte arritur në përfundimin fort të çuditshëm se, po të qe se numuri i hapave që nga kolltuku e gjer tek kabineti i tij, do të ishte një numër i plotpjesëtueshëm me tre, atëhere s'kishte pikë dyshimi se regjimi i ri do ta shëronte rrënjësisht një katarra, ndryshe do rrihte ujë në hava kotë së koti. Hapat që numuroi qenë gjithsejt njëzetegjashtë, mirëpo Matvej finok bëri edhe një hap të vockël dhe, kështu, me hapin e njëzeteshtatë, u ndodh tamam buzë kolltukut.

Figurat e kryetarit dhe të anëtarëve, që u lartësuan mbi podjum kishin, me ato uniformat e tyre të çmueshme e jakat e kollarisura rrethuar me ar, një pamje shumë hijerëndë. Ata këtë e ndjenin edhe vetë, sepse si të turbulluar nga ai efekt madhështor që pasqyrohej në sytë e zgurdulluar që i vështronin me ngulm, ulën kokën me një thjeshtësi vërtet për t'u lavdëruar dhe zunë vënd mirë në ato kolltuqet e tyre prej dru lisi të gdhëndura pas tryezës mbuluar me cohën e blerët, ku ngrihej një instrument trekëndësh me një shgabë trimoshe në majë, ku kishte vazo qelqi mbase plot me konfeta, një takëm boje, ca pëndë, një tabak letre të pa shkruar si dhe gjithfarë lapsa të mprehur për qejf. Bashkë me gjyqtarët hyri në sallë edhe zevendës-prokurori. Duke ecur me rrëmbim, me çantën nën sqetull, e duke tundur krahun lart e poshtë sipas zakonit, ai shkoi drejt e tek vendi i tij që ndodhej pranë dritares e, sapo ndenji, u zhyt menjëherë në leximin, shfletimin dhe shqyrtimin e dokumentave, duke shfrytëzuar çdo minutë për t'u përgatitur për proçesin e helmimit që e kish gjetur, siç thamë, krejt të papregatitur. Ajo që do të lexonte atë ditë ishte pre-

1) Acarimi i mukozës së stomakut. (shën. i përkth.)

tenca e katërt gjatë karierës së tij të porsa-filluar e që, siç besonte, duhej të ishte shumë e shkëlqyeshme. Ambicioz në kulm, karierist i vendosur, ai mendonte se në çdo gjyq, ku do të merrte pjesë, duhej që të bënte çmos për t'i fajësuar të pandehurit e për t'i dënuar sa më rreptë. Njohuritë e tij mbi çështjen e helmimit që do të shqyrtohej në atë seancë ishin fare të përcipta, por megjithatë kjo s'e kishte penguar të hartonte konceptin e fjalimit që do të mbante. I duheshin akoma dhe ca pak të dhëna, por kjo, fundja, s'qe ndonjë punë e madhe se këto mund të merreshin fare bukur, ashtu siç po i merrte me nxitim të madh, nga dosja e hetimeve.

Sekretari zuri vend në anën përkundrejt podjumit e, si i rehatoi mirë të gjitha shkresurinat që do të duheshin mbase për lexim, nisi t'i hedhë një sy një artikulli të ndaluar, të cilin e kish lexuar edhe një herë tjetër një ditë më parë. Ai mendonte se përpara se të hapte, siç kishte shumë qejf, një bisedë mbi përmbajtjen e këtij artikulli me anëtarin e gjyqit mjekërmadh, me të cilin i hahej shumë muhabeti, ishte e këshillueshme të njihej me të në mënyrë të hollësishme.

VIII

Kryetari u hodhi një sy letrave që kishte përpara mbi tryezë, i bëri disa pyetje sekretarit dhe, si mori prej tij përgjegjen e duhur, urdhëroi që të pandehurit të silleshin në sallën e gjyqit. Menjëherë u hap, aty nga fundi, një derë me hekura dhe hynë, me shapkat në kokë dhe me shpatat zveshur, dy xhandarë. Pas tyre u dhanë në prak të derës tre të pandehur, një burrë flokëkuq me quka në fytyrë dhe dy gra. Burri ish veshur me një palë rroba burgu shumë të gjata e të gjëra për të. Me ato duart e tij të ashpra, ku spikatnin, veç nga të tjerët, gishtat e mëdhenj, i pandehuri qe kapur fort pas jakave të setrës për të shkurtuar ashtu disi mëngët që i rrinin shumë të gjata. Ai dukej sikur s'i kishte vënë re fare gjyqtarët dhe publikun që ndodhej në sallë e vështronte ngultas përpara tij karrigen ku do të ulej. Pastaj, si i erdhi rrotull, duke u hapur vend të tjerëve që të kalonin, u ul mbi të, ja nguli sytë kryetarit e filloi t'i lëvizë poshtë e lart muskujt e fytyrës, sikur diç pëshpëriste vetë me vete. Pas tij vinte një grua me moshë të shkuar, veshur edhe ajo me rrobat e

burgut. Gruaja i kishte mbledhur flokët me shami dhe në fytyrën e saj të zbetë e të murme të bënte sidomos përshtypje mungesa e plotë e qerpikëve dhe e vetullave të rruara. E paterhoqi me nge bishtin e fustanit që diku kish ngecur, mbase në një gozhde, e rregulloi me kujdes dhe u ul.

Gruaja tjetër ishte Masllova.

Me të hyrë e pandehura e tretë, të gjithë burrat që ndodheshin në gjyq i kthyen sytë nga ajo e soditën një copë herë fytyrën e saj të bardhë me sytë e zes e të shëndritshem dhe gjirin e këcyer që ngushtohej nën bluzë. Xhandari e vështroi me ngulm dhe e përcolli me sy kur kaloi përpara tij e gjersa u ul në vëndin e saj. Pastaj, si i zënë në faj, u ngut ta kthente kokën n'anën tjetër, u shkund dhe s'i hoqi me sytë nga dritarja përballë.

Kryetari priti gjersa të pandehurit zunë vendet e tyre dhe, kur u ul më në fund edhe Masllova, u kthye nga sekretari.

Filloi atëhere proçedura e zakonshme: apeli i anëtarëve të zhurisë, marrja në shënim e anëtarëve që mungonin dhe shqyrtimi i justifikimeve që kishin paraqitur, gjobitja e atyre që kishin munguar pa arësye, zëvëndësimi i tyre me tjetër. Pastaj kryetari mori ca bileta, i futi në një vazo qelqi dhe, duke i përveshur lehtë mëngët e qëndisura të uniformës me gjestet e matura të një prestigjatori të shkathët, i nxori biletat një nga një, i çpalosi dhe i lexoi. Më në fund i lëshoi përsëri mëngët mbi duart e tij leshtore, u kthye nga prifti dhe e ftoi t'i vërë anëtarët e zhurisë të betohen.

Prifti, një plak i pakët nga trupi, verdhacuk, i zbetë e me fytyrë t'enjtur, veshur me një rasë bojë kafe, me një kryq të florinjtë mbi gjoks e një medalje mbërthyer pak si mënjanë, u drejtua nga pulpiti që ndodhej nën ikonën duke i lëvizur me ngadalë nën rasë këmbët e tij të buhavitura.

Anëtarët e zhurisë u ngritën të gjithë në këmbë dhe i ranë pas pa humbur kohë.

— Urdhëroni — tha urata duke prekur kryqin mbi gjoks me dorën e tij të buhavitur e duke pritur që anëtarët të afroheshin që të gjithë.

Ai qe bërë prift aty e dyzet e giashtë vjet më parë dhe, ashtu siç kishte bërë para ca kohësh edhe kryepeshkopi i katedralit, kishte ndërmënd të kremtonte pas nja tre vietëve jubileun e tij. Kish shërbyer në gjyqin e rrethit që në fillim,

d.m.th. që kur ishte themeluar, dhe krenohej e mburrej që kish marrë në betim gjatë asaj kohe disa dhjetra mijëra njerëz e që, ndonëse tanimë plak, vazhdonte të punonte akoma i palodhur, për të miren e kishës, të Atdheut e të familjes së cilës kishte shpresë t'i linte, veç shtëpisë, edhe ndonja tridhjetë mijë rubla kapital. Uratës kurrë s'i kishte shkuar ndërmend që bënte gjynah kur i vinte njerëzit të betoheshin mbi ungjillin, i cili ndalon me të rreptë çdo betim. Ai e deshte me gjithë shpirt këtë punë me të cilën tani qe mësuar e që, veç të tjerave, i jepte rast të takohej herë pas here edhe me zotërinj të nderuar. Kështu, fjala vjen, atë ditë ai patë mbetur shumë i kënaqur nga takimi me një avokat të famshëm dhe respekti që ju ngjall për të që në fillim, iu dyfishua dhe iu trefishua kur mori vesh për të dhjetëmijë rublat që ai i kishte fituar me një dorë.

Kur anëtarët e zhurisë i ngjitën shkallinat që i shpinin gjer në vendin ku lartësohej pulpiti, urata e uli kokën e tij të shogur e të përthinjur, e futi në të çarën e lerosur të petrahilit dhe, duke ndrequr me dorë flokët e rallë, u drejtua nga zhuria:

— Ngrini dorën e djathtë lart, duke i mbledhur gishtrinjtë, ja, kështu si unë — tha mengadalë, me një zë të pafuqishëm plaku dhe ngriti përpjetë dorën e tij të fryrë me gjishtrinjt të bashkuar në majë. Tani përsëritni me mua — vazhdoi dhe filloi të shqiptojë duke i rrokëzuar fjalët e betimit: — Betohem përpara zotit të plotfuqishëm, përpara ungjillit të tij të shenjtë dhe përpara kryqit jetëdhënës të Krishtit se në çështjen në të cilën jam. . . — këtu urata ngeci një hop. . . — Mos e ulni dorën, ashtu mbajeni, — ju drejtua një djaloshi që e kish ulur krahun. . .se në çështjen në të cilën jam. . .

Zotëria i pashëm me baseta, koloneli e tregëtari e mbanin dorën dhe i mblidhnin gishtërinjtë tamam ashtu siç kërkonte urata me një kënaqësi të veçantë e me një shprehje mëndjemadhësie të theksuar, kurse të tjerët — si me ngurim e paqejf. Disa i përsëritnin fjalët me zë të lartë e me një frymë sikur donin të zbrazin ndonjë duf apo të thonin: «Kini inat sa të doni, po unë do të flas», të tjerët, përkundrazi, i përsëritnin sa për vete, mbeteshin pas nga shokët e nga urata e nguteshin pastaj të trëmbur e të zbehur në fytyrë që t'i arrinin. Gjishtrinjtë kush i shtrëngonte fort e më fort sikur diç mbante në dorë që mund t'i shpëtonte,

kush i hapte e i mblidhte kohë mbas kohe me mospërfillje. Por që të gjithë e ndjenin veten si ndër gjëmba, me përjashtim të priftit plak, që ishte plotësisht i bindur për rëndësinë dhe dobinë e madhe të asaj pune. Pas betimit, kryetari propozoi të zgjidhej një kryetar zhurie. Anëtarët e zhurisë u ngritën përsëri në këmbë dhe hynë, duke u shtyrë, në dhomën e konsultimeve ku, pothuajse të gjithë, nxuarën menjëherë paqetat dhe ndezën nga një cigare. Pastaj se kush propozoi që të zgjidhej kryetari i zhurisë burri i pashëm me baseta. Propozimi u pranua aty për aty dhe të gjithë, si i shuan bishtat e cigareve dhe i flakën, u kthyen në sallë. Këtu burri i pashëm me baseta njoftoi kryetarin mbi përfundimin e zgjedhjeve në zhuri dhe, pas kësaj, të gjithë zunë vend në karriget e tyre me shpina të larta.

Ritmi me të cilin zhvilloheshin të gjitha këto ceremonira ishte i shpejtë e pa ndalesa, por megjithatë kishte një solemnitet, një madhështi e një rregull që forconin tek të pranishmit vetëdijen dhe kënaqësinë për atë vepër të rëndësishme shoqërore që ishin thirrur të kryenin. Këtë ndjenjë kënaqësie e provonte dhe Nekludovi.

Kur zhuria zuri vend në radhët e karrigave me shpina të larta, kryetari iu drejtua me një fjalim të shkurtër për t'i vënë në dukje edhe një herë të drejtat që gëzonin, detyrat që u ngarkoheshin dhe përgjegjësinë që mbanin. Kryetari hidhej nga një çështje në tjetrën duke marrë sipas fjalës edhe pozën e përshtatëshme, d.m.th. herë mbështetej në krahun e majtë, herë në të djathtin, herë mbi shpinën e herë mbi dorezën e karriges, herë ndreqte cepat e letrës dhe herë prekte lapsin si për t'u siguruar që majën e kishte në rregull.

Të drejtat, sipas asaj që tha kryetari, mund të përmblidheshin në pyetjet që mund t'u bëheshin të pandehurve nëpërmjet kryetarit, në letrën dhe në kalemin që mund të mbanin përpara për të marrë shënime si edhe në kontrollin që u lejohej t'u bënin materialeve të akuzës. Detyrat mund të shpreheshin me këtë fjalë të urtë: «Gjyko duke u mbështetur në drejtësinë e jo në padrejtësinë». Dhe, më në fund, përgjegjësia s'ishte tjetër veçse ruajtja e sekretit të gjyqit për t'iu shmangur masave ndëshkimore lidhur me nxjerrjen e këtij sekreti.

Të gjithë dëgjonin me vëmëndje të madhe e plot respekt. Tregëtari duke përhapur rreth e rrotull kundërmimet e gogësimeve të bujëshme që i shkakëtonin kupat e ve-

rës, të cilat i kishte rrëkëllyer esëll që në mëngjes, tundte kokën me vend e pa vend në shenjë aprovimi.

IX

Si i dha fund fjalimit të tij, kryetari u kthye nga të pandehurit.

— Simon Kartinkin, çohuni në këmbë!

Simoni brofi në këmbë me një lëvizje nervoze. Muskujt e faqeve nisën t'i lëvizin edhe më shpejt.

— Si ju quajnë?

— Simon Petrov Kartinkin, — u përgjegj me një zë të ngjirur, por pa ngurim i pandehuri që, me sa dukej, i kishte pregatitur përgjigjet që më parë.

— Gjendja shoqërore?

— Fshatar.

— Guberna, distrikti?

— Guberna e Tulës, distrikti i Krapivos, komuna e Kupjanskojes, fshati Borki.

— Ç'moshë kini?

— Tridhjetë e katër vjeç jam. Kam lindur më 18. . .

— Besimi?

— Besimin e kam rus, orthodoks.

— Jeni i martuar?

— I martuar nuk jam.

— Me ç'punë merreni?

— Ne mirremi me punën si kamerier, në hotelin «Mauritania».

— Jeni gjykuar herë tjetër?

— As gjykuar, as dënuar kurrë, sepse ne kemi rrojtur gjithnjë. . .

— Pra, nuk jeni gjykuar herë tjetër?

— Kurrë, qoftë larg!

— Keni marrë kopje të aktakuzës?

— Posi, kemi marrë!

— Uluni!. . . Eufemia Ivanovna Boçkova, — vazhdoi kryetari duke iu drejtuar njerës prej dy të pandehuravet.

Por Simoni vazhdonte të qëndronte në këmbë përpara Boçkovës.

— Kartinkin, uluni.

Por Kartinkini nuk ulej.

— Kartinkin, uluni!

Kartinkini nuk u ul as edhe këtë radhë. Ai vazhdoi të qëndronte në këmbë gjersa ftuesi i gjyqit iu afrua me të shpejt sikur desh ta përpinte e i pështëriti «Uluni, uluni!»

Kartinkin u ul me një lëvizje, po aq të shpejtë sa ç'ishte ngritur dhe, duke u mbështjellur i tëri në kapotë, nisi t'i përpëliti përsëri buzët e nofullat.

— Si ju quajnë? — iu drejtua të pandehurës së dytë kryetari me një psherëtimë mërzie e lodhjeje, pa e parë fare në fytyrë sikur vështronte me vëmëndje në një letër që mbante përpara. Kryetari ishte tanimë i stërvitur në proçedurat e zakonshme të gjyqit, saqë mund të kryente fare mirë në të njëjtën kohë dy punë të ndryshme.

Boçkova ishte dyzet e tre vjeçe. Gjendja shoqërore: mikroborgjeze. Profesioni: kameriere në hotelin «Mauritania». S'kish qënë ndonjë herë dënuar nga gjyqi. E kishte marrë një kopje të akt-akuzës. Boçkova përgjigjej me një guxim të jashtëzakonshëm e i jepte zërit një ton sikur deshte të shtonte pas çdo përgjegjeje: «Po, Eufemia më quajnë, Boçkova e kam mbiemrin, kopjen e mora dhe as trëmbem hiç, përkundrazi e mbaj kokën lart dhe s'lejoj kurrën e kurrës që të më qeshi njeri». Boçkova nuk priti sa t'i thonin të ulej, por u ul vetë menjëherë pasi përfunduan pyetjet.

— Si ju quajnë? — ju drejtua kryetari, me një dashamirësi të theksuar këtë radhë, të pandehurës së tretë. — Duhet të ngriheni, — shtoi me një zë të butë e me përkëdhelje duke vënë re që Masllova vazhdonte të rrinte ulur.

Ajo brofi në këmbë menjëherë, u bë gati të përgjigjej, nxori përpara gjirin e saj të bështëm e të këcyer dhe e vështroi kryetarin drejt e në fytyrë me sytë e mëdhenj, të zes e të qeshur që vëngëronin lehtë.

— Si ju quajnë?

— Ljubova, — tha ajo me të shpejt.

Ndërkaq, Nekludovi, kishte vënë pince-nez dhe i vrente me kujdes të pandehurit sa herë që ngriheshin për t'u përgjegjur pyetjeve.

«Është e pamundur!» mendonte duke e vështruar ngultas të pandehurën. «Kjo quhet Ljubova. S'është ajo. . . Por sa shumë i ngjet!. . .

Kryetari deshi të hidhej në një pvetje tjetër, por anëtari me syze diç i pështëriti me të rreptë dhe e ndaloi. Krye-

tari tundi kokën në shenjë pohimi dhe u kthye nga e pandehura.

— Ljubova, si kështu? — tha ai. — Këtu njiheni me një emër tjetër.

E pandehura nuk u përgjegj.

— Po ju pyes, si e keni emrin e vërtetë?

— Si ju kanë pagëzuar — ndërhyri me të rreptë anëtari me syze.

— Dikur më quanin Katerina.

«S'është e mundur» vazhdonte të thoshte me vete Nekludovi. Por tani s'kishte asnjë dyshim që e pandehura ishte me të vërtetë Katjusha, të cilën ai dikur e kishte dashuruar me gjithë shpirt, por më vonë, në një çast marrëzie, e kishte mashtruar dhe e kishte braktisur duke u munduar ta harronte përgjithmonë. Kujtimi i asaj aventure të pështirë me kamerieren e tezeve i hapte tani një plagë që i dhimbte, që e poshtëronte, që e demaskonte pa mëshirë; ai ndjente se nuk ishte i pastër e i drejtë, ashtu siç pandehte e mburrej, dhe se vepra e tij ishte vepra e një njeriu të poshtër.

Po, ajo ishte, Katjusha! Tani ai dallonte qartë në fytyrën e saj atë veçorinë e fshehtë tipike që karakterizonte çdo fytyrë si diçka më vete që s'përsëritet më kurrë. Ndonëse ajo fytyrë dukej tani jashtëzakonisht e zbehtë, ndonse ishte e ngjallur dhe e plotë, e mprehtë si dikur, kjo veçori e hollë, e shtrenjtë për të, dukej akoma në çdo tipar: në buzët, në sytë vëngërosh e sidomos në vështrimin e pafajshëm e të qeshur, si dhe në atë shprehje gadishmërie që binte në sy menjëherë, jo vetëm në fytyrën, por në të gjithë trupin e saj.

— Kështu duhet t'ishit përgjegjur që në fillim, — tha kryetari përsëri me të butë. — Emri i babajt?

— S'kam patur baba, — u përgjegj Masllova.

— S'prish punë. Si iu quanin nga emri i nunit?

— Mihaillovna.

«Po çfarë krimi mund të ketë kryer?» — vazhdonte të mendonte ndërkaq Nekludovi, i tronditur.

— Tani na thoni mbiemrin tuaj? — vazhdoi kryetari.

— Mbiemrin e kam Masllova. Kështu e thërrisnin edhe nënën.

— Gjendja shoqërore?

— Mikroborgjeze.

— Besimi orthodoks, sigurisht?

— Orthodoks.

— Profesioni? Me ç'punë jeni marrë?

Masllova nuk përgjegjej.

— Me ç'punë jeni marrë? — përsëriti kryetari.

— Isha në një shtëpi, — tha ajo.

— Ç'farë shtëpie ishte kjo? — tha me të rreptë gjykatësi me gjyslyke.

— Ju e dini në çfarë shtëpie kam qënë! — tha Masllova duke buzëqeshur e, si hodhi një vështrim të shpejt rreth e rrotull, ja nguli përsëri sytë kryetarit.

Kishte diçka të jashtëzakonëshme në shprehjen e fytyrës së asaj gruaje. . . Diçka kaq të tmerëshme dhe kaq të dhimbëshme në fjalët e saja e në vështrimin e shpejt që ajo i kishte hedhur publikut, saqë kryetari uli pa dashur kokën dhe në sallë sundoi befas një heshtje varri. Ajo heshtje u prish nga një e qeshur diku në radhët e publikut. Dikush ja bëri «ssst». Kryetari ngriti kokën dhe vazhdoi:

— Keni dalë ndonjë herë tjetër në gjyq?

— Jo, nuk kam dalë, — tha me një zë të mekur Masllova duke psherëtitur.

— Keni marë kopje të aktakuzës?

— Kam marrë.


— Uluni, — tha kryetari.

E pandehura ngriti pak cepin e fundit, po me atë gjest me të cilin zonjat ngrënë bishtin e fustanit të ballos, pastaj u ul e i futi duart e saja të vogla në mëngët e setrës duke i mbajtur sytë gjatë tërë kohës nga kryetari.

Filloi paraqitja e dëshmimtarëve dhe, pas largimit të tyre nga salla, u vendos të thirret mjeku ekspert e u ftua ky i fundit të hynte në sallë. Pastaj sekretari u ngrit në këmbë e filloi leximin e aktakuzës. Lexonte shkoqur e me zë të lartë, por kaq shpejt sa që zëri i tij, duke mos i shqiptuar mirë gërmat «l» dhe «r» dëgjohej si një zhurmë e mbytur, e pandërprerë që të vinte në gjumë.

Gjykatësit ktheheshin në ato kolltuket e tyre të buta herë në njërin krahë herë në tjetrin, herë i mbështetnin bërrylet mbi tryezë e herë i hiqnin që andej, herë i mbyllnin sytë e herë i hapnin e dic pështërisnin gjatë gjithë kohës me njeri tjetrin. Një xhandar u mundua shumë herë ta mbyllte me zor gojën që i hapej vetvetiu nga mërzia.

Kartinkini, në bangon e të akuzuarve, vazhdonte t'i përpëliste buzët si më parë. Bockova dukej fare e qetë edhe i jepte trupit përpietë duke kruajtur kohë pas kohe me gisht kokën e mbështjellur me shami.



Masllova herë rrinte pa lëvizur, duke i vënë veshin sekretarit e duke mbajtur sytë nga ai, herë bënte të ngrihej e matej të kundërshtonte, skuqej e nxirrte një psherëtimë të thellë, u jepte duarve të tjera lëvizje, hidhte sytë rreth e rrotull e i kthente përsëri pastaj nga sekretari.

Nekludovi qe ulur në rreshtin e parë mbi karriken e tij të lartë, që vinte e dyta nga e djathta dhe, duke hequr pincenez, vështronte me vemendje Masllovën, ndërsa në shpirtin e tij atë çast zhvillohej një proçes i ndërlikuar e i dhimbshëm.

X

Akt-akuza fillonte kështu:

«Më 17 janar të vitit 188. . . në hotelin «Mauritania» vdiq papritmas tregëtari i gildës së dytë, Ferapont Emeljanovi Smelkov nga Kurgansku. Sipas konstatimit të mjekut ekspert, rezultoi se vdekja e të lartpërmendurit erdhi nga ndalimi i zemrës, i shkakëtuar nga një abuzim në përdorimin e pijeve alkoolike. Pas ekzaminimit mjeksor, kufoma e Smelkovit u varros.

Disa ditë pas ngjarjes, një bashkëfshatar dhe shok i Smelkovit, që erdhi nga Peterburgu, tregëtari Timohin, u informua mbi rrethanat e vdekjes të të lartpërmendurit dhe shprehu dyshimin që i ndyeri mund të kish qënë helmuar me qëllim vjedhjeje.

Hetimet, që u zhvilluan sipas kërkesës së tij, nxorrën në shesh sa vijon: 1) Që Smelkovi, disa ditë më parë, kishte tërhequr nga banka 3800 rubla, ndërsa në inventarin që u bë pas vdekjes së të ndjerit iu gjendën vetëm 312 rubla e 16 kopejka. 2) Ditën dhe natën para vdekjes. Smelkovi e kaloi me prostitutën Ljubka (Ekaterina Masllova) në një shtëpi publike dhe në hotelin «Mauritania», ku, sipas porosisë së Smelkovit dhe në mungesë të tij, Katerina Masllova shkoi, pasi u largua nga shtëpia publike për të marrë një shumë të hollash që ndodheshin në valixhen e Smelkovit. E pandehura Masllova e hapi valixhen me çelësin që i kishte dhënë vetë Smelkovi në prani të kamerierëve të hotelit «Mauritania», të Eufemia Boçkovës dhe Simon Kartinkinit. Në valixhen e Smelkovit, Boçkova dhe Kartinkini që ishin aty të pranishëm, panë disa pako me kartë-monedha prej njëqind rublash. 3) Kur Smelkovi u kthye nga shtëpia publike në hote-

lin «Mauritania» bashkë me prostituten Ljubka, kjo e fundit, e këshilluar nga kamerieri Kartinkin, i hodhi në një gotë konjaku e i dha për të pirë Smelkovit një pluhur të bardhë të cilin e kishte marrë nga Kartinkini. 4) Të nesërmen në mëngjes, prostituta Ljubka (Ekaterina Masllova) i shiti padrones së saj, pronares së shtëpisë publike, dëshmitares Kitajeva, një unazë brillanti të Smelkovit duke i thënë se e kishte pasur dhuratë nga vetë Smelkovi. 5) Kamerieria e hotelit «Mauritania», Eufemia Boçkova, një ditë pas vdekjes së Smelkovit, derdhi në bankë një shumë prej 1800 rublash argjënd.

Kontrolli gjyqësor e mjekësor, autopsia e kufomës dhe ekzaminimi kimik i zorrëve të Smelkovit, vunë në dukje se është përdorur një dozë helmi në organizmin e të ndyerit, gjë kjo që të bën të mendosh se vdekja ka rrjedhur si pasojë e një helmimi. E pyetur nga gjykatësi hetues, e pandehura Ljubka pohoi që, ndërsa tregëtari Smelkov ishte në shtëpinë publike në të cilën ajo punonte, e lartpërmendura shkoi në dhomën e tij, që ndodhej në hotelin «Mauritania», për të marrë një sasi të hollash dhe, si e hapi valixhen e tregëtarit me çelësin që ky i kishte dhënë, mori, siç ishte porositur, 40 rubla. Ajo pohoi gjithashtu se nuk kishte marrë të holla të tjera veç atyre që u përmendën më lart, siç dëshmuan në këtë rast edhe të pandehurit Simon Kartinkin dhe Eufemia Boçkova në praninë të të cilëve ajo kishte hapur e mbyllur valixhen.

Në lidhje me helmimin e Smelkovit, prostituta Ljubka deklaroi që, si u kthye dhe një herë në dhomën e tregëtarit, kishte hedhur në gotën me verë, që do t'i jipte këtij të fundit, një pluhur që e kishte marrë nga Simon Kartinkini, duke kujtuar se pluhuri në fjalë nuk ishte vdekjeprurës. E pandehura tha se ja kishte hedhur në gotën e verës tregëtarit me qëllim që ky të flinte e ta linte rehat. Ajo shtoi se nuk ishte fajtore për vjedhjen e të hollave dhe se Smelkovi ja kishte dhënë vetë unazën, pasi e kishte rrahur.

Eufemia Boçkova deklaroi se nuk dinte asgjë mbi zhdukjen e të hollave, se nuk kishte hyrë në dhomën e tregëtarit e se atje kishte hyrë vetëm Ljubka. Ajo pohoi gjithashtu se shuma e të hollave në fjalë duhej të ishte marrë nga e lartpërmëndura Ljubka kur ajo kishte hyrë në dhomë me çelësin e valixhes. Kur sekretari arriti në këtë pikë të akuzës, Masllova u rrënqeth dhe, duke hapur gojën sikur diç deshte të thoshte, u kthye nga Boçkova. Në lidhje me prej-

ardhjen e 1800 rublave të depozituara në bankë, Boçkova deklaroi që kjo shumë ishte vënë mënjanë pak nga pak gjatë 12 vjetëve prej saj e prej Simonit, me të cilin ajo kishte ndërmend të martohej.

Kur u muar në pyetje, Simon Kartinkini pohoi në fillim se, i shtyrë nga Masllova (së cilës tregëtari i kishte dhënë çelësin e valixhes së tij dhe, në bashkëpunim me Boçkovën, ai kishte përvetësuar një shumë të hollash, të cilën e kish ndarë më vonë me Boçkovën dhe Masllovën. I pandehuri pohoi gjithashtu se i kishte dhënë Masllovës një pluhur për ta vënë në gjumë tregëtarin. Por, kur u muar në pyetje për herë të dytë, ai mohoi kategorikisht ç'kish pohuar më parë, duke thënë se nuk kishte vjedhur të hollat dhe nuk i kishte dhënë Masllovës atë pluhurin e gjumit për të cilin u fol më sipër. Kur u pyet në lidhje me të hollat që ishin derdhur në bankë nga Boçkova, Kartinkini u përgjegj se kjo shumë ishte vënë mënjanë prej tij e prej Boçkovës gjatë 12 vjetëve që punonin në hotelin MAURITANIA në saje të bakshisheve që mirrnin nga klientat e hotelit.

Vinin pastaj në aktakuzë deponimet e dëshmitarëve, mendimi i ekspertave, përshkrimi i materialeve t'akuzës etj. Aktakuza përfundonte në këtë mënyrë:

Duke marrë parasysh sa më sipër, Simon Kartinkini, fshatar tridhjetë e katër vjeç, Eufemia Ivanovna Boçkova, mikroborgjeze, dyzet e tre vjeçe dhe Katerina Mihajllovna Masllovna njëzeteshtatë vjeçe, akuzohen se më 16 tetor 188... duke vepruar bashkërisht i kanë vjedhur tregëtarit Smelkov një shumë në të holla prej 2500 rublash dhe një unazë dhe se, për të zhdukur gjurmat e këtij përvetësimi të paligjshëm i kanë hedhur në verë të lartpërmendurit Smelkov një helm vdekjeprurës.

Ky krim parashikohet nga neni 1453 i kodit penal e prandaj Simon Kartinkini, fshatar, Eufemia Boçkova dhe Katerina Masllova, mikroborgjeze, i dërgohen gjyqit të distriktit, për t'u gjykuar në një seancë të zgjeruar me pjesëmarrjen e zhurisë.

Si i dha fund këtij leximi të gjatë, sekretari i mblodhi fletët e aktakuzës dhe u ul e kaloi të dy duart mbi flokët e tij të gjatë e të zes. Të gjithë të pranishmit psherëtitën si të lehtësuar nga një barrë e rëndë dhe secili mendoi atë çast, me kënaqësi, se edo gjë do të kthiellohej pa tjetër për së shpejti dhe se, më në fund, e vërteta do të dilte në shesh. Vetëm Nekludovi nuk bashkohej me këtë mendim. Ai vriste

mëndjen të gjente, i tmerruar, se si kishte mundur të kryente një krim të tillë Masllova, vajza e padjallëzuar, e thjeshtë dhe e ndershme, që ai kish njohur aty e dhjetë vjet më parë.

XI

Kur mbaroi leximi i aktakuzës, kryetari i gjyqit, si dëgjoi mendimin e anëtarëve, u kthye nga Kartinkini me një shprehje që desh të thoshte: «Tani do ta marrim vesh se si qëndron puna, asnjë hollësi nuk do të na shpëtojë».

— Simon Kartinkin! — tha duke u përkulur pak nga e majta.

Simon Kartinkini u ngrit menjëherë, nxorri gjoksin përpara, shtriu krahët mbi tegelat e pantallonave e, duke përpëlitur vazhdimisht pa zë buzët, qëndroi ashtu një copë herë në pritje.

— Akuzoheni se më 16 tetor të vitit 188. . . , në bashkëpunim me Eufemia Boçkovën dhe Katerina Masllovën, i keni vjedhur tregëtarit Smelkov një sasi të hollash dhe, veç kësaj, i keni dhënë Katerina Masllovës një dozë arseniku duke ja mbushur mëndjen që ta hidhte në verën që do t'i jipej Smelkovit e që shkakëtoi vdekjen e papritur të këtij. Pohoni se jeni fajtor? — e përfundoi kryetari duke ndryshuar përsëri mënyrën e të ndënjurit, d.m.th. duke u mbështetur mbi bërrylin e djathtë.

— Jo, ç'është kjo! Ç'fajtor po jam unë gjersa detyra jonë është si e si t'u shërbejmë më mirë klientave. . . Fjalë është kjo. . .

— Për këto mund të flitni më vonë. Tani përgjigjuni pyetjes: Pranoni se jeni fajtor?

— Ç'është ajo, si do të pranoj?!. . . Unë vetëm. . .

— Këto do t'i thoni më vonë. Tani duhet të thoni a pohoni që jeni fajtor! — nguli këmbë kryetari, i qetë si gjithnjë, por me të rreptë.

— Jo, atë s'e bëj kurrë, sepse. . .

Ftuesi i gjyqit u kthye përsëri me një lëvizje të shpejtë nga Simon Kartinkini dhe e ndërpreu me një «ssst» kërcënonjës e t'ashpër.

Kryetari, me një shprehje që linte të kuptohej se ajo punë tani kish marrë fund, e ndryshoi edhe një herë mënyrën e të ndënjurit dhe u kthye nga Eufemia Boçkova.

— Eufemia Boçkova! Ju akuzoheni se, në bashkëpunim me Simon Kartinkinin dhe Katerina Masllovën, në 17 tetor të vitit 188. . . keni vjedhur një shumë të hollash dhe një unazë nga valixhja e tregëtarit Smelkov dhe se, për të fshehur gjurmat e këtij krimi, i keni dhënë tregëtarit Smelkov një helm vdekje-prurës. E pranoni fajin?

— S'e pranoj kurrën e kurrës se jam fajtore, — u përgjegj e pandehura me një zë të fortë e ngulmonjës. — Unë as që kam shkelur fare në dhomë. . . Ajo hyri, ajo kurva, asaj i thoni, se ajo e ka bërë zararin.

— Këto do t'i thoni më vonë! — foli kryetari me atë tonin e tij të qetë e të vendosur. — Me fjalë të tjera, nuk e pranoni fajin?

— S'kam qënë unë që i kam marrë paratë, s'kam qënë unë që i dhashë helmin tregëtarit! Unë as që shkela në dhomë, jua thashë. Se, po të kisha hyrë nuk do ta kisha lënë aty atë, po do ta kisha flakur jashtë. . .

— Pra, nuk pranoni se jeni fajtore?

— Kurrë!

— Shumë mirë. Mjaft me kaq.

— Katerina Masllova! — vazhdoi kryetari duke u drejtuar nga e pandehura e tretë. — ju akuzoheni se, duke ardhur nga shtëpia publike në hotelin «Mauritania», hytë në një dhomë duke e pasur në dorë çelësin e valixhes së tregtarit Smelkov, e i vodhët këtij një sasi të hollash dhe një unazë. — Kryetari, që i tha të gjitha këto sikur përsëriste një mësim të mësuar përmënç, i zgjati ndërkaq veshin një anëtari, në të majtë, i cili i njoftonte se një nga materjalet e akuzës, që përfshihej në listë, një shishe e vogël, nuk ndodhej mbi tryezë. . . — Vodhët nga valixhja një shumë të hollash dhe një unazë: — përsëriti kryetari, — dhe, si e ndatë mallin e grabitur, u kthyet përsëri me tregëtarin në hotelin «Mauritania», ku i dhatë këtij të fundit një gotë në të cilën ishte hedhur pluhuri që e helmoi. Pranoni se jeni fajtore?

— Jam e pafajshme! — u përgjegj me të shpejt e pandehura, — e thashë edhe në fillim dhe prapë po e them: Asgjë nuk kam marrë, asgjë, asgjë! Unazën ai ma dha vetë. . .

— Pra, nuk pranoni se jeni fajtore për vjedhjen e 2500 rublave? — pyeti kryetari.

— Veç 40 rublave s'kam marrë asgjë tjetër. . .

— Po që i keni hedhur tregëtarit Smelkov një pluhur në verë, këtë a e pranoni?

— Këtë e pohoj. Por unë mendoja se, ashtu siç më kishin

thënë, ai pluhuri nuk sillte ndonjë dëm, por vetëm të vinte në gjumë. Pse, ta kisha ditur, a do ta hidhja? Jo, kurrën e kurrës!

— Shumë mirë! — ndërhyri kryetari, i kënaqur, me sa dukej, nga rezultatet e arritura. — Tani na tregoni si ndodhi puna! — shtoi duke u fundosur në kolltuk dhe duke i mbështetur duart mbi tryezë. — Mos fshihni gjë, i thoni të gjitha! Po të jetë se do të tregoheni e sinqertë, kjo do të merret parasysh e do t'jua lehtësojë fajin.

Masllova e vështronte kryetarin në sy e rrinte e heshtur.

— Na tregoni si ndodhi puna!

— Si ndodhi? — nisi të flasë me të shpejtë Masllova. — Po, ja, erdha në hotel dhe atje më shpunë në një dhomë. N'atë dhomë ishte «ai». «Ai» ishte i dehur. — Masllova e shqiptonte fjalën «ai» me një shprehje tmerri e me sy të zgurdulluar. Unë doja të ikja, por «ai» nuk më linte. . .

Ajo e preu sikur papritmas ta kishte humbur fillin e kujtimeve apo sikur t'i kishte rënë ndërmend n'atë çast diçka tjetër.

— Hë? Pastaj?

— Pastaj? Po, ja, pastaj qëndrova. Pastaj ika.

Atë çast zëvëndës prokurori u ngrit disi nga karriga duke e mbështetur njerin bërryl mbi tryezë.

— Mos dëshëroni të bëni ndonjë pyetje? — i tha kryetari.

— Po, dua ta pyes të pandehurën — tha zëvëndës-prokurori.

Kryetari i bëri shenjë me kokë që mund të fliste.

— Pyetja që dua t'i bëj është kjo: A e njihte e pandehura Simon Kartinkinin më përpara? — tha rëndë-rëndë zëvëndës-prokurori pa e kthyer fare kokën nga Masllova. Pastaj mblodhi buzët dhe rrudhi vetullat. Kryetari i përsëriti pyetjen. Masllova e vështronte zëvëndës prokurorin me tmerr.

— Simonin?. . . Po, e njihja, — tha si ngurroi një çast.

— Unë dua të di gjithashtu: në çfarë llojë marrëdhëniesh ishte e pandehura me Kartinkinin? A takohej shpesh me të?

— Unë nuk kisha marrëdhenje me Kartinkinin. . . Ky më rekomandonte tek klientat e hotelit, kaq dhe hiç tjetër, — u përgjegj Masllova duke hedhur sytë e shqetësuar herë nga kryetari, herë nga zëvëndës prokurori.

— Unë desha të di përse Kartinkini ftonte tek klientët e hotelit vetëm Masllovën e asnjë nga vajzat e tjera? — tha prokurori duke u mvrejtur, por me një buzëqeshje të lehtë e dinake.

— Nuk e di! Ku ta di unë? — u përgjegj Masllova duke hedhur sytë rreth e rrotull me ndroje e duke ndaluar një çast vështrimin mbi fytyrën e Nekludovit: — Ato që deshte, ato ftonte ai.

«Të më ketë njohur?» — mendoi me tmerr Nekludovi duke ndjerë që atë çast gjaku i hipte në kokë dhe veshët i buçisnin. Por Masllova as që e kishte vënë re fare dhe vështrimi i saj u drejtua përsëri me frikë nga zëvendës prokurori.

— Pra, e pandehura nuk pranon se ka patur marrëdhënie të ngushta me Kartinkinin. Shumë mirë. Kaq kisha! Fill pas kësaj prokurori seç nisi të shkruaj. Por në të vërtetë nuk shkruante asgjë. . . Ngjyente penën dhe e kalonte mbi fjalët e aktakuzës. Ai deshte t'u përngjante atyre prokurorëve dhe avokatëve të shkathët që, pas çdo pvetje që bëjnë, marrin shënime për të mbledhur kësisoj sa më shumë fakte, me të cilat pastaj e kanë fare lehtë ta vënë të pandehurin me shpatulla në mur. Kryetari ndërkaq bisedonte me anëtarin me gjyslyke dhe e pyeste në ishte dakord me renditjen e pyetjeve që ishin pregatitur e shkrojtur që më parë. Pastaj, duke u drejtuar përsëri nga e pandehura, pyeti:

— Hë, pastaj, ç'ndodhi?

— Shkova në shtëpi, — vazhdoi Masllova që e kishte marrë ndërkaq veten dhe e shikonte kryetarin më me guxim, — i dhashë padrones të hollat e rashë të fle. Porsa më kishte zënë gjumi, vinë e më zgjojnë. «Çohu — më thotë Berta, një nga shoqet — ai tregëtari yt erdhi prapë. «Unë e kisha vendosur të mos i dilja tregëtarit, mirëpo madama më tha se duhet të shkoja me të pa tjetër. Ndërkaq «ai», — ajo e shqiptoi përsëri këtë fjalë me një tmerr të dukshëm, — «ai» u dha për të pirë të gjitha vajzave, mirëpo s'i mjaftuan paratë. Tha se paratë do t'i jepte më vonë, po padrona nuk i zuri besë. Atëhere, «ai» më dërgoi mua në dhomën e tij në hotel. Më tha ku qenë të hollat e sa të merrja. Shkova, — Kryetari vazhdonte të fliste me zë t'ulët me anëtarin, që kishte pranë pa dëgjuar ato që thoshte Masllova. Por, për të treguar që i kishte dëgjuar të gjitha, e pa t'arësyeshme ta përsëriste fjalën e fundit që kish thënë e pandehura:

— Shkuat. . . Pastaj?

— Si arrita në hotel, bëra ashtu si më tha tregëtari: hyra në dhomë. Por, në dhomë, s'hyra vetëm, i thashë edhe Simon Mihajlloviçit, edhe asaj. Bashkë hymë, — tha ajo duke treguar me dorë Boçkovën.

— Genjen, unë as që kam hyrë fare. . . — nisi të thotë Boçkova, por nuk e lanë të fliste.

— E ja në sy të tyre mora katër bileta të kuqe, — vazhdoi Masllova duke u vrejtur e pa kthyer më kokën nga Boçkova.

— E pandehura kur mori të dyzet rublat, siç tha, mos vuri re gjë rastësisht se sa të holla ndodheshin në valixhe?... — e pyeti përsëri prokurori.

— Nuk i numërova. . . Vura re se biletat atje ishin vetëm nga njëqind rubla.

— Domethënë, e pandehura i paska parë biletat nga njëqind rubla?!. . . Kaq kisha.

— Pastaj, ja shputë tregtarit këto të holla?. . . — vazhdoi kryetari duke i hedhur një sy orës.

— Ja shpura.

— Pastaj?

— Pastaj, «ai» më mori përsëri me vete në dhomën e tij. . . — tha Masllova.

— Po pluhurin?. . . Si ja dhatë, atë pluhurin?

— Si ja dhashë? Po ja hodha në verë e ja dhashë.

— Po pse ja dhatë?

Ajo nuk u përgjegj, por psherëtiti thellë, e brengosur.

— Ma mori shpirtin, — tha më në fund, si heshti një copë herë. — S'më linte të ikja. Kështu, më në fund, dola në koridor e i thashë Simon Mihajlloviçit: «Si t'ja bëj? Ky s'po më ndahet. U lodha, u këputa». Simon Mihajlloviçi më tha: «Na mërziti dhe ne, për besë: po e di si do t'ja bëimë? Do t'i japim një pluhur për gjumë; ti pastaj prit sa të flërë e ik». Unë kujtoja se ai pluhuri nuk sillte ndonjë dëm. Atë pluhurin ai ma dha, Simoni. Ma dha mbështjellur në një letër. Kur hyra në dhomë «ai» ishte i shtrirë pas paravanit. Më ndjeu që hyra dhe më urdhëroi t'i mbushja një gotë me verë. Mora një shishe me shampanjë, nga ajo më e mira, që ishte mbi tryezë dhe mbusha dy gota, një për vete e një për «atë». Por në gotën e «tij» hodha më parë atë pluhurin që thashë. Por sikur ta dija nuk do t'ja kisha dhënë, kurrë nuk do t'ja kisha dhënë. . .

— Po ajo unaza si ju ra në dorë? — pyeti kryetari.

— Unazën ai ma fali vetë...

— Kur jua fali?

— Pasi ndënja pak në dhomë, desha t'iki... Mirëpo ai më ra me grusht kokës, po aq fort sa më theu dhe krehërin... Unë u zëmërova dhe bëra për nga dera. Ai më ndaloi, më tha «mos ik!» dhe më dha unazën.

Prokurori u ngrit përsëri mbi bërryl dhe kërkoi leje të bënte edhe disa pyetje të tjera. Leja iu dha dhe ai e kërrusi lehtë kokën mbi jakën e qëndisur, pastaj filloi:

— Desha të di, sa kohë ka qëndruar e pandehura në dhomën e tregëtarit Smelkov?

Masllovën e pushtoi përsëri një ndjenjë frike dhe, duke i hedhur sytë, herë nga kryetari herë nga prokurori, nxitoi të përgjigjej:

— Nuk e mbaj mënd sa kohë.

— Ashtu? Por kur doli nga dhoma e tregëtarit Smelkov, ku shkoi? Mos shkoi në ndonjë dhomë tjetër të hotelit? Apo as këtë nuk e mban mënd?

Masllova u mendua një çast.

— Hyra në dhomën ngjitur me të që ishte bosh...

— Ç'kërkonit atje? — pyeti prokurori duke iu drejtuar këtë radhë drejtpërdrejt së pandehurës.

— Hyra atje që të rregulloja pak rrobat dhe të prisja karrocën.

— Po Simon Kartinkini ishte apo s'ishte në dhomë bashkë me të pandehurën?

— Po, erdhi edhe ai atje.

— E përse erdhi?

— Në shishe kishte mbetur akoma pak shampanjë... E pimë bashkë.

— Nuk pati ndonjë bisedë ndërmjet së pandehurës dhe Simon Kartinkinit?

Masllova u vrenjt edhe një herë, u skuq në fytyrë dhe foli shpejt e me inat.

— Ç'farë bisede? Asgjë nuk kam biseduar me të. Ç'kisha për të thënë, i thashë. Më bëni ç'të doni, po ja ku po jua them edhe një herë: Nuk jam fajtore!

— Kaq kisha, — tha prokurori duke u drejtuar nga kryetari. Pastaj nisi të shkruante me të shpejtë në konspektin e pretencës, që do të mbante se e pandehura e pohoi vetë që kishte hyrë bashkë me Simonin në një dhomë bosh.

U bë një heshtje.

— Nuk kini gjë tjetër për të thënë?

— Jo, s'kam! — tha ajo me një psherëtimë dhe u ul.

Fill pas kësaj kryetari diç shkruajti mbi një letër e, pasi dëgjoi ato që i tha në vesh anëtari që ndodhej nga e majta, shpalli dhjetë minuta pushim. Pastaj u ngrit e dolli nga salla.

Gjykatësi që i kishte folur kryetarit në vesh ishte ai burri në të majtë, i gjatë, me mjekër, me sy të mëdhenj e të padjallëzuar. Ky, duke ndjerë befas shqetësim në stomak, kishte shprehur dëshirën që të largohej për pak kohë nga seanca që të bënte një masazh e të pinte disa pika nga ilaçi që i kish porositur mjeku. Ky kishte qënë pikërisht edhe shkaku i pezullimit të seancës.

Menjëherë pas gjyqëtarëve, u ngritën edhe anëtarët e zhurisë, avokatët e dëshmitarët. E që të gjithë nisën të sillen lart e poshtë për të shpirë gjymtyrat me përshtypjen e këndëshme se e kishin shkarkuar tani një pjesë të barrës së rëndë që u ishte ngarkuar.

Nekludovi hyri në dhomën e zhurisë dhe zuri vend aty pranë dritares.

XII

Po, ajo ishte, Katjusha!

Nekludovi solli ndërmend rrethanat në të cilat e kishte njohur.

Që takuar për herë të parë me Katjushën kur bënte akoma vitin e tretë të universitetit dhe ndodhej tek tetot, ku mendonte të kalonte verën e të pregatiste tezën e dipllomës me titull «Prona e tokës». Zakonisht ai veronte me nënën e me motrën në një çiflik të madh, që e ëma kishte në afërsirat e Moskës. Mirëpo atë vit motra qe martuar dhe e ëma, që vuante nga reumatizma, kish shkuar në ca banja termale jashtë shtetit. Nekludovi, i zënë, siç ishte, me përpilimin e veprës për mbrojtjen e dipllomës, s'kishte patur mundësi ta shoqëronte e qe vendosur tek tetot, ku shpresonte të gjente edhe qetësinë që i duhej për të punuar. E dinte se tetot e donin me gjithë zemër, ashtu siç i deshte edhe ai, për jetën e thjeshtë që bënin dhe për zakonet e vjetra që i ruanin me fanatizëm.

Nekludovi atë behar tek tetot, ndodhej në gjendjen shpirtërore të një të riu që fillon të kuptojë për herë të parë

gjithë bukurinë dhe rëndësinë e jetës e që, ndonëse nuk i nënçmon vështirësitë e mëdha që i dalin përpara njeriut për të mishëruar ëndrrën e tij në jetë, i pushtuar nga një entuziazëm i pashteruar që ja çon pesh të gjitha ndjesitë, e gjykon kapërximin e tyre shumë të lehtë e i vihet me gjithë shpirt punës, jo vetëm me shpresë, por dhe me bindje të plotë se do t'arrijë pa tjetër atë që kërkon.

Atë vit ai kish lexuar veprën «Statika sociollogjike» të Spencerit. Arësyetimet e Spencerit mbi pronën e tokës i kishin lënë një mbresë të fortë edhe sepse vetë e ëma ishte një pronare e madhe tokash. I ati i Nekludovit nuk kishte qënë i pasur, por e shoqja i kish sjellur pajë afro dhjetëmijë disjatinë tokë. Ato lexime të parakohëshme i hapën sytë Nekludovit për herë të parë mbi gjithë egërsinë e padrejtësinë e pronës private mbi tokën. Si një njeri që është i gatshëm për t'u sakrifikuar për një çështje të drejtë, ai vendosi të hiqte dorë nga e drejta e pronës që trashëgonte nga i ati mbi një çiflik të vogël e t'ua ndante këtë fshatarëve. Në lidhje me këtë u shtyt edhe nga pikëpamja nën të cilën trajtohej problemi i pronës në tezën e tij që kishte për titull «Prona e tokës».

Jeta që bënte në fshat tek tetot ishte pak a shumë kjo: çdhej që me natë, nga ndonjë herë që në orën tre të mëngjezit; shkonte të lahej në një lumë që rridhte rrezë malit mbuluar akoma me mjergullat e para të mëngjezit e kthehej që andej kur bari dhe lulet ishin akoma qull nga vesa. Herë-herë në mëngjes, pasi pinte kafenë, ulej përpara tezës, që do të pregatiste, ose shqyrtonte burimet që do të çfrytëzonte në vepër; por, më dëndur, nuk punonte fare e dilte shetitje fushave e pyjeve gjer në drekëherë. Para se të hante bukë, shtrihej e merrte një sy gjumë në ndonjë qoshe të kopshtit të madh, pastaj, kur shtrohej në tryezë për të ngrënë, u bënte ndonjë shaka tetove e i zbaviste me gëzimin e tij të bujëshëm e të çkujdesur rinor. Pas dreke ja hipte kalit ose voziste lart e poshtë nëpër lumë me barkë dhe, mbrëmjeve, merrej me lexime ose luante me tetot letrat. Shpesh herë, netëve me hënë, gëzimi i madh i jetës, që i mbushte zëmrën, s'e linte të flinte. . . Atëhere zbriste në kopsht e bariste vetëm gjer në të gdhirë bashkë me ëndrat dhe mendimet e tij.

Kështu kish rrojtur i lumtur e i qetë atë muajin e parë që ndënji pranë tetove dhe kurrë s'i kishte shkuar në mëndje

t'i hidhte, qoftë dhe një vështrim, Katjushës, vajzës syzezë dhe këmbëshpejtë që mbahej nga tetot për shpirt.

Rritur nën kujdesin e rreptë të s'ëmës, Nekludovi ruante akoma të pacënuar në moshën nëntëmbëdhjetë vjeç pastërtinë shpirtërore të një djaloshi të padjallëzuar. Gratë i mendonte e i ëndëronte vetëm nga pikëpamja e martesës dhe nuk çfaqte kureshtje për ato me të cilat i thoshte mëndja se nuk mund të martohej. Po ja, ndodhi që atë behar, ditën e Rrëshajeve, erdhi për një vizitë tek tetot një zonjë, që rronte aty afër. Kish marrë me vete edhe fëmijët: dy vajzat e rritura, një djalë gjimnazist si edhe një djalosh muzhik, që merrej me pikturë e që u kishte ardhur në shtëpi si mysafir. Si pinë çajin, të rinjtë organizuan, për t'u zbavitur, një vrapim në një luadh të kositur që shtrihej para shtëpisë. E futën në lojë edhe Katjushën. Nekludovit i ra shorti të vrapojë bashkë me të. Nekludovit i vinte mirë sa herë që shikonte Katjushën, por kurrë nuk i shkonte ndërmend të vendoste me të marrëdhenie që të mos ishin thjesht miqësore.

Loja e deshte që ata të vraponin krahë për krahë. Piktori do përpiqej t'i arrinte e t'i ndalonte, por kjo atij nuk i dukej një gjë aq e lehtë, sadoqë ishte zot i vrapit dhe i kish shumë të shpejta ato këmbët e shkurtëra, të shtrëmbëra e tërë muskuj prej muzhiku të vërtetë.

— Një, dy, tre!. . .

Sinjali i nisjes u dha. Kur duart u përpoqën për të tretën herë, Katjusha iu afrua Nekludovit, ndërroi vendin me të duke buzëqeshur, shtrëngoi me dorën e saj të vogël po të ashpër e të fortë dorën e tij të madhe, e u sul me vrap nga e majta me fëshfërimën e fundit të ngrirë të fustanit që e ndiqte pas.

Edhe Nekludovi ishte i lehtë nga këmbët — e, si mori vrull, u lëshua me vrap që të mos i binte në dorë piktorit, gjersa u gjend në një kohë të shkurtër në anën tjetër të luadhit. Por, kur ktheu kokën pas, vuri re që piktori po e ndiqte këmba këmbës Katjushën e mënt po e arrinte, sidoqë ajo bënte çmos që t'i shpëtonte. Nga ajo anë ndodheshin ca kaçube jargavani e në tërë atë pjesë qe vendosur të mos vrapohej; por Katjusha e kapërxeu atë cak që të mos kapej nga piktori dhe i bëri shenjë me kokë Nekludovit që ta ndiqte. Nekludovi i ra pas, por s'vuri re që atje, nën kaçubet e jargavanit të bardhë, ishte një hendek me hithra. U pengua, u rrëzua, çpoi duart e u lag nga vesa që njomte gjethet. Por me-

njëher u ngrit e, duke qeshur me veten e tij, doli në një vend të thatë.

Katjusha i preu rrugën lehtë si ndonjë flutur, e qeshur në fytyrë, me sytë e saj të mëdhenj e të zes si rrush serezi. U takuan dhe u kapën për dore.

— Ç'ju ndodhi? U rrëzuat? — e pyeti vajza ndërsa ndreqte me dorën e majtë kosën që i kishte shkarë dhe, me një dihatje të vështirë e duke buzëqeshur, e vështronte kokë-unjur Nekludovin drejt e në sy.

— S'e dija që këtu kishte një hendek — tha ai e ja ktheu buzëqeshjen, por dorën s'ja lëshoi.

Dhe ja, ashtu tek ecnin bashkë, ajo u mbështet pas tij me një lëvizje të pamatur, padashur dhe ai, pa e kuptuar as vetë ç'po bënte, iu afrua dhe preku me fytyrë fytyrën e saj; ajo s'u hoq pas, s'u largua. Ai ja shtrengoi fort dorën dhe e puthi në buzë.

— Ja, edhe kjo u bë!. . . — murmuriti vajza dhe si e hoqi me një lëvizje të prerë dorën, mori vrapin vetëm.

Kur arriti tek jargavanët, këputi nja dy rrëmba, i ngjeshi pas faqeve që i digjnin dhe, duke kthyer herë-herë kokën nga ai e duke lëvizur lartë e poshtë krahët me naze, u drejtua nga shokët e lojës.

Që atë ditë, marrëdhëniet ndërmjet Nekludovit dhe Katjushës ndryshuan. Ato muarën trajtën e një simpatie që i tërhiqte ndaj njeri tjetrit, po që ata kishin frikë e turp ta pohonin, siç ngjet rëndom në të rinjtë, kur janë akoma të padjallëzuar.

S'ishte nevoja që Katjusha të hynte në dhomë, mjaft që prej së largu Nekludovi të vinte re përparsen e saj të bardhë, që të pandehte se një diell i madh, i ngrohtë, që kishte shpërthyer befas, i zbulonte thesarë gëzimi të pashpresuar, kuptime të thella e të rëndësishme edhe në gjerat që ishin dukur gjer ahere fare pa rëndësi. Jeta sikur zbukurohej, sikur zmadhohej. Po kështu i ndodhte edhe Katjushes. Dhe ndodhte kjo tek ata edhe pa u parë, edhe pa u takuar. Kështu, kur Nekludovi s'merrte letra të mira nga e ëma, ose nuk ecte dot përpara në tezën e tij mbi pronën e tokës, apo kur e pushtonte një trishtim djaloshar fare pa shkak, ai sillte ndërmend Katjushën dhe të gjitha këto derte kalonin vetvetiu.

Katjusha kishte shumë punë në shtëpi, por, e shkathët dhe e zonja siç ishte, i bënte të gjitha shpejt e mirë. Në kohën e lirë i pëlqente të lexonte. Nekludovi i dha disa ro-

mane të Dostojevskit dhe të Turgenjevit që dhe vetë porsa i kishte lexuar. Asaj i pëlqeu sidomos «Bunaca» e Turgenjevit. Takoheshin por me rast nëpër shkallë, në koridor, në oborr e nga një herë në dhomën e Matrena Pavllovnës, kamarieres plakë të tetove që banonte bashkë me Katjushën. Ai shkonte dendur atje për të pirë çajin dhe ato biseda në prani të Matrena Pavllovnës kishin për të dy një shije e një ëmbëlsi të veçantë. Por që të bisedonin kur ishin vetëm, këtë s'e bënin dot sepse menjëherë sytë fillonin të flitnin në gjuhën e tyre për gjëra të tjera shumë më të rëndësishme, goja atëhere nomitej, ata e ndjenin veten si ndër gjëmba, u vinte frikë e nguteshin të ndaheshin.

Këto marrëdhenje të reja që u vendosën mes tyre vazhduan gjatë gjithë kohës që Nekludovi banoi pranë tetove. Tetot i vunë re këto marrëdhenje, u shqetësuan dhe panë të udhës t'i shkruanin princeshës Elena Ivanovnës, të jemës së Nekludovit, një letër ku ta vinin në dijeni mbi të gjitha. Maria Ivanovna kish frikë se mos Dimitri mendonte ta shtinte në dorë Katjushën. Por kjo frikë e saj qe fare e kotë sepse Nekludovi, pa e kuptuar as vetë, e deshte Katjushën me një dashuri të padjallëzuar dhe kjo dashuri i mbronte që të dy nga çdo ngasje e ligë. Ai jo vetëm që nuk ndjente asnjë dëshirë për ta shtënë vajzën në dorë, por as mund ta mendonte kurrë të mundur një gjë të tillë. Sofia Ivanovna me atë natyrën e saj poetike parashikonte me të drejtë. Ajo trembej se mos Dimitri, duke qënë një njeri me karakter, po ta dashuronte vajzën do të kërkonte patjetër të martohej me të, pa marrë parasysh prejardhjen e saj të ultë.

Sikur atëhere Nekludovi të mos ja kish fshehur vetes dashurinë për Katjushen dhe sikur të tjerët të qenë munduar t'ja mbushnin kokën se ajo nuk bënte për të edhe se duhej të hiqte dorë prej saj mund të ndodhte fare mirë që ai, ashtu i drejtë siç ishte në të gjitha të arsyetonte kështu: «Fundja, Katjusha është një vajzë si çdo vajzë tjetër. Gjersa e dua, përse të mos martohem me të?».

Por tetot nuk i zunë në gojë dyshimet dhe frikën e tyre dhe ai u largua nga cifliku pa ja fshehur as vetes ndjenjën që ushqente për Katjushen.

Nga ana tjetër, Nekludovi ishte i bindur se dashuria për Katjushen ishte tek ai vetëm një çfaqje e asaj dashurie të madhe për jetën që i mbushte atë kohë shpirtin.

Por ditën e nisjes, kur pa Katjushen në prak të derës bashkë me tetot plaka, kur vuri re se si e vështronin ngultas

e me dashuri ata sytë e saj të mëdhenj e të përlotur, ai kuptoi në një çast kthjellësie se po humbiste diçka të bukur, diçka të shtrenjtë, që nuk do t'i kthehej më kurrë. Një brengë e hidhur e pushtoi.

— Lamtumirë, Katjushë, falemnderit për të gjitha! — i tha tek hipte në karrocë, duke zgjatur qafën përmbi kokën e mbështjellur me rrjetë të Sofia Ivanovnës.

— Lamtumirë, Dimitri Ivanoviç, — tha ajo me atë zërin e saj të këndshëm e përkëdhelës dhe duke mbajtur me zor lotët që filluan t'i shkitnin faqeve, vrapoi brenda në hajat.

XIII

Që atëhere kishin kaluar tre vjet dhe Nekludovi s'e kishte parë më Katjushën. U takua përsëri me të pasi mbaroi shkollën për oficer, kur, para se të mbërrinte repartin, ku e kishin caktuar, u ndal ca ditë tek tetot. Po tani kishte ndryshuar fare.

Dikur kishte qenë një djalosh i ndershëm e i padjallëzuar, përherë i gatshëm për të mos e kursyer veten për një çështje të drejtë e për një vepër të mirë. Kurse tani ishte një njeri i korruptuar, një egoist i rafinuar që bëhej merak vetëm për qejfet e tij. Dikur e shihte botën si një enigmë e mundohej ta deshifronte me besim në vetvete e me entusiazëm, kurse tani çdo gjë i dukej e thjeshtë dhe e qartë, çdo gjë i dukej sikur varej vetëm e vetëm nga kushtet e jetës së tij personale. Dikur mendonte se gjëja më me rëndësi dhe më e nevojëshme për njeriun ishte studimi i natyrës, njohja e shkrimeve, e të thënave të njerëzve që kishin rrojtur, merduar e ndjerë përpara tij, e filozofëve dhe poetëve të mëdhenj të së kaluarës. Tani më e rëndësishme se çdo gjë tjetër i dukej, përvetësimi i zakoneve mondane të klasës së tij.

Dikur ai shihte tek gruaja një qënie të misterëshme, magjiplote, që të tërhiqte pikërisht për hir të atij misteri që fshihej në qënien e saj. Tani, përkundrazi, gratë, të gjitha gratë (me përjashtim të atyre që bënin pjesë në familjen e tij dhe gratë e shokëve) kishin një kuptim të përcaktuar mirë e jo fort të ndërlikuar: ato nuk ishin tjetër veçse mjetet e një qejfi, që ai tanimë e kish provuar e që i pëlqente mbi çdo tjetër. Dikur nuk kish patur nevojë për të holla, kishte shpenzuar zakonisht vetëm një të tretën e shumës që merr-

te muaj për muaj nga e ëma e kish mundur të hiqte dorë nga prona e trashëguar prej t'et për t'jua dhuruar fshatarëve. Tani, përkundrazi, nuk i arrinin më të 1500 rublat që e ëma i kish caktuar në muaj, bile me t'ëmën kohët e fundit qe grindur kaq e kaq herë për punë të hollash. Dikur «uni» i tij më i thellë kish qenë shpirti, kurse tani ai lartësonte tek njeriu «unin» shtazor, të shëndoshë e qejfli.

I gjithë ky ndryshim i tmershëm, që kish ndodhur tek Nekludovi, rridhte vetëm ngaqë ai kish filluar të mos i besonte vetes, por të tjerëve. Kishte filluar të mos i besonte më vetes, por të tjerëve, sepse të rrosh duke i besuar vetes është një gjë e vështirë. Kur i beson vetes, duhet që çdo çështje ta zgjidhësh jo në dobi të «unit» tënd shtazor, që kërkon përherë gëzime të lehta e kënaqësira të cekta, por po huajse gjithmonë në dëm të tij; përkundrazi, kur u beson të tjerëve, s'të mbetet asgjë për të zgjidhur, sepse të gjitha janë zgjidhur që me kohë nga të tjerët dhe janë zgjidhur gjithmonë kundër «unit» shpirtëror në dobi të «unit» shtazor. Kur i beson vetes, ai u prish me njerëzit e bëri shumë armiq, kurse duke u besuar të tjerëve fitonte levdata e miq të shumtë.

Kështu, kur Nekludovi mendonte, lexonte, fliste për perëndinë, për të vërtetën, për pasurinë dhe për skamjen, të gjithë ata që e dëgjonin, i gjykonin arësyetimet e tij fare pa vënd e qesharake, ndërsa e ëma dhe tetot e thërritnin me një ironi pa të keq, «filozofi ynë i dashur». Përkundrazi, kur lexonte romane, tregonte anekdota, ose fliste për ndonjë vodëvilë të lehtë, që kish parë në theatrin francez, të gjitha e lëvdonin dhe i mbanin ison. Kur vishte një kapotë të vjetër e nuk pinte verë, të gjithë e mbanin për një mëndjemadh, që deshte të bënte ndryshe nga të tjerët. Kur, përkundrazi, i vërviste paratë me të dy duart për të plotësuar të tekurat e qejfet, kur shkonte për gjah, kur e shtronte me drekëra e me darkëra, në shtëpi e jashtë s'kishte njeri të mos fliste mirë për të. Kur një ditë shprehu dëshirën për të patur një dhomë pune me orendi të pasura, të gjithë nxituan t'i dhurojnë sende me vleftë të madhe. Kur ishte djalë i paprishur e mendonte të mbetej i tillë gjer sa të martohej, njerëzit e familjes dridheshin për shëndetin e tij dhe ëma, që u tmerrua kur i thanë që i biri ndoshta kishte ndërmend të martohej me Katjushën, u gëzua pa masë kur mori vesh se ai i kishte rrëmbyer një shoku dashnoren franceze.

Po kështu kur Nekludovi, arriti në moshë ligjore, u

dhuroi fshatarëve pronën e vogël që trashëgonte nga i ati, duke menduar se pronësia e tokës ishte një gjë e padrejtë, ai gjest e tmerroi familjen e s'mbeti njeri, nga ata që e njihnin, pa e qortuar e pa e vënë në lojë. Kush në një mënyrë, kush në një tjetër, që të gjithë i vinin në dukje se me atë dhuratë jo vetëm që nuk i kishte pasuruar fshatarët, por i kishte shtyrë, përkundrazi, në greminën e një skamjeje të sigurtë, se ata qenë ngutur të hapnin në fshat një mejhane, ku i bënin fyt paratë, ku pinin natë e ditë dhe mbytnin në verë, bashkë me të hollat, edhe vullnetin e punës. Por kur Nekludovi kish hyrë në gardë dhe, si përvetësoi mirë veset e shoqërisë aristokratike, kishte filluar të shpenzonte kaq shumë të holla sa ta detyronte t'ëmën të cenonte kapitalin e shtëpisë, princesha plakë, jo vetëm që nuk qe mërzitur nga kjo, por përkundrazi, qe gëzuar duke menduar se i biri po ndiqte tamam atë rrugë që i përshtatej shkallës dhe pasurisë së tij.

Në fillim Nekludovi kishte luftuar, por kjo luftë i qe dukur shumë e vështirë se çdo gjë që atij i dukej e mirë të tjerëve u dukej e keqe dhe anasjelltas; çdo gjë që atij i dukej e keqe të tjerëve u dukej e mirë. Kështu, më në fund, Nekludovi u dorëzua dhe e pranoi veten të mundur. nuk i besoi më vetes e nisi t'u besonte të tjerëve. Në fillim kjo tradhëti, që i kishte bërë vetes, e brengoste pa masë, por dalëngadalë, kur nisi të pinte verë e duhan, kjo ndjenjë e papëlqyer tek ai u zhduk pa lënë gjurmë.

Që atëhere Nekludovi, me atë natyrën e tij të zjarrtë, u dha me mish e me shpirt pas asaj jete të re ashtu siç bënin edhe miqtë e shokët e tij, duke e mbytur atë zërin që i fliste dikur dhe e nxiste për të tjera vepra dhe për një tjetër jetë. Ai ndryshim në jetën e tij filloi që kur erdhi në Peterburg dhe përfundoi kur hyri në shërbimin ushtarak.

Në përgjithësi, ushtëria i korrupton njerëzit, i vë ata në kushtet e një parazitismi të plotë, d.m.th. nuk u jep mundësinë e kryerjes të një pune të dobishme e të arësyeshme, i çliron nga detyrimet që ka çdo njeri ndaj shoqërisë, duke u krijuar vlera të rreme, duke u ngjallur dëshira të dëmshme: nderin konvencional të armës, të uniformës, të flamurit, një pushtet të pakufizuar ndaj deprorëve, një nënshtrim prej skllavi ndaj eprorëve.

Por kur këtij korruptimi të zakonshëm që është lidhur me shërbimin ushtarak, me nderin e tij të uniformës, të flamurit, me përdorjen e dhunës, me lejimin e vrasjes, i shto-

het edhe korruptimi që vjen nga pasuria e nga lidhjet miqësore me familjen, e carit, siç ngjet në radhët e regjimenteve të gardës, ku shërbejnë vetëm oficerë të pasur e nga soji, atëhere njeriu arrin gjer në shkallën e një egoizmi të shfrenuar e të marrë. Pikërisht në këtë gjendje egoizmi të shfrenuar e të marrë ndodhej edhe Nekludovi që kur hyri në shërbimin ushtarak e nisi të rronte ashtu siç rronin shokët e tij.

Punë po s'kishte fare. Mjaft që të pispillosëshe mirë me uniformën e qepur për merak, të pastruar e të hekurosur nga të tjerë, të vije në kokë helmetën e të ngjishje armët që i kishin bërë gati të tjerët, t'i hipje kalit, rritur, ushqyer e stërvitur prapë nga të tjerët, të drejtoje stërvitjen, të kaloje në paradë e të vrapoje trokthi apo në revan, të vërtitje shpatën e të qëlloje me armë duke ua mësuar të gjitha këto marifete edhe njerëzve të tjerë. Punë tjetër po s'kishte, dhe njerëzit me pozitë të lartë, si pleqtë ashtu dhe të rinjtë, si cari vetë ashtu dhe rrethi i tij jo vetëm që pajtoheshin me këtë lloj pune, por edhe e mburrnin, edhe i falënderonin e i shpërblenin njerëzit që merreshin me të. Dhe për t'u çlodhur nga kjo punë, gjykohej se ishte mirë dhe fort e pëlqyer që njerëzit të mblidheshin bashkë për të ngrënë e sidomos për të pirë në klubet e oficerave apo në restorantet e shtrenjta, duke i vërvitur me të dy duart paratë që s'merrej vesh se nga u vinin. Pastaj vinin theatrot, ballot, gratë e prapë hipja mbi kuaj, të vërtiturit e shpatave, vrapimet dhe përsëri paratë që derdheshin si lumë, vera, letrat dhe gratë. . .

Kjo jetë e degjeneruar përvetësohet kaq shpejt e kaq mirë nga ushtarakët edhe nga shkaku se, ndërsa një civil do ta ndjente, qoftë edhe diku në thellësi të shpirtit, turpin e saj, ushtaraku përkundrazi, mendon me bindje se pikërisht ajo jetë i duhet, se vetëm ajo u përshtatet, gjer në fund, ndjenjave e qëllimeve të tij. Ushtaraku mburret, lëvdohet që bën një jetë të tillë, sidomos kur është në kohë lufte, ashtu siç ishte Nekludovi, që e filloi shërbimin pas luftës me Turqinë. «Ne jemi gati të bëjmë fli edhe jetën tonë në luftë. Prandaj kjo jetë e çthurur dhe e çkujdesur jo vetëm që na falet por është e vetmja që na përshtatet».

Ja kështu si shumë të tjerë mendonte edhe Nekludovi në atë periudhë të jetës së tij dhe, i zhytur siç ishte në atë gjendje egoizmi të çfrenuar, entusiazmohej, i çliruar një herë e mirë nga të gjitha kufizimet morale të cilat dikur ja kishte vënë vetvetes.

Pikërisht në këtë gjëndje ndodhej edhe kur u kthye, pas tre vjetëve tek tetot.

XIV

Nekludovi u kthye tek tetot sepse çifliku i tyre ndodhej tamam në rrugën që ndiqte për të arritur regjimentin që ish nisur për në front. Nga ana tjetër, ato i qenë lutur kaq e kaq herë që t'iu bënte një vizitë përpara se të shkonte në luftë; veç kësaj, ai shpresonte e kishte dëshirë tani të takonte atje edhe Katjushën. Kushedi, mbase thellë në shpirtin e tij fshihej një qëllim i keq ndaj Katjushës, të cilin ja kish përshpëritur në vesh ai njeriu shtazarak e i çthurur që rronte prej kohësh në shpirtin e tij. Sidoqoftë, ai s'ja pohonte vetes këtë qëllim dhe i dukej se shkonte tek tetot vetëm e vetëm për të shijuar edhe një herë bukurinë e atyre vendeve ku e kish ndjerë kaq mirë veten dikur, për t'u takuar me ato plakat e tij kaq qesharake, por dhe kaq të dashura për të, që e kishin pritur kurdoherë mirë, që pa e kuptuar se si kishin ditur ta rrethonin me një atmosferë të ngrohtë dashurie dhe entusiazmi. Pastaj. . . pastaj do të takohej edhe me Katjushën, që i kish lënë një tok kujtime.

Arriti në kështjellën e tetove aty nga fundi i marsit, ditën e të Premtes së Madhe, në një kohë kur rrugët mbuloheshin me baltë, kur shiu binte me rrëbesh. Qull në ujë, hyri në oborrin e madh të shtëpisë, zbardhur vende-vende nga bora, që qe shëmbur prej çatisë së haurit të vjetër të yzmeqarëve. Sadoqë i lagur gjer në palcë, s'e kish humbur gjallërinë e ndjehej i shkathët e gazmor, siç ishte përherë ato kohët e fundit. «Të jetë akoma atje?» — mendonte dhe, si i ra ziles, priste që ta shikonte të dilte në verandë e t'i hapte derën. Por, në vend të saj, i duallën përpara dy gra këmbëzbathur, me fustane të përveshura e me ca kova në duar që, me sa duket, po lanin atë kohë dyshemetë. Hyri më thellë, por Katjusha s'dukej gjëkundi. Pa vetëm, duke ecur në drejtim të tij, Tihonin, shërbëtorin plak që, me sa dukej, edhe ai po merrej me pastrimin e shtëpisë, se kish ngjeshur në brez një përparëse. Në sallon doli për ta pritur Sofia Ivanovna, që kish veshur një fustan të mëndafshtë dhe mbante në kokë një kapuç prej leshi të butë.

— Sa mirë bëre që erdhe! — tha Sofia Ivanovna dhe e puthi. — Mashenkën e kemi pak pa qejf se u lodh shumë e gjora në kishë. Sot kishim ditën e rrëfimit.

— Mirësetëgjeta, teto Sofia, — tha Nekludovi duke i puthur duart Sofia Ivanovnës, — ju kërkoj ndjesë, por s'kam ç'bëj, u laga.

— Shko shpejt në dhomën tënde. Po ti qënke bërë qull, pse s'thua. Shiko, shiko, paske lënë edhe mustaqet. . . Katjusha! Katjusha! Shpejt kafenë!

— Ja, tani! — u përgjegj një zë i njohur e i këndshëm, që vinte nga koridori.

Zëmra e Nekludovit atë çast rrahu si e çakërdisur nga gëzimi. «Këtu qënka! Këtu! Këtu!». Iu duk sikur atë çast çau retë e u çfaq përpara tij një diell i ngrohtë, i madh. Ashtu i gëzuar, i ra pas Tihonit e shkoi për t'u ndërruar në dhomën e tij.

Nekludovi kish shumë dëshirë t'i hidhte Tihonit ndonjë fjalë për Katjushen: si ishte me shëndet? Me çfarë merrej tani? Mos kish ndërmend të martohej? Por Tihoni sillej me të me kaq respekt, ishte njëkohësisht kaq i rëndë e i rreptë e kaq shumë ngulte këmbë që t'i hidhte me dorë të tij për t'u larë, saqë Nekludovi s'merrte dot guxim ta pyeste për Katjushen. Meqë duhej të thoshte ndonjë fjalë, e pyeti si i kishte nipat, a mbahej akoma në këmbë ai kali i tij plak, e ç'bënte Pelikani, qeni që u ruante shtëpinë. Të gjithë qenë shëndoshë e mirë, me përjashtim të Pelikanit, që qe tërbuar vitin e kaluar e kish ngordhur.

Nekludovi porsa i kish çveshur rrobat e lagura e po ndërrohej, kur dëgjoi jashtë në koridor disa hapa të shpejta që po afroheshin. Pastaj në derë dikush trokiti. Ishte hapi i saj, ishte trokitja e saj.

Ai nodhi me të shpejt mbi trup kapotën, ashtu qull siç ishte dhe iu afrua derës.

— Hyni!

Po, ajo ishte, Katjusha. Jo, s'kishte ndryshuar, vetëm që bërë më e bukur. Po, ashtu si dikur e hidhte nga poshtë lart vështrimin pak vengërosh të atyre syve të saj të zes të qeshur e të padjallëzuar. Ashtu, si dikur, edhe tani kishte lidhur në bel një përparëse të bardhë borë, të pastër e të hekurosur. Ajo vinte, e dërguar nga tetot për t'i sjellë një sapun me erë që porsa e kishin hapur nga letra dhe dy peshqirë: një të madh, nga ato që përdoret në Rusi për të fshirë trupin e një tjetër më të vogël, me push. Si sapuni

paprekur me gërmat e mëdha të markës që i dalloheshin çkoqur, ashtu dhe peshqirët ishin po aq të pastërta, po aq të freskët e të këndëshëm sa edhe ajo vetë. Dhe buzët, buzët e saj të kuqe e të trasha kërvesheshin po aq lehtë, po aq ëmbël nga gëzimi i madh i takimit me të.

— Mirë se erdhët, Dimitër Ivanoviç! — foli ajo me një fije zëri duke e shqiptuar me zor të madh çdo fjalë dhe fytyra atë çast iu mbulua nga një purpur i ndezur, i dëndur.

— Mirë se ju gjej. . . Mirë se të gjej, — belbëzoi ai pa qenë i sigurtë në se qe më mirë t'i drejtohej me «ju» apo me «ti» dhe u skuq po ashtu në fytyrë si ajo. — Me shëndet si jeni? Jeni mirë?

— Po, po. . . Lavdi zotit. . . Ja, tetua më dërgoi t'ju sjell atë sapunin që juve ju pëlqen shumë, atë bojë rozë, — tha ajo duke e vendosur sapunin mbi tryezë dhe duke i hapur peshqirët mbi karrige.

— Ai ka të tijn — tha Tihoni, si për t'i dalë zot mysafirit, duke treguar me mburrje neseserin [1]) e madh me kapak të argjëndë të Nekludovit, ku qe rrjeshtuar një numër i madh shishesh të mëdha e të vogla, furçash, pomadash, parfumesh e gjithfarë instrumentash të tjera tualeti.

— I thoni tetos nga ana ime shumë faleminderit. Hej, sa mirë bëra që erdha këtu! — tha Nekludovi duke ndjerë në zemrën e tij po atë ngashërim e po atë dritë ngazëllimi si dikur.

Ajo ja ktheu me një buzëqeshje e doli pa thënë më asnjë fjalë.

Tetot, gjithnjë e kishin dashur Nekludovin e gjithnjë e kishin pritur mirë në shtëpi të tyre, po këtë radhë, gëzimi që ndjenë kur e panë dhe nderet që i bënë është e vështirë të përshkruhen. Dhe me hak, se Dimitri shkonte në luftë dhe në luftë, mendonin tetot, Dimitri i tyre mund të plagosej e, larg qoftë, mund edhe të vritej.

Nekludovi kish patur ndërmënd në fillim të qendronte tek tetot vetëm një ditë por, kur pa Katjushën, pranoi të rrinte edhe për pashkë, që binte pas dy ditësh. Prandaj i dërgoi një telegram Shenbokut, një miku të tij, me të cilin e kishte bërë me fjalë të takohej në Odesë, duke e ftuar që të kalonte edhe ai nga çifliku i tetove.

Me të parë Katjushën, ai kuptoi se iu ngjall përsëri ajo ndjenja që kishte patur për të. Ashtu si edhe më parë, ai

1) Takëm tualeti.

nuk mund ta shihte përparësen e saj të bardhë e të mos ngashërehej, të dëgjonte zhurmën e hapave të saj, zërin e të qeshurën e saj e të mos gëzohej, nuk mund të ndeshte vështrimin e syrit të saj të zi, si ai rrushi kokërmadh lagur nga vesa, e të mos rrënqethej. Por, sidomos, nuk mund të shikonte pa u turbulluar se si skuqej fytyra e saj sa herë që ajo takohej me të. E kuptonte se qe dashuruar, por jo ashtu si dikur, kur dashuria ishte për të një mister dhe ai s'guxonte t'ja pohonte këtë as vetes, atëhere kur ishte i bindur se njeriu vetëm një herë mund të dashurojë. Jo, tani ai qe dashuruar ndryshe, se tani ai dinte mirë ç'ishte dashuria e s'i trëmbej më, si dikur, ndjenjës që provonte për Katjushën.

Tek Nekludovi, ashtu si te ç'do njeri, rronin dy njerëz. Njeri, me një natyrë (ta themi kështu) shpirtërore, që s'e ndante të mirën e vetes së tij nga e mira e përgjithëshme; tjetri, — njeriu shtazor, — që kujdesej vetëm për të mirën e tij dhe nuk bëhej merak sikur për këtë t'i duhej të shkelte edhe mbi të mirën e të gjithë njerëzve të tjerë. Në atë periudhë egoizmi të çfrenuar që kishte zënë rrënjë tek ai gjatë jetës ushtarake në Peterburg, njeriu shtazor sundonte si zot i plotfuqishëm, pa e lënë atë njeriun tjetër shpirtëror të ngrinte kokën. Por, kur ai pa Katjushën dhe provoi përsëri atë ndjenjë që kishte patur dikur për të, njeriu shpirtëror, që ishte akoma gjallë tek ai, ngriti zërin për të kërkuar të drejtat që i kishin shkelur. Kështu, gjatë atyre dy ditëve që ndenji tek tetot, gjer natën e pashkës së madhe, në shpirtin e tij u zhvillua një luftë e pandërprerë dhe e rreptë, ndonëse e pavetëdijëshme.

Ai dëgjonte diku thellë në veten e tij një zë që i thoshte se duhej të nisej e të largohej sa më parë që andej, se s'kishte pse të rrinte më tek tetot, parandjente pasojat e papëlqyera që do vinin nga qendrimi i tij i zgjatur me qëllim, por prapë s'i bënte zemra të nisej, kur mendonte sa e bukur, sa e këndëshme ishte jeta atje. Të shtunën në darkë, natën e pashkës, prifti bashkë me dhjakun, sipas zakonit, erdhën në shtëpi për të kënduar meshën e parë. Siç tregoi urata, nga shkaku i borës që kish nisur të çkrinte vende-vende, kishin vuajtur shumë rrugës, gjersa i kishin bërë ato tre vjorstat që e ndanin kishën nga çifliku.

Nekludovi, ashtu si tetot e njerëzit që shërbenin në shtëpi, qendroi edhe ai gjer në fund, sa mbaroi mesha, duke i hedhur sytë parreshtur, gjat tërë kohës, nga Katjusha, që qëndronte tek dera me temjanicën në dorë. Pastaj, si bëri

zakonin e u puth tri herë me priftin, me tetot dhe me të gjithë shërbëtorët një e nga një, po matej të shkonte të flinte në dhomën e tij, kur dëgjoi në koridor zërin e Matrena Pavlovnës, guvernantes plakë të Maria Ivanovnës, që gatitej të shkonte në kishë bashkë me Katjushën për të bekuar kuleçët e Pashkës. «Do të shkoj edhe unë», — mendoi ai aty për aty.

Atë kohë, — ishte koha në të dalë të dimrit, kur bora nis e shkrin e rrugët mbulohen tejpërtej me ujë e me copra akulli të thyer, — karroca e sajat s'punonin. Prandaj Nekludovi, që e ndjente veten tek tetot si zot shtëpie, dha urdhër të shalonin kalin plak, që i kish hipur dikur në shetitje, veshi uniformën e tij që shkëlqente me pantallonat e ngushta e të tendosura mirë të kalorësit, hodhi krahëve mantelin dhe mori udhën e kishës përmes errësirës, përmes borës e gropave me ujë.

XV

Ajo meshë natën do të mbetej për Nekludovin një nga kujtimet më të thella e të dashura të jetës së tij.

Kur, duke çarë rrugën përmes errësirës që ndriçohej aty këtu vetëm nga zbardhëllimi i zbetë i borës, u drejtua për nga kisha, kaluar mbi atin e urtë të tetove, që i pllacariste këmbët me zhurmë në çdo llugë, shërbesa në kishë kish filluar me kohë.

Muzhikët e njohën menjëherë nipin e Maria Ivanovnës, e nxuarrën në vend të thatë, e ndihmuan të zbriste dhe e shoqëruan gjer në kishë.

Kisha ishte mbushur plot me njerëz dhe qe stolisur si për të kremte.

Nga e djathta vinin muzhikët: pleqtë me ca kaftanë që i kishin qepur vetë, mbështjellur këmbët me peca pëlhure të bardhë; të rinjtë me kaftanë prej stofi të trashë, me ca breza të gjerë në mes dhe me çizme. Nga e majta qenë radhitur gratë: të rejat me ca fustane të kuqe mëndafshi me pala, me funde të kaltër, të blertë, të kuq e gjithfarë ngjyrash; në këmbë mbanin këpucë të rënda me gozhdë. Plakat, që kishin lidhur në kokë ca riza të bardha, me kaftanë të murmë, qendronin pas. Ndërmjet tyre qenë rrjeshtuar fëmi-

jët, të veshur me rroba të reja, me flokët që u shëndritnin nga vaji. Burrat bënin kryqin, përkulnin trupin e tundnin kokën; gratë, sidomos plakat, duke i ngulur sytë tek një ikonë rrethuar nga të gjitha anët me qirinj të ndezur, i ngjishnin fort gishtërinjtë e mbledhur në majë mbi shaminë e ballit, mbi të dy supet e nën gji, pëshpëritnin lutje dhe përkuleshin përpara ose binin në gjunjë e faleshin. Të vegjëlit bënin edhe ata si të mëdhenjtë e faleshin me zell të madh, sidomos kur e dinin që po i shikonin. Ikonostasi i florinjtë përshkënditej nga drita e qirinjve të hollë e të llambadhave të trasha e të larta veshur me ar. Qirinj të shumtë qenë ngulur edhe nëpër shandane; nga të dy anët e klirosit ngrihej lart kënga e ngazëllimit të madh, zërat e hollë të fëmijëve dhe basot e trashë të burrave që këndonin në kor.

Nekludovi bëri përpara. Në mes kishte zënë vend aristokracia: çifligari me të shoqen e të birin veshur me një palë rroba marinari, stanovoj, telegrafisti, një tregëtar me çizme të larta që i vinin gjer në gjunjë. Më të djathtë, pas gruas së çifligarit, ndodhej Matrena Pavlovna, me një fustan ngjyrë manushaqe, me një shall të bardhë me thekë, që e kish hedhur krahëve. Pranë saj ishte Katjusha. Kjo qe veshur me një fustan të bardhë me pala dhe mezin e kishte shtërnguar me një brez bojë qielli, ndërsa në kokë, mbi flokët e zes, kish lidhur një fjongo të kuqe.

Çdo gjë aty qe zbukuruar si për festë e të ndillte, pa kuptuar, ndjenjën e një gëzimi të madh, të një mirëqënieje e të një lumturie, që të dukej se s'do të kish, mbase, kurrë të shteruar. Kështu dukeshin priftërinjtë me rrobat e tyre që shëndrisnin tërë ar dhe me ato kryqe të florinjtë, kështu dukej dhjaku dhe ndihmësat e tij me petkat e praruara të së kremtes, kështu dukeshin edhe këngëtarët e korit vullnetar. Herë pas here, urata ngrinte përpjetë shandanet e stolisur me lule për të bekuar popullin: «Krishti u ngjall! Krishti u ngjall!». . . Po, kishte një bukuri të rrallë në të gjitha këto, por bukuria më e rrallë aty ishte Katjusha. me fustanin e saj të bardhë e brezin e kaltërryer që i shtrëngonte belin, me fjongon që kuqërrente në kurorën e flokëve të zes, me ata sytë e saj, që përshkënditeshin nga një ngashërim i thellë, i heshtur.

Nekludovi e ndjente se ajo po e shikonte, sadoqë s'e kthente kokën nga ai. Ai i kaloi pranë për të shkuar në altar. S'kishte ndonjë gjë për t'i thënë, por prapë, kur u gjend pranë saj, u kthye e i tha:



— Tetua më ngarkoi t'ju them që darkën do ta hanë pas meshës së dytë.

Ai gjaku i nxehtë vajzëror i Katjushës, ashtu si çdo herë kur ajo takohej me të, mbuloi me një purpur të dëndur fytyrën e saj nazike dhe sytë, të qeshur e të gëzuar, u ndalën e mbetën një çast me atë vështrimin e tyre të padjallëzuar fëminor, mbi fytyrën e Nekludovit.

— E di, — tha e i buzëqeshi.

Atë çast epitropi që çau turmën e priste lëmoshat në një disk të rëndë bakri në dorë, i kaloi pranë Katjushës dhe, ngaqë s'e pa, e fshiku e mënd u përplas me të. Kjo ndodhi, me sa dukej, nga që epitropi, nga frika se mos i shkelte këmbën nipit të nderuar të Maria Ivanovnës, kish ndërruar udhë me një kthesë fare të papritur. Por Nekludovi çuditej se si ai epitropi hutaq mund të mos e përfillte Katjushën, kur çdo gjë aty e çdo gjë në botë këndonte lëvdatat e saj. Ajo ishte, për sytë e dashuruar të Nekludovit, qendra ku mbahej e vërtitej tërë rruzullimi dhe për të vetëtinte floriri i çmuar i ikonostasit, për të flakëronin qirinjtë e shandaneve, për të ngriheshin lart zërat e hareshme që këndonin: «Ngazëllohi, o nje-rëz, se erdhi pashk'e perëndisë!». Çdo mirësi në këtë botë dhe çdo bukuri mbante vulën e saj. Dhe Katjusha e dinte, të paktën kështu mendonte ai, duke vështruar fytyrën e saj që shprehte një gëzim të paparë.

Kur mbaroi mesha e parë, Nekludovi doli nga kisha. Njerëzia i hapte rrugë e i përulej. Ata, që e njihnin, e përshëndetnin, të tjerët pyetnin: «Kush është ky?». Si kaloi pragun e derës së madhe të kishës, Nekludovi u ndal. Lypësit iu mblodhën rrotull e i kërkonin lëmoshë. Ai u dha të gjitha të hollat që kishte me vete dhe zbriti shkallët.

Hijet e natës sa vinin e bëheshin më të zbeta, por dielli nuk dukej akoma. Njerëzit dilnin nga kisha tufa-tufa e përhapeshin nëpër ca varre që ndodheshin rreth e rrotull. Nekludovi u ndal që të priste Katjushën. Gurët e kalldrëmit në oborrin e kishës kërcisnin nga qindra palë këpucë të rënda me gozhda.

Një plak i moçëm, me një kokë të shogur, qendroi përballë Nekludovit dhe e përqafoi tri herë. Plaku kishte punuar dikur gjellbërës në shtëpi të Maria Ivanovnës. E shoqja, një plakë e moçme, me një fytyrë të zbetë e tërë rrudha, nxorri nga shamia një vezë të kuqe dhe ja dha. Pas tyre, u afrua dunga shamia një vezë të kuqe dhe ja dha. Pas tyre, u afrua duke buzëqeshur një muzhik i ri me muskla të forta, me një brez të gjerë jeshil në mes.

— Krishti u ngjall! — tha, dhe sytë i qeshnin kur iu bë pranë Nekludovit. Duke i çpuar hundën me atë aromën e veçantë që kanë muzhikët e duke e gudulisur lehtë me qimet e mjekrës së shkurtër, ai e puthi tri herë me buzët e tij të trasha e të ashpëra.

Ndërsa Nekludovi puthej me muzhikun, spikati mes turmës fustani tërë shkëlqim i Matrena Pavlovnës dhe fjongua e kuqe mbi flokët e zes të Katjushës.

Ajo i hodhi sytë nga ai përmes qafave të njerëzve që e rrethonin. Fytyra i qeshi menjëherë porsa pa Nekludovin dhe ai këtë e vuri re. Në sheshin përpara kishës, gratë u ndalën duke u dhënë lëmoshë të varfërve. Një lypës, me një plagë të kuqe, që porsa kish nisur t'i piqej në majë të hundës, ju afrua Katjushës. Ajo diç nxori nga shamia dhe ja dha dhe, e qeshur e pa u ndrojtur, e rroku në qafë dhe e puthi tri herë. Po ja, ndodhi që, ndërsa po përqafohej me varfanjakun, vështrimi i saj ndeshi në atë të Nekludovit. Dhe Nekludovit ju duk se sytë e saj e pyetnin:

«Bëj mirë që e puth?».

«Po, po, se çdo gjë që bën ti është e mirë dhe e përsosur, siç je edhe ti vetë. Ah, ta dish sa të dua!» — ja kthente Nekludovi dhe s'e përmbante dot gëzimin e madh që i mbushte zemrën.

Kur zbritën shkallët, Nekludovi u doli përpara jo që t'u uronte pashkën dhe t'i përqafonte sipas zakonit, por vetëm si e si të ndodhej pranë Katjushës.

— Krishti u ngjall! — tha Matrena Pavlovna me një buzëqeshje e me një zë sikur desh të thoshte që atë ditë të gjithë qenë të barabartë; pastaj, si i fshiu buzët me cepin e shamisë, iu afrua Nekludovit që ta puthte.

— Me të vërtetë u ngjall! — u përgjegj Nekludovi dhe, si e puthi, i ktheu sytë nga Katjusha. Ajo u skuq dhe iu afrua.

— Krishti u ngjall, Dimitri Ivanoviç.

— Me të vërtetë u ngjall, — tha ai. U puthën dy herë, por e puthura e tretë iu duk e zorshme se, pas së dytës, qëndruan një çast sikur do të vendosnin a duhej apo s'duhej të putheshin.

Buzëqeshën që të dy.

— Nuk do shkoni tek prifti? — pyeti Nekludovi.

— Jo, do ta presim meshën e dytë këtu, Dimitri Ivanoviç, — foli Katjusha si e ndrojtur. Ajo e vështronte me ngulm me sytë e saj virgjëror e të dashuruar që vëngëronin lehtë.

Në marrëdhëniet ndërmjet burrit e gruas vjen gjithmonë

një çast kur dashuria arrin kulmin e saj më të lartë, kur bëhet një gjë krejt e pavetëdijëshme, kur arësyeja hesht dhe ndjenjat mpihen. Këtë gjë Nekludovi e ndjeu atë natë të kthjelltë pashke. Ndërsa tani rrinte i mënjanuar pranë dritares e përpiqej të sillte ndërmënd të gjitha rrethanat në të cilat e kishte parë Katjushën, ai çast ringjallej në trurin e tij ashtu siç kishte qenë e fshinte çdo mbresë tjetër. Oh koka, koka e vogël dhe flokët e zes e të butë, dhe fustani i bardhë e i ngushtë me pala që i kishte aq hije!. . . Gjiri i saj i bëshëm, sytë e zes të përgjumur e vëngërosh që shkëlqenin si qelq dhe i tërë trupi i Katjushës, magjepsin jo vetëm Nekludovin, por çdo njeri në botë, të mirë apo të lik, edhe atë lypsin e gjymtuar, që e kishte puthur tek dera e kishës.

Një dashuri e thellë kish lindur në shpirtin e saj dhe ai e dinte mirë këtë, se e ndjeu edhe në shpirtin e tij atë natë dhe atë mëngjes, dhe i thoshte zemra se kjo dashuri kishte kaq forcë sa t'i shkrinte ata të dy në një qënie të vetme.

Ah, sikur të kish mbetur puna gjer në ndjenjën e asaj nate! «Po, e keqja erdhi pas asaj nate të bukur pashke!» — mendonte ai tani i brengosur në karrigen e tij të vetmuar pranë dritares, në dhomën e zhurisë.

XVI

Kur u kthye nga kisha, Nekludovi e prishi kreshmën me tetot dhe, si hodhi ca kupa me vodkë, siç bënte në ushtëri kur lodhej, shkoi në dhomën e tij. Atje ra në shtrat dhe fjeti, ashtu me rroba siç ishte. Por dikush trokiti në derë dhe e zgjoi. Kuptoi nga mënyra e të trokiturës që duhej të qe ajo dhe u çua duke fërkuar sytë.

— Katjushë, ti je? — pyeti.

Ajo e shtyu derën por pa e hapur tej për tej.

— Ju thërresin të hani bukë, — tha.

Qe veshur po ashtu si në kishë, po pa atë kordelen e kuqe në kokë. Ajo e shikoi dhe sytë e saj shkëlqenin sikur po sillte një lajm jashtëzakonisht gazmor e të këndshëm.

— Ja tani po vij, — u përgjegj ai duke zgjatur dorën nga krëhëri për të ndrequr flokët.

Ajo ndenji pak më tepër nga ç'duhej. Ai e vuri re dhe, duke e flakur tutje krëhërin, iu afrua. Por vajza, me një rro-

tullim të shpejtë i ktheu krahët dhe doli në koridor me një hap të shpejtë e të lehtë si zakonisht.

«Eh, unë budallai, si nuk e ndala?» — i tha vetes Nekludovi dhe u lëshua me vrap në koridor që ta zinte.

Se çfarë deshte prej saj, nuk e dinte as vetë. Por i dukej që kur ajo kishte hyrë në dhomën e tij, ai diç duhej të kishte bërë, pikërisht atë që bëjnë të gjithë në të tilla raste, dhe ai këtë s'e kishte bërë.

— Katjusha, ndal! — i foli.

— Çfarë? — e pyeti ajo duke kthyer kokën pas e duke ndalur një hop.

— Jo, s'ka gjë, por vetëm. . .

Dhe duke e mposhtur veten, duke sjellur ndërmënd se si vepronin në përgjithësi në të tilla raste të gjithë njerëzit e sërës së tij, ai i hodhi të dy duart në mes dhe e pushtoi.

Ajo qendroi në vend pa lëvizur dhe e vështroi drejt e në sy.

— Nuk bën, Dimitri Ivanoviç, nuk bën! — tha, ndërsa skuqej e tëra në fytyrë dhe me dorën e saj të ashpër dhe të fortë, u çlirua nga krahu që e shtrëngonte.

Nekludovi e lëshoi. E ndjeu veten në çast si në gjëmba, por veç turpit provonte tani për veten e tij edhe një neveritje të thellë.

Ai duhet t'i kishte besuar vetes atë çast vendimtar, por s'ishte në gjëndje ta kuptonte që pikërisht ai turpi dhe ajo neveritje për veprën që kreu ishin çfaqja e ndjenjave më të mira të shpirtit të tij. Përkundrazi, atij iu duk se ai s'ishte zëri i ndërgjegjes, por zëri i budallallëkut të tij që fliste si çilimi akoma dhe se duhej bërë ashtu siç bënin të gjithë.

I ra pas edhe një herë, e përqafoi përsëri dhe e puthi në qafë. Por ajo e puthur nuk ishte si të puthurat që i kishte dhënë më parë: dikur pas kaçubeve të jargavanëve dhe atë mëngjes në kishë. Ajo e puthur kish diçka të tmerëshme, të keqe dhe ajo e ndjeu.

— Ç'bëni kështu? — i thirri plot inat, sikur atë çast t'i kishin çkulur nga zemra diçka të vyer e të rrallë që s'kthehej më kurrë.

Katjusha i ktheu kurrizin e u largua duke nxituar. Ai qendroi në ven si i çoroditur, pastaj shkoi në dhomën e bukës. Këtu gjeti tetot, veshur e stolisur si për të kremte, dhe doktorin. Përpara tyre, mbi tryezë, qenë shtruar mezetë. Rreth e rrotull asgjë s'kish ndryshuar, por në shpirtin e Nekludovit kish filluar tanimë tufani. Ai s'kuptonte asnjë fja-

lë nga ato që i thonin, përgjigjej si të mundte, mendonte vetëm për Katjushën dhe për atë të puthurën e fundit atje në koridor. Për asgjë nuk mund të mendonte atë kohë. Kur ajo hynte në dhomë, ai bënte çmos që të mos kthente kokën e ta shikonte, por me atë mprehtësi të shqisave të tij të tronditura, ndjente çdo hap e çdo lëvizje të saj me një kthjelltësi të çuditëshme.

Menjëherë pasi hëngrën bukë, ai u ngrit e shkoi në dhomën e tij dhe, i çqetësuar, i tronditur, filloi të sillet lart e poshtë duke pritur me ankth zhurmën e hapave të saj.

Shtaza që rronte tek ai, e topitur, e përgjumur gjer ahere, u shkund, ngriti kokën, e sundoi në shpirtin e tij me tërë epshet e egra e mizore. Dhe Nekludovi s'ishte më ai që kish qënë kur kishte ardhur për herë të parë tek tetot e s'ishin më tek ai ato ndjenjat e mëngjezit të pashkës në kishë.

Por sadoqë e kish ruajtur Katjushën tërë atë ditë, nuk gjeti dot rastin të takohej me të vetëm. Me sa dukej, ajo i largohej. Sidoqoftë, atë mbrëmje asaj iu desh të hynte në një dhomë ngjitur me të tijën për t'i gatitur shtratin doktorit, që kish ndërmënd të flinte atje atë natë. Me të dëgjuar zhurmën, Nekludovi i ra pas, me hapin e lehtë të hajdutit.

Ajo mbante në duar këllëfin e pastër të jastëkut dhe, kur e pa, ktheu kokën dhe i buzëqeshi, jo e gëzuar dhe e çkujdesur si më parë, por me buzëqeshjen e ndrojtur, të mjerë, të një njeriu që kërkon mëshirë. «Jo» — thoshte ajo buzëqeshje në gjuhën e saj të mëshirës dhe Nekludovi u ndal. Kuptoi mundësinë e një lufte të rreptë që do të shpërthente përsëri në shpirtin e tij. Dëgjoi përsëri zërin, tanimë të dobët, të dashurisë së vërtetë që kish patur për të. Por një zë tjetër i thoshte: «shiko mos humbasësh» «qejfin tënd», «lumturinë tënde». Dhe zëri i dytë e mbyti të parin. Dhe sakaq çdo ngurrim mori fund. Një ndjenjë shtazarake, e papërmbajtur dhe e tmerëshme, e kishte pushtuar.

Si i hodhi krahët dhe e shtërngoi pas vetes e uli mbi shtrat dhe ndenji pranë saj.

— Dimitri Ivanoviç, të keqen, të lutem shumë, më lëshoni! — ja bënte ajo me një zë të mekur. — Po vjen Matrena Pavlovna! — klithi pastaj papritmas dhe iku nga krahët që e shtërngonin.

Vërtet dikush po afrohej atë çast në derë.

— Atëhere më prit sonte natën, — foli me nxitim Nekludovi, — Ti fle vetëm, apo jo?

— Jo, jo, ç'thoni kështu? Mos, mos! «Nuk bën!» — thonin buzët e saj që dridheshin, por sytë tërë turp iu përpëlitën nga një stuhi ndjenjash që çkallmonte në të çdo qëndresë, e pohonte të kundërtën. . .

Hapat në derë ishin vërtet të Matrena Pavlovnës. Ajo hyri në dhomë me një jorgan në dorë dhe, si i hodhi Nekludovit një vështrim qortonjës, i hoqi me të rreptë vrejtjen Katjushës, që i kish ngatërruar jorganët dhe s'kish marrë atë që duhej.

Nekludovi s'foli dhe doli jashtë. Në fytyrën e Matrena Pavlovnës ai vuri re pa gabuar dënimin e gjestit që kish bërë. E kuptonte edhe vetë që s'kish vepruar mirë. Por s'i vinte turp. Në shpirtin e tij sundonte vetëm ndjenja shtazarake, që kish lindur nga dashuria dikur e pastër për Katjushën. Ai e dinte tani se ç'kërkonte prej tij dhe vriste mëndjen të gjente sa më parë rastin dhe mjetin për ta kënaqur.

Atë mbrëmje s'ishte i qetë: herë shkonte tek tetot, herë mbyllej në dhomën e tij dhe herë dilte në verandë duke menduar tërë kohën mënyrën për t'u takuar me të. Por ajo mundohej të mos i binte në sy dhe Matrena Pavlovna, që diç kish kuptuar, e mbante Katjushën pranë vetes dhe s'i jepte leje e shkak të largohej.

XVII

Kështu kaloi tërë ajo mbrëmje dhe erdhi nata. Doktori shkoi në dhomën e tij. Ranë e fjetën edhe tetot. Nekludovi e dinte që Matrena Pavlovna ndodhej atë kohë në dhomën e fjetjes të tetove e i ndihmonte të çvisheshin e të rehatoheshin, kurse Katjusha ishte në dhomën e saj, vetëm. Doli përsëri në verandë. Jashtë në oborr ishte errësirë; mjegulla e bardhë, që sjell me vete në pranverë borën e fundit, mbushte tërë ajrin. Nga lumi, që rridhte në fund të një rrëpire, ndo njëqind hapa larg shtëpisë, vinin disa zhurma të çuditëshme: ishin të krisurat e akullit që shkrihej.

Nekludovi zbriti shkallët e verandës dhe, duke ecur përmes llugave të borës së shkrirë, u afrua në dritaren e dhomës së Katjushës. Zemra i rrihte kaq fort sa e dëgjonte mirë çdo të rrahur. Katjusha qe ulur përpara tryezës. Du-

kej e kredhur në mendime dhe Nekludovi e soditi një kohë të gjatë pa lëvizur, i shtyrë më tepër nga kureshtja për të ditur çdo të bënte duke qenë vetëm, pa dyshuar se mund ta shikonte njeri. Ajo qendroi nja dy minuta ashtu, pa bërë asnjë lëvizje, pastaj ngriti sytë, buzëqeshi, tundi kokën si me qortim dhe, befas, me një lëvizje të prerë, i vuri të dy duart mbi tryezë dhe i hodhi sytë diku larg përpara saj.

Ai rrinte dhe e vështronte duke u vënë veshin, padashur, të rrahurave të zemrës së tij dhe zhurmave të çuditëshme që vinin nga lumi. Atje përtej në lumë, që ish mbuluar nga mjergulla, dëgjoheshin herë rënkime të mbytura, herë të krisurat e thata e tringëllimat e mprehta.

Ai rrinte dhe vështronte, duke soditur fytyrën e Katjushës ku çdo tipar tradhëtonte haptas mundimet e një pune të lodhëshme, të pandërprerë, që bëhej përbrënda shpirtit të saj.

I erdhi keq për të, por kjo, për çudi, në vend që ta lëkundëte në vendimin që kish marrë, ja forcoi edhe më tepër dëshirën për ta shpurë gjer në fund.

Një epsh i shfrenuar e pushtoi, dhe ai iu dorëzua këmbë e kokë këtij epshi.

Trokiti në xham. Ajo, si nga një shkëndi elektrike që e goditi befas, u rrënqeth në tërë trupin, ndërsa në fytyrën e saj atë çast pikturohej një tmer i papërshkruar. Pastaj brofi në këmbë, iu afrua dritares e u mbështet me fytyrë pas xhamit. Por tmeri nuk u shua nga fytyra e saj gjersa, duke i bërë strehë syve me dorë, për të parë më mirë, dalloi jashtë në errësirë, Nekludovin. Ishte aq hijerëndë sa kurrë s'e kish parë ndonjëherë ashtu. Ajo i buzëqeshi, pasi ai i vuri buzën në gaz më parë, dhe e bëri këtë që të mos ta hidhëronte se në shpirtin e saj atë çast s'kish buzëqeshje por tmer. Ai i bëri shenjë me dorë që të dilte jashtë në oborr e të takoheshin. Por ajo tundi kokën, tha me atë lëvizje që s'deshte të dilte të takohej me të dhe vazhdoi të qëndronte në këmbë pranë dritares. Ai iu afrua dhe një herë tek xhami dhe deshte që t'i thërriste asaj që të dilte, por ajo ktheu kokën pas nga dera. Dikush kish hyrë në dhomë dhe s'i thirri dot. U largua nga dritarja. Mjegulla ish kaq e rëndë dhe e trashë saqë pesë hapa si u largua nga shtëpia, ai s'dalloi dot më as dritaren, por vetëm drita kuqërreme e llambës që depërtonte jashtë dukej shumë e madhe. Dëgjoheshin në drejtim të lumit po ato rënkime, tringëllime e krisje të akullit që po shkrihej. Pas pak, këndoi në oborr një këndes, ca të tjerë iu përgjegjën aty afër e nga larg, nga fundi i fshatit klithmat e këndezëve

vinin njera pas tjetrës. Rreth e rrotull, veç lumit, asgjë s'pipëtinte. Nata qe e errët. Si u suall lart e poshtë një copë herë, duke shkelur tek tuk në ndonjë gropë me ujë, Nekludovi iu afrua përsëri dritares. E pa llambën përsëri të ndezur dhe Katjushën ulur vetëm përpara tryezës e si të zhytur në mendime. Porsa ai iu afrua dritares, ajo ngriti sytë. Ai trokiti. Pa parë se kush trokiti, ajo doli me vrap nga dhoma dhe ai dëgjoi pas pak kërkëllimën e derës së madhe, që hapej. Nekludovi, që po e priste në hajat, e përqafoi pa thënë asnjë fjalë, porsa u dha në prak të derës. Ajo u lëshua në kraharor të tij dhe ngriti kokën për t'i pritur në gojë të puthurat. Ata qendronin në këmbë, në një qoshe të hajatit, në një vend të thatë. Nekludovi ndjente si rritej në shpirtin e tij dëshira për ta vënë në dorë Katjushën. Befas dera krisi, u hap përsëri dhe oshëtiti në hajat zëri i rreptë i Matrena Pavlovnës:

— Katjusha!

Ajo u shkëput nga krahët e tij dhe u kthye në dhomën e saj. Ai dëgjoi zhurmën e thatë të çelësit që u vërtit me nxitim. Pastaj pllakosi heshtja, drita e kuqërreme e llambës u shua dhe s'kishte asgjë tjetër rreth e rrotull përveç mjegullës së rëndë dhe zhurmave që vinin nga lumi.

Nekludovi iu afrua dritares: s'dukej asnjeri. Trokiti, askush s'iu përgjegj. Atëhere u kthye e hyri në shtëpi nga ana e verandës kryesore. Por nuk fjeti. Hoqi çizmet dhe çapiti zbathur nëpër koridor gjer tek dhoma e saj, ngjitur me atë të Matrena Pavllovnës. Mendoi atëhere se çasti ishte i volitshëm për plotësimin e qëllimit të tij, kur befas guvernantja plakë u koll dhe u kthye në anën tjetër në shtratin e saj të vjetër që kërciste. Ai ngriu në vend e qendroi ashtu pa lëvizur një copë herë të madhe. Kur heshtja u prish përsëri nga gërhima e qetë e Matrena Pavlovnës, ai bëri edhe ato hapat e pakta që e ndanin nga dhoma e Katjushës, duke ecur lehtë-lehtë. Nuk dëgjoi asnjë zhurmë, asnjë zë. Ajo, me sa dukej, nuk flinte, sepse veshi i tij, i mprehtë si për çudi atë kohë, s'e rroku dot dihatjen e saj. Atëhere pëshpëriti: «Katjushë!» dhe menjëherë ajo brofi në këmbë, u afrua tek dera dhe me të rreptë, të paktën kështu iu duk atij, iu lut që të largohej.

— Ç'është kjo? Ruajna zot! Por sikur ta marrin vesh tetot? — thonin buzët e saj, por zemra, tërë trupi dhe shpirti i saj thoshnin «jam e jotja». Dhe këtë Nekludovi e kuptoi,

— Hapma. . . pak. . . vetëm pak. Të lutem, të lutem shumë, — belbëzoi ai me një gjuhë të çthurur, pa kuptim.

Ajo s'u ndje, pastaj dëgjoi fëshfërimën e duarve që kërkonin çelësin. Çelësi u vërtit, dera u hap dhe ai hyri.

E pushtoi me të dy krahët, ashtu siç ishte në atë këmishën e saj prej pëlhure të trashë e t'ashpër dhe e ngriti peshë.

— Ah! Jo, mos, ç'bëni kështu? — pëshpëriti zëri i saj i mekur.

Por ai s'ua vuri veshin atyre fjalëve dhe e tërhoqi nga vetja.

— Jo, s'bën, lëshomëni, — thoshte ajo, por i lëshohej vetë pas trupit duke u shtrënguar fort e më fort.

. . . . . .

U largua prej tij pa thënë asnjë fjalë, e dridhej e tëra. Ai i bëri ca pyetje, por ajo s'u përgjegj. Atëhere doli në verandë dhe qendroi atje i kredhur në mendime duke u munduar të rrokte kuptimin e veprës që kishte kryer.

Jashtë errësira qe zbehur; aty poshtë në lumë kërkëllimat, tringëllimat e rënkimet e akllaçeve oshëtinin e, tani, dëgjohej edhe gurgullima e ujit përmes të çarave të akullit. Mjegulla ulej dalëngadalë dhe nga ai muri i saj i trashë, i murmë, nxori kokën hëna.

«E mirë apo e keqe është kjo që më ndodhi? Mos është lumturia vetë apo një fatkeqësi e kobëshme që s'ndreqet kurrë?» — e pyeti ai veten. «Eh, po s'prish punë, s'prish punë, se kështu ndodh përherë» — u dha fund dyshimeve më në fund dhe shkoi e fjeti.

XVIII

Të nesërmen, ditën e Pashkës së Madhe, erdhi në çiflikun e tetove Shenboku, miku i Nekludovit. I pashëm, i qeshur dhe elegant, ai ua rrëmbeu menjëherë zemrën tetove me sjelljet e tij të hijëshme, me bujarinë e rrallë dhe dashurinë e madhe që ushqente për Dimitrin. Por ç'është e vërteta, bujaria e tij, ndonëse u pëlqye shumë, u duk disi e tepruar. Ato mbetën gojëhapur kur e panë se si i dha lëmoshë një

lypësi të verbër një rubël të tërë, se si, njëhershe u dha bakshish shërbëtorëve plot pesëmbëdhjetë rubla e se si grisi pa një pa dy shaminë e tij të qendisur prej mëndafshi (nga ato që, sipas Sofia Ivanovnës, shiteshin të paktën pesëmbëdhjetë rubla dyzina) për të lidhur këmbën e gërvishtur të Suzenkës, bushtrës së racës së Sofia Ivanovnës. Tetove s'u kishte zënë kurrë syri ndonjë njeri të tillë dhe as që u shkonte ndërmënd se ai Shenbaku kish borxh dyqind mijë rubla, të cilat — ai e dinte mirë — s'do të paguheshin kurrë dhe se prandaj njëzetepesë rubla më pak a më shumë s'kishin për të asnjë rëndësi.

Shenboku qendroi vetëm një ditë dhe të nesërmen në mbrëmje u nis bashkë me Nekludovin. S'mund të rrinin më shumë tek tetot, se ndryshe do të shkelnin edhe afatin e fundit të paraqitjes në repart.

Në shpirtin e Nekludovit, ditën e fundit që kaloi tek tetot, kur kujtimet e asaj nate qenë akoma të freskëta, lindnin herë pas here e përlesheshin mes tyre dy ndjenja të kundërta. Nga njera anë ishin përshtypjet e dashurisë shtazore ndaj Katjushës, përshtypje që ja kishin trazuar ëmbël ndjesitë, sadoqë kish pritur prej tyre edhe më shumë; bashkë me këto, ishte edhe një farë krenarie e lëvdate për veten që kish ditur t'ja arrinte qëllimit. Nga ana tjetër, e brente vetëdija e gabimit të veprës që kish kryer dhe meraku për ta ndrequr atë gabim jo për të mirën e saj, por për të mirën e tij.

Në atë gjëndje egoizmi të marrë, në të cilën ndodhej, Nekludovi s'mund të mendonte për njeri tjetër veç vetes. Kështu për të s'qe fjala se si do t'i vinte filli Katjushës, dhe meraku që e hante ishte se mos zbulohej ç'kishte bërë dhe e dënonin.

Ai vuri re se Shenboku diç kuptoi për marrëdhëniet e tij me Katjushën dhe i erdhi mirë, se ndjente që kjo ja guduliste ëmbël sedrën e tij prej burri.

— Tani e marr vesh përse i dashke kaq shumë tetot, — i tha Shenboku, kur pa Katjushën. — E po, këtu diç do të jetë, thashë unë, se që të rrijë një javë me tetot sikur s'besohet. Por, po të them, ke hak, se edhe unë në vend tënd s'do të tundesha që këtej. E bukur që t'i marrësh kokën, jo shaka!

Pastaj Nekludovi hidhej në arsyetime të tjera. Mendonte se vërtet ishte gjynah të largohej pa i shijuar gjer në fund kënaqësitë e asaj dashurie por, nga ana tjetër, ishte shumë mirë që ndodhte kështu, se kjo ishte mënyra e vet-

me për t'i prerë që në fillim ato marrëdhënie që po të zgjateshin, do t'i sillnin mbase shumë andralla. Mendonte gjithashtu se duhet t'i jepte gruas së gënjyer të holla, jo sepse i dhimbej e deshte t'i vinte në ndihmë, por sepse kështu bënin të gjithë, sepse njollosej emri e nderi i tij, po të merrej vesh që ai e kish shfrytëzuar një grua dhe nuk e kish shpërblyer. Prandaj vendosi t'i japë asaj një shumë të hollash, aq sa gjykonte se i përshtatej shkallës së tij dhe gjëndjes së saj.

Ditën që do të nisej, pasi hëngri bukë, e priti Katjushën në hajat. Ajo u skuq kur e pa dhe s'deshi të ndalej duke bërë shenjë me kokë për nga dhoma e hapur e Matrena Pavlovnës. Po ai s'e la.

— Desha, — i tha dhe ndërkaq i vendosi në dorë zarfin ku kishte futur një kartmonedhë prej njëqind rublash. — Ja, unë. . .

Ajo e kuptoi. Vrënjti vetullat, tundi kokën dhe ja largoi dorën.

— Merri, merri, — murmuriti ai dhe ja futi zarfin në gji por menjëherë, sikur të kish prekur padashur në një urë të ndezur, u prish në fytyrë, rënkoi me duf e vrapoi në dhomën e tij.

E pas kësaj, u suall për një kohë të gjatë lart e poshtë nëpër dhomë dhe rrënqethej i tëri e bile përpëlitej e hovte përpjetë e rënkonte me zë të lartë si nga dhëmbja e një plage të rëndë në trup, porsa kujtonte atë skenë.

«S'ke ç'bën! Kjo punë kështu e ka. Kështu i ndodhi dhe Shenbokut me governanten, ai vetë ma tregoi, kështu i ndodhi edhe dajë Grishës, kështu edhe babait kur rronte në fshat e u ngatërrua me atë fshataren që lindi një djalë të paligjshëm, Mitenkën, që është akoma gjallë edhe sot e kësaj dite. E po, gjersa kështu bëjnë të gjithë, do të thotë se kështu duhet bërë». Kështu mundohej ta qetonte ai veten, po s'e qetonte dot. Kujtimi ja ndizte gjakun e i vriste ndërgjegjen.

Thellë, shumë thellë në shpirtin e tij, ai ndjente tërë turpin, poshtërsinë dhe egërsinë e veprës që kish kryer, kuptonte se s'kishte të drejtë t'i gjykonte të tjerët për atë faj dhe se bile as që do të kishte guximin t'i shihte më në sy. Nga ana tjetër, ishte i detyruar të besonte se që një djalosh me zemër të pastër, fisnik e shpirtgjerë, se vetëm me këtë kondítë mund të vazhdonte të rronte i gëzuar e

i çkujdesur. Për këtë s'i mbetej tjetër veç se të harronte. Dhe ai kështu bëri.

Jeta e ushtërisë, me lëvizjet e saj të shpeshta, shokët dhe lufta e ndihmuan që të harronte dhe, me kalimin e kohës, ai i harroi fare mirë të gjitha.

Por prapë, pas ca vjetësh u kthye nga lufta e ndaloi tek tetot, kur mori vesh se Katjusha qe larguar s'andejmi ca kohë pas nisjes së tij, se kish patur një fëmijë dhe, siç thonin zonjushet plaka, qe korruptuar. Fëminë, po ta gjykoje nga koha e lindjes, mund ta kish patur me të, por mund ta kish patur fare mirë edhe me ndonjë tjetër. Burimi i këtyre fatkeqësive që i kishin ndodhur Katjushës, ishte, sipas shpjegimit të tetove, natyra e saj që e kish patur trashëgim nga e ëma. Dhe ky shpjegim Nekludovit i pëlqeu, sepse e justifikonte gjer diku. Në fillim, ai kish dashur ta kërkonte fëminë, që mbase ishte i tij, por, më vonë, pikërisht sepse e ndjente thellë në shpirt turpin e sjelljes karshi saj, s'bëri asnjë përçapje, përkundrazi e harroi edhe më tepër mëkatin e tij dhe hoqi dorë një herë e mirë nga çdo mendim që mund t'ja kujtonte.

Por ja, ajo ngjarja e papritur në gjyq ja sillte ndërmënd tani të gjitha e i kërkonte me ngulm që ta pohonte egërsinë e poshtërsinë që i kishte bërë, mundësinë që të rronte i qetë me atë faj të rëndë mbi vete plot dhjetë vjet. Megjithatë ai s'i dorëzohej akoma atij pohimi të hidhur dhe tani vetëm nga një gjë ruhej: se mos diktohej, se mos mbrojtësi i saj zinte në gojë edhe emrin e tij duke e turpëruar kështu në sy të të gjithëve.

XIX

Në këtë gjëndje shpirtërore ndodhej Nekludovi kur doli nga salla e gjyqit për të hyrë në dhomën e zhurisë. Ai u ul pranë dritares dhe, duke ndezur një cigare pas tjetrës, u vuri veshin bisedimeve që bëheshin rreth tij.

Tregëtarit, me sa dukej i qante zemra për Smelkovin, që e kish sosur jetën në një mënyrë aq të papëlqyer. Po sidomos i vinte mirë ta mburrte si një njeri që ja kish ditur lezetin jetës. Thoshte:

— Për të harbuar qe i vetmi ai, ç'i do llafet. Tamam si

siberian i vërtetë! Dhe s'ish budalla, se kish zgjedhur alamet cope, jo dëngla!

Kryetari i zhurisë parashtroi disa mendime të tij personale nga të cilat mund të nxirrej si përfundim se gjithshka varej tani nga ekspertat. Pjotër Gerasimoviçi bënte shakara me agjentin çifut e qeshte me të, me të gajasur. Nekludovi u përgjegjej thatë pyetjeve që i drejtonin. Ai ndjente nevojën që të përqëndrohej, i pabezdisur, në mendimet e tij.

Kur ftuesi i gjyqit, me të ecurit e tij gërmuq, hyri në dhomë dhe i ftoi anëtarët e zhurisë në sallë, Nekludovin e pushtoi papritmas një tmerr e iu duk se po e shpinin në gjyq jo për të gjykuar, por për t'u gjykuar. Tanimë e ndjente veten fajtor, e kuptonte që, me atë vepër të poshtër që kish kryer, s'kishte më sy e faqe t'u dilte përpara njerëzve, por prapë, forca e zakonit ishte më e madhe tek ai se çdo gjë tjetër dhe ai i ngjiti shkallët gjer në podjum dhe u ul në vendin e tij, menjëherë pas kryetarit, ndënji këmbë mbi këmbë dhe u kapardis me syzat si një njeri që është i çkujdesur e i qetë.

Të pandehurit, që qenë nxjerrë edhe ata jashtë sallës, hynë dhe u ulën në bankat e tyre.

Në sallë shquheshin tani disa fytyra të reja. Këta qenë dëshmimtarët. Nekludovi vuri re se Masllova hidhte sytë herë pas here nga një zonjë shumë elegante, e trashë, veshur në mëndafsh e kadife, me një kapele të lartë mbi kokë, me një kordele të gjerë rreth saj e me një palë dorashka të modës së fundit që i vinin gjer në bërryl. Zonja qe ulur në rreshtin e parë përpara derës me hekura. Nekludovit i thanë se ajo ishte padrona e shtëpisë publike, ku kishte «punuar» kohët e fundit Masllova.

Filloi marrja në pyetje e dëshmimtarëve. U pyetën emrin, mbiemrin, besimin e të tjera dhe a donin të betoheshin përpara se të dëshmonin apo jo. Pastaj u dha përsëri mbi podjum prifti plak duke hequr zvarrë këmbët e tij të ënjtura e duke ndrequr herë pas here kryqin e florinjtë mbi mëndafshin e rasës dhe, po me atë gjakftohtësi, siguri e besim në dobi të detyrës që i ishte ngarkuar, ai i mori në betim dëshmimtarët, e, bashkë me ta, edhe ekspertët. Kur betimi mori fund, dëshmimtarët i nxuarën jashtë që të gjithë dhe lanë aty vetëm Kitajevën, padronen e shtëpisë publike. Madamë Kitajeva u ftua të tregonte ç'dinte mbi çështjen e helmimit. Me një buzagaz të rremë, duke e ngjeshur poshtë e më poshtë kapelen pas çdo fraze, dama e

nderuar parashtroi me hollësi, me një shqiptim gjerman shumë të theksuar, të gjitha faktet që ajo dinte.

Tha se në shtëpinë e saj kishte ardhur, për të kërkuar një vajzë, Simoni, kamerieri i mirënjohur i hotelit «Mauritinia». E kish dërguar një tregëtar i pasur nga Siberia. Ajo i dha Ljubashën. Pas ca kohe Ljubasha u kthye bashkë me tregëtarin.

— Tregëtari ishte, si të thuash, në ekstazë, — tha Kitajeva e buzëqeshi shtrëmbër, — e u dha vajzave për të pirë sa deshën po, meqënëse nuk i arrinin të hollat, atëhere e dërgoi Ljubashën në hotel, në dhomën e tij. Këtë punë vetëm Ljubashës ja besoi, se për të kishte, si të them, një predileksion të vërtetë.

Kitajeva i hodhi sytë të pandehurës, ndërsa thoshte këto fjalët e fundit, dhe Masllova i buzëqeshi. Kjo buzëqeshje iu duk Nekludovit e pështirë dhe një ndjenjë e çuditëshme, e papërcaktuar, mëshire e neverie e pushtoi.

— Çfarë opinioni kini ju për Masllovën? — pyeti duke u skuqur i tëri nga turpi e me ndrojtje të madhe mbrojtësi i Masllovës, një djalosh që porsa kish paraqitur kandidaturën për avokat.

— Opinionin e kam patur kurdoherë të mirë, — u përgjegj Kitajeva, — se është një vajzë me shkollë dhe merr vesh shumë, se është e edukuar në familje të mirë dhe flet frëngjisht shumë mirë. Pi vërtet ndonjëherë më tepër nga ç'duhet, por prapë e mban veten. Është një vajzë e mirë, shumë e mirë!

Katjusha që, gjatë gjithë kësaj kohe, i kishte mbajtur sytë mbi padronen e saj, papritmas e hodhi vështrimin mbi anëtarët e zhurisë dhe e ndali mbi Nekludovin duke i dhënë fytyrës një shprehje serioze e të rreptë. Njeri nga sytë e rreptë shikonte shtrëmbër dhe që të dy sytë iu ngulën për një kohë të gjatë Nekludovit me atë vështrimin e tyre të çuditshëm. Ai, i tmeruar, përpiqej ta kthente kokën m'anë tjetër, por s'mundte. Ju kujtua ajo nata e frikëshme dikur, akulli që thyhej, mjergulla e rëndë e, mbi të gjitha, hëna që ndriçonte e zbetë përpara agimit.

«Më njohu!» — mendoi, dhe u rrënqeth e u mblodh si për t'u mbrojtur nga një goditje. Po ajo nuk e njohu, se psherëtiti e qetë dhe e ktheu përsëri kokën nga kryetari. «Ah, kjo punë duhet të marrë fund sa më parë», — tha ai me vetë, duke riprovuar atë ndjenjën e njohur që i lindëte shpesh kur i duhej të vriste në gjah një zog të plagosur: një ndje-

një ku mëshira, neveria dhe bezdia përziheshin bashkë me një lëmsh të vetëm. Zogu i plagosur përpëlitet brënda në torbë dhe, ndonëse të vjen keq për të dhe të vjen zor ta mbytësh, prapë pret t'i japësh fund sa më parë e ta harrosh.

Këtë ndjenjë të përzierë provonte Nekludovi ndërsa dëgjonte deponimet e dëshmimtarëve.

XX

Por, si për inat, gjyqi po zgjatej shumë: pasi u pyetën një nga një dëshmimtarët dhe ekspertët e, pasi prokurori si edhe avokatët mbrojtës bënë, sipas zakonit, një mizëri pyetjesh fare të kota, kryetari i gjyqit e ftoi zhurinë të shqyrtonte materialet e akt-akuzës, ku bënin pjesë një unazë me një trëndafil brilantesh si dhe një filtër, që kish shërbyer për kullimin dhe studimin e helmit. Sendet në fjalë qenë vulosur dhe mbanin nga një etiketë.

Antarët e zhurisë po mateshin të çoheshin për t'i parë këto sende nga afër, kur prokurori u ngrit përsëri mbi bëryla dhe kërkoi që, përpara se të bëhej shqyrtimi i materialeve të akuzës, të lexoheshin rezultatet e hetimeve mjekësore të kufomës.

Kryetari, sadoqë mundohej t'i jepte fund gjyqit sa më parë që të takohej sa më shpejt me zviceranen e tij, pranoi. Ai e dinte fare mirë se leximi i këtyre dokumentave nuk do të sillte asnjë dobi, që vetëm do t'i mërziste të gjithë e do t'i linte ndofta pa drekë; nga ana tjetër, prokurori e kërkonte leximin e tyre vetëm e vetëm se kishte të drejtë. Por prapë nuk mundi të kundërshtonte. Sekretari mori disa letra që ndodheshin mbi tryezë e, duke i dhënë zërit të tij të ngjirur që s'dinte të shqiptonte siç duhej gërmat «l» dhe «r» një ton të përmortshëm, nisi të lexonte.

«Nga ekzaminimi i jashtëm i kufomës rezultoi sa më poshtë:

1) Shtati i Ferapont Smelkovit ishte i lartë dy arshin e dymbëdhjetë vershokë [1]).

— Thuaj si të duash, po alamet burri paska qenë! — i murmuriti në vesh Nekludovit tregëtari, sikur diç bluante në kokë.

---

1) arshin = 0.711 m.; vershok = 4,4 cm.

2) Mosha, duke gjykuar nga pamja e jashtme e kufomës, duhet të ketë qenë rreth dyzet vjeç.

3) Kufoma paraqitej e buhavitur.

4) Damarët kishin një ngjyrë jeshil të hapur të njollosur aty këtu me pika të zeza.

5) Lëkura vinte e ngritur mbi të gjithë trupin.

6) Flokët, të kuqërreme e të dëndura, çkuleshin lehtë nga lëkura.

7) Sytë ishin të zgurdulluar e të këcyer, bebëza dhe cipa e kornés paraqitej me hije e vende-vende e nxirë.

8) Nga vrimat e hundës, nga të dy veshët dhe nga zgavra e gojës rridhte një lëng me shkumë, ngjitës në të prekur e i qelbur; goja ishte gjysmë e hapur.

9) Qafa ishte krejt e padukëshme nga shkaku i të buhaviturit pa masë të fytyrës e të kraharorit».

Etj. etj. . .

Sekretari lexoi në atë mënyrë edhe 17 pika të tjera gjersa arriti në të 27-tën, ku u ndal dhe pushoi, pasi kish lexuar plot katër faqe. Kështu përshkrimi i hollësishëm i ekzaminimit të jashtëm të asaj kufome vigane, të buhavitur, të kalbëzuar, të llahtarëshme të tregëtarit qejfli mori fund. Ajo ndjenjë e turbullt pështirosjeje që provonte Nekludovi gjatë tërë kohës që vazhdoi gjyqi u forcua edhe më tepër tek ai nga leximi i përshkrimit të kësaj kufome. Jeta e Katjushës, ai lëngu i qelbur që rridhte nga vrimat e hundës, ato sytë e tregëtarit të vdekur, të këcyer, të zgurdulluar, si edhe sjelljet e tij karshi saj, të gjitha këto iu dukën atij në atë çast si çfaqjet e një ligësie të përgjithëshme, që e rrethonte nga të gjitha anët. Kur, më në fund, leximi i ekzaminimit të jashtëm mbaroi, kryetari nxori një psherëtimë të thellë e ngriti kokën si i lehtësuar, duke kujtuar se leximi i hetimeve mjekësore do të mbetej me aq. Por sekretari u vu menjëherë të lexonte përshkrimin e ekzaminimit të brëndshëm.

Kryetari e vari përsëri kokën, e mbështeti mbi pëllëmbë dhe mbylli sytë. Tregëtari, që kishte zënë vend pranë Nekludovit, bënte çmos për të mos iu dorëzuar gjumit që po i kanosej. Të pandehurit, ashtu si dhe xhandarët që i ruanin, rrinin si të mpirë.

— «Nga ekzaminimi i brëndshëm rezultoi sa më poshtë:

1) Lëkura e kafkës shkëputej lehtë nga eshtrat, por pa paraqitur shenja emoragjie.

2) Eshtrat e kafkës kishin një trashësi mesatare e nuk paraqitnin lezione.

3) Mbi cipën e trashë të truve shquheshin dy njolla të pigmetuara me një madhësi afërsisht prej nja katër djujmësh [1]), cipa në fjalë paraqitej me një ngjyrë të zbetë — të zeshkët» — etj. etj. vinin me radhë dhe nja trembëdhjetë pika të tjera.

Vinin pastaj emrat e dëshmimtarëve të hetimit mjekësor, nënshkrimet e tyre dhe, më në fund, konkluzionet e mjekut ekspert, që deklaronte se, nga ndryshimet e vrejtura në stomak, në zorrët dhe në veshklat e tregëtarit Smelkov, mund të arrihej në përfundimin që Smelkovi kish vdekur nga një dozë helmi të gëlltitur njëkohësisht me një sasi vere. Që të përcaktohej, duke u bazuar në ndryshimet e lart përmëndura në stomak dhe në zorrë, lloji i helmit vdekjeprurës, kjo ishte një punë e vështirë, por, që helmi në fjalë qe gëlltitur bashkë me verën, kjo ishte një hipotezë që vërtetohej më së miri nga sasia e madhe e verës që u gjend në stomakun e Smelkovit.

— Mor, qerratai, të pirë që bënte! — pëshpëriti përsëri tregëtari, që u përmënd atë çast krejt papritmas.

Por edhe leximi i këtij proçes-verbali, që vazhdoi ndonja një orë, nuk e kënaqi, siç shpresohej, prokurorin. Kur proçes-verbali u lexua gjer në fund, kryetari i gjyqit, duke u kthyer nga ai, tha:

— Unë mendoj se është e tepërt të lexojmë edhe rezultatet e analizës së zorrëve.

— Unë mendoj se është e nevojëshme t'i lexojmë këto rezultate, — tha me të rreptë prokurori, pa e parë fare në sy kryetarin, duke i dhënë trupit përpjetë me një ton që linte të kuptohej pa pikë dyshimi se ai kishte të drejtë ta kërkonte atë lexim, se nuk do të hiqte dorë nga ajo e drejtë e se, në rast të kundërt, do të kërkonte anullimin e gjyqit.

Anëtari mjekërosh i gjyqit, me ata sytë që i mbante përherë përdhe, që vuante nga katarra, duke mos e ndjerë veten mirë, u kthye nga kryetari dhe i tha:

— Ç'është kjo? Ç'janë këto analiza? A po mos është puna sí e si ta zgjatim?

Anëtari me gjyslykë floriri nuk foli fare, por vështroi përpara çehrengrysur e i vendosur si një njeri që s'pret

1) Djujm = 25,4 mm.

ndonjë gjë të mirë, qoftë nga gruaja në veçanti, qoftë edhe nga jeta në përgjithësi.

Filloi leximi i proçes-verbalit:

— «Më 15 shkurt të vitit 1884 unë i nënshkruari, i ngarkuar nga inspektorati mjekësor i Ministrisë së drejtësisë dhe duke u bazuar në nenin Nr. 638. . . — kështu filloi leximin sekretari, duke e ngritur diapazonin e zërit të tij të ngjirur, sikur të deshte në atë mënyrë t'i përmëndte nga gjumi të gjithë të pranishmit që koteshin e shtriqeshin kohë më kohë, të lodhur e të mërzitur, dhe vazhdoi. . . — në prani të ndihmës inspektorit, bëra hetimet mbi kufomën e mbi të dhënat e autopsisë të të quajturit Ferapont Smelkov. U ekzaminua:

1) Mushkëria e djathtë dhe zemra (mbyllur në një poçe prej qelqi prej gjashtë futash) [1].

2) — Përmbajtja e stomakut (mbyllur në një poçe prej pelqi prej gjashtë futash).

3) Stomaku (mbyllur në një poçe prej qelqi prej gjashtë futash).

4) Mëlçia, shpretka dhe veshkëlat (mbyllur në një poçe prej qelqi prej tre futash).

5) Zorrët (mbyllur në një poçe prej balte prej gjashtë futash).

Kur filloi leximi i këtij proçes-verbali, kryetari i gjyqit u kërrus mbi veshin e një prej anëtarëve që i qendronte në krah e diç i pëshpëriti, u kthye pastaj edhe nga anëtari, që ndodhej në krahun tjetër e, si shkëmbeu me të nja dy fjalë, urdhëroi ndërprerjen e leximit.

— Gjyqi mendon se leximi i këtij proçes-verbali është i tepërt, — tha ai.

Sekretari heshti menjëherë e mblodhi letrat, ndërsa prokurori diç shtonte me shpejt në shënimet e tij.

— Zotërinjtë e zhurisë janë të lutur të kontrollojnë materialet e akt-akuzës, — tha kryetari.

Disa nga anëtarët e zhurisë, me në krye prijsin e tyre, u ngritën në këmbë, iu afruan tryezës dhe soditën me radhë unazën, poçen dhe filtrin. Bile tregëtari deshi ta provonte edhe vetë në gisht unazën.

— Bobo, ç'gisht paska patur, mor maskarai, — tha kur u kthye në vend. — Sa një kastravec, për besë! — shtoi e,

---

1) Fut — njësi gjatësie = 30,5 cm.

me sa dukej, i bëhej qejfi kur e përfytyronte tregëtarin e helmuar si një nga ata bagatirët që lindte dikur pa hesap raca e moçme ruse.

XXI

Kur ndihmës gjyqtarët kontrolluan materialet e akt-akuzës, kryetari e deklaroi seancën gjyqësore të mbyllur dhe, pa ndërprerje, i shtyrë nga ngutja e madhe që kishte për t'i dhënë fund gjyqit sa më parë, ja kaloi fjalën prokurorit. Duke vepruar kështu, mendonte se prokurori ishte, fundja, njeri dhe pra, si çdo njeri, mezi priste edhe ai të ndizte një cigare e të hante bukë. Ai mendonte gjithashtu se atij do t'i vinte keq, në mos tjetër, për trupin gjykues. Por prokurorit s'i erdhi keq. Ky njeri ligji, që ishte për nga natyra shumë mëndjengushtë, kishte patur edhe fatkeqësinë të dilte nga gjimnazi me një medalje të artë dhe të merrte më vonë, në universitet, një farë çmimi për një tezë dipllome ku bëhej fjalë për regjimin e skllavërisë në Romën e vjetër. Kështu prokurori ynë qe bërë shumë mëndjemadh, shumë i sigurtë në vetvete dhe në meritat e tij. Në këtë gjë i kishin dhënë dorë mjaft edhe ato pak suksese që kishte korrur mbi gratë. Kështu ai budallallëku, që kish trashëguar nga natyra, qe zhvilluar e rritur tek ai gjer në disa përpjestime çuditërisht të gjëra e të rrezikëshme.

Kur kryetari i dha fjalën, ai mengadalë, u krekos, si për t'u mburrur me atë uniformë elegante dhe, si i mbështeti të dy duart mbi tribunë, e kërrusi kokën lehtas, përpiu sallën me një vështrim, ku nuk përfshiheshin vetëm të pandehurit, dhe filloi fjalimin që e kishte pregatitur gjatë leximit të proçes-verbalit:

«Çështja që i parashtrohet gjykimit tuaj, zotërinj të zhurisë, nëqoftëse më lejohet të shprehem kështu, përbën një akt kriminaliteti shumë karakteristik».

Fjala e prokurorit duhet të kishte, sipas mendimit të vetë autorit, një domethënie të përgjithëshme e të imitonte, në këtë mënyrë, ato fjalimet e famëshme që kishin qenë lavdia e pavdekur e avokatëve të mëdhenj. Ç'është e vërteta, publiku që e dëgjonte atë ditë, nuk përbëhej veçse nga një rrobaqepse, një kuzhiniere, një gjellëbërëse, nga një

grua tjetër, motra e Simonit, dhe nga një karrocier. Por kjo nuk ishte kurrsesi një arësye e mjaftueshme për të ndaluar hovin e gojtarisë së tij të patrëmbur. Ashtu si ai, edhe avokatët e mëdhenj, mjeshtërit e përsosur të fjalës, kishin debutuar dikur përpara një publiku po aq të paktë e të parëndësishëm. Prokurori i kish vënë vetes për qëllim të ngrihej gjithmonë, siç thoshte, «gjer në majat më të larta të çështjeve» duke u munduar të rrokte kuptimin e thellë psikollogjik të çdo krimi e të nxirrte në pah plagën e thellë shoqërore që fshihej pas tij.

«Ju kini përpara, zotërinj të zhurisë, një krim tipik të shekullit tonë, një krim që, si të thuash, paraqet të gjitha tiparet specifike të atij proçesi të veçantë dekompozimi moral që ka prekur sot shumë e shumë pjesëtarë të shoqërisë sonë. . .»

Prokurori foli në këtë mënyrë për një kohë të gjatë. Gjithë kohës që shqiptonte këtë fjalim të shkëlqyeshëm, ai kishte parasysh sidomos dy gjera: në radhë të parë të mos linte pa përmëndur asnjë nga faktet që kishin të bënin me çështjen, qoftë edhe ato më të papërfillëshmet; në radhë të dytë, të mos ndërpritej asnjë minutë, në mënyrë që rrjedhja e atij lumi të rrëmbyer fjalësh të zgjedhura, fshikullonjëse, demaskonjëse, të vazhdonte të paktën një orë e një çerek. Megjithatë, një herë iu desh të ndalej, sepse, për dreq, e humbi fillin e arësyetimit, por menjëherë e mori përsëri vrullin e parë e, bile, me një oratori të rrallë.

Herë-herë fliste me një zë të butë lajkatar, duke u lëkundur herë andej e herë këtej, duke shigjetuar me sy zotërinjtë e zhurisë. Fliste me një ton krejt të natyrshëm, duke u konsultuar me dosjen që mbante përpara, — zëri gjëmonte si bubullimë dhe shpesh herë kthehej nga publiku dhe nga avokatët. Vetëm asnjë nga të pandehurit s'e ktheu kokën. Fjalimi i tij ishte mbushur plot e përplot me formula të reja, me ato formula që ishin atëhere të modës në rrethin e tij e që mbaheshin në atë kohë e mbahen akoma sot si fjala e fundit e shkencës. Këtu flitej edhe për problemet e trashëgimisë, edhe për kriminalitetin, edhe për Lombrozon, e për Tardin, edhe për luftën për ekzistencë, edhe për degjenerimin. . .

Tregtari Smelkov, siç e karakterizoi prokurori, ishte tipi i rusit të thjeshtë, të fortë e të shëndoshë me trup e me shpirt, që për faj të shpirtgjërësisë së pamatur, të karakterit të tij gjer në fund të padjallëzuar, kishte rënë në dorë

të disa elementave të degjeneruar e, pra, qe marrë më qafë. Simon Kartjenkini ishte një pjellë e bujkrobërisë së soçme famëkeqe, një njeri me një psiqikë të gjymtuar, pa kulturë, pa parime e pa fe. Eufemia Boçkova, e dashura e tij, ishte një viktimë e trashëgimisë: pamja dhe karakteri moral i saj paraqitnin të gjitha simptomat klasike të degjenerimit. Por strumbullari i krimit ishte Masllova, që përfaqësonte, në formën më të poshtër që mund të mendohej, tipin e dekadencës, që kish prekur shoqërinë e sotme.

«Kjo e pandehur, — vazhdoi prokurori pa i kthyer sytë nga e pandehura, — ndryshe nga koleget e saj, ka patur fatin të përfitojë nga kultura që ka marrë. Ne dëgjuam pak më parë deponimet e padrones së shtëpisë së nderuar ku ajo kish punuar: mësuam se e pandehura dinte jo vetëm shkrim e këndim, po dinte edhe frengjishten, dhe e dinte mirë. Pjellë e një bashkimi jo ligjor, e damkosur, padyshim, mban vulën e një trashigimie të sëmurë. Masllova u rrit dhe u edukua në një familje fisnike nga më të nderuarat; ajo do të rronte fare mirë me një punë të ndershme por, jo, s'deshi, dhe i braktisi bamirëset e saj për t'u dorëzuar këmbë e kokë instinkteve të saja të këqija. Dhe, pikërisht për t'i kënaqur këto instinkte sa më mirë, u fut në një shtëpi publike ku i lejoi vetes — siç e dëgjuat dhe vetë, zotërinj ndihmës gjyqtarë, nga padrona e saj, të ushtronte mbi adhuronjësit e saj atë ndikim sa të hollë aq dhe të mistershëm që është studjuar me kaq këmbëngulje nga shkenca këto kohët e fundit e që shkolla e Sharkoit ka ditur ta mbërthejë në një përcaktim tepër të goditur. E kam fjalën këtu për «sugjestionin mendor». Pikërisht këtë sugjestion ushtroi e pandehura Masllova mbi atë bogatirin e ndershëm e të padjallëzuar rus që i ra në dorë, duke e keqpërdorur besimin e tij për ti rrëmbyer në fillim të hollat e më vonë dhe jetën!

— Më duket se ky po na mban raport, — tha me një buzëgas kryetari duke u krrusur nga ana e gjyqtarit të rreptë.

— Paska qenë hajvan fare! — ja ktheu gjyqtari i rreptë.

«Zotërinj ndihmës gjyqtarë, — vazhdonte ndërkaq prokurori duke e përkulur kokën me një gjest të hijshëm e mirëdashës. Fati i këtyre keqbërësve është tani në duart tuaja; në duart tuaja është pjesërisht edhe fati i shoqërisë, sepse gjykimi tuaj ka rëndësinë e një gjesti të madh shoqëror. Ju do të hyni gjer në thellësinë e kuptimit të vërtetë të këtij

krimi, ju do të bindeni për rrezikun që përbëjnë për shoqërinë disa individë, si të thuash, patollogjikë, siç është Masllova; ju do ta ruani shoqërinë nga infektimi vdekjeprurës i këtyre fenomeneve, ju nuk do të lejoni që elementët e shëndoshë e të fortë të shoqërisë të pëgëren nga kontakti i qelbur i këtyre elementeve të sëmurë!»

Më në fund, si i dërmuar dhe vet ndën peshën e rëndësisë jashtëzakonisht të madhe shoqërore të vendimit që do të mirrej, prokurori, i harruar në një entusiazëm të madh për atë fjalim të shkëlqyer, u lëshua mbi kolltukun e tij. Tërë ai fjalim, po të mos mirren parasysh lulkat e xhufkat e gojtarisë, rridhte vetëm e vetëm që Masllova e kishte hipnotizuar tregëtarin, se ja kishte marrë mëndjen dhe zemrën, kish përfituar nga besimi i tij që t'ja rrëmbente të hollat e që, duke qenë se ky plan i sajë mizor kish qenë zbuluar nga Simoni dhe Eufemija, ajo dashur pa dashur u kishte dhënë dhe atyre pjesë në mallin e grabitur. Për t'i humbur gjurmat e vjedhjes, ajo kish gjetur njëmijë pretekste për ta detyruar tregëtarin që të kthehej përsëri në hotel dhe si ja kishte mbrirë këtij qëllimi e kishte helmuar.

Kur fjalimi i prokurorit mori fund, nga bankot e avokatëve u ngrit në këmbë një meso-burrë, veshur me frak, që ishte shumë i vogël nga shtati; ai filloi mbrojtjen e Kartenkinit e të Boçkovës me një zell e një pasion për t'u admiruar. Të pandehurit i kishin dhënë kaparë në dorë për atë mbrojtje plot treqind rubla. E pra, ishte përveç të tjerave, edhe nga kjo që ai bëri çmos për t'i çfajësuar që të dy e për t'ja hedhur gjithë fajin Masllovës. Ai u përqëndrua në mënyrë të veçantë në hedhjen poshtë të pohimit të Masllovës që kish deponuar se Simoni dhe Eufemija në kohën e marrjes së të hollave ndodheshin edhe ata në dhomë. Ky pohim, — deklaroi avokati, — nuk mund të mirret parasysh në asnjë mënyrë dhe s'ka asnjë vleftë, meqenëse vjen nga ana e një personi për të cilin s'ka asnjë dyshim se ka kryer një krim për helmim, me paramendim. Të 2500 rublat e depozituara në bankë nga Simoni mund të jenë fare mirë fryti i kursimeve të kamarjerve punëtorë e të ndershëm të hotelit që, siç pohoi dhe vet drejtori i hotelit mirrnin nga klientët tre gjer në pesë rubla bakshish në ditë. Përsa i përket të hollave të tregëtarit, këto janë vjedhur padyshim nga Masllova e cila, ose do t'ja ketë dhënë nonjë tjetri ose mbase do t'i ketë humbur meqenë se, siç nxorrën në dritë hetimet, natën e krimit, ajo kishte qënë në një gjendje jo normale. Përsa i

perket helmimit, për këtë as që mund të dyshohej fare sepse Masllova e kishte treguar vetë me gojën e saj se si ja kish hedhur helmin në gotën me verë tregëtarit përpara se ky të pinte.

Prandaj avokati mbrojtës i lutej zhurisë ta deklaronte Kartenkinin dhe Boçkovën të pafajshëm për vjedhjen e të hollave duke shtuar me këtë rast se, edhe sikur zhurija t'i fajësonte këta për vjedhjen e të hollave, duhet të deklaronte, të paktën, të pafajshëm përsa i përket helmimit ose, fundja, të hidhte poshtë hipotezën e paramendimit të krimit.

Avokati mbrojtës i Simonit e i Eufemisë e mbylli fjalimin duke vënë në dukje se «arsyetimet e zotit prokuror mbi trashigiminë dhe degjenerimin e trashëguar» me gjithë rëndësinë e tyre të madhe nga pikpamja shkencore, s'kishin të bënin fare me çështjen në fjalë, me qenë se Boçkova kish lindur nga prindër të panjohur.

Prokurori rrudhi fytyrën, mori një çehre të zëmëruar, diç shënoi me ngut në bllokun e tij dhe ngriti supet me përbuzje.

Kur avokati i parë mbaroi dhe u ul, u ngrit mbrojtësi i Masllovës që, duke ngecur në çdo fjalë, nisi të bënte dhe ai me ndroje mbrojtjen e klientes së tij. Ai nuk mohoi që Masllova kishte marë pjesë në vjedhjen e të hollave, por vetëm nguli këmbë që ajo nuk e kishte helmuar Smelkovin me ndonjë paramendim, por krejt padashur duke kujtuar se pluhuri që i dha ishte vetëm për ta vënë në gjumë. Pastaj dhe ai deshi të lëshohej frekëputur në fushat pjellore të gojtarisë, duke i përshkruar gjyqit si në një tablo të gjallë se si klientja e tij kish marrë të tatëpjetën e vesit e shtyrë nga një njeri që e kishte mashtruar e i kish shpëtuar dënimit, ndërsa vajzës së mjerë i qe dashur ta mbante mbi trup e mbi shpirt të gjithë atë peshën e atij gabimi fatal; por ky ekskursion në lëmin e psikollogjisë nuk korri suksesin e shpresuar dhe të gjithë patën atë çast një parandjenjë se e pandehura Masllova do të dënohej pa tjetër.

Kur ai filloi të belbëzonte nga përshkrimet mbi zemërgjerësinë e burrit ose dobësin'e gruas, kryetari, për t'i ardhur në ndihmë, e ftoi që t'i përmbahej sa më tepër thelbit të çështjes.

Avokati u ngut atëhere t'i jepte fund mbrojtjes. Pas tij fjalën e mori përsëri prokurori. Ai i mbrojti dhe një herë pikpamjet e tij mbi trashigiminë dhe mbi degjenerimin e trashëguar dhe, me disa kritika që i bëri, e vuri në vënd avo-

katin që kish guxuar ta kundërshtonte qoftë edhe pjesërisht. Ai deklaroi që, edhe sikur Boçkova të rridhte nga prindër të panjohur, vlefta shkencore e teorisë së trashigimisë e të degjenerimit të trashëguar ruante gjithënjë atë vleftën e saj të madhe që kishte në shpjegimin e fenomeneve shoqërore. «Kjo teori, tha ai, është ngritur mbi një bazë kaq të shëndoshë sa që shkenca sot ka arritur jo vetëm që të kuptojë si të thuash krimin nga trashigimija e nga degjenerimi i trashëguar, por, edhe anasjelltas, të kuptojë nga krimi një rast trashigimije e degjenerimi të trashëguar».

Përsa i përket hipotezës që shprehu avokati i dytë e, sipas së cilës, Masllova mund të kish qenë e shtyrë në degjenerim nga një mashtronjës pak a shumë i hamëndshëm (prokurori me hidhërim theksoi fjalën «hamëndshëm»), të gjitha të dhënat nxitnin për të besuar të kundërtën, gjersa ajo vetë kish mashtruar sa e sa viktima që kishin rënë rastësisht në dorën e saj. Dhe, si tha këto, prokurori u ul e u çlodh ashtu siç çlodheshin dikur trimat e mirë pas një beteje fitimtare.

Kryetari u drejtua atëhere nga të pandehurit duke i pyetur në se kishin ndonjë gjë të për shtuar.

Eufemija Boçkova përsëriti edhe një herë që s'dinte gjë, që s'kish bërë gjë, dhe se fajtore për të gjitha ishte Masllova. Simoni veç përsëriste:

— Bëni ashtu si të dini vetë, po që s'kam gisht në këtë punë, s'kam!

Kur erdhi rradha e Masllovës ajo s'foli fare. Kryetari e pyeti ç'kishte për të thënë, por ajo s'ju gjegj, e si ngriti kryet dhe e vështroi, si i rrotulloi sytë nëpër tërë sallën posi ndonjë bishë e plagosur, uli kokën e shpërtheu në vajë.

— Ç'patët? — e pyeti tregëtari Nekludovin që kish lëshuar pa pritmas një klithëm të çuditëshme. Ajo klithmë s'ish tjetër veçse një vajë i përmbajtur. Por Nekludovi, që nuk dinte se ç'po i ngjiste, mendoi se ajo klithmë e papritur si dhe lotët që i mbushën sytë qenë shkaktuar vetëm e vetëm nga nervat që i kishte të ndeme e të lodhura pa masë.

Frika e turpit që do ta mbulonte kokë e këmbë faqe të gjithëve, atje në sallën e gjyqit, e pengoi përkohësisht atë punën e brëndëshme që zhvillohej tek ay, dhe kjo frikë në fillim i mposhti të gjitha ndjenjat e tjera.

XXII

Pasi të pandehurit thanë fjalën e fundit dhe pasi kaloi akoma një kohë në përpilimin e pyetjeve që do t'i drejtoheshin zhurisë, e mori më në fund fjalën kryetari, i cili nisi të bëjë një përmbledhje të debateve.

Perpara se të hynte në thelbin e çështjes, duke i dhënë zërit disa intonime të këndëshme e konfidenciale, ai u shpjegoi zotërinjve të zhurisë se tjetër është të vjedhësh, e tjetër është të grabitësh, dhe se tjetër është të vjedhësh në një vend të hapur e tjetër është të vjedhësh në një vend të mbyllur. Ndërsa i shpjegonte me nge të gjitha këto, ai e ndalonte dëndur vështrimin tek Nekludovi si për të treguar që këto shpjegime i drejtoheshin posaçërisht atij me qëllim që ai, pasi t'i kishte kuptuar mirë, t'ua shtjellonte edhe kolegëve të tij të zhurisë. Pastaj, pasi u bind se zhuria dëgjoi mjaft thellë nëpër këto çështje të rëndësishme, kryetari kaloi në disa fakte të njohura të një karakteri tjetër. Ai vuri në dukje se si vrasja është një veprim që ka për qëllim vdekjen e një personi e që, për pasojë, vrasje duhej konsideruar edhe helmimi. Mbasi gjykoi se edhe këto fakte u ndriçuan plotësisht, ai u shpjegoi zotërinjve të zhurisë se si, në rastin kur vjedhja dhe vrasja ndodhin në të njëjtën kohë, krimi cilësohet atëhere si një vrasje e shoqëruar me vjedhje.

Kryetari donte edhe vetë t'i jepte sa më parë fund gjyqit, që të takohej me atë zviceranen që po e priste. Por, i stërvitur siç ishte prej kohësh në atë zanat, kur merrte vrull për të folur, e kishte vështirë pastaj të ndalej. Kështu, pra, ai u shpjegoi anëtarëve të zhurisë duke folur me hollësi për të gjitha ato që i gjykoi të nevojëshme, se, po të qe që të pandehurit të cilësoheshin fajtorë, ata duhej ta pranonin këtë dhe, po të tregoheshin të pafajshëm, ata kishin të drejtë të deklaronin se ishin të pafajshëm. Nuk harroi t'u përmëndi gjithashtu se, po të mendonin se kishin faj vetëm në lidhje me një pikë të akuzës, ata kishin të drejtë ta deklaronin veten fajtorë pikërisht në atë pikë e të pafajshëm në pikat e tjera të akuzës.

U tha gjithashtu se, sadoqë gëzonin të drejtë të plotë ta shprehnin lirisht mendimin e tyre, kishin për detyrë ta shfrytëzonin këtë të drejtë në një mënyrë sa më të arësyeshme. Por, pikërisht në çastin kur po matej t'u shpjegonte akoma se, po të përgjigjeshin «po» në njerën pyetje, kjo do të merrej si një përgjegje pozitive e cila do të shtrihej në të

gjithë përmbajtjen e saj dhe po të qe se ata dëshëronin që pergjegja e tyre të përfshinte vetëm një pjesë të kësaj përmbajtjeje, duhej të mos harronin ta ciilesonin këtë në menyrë të posaçme; pikërisht pra, në çastin kur po hidhej në një shpjegim të ri që do t'i hante akoma ndonjë çerek ore, i shkoi ndër mënd t'i hidhte një sy sahatit dhe vuri re se ora ishte tre pa pesë.

Kështu u ngut të hynte në thelbin e çështjes.

— Ja, pra, thelbi i çështjes që po ju parashtrohet — nisi të thotë, e filloi të përsëriste të gjitha ato që qenë thënë kaq e kaq herë nga avokatët, nga prokurori dhe nga dëshmitarët.

Ndërsa kryetari fliste, të dy gjyqtarët nga të dy anët e tij dëgjonin të kredhur në mendime, duke i hedhur heraherës një sy orës e, ndërkaq, mendonin që fjalimi, ndonëse pak i gjatë, ishte vërtet i goditur, domethënë pikërisht ashtu siç duhej të ishte. Këtë mendim kishte edhe prokurori, personeli tjetër i gjyqit dhe e tërë salla.

Kur fjalimi mbaroi, u duk sikur s'kishte mbetur gjë tjetër pa u thënë. Por kryetari s'pushonte dot aq lehtë së foluri, sepse i bëhej qejfi kur dëgjonte ato tingëllimet e këndëshme e tonin bindës që kishte zëri i tij. Prandaj e gjykoi me vënd t'u thonte zotërinjve të zhurisë edhe nja dy fjalë mbi rëndësinë e të drejtës që u jepte ligji, si edhe mbi kujdesin e urtësinë që duhej të tregonin në përdorimin e kësaj të drejte — ta përdornin, por jo ta shpërdornin, — mbi betimin që kishin bërë dhe mbi zotimin që kishin marrë. U tha se ata ishin ndërgjegja e shoqërisë dhe se vendimet që do të merrnin duhej t'i mbanin të fshehta si ca ikona të shënjta, të rralla etj. etj.

Gjatë tërë kohës që vazhdoi fjala e kryetarit, Masllova s'ja hoqi sytë atij as një çast, sikur të trëmbej se mos i shpëtonte pa dëgjuar ndonjë fjalë. Kështu Nekludovi pati mundësinë ta sodiste me nge e pa frikë se mos ndeshte rastësisht në vështrimin e saj. Edhe ai ndjeu atë që ndjen secili nga ne kur sheh sërish, pas shumë vjetësh, fytyrën e dashur të një njeriu që ka qënë dikur shumë i afërt. Në fillim mbeti i habitur nga ndryshimi që kish ndodhur në të gjatë kohës që s'e kishte parë; por, pak nga pak, përshtypja që i kishin lenë ato ndryshime u zhduk, dhe fytyra e saj mori dalëngadalë po ato trajta që kish patur aty e dhjetë vjet më parë. Syt' e shpirtit të tij i errësuan të gjitha të dhënat e shqisave dhe i zbuluan ato tipare që shprehnin në çdo njeri

atë karakteristikën unike të personalitetit të tij shpirtëror.

Po, sadoqë ishte veshur me rrobat e burgut, sadoqë trupi i saj qe trashur më tepër e gjiri i saj më i këcyer, sadoqë pjesa e poshtëme e fytyrës kish tani ca trajta më të pllоçta, sadoqë qepallat i kishte të buhavitura, sadoqë koha dhe vuajtjet kishin mihur në ballin dhe në tëmthat e saj rrudha të shumta, ajo ishte Katjusha, po ajo Katjusha që në një natë pashke e kishte vështruar, ashtu siç vështrohet një njeri i dashur, me dy sy të kulluar fëminorë që shkëlqenin nga dëshira e nga gëzimi i jetës.

«Çfarë koincidencë e çuditëshme! Kujt mund t'i shkonte ndër mënd që kjo do të ndodhte pikërisht në seancën ku marr pjesë edhe vetë unë, e që pas dhjetë vjetësh do ta takoja Katjushën këtu, në bankën e t'akuzuarve? Ç'udhë do të marrë kjo punë? Ah, të paktën të marrë fund sa më parë!»

Nekludovi bënte çmos që të mos i dorëzohej ndjenjës së pendesës që rritej e zmadhohej vazhdimisht tek ai. Përpiqej t'ja mbushte mëndjen vetes se ajo që i kish ndodhur nuk qe veçse një aksident që do të kalonte pa lënë gjurmë në jetën e tij. Ai e ndjente veten si ai qenushi që ka fëlliqur në dhomë dhe që i zoti e kap nga zverku dhe ja fut turinjtë n'atë ndyrësirën që ka bërë. Qenushi angullin, hiqet pas, bën të largohet nga pasojat e veprës së tij e ta harrojë; por i zoti, i rreptë e zemërgur, nuk e lëshon. Kështu edhe Nekludovi. Ndonëse kishte arritur ta kuptonte sa e poshtër kishte qenë vepra që kishte kryer dikur, ndonëse ndjente mbi supet e tij një dorë të fuqishme që e shtynte pa mëshirë ta shikonte në sy gabimin e dikurshëm, ai nuk donte t'i hynte thellë kuptimit të kësaj vepre e bënte sikur s'kuptonte se ç'kërkonte prej tij ajo dorë. S'i mbushej mëndja e s'donte ta besonte që ajo grua atje, përpara tij, ishte pjella e veprës së shëmtuar që kishte kryer dikur. Por dora, dora e fuqishme, e pamëshirëshme, e shtërngonte, s'e lëshonte, dhe ai ndjente se nuk do të mund t'i shpëtonte dot më kurrë. I jepte kurajë vetes, e gënjente e, për të marrë zemër, rrinte, ashtu siç i qe bërë zakon, këmbë mbi këmbë, luante si për t'u englendisur me syzat mbi hundë, mundohej të mbante një pozë sa më të çkujdesur e krekosej me fodullëk në kollтukun e tij të rreshtit të parë. Por, ndërkaq, në thellësi të shpirtit, ndjente tanimë jo vetëm poshtërsinë, egërsinë dhe padrejtësinë e gjestit të tij, por edhe gjithë llumin shpirtëror të jetës së tij boshe, të degjeneruar, të egër e pa kuptim. Ishte sikur perdja e tmerëshme që i kishte fshe-

hur në një mënyrë të çuditëshme gjatë tërë asaj kohe, gjatë tërë atyre dymbëdhjetë vjetve, atë krimin e tij të ndyrë, atë jetën e tij të gjertanishme, të lëkundej dalngadalë, duke i zbuluar në çdo të lëkundur një pjesë të asaj që i kishte fshehur gjer ahere.

XXIII

Më në fund kryetari e mbaroi fjalimin e tij e, duke tundur n'ajër me një gjest të hijëshëm letrën që përmbante listën e pyetjeve, ja kaloi fjalën kryetarit të zhurisë. Anëtarët e zhurisë u ngritën në këmbë dhe, si të lehtësuar, si të turpëruar e si të merakosur për mënyrën se si duhej t'i mbanin duart, shkuan njeri pas tjetrit në dhomën e tyre. Në prak të portës, erdhi e u vendos një xhandar me shpatën çveshur mbi sup. U ngritën e duallën gjithashtu edhe gjyqtarët e, më në fund, u nxuarën nga salla edhe të pandehurit.

Porsa hynë në dhomën e konsultimeve, anëtarët e zhurisë, ashtu siç bënin përherë përpara se të fillonin nga puna. nxuarën nga një cigare dhe e ndezën. Vetëdija e rolit artificjal që u qe ngarkuar të luanin dhe që s'i kishte lënë rehat gjatë tërë seancës së gjyqit, u zhduk menjëherë nga shpirti i tyre porsa e ndjenë veten përsëri të lirë me cigare në gojë. Kështu, si të lehtësuar nga një barr'e rëndë, u shpërndanë nëpër vëndet e tyre e ndënjën të çkujdesur e tërë qejf. Diskutimet filluan menjëherë të gjalla e të zjarrta.

— Në qafë time në ka gisht vajza në këtë punë! Ata kanë faj, ata maskarejtë që ta hodhën! — tha tregëtari babaxhan. — Nuk duhet ta dënojmë!

— Do ta shohim, për këtë jemi mbledhur! — iu përgjegj kryetari. — Vetëm duhet të kemi mëndjen që të mos tërhiqemi nga përshtypjet personale.

— Kryetari shumë bukur e bëri atë përmbledhjen në fund! — vuri në dukje koloneli.

— Oh, lere! A e besoni se për pak desh më zuri gjumi?

— Një gjë është e sigurtë: po të mos kish qenë Maslova, të dy kamarjerët e hotelit, Simoni dhe Eufemia, nuk kishin si ta dinin që tregëtari i mbante të hollat në valixhe, — tha agjenti me tipare çifuti.

— Atëhere, sipas mendimit tuaj, ajo i ka vjedhur? — pyeti një nga anëtarët.

— Këtu s'më kini me vete. Që t'i ketë vjedhur ajo, s'e besoj kurrën e kurrës! Vjedhjen e ka bërë ajo tjetra, ajo kuçka me vetulla të rruara! Ja, unë kështu them! — ngriti zërin tregëtari, i xhindosur.

— Që të tre njëlloj janë, — tha koloneli.

— Po, ama, ajo tjetra thotë se nuk ka hyrë fare në dhomë.

— E pse, i zihet besë asaj? Unë, për veten time, nuk i zë besë asaj qelbësire sikur të më betohet dit'e natë!

— Pun'e madhe se nuk i zini besë! E ç'del nga kjo? — ja ktheu agjenti. — Po që çelësin e dhomës e kishte Masllova, këtë s'ke si ta mohosh!

— Ja, e kishte, po pastaj? — bërtiti tregëtari.

— Po unazën?

— Po more, po ajo na e tregoi vetë si qe puna! Atij siberianit i qe nxehur koka, domosdo, se kish pirë, e ja, e rrahu. Pastaj u ngashërye e i erdhi keq për çupën kur e pa që po qante. «Na, i tha, e ke peshqesh nga unë, po fshiji lotët!» Se ç'burrë ka qenë ky, e dëgjuam me veshët tanë: dymbëdhjetë arshina e dymbëdhjetë vershokë i gjatë, mos pyet pastaj për të tjerat!

— S'është atje puna, — ndërhyri Pjotër Gerasimoviçi — gjithë puna është të zbulojmë a ka qenë ajo që e ka paramenduar dhe e ka kryer krimin, apo kanë qenë të dy kamarjerët.

— Po ç'do të bënin ata të dy po të mos kishin patur çelësin? Çelësin ajo e kishte!

Këto debate të çthurura vazhduan akoma për një kohë të gjatë.

— Më falni, zotërinj, — tha më në fund kryetari — po mua më duket se është më mirë të ulemi rreth tryezës e ta marrim punën shtruar.

Kështu tha e, për të dhënë shëmbullin i pari, u rehatua në kolltukun e tij të butë.

— Mor leni llafet, nga një kalltake si ajo, mos prit ni ndonjë gjë të mirë! — foli agjenti.

Pastaj, për të mbrojtur mendimin që faji duhej të rëndonte kryesisht mbi Masllovën, zuri të tregonte se si një grua tjetër, një si ajo, i kishte vjedhur një kolegut të tij sahatin në bulevard. Fill pas tij, koloneli tregoi një ngjarje akoma më tragjike: vjedhjen e një samovari të argjëndtë!

— Ju lutem, zotërinj, fillojmë nga pyetjet! — tha kryetari duke trokitur me majën e kalemit mbi tryezë.

Të gjithë heshtën. Atëhere Kryetari filloi leximin e pyetjeve që i drejtoheshin zhurisë e që qenë përpiluar e rrjeshtuar në këtë mënyrë:

1) Fshatari Simon Petrov Kartjenkin, nga fshati Borkov, distrikti i Krapivos, vjeç 33, akuzohet se më datën 17 Janar të vitit 188+, ka marrë pjesë, në qytetin N, në vrasjen me paramendim të tregtarit Smelkov, me qëllim grabitjeje dhe, me këtë paramendim, në marrëveshje me persona të tjerë, i ka hedhur në verë një helm që shkaktoi vdekjen e të lartpërmendurit Smelkov, duke i rrëmbyer këtij në një kohë të dytë një sasi të hollash prej dymij'e pesëqind rublash, si dhe një unazë me gurë brilanti. A është fajtor i pandehuri Simon-Petrov Kartjenkin për sa më sipër?

2) A është fajtore për krimin e përshkruar në pyetjen e parë Eufemia Ivanova Boçkova, borgjeze, vjeç 43?

3) A është fajtore për krimin e përshkruar në pyetjen e parë Ekaterina Mihaillovna Masllova, vjeç 27?

4) Në rast se Eufemia Boçkova nuk njihet fajtore për akuzën që shprehet në pyetjen e parë, a mund të konsiderohet fajtore se më 17 Janar të vitit 188+, duke shërbyer si kamarjere në hotelin «Mauritania», në qytetin N, ka rrëmbyer fshehurazi nga valixha e mbyllur me çelës e klientit të po këtij hoteli, tregëtarit Smelkov, një shumë prej dymij'e pesëqind rublash, duke e hapur valixhen në fjalë me çelësin që iu dha?

— E po, zotërinj, ç'thoni? Si do t'i përgjigjemi?

Përgjegja u gjend menjëherë. Të gjithë qenë dakord se duhej përgjigjur: «Po, është fajtor», si për vjedhjen, ashtu edhe helmimin. Nuk u bashkua me kolegët e tij në pohimin e fajsisë së Kartjenkinit, vetëm një nga anëtarët: ky ishte një burrë plak, që punonte në një artel, i cili përpiqej në çdo rast t'i shfajsonte të pandehurit dhe kur qe i bindur se kishin faj.

Në fillim, kryetari kujtoi se mos plaku nuk kishte kuptuar mirë se për ç'bëhej fjalë, e, prandaj, mendoi se e kishte për detyrë t'i shpjegonte me të gjitha hollësirat, e me të gjitha provat bindëse, se si nuk kishte as pikë dyshimi që Kartjenkini dhe Boçkova e kishin kryer me të vërtetë krimin për të cilin bëhej fjalë në pyetjen e parë dhe se, pra, ishin fajtorë. Por plaku u gjegj se ai e kuptonte, jo se nuk e kuptonte, porse prapë qe më mirë që t'i falnin që të dy. «E

po, edhe ne s'e heqim dot veten për shënjtor! — tha ai, dhe vazhdoi të ngulte këmbë në të tijën.

Pyetjes së dytë, që kishte të bënte me Boçkovën, pas shumë debatesh, iu dha kjo përgjigje: «Jo, nuk është fajtore.» Zhuria u shty të përgjigjej kështu nga shkaku se mungonin provat e pjesëmarrjes së saj në helmim. Pikërisht mbi këtë pikë kishte ngulur këmbë veçanërisht edhe avokati mprojtës i Boçkovës.

Tregëtari që kërkonte ta çfajsonte Masllovën, u hodh e foli përsëri duke thënë se Boçkova ishte strumbullari kryesor i të gjithë krimit. Kio pikëpamje u mbrojt gjithashtu edhe nga shumë anëtarë të tjerë të zhurisë gjer atëhere kur kryetari që bënej merak vetem e vetëm se si t'i përmbahej më mirë ligjit, vuri në dukje që, sidoqoftë, pjesëmarrja e saj në helmim, nuk mbështetej mbi asnjë provë materiale. U diskutua akoma për një kohë të gjatë por, më në fund, u pranua mendimi i kryetarit.

Pyetjes së katërtë që kishte të bënte përsëri me Boçkovën, meqënëse në pyetjen e dytë qenë treguar shumë të butë karshi saj, i dhanë këtë përgjigje: «Po, është fajtore». Zanatçiu që punonte në artel kërkoi që të shtoheshin edhe këto fjalë: «Por duhen marrë parasysh rrethanat lehtësonjëse».

I erdhi radha dhe pyetjes së tretë e cila qe lënë për në fund. Diskutimet që lindën me këtë rast, qenë shumë të zjarrta.

Kryetari thoshte se Masllova ishte fajtore, si për sa i përkiste helmimit, ashtu edhe për sa i përkiste grabitjes së të hollave. Tregëtari, përkundrazi, thoshte se ishte krejt e pafajshme, dhe me mendimin e tij u bashkuan gjithashtu koloneli dhe zanatçiu. Anëtarët e tjerë të zhurisë ngurronin, por, megjithatë, dukej se anonin më tepër nga mendimi i çfaqur prej kryetarit; kjo rridhte sidomos nga shkaku se anëtarët, duke qënë të lodhur, bashkoheshin më me qejf me njerin prej dy mendimeve të kundërtë që u jepte mundësi ta përfundonin sa më parë atë mbledhje të mërzitëshme.

Nga të dhënat e hetimeve e, sidomos, nga njohja që kish patur me Masllovën, Nekludovi ishte plotësisht i bindur se ajo nuk ishte fajtore as për vjedhjen e as për helmimin e tregëtarit. Në fillim ai besonte se kështu do të mendonin të gjithë, por e pa që u gabua dhe se shumica mendonin të kundërtën, ca nga që qenë lodhur, ca nga që nuk donin t'ia

prishnin kryetarit e ca nga që ai tregëtari babaxhan linte të kuptohej sheshit se Masllova i kishte pëlqyer, e pra, tregohej shumë i pa aftë për ta mbrojtur. Duke e çmuar siç duhej këtë situatë, Nekludovi u mat të ndërhynte; por i mungoi guximi që t'i dilte për zot Katjushës. I dukej se po të vepronte kështu, do të zbulonte pa dashur marrëdhënjet që kishte patur dikur me të. Përpiqej megjithatë t'i mbushte mëndjen vetes se e kishte për detyrë të ndërhynte pamvarësisht çfarë të ndodhte. Herë skuqej e herë zbehej në fytyrë. Por më në fund e mposhti ngurrimin dhe vendosi të fliste. Nuk arriti në kohë, se tamam atë çast, Pjotër Gerasimoviçi, të cilit, me sa dukej, toni autoritar i kryetarit s'para i pëlqente, u hodh e tha pikërisht ato që kish ndër mënd të thoshte ai vetë.

— Më falni, ju lutem — tha profesori — po ju ja ngarkoni asaj fajin duke u bazuar vetëm e vetëm në faktin se, siç e pohoi vetë, pat marrë nga Smjelkovi çelsin e valixhes. Po kush na siguron që kamarjerët e hotelit nuk e kanë hapur valixhen me një çelës tjetër?

— Ja, atë them dhe unë! — e mbështeti tregtari babaxhan.

— Në realitet është e pamundur që Masllova t'i ketë marrë të hollat. Ç'do t'i duheshin atje ku ishte?

— Ashtu po, atë them dhe unë! — foli përsëri tregtari duke u nxehur.

— Është më e drejtë të mendosh, e unë pikërisht kështu mendoj, që ardhja e saj në hotel me çelsin e valixhes, kaqënë si një ngasje për të dy kamarjerët që, duke përfituar nga rasti, vodhën të hollat që tregtari Smjelkov kishte në valixhe, duke ia ngarkuar fajin për këtë Masllovës.

Pjotër Gerasimoviçi fliste me inat. Inati i tij iu ngjit edhe kryetarit që filloi të ngulte këmbë përher'e më shumë në mendimin e tij. Por Pjotër Gerasimoviçi fliste me një siguri e me një kompetencë të tillë, saqë pjesa më e madhe e zhurisë kaloi nga ana e tij e pranoi që Masllova nuk mund të akuzohej as për vjedhjen e të hollave e as për vjedhjen e unazës të cilën tregtari ja kish dhuruar vetë.

Mbetej për të shqyrtuar në se ishte fajtore për helmimin e Smjelkovit. Tregtari, si mbrojtës i zjarrtë i të pandehurës, tha se duhej t'i jepnin patjetër pafajsinë, por kryetari kundërshtoi dhe tha, duke ngritur zërin, se praktikisht ishte krejt e pamundur t'i jepej pafajsija në këtë pikë gjer-

sa e pandehura e kishte pohuar vetë me gojën e saj, se ajo ia kishte dhënë helmin tregtarit.

— Helmin ja hodhi vërtet, por ajo e dinte për opium e jo për helm! — ja priti tregtari.

— Por dhe opiumi është një helm — ndërhyri e tha koloneli dhe, ashtu qejfli i madh siç ishte pas ndodhirave të çuditëshme, tregoi, me që e solli rasti, se si gruaja e kunatit të tij kish gëlltitur gabimisht një dozë opiumi dhe se, po të mos qe thirrur me të shpejtë mjeku, ajo vajti e shkoi! Koloneli e tregoi këtë meselé kaq bukur, në një mënyrë kaq autoritare e bindëse, sa asnjerit s'i bëri zemra ta ndërpriste. Vetëm agjenti çifut guxoi e tha, duke dashur edhe ai të tregonte ndonjë çudi të rrallë:

— Po të mësohesh të pijsh çdo ditë nga pak helm, vjen një kohë që s'të bën fare dëm sikur ta pijsh, makar, edhe nie shishe; ja, fjala vjen, një kushëriu im. . .

Mirëpo koloneli s'ishte nga ata burra që e linte fjalën përmes sepse kështu i pëlqente atij tjetrit; ai e vazhdoi atë historin'e gruas së kunatit gjersa të gjithë u skjaruan fare bukur për rolin që kishin luajtur në jetën e saj ca gramë opiumi të gëlltitura gabimisht.

— Zotërinj, ora paska vajtur pesë! — tha një nga anëtarët.

— Atëhere, zotërinj, si u ia? — pyeti kryetari — Si do t'i përgjigjemi pyetjes? Dëshironi që t'i përgjigjemi duke thënë se është fajtore, por pa paramendim vjedhjeje, dhe pa e kryer vjedhjen? Hë, si ju duket?

Pjotër Gerasimoviçi, i kënaqur që kish shkuar e tija, pranoi menjëherë.

— Vetëm, ama, duhet të shtojmë: «Me rrethana lehtësonjëse!» — tha tregtari.

Po të këtij mendimi qenë dhe të tjerët, me përjashtim të zanatçiut i cili ngulte këmbë që të shkruhej: «Jo, nuk është fajtore».

— Po e njëjta gjë është — e skjaroi kryetari, — gjersa themi se nuk ka patur paramendim vjedhjeje nga an'e saj, do të thotë se i japim pafajsinë.

— Ashtu, ashtu! Dhe me ato rrethanat lehtësonjëse që thashë unë, e hodhi ajo, s'kanë ç'i bëjnë, i marrin të keqen! — ndërhyri e tha çakërrqejf tregtari.

Por asnjerit s'i vajti ndër mënd, ashtu të lodhur e të mërzitur nga ato diskutime që s'kishin të sosur, të bënte edhe këtë shtojcë në përgjegje: **po, por pa paramendim vra-**

sjeje. Kjo i shpëtoi dhe Nekludovit që atë kohë e ndjente veten shumë të tronditur. Përgjigjet u shkruan e u dërguan në sallën e gjygjit.

Rable-ja shkruan diku për një jurist që e kishin thirrur për të zgjidhur një proçes gjyqësor. Ky, pasi rrjeshtoi të gjitha paragrafet e ndën paragrafet e ligjit, pasi lexoi edhe ndonja njëzet faqe ku me një latinishte çuditërisht të pa kuptuarshme, bëhej fjalë për ca rregulla e parime drejtësie, u propozoi kolegëve të tij që të hidhnin zaret për të parë se cila nga palët kishte të drejtë. Po të qe se zaret do të tregonin një numur çift, e drejta ishte nga ana e paditësit, kurse po të tregonin një numur tek, atëhere kishte të drejtë i pandehuri.

Kështu ndodhi edhe këtu. U mor ky vendim e jo një tjetër, jo sepse kështu ranë dakord që të gjithë, por sepse, piksëpari, kryetari i gjyqit, sidoqë u zgjat sa s'duhej n'atë përmbledhjen e tij, ndryshe nga herët e tjera, harroi të përmëndte që përgjegjen zhuria mund ta përpilonte edhe në këtë mënyrë: «Po, është fajtore, por pa paramendim vrasjeje»; sepse, së dyti, historia që tregoi koloneli për të shoqen e kunatit të tij, qe shum'e gjatë dhe e mërzitëshme; sepse, së treti, Nekludovi ishte kaq i tronditur, saqë nuk mundi ta vinte re harresën e shtojcës në përgjigje e cila do të mohonte paramendimin e krimit, dhe kujtoi se duke shkruar: «pa qëllim vjedhjeje», kjo akuzë binte poshtë vetvetiu dhe shtesa e shtojcës nuk paraqitej e nevojshme; sepse, së katërti, Pjotër Gerasimoviçi, gjatë kohës që kryetari i zhurisë bënte leximin e përgjigjeve, kishte dalë nga dhoma dhe, sidomos, sepse të gjithë qenë të lodhur, që të gjithë donin të çliroheshin sa më parë nga ajo angari dhe pra, pajtoheshin më mirë me atë vendim që do t'i jepte fund mbledhjes sa më shpejt.

Anëtarët e zhurisë i ranë ziles. Xhandari që qëndronte me shpatën xhveshur tek dera, e futi shpatën në këllëf e u hoq mënjanë. Gjyqtarët u ulën nëpër vëndet e tyre dhe anëtarët e zhurisë dolën nga dhoma një nga një.

Kryetari mbante në dorë listën e pyetjeve. Ai iu afrua rëndë-rëndë kryetarit të gjyqit dhe ja dha Kryetari e lexoi dhe, si ngriti duartë i habitur, u kthye nga shokët e nisi të konsultohej me ta. Kryetari i gjyqit çuditej se si zhuria, ndonëse e kishte kufizuar shtrirjen e fajit në përgjigjen e parë me shtojcën: «Pa paramendim vjedhjeje», nuk e kishte bërë këtë në të dytën ku duhej të cilësohej: «Pa paramen-

dim vrasjeje». Kështu, sipas mendimit të zhurisë, dilte se Masllova as nuk kishte vjedhur, as nuk kish grabitur por, në të njëjtën kohë, e kishte helmuar tregtarin pa patur shtytjen e ndonjë qëllimi të dukshëm.

— Shikoni se në çfarë konkluzioni absurd arrijnë këta zotërinj! — i tha ai anëtarit në të majtë. — Pranojnë që është e pafajshme dhe ja, e dënojnë me katorga! Po kësaj, ç'i thua?

— E pafajshme? Kush e tha? — tha anëtari, i rreptë.

— Unë e them. Sipas mejtimit tim, në rastin e saj mund të zbatohej nëni 818 (sipas nënit 818 gjygji, në qoftë se e gjen të padrejtë akuzën, mund të mos e marrë parasysh mendimin e zhurisë).

— Ju si mendoni? — iu drejtua kryetari anëtarit të gjyqit.

Anëtari nuk u përgjegj menjëherë; ai i hodhi një sy numrit që mbante në krye shkresa që ndodhej përpara tij dhe mblodhi shifrat për të parë nëse plotpjestohej me tre shuma. Kish vendosur që më parë që nëse plotpjestimi me tre do të qe i mundur, do të bashkohej me mendimin e kryetarit, dhe nuk do të bashkohej me të në rastin e kundërt. Por, megjithëse plotpjestimi nuk kryhej, ai, zemërmirë siç ishte, u çfaq pro zbatimit të nënit 818.

— Ashtu mendoj dhe unë. Mund ta zbatojmë. . . — tha.

— Po ju? — iu drejtua kryetari anëtarit të rreptë.

— N'asnjë mënyrë! u përgjegj ai i vendosur. — Gazetat kështu, e po trumbetojnë që zhuria u jep pafajsinë kriminelave. Ç'do të thonë pastaj kur gjyqi të tregohet edhe më i butë nga zhuria? Unë, nga ana ime, nuk pranoj n'asnjë mënyrë.

Kryetari i hodhi një sy orës.

— Keq më vjen, por s'ke ç'i bën! — tha dhe ia ktheu pyetjet kryetarit të zhurisë për t'i lexuar bashkë me përgjigjet.

Të gjithë u ngritën në këmbë. Kryetari, duke u mbështetur herë në njerën këmbë e herë në tjetrën, u kollit, qëroi mirë-mirë zerin, e filloi leximin. Sekretari, avokatët, bile dhe vetë prokurori u shprehën të habitur kur e dëgjuan.

Të pandehurit nuk jepnin asnjë shenjë çqetësimi me që, siç duket, nuk e kuptonin rëndësinë që kishin përgjigjet e zhurisë. Pastaj u ulën përsëri që të gjithë dhe kryetari iu

drejtua prokurorit duke e ftuar të propozonte dënimet që mendonte t'u jepeshin të pandehurve.

Prokurori, i gëzuar sa s'thuhej nga ai sukses sa i bujshëm, aq edhe i papritur për të në lidhje me Masllovën, duke ja detyruar këtë sukses, si dhe shumë të tjera, oratorisë së tij të mprehtë, diç çfletoi, u ngrit përgjysëm e foli:

— Mendoj që Simon Kartjenkini të dënohet sipas nënit 1452 dhe paragrafit 4 të nënit 1453, Eufemia Boçkova sipas nënit 1659 dhe Ekaterina Masllova sipas nënit 1454.

Prokurori kish zgjedhur dënimet më të rrepta që ligji parashikonte n'atë rast.

— Trupi gjykues tërhiqet për të marrë vendim — tha kryetari dhe u ngrit.

U ngritën dhe të gjithë të tjerët pas tij dhe, si të lehtësuar e me atë ndjenjë gëzimi që ka çdo njeri kur kryen një vepër të mirë, nisën të dalin jashtë dhe të sillen posht'e lart nëpër sallë.

— Thuaj si të duash, or babush, po u gënjyem keq këtë radhë! — tha Pjotër Gerasimoviçi duke iu afruar Nekludovit i cili po bisedonte at' kohë me kryetarin e zhurisë. — Në Siberi e degdisëm, jo shaka!

— Ashtu? Si qenka kjo? — ja bëri Nekludovi pa e vënë re fare këtë radhë familjaritetin e tepëruar të profesorit.

— Po ta merr mëndja — tha ai, — se ne nuk shkruam në përgjigje: «Është fajtore, por pa paramendim vrasjeje». Tani sapo fola me sekretarin; ai më tha se prokurori kërkon të dënohet me pesëmbëdhjetë vjet punë të detyruara.

— Po dhe ne kështu vendosëm — tha kryetari i zhurisë.

Pjotër Gerasimoviçi filloi të grindej duke thënë se gjersa pranohej që e pandehura nuk i kishte marrë të hollat, ishte marrëzi të mendohej që ajo e kishte vrarë tregëtarin me paramendim.

— Unë i lexova edhe një herë përgjigjet para se të dilnim — tha kryetari që kërkonte të mprohej. — Asnjeri nuk kundërshtoi.

— Unë atë kohë nuk u ndodha aty se dola jashtë — tha Pjotër Gerasimoviçi — Mirë, po ju, si nuk e vutë re këtë?

— Kurrë s'ma priste mëndja se mund të ndodhte kështu! — tha Nekludovi.

— E, e, po duhet të ta kishte prerë.

— Po kjo, mbase mund të ndreqet — tha Nekludovi.

— Eh, jo, tani çdo gjë ka marrë fund!

Nekludovi u hodhi një sy të pandehurve. Sidoqë atë çast vendosej fati i tyre, ata rrinin gjithë po aq të mpirë në bangot matanë hekurave. Masllova dikujt po i buzëqeshte. Një ndjenjë e poshtër lëvriu në shpirtin e Nekludovit kur e vuri re. Gjer atëhere, i sigurtë se Masllova do të mirrte pafajsinë e do të kthehej përsëri atje ku kishte qenë, po n'atë qytet ku banonte dhe Nekludovi, ai ngurronte t'i përcaktonte vetes qëndrimin që do të mbante këndej e tutje karshi saj. dhe që të mbante një qëndrim, çfardo qëndrimi, ishte e vështirë, shumë e vështirë për të. Kurse tani, punët e detyruara në Siberi, e zhduknin menjëherë mundësinë e marrëdhënjeve me atë grua: zogu i plagosur, ahere, nuk do të përpëlitej më në trastë, dhe kështu gjahtarit s'do t'i binte më ndër mënd për të.

XXIV

Ndodhi ashtu siç kishte parashikuar Pjotër Gerasimoviçi. Si u kthye nga dhoma e konsultimeve, kryetari lexoi vendimin që ishte përpilluar në këtë mënyrë:

«Sot, më datën 28 Prill 188..., seksioni i krimeve i gjyqit të distriktit, me urdhër të Madhërisë së Tij Perandorit, duke marrë parasysh mendimin e zhurisë e duke u mbështetur në paragrafin 3 të nenit 771, të paragrafit 3 të nenit 776 dhe të nenit 777 të kodit të proçedurës penale, dënoi Simon Kartjenkinin, fshatar, vjeç 33, dhe Katerina Masllovën, borgjeze, vjeç 27, me privimin e të gjitha të drejtave civile dhe vendosi dënimin e tyre me punë të detyruar, Kartjenkinin për një periudhë prej 8 vjet, Masllovën për një periudhë prej 4 vjet, duke i ngarkuar njëkohësisht edhe me të gjitha pasojat përkatëse që parashikohen nga kodi penal.

Dënoi Eufemi Boçkovën, borgjeze, vjeç 43, me humbjen e të gjitha të drejtave civile, me 3 vjet burgim, si edhe me të gjitha masat ndëshkimore që rrjedhin nga neni 49 i kodit penal.

I dënoi gjithashtu të tre të pandehurit të paguajnë bashkarisht të gjitha shpenzimet e gjyqit duke dekretuar në të njëjtën kohë që, në rast se të lartpërmëndurit nuk do të jenë në gjëndje t'i përballojnë shpenzimet në fjalë, këto t'i ngarkohen buxhetit. . .»

Vendimi bënte fjalë gjithashtu për materialet e akt-aku-

zës, që duheshin shitur, me përjashtim të unazës, që do t'i kthehej trashëgimtarit më të afërt të tregëtarit Smelkov, dhe shishes që do të zhdukej.

Kartenkini qëndronte në këmbë e sikur shtriqej, ndërsa duart, me gishtërinjt' e mpirë që ngriheshin mbi pëllëmbë si ca perona ngulur mbi një dërrasë, i mbante ngjitur pas tegelave të rrobës. Ndërkaq, muskujt e fytyrës gjithë i lëviznin. Boçkova dukej fare e qetë. Masllova, kur e dëgjoi vendimin dhe e kuptoi, u skuq në fytyrë.

— Unë s'kam faj, s'kam faj unë! — shpërtheu ajo me britmë, menjëherë porsa kryetari i dha fund leximit. — Mos, mos, se është gjynah! As desha, as e mendova. Të vërtetën ju them. Të vërtetën!

Pastaj, si i nxori këto pak fjalë me një zë që oshëtiti në tërë sallën, u lëshua mbi bango, mbuloi fytyrën me të dy duart e qau me dënesë.

Kur Kartenkini dhe Boçkova u ngritën e duallën, ajo vazhdonte të rrinte ulur e të qante. Një nga xhandarët e kapi për krahu dhe e detyroi të ngrihej.

«Jo, kjo punë s'mund të mbetet kështu», — murmuriti vetë me vete Nekludovi, duke harruar për një çast ndjenjën e ligë që kish patur pak më parë. Brofi në këmbë dhe, pa ditur as vetë ç'po bënte, u sul në koridor që ta shihte edhe një herë të burgosurën tek dilte. Po e gjeti derën të zënë nga turma e avokatëve dhe e gjyqtarëve, që nguteshin të dilnin nga salla e dukeshin tani shumë të kënaqur që seanca kish marrë fund. Iu desh të priste. Kur doli në koridor, Masllova me xhandarët ishte larguar. Atëhere u dha këmbëve shpejt dhe, pa u kujdesur për vëmëndjen e papëlqyer që do të ngjallte rreth tij, nuk e preu asnjëherë atë të ecur, pothuaj me vrap, gjersa e arriti. Ajo tani nuk qante më, por vetëm herë-herë nxirrte ndonjë ofshamje të thellë, të prerë, e fshinte me cepin e shamisë fytyrën pllanga-pllanga nga lotët. I kaloi fare pranë Nekludovit, por nuk e ktheu kokën dhe nuk e pa. Ai, nga ana e tij, nuk bëri asnjë lëvizje për t'i rënë në sy, por nxitoi përkundrazi të kthehej pas për t'u takuar me kryetarin e gjygjit. Mendonte se do ta gjente në zyrë, por i thanë që porsa kish dalur. Atëhere zbriti shkallët me vrap.

E gjeti kryetarin në dhomën e portierit tek ngjishej në një pallto me ngjyrë të çelur e merrte nga dora e portierit një bastun me kokën veshur në ergjënd.

— Zoti kryetar, — i tha Nekludovi duke iu afruar —

ka mundësi të bisedoj pak me ju në lidhje me gjyqin e sotëm? Unë vetë bëj pjesë në zhuri.

— Oh, po është e kotë që më pyetni: me gjithë qejf, e më vjen shumë mirë që më bie rasti të takohem edhe një herë me ju. Princi Nekludov, në s'gabohem? — ja ktheu kryetari që, ndërsa ja shtërngonte fort dorën, sillte ndër mend takimin e parë me Nekludovin, në një mbrëmje vallëzimi, ku ai kish kërcyer më mirë nga të gjithë. — Ç'urdhëroni nga unë?

— Ka patur një keqkuptim në përgjegjen për të pandehurën Masllova. E kemi dënuar me punë të detyruar duke qenë krejt e pafajshme, — tha Nekludovi i ngrysur e me një ton të vendosur.

— Gjyqi e mori vendimin duke u mbështetur në përgjigjen që dhatë ju, si zhuri, tha kryetari, duke u drejtuar për nga dera — sadoqë, po e them, kjo përgjegje edhe vetë gjyqit iu duk sikur s'pajtohej me faktet. — Ai u kujtua atë çast se si kish dashur t'i shpjegonte zhurisë ca hollësira mbi përpilimin e përgjegjeve. Kështu, bie fjala, kishte patur ndër mënd të vinte në dukje, ndërmjet të tjerave, që një përgjegje si kjo: «Po, është fajtore» pa mohuar paramendimin e krimit, pranonte tërthorazi kryerjen e krimit me paramendim.

— E kuptoj, po s'ka mundësi që të ndreqet tani ky gabim?

— Mund të bëhet një apel në Gjykatën e Lartë. Pretekst i po gjëndet. Bisedoni me një avokat, — i ra shkurt kryetari, duke ulur pak mbi sy kapelën e duke çapitur për nga dera.

— Po kjo është e tmerëshme!

— Shikoni si është puna: ne kishim vetëm dy udhë, — filloi të thotë kryetari që, me ç'kuptohej, kërkonte të dukej sa më i përzëmërt me Nekludovin. Por, befas, diç iu kujtua dhe, duke ndrequr basetat që i binin përmbi jakën e palltos, i shkoi lehtë krahun Nekludovit nën sqetull dhe, gjithë duke lëvizur për nga dera, vazhdoi: — Edhe ju sikur do të dilni, apo jo?

— Po, — u përgjegj Nekludovi duke u veshur me ngut që ta shoqëronte.

Kur duallën jasht, nën një diell të ngrohtë e gjallëronjës, u desh të flisnin me zë të lartë nga shkaku i kërkëllimës shurdhonjëse të rrotave mbi kalldrëm.

— Ka qënë një rast vërtet i çuditshëm — vazhdoi kryetari duke e ngritur zërin — se, siç ju thashë, na mbeteshin

vetëm dy udhë: ose pothuajse ta çfajësonim Masllovën duke e dënuar me burgim të lehtë e duke i zbritur edhe kohën që ka qëndruar e arrestuar, ose punët e detyruara, «katorga». Udhë të mesme s'kishim. Sikur në përgjigjen tuaj ju të kishit shtuar dhe këto fjalë: «Por pa paramendim vrasjeje», ajo do të kishte marrë pafajsinë.

— Kjo na shpëtoi dhe është gabimi im, një gabim që s'ja fal vetes.

— Pikërisht këtu qëndron tërë puna, — tha kryetari duke buzëqeshur dhe i hodhi një sy orës.

Mbeteshin akoma gjithë-gjithë edhe tre çerek ore nga afati i fundit i takimit me Klarën.

— Tani, po të dëshëroni, drejtohuni tek një avokat për të gjetur një pretekst për apelin. Siç thashë, pretekst gjendet kurdoherë. Në Dvorjanskaja, — i thirri karrocierit të një «fiacre» që kalonte atë çast pranë, — tridhjetë kopejka, kaq paguaj gjithmonë.

— Urdhëroni e hypni, shkëlqesi!

— Nderimet e mia. Po të kini akoma nevojë për mua, do të jem i lumtur t'ju shërbej. Do të më gjeni në këtë adresë: Dvorjanskoje, shtëpia e Dvornikovit. Mbahet mënd lehtë, apo jo?

Dhe me kaq kryetari u largua, e përshëndeti edhe një herë miqësisht Nekludovin me një përkulje të kokës.

XXV

Biseda me kryetarin dhe ajri i pastër ja qetësuan disi nervat. Tani ai filloi të mendonte që ajo tronditje e fortë shpirtërore që kish provuar, nuk ishte tjetër veçse një pasojë e tepruar e ngjarjeve në gjyq dhe të rrethanave anormale që i kishin shoqëruar.

«Është një koincidencë e çuditshme, s'ka dyshim! E duhet të bëj çmos që t'i vij në ndihmë. Patjetër. Pa humbur kohë. Ja, t'i vihem kësaj pune që tani. Të pyes në gjyq ku e ka shtëpinë Fanarini ose Mikishini».

Fanarin dhe Mikishin ishin emrat e dy avokatëve të dëgjuar.

Nekludovi u kthye në gjyq, hoqi pallton dhe u ngjit sipër. E takoi Fanarinin që porsa hyri në koridorin e parë. E

ndaloi dhe i tha se kishte pak punë me të. Fanarini, që e njihte Nekludovin jo vetëm me emër por edhe për nga fytyra, tha se ishte gati ta dëgjonte dhe po të mundte t'ja mbaronte punën menjëherë.

— Ç'është e vërteta, jam pak i lodhur. . . Por besoj se do të mbarojmë shpejt, apo jo? Ja, futemi këtu!

Fanarini e tërhoqi pas Nekludovin në një dhomë të vogël që do t'ishte, mbase, kabineti i ndonjë gjykatësi. Zunë vënd pranë tryezës.

— E po, si qëndron puna?

— Në radhë të parë unë do t'ju lutesha, — nisi të thotë Nekludovi — që ato sa do t'ju them, të mbeten mes nesh. S'dua kurrsesi ta marri vesh njeri pjesëmarrjen time në këtë punë.

— Kjo dihet. E po?. . .

— Po ja, sot, në seancën e gjyqit, ku kam marrë pjesë si anëtar i zhurisë, një grua është dënuar me punë të detyruar duke qenë e pafajëshme. Ja, kështu, unë, nga ana ime, s'jam në rregull me ndërgjegjen. . .

Duke thënë këto fjalë, Nekludovi nuk mendonte se do të skuqej në fytyrë e se do t'i merrej zëri. Po, kështu i ndodhi.

Fanarini i ngriti sytë mbi të i habitur, por pastaj i uli përsëri.

— Edhe?. . . — pyeti.

— Siç thashë, dënuam një njeri të pafajshëm, prandaj unë, nga ana ime, dua të kërkoj anullimin e gjyqit duke ja referuar çështjen Gjykatës së Lartë.

— Senatit, — ja ndreqi gabimin Fanarini.

— E ja, kështu, do t'ju lutesha që apelin ta merrnit ju përsipër.

Dhe, duke dashur të kapërxente sa më shpejt pikën më të zorshme të biseedës, Nekludovi, pa pritur përgjegjen e avokatit, shtoi me një frymë:

— Shpërblimin që do të kërkoni si edhe të gjitha shpenzimet lidhur me këtë çështje, sado të mëdha qofshin, i heq unë.

Nekludovi, duke thënë këto, prapë u skuq.

— Kollaj është për atë. . . nuk prishemi. . . — ja ktheu avokati duke buzëqeshur me mirëdashje për atë mungesë përvoje që vinte re tek klienti i tij.

— Po, më konkretisht, si është puna?

Nekludovi ja tregoi.

— Mirë. Atëhere do të bëjmë kështu: nesër unë po marr dosjen e po i hedh një sy, kurse pasnesër, ç'është nesër?... Jo, jo, të ejten mbrëma ejani nga unë aty nga ora gjashtë të merrni përgjegjen. Kështu? Mua tani do të më falni...

Nekludovi u përshëndosh me të e doli.

Biseda me avokatin si edhe mendimi që ai tani diç kishte bërë për t'i ardhur në ndihmë Masllovës, e qetuan Nekludovin akoma dhe më shumë. Ai doli jashtë në oborr. Moti ishte i mirë, pa shi e pa re, dhe ai thithi i gëzuar ajrin e freskët pranveror. Rrugës, karrocat ndaleshin dhe karrocierët e ftonin të hypte, por atij i pëlqente të ecte me këmbë. Ishte si një çurg mendimesh që shpërthente në trurin e tij në çdo hap. Sillte ndër mënd Katjushën ashtu siç kishte qenë dikur, mashtrimin e tij djallëzor, dhe mendime të hidhura e pushtonin. «Jo, jo, këto do t'i mendoj më vonë, — thoshte me vete — hë për hë duhet të bëj çmos që ta shporr këtë brëngë nga shpirti im».

I ra ndër mënd dreka tek Korçaguinët dhe pa orën. Akoma s'qe vonë, po të donte mund të arrinte tamam në kohë. Dëgjoi pranë tringëllimën e një vagoni nga ata që tërhiqeshin me kuaj. I ra pas me vrap dhe e zuri. Tek sheshi hypi në një karrocë luksoze dhe mbrijti pas dhjetë minutash në shtëpinë e madhe të Korçaguinëve.

XXVI

— Shkëlqesia juaj mund të urdhërojë, e presin, — tha portieri barkmadh e përherë i qeshur i shtëpisë së madhe të Korçaguinëve, duke hapur pa zhurmë derën e madhe prej dru lisi të hyrjes, që mbahej në disa çivi angleze. — Janë në tryezë. Shkëlqesia juaj është e lutur të ngjitet në dhomën e bukës.

Portieri iu afrua shkallës dhe i ra ziles.

— Ka ndonjë të huaj? — pyeti Nekludovi duke u zhveshur.

— Zoti Kolosov dhe Mihail Sergejeviçi, vetëm këta, — u përgjegj portieri.

— Majë shkallës zgjati kokën poshtë një laké bukurosh veshur në frak e me dorashka të bardha.

— Shkëlqesia juaj le të ngjiti shkallët, — tha — jam i urdhëruar t'ju ftoj të hyni.

Nekludovi u ngjit dhe, si kaloi përmes një salle të gjerë e madhështore, hyri në dhomën e bukës. Rreth tryezës kish zënë vënd tërë familja e Korçaguinëve, me përjashtim të princeshës Sofia Vasilievnës që s'dilte kurrë nga dhoma e saj. Në krye ishte plaku Korçaguin, pranë tij, në të majtë, që ulur doktori, ndërsa në të djathtë rrinte Ivan Ivanoviç Kolosovi, ish marshall fisnikërie në një gubernë e tani anëtar i kryesisë së një banke, liberal e mik i ngushtë i Korçaguinit; pastaj vinin — nga e majta: Miss Reder, guvernantja e motrës së vogël të Missit dhe, pranë saj, motra e vogël, një vajzë nja katër vjeçe; nga e djathta, përballë, vinin i vëllai i Missit, Petja, djali i vetëm i Korçaguinëve, gjimnazist në klasën e gjashtë, që e kishte detyruar tërë familjen të rrinte në qytet gjersa të jepte provimet dhe, pranë tij, një student që e ndihmonte në mësime; pastaj, përsëri nga e majta, ndodhej Katerina Aleksejevna, një mamole dyzet vjeçe, sllavofile e tërbuar; përballë saj, Mihail Sergejeviçi ose Misha Telegini, siç i thonin, kushuri i parë me Missin. Në fund të tryezës qe ulur vetë Missi, ndërsa në krah të saj ishte një vënd bosh.

— Mirë, mirë bëtë që erdhët! Uluni, ja tani porsa filluam nga peshku, — tha plaku Korçaguin duke u mbllaçitur me zor e i matur me dhëmbët e tij të vënë, ndërsa ngrinte mbi Nekludovin vështrimin e syve të spërkatur me gjak e pa qerpik. — Stepan, — iu drejtua me gojën plot bufetierit të trashë me një pamje madhështore që qëndronte në këmbë pas banakut, duke i treguar me sy pjatën bosh në krah të Missit.

Nekludovi e njihte mirë Korçaguinin plak dhe s'ishte hera e parë që e shihte duke ngrënë bukë. Por, ndryshe nga herët e tjera, këtë radhë, ajo fytyrë e kuqe dhe e ngjallur, ato buzë të trasha plot epsh që përtypnin e dukej sikur rrufisnin mbi pecetën e bardhë hapur mbi zhilé, qafa e majme e, në përgjithësi, tërë ajo figura e tij katrore dhe e ushqyer mirë prej gjenerali, i bënë atij një përshtypje të papëlqyer, për të mos thënë që e përshtirosën. Nekludovi solli ndër mënd padashur ato sa kish dëgjuar për mizoritë e kryera nga ky njeri që, kushedi përse, pa qënë ngushtë as për të holla e as për nam, kur kish qënë gubernator province kish vrarë e kish prerë sa kish mundur.

— Ja, tani do t'ju shërbejnë, shkëlqesi, — tha Stepani e mori nga bufeja, ku ngriheshin anash ca vazo prej argjëndi, një qepshe të madhe, duke i bërë në të njëjtën kohë një

shënjë me kokë lakéit bukurosh me baseta. Ky u sul menjëherë nga pjata bosh në krah të Missit e hoqi që andej pecetën e hekurosur e të palosur me mjeshtëri të rrallë.

Nekludovi i ra rrotull tryezës duke u shtrënguar dorën një nga një të gjithëve. Me përjashtim të Korçaguinit e të damave, të gjithë u ngritën dhe u përshëndetën me të në këmbë. Pa lezet dhe qesharake iu duk atij atë mbrëmje edhe ajo shëtitje për rreth tryezës, dhe ai shtrëngim duarsh me njerëz të njohur e të panjohur. Kërkoi ndjesë që nuk kishte ardhur dot në kohë dhe u mat të ulej në vëndin bosh, në fund të tryezës, ndërmjet Missit dhe Katerina Aleksejevnas; por plaku Korçaguin nguli këmbë që të shijonte më parë, me votkë a pa votkë, mezetë. Kështu Nekludovi u detyrua të ulej në një tryezë të veçantë, më të vogël, ku qenë shtruar pjata me gaforre, me havjar, me djathë e ciraga. Pandehte se nuk ishte i uritur, por me kafshatën e parë të bukës me djathë që futi në gojë, e kuptoi se e kishte zor të ndalej dhe vazhdoi të hante me oreks të madh.

— E po si, i minuat bazat? — e pyeti Kolosovi duke përdorur me ironi shprehjen e një gazete reaksionare në një artikull që kishte për qëllim të vinte në dukje rrezikun e pjesëmarrjes në gjyq të zhurisë. — I çfajsuat fajtorët, i dënuat të pafajshmit?

— I minuat bazat... I minuat bazat... — i mbajti ison duke qeshur princi, që kishte shumë besim në mëndjen e hollë dhe në diturin'e thellë të mikut të tij liberal.

Nekludovi s'i foli fare Kolosovit, sadoqë kjo mund të dukej ndofta një mungesë edukate nga ana e tij. Ai vazhdoi të përtypej përpara pjatës me supë të nxehtë që i kishin serviruar pak më parë.

— Pritni një herë sa të hajë! — u hodh e tha Missi dhe, mënyra se si e tha, fliste hapur për marrëdhëniet e ngushta që e lidhnin me Nekludovin.

Po Kolosovit tani as që i binte më ndër mënd për pyetjen që i kishte bërë dhe që kish mbetur pa përgjegje. Ai tregonte me zë të lartë e me gjallëri përmbajtjen e artikullit që e kishte revoltuar. Mihail Sergejeviçi, i nipi, e nxiste, duke folur për përmbajtjen e një artikulli tjetër të po asaj gazete.

Missi, si gjithmonë, qe veshur shumë distinguée dhe mirë, me një elegancë të hollë që s't'i vriste sytë.

— E marr me mënd që do të jeni lodhur tmerësisht dhe keni shumë uri, — i tha ajo Nekludovit dhe ndënji e priti, me

kokë kthyer nga ai, gjersa të përtypte bukën që kishte në gojë.
— Jo, jo edhe aq. Po ju ç'bëtë? I patë ato tabllotë? — e pyeti Nekludovi.

— Jo, e lamë për një herë tjetër. Shkuam në lawn tennis [1]) e tek Salamatovët. Mirë thonë që ai mister Kruks lot mirë. Vërtet, shumë mirë lot.

Nekludovi kishte ardhur aty që të zbavitej disi nga telashet e ditës e gjithmonë ajo shtëpi i kishte pëlqyer, jo aq për atë luks krejt të posaçëm që ndikonte në një mënyrë aq të këndëshme në ndjenjat e tij, se sa për atë atmosferë lajkash e kujdesjesh të tepruara që e rrethonte atje. Por, për çudi, atë ditë që të gjithë atje e pështirosnin, që nga portieri e nga shkallët e gjëra, e nga lulet, e nga lakéjtë e nga mënyra se si ishte shtruar tryeza e gjer tek Missi vetë, që nuk e tërhiqte më si dikur dhe që mbante, sipas mendimit të tij, disa qëndrime që s'ishin aspak të natyrëshme. E pështiroste edhe toni tepër i vendosur, tepër banal e liberal i Kolosovit dhe pamje prej kau të ngosur, të kënaqur e Korçaguinit dhe ajo dremitje epshesh mbi buzët e tij; e pështirosnin ato frazat e frëngjishtes së shtrëmbër që futeshin si pykë në rusishten e bastardуar të sllavofiles Katerina Aleksejevna, fytyrat e ndrojtura të guvernantes e të studentit dhe, sidomos e mbi të gjitha, paturpësia e familjaritetit që kishte treguar ndaj tij Missi duke thënë: «Pritni një herë sa të hajë. . .» Nekludovi kishte patur gjithnjë për Missin dy mendime të kundërta. Herë-herë, e shihte si për së largu ose, më mirë të themi, si nën dritën e dobët të hënës dhe, atëhere, i dukej e përsosur, se ishte edhe e freskët, edhe e bukur, edhe e mënçur, edhe e thjeshtë. . . Por herë tjetër e shihte si në një mesditë, kur dielli është në zenith dhe shkëlqen e atëhere zbulonte, nuk mund të mos zbulonte në të, shumë të meta. Kështu edhe atë mbrëmje ai vinte re mirë në fytyrën e saj të gjitha rrudhat, dallonte në flokët e saj të dredhura shënjat e hekurit të nxehtë, i binin në sy majat e mprehta të bërryleve dhe sidomos ai thoi i gjerë i gishtit të madh që i kujtonte thuan po aq të gjerë, po n'atë gisht, të plakut Korçaguin.

— Ju them unë, s'ka lojë më të mërzitëshme se tennisi, — tha Kolosovi. — Shumë më mirë ka qenë ajo «llapta» [2]) që luhej në kohën tonë.

— Ju flitni pa e provuar. Përkundrazi, është një lojë

1) tennis (anglisht).
2) Një lojë me top, me dy grupe lojtarësh.

tmerësisht interesante! — kundërshtoi Missi duke e shqiptuar, siç iu duk Nekludovit, fjalën «tmerësisht» me një ton në zë që s'ishte i saj.

Por Kolosovi nguli këmbë në të tijën e atëhere filloi një përleshje e vërtetë fjalësh nga të dy anët, në të cilën muarrën pjesë edhe Mihail Sergejeviçi me Katerina Aleksejevën. Vetëm guvernantja, studenti dhe fëmijët vazhdonin të rrinin të heshtur e, me sa dukej, të mërziteshin.

— Kështu gjithmonë këta, nuk u rrihet pa u zënë! — tha Korçaguini plak e ja dha gazit ndërsa hiqte pecetën e, duke shtyrë me zhurmë karrigen që u rrëmbye menjëherë nga lakéi, ngrihej nga tryeza. Shëmbullin e tij e ndoqën që të gjithë dhe u afruan, një nga një, tek një tryezë tjetër e vogël, ku qenë vendosur ca enë me ujë të vakët, aromatik, për të shplarë gojën. Gojët u shplanë dhe duart u lanë e pastaj biseda, ajo bisedë që s'i hynte asnjeriut në punë, vazhdoi tamam atje ku qe ndërprerë.

— Nuk kam të drejtë? — iu drejtua Missi Nekludovit duke e ftuar që të pohonte edhe ai se n'asnjë vënd tjetër karakteri i njeriut nuk çfaqet aq mirë se sa në lojë. Ajo kishte vënë re në fytyrën e tij atë shprehje përqëndrimi e, siç iu duk, qortimi të heshtur, të cilës i trëmbej më tepër nga çdo gjë tjetër, e mundohej të gjente tërthorazi shkakun.

— S'di si t'ju them, s'e kam menduar ndonjë herë, — u përgjegj Nekludovi.

— Do të shkoni tek mamaja? — e pyeti Missi.

— Po, po, — ja bëri ai duke ndezur një cigare, por me një zë që deshte të thoshte të kundërtën.

Ajo ngriti sytë dhe e vështroi sikur diç deshte t'i pyeste akoma e nuk guxonte. Atij i erdhi keq. «S'bëj mirë që mbaj këtë qëndrim se, fundja, s'kam ardhur këtu që t'i mërzit njerëzit», — mendoi Nekludovi e, duke u përpjekur të dukej sa më i përzemërt, tha se do të dëshëronte me gjithë qejf t'i bënte një vizitë princeshës po, vetëm, kishte frikë se mos e bezdiste.

— Përkundrazi, mamasë do t'i vijë shumë mirë. Cigaren mund ta pini edhe atje. Atje është edhe Ivan Ivanoviçi.

E zonja e shtëpisë, një damë e rëndë që e kalonte jetën shtrirë, quhej Sofia Vasiljevna. Bëheshin tetë vjet që ajo i priste mysafirët shtrirë mbi divanin e saj që hijeshohej nga dantella e fjongo soj sojë, mes kadifes së butë ngjyrë-nëdezur, fildishit të zbetë e bronzit krenar, në një dhomë që kundërmonte nga era e luleve, e parfumit dhe vernikut të fres-

këtë e ku priste, siç thoshte, vetëm «miqt'e saj», d.m.th. ata të rrallët që, për një arësye a për një tjetër, spikatnin në sfondin e murmë të njerëzve të zakonshëm. Ndër këta të zgjedhur, miq të princeshës Sofia Vasiljevnës, ishte edhe Nekludovi, si një njeri shumë i zgjuar, ndonëse akoma shumë i ri, sepse e ëma e tij kish patur së gjalli shoqëri të ngushtë me Korçaguinët dhe, së fundi e sidomos, sepse do të qe shumë mirë sikur ta martonin me Missin.

Para se të hyje në dhomën e Sofia Vasiljevnës, duhej të kaloje një pas një dy sallone nga të cilët i pari ishte më i madh. Në sallonin e madh Missi, që i hiqte udhën Nekludovit, u ndal me një lëvizje të prerë e të vendosur dhe, duke u mbështetur me të dy duartë pas shpinës së lartë të një karrigeje veshur me ar, e vështroi drejt e në sy.

Missi kishte shumë qejf të martohej dhe e dinte që një burrë si Nekludovin nuk e gjente dot edhe aq lehtë. Veç kësaj, ai i pëlqente dhe ajo sikur qe mësuar tani me mendimin që një ditë ai do të bëhej i saj (jo që ajo të bëhej gruaja e tij, por që ai të bëhej burri i saj). Dhe ajo luftonte për t'ja arritur qëllimit çdo ditë me një dinakëri të pa vetëdijshme, por ngulmonjëse, si ajo që vihet re dëndur në njerëz shpirtërisht të sëmurë. Kështu, pra, si u ndal dhe, si e vështroi Nekludovin ngultas, si për ta detyruar që të mos i fshihte asgjë, i tha:

— Shoh që diç ju ka ndodhur. Si qëndron puna?

Ai solli ndër mënd ngjarjen në gjyq, vrënjti vetullat e u skuq në fytyrë.

— Po, diç më ka ndodhur vërtet — pohoi ngaqë s'deshte të gënjente, — dhe është një gjë shumë e madhe dhe e rëndësishme që më ka gjetur fare të pa pregatitur.

— Çfarë? Nuk mund të ma thoni?

— Hë për hë, nuk mundem. Më lejoni të mos jua them. Duhet ta mendoj vetë më parë, — tha ai, duke u skuqur edhe më shumë.

— Pra, nuk doni të ma thoni? — dhe, ndërsa në fytyrë iu drodh befas një muskul, ajo shtyu me vrull karrigen ku qe mbështetur.

— Jo, nuk mundem, — u përgjegj ai duke ndjerë që me atë përgjegje i nguliste bindjen vehtes se ajo që i kishte ndodhur në gjyq, ishte me të vërtetë diçka shumë e rëndësishme.

— Mirë, si të doni. Shkojmë atëherë tek mamaja.

Duke shkundur kokën si për të larguar një mendim

që e bezdiste, ajo doli përpara e i hoqi rrugën me një hap të shpejtë e të nxituar si kurrë ndonjë herë tjetër.

Nekludovit iu duk se në të njëjtën kohë Missi kafshoi buzën si një njeri që do të qajë po përmbahet. I erdhi keq për të dhe e ndjeu veten fajtor. Por dobësia më e vogël atë çast do ta merte në qafë Nekludovin, d.m.th. do ta lidhte me Missin përfundimisht. Këtë ai e kuptonte mirë dhe, sidomos atë ditë, ruhej nga kjo më tepër se nga çdo gjë tjetër. Prandaj s'foli dhe e ndoqi i heshtur Missin gjer në kabinetin e princeshës plakë.

XXVII

Princesha Sofia Vasiljevna porsa kishte mbaruar së ngrëni drekën e saj tepër të shijëshme e tepër të ushqyeshme, si nga herë. Ajo e kishte zakon të hante vetëm sepse, siç thoshte, nuk i vinte mirë ta shikonin duke u marrë me një punë të tillë siç është të ngrënit. Nekludovi kur hyri e gjeti duke pirë një cigare «Pahitos», gjysëm shtrirë mbi divan, ndërsa, përpara, mbi një tryezë të vogël, kishte një filxhan me kafe. Princesha Sofia Vasiljevna qe një grua e hollë. me shtat të lartë, e zeshkët, me dhëmbë të gjatë e me sy të mëdhenj e të zez. Sidoqoftë tanimë plakë, mbahej e dukej, megjithatë, mjaft e re.

Mbi marrëdhënjet e ngushta që mbante me mjekun e saj, pëshpëriteshin lloj-lloj fjalë. Nekludovi s'ua kishte vënë veshin kurrë, por i solli ndër mënd pa dashur kur hyri në dhomë e vuri re mjekun që qe ulur në një kolltuk, pothuajse ngjitur me të. Pamja e atij burri të shkurtër e të trashë, me një mjekër të lyrosur, të ndritëshme e që ndahej më dysh, i ngjalli pa dashur një ndjenjë pështirimi që s'ishte në gjëndje tu përmbante.

Pranë Sofia Vasiljevnës, mbi një kolltuk të ultë e të butë, qe ulur gjithashtu edhe Kolosovi që po përziente atë kohë sheqerin në filxhanin e kafesë që mbante në dorë. Përpara vetes, mbi tryezë, kishte një gotë me liqer.

Missi hyri në dhomën e të jemës bashkë me Nekludovin.

— Kur mamaja ta ndjejë veten të lodhur e t'ju dëbojë, ejani nga unë — tha ajo duke iu drejtuar Kolosovit dhe Ne-

kludovit me një ton miqësor e gazmor, sikur ndërmjet tyre të mos kish ndodhur asgjë. Pastaj, duke shkelur lehtë mbi qylymin e trashë e duke buzëqeshur, doli nga dhoma.

— E po, tungjatjeta i dashur! Uluni e na tregoni ç'kemi ndonjë të re — tha princesha Sofia Vasiljevna me buzëqeshjen e saj artificjale, por dhe kaq mjeshtërore, saqë nuk i linte gjë mangut një buzëqeshjeje te natyrëshme, duke zbuluar me këtë rast dhëmbët e saj të gjatë e të hijëshëm, të punuar me një mjeshtëri të rrallë, aq sa dukeshin sikur qenë të vërtetë. — Më thanë se jeni kthyer nga gjyqi shumë i mërzitur. Për njerëzit e ndjeshëm si ju, është e rëndë, e kuptoj — shtoi në frëngjisht.

— Ashtu vërtet — tha Nekludovi — të qëllon të shohësh dëndur se nuk... ndjen, me një fjalë se nuk ke të drejtë ta gjykosh atë tjetrin.

— Comme c'est vrai [1]) — ja bëri princesha, gjoja si e mahnitur nga mendimi i thellë që fshihej pas fjalëve të Nekludovit, por, në të vërtetë për t'i bërë qejfin këtij të fundit, ashtu siç bënte me të gjithë.

— Po, a s'më thoni, princ, ç'kemi ndonjë të re në lidhje me atë tabllonë tuaj? Nuk mund ta mirrni me mënd se sa shumë interesohem për të! — shtoi. — Sikur të mos kisha qenë kaq e pafuqishme, do të kisha kaluar patjetër ndonjë ditë andej nga ju.

— Kam hequr dorë prej saj — u përgjegj thatë-thatë Nekludovi, që atë ditë zbulonte me një kthjelltësi të jashtëzakonëshme gënjeshtrat që fshiheshin pas lajkave të princeshës e diktonte qartë shenjat e pleqërisë së maskuar në fytyrën e saj. Ai mundohej të tregohej i njerëzishëm, por më kot.

— Gabim, shumë gabim! E dini, vetë Repini më thoshte një ditë për të që është shumë i talentuar! — tha ajo duke u drejtuar nga Kolosovi.

«Si nuk ka turp që gënjen në këtë mënyrë!» — mendonte ndërkaq Nekludovi çehrengrysur.

Kur u bind se Nekludovi atë ditë nuk ishte në qejf dhe se, pra, ishte e pamundur ta tërhiqje në një bisedë të këndëshme e të mënçur, Sofia Vasiljevna u kthye nga Kolosovi dhe e pyeti ç'mendonte mbi një dramë të re që qe çfaqur aty para ca ditësh. Toni me të cilin ja bëri këtë pyetje, linte të kuptohej se përgjegja e Kolosovit do të hiqte nga

1) Sa është e vërtetë (frengj.)

mesi çdo dyshim dhe se opinioni që do të shprehej përmjet saj duhej pranuar si një e vërtetë që nuk mund të diskutohej. Kolosovi nuk foli mirë për dramën e, duke përfituar nga rasti, shprehu dhe mendimet e tij mbi artin. Princesha Sofia Vasiljevna mahnitej me vërtetësin'e arësyetimeve të tij, bënte aty-këtu ndonjë orvatje të pa vendosur për ta mprojtur autorin, por, aty-për aty, ose tërhiqej e kapitullonte pa kushte, ose ngutej të gjente një udhë kompromisi. Nekludovi vështronte e dëgjonte, por shikonte e dëgjonte të tjera gjëra, jo ato që ndodhnin atje përpara tij.

Duke ja vënë veshin herë Sofia Vasiljevnës, herë Kolosovit, Nekludovi vinte re, në radhë të parë, që Sofia Vasiljevna ashtu dhe Kolosovi, nuk interesoheshin as për dramën e as për njeri tjetrin dhe, në se flitnin ashtu me zjarr, flitnin vetëm e vetëm për të kënaqur atë nevojën fiziologjike të lëvizjes së muskujve të gjuhës e të fytit pas së ngrënit; ai vinte re, së dyti, që Kolosovi, me që kishte pirë vodkë, verë e liqer, ishte pak si i dehur, por jo ashtu i dehur siç dehen njerëzit që nuk e kanë zakon pijen, por, përkundrazi, si ata që janë dhënë pas alkoolit me kohë: ai nuk lëkundej, nuk thoshte ndonjë budallallëk, por prapë kuptohej se ishte në një gjëndje jo normale, në një gjëndje ekzitimi dhe ekzaltimi shpirtëror.

Së fundi, Nekludovi vinte re se princesha Maria Vasiljevna kthente kokën e shqetësuar në bised'e sipër nga dritarja, nëpërmjet së cilës kishin filluar të depërtonin rrezet e tërthorta të diellit në perëndim, që hidhnin një dritë të pa pëlqyer mbi rrudhat e maskuara të fytyrës së saj të fishkur.

— Kjo është shumë e vërtetë! — iu përgjegj ajo Kolosovit për diçka që ky i tha, e ndërkaq shtypi sustën e një zileje elektrike që ndodhej pranë divanit.

Atë çast doktori u ngrit në këmbë e doli nga dhoma pa u përshëndetur, si një njeri i shtëpisë. Sofia Vasiljevna e ndoqi me sy pa e ndërprerë sakaq bisedën.

— Të lutem, Filip, ma ul pak atë perden atje! — i tha ajo një lakejit bukurosh që hyri në dhomë porsa dëgjoi zilen, duke i treguar me sy një nga perdet e dritares.

— Thoni si të doni, por ka në të diçka mistike dhe, siç dihet, pa mistiçizëm nuk ka poezi — thoshte ajo duke ndjekur me të rreptë me njerin nga syt'e saj të zez çdo lëvizje të lakejit që po merrej atë çast me perden. — Misticizmi pa poezi, është bestytni, poezia pa misticizëm është prozë —

tha ajo me një buzagaz të trishtuar, pa i hequr ndërkaq sytë lakejit.

— Filip, jo atë perde, atë tjetrën tek dritarja e madhe! — tha me një zë të përvojtur Sofia Vasiljevna si e pikëlluar pa masë për mundimin që i kishin kusntuar ato fjalë. Pastaj, si për ta qetuar veten, ndezi një «Pahitos» të parfumuar dhe e shpuri në gojë duke e lëvizur dalngadalë dorën e saj të ngarkuar plot e përplot me unaza.

Filipi, një djalosh bukurosh, muskuloz e shpatullgjerë, bëri një reverancë të lehtë si për të kërkuar ndjesë e, duke shkelur butë mbi qylym, me këmbët e tij të fuqishme, me pulpa të spikatura, u afrua i bindur e i heshtur tek dritarja tjetër. Këtu, duke e kthyer kokën me zell të madh nga ana e princeshës, nisi ta ndreqte perden me merak që të mos dëpërtonte dot e të binte në fytyrën e saj asnjë rreze. Por edhe këtë radhë nuk bëri ashtu siç e kishte porositur zonja dhe, prandaj, Sofia Vasiljevnës iu desh ta ndërpriste përsëri, e pikëlluar, disertacionin e saj mbi misticizmin e ta korregjonte përsëri atë Filipin kokëtrashë e të pamëshirshëm që po e shqetësonte në një mënyrë aq mizore. Syt'e Filipit u përshkënditën për një çast me inat.

«Dreqi e merr vesh se ç'do ti!» — thotë ai me vete» — mendoi Nekludovi, duke e soditur me nge atë lojë. Por bukuroshi e trupmadhi Filip e maskoi menjëherë atë gjest padurimi e nisi të kryente i qetë urdhërin që i dha princesha Vasiljevna, ajo zonjë e rëndë e raskapitur, e pafuqishme e kallb.

— S'ka dyshim që teoria e Darvinit ka një thelb të vërtetë — tha Kolosovi duke u rehatuar në kolltukun e ultë ku kish zënë vënd e duke i hedhur princeshës Sofia Vasiljevnës një vështrim të përgjumur, — por, ama, e tepron. Po, po, e tepron.

— Po ju, princ, a besoni në trashëgiminë? — e pyeti princesha Sofia Vasiljevna Nekludovin që vazhdonte të rrinte i heshtur. Princeshës nuk i pëlqente aspak heshtja e tij, prandaj dhe ia bëri atë pyetje.

— Në trashëgiminë? — e përsëriti pyetjen Nekludovi. — Jo, nuk besoj — tha, sa për të dhënë një përgjigje, i harruar siç ishte atë çast pas disa figurave të çuditëshme që ngjalleshin vetvetiu n'imagjinatën e tij. Pranë bukuroshit e trupmadhit Filip të cilin ai e përfytyronte si një model të gjallë që pozon lakuriq në studjon e ndonjë piktori, fantazia i nxirrte përpara Kolosovin, lakuriq edhe atë, me një bark

të kërcyer që i përngjiste një karpuzi, me një kokë të shogur e me ca krahë pa muskuj si lozet e hardhijave. Përfytyronte ashtu në të turbullt edhe shpatullat e Sofia Vasiljevnës, por jo të mbështjellura në mëndafsh e në kadife, por ashtu siç duhej të qenë në të vërtetë. Të gjitha këto përfytyrime të çuditëshme i ngjallnin atij në zemër një tmerr të pashpjeguar e ai bënte çmos që t'i largonte.

Sofia Vasiljevna i hodhi një vështrim depërtonjës.

— Nuk dua t'ju mbaj më gjatë se e di që Missi po ju pret — i tha — Ajo ka dëshirë t'ju ekzekutojë një pjesë të re që ka mësuar tani së fundit. . . Është një pjesë shumë interesante, nga Shumani.

«Ajo për këtë nuk më tha asgjë. S'e marr vesh përse kjo po më gënjen» — mendoi Nekludovi. Pastaj u ngrit e, si shtërngoi dorën e tejdukëshme, të thatë e të mbuluar me unaza të Sofia Vasiljevnas, doli jashtë.

Kur po dilte, në dhomën e pritjes, takoi Katerina Aleksejevnën që i tha menjëherë porsa e pa, në frëngjisht, si zakonisht:

— Me ç'po shoh, ajo detyra që u kanë caktuar në gjygj, u rëndoka shumë.

— Po, është e vërtetë. Më falni se unë sot jam pak si i mërzitur, dhe nuk dua aspak që t'u ndjell dhe juve mërzinë — tha Nekludovi.

— Ashtu? Po përse jeni i mërzitur?

— Më lejoni të mos ua them — u përgjegj ai, duke kërkuar ndërkaq me sy kapelen.

— Ah, po e harruat që dikur na predikonit se si njeriu duhet të thotë gjithmonë të vërtetën dhe se si na thatë dhe vetë një herë disa të vërteta të mëdha e të hidhura? Pse atëhere tani preferoni të heshtni?. . . A të kujtohet, Missi? — shtoi, duke iu drejtuar princeshës Korçaguin që u doli atë çast përpara dhe iu afrua.

— Atëhere qe ndryshe, se talleshim, e në tallje e sipër njeriu mund të thotë ç'të dojë. Po në realitet ne jemi kaq të këqij (të paktën flas për veten time), sa nuk kemi guxim ta shohim të vërtetën në sy, e aq më pak ta themi.

— Mos u mundoni të justifikoheni, por na thoni më mirë përse qënkemi kaq të këqij — tha Katerina Aleksejevna duke u argëtuar me atë lojë fjalësh, e gjoja pa e vënë re se Nekludovi fliste me tërë mënd.

— Është shumë keq për një njeri kur thotë se është i mërzitur — ndërhyri Missi — Unë, edhe po të jem e mër-

zitur, këtë nuk ia pohoj kurrë vetes e prandaj, mbase, edhe nuk mërzitem. Nejse, fundja, si të doni. Shkojmë atëhere në dhomën time. Do të mundohemi t'ua heqim me zor atë mauvaise hummeur [1]) që ju paska kllapitur sot.

Nekludovi provonte atë çast pak a shumë atë ndjenjë që duhet të provojë kali kur i vinë rrotull sa t'i gjejnë anën që t'i hedhin zgjedhën e ta ngarkojnë. Por atë ditë atij ajo zgjedhë i dukej e rëndë, si kurrë ndonjë herë tjetër. Prandaj lypi ndjesë e tha se kishte ngutë të kthehej në shtëpi. Kur u ndanë, Missi ia shtërngoi dorën më tepër nga ç'duhej.

— Mos harroni se ne jemi miqtë 'uaj — tha ajo — prandaj duhet t'i ndajmë bashkë të mirat e të këqijat. Do të vini nesër?

— Nuk e besoj — tha Nekludovi dhe, duke ndjerë se po skuqej duke i ardhur turp për të, apo mbase për veten e tij, u ngut të largohej.

— Ç'është kjo? Comme cela m'intrigue [2]), — tha Katerina Aleksejevna kur Nekludovi u zhduk. — Po do ta marr vesh patjetër si qëndron puna. Do të jetë, sigurisht, ndonjë affaire d'amour-propre: il est très susceptible, notre cher Mitja [3]).

«Plutot une affaire d'amour sale» [4]) — u mat të thoshte Missi dhe vështroi përpara saj me sy të fikur e me fytyrë të prishur, siç nuk i ndodhte kurrë kur takohej me Nekludovin. Për atë kalambur banal nuk ia tregoi Katerina Aleksejevnës, dhe u kufizua të përgjigjej:

— S'ke ç'i bën, secili nga ne ka ditë të mira, po ka dhe ditë të këqija.

«Mos, vallë, dhe ky do të më gënjejë? Pas tërë atyre që kanë ndodhur mes nesh, kjo s'është aspak korrekte nga an'e tij».

Sikur Missin ta pyesnin çfarë deshte të thoshte me fjalët: «Pas tërë atyre që kanë ndodhur mes nesh», ajo s'do të mund të përgjigjej me saktësi. Por, pamvarësisht nga kjo, ajo ndjente se kur me një buzëqeshje, kur me një vështrim, kur me një fjalë shkarazi e kur me ndonjë heshtje

---

1) Mërzi (frëngj.)

2) Sa kurioze që më bën (frëngj.)

3) Çështje sedre: është shumë i ndjeshëm ky Mitja yné (frëngj.)

4) Thuaj më mirë ndonjë çështje dashurie të ndyrë (frëngj.) — lojë fjalësh që s'mund të kthehet në shqip.

me vënd, ai, jo vetëm që ia kishte ngjallur e ja kishte ushqyer gjer atë ditë shpresat, por pothuaj i kishte premtuar se do të martohej me të. Kështu, ajo vazhdonte të besonte se ai ishte i saj dhe që të hiqte dorë prej tij kjo do t'ishte për të një gjë shumë e rëndë.

XXVIII

«Ç'turp e ç'ndoht!» — mendonte Nekludovi kur po kthehej me këmbë në shtëpi. Ndjenja e rëndë që e kish pushtuar nga biseda me Missin nuk e linte rehat. Ndjente se formalisht, nëqoftëse mund të shprehemi kështu, ai ishte shumë në rregull karshi saj. Dhe me të vërtetë nuk i kish thënë asgjë që mund ta lidhte me të e, pra, ishte i lirë të vepronte si të donte. Por prapë e kuptonte se gjer diku e kish lidhur veten, se diç i kish premtuar megjithëse atë ditë, më tepër nga çdo herë tjetër, e kishte patur të qartë se nuk mund të martohej me të kurrën e kurrës. «Ç'turp e ç'ndoht, ç'ndoht e ç'turp» — i përsëriste vetes pa rreshtur dhe jo vetëm lidhur me marrëdhëniet që kish patur me Missin por edhe për të gjithë jetën e tij në përgjithësi. Çdo gjë që e rrethonte i dukej e turpëshme dhe e ndytë. Dhe fjalët turp e ndoht s'iu hoqën nga goja gjersa kapërceu prakun e shtëpisë.

— Nuk do të ha darkë, — i tha Korneit që e ndoqi pas në dhomën e bukës, ku qenë shtruar e bërë gati takëmet e çajit. — Mund të shkoni.

— Si urdhëroni, — iu përgjegj Kornei, por nuk doli e nisi të merej me boshatisjen e tryezës. Nekludovi e vështronte Kornein me inat. N'atë gjëndje shpirtërore në të cilën ndodhej ai kishte nevojë të përmblidhej në veten e tij, por ja, si për inat, nuk e linin vetëm. Kur Kornei doli më në fund, Nekludovi u mat t'i afrohej samovarit e të mbushte vetë një filxhan çaji, por duke dëgjuar hapat e Agrafena Petrovnës, nxitoi të futej në dhomën e pritjes dhe e mbylli me të shpejt derën pas vetes që ajo të mos e vinte re. Dhoma në të cilën hyri ishte ajo ku aty tre muaj më parë kishte vdekur e ëma e tij: një sallë e madhe e ndriçuar nga dy llamba me reflektorë, njëra përpara portretit të t'et, tjetra përpara portretit të s'ëmës. Nekludovi solli ndërmënd po

dashur marëdhëniet që kish patur me t'ëmën dhe këto marëdhënie iu dukën se kishin qënë të pasinqerta e bile të pështira. Po, po, turp e ndoht edhe aty! Ju kujtua se kur ajo u sëmur ai kish dashur me gjithë shpirt që të vdiste. I thoshte vetes atëhere se kjo dëshirë kish lindur tek ai ngaqë nuk e shikonte dot duke vuajtur, por në të vërtetë ai që mërzitur nga lëngimi i saj i gjatë dhe pa shpresë.

— Nekludovi i hodhi një sy portretit me shpresë se do t'i sillte ndërmënd ndonjë kujtim të dashur nga e ndjera. Portreti ish vepër e një piktori të dëgjuar që kish marrë për punën e bërë pesëmijë rubla. E ëma e tij qe paraqitur aty si një zonjë e rëndë, veshur me një fustan kadifeje të zi e dekolté. Kuptohej që piktori e kish punuar veçanrisht me merak të madh pjesën e gjirit, brazdën mes gjive si dhe supet e qafën që kishin një bukuri me të vërtetë verbonjëse. S'kish dyshim, që kjo ishte një gjë e turpëshme dhe e ndytë. Kishte diçka që të revoltonte e të pështiroste në kulm në atë portret, ku e ëma e tij paraqitej si një femër gjysëm e zhveshur. Aq më i madh bëhej pështirimi kur sillje ndërmënd se si aty e tre muaj më parë, pikërisht në atë dhomë, ajo grua qe dergjur, katandisur kockë e lëkur si një mumje duke kundërmuar një erë të qelbur e të rëndë, që të therrte në hundë porsa shkelje në shtëpi. Atij i dukej se e ndiente akoma atë erë. Ju kujtua se si një ditë përpara se të vdiste, dora e saj e imët, e fishkur dhe e nxirë, preku dorën e tij të bardhë e të fuqishme dhe ajo, duke e vështruar në sy i tha: «Mos më gjyko, Mitja, për gjynahet që kam bërë». Dhe sytë e shplarë nga vuajtjet iu mbushën me lot. «Ç'ndoht!» — i tha ai dhe një herë vetes, duke vështruar atë femër gjysmë të zhveshur, me supet madhështore të mermerta, me doçkat e fryra, me buzët që buzëqeshnin ëmbël. Gjiri gjysmë i zbuluar në portret, i solli ndërmënd një grua tjetër të cilën ai e kish parë ca ditë më parë po aq të zhveshur. Kjo ishte Missi, që e kishte ftuar një mbrëmje në dhomën e saj vetëm e vetëm që ai t'i shikonte fustanin e ballos. Ai solli ndërmënd i pështirosur supet e krahët e saj, që s'kishin të sharë. Solli ndërmënd edhe të jatin e saj, njeri i vrazhdë e shtazor, katil e mizor dhe t'ëmën, një femër bel-esprit [1]) dhe moral prishur. Dhe të gjitha këto kujtime iu dukën të pështira. «Turp e ndohtë, ndohtë e turp» — i thoshte vetes — dhe asgjë tjetër».

---

1) I hollë nga mëndja (frëngj.)

«Jo jo, — mendonte — duhet të çlirohem, duhet të çlirohem patjetër nga të gjitha këto marrëdhënie të gënjeshtërta si me Korçaguinët ashtu dhe me Maria Vasiljevnën, ashtu dhe me trashëgimin e me çdo gjë tjetër që më ka mbajtur lidhur gjer tani. . . Dua të marr frymë lirisht. Do të dal jashtë shtetit, do të shkoj në Romë, do të merrem aty me kuadrin që kam nisur. . . — Por tek mendonte kështu iu kujtua se si talenti i tij qe i dyshimtë e ngeci një hop. — Nejse, s'prish punë, — vazhdoi — mjaft që ta ndjej veten të lirë. Ja, në fillim do shkoj në Kostandinopojë, kurse në Romë do të shkoj më vonë. . . Ja, sa të shkarkohem nga ajo dreq përgjegjësi që kam në gjyq, sa të sistemoj edhe atë punën me avokatin. . .»

Befas, me një gjallëri përfytyrimi të jashtëzakonëshme, iu duk se pa përpara vetes të pandehurën me syt'e zez vëngëroshë. Ah, si qante, si qante e mjera kur e dënuan! Nekludovi e shtypi me vrull cigaren, e shojti, ndezi me të shpejt një tjetër e, si brofi në këmbë, nisi të sillej lart e poshtë nëpër dhomë. Dhe menjëherë iu ngjallën një nga një në kujtesë të gjitha çastet që kishte kaluar me të. Iu kujtua takimi i tyre i fundit, epshi shtazor që e kish pushtuar dhe pakënaqësia e hidhur në mos gjetjen e lumturisë së shpresuar pas përmbushjes së epshit. Iu kujtua fustani i bardhë dhe fjongua e kaltërtë, iu kujtua edhe mesha e dytë e pashkës së madhe. «Jo, nuk mund të them se nuk e kam dashur! E kam dashur me tërë shpirt, me një dashuri të pastërt, atë natë dhe akoma më thellë e më mirë e kam dashur më parë, atëhere kur shkova tek tetot për të shkruar tezën e diplomës!» Kështu mendonte Nekludovi dhe e përfytyronte veten e tij ashtu si kish qenë dikur. Dhe, tek e kujtonte atë kohë, i dukej se e ndjente përsëri në shpirtin e tij atë freski djaloshare, atë hov rinor, atë gëzim të madh jete. Dhe një brëngë e pushtonte, e madhe, e hidhur. Ndërmjet Nekludovit, që kish qenë atëhere, dhe Nekludovit, që ishte tani, ai shihte një ndryshim shumë të thellë, po aq të thellë si ç ishte ndryshimi ndërmjet Katjushës në kishë dhe asaj prostitutës që kish harbuar me një tregëtar dhe e kish dënuar atë mëngjes në gjyq. Atëhere ishte një njeri i lirë e i gjallë përpara të cilit hapeshin horizonte të gjëra mundësirash pa fund, kurse tani e ndjente veten të burgosur pa shteg shpëtimi në rrjetën e një jete pa kuptim, pa qëllim, të një jete të vogël nga e cila s'kishte si të dilte, po as që deshte të dilte. Atë-

here ishte një njeri i drejtë, që thoshte gjithmonë të vërtetën e s'gënjente kurrë, kurse tani rronte në gënjeshtër, që zhytur kokë e këmbë në gënjeshtër, në më të tmerrshmen e gënjeshtrave, n'atë gënjeshtrën që ka zëvëndësuar tek të gjithë njerëzit të vërteten. Dhe nga ajo gënjeshtër s'dilej, të paktën kështu i dukej atij. Prandaj edhe ai që fundosur në llumin e saj përditë e më shumë e që mësuar e lezetuar me të. «Në ç'mënyrë — thoshte Nekludovi — do t'i pres marëdhënjet me Maria Vasilievnën dhe me të shoqin e saj e të kem sy e faqe pas kësaj t'i dalë përpara atij edhe fëmijëve të tij? Në ç'mënyrë do të mund t'i këpus marëdhënjet me Missin pa qenë i detyruar të përdor përsëri gënjeshtrën? Në ç'mënyrë do të mund t'i shpëtoj kundërthënies flagrante që ka nga njera anë ndërmjet pohimit se prona private mbi tokën është e paligjëshme dhe nga ana tjetër çfrytëzimit të pronave të trashëguara nga nëna? Në ç'mënyrë do të mund ta laj gjynahun që kam ndaj Katjushës? Dhe duhet ta laj patjetër, në dua të jem i drejtë. Unë nuk mund të braktis një grua, të cilën e kam dashur, nuk mund ta flë mëndjen duke i thënë vetes që mjaft bëra për të gjersa i zura një avokat që do ta shpëtojë nga katorga të cilën ajo as që e meriton, duke qënë e pafajëshme. Nuk është e mundur që ta shlyej këtë faj me të holla, ashtu si pandehja atëhere kur, duke i dhënë njëqind rubla, mendoja se isha në rregull».

Ai e përfytyroi të gjallë çastin kur ndoqi me vrap Katjushën në koridor, kur i futi me zor në grusht ca të holla, kur iku dhe e la. «Ah, ato të holla! — ja bëri duke sjellur ndërmënt atë çast e, bashkë me të, tmerrin dhe pështirimin që kish provuar dikur. — Ah, ah! Çfarë poshtërsije! — iu shkreh me zë të lartë vetes po ashtu si i qe shkrehur dikur. — Vetëm një njeri i poshtër dhe maskara do ta bënte atë që bëra unë! Dhe ai njeriu i poshtër, ai maskarai jam unë! — tha me zë të lartë. — Mos vallë, me të vërtetë — tek vërtitej ashtu lartë e poshtë nëpër dhomë ai ndali një hop — mos vallë me të vërtetë unë jam një njeri i poshtër? Je, si s'je! — iu përgjegj aty për aty një zë përmbrënda tij — Po s'është vetëm rasti i Katjushës. Nuk ka qenë e ultë, nuk ka qenë e poshtër edhe sjellja jote karshi Maria Vasilievnës dhe të shoqit të saj? — vazhdonte ta qortonte ai zeri përmbrënda tij. — Po ashtu dhe qëndrimi karshi pronës që ke trashëguar? Nën pretekstin se të hollat janë të nënës tënde e jo të tuat, përfiton t'ardhurat e një pasu-

rie që ti vetë e ke shpallur të paligjëshme. Dhe dëshmi e gjallë e poshtërsisë tënde është më në fund jeta e çmendurë, jeta prej paraziti që po bën prej kohësh. Dhe kulmi, ajo që i ve kapakun të gjithave, mashtrimi i ndytë i Katjushës. I poshtër, maskara! Ata (njerëzit) mund të të gjykojnë si të duan, ata fundja ti edhe mund t'i gënjesh, por veten, jo, veten s'e gënjen dot!».

Këto mendime e shtynë Nekludovin të kuptojë befas që ndoshta që i ngjallnin njerëzit kohët e fundit e, veçanërisht atë ditë, princi, Sofija Vasilievna, Missi, Kornei e të tjerë duhej ta kërkonte në veten e tij. Dhe çudi, në këtë ndjenjën e pranimit të poshtërsisë së tij kishte për të diçka si një kënaqësi të sëmurë që e gëzonte dhe e qetësonte.

S'ishte e para herë që Nekludovit i ndodhnin të tilla kriza ose, siç i quante ai, të tilla «spastrime shpirtërore». Një spastrim shpirtëror ishte në gjuhën e tij një gjëndje shpirtërore gjatë së cilës njeriu, duke vënë re një ngadalësim dhe herë-herë një ndalesë në procesin e zhvillimit të jetës së tij të brendëshëm, përpiqej ta spastronte nga shpirti i tij tërë llumin moral që, duke u grumbulluar pak nga pak atij bëhej shkak i ngadalësimit apo i ndalesës.

Pas çdo krize, Nekludovi hartonte ca rregulla jete të cilave zotohej t'u përmbahej gjer në fund, mbante një ditar e niste një jetë të re të cilën kishte shpresë të mos e ndryshonte më kurrë. Por kurdoherë jeta e rrëmbente me ngasjet e saj dhe ai u dorëzohej atyre në një mënyrë të pavetëdijëshme e kridhej përsëri në llumin e mëparshëm.

Kështu kishte ndodhur me të disa herë. Krizën e parë e kishte patur atë behar që shkoi tek tetot për pushime. Nga të gjitha zgjimet e ndërgjegjes së tij të topitur, ky kishte qenë më i bujëshmi e më i pasuri në pasoja. Kriza e dytë koincidoi me braktisjen e karierës civile, atëhere kur ai, duke dashur të bënte fli jetën e tij për një çështje të drejtë, hyri gjatë luftës në radhët e ushtërisë. Por këtu shpirti i tij u ndoht shumë shpejt. Kaloi më në fund një krizë të tretë kur dha dorëheqjen nga ushtëria dhe, si doli jashtë shtetit, nisi të merrej me pikturë.

Që atëhere kishte kaluar një kohë e gjatë pa «spastrime» dhe prandaj llumi që qe grumbulluar në shpirtin e Nekludovit, nuk kish qenë kurrë herë tjetër kaq i madh dhe kurrë herë tjetër nuk kishte qenë kaq i rreptë konflikti ndërmjet kërkesave të ndërgjegjes së tij dhe jetës

që ai bënte në të vërtetë. Hendeku mes tyre qe kaq i thellë, sa ai e shihte dhe tmerohej.

Po, ai hendek qe kaq i thellë, dhe shpirti i tij qe ndyrë kaq shumë, sa në fillim ai i humbi shpresat në mundësinë e një spastrimi. «Kaq herë je orvatur të përsosesh e të bëhesh më i mirë dhe s'ja ke dalë dot mb'anë, — fliste përmbrënda tij zëri i ngasjes djallëzore. — Kot e ke që mundohe! — i thoshte ai zë. Por qenia e lirë, qenia shpirtërore, që është thelbi i vërtetë, i pastër, i fuqishëm e i përjetëshëm që rron tek secili nga ne, qe zgjuar tanimë tek Nekludovi. Dhe ai nuk mund të mos i besonte asaj. Sado i madh që ishte ndryshimi ndërmjet njeriut që ai ishte në të vërtetë dhe atij që donte të ishte, për atë qënien shpirtërore që u zgjua tek ai, çdo gjë ishte e mundur.

«Do ta çjerr këtë gënjeshtër që më rrethon, që më lidh, sikur ç'të dojë le të bëhet, do ta flas të vërtetën e do ta bëj! — i tha i vendosur vetes Nekludovi me zë të lartë. — Do t'i flas hapur Missit, do t'i them që jam një njeri i çthurur, se nuk mund të martohem me të dhe se i kam dhënë një shqetësim të kotë; do t'i them Maria Vasilievnas (të shoqes së marshallit të fisnikërisë). . . Jo, asaj s'është nevoja t'i them asgjë, po do t'i them të shoqit të saj që unë jam një horr dhe se e kam gënjyer. Me pronat do të veproj ashtu siç do të jetë më e drejtë që të veproj. Do t'i them asaj, Katjushës, që unë jam një njeri i poshtër, që jam fajtor përpara saj dhe se do të bëj ç'të jetë në dorën time që t'ja lehtësoj fatin. Po, do ta takoj dhe do t'i kërkoj ndjesë. Po, do ti kërkoj ndjesë edhe do ti lutem, në gjunjë, si fëmijë, që të më falë. . . Dhe po të jetë nevoja. . . do të martohem me të!»

Ai u ndal, i bashkoi duart përpara në krahëror ashtu siç bënte dikur kur ishte i vogël, i ngriti sytë lart dhe bëlbëzoi duke i folur dikuj:

— O perëndi ndihmomë, mësomë, hyr në trupin tim e në shpirtin tim e spastromë e dëbo nga unë çdo frymë ligësie!

Ai falej e i lutej zotit që ta ndihmonte, që të hynte tek ai e ta spastronte dhe ndërkaq ajo, për të cilën ai lutej, u bë. Zoti, që rronte tek ai, u zgjua. Ai ndjeu se bëhej edhe vetë një zot e ndjeu sakaq jo vetëm lirinë e jetës, gjallësinë e gëzimin e saj, por edhe epërsinë e pakundërshtuar e të plotëfuqishme e së mirës mbi të ligën. Ai

ndjente se ishte i zoti të bënte tani edhe atë më të mirën vepër që mund të bënte një njeri.

Sytë iu mbushën me lot kur ja pohoi këtë vetes, qenë lot gëzimi që derdheshin për të festuar zgjimin e qënies shpirtërore që kish fjetur tek ai vite me radhë, dhe lot ngashërimi për veten e tij, për shpirtgjërësinë e tij.

Afshe të nxehta i hipën në tytyrë. Ju afrua dritares dhe e hapi. Dritarja shikonte nga ana e kopshtit. Nata ishte e qetë, e freskët dhe me hënë. Dëgjohej herë pas here kërkëllima e një karroce në rrugë, pastaj pllakosi një heshtje e asgjë më nuk pipëtiu. Drejt, nën dritare dukej hija që lëshonin degët e një plepi të lartë e të zveshur mbi rërën e sheshit aty poshtë. Dalloheshin shkoqur në atë hije dhe ravizimet më të holla të degëve. Nekludovi soditi kopshtin e ndriçuar nga hëna, çatinë, hijen e plepit dhe thithi ajrin e freskët, gjallëronjës që vinte nga jashtë.

«Oh, sa mirë, o zot, sa mirë, sa mirë!» — thoshte me vete për atë që kish ndodhur në shpirtin e tij.

XXIX

Masllova u kthye në qelinë e saj në burg vetëm aty nga ora gjashtë e mbrëmjes. E ndjente veten të lodhur, e pamësuar siç ishte të bënte pesëmbëdhjetë vjorsta udhë pa pushuar. Këmbët i dhimbnin dhe kishte shumë uri.

Në gjyq, kur kishte parë rojet që i rrinin pranë duke ngrënë vezë të ziera me bukë, i kishte shkuar lëng nga goja dhe e kishte ndjerë më tepër urinë, por prapë e kishte përmbajtur veten dhe s'u kishte kërkuar. Pas tri orësh, as që i shkonte më ndërmënd për të ngrënë nga dobësia e madhe që ndjente në trup. Në këtë gjëndje ndodhej kur dëgjoi vendimin e gjyqit që erdhi për të fare i papritur. Në fillim iu duk se i kishin bërë veshët, nuk u besoi atyre që dëgjoi e s'i mbushej mëndja që e kishin dënuar me punë të detyruar. Por, kur vuri re fytyrat e qeta të gjykatësve e të anëtarëve të zhurisë, që e kishin pritur këtë lajm si krejt të natyrshëm, u revoltua dhe thirri sa gjëmoi tërë salla duke thënë se ishte e pafajëshme. Kur vuri re që edhe britma e saj u prit, si diçka që pritej e parashikohej por që nuk mund të ndryshonte asgjë, kuptoi më në fund se duhej t'i nënshtrohej padrejtësisë së tmerrshëme që kishin kryer

kundër saj dhe qau. Habitej sidomos sepse i dukej e pamundur që burrat, pikërisht ata burra të rinj e jo pleq, që e shikonin përherë me aq mirëdashje, ta dënonin tani në një mënyrë aq mizore. Në dhomën e të pandehurve, ku kishte pritur bashkë me shokët fillimin e gjyqit, ashtu si edhe në pushimet ndërmjet seancave, asaj i kishte rënë në sy se si këta burra kalonin pranë derës, apo futeshin në dhomë, gjoja me ndonjë punë, por në të vërtetë vetëm që t'i hidhnin një sy. E ja, befas, pikërisht këta burra, po të tjerë, mblidhen, e akuzojnë dhe e dënojnë, kushedi përse e padrejtësisht, me punë të detyruar. Në fillim ajo qau nga inati, por pastaj heshti e s'u ndje më duke pritur si e mpirë në dhomën e të pandehurve rojet që do ta shoqëronin përsëri në burg. Tani kishte vetëm një hall: të ndizte një cigare. Në këtë gjëndje ndodhej Masllova kur suallën aty edhe të dy të pandehurit e tjerë, Boçkovën dhe Kartinkinin. Boçkova nisi menjëherë të grindet me Masllovën e t'i këpusë asaj njëmijë të shara.

— Hë, e pe? Ta rregulluan paq! Gjidi bushtër e sokaqeve! Mirë ta bënë, ashtu e doje ti! Kur të vesh në katorga, s'do të ma dredhësh dot më bishtin, se atje ta shkurtojnë!

Masllova rrinte me duart mbështjellur në mëngët e kapotës dhe, me kokën ulur poshtë, vështronte pa lëvizur nja dy hapa para saj gjurmat e këmbëve me baltë mbi dysheme. Herë-herë lëvizte buzët e thoshte e lodhur:

— Ç'kini që më ngisni? Unë s'po ju ngas. . . Unë s'po ju ngas, ju pse më ngisni?. . .

Pastaj Kartenkinin dhe Boçkovën i larguan që andej dhe Masllova mbeti vetëm. Në këtë kohë e sipër, roja iu afrua e i dha tri rubla duke e pyetur:

— Ti je Masllova?. . .

Masllova pohoi me kokë.

— Na, merri këto, — vazhdoi roja e i dorëzoi të hollat. — I ke nga një zonjë.

— Nga cila zonjë?

— Meri e mos u ndiej, s'kam kohë të merrem me ty.

Të hollat ja dërgonte Kitajeva, padrona e shtëpisë publike, ku Masllova kish punuar. Duke dalë nga gjyqi, ajo e kish pyetur ftuesin a mund t'i dërgonte Masllovës ca të holla dhe, mbasi ky nuk i kish sjellur ndonjë pengesë, zonja, si kish hequr dorashkat prej kamoshi, duke çkopsitur një e nga një kopsat që i shtërngonin dorën e bardhë e të

shëndoshë, nxori nga xhepi i fustanit të mëndafshtë një portofol, nga ata të modës së fundit, dhe zgjodhi ndër një tok kuponash, të porsa prerë nga biletat e myshterinjve të saj, një kupon prej dy rubla e pesëdhjetë kopejkë. I shtoi dhe një grivenik [1]), pastaj edhe një tjetër dhe ja dha të gjitha këto ftuesit. Ftuesi i bëri zë rojës dhe i dorëzoi të hollat në sy të Kitajevës.

— Ju lutem ja jepni në dorë, — e porositi Karolina Albertovna rojen.

Roja e ndjeu veten të fyer për këtë mosbesim, prandaj edhe u suall aq i rreptë dhe harbut me Masllovën.

Masllova u gëzua shumë për të hollat, se me to mund të plotësonte dëshirën e vetme që kishte tani.

«Kam hall sa të gjej ndonjë cigare, pastaj s'kam gajle» — mendonte e burgosura dhe asnjë mendim tjetër nuk ja vriste më tepër trurin e saj të lodhur se sa mendimi i cigares. Epshi i duhanit, që e kishte pushtuar, ishte kaq i madh sa e kafshonte ajrin si e etuar sa herë që nuhaste në të erën e tymit që shpëtonte nga dyert e dhomave e qarkullonte në koridor. Por iu desh të priste akoma për një kohë të gjatë, se sekretarit, i cili do të jepte urdhër ta shpinin përsëri në burg, s'po i binte në mënd fare për të pandehurit, i zhytur siç ishte në një bisedë shumë të zjarrtë me njerin nga avokatët mbi atë artikullin e ndaluar. Disa burra, ndër të cilët edhe ca oficerë, hynin e dilnin, edhe pas gjyqit, në dhomën ku ndodhej e pandehura e bukur e, si e përpinin me sy, diç pëshpërisnin mes tyre. Por ajo tani as që i vinte re fare.

Më në fund, aty nga ora pesë, erdhi urdhëri që të pandehurit të largoheshin nga gjyqi. Rojet, djaloshi nofullgjerë nga Nizhni Novgorodi dhe ai tjetri nga Çuvakiia, e vunë përsëri Masllovën në mes e duallën jashtë bashkë me të nga një derë e pasme. Tek dilnin, ajo u dha njëzet kopejka, duke iu lutur që t'i blinin një bukë dhe një paketë me cigare. Cuvakasi vuri buzën në gaz, mori të hollat e tha:

— Mirë, po t'i blejmë.

Dhe ja b'eu vërtet, ndershmërisht, duke ja kthyer kusurin gjer në centim.

Të burgosurve u ndalohej të pinin duhan rrugës, kështuqë Masllova s'e ndezi dot cigaren dhe s'e shoi epshin që e mundonte gjersa arriti në burg. Kur, e shoqëruar nga

---

1) monedhë argjëndi prej dhjetë kopejkash.

të dy rojet, po i afrohej derës së burgut, u ndesh në ndo njëqind të arrestuar që porsa i kishin prurë aty me tren.

Të arrestuarit, ca me mjekër, ca pa mjekër, ca pleq e ca të rinj, ca rusë, ca nga krahinat jo ruse e ca me kokën rruar përmes, tringëllinin prangat që iu shtrëngonin këmbët dhe e mbushnin vëndin me pluhur, me rraptimën e hapave, me zhurmën e bisedave të tyre të çthurura dhe me kundërmimin e athët që u vinte nga trupat e dirsura. Që të gjithë, duke kaluar pranë Masllovës, ja ngulnin sytë me epsh të madh dhe kish ndërmjet tyre edhe nga ata që, me fytyra të ndezura nga dëshira, i afroheshin dhe e shtynin.

— E mirë, për perëndi, s'ka të sharë! — u hodh e tha njeri.

— Zonjushë, nderimet e mia! — i tha një tjetër duke i shkelur synë.

Një i tretë, me kokën rruar dyst nga pas, pa mjekër por me një palë mustaqe që i nxinin mbi faqe, duke u penguar në hekurat që i tringëllinin, i vajti pranë dhe e përqafoi.

— Moj po si, nuk më njeh? Hajt, hajt, leri nazet! — iu shkreh ai me të thirrur ndërsa i kërcëllitnin dhëmbët e i përshkënditeshin sytë kur ajo e shtyu dhe e zmbrapsi.

— Hy, qelbanik, ç'bën ashtu? — i foli atë çast ndihmës-drejtori i burgut që i doli nga pas e iu afrua.

I arrestuari u kuspullos si i zënë në faj dhe u ngut të zmbrapsej për t'u bashkuar me shokët. Ndihmës-drejtori iu shkreh atëhere Masllovës:

— Po ti këtu?!

Masllova deshte t'i përgjigjej se po kthehej nga gjyqi, por ishte kaq e lodhur sa që përtonte të fliste.

— Nga gjyqi, fisnikëria juaj, nga gjyqi! — tha nga të dy rojet ai më i vjetri, duke çarë rrugën përmes turmës, që ngushtohej në derën e burgut e duke nderuar me dorë.

— E po, atëhere, ç'prisni? Dorëzojeni ku kini për ta dorëzuar! Maskarallëk!. . .

— Si urdhëroni, fisnikëria juaj!

— Sokollov! Merreni në dorëzim! — thirri nën drejtori.

Përgjegjësi i ndërrimit të rojeve u afrua dhe, i zymtë e me të rreptë, i vuri dorën Masllovës mbi sup, i bëri shënjë me kokë dhe e hoqi pas në koridorin e grave. Si mbrrijtën në koridor, Masllova iu nënështrua një kontrolli

të imtë dhe, si nuk iu gjënd asgjë (paketën e cigareve ajo e kish fshenur brënda në bukë) e mbyllën përsëri në qelinë, ku kishte qenë atë mëngjes para se të dilte në gjyq.

XXX

Qelia e Masllovës ishte një dhomë e gjatë nja nëndë arshina [1]), rreth shtatë arshina e gjerë, me dy dritare, me një sobë të rjepur dhe me ca shtretër me dhoga të rralla që zinin më tepër se dy të tretat e vëndit. Në mes, përballë derës, qe varur një ikonë e lerosur dhe e vjetëruar; ngjitur me të qe ndezur një qiri; më poshtë, nën të, qe vendosur një tufë me lule që kishin një gisht pluhur sipër. Pas derës, në të majtë, mbi një vënd të nxirë të dyshemesë, kishte një shportë plehrash, që e mbushte tërë dhomën me një erë të qelbur. Në kohën kur hyri Masllova, kontrolli i të burgosurave që bëhej çdo mbrëmje, porsa kishte marrë fund, dhe gardiania i hodhi çelësin derës, e siguroi mirë, siç bënte përnatë.

Në atë dhomë banonin pesëmbëdhjetë vetë: dymbëdhjetë gra e tri fëmijë.

Akoma nuk qe ngrysur mirë dhe vetëm dy nga gratë qenë shtrirë mbi shtretërit e tyre me dërrasa, anës së murit. Njera syresh, që flinte nat'e ditë me kokën të mbu'uar me kapotë, ishte një budallaçkë, që e kishin futur brënda se e kishin gjetur pa dokumenta. Tjetra ishte një grua me fytyrë të hequr nga veremi që nuk flinte, por rrinte e shplodhej shtrirë, me kapotën mbledhur shuk nën kokë e me sy të çakarritur. Që të mos kollej, e mbante gojën mbyllur dhe mundohej ta përmbante pështymën që i gudulis-te gërmazin e i rridhte herë-herë jashtë. E kishin futur në burg p'r vjedhje. Nga gratë e tjera, veshur që të gjitha me ca këmisha të gjata prej pëlhure të trashë e t'ashpër, disa qenë ulur mbi shtretërit e qepnin, të tjerat qëndronin në këmbë, përpara dritares, dhe bënin sehir të arrestuarit që ndodheshin poshtë, në oborr. Midis tri grave që qepnin, ishte dhe plaka që e kishte këshilluar atë mëngjes Masllovën para se të shkonte në gjyq. E quanin Korobleva. Kishte një fytyrë tërë rrudha, një gushë që i varej e fllashkët nën

1) arshinë: masë gjatësie baraz me 0,71 m.

mjekër dhe qe e lartë me shtat, e fortë dhe e shëndoshë. Flokët, të kuqërremë e të përthinjur aty-këtu mbi tëmtha, i mbante mbledhur në një kosë të trashë e të shkurtër mbi zverk. Në mes të faqes i nxinte një nishan i madh me qime. Qe dënuar me punë të detyruar, sepse kishte vrarë të shoqin me sëpatë një ditë që e pat zënë tek mundohej të çnderonte të bijën. Në burg e kishin caktuar si kujdestare të qelisë. Të burgosurat, për ndonjë nevojë si raki apo ndonjë gjë tjetër, i drejtoheshin kurdoherë asaj. Tani kishte vënë syzat e qepte, duke e mbajtur gjilpërën fshatarçe, me të tre gishtërinjtë e me majën kthyer për nga vetja. Pranë saj rrinte e qepte një thes prej pëlhure të trashë edhe një grua e shkurtër, hundë-krrute, me një fytyrë të zeshkët, me ca sy të vegjël, të zes e të butë, që s'rrinte dot një minutë pa folur. Dikur kishte punuar si rojtare në një stacion treni por, pas një fatkeqësie që i kishte ndodhur trenit për fajin e saj, mbasi kishte harruar t'i dilte atë ditë me flamur në dorë, siç ishte rregulli, e kishin pushuar nga puna dhe e kishin hedhur në gjyq, duke e dënuar me tre muaj burg. E treta nga ato që qepte quhej Fedosja ose Feniçka, siç i thërrisnin shoqet. Ishte një vajzë e hijëshme dhe fare e re, e bardhë, faqekuqe, me sy të kaltër e të kthjellët fëminor, me dy bishtaleca të gjata e të kuqërreme që ja stolisnin nga të dy anët kokën e vogël si një kurorë. Mbahej në burg për një tentativë helmimi kundër të shoqit. Kjo kishte ndodhur fill pas martesës, kur Feniçka s'ishte akoma as gjashtëmbëdhjetë vjeçe vajzë. Por gjatë tetë muajve pas kapjes në faj, në pritje që të gjykohej, ajo, jo vetëm që ishte pajtuar me të shoqin, por qe dashuruar kaq tepër pas tij saqë, kur erdhi koha për të dalë në gjyq, të dy bashkëshortët duheshin mes tyre me gjithë zemër. Por, megjithatë, gjyqi e kishte gjykuar Fedosjen me të gjithë rreptësinë që parashikonin nenet e paragrafet e kodit, sikur gjatë kësaj kohe të mos kish ndodhur asgjë, pa marrë parasysh lutjet dhe përpjekjet ngulmonjëse të bëra nga ana e të shoqit, të vjehrit, e sidomos të vjehrës, që e donte me kokë, për ta çfajësuar e për të kërkuar anullimin e atij vendimi të egër, që e dënonte me internim e me punë të detyruar në Siberi. Përherë e qeshur, zemërmirë dhe e dashur, Fedosja ishte shoqja më e ngushtë e Maglovës. ajo që i rrinte përherë afër, ajo që më tepër nga të gjithë përkujdesej për të dhe ja qante hallin. Pa ndonjë punë në dorë, rrinin mbi shtrat edhe dy gra të tjera. Njera, një

grua në të dyzetat, kishte një fytyrë të zbetë e të thatë që ruante akoma, ndonse e fishkur, gjurmat e një bukurie të madhe të perënduar. Në prehër mbante një foshnje dhe i jepte të pinte nga gjiri që e kish të bardhë e të gjatë. Në fshatin e saj kish ndodhur një katrahurë. Fshatarët qenë ngritur kundër stanovojt dhe kishin vënë dorë mbi të për punë të një rekruti të cilit, siç e mendonin ata, nuk i takonte të thirrej ushtar. Gruaja, që e kishte nip rekrutin, nuk e kish lënë t'ja merrnin se i kish zënë rrugën kalit dhe e kish kapur nga frerët. Pikërisht, për këtë dhe e kishin dënuar. Tjetra ishte një plakë, jo dhe aq e lartë me shtat, tërë rrudha në fytyrë dhe e qeshur, me flokë të thinjura, e kërrusur dhe me gungë. Plaka rrinte pranë sobës dhe bënte gjoja sikur mundohej të zinte një çilimi si nja katër vjeç, me kokën qethur toç e me një bark shumë të madh për moshën e tij. Spurdhjaku, karkacul, vetëm në këmishë, i shkonte vrapthi fare afër e gjithë përsëriste me çapkënllëk duke ja plasur gazit: «Ja e sheh, s'më zure dot!» Plaka, që akuzohej për djegje bashkë me të birin, i hiqte vuajtjet e burgut me durim të madh dhe, në mërzitej herë-herë, kjo ndodhte kur kujtonte djalin, në burg dhe ay, dhe plakun që kish mbetur fillikat pa njeri që ta shikonte, ta lante e të mos e linte «ta hanin krimbat», siç shprehej plaka.

Veç këtyre shtatë grave, që përmëndëm, ndodheshin n'atë qeli edhe katër të tjera që qëndronin në këmbë përpara dritares e që, me duar kapur pas hekurave, përpiqeshin të merreshin vesh me fjalë e si të mundnin me ca të arrestuar që kalonin atë kohë nëpër oborr. Të arrestuarit ishin po ata që kish ndeshur Masllova tek dera e burgut kur qe kthyer nga gjyqi. Njera nga gratë, që ndodhej në burg për vjedhje, ishte e madhe për nga trupi dhe e mbushur, por mishërat i vareshin nga të gjitha anët, të buta e të flashkëta. Flokët i kishte të kuq, fytyrën të verdhë si në të bardhë mbuluar me quka, krahët të trashë e të fuqishëm. Jaka e këmishës, zbërthyer gjer poshtë, i zbulonte një gushë të gjerë e të dhjamur. Ajo çfrynte me zë të lartë nga dritarja një lumë fjalësh të ndyra. Në krah të saj qëndronte një grua e zeshkët që, po ta gjykoje nga trupi, nuk i jepje as dhjetë vjeçe, se dukej tamam si ndonjë vajzë e vogël jo vetëm nga shtati, por edhe nga lëvizjet. Kishte një trup kaba që e rrotullonte me njëmijë kujdesje sikur trëmbej se mos i thyhej, një kurriz të gjatë e të thatë dhe dy këmbë kaq të shkurtëra, nuk binin në sy fare. Faqet i kish të kuqe,

sytë të zez e të çaplyer dhe buzët të trasha e të shkurtëra, i zbulonin, kur qeshte, një sërë dhëmbësh të kërcyer përpara. Ajo qeshte me të prera sikur angurinte duke ndjekur, shumë e kureshtur, ato sa ndodhnin atje poshtë, n'oborr. E thirrnin «Bukuroshja» si për të vënë në dukje pispillosjen e saj të tepruar edhe aty brënda në burg. E kishin arrestuar për vjedhje e për djegje me paramendim. Prapa saj, me një këmishë të murme e shumë të ndytë në trup, qëndronte një grua thatane, me ca rrëmba damarësh mavi që i dalloheshin çkoqur nën lëkurë, me një bark të këcyer për hata nga barra e me një pamje të tmeruar. Mbahej në burg se, në një vjedhje që ishte bërë, i kishte strehuar hajdutët në shtëpi të saj. Rrinte e heshtur por tundte kokën tërë kohës si për të aprovuar ato sa ngjisnin poshtë në oborr e qeshte me duf. E katërta nga gratë që qëndronin tek dritarja, ishte një fshatare shpatullgjerë, me kokërdhokët e syve të këcyer, me një fytyrë babaxhane, arrestuar se kish shitur alkol pa leje. Ishte e ema e çamarrokut, që luante me plakën, si edhe i një vajze të vogël, nja shtatë vjeçe, të cilën, bashkë me djalin, e kishte marrë me vete në burg duke mos patur se kujt t'ja linte. Vështronte edhe ajo nga dritarja duke punuar me të dy duart shtizat, por, ndryshe nga të tjerat, shtrëmbëronte buzët e pështirosur dhe mbyllte sytë për çdo fjalë të ndytë që vinte nga poshtë. E bija, një vajzë nja shtatë vjeçe, me ca flokë të bardha të lëshuara, duke u kapur me doçkën e saj të zbetë pas fustanit të gruas flokëkuqe me quka, dëgjonte, pa lëvizur qepallat, fjalët e ndyta që shkëmbenin gratë me të arrestuarit. Pastaj i përsëriste fjalët një nga një, me zë të ulët, sikur përpiqej ashtu t'i ngulisnte mirë në kokë që të mos i harronte. E arrestuara e dymbëdhjetë ishte e bija e një dhjaku, që kish mbytur në pus doçin që kish patur me një të panjohur. Shtatlartë dhe e hijëshme, me ca flokë të shpuputura që i shpëtonin nga gërsheta e shkurtër por e trashë dhe e kuqërreme mbi zverk, i mbante sytë përherë të çaplyer e të palëvizur, sikur diç hetonte me ngulm në mapësirë. Nuk bënej fare merak për ato sa ndodhnin rreth saj, ecte zbathur duke patur në trup vetëm një këmishë të murme e të ndytë e sillej lart e poshtë nëpër rripin e ngushtë mes shtretërve. Duke u kthyer pas me një lëvizje të prerë sa herë që arrinte murin.

XXXI

Kur dera u hap dhe hyri Masllova, të gjitha vështrimet u drejtuan nga ajo. Bilé dhe bija e dhjakut u ndal një hop, ngriti vetullat dhe i nguli sytë të porsaardhurës. Por, pastaj, pa hapur gojë, vazhdoi përsëri udhën me hapin e saj të madh e të vendosur. Korableva e nguli gjëlpërën në pëlhurën e trashë të thesit që kishte në dorë dhe i ktheu me qortim sytë përmes syzave për nga Masllova.

— Ah, me të shkretën! Po si, u ktheve? Dhe unë që e kisha bërë të mbaruar këtë punë. Do ta nxjerrin, thosha, se s'ka se si. Po, duket, ta ngopën edhe ty, moj bijë! — tha me zërin e saj të ngjirur e të trashë, pothuaj si zë burri.

Ajo i hoqi syzat dhe e la thesin e gjëlpërën mbi shtrat.

— Që ta marrësh vesh ti, moj dallandyshezë, që kur u nise e shkove sot në gjyq, unë me teton, muhabetin tënd kishim në gojë. E, që thua, na shkonte mëndja se mbase që sot do të të nxirrnin. Se këto punë kanë bërë vaki, kanë bërë posi! Dhe sos që i nxjerrin nga burgu, por u japin edhe para, — filloi të fliste menjëherë, me atë zërin e saj të hollë, rojtarja e trenit. — Po ç'e do, na doli ndryshe. S'e pikasëm dot. Duket kështu e nisi i madhi e kështu e bitisi! — e mbylli ligjërimin e saj kumbonjës rojtarja e u hoq mënjanë.

— Vërtet u dënuan? — pyeti Fedosja duke e vështruar Masllovën si me të qarë, me sytë e saj të kaltërt fëminorë, ndërsa fytyra e qeshur dhe e njomë iu rrudh.

Masllova nuk u përgjegj dhe shkoi e ndënji e heshtur në vëndin e saj, që vinte i dyti nga qoshja, pranë Korablevës.

— Ta dija, nuk do kisha ngrënë — tha Fedosja duke u ngritur në këmbë e duke iu afruar Masllovës.

Masllova nuk foli, por vuri bukën mbi kokë të krevatit e nisi të zvishej: hoqi kapotën me pluhur dhe rizën që i mbulonte flokët e zez kaçurel dhe u ul.

Plaka gungaçe, që luante me çunakun n'anën tjetër të dhomës, iu afrua edhe ajo Masllovës e i ndënji përballë.

— Cë-cë-cë! — ja bëri duke kërcitur gjuhën e duke tundur kokën me keqardhje.

Erdhi aty pas plakës edhe çunaku, që ja nguli sytë, duke nxjerrë si buri buzën e sipërme, bukës që kish sjellë Masllova. Duke vënë re me një dhëmbshuri të thellë ato fytyra të njohura që e rrethonin pas ngjarjeve të kobëshme në gjyq, Masllovës iu mblodh një lëmsh në fyt dhe

buzët iu drodhën. E mbajti veten gjer sa erdhi atje plaka me çunakun. Por kur pa dëshpërimin e plakës dhe sidomos kur vuri re se si çunaku e kalonte vështrimin nga fytyra e saj tek buka, me një pamje serioze, s'u përmbajt dot më dhe ja plasi vajit.

— Të thashë apo s'të thashë që të marrësh një avokat të zotin? Ja, e sheh tani? — iu drejtua me të rreptë Korableva. — Po si, të internuan, apo qysh? — pyeti pas pak me një zë më të butë.

Masllova deshte të përgjigjej, por s'mundej. Gjithë duke qarë me dënesë, nxori nga buka paketën me cigare, mbi të cilën qe përfytyruar një zonjë me të kuq në faqe, me ca flokë kapur me fërqeta e ngritur përpjetë, me një dekolté me sqep që i zbulonte një pjesë të gjirit; dhe, si e nxori, ja dha Korablevës. Korableva e soditi një copëherë paketën dhe veçan figurën mbi të, tundi kokën me qortim, si për t'i treguar Masllovës që i kishte bërë dëm paratë dhe, pasi mori një cigare, e ndezi tek flaka e llambës, e thithi veté nja dy herë e pastaj ja futi në gojë Masllovës. Masllova, që nuk pushonte së qari, nisi ta thëthijë si e etuar tymin e duhanit duke e nxjerrë me duf nga goja dhe nga hunda.

— Me punë të detyruar më dënuan, — tha duke qarë.

— Ah, këta qenër të mallëkuar, s'i trëmben as perëndisë! — çfryu Korableva. — Shkojnë dhe e dënojnë të gjorën kot më kot, se kështu u do qejfi! Të poshtërit, gjakpirësit e pangopur!

Atë çast u dëgjua një valë gazi që vinte nga dritarja, ku rrinin e bënin sehir disa nga gratë. Qeshte edhe voglushja e zëri i saj i hollë fëminor ngatërrohej e shkrihej në të qeshurén e ngjirur e me piskamë të të tri të burgosurave të tjera. Shkakëtari i asaj gajasjeje me lot ishte, me sa dukej, një nga të arrestuarit atje poshtë në oborr me ndonjë fjalë që kish thënë, apo me ndonjë gjest të ndytë që kish bërë.

— A-a, kokërruari i qerratait, shih se ç'bën! — foli me të madhe flokëkuqja me quka, duke lëkundur herë në njerën anë, herë në tjetrën trupin e saj të majmë. Pastaj, duke ngjeshur fytyrën pas hekurave, nisi të zbrazë nga goja një çurk fjalësh tmerësisht të ndyta.

— Jazëk të qoftë! Moj cipëplasur! Fjalë po janë këto?!... — iu shkreh Korableva flokëkuqes; por si e pa që ajo tjetra as që ja vinte fare veshin, u drejtua përsëri nga Masllova dhe vazhdoi ta pyeste: — Mirë të dënuan, po me sa vjet vallë?

— Me katër, — tha Masllova dhe lotët i rrodhën çurg. Një lot u çkëput e ra mbi cigare.

Masllova e shtypi me inat cigaren, e flaku tej dhe mori një tjetër.

Rojtarja e trenit, ndonëse nuk e pinte duhanin, u ul dhe e ngriti menjëherë bishtin e shuar, e drejtoi, pa e prerë, në këtë e sipër, bisedën.

— Eh, moj dallandyshezë, po mirë thonë që drejtësinë e hëngrën derrat! E ja, atë që duan bëjnë, se s'ka kush ua mban dorën. Atë i thoja dhe Matvejevnës qëparë. Se ra muhabeti tënd dhe «do ta nxjerrin» më thoshte ajo se «që ta mbajnë kot, s'e mbajnë dot!» E ja, u hëngrëm një copë herë me fjalë bashkë. Unë kështu, ajo ashtu. Po i thashë: e jo, moj dallandyshezë, se ma ndjen zemra mua, janë ujqër ata dhe do ta hanë, mos prit që ta lëshojnë. E ja, për perëndi, doli fjala ime! — dërdëliste ajo pa rreshtur, me zërin e saj të këndshëm që, dukej, i kishte hyrë edhe asaj vetë në qejf.

Ndërkaq, të arrestuarit kishin kaluar matanë oborrit e po futeshin brënda. Gratë, që s'rrinin rehat gjer ahere me shakatë e qyfyret e tyre, u larguan nga dritarja e u grumbulluan edhe ato rreth Masllovës. U afrua e para gruaja me kokërdhokë të këcyer, që e kishin zënë duke shitur verë pa leje, bashkë me të bijën.

— Çudi, pse të sillen kaq të egër? — pyeti duke zënë vënd pranë Masllovës, pa hequr nga duart shtizat që vazhdonte t'i punonte shpejt.

— Të egër, domosdo, se, atyre që s'u ka jhepi, kështu u sillen. T'i kishte patur plot xhepat e t'i qe vardisur ndonjë avokati nga ata që janë dhelpër e kaluar dhelprën, pa të shikoje si ta kishin liruar! Oj të liruar! Që aty, në gjyq! — tha Korableva. — Apo s'qe një, një leshatar, një hundëmadh, s'e di se qysh i thonin. . . Ai të mbyturin që është qullë n'ujë edhe e nxjerr nga pusi trok të thatë. Ja, ai ta kish marrë këtë punë në dorë, pa atëhere llafoseshim!

— E, e, ta kish marrë. . . — ndërhyri e tha duke kërcëllitur dhëmbët Bukuroshja, që u ul e ndënji atje pranë saj — mirë, mirë po pa nja njëmijë koqe rubla s'ndahej me të!

— Po, moj bijë, duket ky paska qenë fati yt, — u hodh e tha plaka që mbahej në burg për djegie. Po pse, mua si? Ja, ashtu ma punuan edhe mua dhe më ndanë nga burri! Dhe sos ta kisha të ri, po e kam që s'luan dot as këmbë as

dorë nga pleqëria. . . — nisi ajo të tregojë për të njëqindën herë historinë e saj. — Po mirë thonë «ai që është fukara, ta bëjë hesap edhe burgun». Se ja, paska qenë fjalë e vërtetë.

— Ashtu, ashtu, se s'pyesin këta per tjetrin që heq e vuan. Tymi t'u vejë drejt! — e mori fjalën ajo që kish shitur verë pa leje dhe, duke ua ngulur sytë flokëve të së bijës, e la çorapen mënjanë, e hoqi vajzën për nga vetja në mes të gjunjëve dhe, duke i lëvizur të shpejtë gishtërinjtë, nisi ta morritë. — E di ç'më thanë mua? «E ç'të duhet ty — më thanë — që ngatërrohesh me verë?» Po fëmijët me se t'i ushqej? Me morra? — tha ajo duke vazhduar punën që kishte në dorë.

Fjalët e kontrabandistes plakë, i kujtuan Masllovës verën.

— Sikur të pinim pak, s'do të qe keq, — i tha ajo Korablevës, duke fshirë me mëngët e këmishës lotët e duke dënesur tani vetëm më të rrallë.

— «Gamirka» do? E po, prishur mos qoftë! — ja ktheu Korableva.

XXXII

Masllova nxori nga buka një kartmonedhë. Korableva e mori, e vështroi mirë e mirë nga të dy anët dhe, sadoqë s'kishte shkollë e s'dinte të lexonte, i besoi në fjalë Bukuroshes, që mbahej se i dinte të gjitha e që i tha se kartmonedha vlente dy rubla e pesëdhjetë kopekë. Pastaj gërmoi në një vrimë në mur dhe nxori që andej një faqore me raki. Gratë, që s'i kishin shtretërit aty, u tërhoqën nëpër vëndet e tyre. Masllova ndërkaq shkundi pluhurin nga shamia e kokës dhe nga kapota e, si u rehatua mbi shtrat, nisi të hante bukën.

— Të kisha ruajtur çajin, po tani besoj, do të jetë ftohur, — i tha Fedosja duke marrë nga sergjeni një çajnik prej teneqeje të mbledhur me peca këmbësh si edhe një mashtrapë.

Pija ishte fare e ftohtë dhe mbante erë më tepër teneqe të ndryshkur se sa erë çaji; por Masllova e mbushi mashtrapën e nisi ta pijë duke e shoqëruar me bukë.

— Finashka, na! — i thirri çunakut që po e vështronte drejt e në gojë dhe, si këputi një copë nga buka, ja dha.

Në këtë kohë e sipër Korableva i vuri përpara faqoren me raki dhe një mashtrapë. Masllova e ftoi Korablevën dhe Bukuroshen të pinin bashkë. Që të tria përbënin, si të thuash, aristokracinë e qelisë, sepse kishin përherë të holla dhe ato që kishin i ndanin kurdoherë në mes të tyre.

Rakia i bëri mirë Masllovës, se e gjallëroi e ja zgjidhi gjuhën. Ajo nisi të tregonte shtruar e me nge ngjarjen e ditës duke përqeshur aty-këtu prokurorin e duke përshkruar me hollësi ato që i kishin bërë më tepër përshtypje në gjyq. Në gjyq, sipas asaj që tha, të gjithë ja k shin ngulur syte dhe e kishin vështruar me qejf; dhe, bënin ç'bënin, hynin në dhomën e të pandehurve për ta parë.

— Bilé kjo i ra në sy edhe xhandarit që më shoqëronte, se më tha: «Këta për ty vijnë këtu, se s'kanë ndonjë punë». Dhe kështu vërtet, se sytë tek unë i kishin sadoqë, sa për të humbur gjurmat, bënin gjoja sikur kërkonin ndonjë kartë apo ndonjë gjë tjetër, që s'u hynte hiç në punë. Më përpinin, më përpinin me sy, ja kështu, — tregonte Masllova dhe buzëqeshte duke tundur kokën si e habitur e me një kënaqësi të lehtë. — Ustallarë, ata!

— Po dhe ndryshe s'ka si të jetë, — u hodh e ja rrëmbeu fjalën nga goja rojtarja me zërin e saj kumbonjës, — është si puna e mizave që i mblidhen sheqerit. Për të tjerat s'i ke, por për këtë të bëhen teslim kur të duash. . .

— Le, po dhe këtu po ajo më ndodhi, — ia preu Masllova. — Se ç'ishin ca të arrestuar që kishin sjellur me tren. E, që thoni, më rrethuan nga të katër anët sa që erdhi një kohë kur u mbërtheva në vënd e s'luaja dot as këmbë as dorë. Dhe e pashë pisk, jo shaka, po thuaj faleminderit atij ndihmës-drejtorit që më shpëtoi e m'i hoqi qafe me një të folur që u bëri. Njeri sidomos, se kush qe s'e di, qe çapkën i madh se më hodhi duart e desh të më kapte me zor. Mezi e shporra.

— Po pamjen si e kishte, s'e mban mënd? — e pyeti Bukuroshja.

— Vinte si i zi, me mustaqe.

— Ai duhet të jetë.

— Kush ai?

— Shçeglovi, kush tjetër. Ja, tani porsa kaloi.

— Po cili qenka ky Shçeglovi?

— Si, nuk e njeh Shçeglovin? Shçeglovin e njohin të gjithë, se është arratisur nga katorga dy herë. Tani e zunë, por prapë do t'iu iki ai. Atij, edhe gardianët ja kanë fri-

kën! — tha Bukuroshja që shkëmbente pusulla me të arrestuarit dhe s'i shpëtonte asgjë nga punët e burgut. — Që do t'u ikë, jua jap me bast kur të doni.

— Ikën apo s'ikën, neve aq na bën. Se mos do të na marrë me vete, nuk sheh?. . . — ja mori fjalën Korableva. — Po ti, a nuk më thua, — vazhdoi duke iu drejtuar Masllovës — ai avokati yt ç'tha për punën e faljes? Të tha gjë? Se tani do bërë një lutje, apo s'e kam mirë?

Masllova u përgjegj se nuk dinte gjë.

Ndërkaq, flokëkuqja, duke i ngulur gishtërinjtë e saj me quka në flokët e dëndura e të shpupuritura, e duke e krojtur kokën me thonj, iu afrua aristokrateve që po p nin.

— Katerina, hiç mos ki gajle, pa të mësoj unë si të bësh, — e filloi ajo bisedën. — Në krye fare do të bësh një ankesë, një do t'ua drejtosh gjykatësve, një prokurorit. Do t'u thuash që kështu e kështu e kam punën, që s'jam e kënaqur nga gjyqi. . .

— Moj, po ti ç'hyn në këtë mes? — iu kthye me një zë të rreptë basi Korableva — I ra erë rakisë, duket, e dërr-dërr. . . Hajt, gremisu tutje, pa e dimë vetë se ç'duhet bërë!

— Po ti ç'ke që hidhesh sikur të zuri zekthi? Kush po flet me ty?

— Po pse, mos do të thuash se s'erdhe për rakinë?

— S'prish punë. mos e prish zemrën: jepi dhe asaj, — ndërhyri Masllova, që u bënte pjesë përherë të giithave.

— Kujt, asaj t'i jap? Asaj t'i jap një strunxë më mirë që ta shemb përdhé, ta. . .

— Pa hë, pa hë, — iu afrua flokëkuqja Korablevës me kanosje. — E ç'pandeh ti, se të trëmbem?

— Ik, moj qelepirxheshë e ndyrë!

— E ndyrë je vetë!

— Moj fytyrë plënce!

— Plënc qofsh vetë! Moj katile e katorgës! — çirrej leshkuqja.

— Qërohu të them! — foli e zymtë Korableva.

Po flokëkuqja u qas përkundrazi edhe më tepër e Korableva atëhere brofi në këmbë dhe i dha një të shtyrë me dorë në gjirin që e kish të zbuluar e të majmë. Flokëkuqja duket vetëm këtë priste, se, papritmas, me një lëvizje të shpejtë, u kap me njerën dorë nga flokët e Korablevës ndërsa me tjetrën u mat ta godiste në fytyrë. Po Korableva ja zuri dorën. Masllova dhe Bukuroshja iu hodhën flokëkuqes, ja mbërthyen krahët e u munduan ta largojnë, por ajo

kishte shtrënguar në dorë gërshetën e Korablevës e nuk e lëshonte. Një çast u duk se do ta lëshonte, por menjëherë pastaj e përdrodhi rreth grushtit dhe e tërhoqi për nga vetja me sa mundej. Korableva, me kokën që s'e lëvizte dot as këtej as andej, këputste një breshëri grushtash mbi trupin e kundërshtares e përpiqej t'i kafshonte dorën. Gratë u bënë për rreth e orvateshin t'i ndanin. Dhoma buçiste nga të thirrurat e nga klithmat. Erdhi aty edhe e veremosura e u afrua gjithë duke u kollur. Fëmijët ngjisheshin njeri pas tjetrit dhe qanin. Gardiania e burgut, bashkë me mbikqyrësin, dëgjuan zhurmën dhe çatisën aty me të shpejtë. Më në fund, gratë i ndanë, por edhe pas kësaj, si njera, ashtu dhe tjetra, vazhdonin të çirreshin me të madhe, të qaheshin duke kërkuar që të hakmerreshin. Korableva e kish zgjídhur gërshetën e saj të thinjur e qëronte me dorë tufat e flokëve të këputura. Flokëkuqja mbante me të dy duart këmishën e grisur që i zbulonte tani tejpërtej gjirin e verdhë.

— E mora vesh si qëndron puna. Fajin këtu e ka rakia, se ja, kundërmon nga të katër anët! — foli gardiania kur të dy gratë orvateshin t'i shpjegonin me britma se si kishte lindur sherri. — Por nesër do t'i them drejtorit që t'jua rregullojë qejfin! Hajt, tani, secila në vëndin e saj! E s'dua të dëgjoj më as gëk, as mëk, dëgjuat?

Por heshtja s'u vendos dot menjëherë. Të sharat vazhduan nga të dy anët për një kohë të gjatë. Gratë i tregonin e i ritregonin njera tjetrës si e qysh kishte nisur sherri dhe kush e kishte patur fajin. Më në fund, gardjani dhe gardjania duallën, zhurma në qeli u qetua disi dhe të burgosurat shkuan e ranë një nga një në shtretërit e tyre. Plaka qëndroi përpara ikonës e nisi të falej.

— Janë mbledhur dy nga ato të katorgës e ngatërrojnë dynjanë! — e prishi heshtjen, papritmas, zëri i ngjirur i flokëkuqes, që vinte nga cepi i kundërt i dhomës, duke e shoqëruar çdo fjalë me ca të shara çuditërisht të ndyra.

— Mbylle gojën, se mos të të përvishem përsëri! — ja prit aty për aty Korableva, bashkë me njëmijë të shara po aq të ndyra.

Pastaj heshtën që të dyja.

— Ç'e do se na ndanë, pa do të t'i kisha dhënë sytë në pëllëmbë!. . . — çfryu përsëri flokëkuqja.

Po aq rëndë ja ktheu pas pak edhe Korableva.

U bë dhe këtë radhë një heshtje, disi më e gjatë nga të tjerat. Pastaj të sharat filluan përsëri nga të dy anët. Hesh-

tjet bëheshin përherë e më të gjata gjersa, më në fund, as njera as tjetra s'u ndje më.

Qetësia tani kish pllakosur në tërë dhomën. Që të gjitha kishin rënë në gjumë e gërrhitnin, me përjashtim të plakës që vazhdonte të falej e të gjunjëzohej përpara ikonës, dhe bijës së dhjakut që, me t'u larguar gardjanët, u ngrit e nisi të vërtitej përsëri poshtë e lart.

Edhe Masllova nuk flinte. Mendimi që tani e priste katorga, nuk e linte të qetë. Dy herë ja kishin përmëndur atë ditë katorgën: në mëngjes, në gjyq, Boçkova dhe atë mbrëmje, në burg, flokëkuqja. Korableva u kthye nga an'e saj.

— S'ma priste mëndja se do të ndodhte kështu, — tha Masllova me zë të ulët. — Të tjerët s'lenë gjë pa bërë e, kur vjen puna, i lirojnë. . . Kurse unë, ja, vuaj kot më kot. . .

— Mos u dëshpëro, moj bijë, pa njerëz gjen plot edhe në Siberi. Nuk ke për të vdekur. . . — i tha Korableva për ta ngushëlluar.

— E di që nuk do të vdes, por prapë më vjen inat! Pastaj unë jam mësuar të rroj mirë, s'rroj dot kështu unë!

— E po ja që kështu është thënë nga zoti. . . ç'do të bësh? — tha Korableva dhe pshertiti.

— E di, teto, por prapë do të jetë shumë e rëndë për mua. . .

Heshtën.

— E dëgjon atë sherrmadhen? — pyeti Korableva duke ja drejtuar vëmëndjen Masllovës nga disa tinguj të çuditshëm që vinin nga fundi i dhomës.

Atë tinguj ishin rënkimet e përmbajtura të së burgosurës flokëkuqe me quka në fytyrë. Flokëkuqja qante ngaqë e kishin sharë, ngaqë e kishin rrahur dhe s'i kishin dhënë të pinte pak raki. Qante edhe sepse tërë jeta i kishte kaluar me të shara e me të rrahura. Të gjithë e përbuznin, të gjithë e fyenin. Ajo solli ndërmënd, për t'u ngushëlluar, dashurinë e parë. Kujtoi Fedka Mollodjonkovin, atë punëtorin e fabrikës me të cilin qe dashuruar. Por iu kujtua edhe se si kishte marrë fund ajo dashuri atë ditë kur Mollodjonkovi, i pirë, e leu me gurkali në një vënd shumë të ndjeshëm e, ndërsa ajo rrënqethej nga dhëmbja, ai e bënte sehir e qeshte bashkë me ca shokë të tij. Kur iu kujtua kjo, i erdhi keq për veten e saj dhe, duke pandehur se tani nuk e dëgjonte

më njeri, ia shkrepi vajit. Rënkonte, tërhiqte hundët e gëlltiste lotët e kripur që i ridhnin faqeve. . .

— Sa gjynah! — tha Masllova.

— Gjynah, vërtet, por s'ja ka njeri fajin.

XXXIII

Ndjenja e parë që provoi Nekludovi të nesërmen kur u zgjua, ishte vetëdija se diçka i kishte ndodhur. Nuk e dinte se çfarë i kishte ndodhur me saktësi, por kishte përshtypjen se duhej të qe diçka e rëndësishme dhe e mirë. «Katjusha, gjyqi». Po, dhe, veç kësaj, iu kujtua vendimi që kish marrë të mos gënjente kurrë, po të thoshte gjithmonë të vërtetën. Për një koincidencë të çuditëshme, po atë mëngjes erdhi më në fund edhe letra nga Maria Ivanovna, e shoqja e marshallit të fisnikërisë, që vinte tamam në kohën e duhur. Dashnorja e tij e vjetër i jepte liri të plotë veprimi dhe i uronte një martesë të lumtur.

— Kjo më flet për martesë! — tha ai me ironi, si e lexoi letrën. — Kurse mua tani as që më bie ndërmënd fare të martohem!

Iu kujtua mendimi i djeshëm që të sqarohej me të shoqin e saj, t'i lypte ndjesë e t'i jepte atë që do të kërkonte. Por atë mëngjes kjo punë nuk i dukej më aq e lehtë si i qe dukur një ditë më parë. «Fundja, përse t'ja prish lumturinë atij tjetri gjersa ai s'ka asnjë dyshim në gruan e tij? Po të më pyesë, atëhere dhe mund t'ja them, po që t'ja fus në vesh vetë, jo, kjo s'duhet bërë, kjo s'ka kuptim».

Po aq e vështirë i dukej atë mëngjes t'ja thoshte troç të vërtetën Missit, pa i fshehur asgjë. Mendonte se edhe këtu nuk i përkiste atij të parit të fliste në deshte që të mos e fyente Missin. Patjetër duhej të mbetej, siç ngjet rëndom në shumë marrëdhënie familjare intime, diçka si një nënkuptim i heshtur. Sidoqoftë, një gjë e kishte të qartë: që nuk do të shkonte më tek Korçaguinët e që, po ta pyesnin, nuk do t'ua fshihte të vërtetën.

Në marrëdhëniet me Katjushën, përkundrazi, çdo gjë duhej të ishte e kthjelltë gjer në fund.

«Do t'i shkoj në burg, do t'i them, do t'i lutem të më falë. Dhe, po të jetë nevoja, po, po të jetë nevoja, edhe do ta marr për grua», — mendonte dhe e kishte me tërë mënd.

Sakrifica që do të bënte duke u martuar me të për të kënaqur një nevojë të thellë morale, e ngashërente atë mëngjes në një mënyrë krejt të posaçme.

Kurrë herë tjetër nuk e kish ndjerë veten aq energjik si atë ditë. Kur hyri në dhomë Agrafena Petrovna, me një vendosmëri të cilën s'e kish pritur kurrë nga vetja e tij, ai e njoftoi se nuk kishte më nevojë për atë apartament ku banonte, dhe as për shërbimin e saj. Me një marrëveshje të heshtur që kishin patur në mes tyre, ata kishin vendosur që Nekludovi do ta mbante apartamentin me qëllim që të martohej e të sillte aty gruan. Prandaj Agrafena Petrovna ngriti sytë n'ato fjalë që i tha Nekludovi dhe e vështroi e habitur.

— Ju falemnderit shumë, Agrafena Petrovna, për të gjitha kujdesjet që kini treguar për mua dhe për shërbimin që më keni bërë, por unë tanimë s'kam nevojë për një apartament kaq të madh dhe, aq më pak, për tërë këta shërbëtorë që punojnë në shtëpinë tonë. Pra, nëqoftëse doni të më ndihmoni, kini mirësinë të përkujdeseni që të mblidhen plaçkat në një dhomë, ashtu siç u bë kur vdiq e ndjera nënë. Nuk do të jeni vetëm se do të vijë edhe Natasha dhe bashkë e keni më kollaj. (Natasha ishte e motra e Nekludovit).

Agrafena Petrovna tundi kokën.

— Po pse t'i heqim plaçkat? — tha — do të na duhen.

— Jo, nuk do të na duhen, Agrafena Petrovna, nuk do të na duhen, ju siguroj unë, — tha Nekludovi si për t'iu përgjegjur asaj tundje koke të guvernantes së habitur. — I thoni, ju lutem. edhe Korneit që do t'i jap dy muaj rrogë parapagim, por që nuk kam ndërmend ta mbaj më se s'më duhet.

— Kot e kini që veproni kështu, Dimitri Ivanoviç, — tha ajo. — Edhe sikur të shkoni jashtë shtetit, banesa s'ju prish punë, se do t'ju duhet fundja më vonë, kur të ktheheni.

— Ju nuk e dini si është puna, Agrafena Petrovna. Diku do të shkoj. po jo jashtë shtetit, siç mendoni ju.

Tha këto fjalë dhe u skuq në fytyrë.

«Po, duhet t'ja them të gjitha, — mendoi — nuk kam pse hesht, më mirë le ta dijë si qëndron puna».

— Dje më ndodhi një gjë shumë e çuditëshme, por edhe shumë e rëndësishme për mua. Ju kujtohet Katjusha, që banonte tek tetua, tek Maria Ivanovna?

— Po si s'më kujtohet? Unë e kam mësuar edhe të qëndiste.

— E po ja, dje në gjyq Katjushën e dënuan. Unë, n'atë gjyqin që u bë, isha anëtar zhurie.

— Ah, zot i madh, sa keq po më vjen! — tha Agrafena Petrovna. — Po pse e dënuan? Ç'kish bërë?

— E dënuan për vrasje, po fajin e kam unë.

— E keni ju fajin?! Ç'po dëgjoj! Po më çuditni, — tha Agrafena Petrovna dhe sytë e saj të mplakur u përshkënditën me tallje.

Ajo e dinte mirë historinë e Katjushës.

— Po, fajin e kam unë për të gjitha. Unë u bëra shkak që u dënua. Dhe ja, kjo m'i përmbysi të gjitha planet.

— Çfarë ju lidh ju me këtë punë, nuk e kuptoj, — tha Agrafena Petrovna me një buzëqeshje të përmbajtur.

— Po është e qartë se, gjersa jam unë shkakëtar që ajo ra aq poshtë, ahere më bie si detyrë të bëj çmos që t'i jap dorën e ta ngrë.

— Këto fjalë, vërtet, ju nderojnë e ju tregojnë njeri me vullnet të mirë, por, kur mendoni se kini faj në këtë mes, më falni, këtu gaboheni! Kjo që ju ka ndodhur juve, të gjithëve u ka ndodhur, por kur njeriu është me mënd në kokë i harron të tëra dhe vazhdon të rrojë i qetë e i lumtur, siç ka rrojtur më parë, — tha Agrafena Petrovna me të rreptë e çehrengrysur, — pra, kot sa përzihëni në këtë punë. Për të kam dëgjuar me kohë që ka hyrë në rrugë të shtrëmbër dhe s'është vetëm tani. E po atëherë kush ja paska fajin asaj?

— Unë, dhe dua ta laj këtë faj.

— Eh, zor do ta kini!

— Kjo është punë për mua. Nëqoftëse e kini fjalën për veten tuaj, ashtu siç qe dëshira e mëmës së ndjerë, unë jam gati. . .

— Jo, s'është fjala për mua. Unë mirë jam sido që të bëhet. Nëna juaj, ndjesë pastë s'më la të më mungonte asgjë. Fundja, po të mos jem më e nevojëshme, shkoj tek Lizanka (Lizanka ishte një mbesë e saj e martuar). Vetëm këtë ju them: më kot e brengosni veten, kjo u ka ndodhur edhe të tjerëve, por s'kanë bërë kështu si ju.

— Unë kam mendimet e mia. Se ç'kanë bërë të tjerët, as që dua ta di. Pra, ju lutem, të më ndihmoni ta zbraz aparatamentin e t'i mbledh plaçkat. Mos më mbani mëri. Unë kam ndaj jush një mirënjohje të thellë dhe s'i harroj kurrë ato që keni bërë për mua.

Çudi! Që kur e kish kuptuar ligësinë e tij e i qe neveritur vetes, Nekludovi ndjente një simpati për të gjithë nje-

rëzit, edhe për ata që dikur i kish urryer; kështu edhe kundrejt Agrafena Petrovnas, edhe kundrejt Korneit, kishte tani një dashamirësi të veçantë e të sinqertë, si nuk i kishte ndodhur kurrë. Bilé, ai arriti gjer aty sa deshi t'i kërkonte të falur edhe Korneit por u tërhoq nga ky respekt aq i thellë e të nënshtruar, saqë Nekludovi ngurroi e nuk i tha asgjë.

Kur po shkonte në gjyq, hypur po n'atë karrocë, duke kaluar po n'ato rrugë, Nekludovi habitej me veten e tij për ndryshimin e madh që i kish ndodhur në një kohë aq të shkurtër.

Martesa me Missin, që gjer dje i ishte dukur e domosdoshme dhe fare e afërtë, i paraqitej tani krejt e pamundëshme. Dje e mbante akoma kaq lart veten, saqë mendonte se Missi do të ishte shumë e lumtur të martohej me të; kurse sot, përkundrazi, ndjente jo vetëm që nuk ishte i denjë të martohej me të, por as që t'i rrinte pranë. «Sikur ajo të më njihte thellë kush jam. zor se do të më pranonte në shtëpinë e saj. Dhe unë pata sy e faqe t'i qortoj atë «kokoterinë» që m'u duk e tepruar me një zotëri veshur me të zeza. Jo, jo, edhe sikur ajo tani të dojë të martohet me mua, s'kam si të jem i lumtur, s'kam si të jem i qetë duke ditur që atë tjetrën atje, në burg, në mos nesër, pasnesër, e nisin në katorga. Dhe ndërsa ajo e mjerë, që dënohet për fajin tim, do të shkojë në katorga, unë do të rri këtu e do të pres urime martese e do të shkoj lart e poshtë për vizita me një grua tjetër, të re e të bukur. Ose, bie fjala, do të ulem në një tryezë me marshallin e fisnikërisë, të cilin e preva në besë dhe i mashtrova gruan dhe, bashkë me të, do t'i çaprashit në mbledhje jo po kështu e jo po ashtu, e do të numëroj votat pro e kundra dekretit për inspektimin e shkollave, e ku di unë për çfarë e çfarë budallallëqe të tjera. Pastaj, si të mbarojë mbledhja, do të ngutem t'i shkoj në takim së shoqes së tij (ptu, sa gjë e ndytë!); ose, për të humbur kohën, do rri të dërsitem mbi një tabllo që s'do të përfundojë kurrë, sepse s'kam as zotësinë dhe as kohën që të merrem me të». Ja, kështu i fliste vetes Nekludovi ndërsa shkonte në gjyq edhe gëzohej, gëzohej shumë për atë ndryshim të brëndshëm që ndjente në veten e tij.

«Puna e parë që duhet të bëj, — mendonte, — është të takohem me avokatin që të më thotë se ç'mendon, pastaj... pastaj të takohem me atë... atë të pandehurën dje, në gjyq, dhe t'ja rrëfej të gjitha».

Kështu mendonte dhe e përfytyronte me gjallëri çastin kur do të takohej me të, kur do t'i rrëfehej, kur do të pendohej përpara saj e kur do t'i thoshte se ishte gati të bënte çmos për t'i ardhur në ndihmë e, fundja, edhe të martohej me të, që ta shlyente fajin e madh që kishte karshi saj. Një ndjenjë e veçantë entusiazmi e pushtoi dhe sytë iu përlotën pa e kuptuar as ai vetë se si.

XXXIV

Kur mbrijti në gjyq, Nekludovi takoi në koridor ftuesin dhe e pyeti ku mbaheshin të pandehurit, që qenë dënuar dje, dhe me kë duhej të bisedonte që të merrte një leje për t'u takuar me ta. Ftuesi i shpjegoi se të arrestuarit nuk mbaheshin të gjithë në një vënd të caktuar, po kush këtu, kush atje, dhe se, gjersa vendimi të shpallej në formën e prerë, lejet i kishte në dorë prokurori.

— Ju shpie unë tek ai porsa të mbarojë seanca. Hë për hë prokurorin nuk e kini këtu. Po, pas seancës, jua marr unë përsipër këtë punë, hiç mos u bëni merak! Tani, ju lutem të urdhëroni në gjyq. Ja, po fillon.

Kushedi përse, Nekludovit i erdhi keq për ftuesin që iu duk atë ditë si i mjeruar e i shkretë. E falënderoi për zellin që tregoi për t'i shërbyer dhe hyri në dhomën e zhurisë.

Kur hyri ai, anëtarët e tjetër po ngriheshin të dilnin për të shkuar në sallën e gjyqit, ku do të zhvillohej seanca. Tregëtari dukej po aq babaxhan, gazmor e i dehur siç kishte qenë dje dhe e priti Nekludovin krahëhapur, siç pritet një mik i ngushtë. Po ashtu edhe Pjotër Gerasimoviçi nuk i ngjalli atë ditë Nekludovit ndonjë ndjenjë antipatie e neverie me familjaritetin e tij të tepruar e me të qeshurën e tij të çkujdesur.

Nekludovi u mat t'ua thoshte edhe shokëve të tij të zhurisë marrëdhëniet që kish patur me të pandehurën e dënuar dje. «Të kisha qenë me të vërtetë i ndershëm, — mendoi, — dje, kur u bë gjyqi, duhej t'isha ngritur në këmbë e ta kisha shpallur publikisht fajin tim». Por kur hyri në sallën e seancës, bashkë me anëtarët e tjerë të zhurisë, dhe pa se si u përsëritën një nga një të gjitha formalitetet, me të cilat kish filluar procesi kundra Masllovës dhe shokëve të saj, ndjeu

që, me gjithë vullnetin e mirë që kishte, nuk do të kish patur kurrë guximin ta prishte me ndërhyrjen e tij madhështinë e asaj procedure bajate.

Ashtu si dhe dje, sekretari u ngrit në këmbë e tha: «Gjyqi hapet!». Pastaj u dukën përsëri ata të tre me jakara të kollarisura majë podiumit, pastaj u bë një heshtje, zhuria zuri vënd në karriget me shpinë të lartë, xhandarët suallën në sallë të pandehurit, urata u ngrit e iu afrua ikonës, etj. etj.

Pregatitjet për fillimin e gjyqit ishin po ato të djeshmet; u la mënjanë vetëm betimi dhe fjalimi i shkurtër paraprak i kryetarit mbi detyrat e të drejtat e zhurisë. Atë ditë gjykohej një rast vjedhjeje. I pandehuri, i shoqëruar nga dy xhandarë me shpata të çveshura që e ruanin në këmbë nga të dy anët, ishte një djalosh thatanik, me shpatulla të ngushta, me një pallto të murme në trup e me një fytyrë të murrëtyer e pa gjak.

Ai rrinte i vetmuar në bankën e të akuzuarve e vështronte herë-herë me bisht të syrit ata që hynin. Djaloshi akuzohej se bashkë me një shok kish prishur drynin e një plevice e, si e kishte çarë derën e qe futur brënda, kish rrëmbyer që andej ca shkorsa të vjetra që zinin një shumë në të holla prej tri rubla e gjashtëdhjetë e shtatë kopekë. Në akt-akuzë thuhej se djaloshi qe kapur nga organet e policisë kur po largohej nga plevica bashkë me shokun e tij, që i kish ngarkuar shkorsat në krahë. Djaloshi dhe ortaku i tij e kishin pohuar menjëherë vjedhjen e kryer dhe, hë për hë, para se t'i drejtoheshin gjyqit, qenë burgosur. Shoku, që punonte diku si çelsabërës, kish vdekur në burg, kështu gjyqit i paraqitej tani vetëm ai djaloshi njëzetvjeçar. Shkorsat e vjetra qenë vënë mbi një tryezë ku mbaheshin materialet e akt-akuzës. Procesi u zhvillua tamam si ai tjetri dje, po me atë arsenal dëshmish, ballafaqimesh, betimesh e pyetjesh të kryqëzuara. Polici, që e kish zënë vjedhësin, sa herë që kryetari, prokurori apo mbrojtësi i drejtoheshin me ndonjë pyetje, ua priste shkurt duke u përgjegjur me një zë të mekur: «Ashtu vërtet», «Këtë nuk e di» dhe pastaj përsëri «Ashtu vërtet». . . ; por ndonëse qafeti e tregonte të vrazhdë e zemërgur, ashtu siç i ka hije një ushtari të vërtetë, kuptohej që i vinte keq për djaloshin dhe që i tregonte si pa qejf rrethanat e ngjarjes.

Dëshmimtari tjetër, një plak i drobitur, ish pronari i shkorsave të vjedhura, kur e pyetnin a i njihte për të tijat ato shkorsa, ngurronte e lëkundej përpara se ta pohonte

këtë; kur pastaj prokurori e pyeti se për çfarë kishte ndërmënd t'i përdorte shkorsat dhe në se e quante apo jo vjedhjen e tyre një humbje të madhe, ai u nxeh dhe u përgjegj i xhindosur:

— Njëqindmijë herë më mirë të kishin humbur se as që ua kam nevojën fare! Ta kisha ditur që do të më sillnin kaq andralla, jo me gjyqe, jo me dëshmimtarë e ku di unë se çfarë, të m'i kishin falur e s'i kisha pranuar kurrën e kurrës. Ta dija se do të më kishin ngatërruar kaq thellë, ja kisha bërë hallall edhe nja dy a tri rubla mbi to, mjaft që të m'i shporrnin. Domosdo, se pesë më shkuan në karroca gjersa erdha këtu. Le që u lodha e u këputa, se s'më ecën as shëndeti e vuaj keq nga reumatizma e nga dhjamët që më ka shkarë.

Kështu folën dëshmimtarët. I pandehuri, nga ana e tij, e pranoi fajin pa asnjë kundërshtim dhe, si një bishë e mjerë e kapur në kurth, hidhte sytë rreth e rrotull pa kuptim, e tregonte me të prera, me zë të dredhur e të shuar, gjithë rrjedhjen e ngjarjeve.

Gjithshka ishte e qartë dhe sheshit, por prokurori, ashtu si dje, ngrinte supet e bënte ca pyetje të holla që kishin për qëllim, sadoqë s'ishte nevoja, ta kapnin në fjalë e ta vinin me shpatulla për muri kriminelin dinak e të rrezikshëm.

Ai u mundua të provojë se vjedhja u krye në një lokal të banuar, me paramendim e me shkatërrim. e se prandaj djaloshi duhej të dënohej me të gjithë rreptësinë e ligjit.

Avokati mbrojtës, i caktuar nga gjyqi, u orvat të dokumentojë se vjedhja nuk qe kryer në një lokal të banuar dhe se, ndonëse krimi nuk mund të mohohej, megjithatë, ky krim nuk mund të konsiderohej aq i rrezikshëm për shoqërinë, ashtu siç e paraqiste prokurori.

Prokurori, po ashtu si dje, i vuri vetes për detyrë të mishërojë paanësinë e drejtësinë dhe, duke u kthyer nga zhuria, u shpjegoi anëtarëve të nderuar ca gjëra që ata i dinin mirë e nuk mund të mos i dinin. E, tamam ashtu si dje, u bënë disa pushime të shkurtëra, njerëzit ndezën nga një cigare, ftuesi thirri me sa mund: «Gjyqi filloi», ndërsa, duke u kotur në gjumë e duke shkundur orë e çast kokën që të mos i zinte gjumi, nga të dy anët e të pandehurit rrinin me karrosie, me shpatat çveshur, dy xhandarë.

Hetimi kish nxjerrë në shesh se djaloshi qe futur në punë nga i ati që së vogli në një fabrikë duhani, ku kish

qëndruar pesë vjet. Atë vit ish pushuar nga puna nga i zoti i fabrikës pas disa mosmarrëveshjeve që ky i fundit kish patur me punëtorët. Kështu, si kish mbetur pa punë, kish filluar të bridhte lart e poshtë nëpër qytet, duke pirë nëpër mehane të gjitha të hollat e fituara. Në një mehane kish bërë mik me kokë një shok kupe, një pijanec të çthurur që kish punuar dikur si çelsabërës, po që më vonë kish mbetur pa punë. Një natë, të pirë që të dy, kishin prishur çelësin e një plevice e. ashtu të dehur, kishin rrëmbyer në errësirë ç'kishin mundur. I kishin zënë. Ata e kishin pohuar vjedhjen. I kishin burgosur. Çelsabërësi kishte vdekur në burg, pa dalë në gjyq. Djaloshi tjetër gjykohej tani si një njeri i rrezikshëm për shoqërinë.

«Po aq i rrezikshëm është ky, sa dhe ajo e pandehura tjetër, dje, — mendonte Nekludovi duke soditur ato që ndodhnin përpara tij. — Mirë, këta qënkan të rrezikshëm, po ne?... Ja, unë, bie fjala, jam një njeri aventurier, një njeri i çthurur, gënjeshtar e hipokrit, dhe asnjeri s'më prek, asnjeri s'më thotë gjysmë fjale, po, përkundrazi, më nderojnë e më çmojnë! Po, fundja, ta zëmë se ky djaloshi, që është akoma çilimi, me atë që ka bërë e paska treguar veten se është shumë i rrezikshëm për shoqërinë. E po pastaj? Kështu duhet vepruar, si veprojmë ne?

Ky djalosh nuk i ka tiparet e një keqbërësi të lindur, këtë e shohin të gjithë. Ai është një njeri i zakonshëm dhe, në se tani gjykohet e dënohet, fajin s'e ka ai, fajin e kanë kushtet që i shtrëmbërojnë njerëzit e i prishin. Prandaj është e qartë që, në duam t'i shpëtojmë këta djelmosha nga ngasjet e liga e ta ruajmë shoqërinë nga rreziku i tyre, puna e parë që duhet të bëjmë është të zhdukim kushtet nga të cilat lindin këta njerëz të mjerë.

Po ne ç'bëjmë? Ne vemi e kapim një syresh, duke e ditur mirë që njëmijë të tjerë na kanë mbetur pa kapur, dhe e rrasim në burg, e lëmë të mësojë të gjitha veset që vinë nga papunësia ose i japim një punë që ja tharton trutë e ja thyen vullnetin, e vëmë të rrijë me ca shokë po aq fatkeqë, po aq vullnetdobët e të fshikulluar nga jeta dhe. më në fund, e dërgojmë me pranga në Irkutsk bashkë me keqbërësit më të përdhosur.

Për të zhdukur kushtet që i bëjnë këta njerëz kështu siç janë, ne nuk bëjmë asgjë e rrimë duarkryq. Jo vetëm po i përkrahim mundësitë për shtimin e tyre duke shtuar fabrikat, uzinat, punishtet, mehanet, kafenetë e shtëpitë publike.

Ne, jo vetëm që nuk i zhdukim këto, por, përkundrazi, na duket e nevojëshme t'i zgjerojmë, t'i organizojmë, t'i shtojmë.

Kështu, rritim e edukojmë në frymën e keqbërjes, jo vetëm një njeri, po me miliona njerëz dhe, kur kapim një syresh dhe e përplasim në burg apo e nxjerrim në gjyq, na duket se diç kemi bërë për të mirë të shoqërisë dhe e flemë mëndjen shpejt, porsa marrim vesh që ai keqbërësi i rrezikshëm u syrgjynos në gubernën e Irkutskut e larg e më larg».

Këto mendime, me një gjallëri e kthjelltësi të jashtëzakonëshme, i lindin Nekludovit ndërsa, ulur në karrigen e tij pranë kolonelit, u vinte veshin tingujve të ndryshme që kishin zërat e avokatit mbrojtës, prokurorit dhe kryetarit, e vështronte me ngulm fytyrat e gjestet e tyre që tradhëtonin sheshit një siguri e një besim të madh në vete.

«Dhe me sa mundim arrihet kjo hipokrizi e tmerëshme, — vazhdonte të mendonte Nekludovi duke hedhur sytë nga salla, nga portretet, nga llambat, nga kolltuqet, nga uniformat, nga muret e trashë e nga dritaret, duke sjellur ndërmënd madhështinë e asaj ndërtese nga jashtë, dhe atë ushtërinë e nënpunsave, shkronjësve, rojtarëve e korrierëve që shërbenin atje e, jo vetëm atje, por në të gjithë Rusinë, duke marrë një rrogë të majme për rolin që luanin n'atë komedi të dëmshme. — Nuk do të qe më mirë sikur të gjitha këto përpjekje, ose, të paktën, të qindën e tyre, t'i përdornim për t'i ndihmuar këta njerëz të braktisur e të goditur nga fati, tek të cilët shohim tani vetëm ca krahë që duhet të punojnë pa u lodhur për rehatin tonë? Si nuk u gjënd një njeri — mendonte Nekludovi duke hetuar me vrejtje fytyrën e ligur e të turbulluar të djaloshit, — si nuk u gjënd një njeri që t'i vinte keq për të atëhere kur skamja e shkëputi nga vatra e tij e ngrohtë në fshat dhe e degëdisi në kurbet? Si s'u gjend një njeri zemërmirë që t'i thoshte, kur shokët e merrnin me vete në mehane, pasi dilnin nga fabrika, ku kishin punuar si kuaj dymbëdhjetë orë: «Mos shko, Vanja, se s'është mirë!» Djaloshi mbase do t'ja kish dëgjuar, nuk do të qe dehur dhe nuk do të kish bërë atë që bëri.

Por asnjeriu s'i erdhi keq për të, asnjeri s'i dha kurrë një këshillë gjatë tërë kohës që ai kaloi në fabrikë, ku rrojti si një kafshë e përbuzur, me kokën rruar me brisk që të mos zinte morra. Përkundrazi, me bisedat e ndyta që bënin në fabrikë e jashtë, shokët dhe mjeshtrat që kishte mbi

krye e mësonin se si të gënjente, si të pinte e të bëhej tapë, se si të shante, të zihej e të shkonte me gra të liga.

Kur, i sëmurë e i shkatërruar nga puna e lodhëshme, nga të pirët e nga veset e tjera të ndyta që i kishin mësuar. . . kur pastaj i dërrmuar e i rraskapitur bariste si nëper endër rrugë më rrugë gjersa shkoi e rrëmbeu, nga budallallëku, në një plevicë, ca shkorsa të rjepura, ne, njerezit me kulturë, që të gjithë në gjëndje të mirë, të gjithë të pasur sa s'dimë ç't'i bëjmë paratë, në vënd që të përpiqemi për ta zhdukur shkakun që e solli këtë djalosh në gjëndjen e mjerë në të cilën ndodhet tani, i biem shkurt dhe kënaqemi me veten tonë duke e dënuar djalin e gjorë sa të jetë e mundur më rreptë.

Oh, ç'tmer! Të gjitha këto rrjedhin mbase nga zemërgurësia e njerëzve, mbase nga padija e tyre. Por, sido që të jetë, si njera, ashtu edhe tjetra, kanë arritur cakun më të lartë që mund të mendohet!»

I zhytur në këto mendime, Nekludovi nuk vinte më re ato që ndodhnin tani përpara tij. Ato që kishte zbuluar e tmerronin. Ai habitej se si nuk i kishin rënë në sy të gjitha këto më parë, se si mund të mos u binin në sy këto edhe të tjerëve.

XXXV

— Menjëherë porsa u bë pushimi i parë, Nekludovi u ngrit e doli në koridor. Kishte vendosur të mos kthehej më në gjyq. Do t'i mirëpriste të gjitha masat ndëshkimore që mund të merreshin kundra tij, mjaft që të mos merrte më pjesë n'atë komedi të tmerëshme që luhej aty brënda.

Pyeti ku ndodhej zyra e prokurorit e shkoi drejt atje. Korieri nuk deshte ta linte meqënëse, siç thoshte ai, prokurori atë kohë ishte i zënë me punë. Po Nekludovi s'ja vuri veshin, hapi derën dhe, duke iu drejtuar një nëpunësi që i doli përpara, iu lut t'i bënte të ditur prokurorit se një anëtar i zhurisë donte të takohej me të për një çështje shumë të rëndësishme. Nëpunësi e njoftoi prokurorin dhe pas pak, Nekludovin e lejuan të hynte në zyrën e tij. Prokurori e priti në këmbë, i pakënaqur, me sa dukej, nga këmbëngulja që kishte treguar Nekludovi për ta takuar.

— Çfarë dëshëroni? — e pyeti me të rreptë.

— Bëj pjesë në zhuri. Më quajnë Nekludov. Dua të takohem me të pandehurën Masllova, — foli me të shpejt, po me ton të vendosur Nekludovi, ndërsa skuqej në fytyrë e ndjente se hapi që po bënte do të kishte një rëndësi vendimtare në jetën e tij.

Prokurori ishte një burrë me trup mesatar, me flokë të thinjura, që i kishte prerë shkurt, me një palë sy të shndritëshëm që i lëviznin or'e çast me shkathtësi, me një mjekër të dëndur e të qethur mbi nofullën e poshtme pak si të këcyer.

— Masllovën? Po, po, e njoh. Akuzohet për helmimin e një farë tregëtari Smellkov, — tha i qetë prokurori. — Ç'ju shtyn të takoheni me të?

Nekludovi nuk u përgjegj menjëherë. Prokurori vazhdoi atëhere me një zë më të butë:

— Unë nuk mund t'jua jap lejen që më kërkoni, pa ditur më parë se përse ma kërkoni.

— Kam një punë shumë të rëndësishme me të, prandaj desha ta takoj, — ja preu shkurt Nekludovi dhe ndjeu se si atë çast i hypi gjaku në kokë.

— Ju kuptoj, — tha prokurori, që ngriti sytë dhe e vështroi Nekludovin me një vëmëndje të posaçme. — Nuk e di në se çështja e saj ' ka kaluar në gjyq apo jo.

— Gjyqi i saj u bë dje. E dënuan gabimisht me katër vjet punë të detyruar. Ajo është e pafajëshme.

— Ju kuptoj. Nëqoftëse nuk ka dalë në gjyq më parë, po dje. siç po më thoni, — foli prokurori, pa i dhënë asnjë rëndësi pohimit të Nekludovit mbi pafajësinë e Masllovës, — ahere, gjersa vendimi kundra saj të marrë një formë të prerë, ajo mbahet në burgun e të paraburgosurve. Takimet atje bëhen në ditë të caktuara. Ju këshilloj, pra, të drejtoheni atje.

— Mua s'më pret puna. Duhet të takohem me të sa më parë, — tha Nekludovi dhe parandjeu që çasti vendimtar po afrohej, se nofulla e poshtëme po i dridhej dhe ai s'ishte në gjëndje ta përmbante.

— Po përse doni ta takoni? — pyeti prokurori duke ngritur disi vetullat përpjetë me një çqetësim të lehtë.

— Se, duke qenë e pafajëshme, është dënuar me punë të detyruar. Fajtori i vërtetë jam unë, — tha Nekludovi me një zë të prerë nga drithërima. duke u penduar padashur ngaqë kish folur më tepër nga ç'duhej.

— Po si kështu? — pyeti prokurori.

— Po sepse unë e mashtrova dhe e solla n'atë gjëndje në të cilën ndodhet tani. Sikur të mos kisha qenë unë, ajo nuk do të kishte pësuar atë që pësoi.

— Prapë, unë nuk kuptoj ç'lidhje ka kjo me takimin. . .

— Ka këtë lidhje se unë dua të përkujdesem për të. . . të martohem me të, — tha Nekludovi dhe, ashtu siç i ngjiste gjithmonë kur e zinte këtë në gojë, sytë iu mbushën me lot.

— Ashtu? Aha, ja si qenka puna! — ja bëri prokurori. — Ky është një rast vërtet i jashtëzakonshëm. Në s'gabohem, ju jeni ai princi Nekludov që ka qenë dikur anëtar i zemstvos së Krasnoperskut. . .

Prokurori e tha këtë sikur ishte hera e parë që dëgjonte të fliitej për princin Nekludov, i cili vinte e i njoftonte tani një vendim aq të çuditshëm.

— Më falni, po unë nuk mendoj që kjo të ketë ndonjë lidhje me lutjen time, — u përgjegj me inat Nekludovi dhe fytyra atë çast iu prish.

— Jo, jo, ta pret mëndja, — u ngut të thoshte prokurori, me një buzëqeshje të lehtë e i qetë, — po dëshira që më shprehët është kaq e rrallë, sa që, si t'ju them, sikur nuk pajtohet me format e zakonshme. . .

— T'i biem shkurt: do të ma jepni lejën?

— Lejën? Po, po. Ja, tani do t'ju lëshoj një leje-kalimi. Merrni mundimin të uleni e të pritni një minutë.

Ai shkoi e u ul përpara tryezës e nisi të shkruajë.

— Uluni, ju lutem.

Nekludovi vazhdonte të qëndronte në këmbë.

Pasi e shkroi pusullën, prokurori u ngrit e ja dha Nekludovit, duke ja ngulur sytë në këtë e sipër me kureshtje të madhe.

— Duhet t'ju bëj të ditur gjithashtu, — tha Nekludovi — që këtej e tutje nuk do të marr më pjesë në seancat e gjyqit.

— Për këtë, siç e dini, duhet t'i paraqitni gjyqit arësyet që ju shtrëngojnë të largoheni. . .

— Arësyet janë këto: sipas mendimit tim, gjyqi, çdo gjyq, jo vetëm që nuk është i nevojshëm, por, për më tepër, është i dëmshëm dhe imoral!

— Ju kuptoj, — tha prokurori dhe, me atë buzëqeshjen e lehtë që bëri, dha të kuptohej se s'ishte hera e parë që dëgjonte të tilla deklarata, sipas mendimit të tij, boshe dhe qesharake. — Ju kuptoj, por besoj se edhe ju, nga ana

juaj, e kuptoni që mua, si prokuror i gjyqit, nuk më përket t'ju jap të drejtë. Prandaj, ju këshilloj t'i drejtoheni me lutje gjyqit dhe ai pastaj, sipas rastit që do t'i shikojë të arësyeshme apo jo pretendimet tuaja, mund t'ju çlirojë nga përgjegjësia që mbani, duke ju detyruar të paguani eventualisht ndonjë gjobë. Kështu, pra, drejtohuni gjyqit.

— Gjersa ju vura juve në dijeni, s'kam përse t'i drejtohem gjyqit! — tha me të rreptë Nekludovi.

— Nderimet e mia, — i dha fund bisedës prokurori dhe kërrusi kokën duke dashur, me sa dukej, ta hiqte qafe sa më shpejt atë vizitor të çuditshëm.

— Kush qe ai? — e pyeti një gjykatës që hyri në zyrën e prokurorit, kur Nekludovi po dilte.

— Një farë Nekludovi. E dini cili është ky? Ju kujtohet ai princi në distriktin e Krasnoperskut që deshi të bënte ca reforma të çuditëshme? Ja, ai, dora vetë. Dhe, me sa duket, ka akoma të tjera marrëzira për të bërë, se erdhi këtu e më tha që bën pjesë në zhuri, se në radhët e të pandehurve është edhe një vajzë, apo një grua, që është dënuar me punë të detyruar, të cilën, siç thotë, e ka mashtruar dikur e tani do ta marrë për grua.

— Sikur s'më besohet. . .

— Kështu të paktën më tha. . . po duket që s'është në të.

— Tek këta të rinjtë sot sikur vrehet një farë anormaliteti.

— Ai nuk është edhe aq i ri. . .

— Me që ra fjala, atë Ivashenkovin ju e ngritët në qiell, por, në doni t'jua them troç, na mërziti, për fjalë të nderit na mërziti! Flet e flet e s'pushon kurrë. Duket kërkon t'i fitojë davatë me fjalë.

— Disave si ai, ç'është e vërteta, është më mirë t'ua mbyllësh gojën, se ndryshe ka rrezik të bëhen obstruksionistë. . .

XXXVI

Nekludovi doli nga zyra e prokurorit dhe shkoi drejt e në burgun e të paraburgosurve. Po i thanë se atje nuk ndodhej ndonjë e arrestuar me emrin Masllova. Drejtori, me të cilin foli Nekludovi, e këshilloi ta kërkonte në burgun e vjetër të distriktit.

Nekludovi shkoi atje.

Ekaterina Masllova ndodhej me të vërtetë në burgun e vjetër. Prokurori kishte harruar që, aty e gjashtë muaj më parë, kishin ndodhur disa turbullira politike dhe, si pasojë, godina e të paraburgosurve qe mbushur plot e përplot me studenta, me mjekë, me punëtorë, me kursista dhe me gra infermiere.

Burgu i vjetër mbante shumë larg dhe Nekludovi arriti atje vetëm aty ndaj mbrëmjes. Ai deshi t'i afrohej derës së ndërtesës së madhe të burgut, që ngrihej e zymtë përpara tij, por u ndalua nga roja, që i tha të priste dhe i ra, ndërkaq, ziles që ndodhej në mur. Një gardian, që doli pas pak, kur Nekludovi i tregoi leje-kalimin e prokurorit, i tha se, pa qenë aty drejtori, nuk mund ta lejonte. Nekludovi shkoi atëhere të takohej me drejtorin në shtëpi. Tek ngjiste shkallët e shtëpisë, dëgjoi ca tinguj të një pjese muzikore fort të ngatërruar të luajtur në pjano. Kur pastaj, pasi trokiti, u dha në derë një kamarjere me një fytyrë të ngrysur e me një sy të lidhur, tingujt që dëgjoheshin tani fare çkoqur, iu duk se dilnin e shpërthenin jashtë nga dhoma. Pjesa, e luajtur me një mjeshtëri vërtet të rrallë, por vetëm gjer në një farë vëndi, ishte rapsodia e mirënjohur e Listit. Kur arrinte tek ai vëndi i caktuar, pjesa përsëritej rishtas që nga fillimi. Kamerierja me sy të lidhur, pas pyetjes që i bëri Nekludovi, tha se drejtori nuk ndodhej në shtëpi.

— Dini gjë kur kthehet?

Rapsodia ngeci përsëri, dhe përsëri nisi me bujë e me gjallëri, nga e para e gjer tek vëndi i magjepsur.

— Nuk e di. Po shkoj të pyes.

Kamarierja u largua.

Rapsodia porsa kishte filluar të shpërndante në të katër anët tingujt e saj kumbonjës, kur, papritmas, u pre pa arritur dot tek vëndi i caktuar.

— Thuaj që nuk është këtu dhe që është e kotë të presë, se sonde është mysafir tek disa miq e nuk vjen. Çudi e madhe me këta njerëz, do t'ua thuash njëmijë herë që ta marrin vesh! — u dëgjua një zë fëmre që vinte nga pas derës dhe, fill pas tij, përsëri tingujt e rapsodisë që u ndërprenë papritmas edhe këtë radhë nga zhurma e një karrigeje që shtyhej me inat. Siç dukej, pjanistja e besdisur, deshte t'i shkrehej vetë në fytyrë vizitorit kokëfortë që vinte dhe e shqetësonte në një kohë aq të papërshtatëshme.

— Babai nuk është këtu, — tha me të rreptë, duke u afëruar në derë pjanistja, që ishte një vajzë me flokë të shpupuritura, e zbetë, me një shprehje mjerimi në fytyrë, me ca sy të trishtuar e të prerë. Por, kur pa përpara djaloshin dhe pallton e mirë që kishte veshur, nga e zymtë që ish, u çel menjëherë e vazhdoi me të butë: — Hyni, ju lutem. . . përse jeni munduar?

— Dua të takohem me një grua që ndodhet në burg.

— Për arësye politike, sigurisht.

— Jo, për arësye të tjera. Për këtë kam marrë dhe një autorizim nga prokurori i gjyqit.

— Nuk di si t'ju them. Babai nuk është këtu. Por urdhëroni, urdhëroni brënda, ju lutem. . . Pse nuk shkoni një herë tek zëvëndësi? Bisedoni me të se mbase mund t'jua mbarojë punën. Tani besoj do të jetë në zyrë. . . Juve si ju quajnë?

— Ju falem nderit! — ja preu shkurt Nekludovi, pa iu përgjegjur pyetjes, dhe doli.

Dera nuk qe mbyllur mirë pas tij, kur buçitën përsëri tingujt gazmorë, plot hov e gjallëri, të rapsodisë që nuk përshtateshin as me vëndin dhe as me fytyrën e mjeruar të vajzës shëndetligë, që tregonte aq zell në muzikë. Në oborr Nekludovi ndeshi me një oficer të ri, me një palë mustaqe të ngjyera me bojë, të kthyera përpjetë, dhe iu lut t'i tregonte se ku mund ta gjente ndihmës-drejtorin e burgut. Ai ishte vetë zëvëndës drejtori. Si e mori në dorë autorizimin e Nekludovit dhe e lexoi, i tha që ajo pusullë i drejtohej burgut të të paraburgosurve e jo burgut të vjetër. Pra, nuk kishte mundësi që Nekludovi të takohej me të burgosurën, për të cilën bëhej fjalë në leje-kalimin e prokurorit. Veç kësaj, edhe koha nuk qe e përshtatur, se po ngrysej. . .

— Merrni mundimin të vini përsëri nesër. Nesër në ora dhjetë ka takim për të gjithë; do të jetë dhe drejtori këtu, kështuqë, po të doni, mund të bisedoni gojarisht me të. Po t'jua lejojë ai takimin me të burgosurën që ju intereson, mund ta bëni vetëm me të në zyrë e jo përmes hekurave, siç është rregulli.

Nekludovit s'i mbetej gjë tjetër veçse të kthehej në shtëpi. I shqetësuar nga mendimi i takimit të afërt me Masllovën, ai ecte rrugës duke sjellur ndërmënd, jo më gjyqin, por bisedat që kishte patur me prokurorin dhe me drejtorët e burgjeve. Ishte kaq i tronditur nga hapat e para që kishte bërë për t'u takuar me të, duke mos ja fshehur prokurorit

vendimin që kishte marrë e duke shkuar në dy burgjet me radhë për ta kërkuar, saqë nuk e ndjeu veten dot të qetë për një kohë të gjatë. Kur mbrrijti në shtëpi, nxori nga një sirtar ditarin që e kishte harruar aty prej kohësh dhe, si lexoi aty këtu ndonjë faqe, shkroi këto radhë: «Kam dy vjet që nuk shkruaj në këtë ditar dhe kisha vendosur të mos merresha më kurrë në jetën time me një çilimillëk si ky. Por tani e kuptoj që ky s'është një çilimillëk, po një bisedë me veten time, me atë unin e vërtetë e hyjnor, që rron në secilin nga ne. Ky «uni» im ka qenë në gjumë dhe prandaj gjer më sot unë s'kam patur me kë të bisedoj. Por ngjarja e jashtëzakonëshme e 28 Prillit në gjyq, ku mora pjesë si anëtar i zhurisë, e zgjoi më në fund nga gjumi. Unë e pashë Katjushën, vajzën që mashtrova dikur, me rrobat e burgut, në bankën e të akuzuarve. E dënuan me punë të detyruar për gabimin tim e për një keqkuptim të çuditshëm që na ndodhi. Sot isha tek prokurori. Shkova edhe në burg, por nuk më lanë të takohesha me të. Sidoqoftë, kam vendosur të bëj çmos që ta takoj, që t'i bie në gjunjë duke i kërkuar ndjesë, për të ndrequr më në fund fajin tim të madh karshi saj, qoftë edhe duke e marrë për grua. O zot, ndihmomë! Kurrë herë tjetër shpirti im nuk ka qenë kaq i qetë, kaq i gëzuar!»

XXXVII

Atë natë Masllova nuk fleti fare. Rrinte syhapur, vështronte derën që zihej or'e çast nga e bija e dhiakut, e cila vërtitej posht'e lart, dëgjonte se si rënkonte flokëkuqja e mendohej.

Mendonte që nuk do të martohej kurrë me ndonjë të burgosur atje në Sakalin. Përkundrazi, do të bënte çmos që të shtinte në dorë ndonjë drejtor burgu, ndonjë sekretar apo ndonjë gardian ose, të paktën, ndonjë ndihmës-gardian. Ajo e dinte mirë që ata do t'i vardiseshin që të gjithë. «Vetëm të mos dobësohem, ta ushqej veten, se ndryshe do ta kem keq». Masllovës iu kujtua se si e kishin vështruar në gjyq akovati mbrojtës, kryetari dhe shumë të tjerë. Iu kujtua shoqja e saj, Berta, që kishte ardhur një ditë ta shikonte dhe i kish folur për një student që ajo e kish dashuruar. Studenti, sipas fjalëve të Bertës, kur nuk e kishte gjë-

tur më Masllovën në shtëpinë publike të Kitajevës, qe mërzitur shumë. Iu kujtua zenka me flokëkuqen dhe i erdhi keq për të. Iu kujtua furrxhiu, që i kishte falur një bukë. Iu kujtuan edhe shumë ngjarje e njerëz të tjerë, përveç Nekludovit. Fëmininë, rininë, e sidomos dashurinë që kishte patur dikur për Nekludovin ajo s'i kujtonte kurrë. Këto kujtime ruheshin të paprekura diku thellë në shpirtin e saj. Ajo s'e shihte më Nekludovin as në gjumë. Atë ditë në gjyq, nuk e kishte njohur. Dhe kjo kishte ndodhur jo vetëm sepse herën e fundit që qe takuar me të, ai qe veshur me uniformë ushtarake, dhe s'kish mjekër, por vetëm dy fije mustaqe të holla mbi buzë dhe ca flokë të shkurtëra, të dëndura e kaçurrel, kurse tani kishte pamjen e një burri të pjekur, me mjekër e me thinja, por, sidomos, sepse duke mos i rënë më ndërmënd për të, ajo pothuaj e kishte harruar fare. Masllova i kishte varrosur të gjitha kujtimet e largëta të rinisë së saj atë natë të zezë e të frikëshme, kur ai u kthye nga ushtëria dhe s'u ndal tek tetot, siç bënte përherë.

Pa ardhur akoma ajo natë, shpresonte se ai do të vinte përsëri të takohej me të, dhe s'bëhej merak për foshnjen që do t'i lindte. Përkundrazi, ngashërohej e gëzohej kur ndjente se si i lëvrinte e i hovte në bark. Por, pas asaj nate, çdo gjë ndryshoi. Foshnja u bë për të një pengesë.

Tetot e pritnin Nekludovin, e kishin lutur që të ndalej në udh'e sipër në shtëpi të tyre, si zakonisht; mirëpo ai u dërgoi një telegram duke i njoftuar se duhej të ndodhej sa më parë në Petreburg. Kur Katjusha e mori vesh këtë, vendosi të shkonte vetë në stacion që ta takonte. Treni kalonte andej nga ora dy e natës. Katjusha u ndihu zonjave që të çvishen dhe, pasi ato ranë e fjetën, mori me vete një vajzë të vogël, që ishte e bija e Mashkës, e gjellëbërëses, mbathi ca brashnja të vjetëra, u ndreq, u rregullua dhe vrapoi në stacion.

Ishte një natë e errët vjeshte, me erë e me shi. Shiu herë binte rrëke me ca pika të mëdha, të vakëta, herë pushonte. Nëpër ara qe errësirë e madhe sa s'shihje ku të vije këmbën, kurse pylli ishte i zi sterrë. Katjusha, sadoqë e njihte mirë rrugën, humbi nja dy herë nëpër pyll, kështuqë arriti në stacion, ku treni qëndronte gjithë-gjithë vetëm tri minuta, jo në zilen e parë, siç shpresonte, por në të dytën. Vrapoi mbi platformë dhe menjëherë e pa atë në dritaren e një vagoni të klasës së parë. Vagoni qe i ndriçuar



fort. Dy oficerë i kishin hequr redingotat, qenë fundosur në ca kolltuqë të veshur me kadife dhe po luanin me letra. Mbi një tryezë të vogël pranë dritares digjeshin me flakë ca qirinj të trashë, të trashur edhe më tepër nga rrëketë e dyllit të çkrirë. Ai qe ulur mbi mbështetësen e një kolltuku e qëndronte ashtu, me bërrylin mbështetur mbi shpinzë. Këmisha e bardhë e pantallonat e ngushta, të kollarisura, i shkëlqenin nga drita e qirinjve. Atë kohë se përse po qeshte. Ajo. porsa e njohu, trokëlliti me dorën e mardhur në xhamin e dritares. Por, pikërisht atë çast, ushtoi tringëllima e ziles së tretë dhe treni nisi të tundej dalngadalë, me një lëvizje sëprapthi në krye, gjersa mori hov e bëri përpara. Vagonat kalonin varg njeri pas tjetrit duke u tronditur. Njeri nga ata të dy që po luante, u ngrit e vështroi jashtë. Ajo trokiti përsëri dhe e ngjeshi fytyrën pas xhamit. Por atë kohë i erdhi radha të tundej edhe vagonit të klasës së parë. Vagoni lëvizi, ajo i ra pas dhe sytë i mbante ngulur në dritare. Oficeri u orvat të ulte xhamin, por s'mundi. Atëhere Nekludovi u ngrit dhe, si e shtyri mënjanë shokun, u muar vetë me xhamin. Treni, ndërkaq, e kishte rritur shpejtësinë. Edhe ajo e shpejtoi hapin që të mos mbetej pas. Por treni lëvizte përherë e më shpejt dhe, tamam në çastin kur xhami më në fund u ul gjer poshtë, konduktori e shtyu Katjushën e këceu në vagon. Katjusha mbeti pas, por prapë vazhdonte të vraponte mbi dhogat e lagura të platformës; kur platforma mbaroi, mënt u rrëzua, por u mbajt në kohë. Vazhdonte të vraponte, por vagoni i klasës së parë kishte shkuar tani shumë përpara. Pranë saj lëviznin vagonat e klasës së dytë dhe, pas tyre, akoma më të shpejt, vagonat e klasës së tretë. Por, megjithatë, vazhdonte të vraponte. Kur kaloi edhe vagoni i fundit me fenerin e kuq pas, ajo ndodhej në një vënd të pambrojtur, që rrihej nga era. Era iu turr me furi, i shkuli nga koka shaminë, i fshikulloi këmbët me cepat e fustanit të gufuar. Shamia ra përdhe, iku ku e shpuri era, por ajo prapë s'ndalej e vraponte.

— Teto Mihaillovna! — thërriste vajza e vogël që e shoqëronte dhe që s'e ndiqte dot më. — Ju ra shamia!

«Ai rri në një vagon me dritë të klasës së parë, mbi një kolltuk të butë të veshur me kadife, e pi, e qesh e zbavitet, kurse unë këtu, në baltë, në errësirë, nën shi e nën erë, rri e qaj. . .» — mendoi Katjusha dhe u ndal, e hodhi kokën pas, e pushtoi me të dy duart dhe u shkreh në vaj.

— Iku! — tha.

Vajza u trëmb dhe e përqafoi duke i hedhur duart përmbi fustanin e saj të lagur.

— Teto Katja, hajt të kthehemi në shtëpi!

«Do të kalojë një tren tjetër pas këtij, atëhere hidhem nën të e i jap fund!» — mendonte ndërkaq Katjusha, pa ja vënë veshin voglushes.

Vendosi të bënte ashtu siç mendoi. Por, aty për aty, siç ngjet zakonisht pas një tronditjeje shpirtërore të rëndë, fëmija, fëmija e saj, befas, lëvriu në bark duke i shkaktuar një dhëmbje të fortë, por të këndëshme. Dhe ja, menjëherë, çdo gjë që e kishte menduar gjer ahere, mendimi i llahtarshëm se tani nuk mund të rronte më, inati i tërbuar kundër atij dhe dëshira e shfrenuar që të hakmerrej, qoftë edhe me vetvrasje, të gjitha këto u zhdukën pa lënë gjurmë. E mori veten, u qetësua, ndreqi fustanin, mbështolli kokën me shami dhe nxitoi të kthehej në shtëpi.

U kthye në shtëpi e dërmuar, e lagur, e ndohtur. Kthesa e thellë shpirtërore, që e solli Katjushën n'atë gjëndje në të cilën ndodhej tani, filloi tek ajo që atë natë. Që atë natë të llahtarëshme ajo nuk besoi më në drejtësinë. Që atë natë u bind se asnjeri nuk besonte në drejtësinë dhe kuptoi se të gjithë ata që flisnin për zotin e për drejtësinë, e bënin këtë vetëm e vetëm për t'i mashtruar njerëzit. Njeriu që ajo kish dashuruar dhe që e kishte braktisur duke u tallur me ndjenjat e saj, ishte më i miri nga të gjithë njerëzit që ajo kishte njohur. Të tjerët qenë shumë më të liq nga ai. Këtë ja vërtetuan përdit'e më tepër ato që i ndodhën më vonë. Tetot e tij, ato dy plakat që, siç thonin, rronin me frikën e perëndisë, e dëbuan menjëherë porsa panë që nuk ishte më e zonja t'u shërbente, siç u kishte shërbyer më parë. Kurse njerëzit e tjerë, kur, qenë gra, mundoheshin ta shfrytëzonin për interesin e tyre, kur qenë burra, i vinin rrotull duke parë tek ajo vetëm një mjet kënaqësie. Dhe dukej se në botë nuk kishte asgjë tjetër përveç asaj kënaqësie që kërkonin ata tek ajo. Këtë mendim ja kishte përforcuar Masllovës edhe më tepër shkrimtari plak me të cilin ajo u lidh një vit pasi filloi të rronte e lirë. Ai i foli hapur e i tha se pikërisht këtu (ai këtë e quante poezi dhe estetikë) qëndronte tërë lumturia e njeriut.

Të gjithë, pra, rronin vetëm për veten e tyre, vetëm për kënaqësin'e tyre, kështuqë të gjitha fjalët që thuheshin për zotin dhe për drejtësinë, qenë gënjeshtra. Prandaj për njeriun është e kotë të vrasë mëndjen përse bota është ndër-

tuar kaq keq dhe përse njerëzit mundohen si e si t'i bëjnë të ligën njeri-tjetrit. Kështu është, s'ke ç'i bën. Ti, po u mërzite, ndiz një cigare, pi një gotë verë, apo, më mirë bjerë në dashuri, po munde, me një mashkull, e ke për të parë se do të të kalojë.

XXXVIII

Të nesërmen, që ishte e dielë, n'orën pesë të mëngjesit, kur në koridorin e burgut të grave u dëgjua bilbili i zakonshëm i gardianit, Korableva, që nuk flinte, e zgjoi Masllovën nga gjumi.

«Katorga» — mendoi me tmer Masllova duke fërkuar sytë e duke thithur, pa dashur, ajrin e prishur të qelisë. U mat një herë t'i mbyllte përsëri sytë e të zhytej rishtas në botën e vetëdijes së fjetur. Por frika që i kishte hyrë në palcë e detyroi të ngrihej; i mblodhi këmbët nën vete, ndënji mbi shtrat dhe i hodhi sytë rreth e rrotull. Kontrabandistja me sy të kërcyer po hiqte me kujdes nga shtrati rrobat e burgut, ku qenë shtrirë e flinin fëmijët e saj. E burgosura për rebelizëm po varte për t'u tharë rreth sobës ca rrecka që i përdorte si pelena, ndërsa i biri atë kohë qante e sokëllinte në krahët e Fedosjes që lëkundej bashkë me të dhe e nanuriste me një zë të butë e t'ëmbël. E veremosura i kishte ngjeshur të dy duart mbi krahëror e kollitej. Fytyra i qe skuqur dhe, sa herë që pushonte për të marë frymë, nxirrte një zë që ishte pothuajse si një klithmë. Qe zgjuar edhe flokëkuqja, por vazhdonte të rrinte shtrirë me barkun kthyer nga tavani. Atë kohë i kishte kthyer këmbët e trasha e po u tregonte shoqeve me zë të lartë e duke qeshur një ëndër që kish parë. Plaka, që mbahej në burg për djegëje, qëndronte përpara ikonës, belbëzonte tërë kohës po ato fjalë, kërrusej e bënte kryqin. E bija e dhiakut kish ndënjur mbi shtrat e rrinte si e mpirë duke hedhur një vështrim të përgjumur e të topitur diku përpara saj. Bukuroshja përdridhte me gisht flokët e saj të zez, të dëndur e të lyrshëm.

Në koridor u dëgjuan disa hapa të rënda dhe, fill pas tyre, u dëgjua zhurma e çelësit që vërtitej në bravë. Dera u hap dhe hynë dy të burgosur që mblidhnin plehrat. Këta qenë veshur me disa tuta të mbyllura e me pantallona të

shkurtëra bojëhiri që s'u arrinin as gjer te kërcinjtë. Me ca fytyra të ngrysura e të rrepta, ata e ngarkuan vozgën e qelbur të plehrave mbi supet e tyre dhe duallën jashtë. Pas pak, duallën edhe gratë dhe u grumbulluan për t'u larë rreth çezmave në koridor. Këtu flokëkuqja u përlesh përsëri me një të burgosur tjetër të një qelie pranë. Përsëri të shara, të thirrura, të qara. . .

— Do t'ju hedh në podrum, ta dini! — u thirri gardiani dhe i dha flokëkuqes një grusht në kurrizin e zveshur e të dhjamur, sa gjëmoi në tërë koridorin. — Herë tjetër mos të ta dëgjoj zërin, more vesh?

— Hej, plakushi! Ç'ma punoka dorën djalli! — tha flokëkuqja që e ktheu punën në shaka.

— Hajt, shpejt! Bëhuni gati, se do të shkoni në kishë!

Masllova po krihte flokët, kur atë çast erdhi aty drejtori i burgut bashkë me suitën.

— Kontrolli! — thirri me zë të lartë një gardian.

Duallën edhe të burgosurat, që ndodheshin në qelinë tjetër, dhe që të gjitha u vunë në rresht, për dy. Ato të rreshtit të dytë vunë duart mbi supet e shoqeve të tyre të rreshtit të parë. Pastaj gardiani filloi numurimin.

Pas kontrollit, gardiania i mori të burgosurat dhe i çoi në kishë. Masllova dhe Fedosja ndodheshin andej nga mezi i kolonës, që përbëhej nga më se njëqind gra. Që të gjitha kishin vënë shami të bardha në kokë. Të bardha qenë gjithashtu edhe bluzat e fundet, që kishin veshur dhe vetëm më të rrallë dukej aty-këtu ndërmjet tyre ndonjë grua e veshur ndryshe. Procesioni i të burgosurave e mbulonte shkallën tejpërtej. Dëgjohej trokëllima ritmike e këmbëve, dëgjoheshin zëra e të qeshura. Në një të kthyer të koridorit. Masllova vuri re fytyrën e egër të armikes së saj, të Boçkovës, që ecte disa hapa përpara dhe ja tregoi Fedosjes. Kur zbritën poshtë, të burgosurat heshtën menjëherë që të gjitha e, duke bërë kryqin, kapërxyen prakun e kishës, që ishte akoma bosh, por që shkëlqente nga llambadhat dhe nga pasqyrimet e forta të ikonave të veshura me ar. Gratë, dora dorës që hynin, shtyheshin e ngjesheshin me njera tjetrën, për të zënë vënd kush e kush më përpara, në të djathtë. Fill pas grave, hynë radhas në kishë burrat, të burgosurit kalimtarë, të burgosurit që e kishin kryer dënimin e qenë në pritje të lirimit, si edhe të burgosur të tjerë. Ata qenë veshur me ca tuta bojëhiri dhe, ndërsa kolleshin me të madhe, vinin e ngjisheshin në krahun e majtë e në qëndër të kishës. Sipër, në lloxhat e korit, kishin zënë

vënd qëkur nga njera anë, të dënuarit me punë të detyruar në Siberi, me kokët e tyre gjysmë të rruara e me prangat që u tringëllinin dhe, nga ana tjetër, pa pranga e të pa rruar, të burgosurit që ende s'kishin dalë në gjyq.

Kisha e burgut, që fekste e tëra nga ngjyrat e ndezura dhe nga ari i kulluar i ikonave, qe ndërtuar e stolisur rishtazi nga një tregëtar i pasur, që kishte harxhuar në këtë vepër disa dhjetra mijë rubla.

Në kishë pllakosi një heshtje. Dëgjoheshin vetëm, atykëtu, të kollitura, heqje hundësh, piskama fëmijësh e, më të rrallë, tingëllimat e prangave. Por, befas, turma u nda më dysh, të burgosurit u ngjeshën nga të dy anët dhe, në hapësirën që u formua në këtë mënyrë, kaloi drejtori i burgut i cili shkoi e u vendos në krye, në mes të kishës.

XXXIX

Shërbesa fetare filloi.

Prifti, si vuri petrahilin prej kumashi të qendisur, mori një meshë, e theu, i hodhi copërat në një dhisk e që andej në një kupë me verë, duke i shoqëruar të gjitha këto veprime me emra dhe lutje gjithfarësh, të cilat i shqiptonte me zë të lartë. Dhiaku, në fillim, nisi të lexojë pa rreshtur, pastaj, duke u shkëmbyer me korin e të burgosurve, këndonte ca lutje sllave që ishin krejt të pakuptueshme, ca nga gjuha e moçme, në të cilën qenë shkruar, e ca më tepër nga mënyra e shpejtë me të cilën këndoheshin. Sidoqoftë, merej vesh nëpër të se lutjet përthirrnin hirin e perëndisë, që duhej të zbriste mbi madhërin' e tij perandorin e mbi familjen mbretërore. Posaçërisht për këtë u kënduan lutje të shumta qoftë bashkë me të tjerat, qoftë edhe veçmas, në gjunjë. Dhiaku lexoi gjithashtu edhe disa radhë nga Veprat e apostojve, me një zë kaq të çuditshëm e të ndemë, saqë s'u muar vesh asgjë, ndërsa prifti, nga an'e tij, lexoi shumë bukur një pjesë nga ungjilli sipas Markut. Në të thuhej që Krishti, si u ngjall së vdekuri, më parë se të hypte në qiell e të unjej mb'anë të djathtë të perëndisë, iu duk të parën herë Marisë Magdhalinës, prej së cilës kishte nxjerrë shtatë djaj. Pastaj iu dëftye edhe të njëmbëdhjetë dishepujve, edhe u tha atyre që të shkonin nëpër gjithë botën dhe të leçitnin ungjillin nëpër gjithë krijesën. Dhe tha se kush të besojë

dhe të pagëzohet, do të shpëtojë dhe, pas kësaj, do të krrejë djaj, gjuhëra të ra do të flasi, gjarpinj do të zërë dhe, në piftë ndonjë farë gjëje që sjell vdekje, nuk do t'i bëjë dëm; përmbi të sëmurët dy duar do të verë dhe do të shërohen.

Mendohej se kuptimi i thellë që kishte kjo shërbesë, ishte se grimcat e bukës që kish prerë urata, pasi shtiheshin në verë dhe pasi bëheshin mbi to ca manipulime e lutje të caktuara, shndërroheshin në trupin e në gjakun e perëndisë. Manipulimet në fjalë ishin gjestet që bënte prifti, i cili, ndonëse e pengonte thesi që kishte shkuar në trup, me një lëvizje të butë e të matur, i ngrinte të dy krahët përpjetë dhe i mbante ashtu një copëherë gjersa, më në fund, binte në gjunjë për të puthur tryezën dhe sendet që ndodheshin përmbi të. Por veprimi kryesor ishte ky: prifti kapte me të dy duartë pecetën dhe, me një lëvizje ritmike, e tundte nja dy a tri herë përmbi dhiskun e kupën e florinjtë. Mendohej që pikërisht në këtë çast nga buka e nga vera bëhej mishi e gjaku dhe, prandaj, kjo pjesë e shërbesës kryhej me një madhështi të posaçme.

— «Ndërmjetëso për shpëtimin tonë, o e shënjtëruara, o e papërlyera, o e shumëbekuara zonja Shën Mëri» — thirri pas kësaj me zë të lartë prifti mb'anë tjetër të ikonostasit; kori ja ktheu menjëherë, triumfonjës e gazmor, duke e lavdëruar zonjën Shën Mëri, që e kish lindur Krishtin pa e cënuar barkun e saj të virgjër, që nderohej e mbahej lart në mbretëri të qiejve nga ca kerubinë e nga ca serafimë. Pas kësaj mendohej se shndërrimi i verës në gjak e i bukës në mish kish marrë fund. Prifti, duke e zbuluar dhiskun, që e kish mbuluar me pecetë, e pjesëtoi rriskën e mesit në katërsh dhe e shtiu më parë në verë e pastaj në gojë. Mendohej se ai kishte ngrënë kështu një copë nga trupi i zotit dhe kishte pirë një gllënjkë nga gjaku i tij. Si e bëri dhe këtë, prifti hodhi perden, hapi derën e mesit dhe i ftoi besnikët të shijonin edhe ata mishin e gjakun e perëndisë, që përmbahej në kupë.

Menjëherë hovën përpara ca fëmijë.

Prifti i pyeti më parë fëmijët se si i quanin, pastaj, duke mbushur me kujdes të madh, që të mos derdhej, një lugë të vogël me verë ja shtiu sejcilit në gojë. Ndërkaq, dhiaku që i vinte pas, ua fshinte buzët fëmijëve me pecetë e me një zë gazmor këndonte e thoshte që fëmijët hanin nga trupi i perëndisë e pinin nga gjaku i tij. Pas kësaj, prifti e shpuri kupën në tryezën e shënjtë, pas ikonostasit, e si

piu atje ç'kish mbetur nga gjaku e si hëngri ç'kish tepruar nga mishi i zotit, doli që andej çakërqejf, duke i përplasur me të fortë çizmet prej lëkurë viçi që i kërcisnin në çdo hap.

Me kaq mesha merrte fund. Mirëpo prifti, duke dashur t'i ngazëllejë edhe ca më tepër të burgosurit e mjerë, i bëri shërbesës një shtojcë. Qëndroi, pra, përballë fytyrës së zotit të hamëndshëm, të cilit i falej, t'atij zoti të cilin ai e kish ngrënë pak më parë e që përfaqësohej aty nga një ikonë veshur me ar, me duart dhe fytyrën të nxira nga koha, rrethuar me ndonja dhjetë qirinj të trashë prej dylli që flakëronin dhe e ndriçonin. Prifti, pra, si u vendos aty, nisi të bërbëliste ca lutje e ligjërime të çuditëshme:

— «Të falem ty, o Krisht, që të më shpëtosh, se ti, o Krisht, perëndia ime, je i ëmbël e i butë si shqerrat, se ti, o Krisht, je lavdëresa e apostujve dhe përthirimi i martirëve dhe mbajtësi i gjithësisë. Të falem ty, o Krisht, perëndia ime, që të më përdëllesh dhe me ndërmjetësinë e mëmës tënde e të të gjithë shënjtorëve të tu, e të të gjithë atyre që kanë bërë profeci n'emrin tënd, të më falësh mua mëkatat. Shpëtomë, o Krisht, perëndia ime, e ruajmë mua, o Krisht, o njeridashës, të mirat e parajsës!» Kur arriti këtu, urata ndali një hop, mori frymë e u kërrus mbi dhe; po ashtu bënë të gjithë. U kërrus drejtori, u kërrusën mbikqyrësit e u kërrusën të burgosurit, ndërsa atje sipër, në llozhat e korit, u dëgjua më e dëndur këtë radhë zhurma e prangave që tringëllinin.

— «Ti që krijove engjëjt e fitove fuqi perëndie, — vazhdoi ai — ti, o Krisht, që habite engjëjt me mrekullit'e tua, ti, o Krisht, që e çlirove fisin tënd, ti, o Krisht, që me urtësinë tënde fitove adhurimin e patriarkëve, ti, o Krisht, që je në lavdinë tënde forcimi i carëve, ti, o Krisht, që përmbushe me mirësinë tënde fjalën e profitëve, ti, o Krisht, që me përsosjen tënde shtove durimin tek martirët, ti, o Krisht, që me butësinë tënde ngazëllove shpirtërat e murgjëve të tu, ti, o Krisht, që me zemërqashtërsinë tënde shtove besë ndër ata që agjërojnë n'emër tënd, ti, o Krisht, që me ëmbëlsinë tënde hodhe gaz në priftërinjt'e tu, ti, o Krisht, që me pastërtinë tënde dërrmove kurvërimin, ti, o Krisht, që u përmishërove për shpëtimin e mëkatarëve, o Krisht, o bir i perëndisë, mëshiromë!» — arriti ai më në fund gjer atje ku duhej të ndalej, duke e shqyrtuar përher' e më tepër me vërshëllimë emrin e Krishtit; dhe, si e ngriti pak me dorë rasën që të mos i fëlliqej, theu njerin gju dhe u kërrus për-

dhe, ndërsa kori përsëriste duke kënduar fjalët e fundit të përthëresës:

— «O Krisht, o bir i perëndisë, mëshiromë!»

Të burgosurit uleshin e ngriheshin duke shkundur flokët që u kishin mbetur mbi kafkat gjysmë të rruara, duke tringëllitur me zhurmë në këmbët e tyre të thata prangat e rënda, që i ripnin e i vritnin.

Mesha vazhdoi kështu për një kohë të gjatë. U bënë përthirime që mbaronin me fjalën: «Mëshiromë! e pastaj të tjera përthirime që mbaronin me fjalën: «Aleluja!» Të burgosurit bënin kryqin, kërruseshin e binin në gjunjë. Në fillim kërruseshin pas çdo përthirimi, por pastaj në dy përthirime një herë, e më rrallë. Më në fund përthirimet mbaruan dhe që të gjithë u gëzuan kur panë priftin, që, duke psherëtitur si i lehtësuar nga një barrë e rëndë, e mbylli librin e shërbesave dhe u zhduk pas ikonostasit. Pastaj prifti kreu dhe veprimin e fundit që i kish mbetur akoma pa bërë. Mori një kryq floriri me katër medaljonë tunxhi në të katër cepat, që ndodhej mbi një tryezë të madhe, dhe erdhi e u vendos me të në mes të kishës. Iu afrua uratës dhe e puthi kryqin i pari drejtori i burgut, pastaj ndihmësi i tij, pastaj mbikqyrësit dhe pastaj të burgosurit, që shtyheshin e grindeshin me zë të ultë që të mos mbeteshin pas. Urata, ndërsa bisedonte me drejtorin, zgjaste dorën dhe e shtinte, ashtu me kokën kthyer nga ana tjetër, në gojën e, ngandonjëherë, në hundën e atij që i afrohej e që përpiqej t'i puthte që të dyja: edhe kryqin, edhe dorën. Kështu përfundoi ajo shërbesë e krishterë që kryhej për të kthyer përsëri në vathën e perëndisë delet e humbura.

XL

Dhe asnjerit nga të pranishmëve, duke filluar nga urata e nga drejtori e gjer tek Masllova, nuk i shkonte ndër mënd që Krishti, emrin e të cilit prifti e kishte përsëritur kaq e kaq herë me vërshëllimë, duke i thurur lëvdatë pas lëvdate me njëmijë fjalë e shprehje të çuditëshme, i kish ndaluar rreptësisht të gjitha ato sa bëheshin aty; kish ndaluar jo vetëm llomotitjen e çmëndur e magjirat që kryheshin nga priftërinjtë-mësonjës mbi bukën e mbi verën, por, në një mënyrë të prerë e të përcaktuar mirë, u kishte nda-

luar njerëzve që të hiqeshin mësonjës përmbi të tjerët, kishte ndaluar faljet ndër hieroret, kishte porositur secilin të lutej në vetmin'e tij e i kishte ndaluar edhe vetë hieroret, duke thënë se kish ardhur jo për t'i ndrequr, por për t'i shëmbur, dhe se çdo njeri duhej të falej jo në hierore, por në frymë shënjtërie e vërtetësie; e, sidomos, kish ndaluar që njeriu të gjykohej e të robërohej, që të mundohej, që të poshtërohej e të dënohej, siç bëhej këtu, duke thënë se kish ardhur t'u jepte liri robërve.

Asnjerit nga të pranishmëve nuk i shkonte ndërmënd se të gjitha ato sa kryheshin këtu qenë një bllasfemi e rëndë, qenë një tallje e një shkelje trashanike e porosive të Krishtit. Asnjeriut s'i shkonte ndër mënd se kryqi i florinjtë, i stolisur në të katër cepat me medaljona tunxhi, të cilin urata ua jepte njerëzve që ta puthnin, nuk qe veçse një simbolizim i veglës djallëzore ku Krishti u martirizua pikërisht sepse kish dashur të ndalonte të gjitha ato sa bëheshin tani këtu në emrin e tij. Asnjeriut s'i shkonte ndër mënd se priftërinjtë, të cilët kujtojnë se hanë në trajtën e bukës, trupin e Krishtit, e pinë, nën trajtën e verës, gjakun e Krishtit, e hanë me të vërtetë trupin dhe e pinë me të vërtetë gjakun e tij, por jo ashtu siç mendojnë ata, por duke i mashtruar «ata të thjeshtët në shpirt» me të cilët Krishti deshi të barazohej, duke u mohuar atyre kënaqësinë supreme që buron nga besimi i pastër, duke i munduar egërsisht, duke u fshehur lajmin e asaj të mire të madhe që ai u kishte sjellur.

Prifti i bënte me ndërgjegje të pastër të gjitha këto, sepse, që së vogëli, e kishin mësuar të besonte se ai ishte i vetmi besim i vërtetë të cilit i kishin besuar të gjithë njerëzit e shenjtë që kishin jetuar më parë dhe të cilit i besonin tani edhe krerët e fesë e të shtetit. Që buka shndërrohej në mish e vera në gjak, që disa llomotitje të çthurura i bënin mirë shpirtit dhe se ai kishte ngrënë vërtet nga trupi i zotit, këto, natyrisht, nuk besoheshin, këto nuk i besonte as ai, por ai besonte që duhej patur besim n'atë besim. Dhe prifti kishte të drejtë sepse, duke përmbushur kërkesat e këtij besimi, për tetëmbëdhjetë vjet rrjesht, që kur qe dorëzuar prift, ai kishte marrë me rrogë e me të tjera kaq të holla sa t'i përballonte me to të gjitha nevojat e families, t'i jepte mundësinë djalit të vazhdonte mësimet në gjimnaz dhe ta edukonte të bijën në seminar. Kështu besonte edhe dhiaku dhe besimi i tij qe, mbase, edhe më i

fortë nga ai i priftit, sepse e kishte harruar me kohë kuptimin e vërtetë të dogmave dhe mbante mënd vetëm ato që i duheshin, d.m.th. që uratat, lutjet e shërbesat bëheshin me një çmim të caktuar, të cilin çdo i krishter i mirë e paguante me qef. Prandaj edhe dhiaku thërriste me sa kishte gërmazin: «Mëshirona, mëshirona, o zot!» dhe i këndonte e i lexonte të gjitha mir'e bukur, i sigurt e i qetë, siç mund të jetë një njeri që ka dalë në pazar e shet miell, dru apo patate. Përkundrazi, drejtori i burgut dhe mbikqyrësat, sadoqë nuk i dinin dhe as që ishin interesuar kurrë t'i dinin të vërtetat që fshiheshin pas dogmave të fesë, dhe ç'kuptim kishin të gjitha ato që bëheshin në kishë, besonin se duhej t'i besonin patjetër kësaj feje vetëm e vetëm sepse i besonin edhe eprorët e tyre, bilé edhe cari vetë. Por, veç kësaj, ata ndjenin, sidoqë në të turbullt (se si ndodhte kjo, ata nuk ishin në gjëndje ta shpjegonin), që ai besim e justifikonte detyrën e rëndë që kryenin. Të mos kish qënë ai besim, për ata do të qe jo vetëm e vështirë, por, mbase, edhe e pamundur t'i përdornin të gjitha aftësit'e tyre për t'i munduar njerëzit, ashtu siç bënin tani, me ndërgjegje të qetë. Drejtori, sidomos, ishte një njeri kaq shpirtmirë, saqë kurrë nuk do të mund të rronte, ashtu siç rronte, sikur të mos kish mbështetjen e këtij besimi. Prandaj qëndronte drejt në këmbë e nuk lëvizte, kërrusej e bënte kryqin me zell të madh, dhe përpiqej të mallëngjehej kur këndonin «Bashkë me Kerubinët». Prandaj dhe doli përpara kur nisi kungimi i fëmijëve dhe e mbajti një syresh në duar gjersa u kungua.

Pjesa më e madhe e të burgosurve (duke përjashtuar disa të paktë, që e shihnin kjartë mashtrimin që kryhej mbi njerëzit e këtij besimi, dhe që vetë nuk i besonin por tallëshin me të) besonte se ikonat e qëndisura me ar, qirinjtë, kupat, kryqet dhe fjalët e pakuptueshme që përsëriteshin or'e çast: «Ti, o Krisht, me ëmbëlsinë tënde» dhe «mëshirona» fshihnin një fuqi të misterëshme me ndërmjetësin'e së cilës njeriu mund të kishte të mira të mëdha, si në këtë botë ashtu dhe n'atë tjetrën. Sadoqë shumë prej tyre ishin përpjekur të fitonin ndonjë nga të mirat e kësaj bote me lutje, me qirinj e me përthirime e nuk kishin fituar gjë, ata prapë vazhdonin të besonin me bindje se ky dështim kish qënë i rasëshëm dhe se një institucion, që pranohej nga njerëz të ditur e nga metropolitë, nuk mund të mos ishte shumë

i rëndësishëm e shumë i nevojshëm, në mos në këtë jetë, të paktën n'atë tjetrën matanë.

Kështu besonte edhe Masllova dhe, ashtu si të gjithë, edhe ajo, provonte gjatë meshës një ndjenjë venerate të thellë, ndonëse edhe mërzitej. Në fillim, e rrethuar siç ishte nga turma, nuk shikonte dot asgjë, përveç shoqeve që kishte pranë; por kur gratë që do të kungonin fëmijët duallën në krye, lëvizi edhe ajo bashkë me Fedosjen dhe atëhere vuri re drejtorin e burgut e, pas tij, ndërmjet gardianëve, një muzhik të shkurtër me një mjekër të vogël e të verdhë e me flokë të kuqërreme. Muzhiku, që ishte burri i Fedosjes, e kishte kthyer kokën nga e shoqja dhe e shikonte me ngulm. Masllova e soditi me nge gjatë tërë kohës që vazhduan lutjet. Ndërkaq shkëmbente me zë të ulët me Fedosjen ndonjë fjalë, apo lutej e bënte kryqin, kur shikonte që kështu bënin edhe të tjerët.

XLI

Nekludovi doli herët nga shtëpia. Në rrugicë pa një muzhik që shkonte derë më derë e thërriste me një zë të çuditshëm:

— Qumësht, qumësht, qumësht!

Atë natë kish rënë një shi i vakët pranveror. Kudo, ku nuk kish kalldrëm, bari kish shpërthyer befas përpjetë; mështeknat nëpër kopshte qenë mbuluar me një push të blertë, qershit'e egra dhe plepat kishin nisur të drejtonin gjethet e tyre të gjata, kundërmonjëse. Ndër dyqane e ndër shtëpira njerëzia u kishin vënë dritareve kornizat e i kishin pastruar xhamet që të llamburitnin. Nekludovit i duhej të kalonte përmes pazarit të plaçkave të vjetra dhe atje vuri re një serë çadrash, ku qenë grumbulluar një turmë njerëzish që lëvrinte e gumëzhinte. Varfanjakë të rreckosur silleshin lart e poshtë me ndonjë palë çizme nën sqetull, me ndonjë palë pantallona, apo me ndonjë jelek të hekurosur, hedhur mbi sup.

Punëtorët kishin dalë nga fabrikat dhe ngjisheshin tani përpara dyerve të gjëlltoreve. Burrat qenë veshur me podjofka të pastra e mbanin në këmbë çizme të forta llustrofini. Gratë kishin mbështjellur kokën me shamija të mëndafshta, me ngjyra të ndezura, dhe qenë veshur me pallto

të zbukuruara me xhixha. Policët qëndronin nëpër vëndet e tyre me koburet lidhur në kordona të verdhë duke pritur me padurim ndonjë rast kundravajtjeje që t'u hiqte mërzinë. Nëpër rrugët e bulevardit dhe mbi barin e ri të postatave, fëmijët e qëntë luanin e vraponin, ndërsa dadot që i ruanin, ulur në frona, qeshnin e bisedonin mes tyre.

Nëpër rrugët, që ishin akoma të freskëta e me lagështirë në të majtë, nën hije, dhe të rreshkura në mes, dëgjohej parreshtur kërkëllima e qerreve mbi kalldrëm, kuitja e lehtë e karrocave dhe tringëllima e vagonave që tërhiqeshin nga kuajt. Ajri dridhej nga të katër anët nga kumbimi i larmë dhe gjëmëmadh i kambanave që i ndillnin njerëzit në kishë e i ftonin të merrnin pjesë në një ceremoni si ajo që zhvillohej atë kohë në burg. Dhe njerëzit, veshur e stolisur si për të kremte, shpejtonin hapin dhe drejtoheshin secili për në kishën e tij.

Nekludovi hypi në një karrocë, e cila e shpuri jo tamam gjer tek burgu, por gjer në një të kthyer aty pranë.

Disa njerëz, burra e gra, pjesa më e madhe me ndonjë bohçe në dorë, qenë grumbulluar në të kthyerën që ishte ndo njëqind hapa larg burgut. Në të djathtë dukeshin ca baraka, kurse në të majtë ngrihej një shtëpi dykatëshe përpara sëcilës qe vendosur një tabelë. Burgu, një godinë shum'e madhe prej guri, ndodhej më thellë dhe atje nuk lejonin t'afrohej njeri. Një roje me pushkë vërtitej posht'e lart dhe i ndalonte, duke u thirrur me të rreptë, të gjithë ata që orvateshin të kalonin pa i rënë në sy.


Tek dera e një barake, nga e djathta, qe ulur mbi një fron, përballë rojës, një gardjan me uniformë e me shirita në krah. Njerëzit afroheshin tek ai, i thonin kë donin të takonin dhe ai ua shënonte emrat në një bllok. U afrua aty edhe Nekludovi e tha se deshi të takohej me Ekaterina Masllovën. Gardjani me shirita mori shënim.

— Përse nuk lejojnë akoma? — e pyeti Nekludovi.

— Akoma s'ka mbaruar mesha. Të mbarojë e do t'i lejojnë.

Nekludovi u hoq pas e u bashkua me turmën. Nga turma u shkëput e u drejtua atë çast nga burgu një rreckaman me një kapele të shtypur që e kish ngjeshur mbi kokë, me një palë brashnja të grisura në këmbët e zbathura, me një fytyrë të përshkuar kryq e tërthor nga disa rrypa mavi.

— Hej, ore, ku shkon ashtu? — i thirri ushtari me pushkë.



— Po ti, ç'ke që ulërin? — ja priti rreckamani, pa e prishur fare gjakun, dhe u hoq pas. — Porsa s'më le të kaloj, do të pres... Më ulërin i bir'i botës si të më qe ndonjë gjeneral!

Të gjithë qeshën duke i dhënë të drejtë, me sa dukej, rreckamanit. Vizitorët, në pjesën më të madhe, qenë njerëz të veshur keq, bile edhe të rreckosur, por kishte ndër ta edhe të veshur mirë. Pranë Nekludovit ndodhej një burrë me një kostum fringo të ri, pa mjekër e pa mustaqe dhe i kuq në fytyrë. Në dorë mbante një bohçë ku kishte mbështjellur ndofta ca ndërresa. Nekludovi e pyeti në se ishte hera e parë që vinte në burg. Burri me bohçën iu përgjegj se vinte çdo të dielë. Kështu, u njohën e filluan të bisedojnë. Ai i tregoi fije e për pe Nekludovit gjithë historin' e tij, i tha se ishte portjer në një bankë dhe se kishte në burg të vëllanë, që akuzohej për disa falsifikime. Por, ndërsa bashkëfolësi i Nekludovit, që dukej njeri shumë muhabetçi, po matej t'i bënte edhe ai ndonjë pyetje, u afrua befas me zhurmë dhe ua hoqi vëmëndjen një «fiacre» me rrota gome, i tërhequr nga një kalë vraç i sojmë, ku kishin zënë vënd, njeri pranë tjetrit, një student dhe një damë e mbuluar me vello. Studenti mbante në dorë një bohçë të madhe. Ai iu afrua Nekludovit dhe e pyeti a ishte e mundur t'u dhuronte të burgosurve bukët që kishte mbështjellur në bohçë dhe si duhej vepruar për këtë.

— M'është lutur e fejuara. Kjo këtu është e fejuara ime. Prindërit e saj na këshilluan t'ua japim këto të burgosurve.

— Unë vetë vij për herë të parë këtu dhe s'di si t'ju them. Por mendoj se duhet pyetur ai burri atje, — tha Nekludovi duke treguar me dorë gardjanin me shirita, që rrinte më të djathtë. me bllokun e shënimeve në dorë.

Por ndërsa Nekludovi po bisedonte me studentin, dyert e mëdha e të hekurta të burgut me një deriçkë në mes, u hapën. U dha në derë një oficer me uniformë, si edhe një gardjan tjetër. Gardjani me shirita u ngrit e u tha vizitorëve të hynin. Roja u bë mënjanë e, që të gjithë, u turrën për nga dera e burgut duke nxituar e duke vrapuar, sikur të trëmbeshin se mos nuk arrinin në kohë. Gardjani, që qëndronte tek dera, i numëronte ata që hynin duke thirrur me të madhe: «Gjashtëmbëdhjetë, shtatëmbëdhjetë» etj. Një gardjan tjetër, më thellë, e përsëriste numurimin me qëllim që, kur të vinte koha e daljes, të mos dilte, bashkë me vi-

zitorët, edhe ndonjë i burgosur. Ai nuk i vinte re ata që kalonin, kështuqë e preku me dorë në kurriz edhe Nekludovin duke e numëruar. Nekludovi, në fillim, e ndjeu veten të fyer, por iu kujtua aty për aty përse kishte ardhur në burg, dhe menjëherë i erdhi turp për atë ndjenjë pakënaqësie e poshtërimi që kish provuar nga të prekurit e gardianit. Pas derës, vinte një ndërtesë e vogël e me qemer të ngritur. Këtu, në një dhomë me hekura në dritare, që quhej në gjuhën e burgut «dhoma e mbledhjeve», Nekludovi vuri re në një të thelluar në mur një kryq të madh me figurën e Krishtit të kryqëzuar.

«Po kjo, përse këtu?» — tha ai me vete, duke menduar se Krishti duhej të ndodhej atje ku njerëzit qenë të lirë e jo atje ku qenë të burgosur.

Nekludovi ecte mengadalë, duke u hapur rrugë vizitorëve që nxitonin e ndjente sakaq se si i lëvrinin në shpirt ndjenja të shumta e të ndryshme. Tmerohej duke përfytyruar kaqbërësit që qenë mbyllur aty, i vinte shumë keq për çunakun që kishin gjykuar dje, për Katjushën dhe për shumë njerëz të tjerë të pafajshëm që ndodheshin aty, provonte një ndrojtje e një ngashërim duke menduar takimin e afërt që po e priste. Kur duallën nga dhoma e parë, një gardjan u kthye nga vizitorët e diç u tha. Por Nekludovi, i zhytur në mendime, nuk ja vuri veshin dhe vazhdoi të ecte andej nga shkonte shumica, d.m.th. në burgun e burrave e jo n'atë të grave për ku qe nisur.

Arriti atje i fundit. Kur hapi derën e hyri brënda, mënd u shurdhua nga britmat e të thirrurat që shkriheshin në një gjëmë të fuqishme. Në fillim u habit por, kur u afrua dhe pa se njerëzit qenë ngjitur pas hekurave që e ndanin në dysh dhomën, ashtu si mizat pas sheqerit, e kuptoi si qe puna. Dhoma, me dy a tri dritare në murin e pasëm, qe ndarë në dysh jo nga një rrjetë, por nga dy dhe rrjetat ngriheshin lart gjer në tavan. Të burgosurit ndodheshin nga njera anë e rrjetave, ata që kishin ardhur për t'i parë, nga ana tjetër. Në hapësirën në mes silleshin posht'e lart gardianët. Kjo hapësirë ishte të paktën nja tri arshinë, kështuqë bashkëfolësit zor se mund të merreshin vesh mes tyre, e aq më pak pastaj kishin mundësi ta shihnin mirë njeri-tjetrin në fytyrë. Vije re nga të dy anët fytyra të ngjeshura pas hekurave: fytyrat e grave, të burrave, të baballarëve, të nënave, të fëmijve, që orvateshin ta shikonin njeritjetrin e të thonin ato pak fjalë që duheshin thënë. Për

t'u fjalosur duhej thirrur me një zë sa të qe e mundur më të lartë. Por bërtitnin të gjithe e, pra, duhej bërtitur më fort nga ata. Këtu e kishte burimin ajo gjëmë zërash që e habiti në fillim Nekludovin. E kot qe çdo orvatje për të kapur ndonjë fjalë, se nuk mund të kuptohej asgjë. Vetëm duke hetuar shprehjet e fytyrave, herë të njerit, herë të tjetrit, mund të gjykoje afërsisht përse bëhej fjalë dhe çfarë lidhje kishin mes tyre ata që bisedonin. Pranë Nekludovit ndodhej një plakarushe e drobitur, me një shami në kokë, që i dridhej nofulla e që diç mundohej t'i thoshte duke thirrur një djaloshi të zbehtë e me kokë të rruar. I burgosuri ngrinte vetullat, rrudhte ballin dhe e dëgjonte me vëmëndje. Pas plakës, vinte një djalosh me podjovkë, që i kish vënë duartë në vesh dhe dëgjonte duke tundur kokën ato sa i thoshte një i burgosur që i shëmbëllente, me fytyrë të vojtur e me mjekër të thinjur. Më tutje qëndronte në këmbë një rreckaman që thërriste e tundte dorën duke qeshur. Pranë tij qe sheshuar përdhé një grua me një shami të mirë leshi në kokë e me një fëmijë në prehër. Gruaja qante me dënesë, ndofta ngaqë ishte e para herë që e shihte me kokë të rruar, me rroba burgu e me pranga burrin e thinjur që ndodhej matanë hekurave. Mbi gruan qe kërrusur portjeri i bankës me të cilin Nekludovi qe njohur para se të hynte në burg. Ai po fjalosej me një të burgosur tullac që i shkëlqenin sytë. Kur Nekludovi kuptoi se në ato kushte duhej të merrej vesh edhe ai me Masllovën, i urreu ata që kishin mundur të mendonin e të organizonin një gjë të tillë. Ai habitej se si asnieri aty nuk e ndjente veten të fyer nga ajo gjëndje aq e tmershme dhe nga ajo përbuzje aq e rëndë kundrejt ndjenjave të njeriut. Edhe gardjanët, edhe drejtori, edhe të burgosurit, edhe vizitorët, me ato që bënin e nga mënyra se si i bënin, linin të kuptohej se për ata çdo gjë aty ishte në rregull.

N'ato pesë minuta që Nekludovi qëndroi n'atë dhomë, ndjeu një brëngë të çuditëshme, kuptoi se ishte i pafunishëm dhe bota iu duk e çthurur; një ndjenjë pështirosjeje morale e pushtoi aq sa ju duk se do të villte.

XLII

«Sidoqoftë, nuk duhet ta harroj përse kam ardhur, — tha ai, duke i dhënë zemër vetes. — Po kë të pyes?»

Hodhi sytë rreth e rrotull se mos shihte ndonjë nga mbikqyrësat e burgut, kur, papritmas, vuri re një burrë të hollë, me shtat mesatar, me spaleta oficeri e me mustaqe, që ecte në bisht të turmës. Iu drejtua dhe e pyeti me një mirësjellje të shtënë e të tepruar:

— A është e mundur, i nderuar zotëri, të më thoni ku mbahen gratë dhe ku lejohen takimet me to?

— Ju, në burgun e grave do të shkoni?

— Po, desha të takohesha me një grua, me një të burgosur, — u përgjegj Nekludovi, po me atë mirësjellje të tepruar.

— Pse nuk e thatë atëhere që në fillim, kur ishit në dhomën e mbledhjeve? Kë thatë se deshët të takonit?

— Dua të takohem me Ekaterina Maslloven.

— Për politikë është. . . — pyeti oficeri i hollë, që ishte ndihmës drejtor i burgut.

— Jo, e dini si është puna e saj?. . .

— Ka dalë në gjyq?

— Po, bëhen tri ditë sot që e kanë dënuar, — u përgjegj me përunjësi Nekludovi, duke u trëmbur se mos e bezdiste ndihmës dreitorin me ndonjë fjalë të tepërtë.

— E po, gjersa doni të shkoni në burgun e grave, urdhëroni nga kjo anë, — tha ndihmës drejtori që, me sa dukej, nga pamja e Nekludovit kishte gjykuar se kishte të bënte me një njeri i cili duhej respektuar. — Sidorov! — thirri ai duke iu drejtuar një nënoficeri me mustaqe e me ca medalje në gjoks, — shoqëroje zotërinë në burgun e grave.

— Si urdhëron!

Atë çast, matanë hekurave, ku mbaheshin të burgosurit, u dëgjuan ca të qara me dënesë që të këpusnin shpirtin.

Çdo gjë aty ishte e çuditëshme për Nekludovin. Por ai çuditej sidomos kur mendonte se tani e ndjente veten të detyruar ta falënderonte nën drejtorin dhe mbikqyrësin e burgut, d.m.th. t'u ishte mirënjohës dy njerëzve, që ishin fajtorë për të gjitha ato tmere që bëheshin aty.

Mbikqyrësi i priu Nekludovit dhe, si doli bashkë me të në koridor, hapi një derë që ndodhej përballë dhe e ftoi të hynte në dhomën e takimeve me gratë.

Kjo dhomë, ashtu si edhe ajo e burrave, ndahej në tresh me anë të dy rrjetave të hekurta, por ishte më e vogël. Më i vogël ishte gjithashtu dhe numri i të burgosurve dhe i vizitorëve, sadoqë të thirrurat dhe gjëma e zerave të çthurura, që kryqëzoheshin nga të dy anët, ishte po aq e fortë dhe shurdhonjëse. Po ashtu, si në burgun e burrave, sillej lart e poshtë në rripin e gjerë ndërmjet rrjetave një mbikqyrës. Kjo ishte një grua veshur n'uniformë, me ca shirita në krah dhe me një rrip të trashë të ngjeshur në bel. Po ashtu si në burgun e burrave, njerëzit qenë ngjitur nga të dy anët pas hekurave: nga njera anë dukeshin qytetarë të veshur me gjithfarë rroba, ndërsa nga ana tjetër, përkundrejt tyre, — të burgosurat, veshur me tuta të bardha, si edhe aty-këtu disa të arrestuara që mbanin akoma rrobat e tyre. Rrjetat qenë mbuluar tejpërtej nga trupat e njerëzve. Disa ngriheshin në majë të gishtërinjve e flitnin përmbi kokat e atyre që kishin përpara, të tjerë qenë sheshuar për tokë e bisedonin ashtu ndënjur.

Të binte në sy menjëherë nga të burgosurat, si për nga pamja ashtu dhe për nga zëri i hatashëm që lëshonte kur thërriste, një cigane e hollë leshtore, me ca flokë drudhë që i shpëtonin nga shamia gjysmë e rrëzuar mbi kokë që, e mbështetur pas kolonës, mb'anën tjetër të hekurave, diç mundohej t'i shpjegonte me britma e me ca lëvizje të shpejta e të shkathëta, një cigani me një redingotë blu, shtërnguar fort nën bel. Pranë ciganit qe ulur e bisedonte me një të burgosurë një ushtar dhe, pak më larg, qëndronte në këmbë, me faqe ngjitur pas rrjetës, një muzhik me trup të pakët, me mjekër të verdhë, me fytyrë të skuqur dhe me sy të përlotur. Ai bisedonte me një të burgosurë flokëverdhë, me një fytyrë të hijëshme që e vështronte bashkëfolësin e saj me ca sy të kaltër e të shëndritëshëm. Ishte Fedosja me të shoqin. Nën këmbët e tyre rrinin, nga njera anë një i rreckosur, nga ana tjetër, një grua po aq e rreckosur e me fytyrë të gjerë; pastaj vinin me radhë: dy gra, një burrë e pastaj përsëri një grua; përballë secilit ndodhej nga një e burgosurë. Masllova nuk ishte atje. Por, jo në radhën e parë, por mbrapa, dukej një grua që qëndronte më këmbë. Nekludovi e mori me mënd se duhej të qe ajo dhe ndjeu në çast se si zemra nisi t'i rrihte me të fortë. Iu duk se iu zu fryma. Po afrohej më në fund çasti vendimtar. Iu avit rrjetës dhe e njohu. Ajo qëndronte prapa Fedosjes dhe e dëgjonte duke buzëqeshur çfarë po i thoshte të shoqit.

Nuk qe veshur si atë ditë në gjyq, por kish vënë një bluzë të bardhë, shtërnguar fort në mes, të ngritur disi lart mbi gjoks. Flokët e zez e kaçurrel i shpëtonin përsëri nga shamia si në gjyq.

«Tani vendoset çdo gjë. . . — mendoi Nekludovi — Po si ta thërres? Apo mbase do të vijë vetë?»

Po ajo vetë nuk erdhi. Ajo priste Klarën, shoqen e saj, dhe s'i shkonte kurrë ndërmënd që ai zotëri kishte ardhur pikërisht për t'u takuar me të.

— Ju, kë kërkoni? — e pyeti Nekludovin mbikqyrësja që sillej posht'e lart ndërmjet hekurave.

— Ekaterina Masllovën, — tha Nekludovi me një fije zëri.

— Masllova, të kërkojnë! — thirri mbikqyrësja.

XLIII

Masllova ktheu kokën pas duke drejtuar trupin me atë shprehje të veçantë gatishmërie, të cilën Nekludovi ja kishte vënë re kaq herë, iu afrua hekurave, çau rrugë përmes grave dhe ja nguli sytë vizitorit të saj e habitur pa e njohur.

Sidoqoftë, nga rrobat kuptoi se kishte të bënte me një njeri të pasur e i buzëqeshi.

— Për mua kini marrë mundimin? — pyeti duke e zgjatur matanë hekurave fytyrën e saj të qeshur me sytë vëngërosh.

— Po. . . Erdha të. . .

Nekludovi nuk dinte si t'i drejtohej: me «ju» apo me «ti»? Por më në fund vendosi t'i fliste me «ju» dhe, pa e ngritur zërin, vazhdoi:

— Erdha t'ju shoh. . . unë. . .

— Mor, po ti mos shiko të më hedhësh pluhur syve. Kështu të them!. . . — çirrej pranë tij një varfanjak i rreckosur — E more apo s'e more? Folë!

— E po të thashë, po vdes, ç'do tjetër? — thërriste dikush që nga pas hekurave.

Masllova nuk i dëgjoi dot shkoqur ato që tha Nekludovi por, duke vënë re shprehjen e fytyrës së tij tek fliste, befas e njohu. S'deshi ta besojë që ai ishte vërtet Nekludovi por, sidoqoftë, buzëqeshja iu zhduk nga fytyra dhe një rrudhë brenge i çau ballin.

— Nuk po ju marr vesh, se s'dëgjohet! — thirri duke i përpëlitur qepallat, ndërsa ajo rrudha në ballë mihte përherë e më thelië.

— Unë vij që. . .

«Po, mirë bëj, po pendohem!» — mendonte ndërkaq Nekludovi dhe porsa e mendoi këtë ndjeu që sytë iu përlotën, ndjeu një lëmsh në fyt, që i mirrte frymën. Shtrëngoi hekurat e heshti duke bërë çmos që të mos shpërthente në vaj.

— E ç'pate që i fute hundët atje ku s'duhej?. . . — thërriste një atje pranë.

— Ç'është ai zot, në kam gisht n'atë punë! — përgjigjej e burgosura matanë.

Ngashërimi, që e kishte pushtuar, i kishte dhënë Nekludovit një shprehje në fytyrë, të cilën Masllova ja njihte mirë dhe tani ajo u bind plotësisht se ishte ai vetë.

— Diku ju kam parë, por nuk mbaj mënd. . . — tha me zë të lart, pa e shikuar në sy, dhe fytyra e saj, që u skuq befas, mori një çehre akoma më të zymtë.

— Unë vij t'ju kërkoj ndjesë, — thërriti ai me sa zë kishte, por me një zë të shplarë, pa ngjyrë, sikur përsëriste ashtu një mësim të mësuar përmëndç.

Si i shqiptoi këto fjalë, i erdhi turp dhe vështroi rreth e rrotull si për t'u siguruar që s'e kishte dëgjuar njeri. Por, duke menduar se ishte e drejtë të turpërohej gjersa e turpëshme kish qënë edhe vepra që kish kryer dikur, i dha zemër vetes e vazhdoi gjithë me zë të lartë:

— Ndjemë, se jam shumë fajtor përpara. . .

Ajo rrinte si e ngrirë, ndërsa vështrimi i syve të saj të vëngërt i dukej Nekludovit se e shponte tejpërtej.

Ai ngeci. Ndjente që giuha po i trashej, ndjeu një vaj të heshtur diku thellë në krahëror. U largua nga hekurat e u hoq mënjanë.

Atëhere mbikqyrësi, pikërisht ai që e kish shoqëruar atje, i shtyrë ndofta nga kureshtja, iu afrua dhe e pyeti përse nuk bisedonte me të burgosurën. Nekludovi tërhoqi hundët, u shkund e, duke u munduar të dukej i qetë, u përgjegj:

— Më pengojnë hekurat, nuk dëgjoj dot asnjë fjalë. . .

Mbikqyrësi u mendua një hop pastaj tha:

— E po çka, çka, po iua sjellim këtu. — . . . Maria Karlovna, nxirre jashtë atë Masllovën!

Pas pak, Masllova doli nga një derë anësore, duke

shkelur lehtë e butë mbi pllloçat e moçme të burgut. U ndal përpara Nekludovit dhe e vështroi duke ngritur sytë përmes vetullave. Flokët e zez e kaçurrel i vareshin të shpupuritura andej e këtej si atë ditë në gjyq. Fytyra, e ligur, e buhavitur, e bardhë, dukej plotësisht e qetë. Po syt'e zes e vëngëroshë, kishin nën qepallat e enjtura një shkëlqim të çuditshëm.

Nekludovi shkoi e u ul tek një stol aty, rrëzë murit.

Masllova hodhi sytë si me pyetje nga ana e ndihmësmbikqyrësit të burgut, pastaj ngriti supet, i ra pas Nekludovit dhe ndënji pranë tij mbi stol, si ndreqi më parë me merak fustanin.

— Duke ju kërkuar që të më ndjeni, ju kërkoj një gjë të zorshme, e di, — n.si të thotë Nekludovi, por prapë ngeci, se iu desh të përmbante lotët. — Po, në s'e ndreq dot më të kaluarën, të bëj të paktën tani çmos që t'ju vij në ndihmë. Ja, më thoni, si. . .

— Si e muarrët vesh që jam këtu? — u hodh e ja preu fjalën Masllova, pa iu përgjegjur pyetjes e duke e vështruar kur e kur vëngër.

«O zot i madh! Ndihmomë! Mësomë si të veproj!» — thoshte vet me vete Nekludovi duke hedhur sytë vjedhurazi, si me frikë, nga fytyra e saj tanimë e prishur, ku dukeshin çkoqur gjurmët e jetës së çthurur që kishte bërë.

— Isha në gjyq atë ditë që ju dënuan, — tha. — Bëja pjesë në zhuri. Nuk më njohët?

— Jo, nuk ju njoha. Le që as më shkonte ndërmënd të soditja me nge njerin apo tjetrin. Jo, jo, nuk ju pashë. . .

— Sikur lindi një fëmijë?. . . — pyeti ai, e ndjeu një afsh të nxehtë që i hypi në fytyrë.

— Lindi, po desh zoti më vdiq, — tha ajo me duf dhe ktheu kokën nga ana tjetër.

— Po si? Nga se?

— Unë edhe vetë sa s'vdiqa, u sëmura shumë rëndë atëhere. . . — tha ajo me sytë përdhe.

— Po mirë, tetot, pse ju dëbuan?

— Po me atë këlysh në bark, kush do të më mbante? Domosdo, më dëbuan, porsa që u ra erë. Po kot sa e zemë në gojë këtë punë. Tani s'mbaj mënd asgjë, i kam harruar të gjitha. Ç'u bë, u bë.

— Jo, jo, kjo punë s'mund të mbetet me kaq. Ka erdhur kcha për mua ta laj gjynahun e madh që kam në shpirt.

— E ç'do të lani? S'kini ç'lani! Të shkuara, të harrua-

ra. . . — edhe befas, kur ai s'e priste fare, ajo ngriti sytë dhe i hodhi një vështrim ku ishte epshi dhe mashtrimi, po ishte sadopak edhe mëshira, edhe keqardhja e thellë. . .

Maslova kurrë nuk do ta kishte besuar se do të takohej një ditë me Nekludovin, aq më pak n'atë gjëndje e n'atë vënd ku ndodhej tani. Prandaj, në fillim, porsa e pa dhe e njohu, u shtang në vënd e habitur, dhe risolli në mënd pa dashur ca kujtime të largëta, të harruara. . . Solli ndërmënd si në tym atë botë të re magjiplote ndjenjash e mendimesh që u hap si për çudi përpara saj kur ra në dashuri me një djalosh zemërçelur e fisnik, që ja shkëmbeu dashurinë, por që më vonë, kushedi përse, u soll me të i ashpër e zemërgur. Iu kujtuan poshtërimet, vuajtjet që erdhën pas asaj lumturie prrallore e, duke i kujtuar të gjitha këto, një brengë e pushtoi, e thellë, e hidhur. Deshi t'i gërmonte gjer në fund ato kujtime por s'mundi, se s'pati zemër, dhe atëhere bëri siç bënte gjithmonë: i largoi, i mbuloi, sa të mos dukeshin fare, me mjegullën e veçantë të jetës së saj të korruptuar. Deshi të ringjallte në fytyrën e burrit që i rrinte pranë tiparet nazike të djaloshit që kish dashur dikur me gjithë shpirt, por edhe këtë s'e bëri, se parandjeu që do të vuante shumë. Jo, ai zotëri i veshur kërk, i mbajtur me merak, me mjekër të parfumuar, nuk ishte Nekludovi që kishte dashuruar dikur, por një burrë si çdo burrë, një nga ata që shkonin me ca gra siç ishte ajo. Këta burra duhen për paratë që kanë, prandaj edhe ajo i buzëqeshi atij me epsh, e, si u mundua një copëherë se si ta shfrytëzonte më mirë, tha:

— Ç'u bë, u bë. Po tani, burgut si i bëhet, katorgës?

Dukej që ajo fjalë e tmerronte, sepse buzët iu drodhën kur e shqiptoi.

— Unë, nga ana ime, isha krejt i bindur që ju ishit e pafajshme, — tha Nekludovi.

— S'do mënd që jam e pafajshme. Ç'u bëra unë, hajdute? Apo mos kam dalë të grabis dynjanë?. . . Këtu tek ne thonë që gjithë puna është tek avokati, — vazhdoi, — thonë se duhet bërë një lutje. Po ç'e do, vete shumë, duhet t'i kesh paratë me thes. . .

— Po, po, lutjen do ta bëjmë patjetër! — u ngut të thoshte Nekludovi. — Kam folur edhe me një avokat.

— Paratë s'duhen kursyer, ndryshe s'ju mbaron punë, — tha ajo.

— Asgjë s'do të kursej. . .

U bë një heshtje. Në buzët e saj u duk përsëri nënqeshja e parë.

— Me që ra fjala. . . mos u ndodhen para me vete?. . . Jo shumë. . . nja dhjetë rubla. . . — tha ajo duke e prishur befas heshtjen.

— Ja, ja, tani. . . — ja bëri Nekludovi i turbulluar dhe vuri dorën në kuletë.

Ajo ndërkaq ktheu kokën me të shpejtë nga gardiani që sillej lart e poshtë nëpër koridor.

— Mos m'i jepni në sy të tij, pritni sa të largohet, se ndryshe do të m'i marri.

Nekludovi e nxori nga xhepi kuletën pikërisht në çastin kur pa që gardjani po u kthente kurrizin. Por, kur po merrte nga kuleta një kartmonedhë prej dhjetë rublash e po matej t'ja jepte Masllovës, gardjani bëri një kthesë të pa pritur e u doli përballë. Pa humbur kohë, ai e shtrëngoi kartmonedhën në dorë që të mos dukej.

«Kjo paska marrë fund!» — mendoi për një çast, duke hedhur sytë nga Masllova, nga fytyra e saj dikur aq e dashur, kurse tani e pështirë, e buhavitur, me një shkëlqim të lik në syt'e zes vëngëroshë, që kalonin atë çast, të shka'hët, nga gardjani tek kartmonedha, që fshihej në dorën e Nekkludovit. Dhe ai ndjeu që po lëkundej.

Përsëri foli në shpirtin e Nekludovit zëri i ngasjes djallëzore që e kishte munduar një natë më parë, duke u përpjekur t'ja hiqte vëmëndjen nga ajo që duhej të bënte e t'ja përqëndronte përkundrazi në pasojat e rënda që mund të rridhnin nga hapat e rrezikshme që po ndërmerrte.

«Kot mundohe me këtë grua, — i thoshte ai zë, — se do të merresh në qafë e s'do të jesh më i zoti as për vete e as për të tjerët. Para jepi, mos kurse, po, ama, kërkoi të falur e largohu prej saj!»

Por në të njëjtën kohë, ai ndjente që në shpirtin e tij po ndodhte diçka jashtëzakonisht e rëndësishme, që tërë jeta e tij shpirtërore qe vënë atë çast mbi një peshojë kaq të ndjeshme, saqë mjaftonte të rëndoje sadopak në njerën anë apo në tjetrën, për ta prishur përfundimisht atë ekuilibër që mezi mbahej. Edhe ai rëndoi, rëndoi nga ana e atij zotit që kish ndjerë dje në shpirtin e tij, e zotit mëshirëmadh. të plotfuqishëm. . . Vendosi, pra, t'i fliste siç i thoshte zemra.

— Katjushë! — i tha. — Erdha të të kërkoj ndjesë, po ti

nuk m'u përgjegje a më ndjeve, a do të vijë një kohë kur do të më ndjesh. . .

As vetë nuk e kuptoi se si i erdhi që t'i fliste me «ti», por ndjeu se kështu duhej.

Ajo nuk ja vinte veshin, por vazhdonte t'i lëvizte sytë me shkathtësi herë nga gardjani, herë nga kartmonedha, që ndodhej në dorën e tij. Kur gardjani u kthye n'anën tjetër, ajo zgjati krahun me një lëvizje të shpejt, të pa pritur, e rrëmbeu kartmonedhën dhe e fshehu nën brez.

— Po më çuditni, — tha, duke buzëqeshur (të paktën kështu iu duk atij) me përçmim.

Kishte tek ajo grua diçka që Nekludovit i dukej se e kundërshtonte, diçka si një mburojë armiqësore e kryeneçe, që e pengonte të depërtonte në zemrën e saj.

Por, për çudi, kjo, jo vetëm që nuk e nxiste atë të hiqte dorë nga Masllova por, përkundrazi, e shtynte tek ajo me një forcë të dyfishuar, e lidhte pas saj me lidhje të tjera, më të shëndosha. Kuptoi që duhej të mundohej të ngjallte përsëri në jetë shpirtin e saj të vdekur dhe vështirësit' e tmerrshme, që parashikonte në arritjen e këtij qëllimi, ja shtuan dëshirën që ta arrinte me çdo kusht. Ndjenja që provonte tani karshi saj ish ndjenjë e paprovuar kurrë ndonjëherë; s'kishte në të asgjë që të lidhej drejt apo tërthor me veten e tij: asgjë s'kërkonte ai për veten e tij, po kërkonte me ngulm që ajo të ndryshonte, që të mos ishte më ajo që qe tani, që të shkundej e të zgjohej, që të bëhej përsëri ajo që kishte qënë dikur.

— Katjushë, përse më flet kështu? Unë të di si ke qenë dikur në Panovë. . .

— Përse të kthehemi tek e kaluara? S'ka kuptim. . . — ja preu ajo fjalën dhe zëri i doli i thatë, i vrazhdë.

— Kthehem se dua të ndreq gabimin që bëra, se dua të laj mëkatin tim, Katjushë, — belbëzoi ai, e matej të thoshte akoma se kishte ndërmënd të martohej me të por, duke ndeshur atë çast vështrimin e saj të vëngërt, e duke lexuar n'atë vështrim diçka tmerrësisht të vrazhdë e të pështirë, s'e sosi dot fjalën.

Ndërkaq vizitorët kishin filluar të dilnin. Gardiani iu afrua Nekludovit dhe e lajmëroi që koha e takimeve kish marrë fund. Masllova u ngrit menjëherë në këmbë dhe qëndroi ashtu një copë herë me përvojë dhe e nënshtruar, duke pritur që ta shoqëronin përsëri në qelin'e saj.

— Lamtumirë. Kam akoma shumë gjëra për t'ju thënë.

Por tani, siç e shihni, nuk kam mundësi, — tha Nekludovi dhe i zgjati dorën. — Po do të vij, prapë do të vij.

— Më duket se i thatë të gjitha. . .

Masllova ja dha dorën, por s'ja shtërngoi.

— Jo, jo, unë do të bëj çmos që t'ju shoh përsëri, që të takohemi në një vënd, ku të mund të flasim lirisht, dhe atëhere do t'ju them diçka me shumë rëndësi për ju, — tha Nekludovi.

— E po, fundja, si të doni: ejani, — tha ajo. me atë buzëqeshjen që u bënte burrave kur donte t'u pëlqente.

— Ju kam si një motër, — tha Nekludovi.

— Çudi! . . . — murmuriti ajo sikur fl'ste me vete, duke tundur kokën, ndërsa humbiste diku përtej hekurave.

XLIV

Nekludovi kujtonte se kur Katjusha do të shikonte që ai kishte ardhur ta takonte e t'i kërkonte ndjesë, do të gëzohej. do të mallëngjehej e do të bëhej përsëri ajo Katjusha, që kishte qënë dikur. Por u gabua dhe vuri re, i habitur e i tmeruar, se e burgosura Masllova nuk kishte të bënte aspak me Katjushën që ai kish njohur.

«Masllovës i vjen turp që e kanë burgosur, por ja, s'i vjen turp aspak që është një prostitutë, përkundrazi, duket shumë e kënaqur e mburret. Kjo është një gjë vërtet shumë e çuditëshme». — mendonte Nekludovi.

Por ajo, që atij i dukej një gjë shum'e çuditëshme, ishte përkundrazi një gjë shum'e logjikëshme. Njeriu, që të veprojë, duhet të besojë se ajo që bën është një gjë e mirë dhe e rëndësishme. Kjo është e domosdoshme, ndryshe ai s'bën dot asgjë. Prandaj çdo njeri, cilido qoftë e sidoqoftë, krijon për jetën një pikpamje që e paraqet veprimin e tij të dobishëm e të rëndësishëm.

Zakonisht mendohet se vjedhësi, vrasësi, spiuni dhe prostituta s'kanë si të mos e kuptojnë edhe ata vetë se kryejnë një punë të dëmshme e të turpëshme. Në të vërtetë, ndodh krejt e kundërta. Njerëzit, që fati dhe fajet apo gabimet e tyre i kanë katandisur n'atë gjëndje, në të cilën ndodhen, sado e ulët qoftë kjo, krijojnë një pikëpamje të tillë mbi jetën që i bën të aftë të besojnë se gjëndja e tyre, jo vetëm që nuk mund të kritikohet, por, përkundrazi, me-

riton të lëvdohet. Neve kjo na habit, kur është fjala për vjedhësin që mburret se është i shkathët, për prostitutën, që mburret se është e përdhosur, për vrasësin që mburret se është zemërgur. Por, në habitemi, kjo i detyrohet faktit se rrethi dhe atmosfera e këtyre njerëzve është e kufizuar dhe, sidomos, sepse ne ndodhemi jashtë. Por a nuk vrehet i njëjti fenomen tek i pasuri, që mburret me pasurin'e tij, d.m.th. me ato që ka grabitur, tek prijsi ushtarak, që mburret për fitoret e korrura, d.m.th. me njerëzit që ka vrarë, te sunduesi, që mburret se është i fuqishëm, d.m.th. se është i aftë të përdorë dhunën? Ne nuk mendojmë se këta njerëz e kanë shtrëmbëruar kuptimin mbi jetën, mbi të mirën e mbi të keqen në botë n'atë drejtim që u përshtatet interesave të tyre, vetëm e vetëm se rrethi i tyre është më i gjërë e, sidomos, sepse në të bëjmë pjesë dhe ne vetë.

Kështu, pra, edhe Masllova kish krijuar, edhe ajo, një pikëpamje të saj mbi jetën. Ajo ishte një prostitutë, një e burgosur me punë të detyruar e, megjithatë, kish arritur të sajonte një botëkuptim të tillë që jo vetëm i jepte mundësinë ta çmonte akoma veten, por i lejonte bile edhe të mburrej.

Sipas këtij botëkuptimi, kënaqësia më e madhe e meshkujve, e të gjithë meshkujve pa përjashtim, qofshin këta të rinj apo pleq, gjimnazistë, gjeneralë, me shkollë apo pa shkollë, qëndronte kryekëput në kontaktin seksual me një femër të bukur e prandaj, të gjithë meshkujt, ndonëse shtiheshin sikur merreshin me punë të tjera, kryesisht merreshin vetëm me këtë punë. Nga ana tjetër, Masllova s'kish dyshim se ishte një femër e bukur e, pra, e kishte në dorë t'ua jepte apo të mos ua jepte atyre këtë kënaqësi, kështu që rridhte vetvetiu se duhej konsideruar si një njeri shumë i rëndësishëm e i nevojshëm për shoqërinë. Tërë jeta e saj provonte se të gjitha këto qenë të drejta.

Gjatë atyre dhjetë vjetëve të fundit, ajo kish vënë re kudo se të gjithë burrat, duke filluar nga Nekludovi e nga stanovoj plak e gjer tek gardianët e burgut, ja kishin nevojën; ajo nuk kish vënë re kurrë një burrë që të mos kish patur nevojë për të. Dhe prandaj ajo e përfytyronte botën si një vënd ku njerëzit, të gjithë njerëzit, të gllabëruar nga një epsh shtazor, e përgjonin nga të katër anët dhe orvateshin si e si ta vinin në dorë, duke e mashtruar, duke e dhunuar, duke e blerë.

Kështu e kuptonte jetën Masllova dhe, duke e kuptuar

kështu, mendonte se nuk ishte aspak një njeri i përbuzur por, përkundrazi, një njeri shumë i rëndësishëm. Ketë botëkuptim Masllova e çmonte më tepër se çdo gjë tjetër dhe s'kishte si të mos e çmonte gjersa, po ta ndryshonte, do të humbiste menjëherë vlerën që mendonte se kishte në shoqëri. Që pikërisht për të mos e humbur vlerën e saj në shoqëri që ajo shoqërohej instinktivisht me njerëz që kishin po ato pikëpamje për jetën. Prandaj, kur kuptoi që Nekludovi deshte ta çkulte nga ajo botë, ajo i kundërshtoi sepse parashikonte qarte se në atë botën tjetër, ku ai kërkonte ta tërhiqte, duhej të hiqte dorë nga vëndi që zinte në shoqëri dhe që ja mbante gjallë besimin dhe respektin ndaj vetes. Po për këtë arësye, ajo i kish shporrur njëher'e përgjithmonë të gjitha kujtimet e rinisë dhe të marrëdhënieve te para, që kish patur me Nekludovin. Këto kujtime nuk pajtoheshin më me botëkuptimin e saj, prandaj ajo i kishte fshirë nga kujtesa ose, që të jemi më të saktë, i ruante diku thellë të paprekura, të mbyllura nga të katër anët e të vulosura mirë, ashtu siç vulosin bletet krimbat që të mos u prishin mjaltën. Prandaj edhe Nekludovi nuk ishte më për të njeriu të cilin ajo e kish dashur me tërë shpirt, por vetëm një zotëri i pasur që mund e duhej të shfrytëzohej, e me të cilin marrëdhëniet duhej të qenë po ato, si me të gjithë burrat e tjerë.

«Jo, unë s'munda t'i them atë më kryesoren, — mendonte Nekludovi duke dalë bashkë me turmën nga burgu. — Nuk i thashë që do të martohem me të. Nuk ja thashë, por do t'ja them».

Gardianët i numruan përsëri vizitorët tek dilnin, me qëllim që të mos dilte ndonjë i tepërt e të mos mbetej njeri në burg. Po këtë radhë Nekludovi, kur e prekën në kurriz, jo vetëm që nuk u fye, por as që e vuri re fare.

XLV

Nekludovi deshi ta ndryshonte mënyrën e jetesës: të jepte me qira shtëpinë e madhe që zotëronte, t'i dëbonte shërbëtorët e të zinte për vete ndonjë dhomë në hotel. Mirëpo Agrafena Petrovna ja mbushi mëndjen se, të paktën gjer në dimër, nuk kishte mundësi të bënte asnjë ndryshim. Në radhë të parë ishte shumë e vështirë ta jepje me qira shtë-

pinë në dimër dhe, së dyti, plaçkat diku duheshin mbajtur se nuk mund të hidheshin në rrugë. Kështu të gjitha përpjekjet e Nekludovit për të filluar një mënyrë tjetër jetese (ai deshte të jetonte thjesht dhe pa shpenzime, pak a shumë si studentët) dështuan. Dhe jo vetëm kaq, por në shtëpi filloi një punë e madhe: ajrimi e shkundja e gjithfarë rrobave të mëndafshëta e prej gëzofi, në të cilën merrnin pjesë edhe shërbëtori edhe ndihmësi i tij, edhe gjellbërsja e, bile, edhe vetë Kornej. Në fillim u nxuarrën jashtë dhe u nderën në litar ca uniforma të veshura me gëzof e me forma të çuditëshme, të cilat asnjeri në atë shtëpi nuk i kishte përdorur kurrë; pastaj u nxuarrën me radhë qilimat dhe mobiljet. Shërbëtori dhe ndihmësi i tij kishin përveshur mëngët duke zbuluar krahët tërë muskla dhe, me një lëvizje ritmike, i shkundnin me sa mundnin këto plaçka, ndërsa në tërë shtëpinë përhapej valë-valë era e fortë e naftalinës. Kur kalonte nëpër oborr apo kur vështronte nga dritarja, Nekludovi habitej dhe s'i besohej që në shtëpi të tij kish patur tërë ato vjeturina që, sigurisht, asnjeriu nuk i hynin në punë. «Vetëm për një gjë mund të shërbejnë të gjitha këto rangulla. — mendonte Nekludovi, — që t'i japin mundësi herë pas here Agrafena Petrovnës, Korneit, shërbëtor t, ndihmësit të tij dhe gjellbërëses që të merren me gjimnastikë».

Fundja, nuk është dhe aq e nevojëshme ta ndryshojë mënyrën e jetesës në një kohë kur çështja e Maslovës ende nuk ka marrë fund, — mendonte për ta ngushëlluar veten Nekludovi. — Ndryshimi do të vijë vetë, porsa që ata ta lirojnë ose ta dërgojnë në Siberi dhe unë ta ndjek».

Ditën që i kishte caktuar avokati Fanarin, Nekludovi i shkoi në shtëpi. Kur hyri në oborrin madhështor të shtëpisë, të cilën avokati e kishte pronë të tij, me perde të çmueshme në dritare dhe me një luks të tepruar në çdo gjë, që dëshmonte për një pasuri të bërë pa mundime, ashtu siç vihet re tek ca njerëz që ngrihen menjëherë, Nekludovi pa një varg klientësh. që kishin zënë radhën në paradhomë, si tek mjeku, dhe çfletonin me fytyra të trishtuara, rivistat e ilustruara që ndodheshin mbi tryezë. Ndihmësi i avokatit qe ulur në një skrivani të lartë. Porsa e pa Nekludovin dhe e njohu, u ngrit në këmbë, i doli përpara, e përshëndeti dhe i tha se do ta lajmëronte menjëherë avokatin për ardhjen e tij. Ndihmësi po matej t'i afrohej derës së kabinetit, kur ajo atë çast u hap vetë dhe u dëgjua zëri i fortë dhe i gjallë i një mesoburri shpatullgjerë, me një fytyrë të kuqe tërë shëndet, me

ca mustaqe të trasha dhe me një kostum të ri si edhe vetë zëri i avokatit. Që të dy kishin në fytyrë atë shprehje që kanë zakonisht njerëzit që porsa kanë përfunduar një punë të leverdisëshme, por jo dhe aq të paqme.

— Paçin veten në qafë. Ne, ore byrazer, u kemi dalë hakut.

— Siç thotë fjala: dua e dua të shkoj në parajsë, por ç't'iu bëj gjynaheve që s'më lënë.

— E di, e di...

E që të dy qeshën si me zor.

— Ju lutem, princ, urdhëroni, — tha Fanarini, kur vuri re Nekludovin dhe, si e përshëndeti edhe një herë me kokë burrin shpatullgjërë që, siç dukej, ishte ndonjë tregëtar, i priu Nekludovit në kabinetin e tij të mobiluar në një stil të rëndë zyrtar. — Merrni, ju lutem, një cingare, — tha avokati duke ndënjur përballë Nekludovit dhe duke mbajtur me pahir gazin, që i shkakëtonte suksesi i çështjes, që kish përfunduar pak më parë.

— Ju falemnderit. Unë erdha t'ju pyes për punën e Maslovës.

— Ja, ja, një minutë. Ama budallenj që janë këta bark-mëdhenjtë! — tha ai — E patë atë bablokun që shkoi? Ai, or tunjatjeta, ka nja dymbëdhjetë milionë rubla kapital. Dhe, mëk-mëk, s'lidh dot as dy fjalë i biri i botës! Po, në i tregofsh ndonjë biletë njëzet rublëshe, ka borxh të ta nduki me dhëmbë! Ha, ha!

Nekludovit i lindi atë çast një neveri e pashpjeguar ndaj atij njeriu, që hiqej aq i çpenguar në sy të tij e i cili, me atë ton që i jepte bisedës, deshte t'i tregonte Nekludovit që me të sillej në një mënyrë krejt tjetër dhe jo si me klientat e zakonshëm, me të cilët, përveç parasë, nuk e lidhte asgjë.

— Thuaj si të duash, por ma mori shpirtin. Bataçki me vulë, jo shaka! Më falni se u zgjata pak si shumë në këtë bisedë, por do të më ndjeni, se kisha nevojë të qeshja ca, — tha akovati si për t'u justifikuar që nuk kishte filluar menjëherë nga puna për të cilën kishte ardhur Nekludovi. — Atëhere, pra, të vijmë tek puna juaj ose më mirë të themi, tek puna për të cilën ju interesoheni. . . E lexova me kujdes dosjen dhe «përmbajtjen e saj nuk e pëlqeva», siç thotë Turgenievi. Me fjalë të tjera dua t'ju them se ai avokati, që e mori përsipër mbrojtjen, s'qe fare për të qënë dhe, me budallallëkun e tij, i humbi të gjitha mundësitë e apelit.

— Atëhere, ju, si vendosët?

— Një minutë!

— I thuaj atij, — iu drejtua ai atë çast ndihmësit që kishte hyrë në dhomë, — se do te bëhet ashtu siç thashë unë; në do, mirë, në s'do, le të bëjë atëhere si të dijë vetë.

— Ai thotë se nuk është dakord.

— E po mirë, e lëmë këtë punë me kaq, — tha avokati dhe fytyra, gjer ahere e qeshur dhe e përzemërt, i mori një çehre të zymtë dhe të ligë.

— E pastaj kanë gojë e thonë se avokatët i marrin kot paratë, — tha ai duke rimarrë në fytyrë shprehjen e mëparëshme. — E dini çmë ka ngjarë? Një klientin tim e kisnin hedhur në gjyq për borxh. E, që thoni ju, unë e mbroj dhe, si provoj që padia kundër tij ishte e padrejt, e detyroj gjyqin t'i japë pafajësinë. Mirëpo kjo punë mori dhenë e tani të gjithë borxhlinjtë, nga janë e nga s'janë, vinë e më zënë derën, sikur nuk ka avokat tjetër! Dhe s'janë punë të vogla, se duan lodhje të madhe, vëmëndje, përqëndrim. . . Se cili shkrimtar e ka thënë, nuk e di, por ama e ka thënë shumë mirë: «Ne, ka thënë ai, lemë një pjesë të mishit tonë në kallamar!» Ja, kështu edhe unë... Kështu, pra, siç ju thashë, puna juaj, ose më mirë të themi, puna për të cilën ju interesoheni, është trajtuar shumë keq. Më keq nuk ka si të bëhet. Argumenta të favorëshme për apelin, nuk ka, por, sidoqoftë, mund të mos hiqet dorë nga kjo gjë. Në lidhje me këtë, unë kam shkruar këto që do t'ju lexoj tani.

Ai mori një fletë të shkruar, që ndodhej mbi tryezë, dhe duke i gëlltitur shpejt e shpejt disa fjalë formale, që nuk paraqesnin asnjë interes dhe duke i theksuar në një mënyrë të veçantë disa të tjera, nisi të lexonte:

— «Departamentit të Apelimeve penale, etj. etj. i parashtrohet filan ankesë etj. etj. Me vendimin etj. etj. të gjyqit të Distriktit filan, akuzohet një farë Masllova për helmimin e tregëtarit Smjelkov dhe, në mbështetje të nenit 1454 të Kodit Penal, dënohet etj. etj. me punë të detyruar etj. etj.»

Kur arriti këtu, ai ndaloi, me sa dukej, sadoqë tani kishte kaq kohë që merrej me atë punë, atij i pëlqente ta dëgjonte edhe vetë veprën e tij.

— «Ky dënim duhet konsideruar si një rezultat shkelljesh ligjore dhe gabimesh gjyqësore, — vazhdoi ai me një ton bindës, — kaq trashanike saqë duhet pa tjetër të anu-

llohet. Pikë së pari, leximi gjatë hetimit gjyqësor të proces-verbalit mbi ekzaminimin e të dhënave të autopsisë së brëndëshme të Smjelkovit, u ndërpre që në rreshtat e para nga kryetari», një kjo!

— Ç'rëndësi mund të ketë kjo, gjersa ky leximi kërkohej nga akuza? — tha i habitur Nekludovi.

— S'ka të bëjë, ku ta dish, mbase edhe mbrojtja mund të kishte arësyet e saja për ta kërkuar një gjë të tillë.

— E përse do ta kërkonte? Kjo s'ka asnjë kuptim.

— Sidoqoftë, ky është një pretekst. Më poshtë: «Së dyti, mbrojtësi i Masllovës, — vazhdoi leximin avokati, — u ndërpre nga kryetari, tamam në një kohë kur, duke dashur ta karakterizonte personalitetin e Masllovës, ai preku shkaqet e brëndëshme të rënies së saj morale, gjoja me pretekst se fjala e avokatit mbrojtës nuk kishte të bënte drejtpërdrejtë me çështjen, kurse, siç dihet mirë dhe siç është vënë në dukje më se një herë nga senati, në çështjet kriminale, nxjerja në pah e karakterit e, në përgjithësi, e prirjeve morale të të pandehurit, ka një rëndësi të dorës së parë, në mos tjetër për formimin e opinionit». Kështu u bënë dy, — tha ai duke kthyer kokën nga Nekludovi.

— Po nuk kishte ndonjë përfitim ta lije të vazhdonte, sepse ai fliste shumë keq, aq keq sa nuk mirrej vesh asnjë nga ato që thoshte, — tha përherë e më tepër i habitur Nekludovi.

— Që ai është një, më falni për shprehjen, një hajvan me zile, kjo s'ka dyshim e, pra, s'pritej të thonte ndonjë fjalë me vënd, — tha duke qeshur Fanarini, — por, sidoqoftë, edhe ky është një pretekst. Vazhdojmë. «Së treti, në fjalën e mbylljes së debateve, kryetari, në kundërshtim me paragrafin 1 të nenit 801 të Statutit të Procedurës Penale, nuk i spjegoi zhurisë cilat elemente juridikë merrnin pjesë në përbërjen e fajësisë dhe as nuk u tha se ata kanë të drejtë, duke e pranuar si të provuar aktin e dhënies së helmit tregëtarit Smjelkov nga e pandehura Masllova, që të mos e cilësonin këtë veprim si një faj, në mendonin që mund të mohohej mundësia e paramendimit të vrasjes dhe, pra, në këtë mënyrë, ta çfajësonin të lartpërmëndurën nga pasojat e krimit penal që rëndonte mbi të, duke e sjellur gjithë punën në një shkak pakujdesie që shkakëtoi pa dashjen e Masllovës, vdekjen e tregtarit». Ja, kjo këtu është kryesorja.

— Ne këtë duhet ta kishim kuptuar edhe vetë, pa që në nevoja të na e thoni. Ky është gabimi ynë.

— «Dhe pika e katërt dhe e fundit, — vazhdoi avokati: — Zhuria e përpiloi përgjigjen, që i dha gjyqit në lidhje me pyetjet që iu bënë, në një formë që përfshinte në vetvete një kundërthënie flagrante. Masllova akuzohej për helmimin me paramendim të tregëtarit Smjelkov, e shtyrë ekskluzivisht nga një qëllim interesi, që përbënte vetëm e vetëm ky motivin e vrasjes, kurse zhuria, në përgjegjen që dha, e mohonte qëllimin e grabitjes dhe pjesëmarrjen e Masllovës në vjedhjen e sendeve me vlerë të tregëtarit, gjë kjo që linte të kuptohej kjartë se zhuria kishte ndërmënd ta përmbyste edhe hipotezën e ekzistencës së paramendimit në vrasje dhe, në se nuk e shprehu këtë mendim në një mënyrë adeguate në përgjigjen e saj, kjo i detyrohet keqkuptimit që u shkaktua nga fjala jo e plotë e kryetarit në mbylljen e debateve. Prandaj, përgjegja në fjalë nga ana e zhurisë, lindte patjetër nevojën e zbatimit të neneve 816 e 808 të statutit të Procedurës Penale, d.m.th. skjarimin e zotërinjve të zhurisë, nga ana e kryetarit të gjyqit, mbi gabimin që ata kishin bërë, mbledhja rishtazi në një seancë konsultimi, përpilimi i një përgjegjeje tjetër në lidhje me fajësinë e të pandehurës.

— Kur duhej vepruar kështu, përse kryetari nuk veproi kështu?

— Hë, përse? Këtë dua të di edhe unë! — tha Fanarini duke qeshur.

— Ju mendoni se senati do ta ndreqë gabimin?

— Këtë nuk e di. Sidoqoftë, kjo mvaret nga përbërja e senatit në çastin e dhënë, me fjalë të tjera, nga fakti se kujt prej atyre matufëve që rrinë aty do t'i ngarkohet shqyrtimi i lutjes.

Kështu, pra. Më poshtë do të themi: «Për arësyet që parashtruam më lart, — vazhdoi ai me të shpejt — gjvqi nuk ka patur të drejtë ta dënonte Masllovën, siç e dënoi, duke zbatuar në rastin e saj paragrafin 3 të nenit 7771 të Kodit Penal, gjë që përbën një shkelje të rëndë dhe flagrante të parimeve bazë të Procedurës sonë Penale. Prandaj, në mbështetje të nenit 909, 910, të paragrafit 2 të nenit 912 e 928 të Kodit të Procedurës Penale, kam nderin të kërkoj eti. etj., anullimin etj. etj. dhe rishqyrtimin e procesit në një seancë tjetër të po atij givqi etj. etj.» E me kaq. i japim fund. Bëmë ç'ae e mundur. Tjetër s'kemi ç'bëjmë. Por do të jem i sinqertë me ju: zor se do të na e marrin parasysh. Sidoqoftë, siç ju thashë, gjithçka mvaret nga përbërja e depar-

tamentit në senat. Në keni atje ndonjë mik, mos e lini rehat.

— Diku kam ndonjë të njohur.

— Atëhere vihuni kësaj pune sa më shpejt, sepse ata se nga shkojnë e mjekojnë hemoraidet, e për tre muaj s'i ke aty. . . Dhe, nëqoftëse s'bëhet gjë, atëhere na mbetet lutja perandorit. Edhe kjo, s'do mënd, mvaret nga puna që mund të bëhet prapa perdes. Mund të mbështeteni edhe në këtë rast në gadishmërinë time për t'ju shërbyer, jo prapa perdes, ta pret mëndja, por në përpilimin e lutjes.

— Ju falemnderit. . . Atëhere për shpërblimin që. . .

— Biscdoni me ndihmësin; ai do t'ju japë edhe një kopje të aktit me të gjitha udhëzimet dhe demarshet që duhet të kryeni.

— A mund t'ju bëj edhe një pyetje tjetër?. . . Kam marrë nga prokurori një leje për t'u takuar me personin për të cilin interesohem. Mirëpo në burg më thanë që, për takimet jashtë ditës e vëndit të caktuar, duhet një autorizim i veçantë i guvernatorit. Është e vërtetë?

— Besoj se po. Por tani guvernatori nuk gjëndet këtu. Ka lënë mëkëmbësin në vënd të tij. Por ai është një idiot, që flë me sy hapur, e zor se do të bëni dot gjë me të.

— Mos është Maslenikovi?

— Po.

— E njoh, — tha Nekludovi dhe u ngrit në këmbë, që të ndahej nga avokati.

Atë çast hyri ose, më mirë të themi, çatisi e rrufeshme në dhomë një grua kock'e lëkurë, me një hundë kërrute, dyll'e verdhë në fytyrë dhe beter e shëmtuar, por që, me sa dukej, s'bëhej fare merak që s'ishte e bukur. Ishte pispillosur në një veshje krejt origjinale, ku kishte fjongo e stolira edhe prej mëndafshi, edhe prej kadifeje, edhe të verdha, edhe jeshile; kurse flokët, ato dy fije floku që kishte në kokë, i kishte përdredhur në bukle të shumta. Ajo, pra, çatisi në dhomën e pritjes me çapin e një prijësi ngadhnjimtar, e ndjekur nga një burrë shul i gjatë, që buzëqeshte tërë kohës, me një fytyrë ngjyrë baltë, me një redingotë me jakat veshur me mëndafsh e me një kravatë të bardhë. Gruaja ishte e shoqja e avokatit dhe zotëria që e shoqëronte me aq zell, ishte një shkrimtar të cilin Nekludovi e njihte mirë.

— Anatol, — thirri ajo duke hapur derën — eja nga unë! Ja ku të kam sjellë këtu Semjon Ivanoviçin që më ka

premtuar se do të na lexojë një vjershë të tij, kurse ti do të na lexosh diçka mbi Garshinin. Mirë?

Nekludovi u mat të dilte, por gruaja e avokatit diç pështpëriti me të shoqin dhe aty për aty u drejtua nga ai.

— Ju lutem, princ, — me që ju njoh, mendoj se është e tepërmë të prezantohemi, — frekuentoni mëngjezin tonë letrar. Do të jetë shumë interesant. Anatoli deklamon vërtet shumë bukur.

— Ja, e shikoni me sa gjëra duhet të mirrem? — tha Anatoli duke ngritur duart me buzën në gaz, e duke bërë me shënjë për nga e shoqja si për të treguar që ishte e pamundur të mos gjunjëzoheshe përpara një bukurie aq të rrallë.

Duke i dhënë fytyrës një çehre të merakosur e të rreptë por, në të njëjtën kohë, edhe shumë të njerëzishme e plot respekt, Nekludovi e falënderoi të shoqen e avokatit për nderin që i bënte duke e ftuar në një mëngjes letrar të zgjedhur, por tha se nuk kishte mundësi ta pranonte.

— Uh, çfarë njeriu! Ku i di tërë ato grimasa! — ja bëri e shoqja e avokatit, porsa Nekludovi kërkoi ndjesë e doli.

Në dhomën e pritjes ndihmësi i dorëzoi Nekludovit lutjen e apelit dhe, kur ky e pyeti në lidhje me shpërblimin, i tha se Anatoli Petroviç e kishte caktuar njëmijë rubla duke i sqaruar, në këtë rast që, zakonisht, Anatoli Petroviç, nuk merrej me të tilla çështje, porse për princin kishte bërë një përjashtim.

— Po lutjen kush e firmon? Kush duhet ta firmojë? — e pyeti Nekludovi.

— Mund ta firmojë vetë e pandehura por, në rast se kjo nuk do të jetë e mundur, mund ta firmojë edhe vetë Anatoli Petroviç, duke patur autorizimin e saj.

— Jo, më mirë po ja shpie ta firmojë vetë, — tha Nekludovi, i gëzuar që i paraqitej rasti të takohej me të, më parë nga dita e caktuar.

XLVI

Çdo ditë në të njëjtën orë në burg, dëgjoheshin bilbilat e gardianëve, dëgjohej se si hapeshin me zhurmë dyert e hekurta të qelive e të koridoreve, dëgjohej një pllacaritje këmbësh të zbathura dhe një trokëllimë këpucësh të rënda. Nëpër koridor kalonin të burgosurit e pastrimit, që e

mbushnin ajrin me një kundërmim të qelbur; të burgosurit e tjerë ndërkaq, lahështin, visheshin dhe dilnin për kontroll në koridor dhe, pas kontrollit, shkonin e merrnin ujin e vluar për çajin.

Atë ditë, në kohën e çajit, në të gjitha qelitë bisedohej me gjallëri të madhe për dy të burgosur që do të dënoheshin me thupra. Njeri syresh ishte një djalosh me arësim të lartë, një farë Vasiljevi, që kishte punuar më parë si administrator në një çiflik. Vasiljevi qe futur në burg sepse kishte vrarë në inat e sipër nga xhelozia të dashurën. Të gjithë shokët e qelisë e donin shumë, se qe kurdoherë i qeshur, bujar dhe, sidomos, sepse në marrëdhëniet me personelin e burgut tregohej i vendosur e trim. Vasiljevi i njihte mirë ligjet dhe nuk lejonte që të shkeleshin. Dhe, pikërisht për këtë, në burg nuk e shikonin me sy të mirë. Aty e tri javë më parë një gardian e kish goditur një të burgosur nga ata të pastrimit me pëllëmbë, se ky ja kish fëlliqur pa dashur uniformën e re me ca lëng lakre. Vasiljevi i kishte dalur për zot shokut duke thënë se ligji nuk lejonte të vihej dorë mbi të burgosurit. «Ta tregoj unë ligjin!» — i kishte thënë gardiani dhe i qe shkrehur me të shara. Po Vasiljevi s'ja kish lënë thatë. Atëhere gardiani qe matur ta qëllonte. Vasiljevi ja kishte kapur dorën dhe, si e kish mbërthyer ashtu në vënd gardianin nja dy a tri minuta, e kish kthyer pastaj me fytyrë nga dera dhe e kishte shporrur jashtë. Gardiani qe ankuar dhe drejtori i burgut kish dhënë urdhër që Vasiljevi të hidhej menjëherë në podrum.

Në podrumin e errët të burgut ndodhej një serë qelish të vogla e të veçuara, të mbyllura nga jashtë me lloze. Në këto qeli të errëta e të ftohta nuk kishte as shtretër, as tryeza e as karrige, kështu që i burgosuri qe i detyruar të ulej apo të shtrihej përdhe. Por më e keqja qe se këtu minjtë qenë të shumtë e të guximshëm aq sa të kalonin mbi trup e nën trup, ta rrëmbenin bukën nga dora dhe, po të vinin re që nuk lëvizje, të suleshin që të të kafshonin. Vasiljevi tha se gjersa nuk ishte fajtor, nuk kishte përse të shkonte në podrum. E detyruan të shkonte me forcë. Ai kundërshtoi dhe, i ndihmuar nga dy shokë, mundi t'u bënte ballë gardianëve e të çlirohej. U mblodhën aty edhe gardianë të tjerë e, ndërmjet syresh, edhe Petrovi, i mirënjohur për fuqinë e tij të jashtëzakonëshme. Më në fund, qëndresa e të burgosurve u mposht. Gubernatorit iu raportua menjëherë se në burg kishte plasur një kryengritje. Muarrën si përgjegje një

shkresë, me të cilën urdhërohej burgu t'i dënonte fajtorët kryesorë, Vasiljevin dhe endacakun Nepomnjashçim, me tridhjetë thupra.

Dënimi duhej të vihej në zbatim në sallën e takimit të burgut të grave.

Korableva, Bukuroshja, Fedosja dhe Masllova qenë ulur në qoshen e tyre, pinin çaj dhe bisedonin. Nga vodka, që kishin pirë e që s'u mungonte kurrë, sepse për këtë kujdesej tani çdo mbrëmje Masllova, qenë skuqur në fytyrë e flitnin me gjallëri.

— Të qe që të kish bërë ndonjë sherr, e marr vesh, — thoshte Korableva për Vasiljevin, duke i çukitur coprat e sheqerit me të gjithë dhëmbët e saj të shëndoshë, — po se i doli për zot shokut, mirë bëri, se tani drurin e kanë ndaluar.

— Dhe thonë se është një djalë për kokën e djalit, — shtoi Fedosja, kosëgjata, që qe ulur mbi një kërcu përballë çajnikut.

— Ja, me atë sikur ta bëje fjalë këtë punë, moj Mihaillovnë, — iu drejtua rojtarja Masllovës, duke nënkuptuar me fjalën «atë» Nekludovin.

— Do t'ja them. Ai për mua s'kursehet! — u përgjegj Masllova e tundi kokën me buzën në gaz.

— Ehu, kushedi kur vjen ai, kurse këta ja, thonë, se çuan t'i marrin. . . Bobo, të gjorët, çdo të heqin! — tha Fedosja duke psherëtitur.

— Mua më ka qëlluar të shoh një herë se si e rrahën një muzhik në zyrën e vollostës [1]). Që thoni ju, ky vjehri im kish ca punë me kryeplakun e më dërgon mua atje. Nisem edhe unë e shkoj po, kur arrij atje, ç'të shoh?. . . — filloi rojtarja një histori të gjatë. Por tregimi i saj u ndërpre befas nga disa zëra e hapa sipër, në koridor.

Gratë heshtën dhe vunë veshin të dëgjonin se ç'po ndodhte.

— Ah, djajtë, e paskan marrë! — tha Bukuroshja. — Prit tani kur ta rrahin. Halë në sy e kanë ata gardianët, domosdo, se u vjen hakut ai!

Sipër u bë një heshtje. Rojtarja përfitoi nga kjo për ta shpënë gjer në fund historin'e saj e që t'u tregonte shoqeve se si ahere, kur shkoi në zyrën e vollostës dhe pa një muzhik që po e mbytnin në dru, aty në një plevicë, qe trëm-

---

1) Vollost = ndarje administrative në Rusinë e vjetër, pak a shumë si një pjesë e distriktit (sh. i përkth.)

bur kaq shumë sa nga tmeri dhe lemeria e madhe mënt shkalloi. Pastaj Bukuroshja tregoi se si edhe Shçeglovin e kishin rrahur me kamzhik, por ai hiç, s'e kish dhënë veten, e as që kish bërë një herë «oh!». Fedosja u ngrit e mblodhi enët e çajit, Korableva dhe rojtarja nisën të qepnin, kurse Masllova u ul mbi shtrat e mërzitur, duke i pushtuar gjunjët me të dy duart. Po matej të shtrihej e të flinte, kur u dëgjua zëri i gardianes që e lajmëronte të bëhej gati, se e thërrisnin në zyrë.

— Shih se mos harrosh t'i thuash për ne! — i foli plaka Menshova Masllovës që po ndreqte gërshetën përpara pasqyrës gjysmë të ckërfitur. — Se nuk e dogjëm ne, po ai e dogji, ai katili, dhe e panë, e pa dhe një fshatar që ndodhej aty. Ja, kështu thuaj, e thuaj të takohet me Mitron, se ai ja tregon për fije e për pe qysh e tek rrodhi puna. Ku është parë kjo? Ta pimë ne që s'kemi gisht fare n'atë punë, e ta hamë ne burgun kur ai katili, ai që e bëri zararin, rri e më kapardiset në mehane e bën qejf me gruan e botës!

— Kjo është kundër ligjit! — i mbështeti fjalët e plakës Korableva.

— Do t'i them, do t'i them patjetër, — u përgjegj Masllova. — Po të pi edhe pak që të marr zemër, — shtoi duke shkelur synë.

Korableva ja mbushi mashtrapën gjer në mes. Masllova e piu, fshiu buzët dhe, çakërrqejf, e ndoqi gardianen në koridor. Ecte e buzëqeshte, tundte kokën e pëshpëriste herë pas here: «Që të marr zëmër, që të marr zëmër!»

. . . . . .

XLVII

Nekludovi kishte kohë që po priste në të hyrë të burgut.

Porsa sosi në burg, ai i ra ziles dhe i dha mbikqyrësit dezhur lejen që i kishte lëshuar prokurori.

— Ju, me kë doni të takoheni?

— Me të burgosurën Masllova.

— Hëpërhë, s'ka mundësi: drejtori është i zënë.

— Ku? Në zyrë? — pyeti Nekludovi.

— Jo, këtu, në dhomën e takimeve, — u përgjegj mbikqyrësi si i turbulluar, të paktën kështu ju duk Nekludovit.

— Pse, ka takime sot?

— Jo, po ashtu është një punë, — tha mbikqyrësi.

— E si i bëhet atëhere që ta takoj?

— Ja, tani do të dalë, bisedoni vetë me të. Pritni pak.

Atë çast doli nga një derë anësore një feldfebel me ca kordona që i shëndritshin varur në gjoks, me një fytyrë të kënaqur e me shkëlqim, e me një palë mustaqe të trasha që kundërmonin nga era e duhanit.

— Ç'e prure këtë këtu?. . . E di që në zyrë. . . — nisi t'i shkrehej feldfebeli me të rreptë mbikqyrësit porsa vuri re Nekludovin.

— Më thanë që drejtori ndodhet këtu, — ndërhyri Nekludovi, i habitur nga ai shqetësim që vuri re tek feldfebeli.

Atë çast, dera e brëndëshme përballë tyre u hap dhe u dha në prak Petrovi, i skuqur në fytyrë e i dirsur.

— Ta mbaj mënd!. . . — tha ai duke u kthyer nga feldfebeli.

Feldfebeli i tregoi me sy Nekludovin. Petrovi heshti menjëherë, vrënjti vetullat, hapi derën e pasme e doli.

«Kush ta mbaj mënd? Përse këta sot duken të gjithë kaq të turbulluar? Përse feldfebeli i bëri shenjë atij që të mos fliste përpara meje?» — e pyeste veten Nekludovi.

— Këtu nuk bën ta pritni, urdhëroni në zyrë, — iu drejtua feldfebeli Nekludovit. Nekludovi po matej ta ndiqte kur, nga dera e pasme, doli drejtori, që dukej akoma edhe më i turbulluar se mvartësit e tij. Ai psherëtinte or'e çast. Porsa e pa Nekludovin u kthye nga mbikqyrësi e i tha:

— Fedotov! Masllova, qelia gjashtë, burgu i grave, të vijë këtu në zyrë!

— Urdhëroni, — shtoi, duke u drejtuar nga Nekludovi. Ata u ngjitën të dy bashkë nëpër një shkallë të rrëpirë e hynë që andej në një dhomë të vogël me një dritare, me një tryezë shkrimi dhe me dy a tri karrige. Drejtori u ul.

— Pun'e rëndë, shumë pun'e rëndë, — tha duke u kthyer nga Nekludovi, ndërsa ndizte një cigare të trashë.

— Duket, e ndjeni veten të lodhur, — i tha Nekludovi.

— U lodha nga kjo punë. Pun'e rëndë kjo. . . Mundohesh për të mirë e bën keq; mendoj t'iki që këtej. . . pun'e rëndë, shumë punë e rëndë. . .

Nekludovi nuk kuptonte përse drejtorit i dukej aq e rëndë ajo punë, por atë ditë vinte re tek ai shprehjen e një keqardhjeje e të një trishtimi të thellë.

— Po, ashtu mendoj edhe unë, është vërtet një pun'e rëndë! — tha ai — Po pse nuk jepni dorëheqjen?

— T'isha në gjëndje të mirë do ta kisha dhënë me kohë, por s'jam, kam familje...

— Sidoqoftë, gjersa mendoni se është një pun'e rëndë...

— Ashtu, vërtet, por megjithatë, edhe këtu njeriu, po të dojë, mund të bëjë të mirë. Ja, unë, fjala vjen, jam munduar t'ua bëj më të lehtë burgun këtyre fatkeqëve. T'ishte ndonjë tjetër në vëndin tim nuk do të qe sjellur kështu. Se s'i thonë shaka: bëhen më tepër se dymijë të burgosur! Duhet të dish si të sillesh me ta. Të vjen keq, domosdo, se, fundja, njerëz janë... Po edhe që t'ua lëshosh shumë frenë, nuk bën. E ja, kështu...

Pastaj drejtori nisi të tregonte një rast grindjeje që kishte shpërthyer ndërmjet të burgosurve dhe ku kish patur edhe një të vdekur.

Por drejtori s'e përfundoi dot tregimin, se atë çast hyri në dhomë Masllova, e shoqëruar nga mbikqyrësi.

Nekludovi e pa që në derë, kur ajo akoma s'e kishte vënë re drejtorin. Dukej e skuqur në fytyrë. Ecte shumë serbes pas mbikqyrësit dhe tundte kokën duke buzëqeshur parreshtur. Sapo vuri re në dhomë drejtorin, u trëmb e ja nguli sytë, por aty për aty e mori përsëri veten dhe, po aq e dlirtë dhe e qeshur, u kthye nga Nekludovi.

— Tungjatjeta, — tha si me të kënduar, duke buzëqeshur e me zë të lartë dhe ja shtrëngoi dorën ndryshe nga herët e tjera.

— Ju kam sjellur lutjen që ta firmoni, — tha Nekludovi, shumë i habitur për atë mungesë ndrojtjeje që vinte re tek ajo atë ditë. — Avokati e shkroi lutjen por, para se ta dërgojmë në Peterburg, duhet që ju ta firmoni.

— E firmojmë, pse të mos e firmojmë. Punë që bëhet... Të gjitha bëhen... — tha ajo e, ndërsa thoshte kështu, e rrudhte njërin sy dhe buzëqeshte.

— Eja këtu, ulu, — i tha drejtori, — ja ku e ke edhe penën. Hë, ç'thua, di nonjë çikë shkrim?

— Dikur kam ditur, — tha ajo duke buzëqeshur dhe duke ndrequr fundin e fustanit e mëngën e bluzës. Ndënji përpara tryezës, mori me një lëvizje të shpejt, në dorën e saj të vogël energjike, penën, vështroi Nekludovin dhe qeshi.

Ai i tregoi se ku duhej ta hidhte firmën.

Si e ngjeu me kujdes penën në bojë dhe si e shkundi dy a tri herë që të mos lëshonte nonjë pikë, e shkroi emrin e saj të plotë.

— Kaq? S'duhet gjë tjetër? — pyeti duke i kthyer sytë

herë nga Nekludovi, herë nga drejtori dhe duke mbështetur penën herë mbi kallamar e herë mbi letër.

— Unë kisha diçka për t'ju thënë — i tha Nekludovi dhe ja mori penën nga dora.

— E po mirë, ma thoni, — tha ajo dhe, befas, sikur diç iu kujtua apo sikur deshi të flinte, u vrënjt në fytyrë.

Drejtori u ngrit e doli dhe Nekludovi u ndodh me të ballë për ballë.

XLVIII

Mbikqyrësi, që e kishte shoqëruar Masllovën, u hoq mënjanë dhe shkoi e u ul në pezulin e dritares. Kishte ardhur për Nekludovin çasti vendimtar. Ai e qortonte veten që s'i kishte thënë asaj atë më të rëndësishmen e kryesoren që në takimin e parë, me fjalë të tjera, që nuk i kishte thënë se kishte ndërmënd të martohej me të. Por tani kish vendosur t'ja thoshte patjetër. Ajo qe ulur nga njera anë e tryezës, kurse Nekludovi nga ana tjetër, përballë saj. Dhoma ishte e ndriçuar mirë dhe për të parën herë Nekludovi e soditi kjartë, nga afër, fytyrën e saj duke vënë re të gjitha rrudhat mbi tëmtha dhe në të dy çipet e buzëve, si edhe sytë me qepalla të buhavitura. Keqardhja që ndjente për të iu shtua.

Ai mbështeti njerin bërryl mbi tryezë, që mbikqyrësi me baseta të thinjura që ndodhej tek dritarja e që dukej nga pamja një çifut, të mos e dëgjonte dot e tha:

— Nëqoftëse apeli do të dështojë, atëhere do t'i bëjmë një lutje perandorit. Nuk do të lemë gur pa lëvizur. . .

— E, të kisha patur atëhere një avokat për të qenë... — e ndërpreu ajo. — Po ai imi qe fare torollak nga mëndja, mundohej, i shkreti, vetëm si e si të më merrte me të mirë, — tha Masllova, e qeshi — Sikur ta kishin ditur ahere që isha një e njohura e juaj, ndryshe do të qenë sjellur me mua. Mirëpo s'e dinin dhe, ja, më bënë edhe hajdute!. . .

«Ndryshe po më duket sot», — mendoi Nekludovi dhe po matej të fliste, kur atë çast ajo u hodh e tha:

— Ja se ç'dua t'ju them. Atje tek ne është një plakë. Nuk mund ta merrni me mënd se sa plak'e mirë është. Mirëpo e kanë dënuar, atë dhe të birin. I kanë akuzuar për djegëje, por e dinë të gjithë që ata janë të pafajshëm. E ja, kështu, i kanë futur në burg që të dy, nën'e bir. Ajo, siç

duket, e ka marrë vesh që unë njihem me ju, — këtu Masllova ktheu kokën nga Nekludovi dhe e vështroi, — se më tha: «Thuaj atij, më tha, të kërkojë të piqet me tim bir, se ai ja çkoqit punën mirë». Menshovi quhen. . . E, si, do t'ja bëni këtë të mirë? E dini sa plak'e mirë që është? S'e merrni dot me mënd! Veç ta njihnit!. . . Duket menjëhere që s'ka bërë gjë. Hajt, pëllumb, bëni diçka për të, se është gjynah! — tha ajo, ndërsa ulte sytë e buzëqeshte.

— Mirë, do t'i ndihmoj, do të marr vesh si qëndron pun'e tyre, — tha Nekludovi, që dukej përher'e më i habitur nga ajo sjellje aq e çpenguar e Masllovës. — Por unë desha të bisedoj me ju, për punën tonë. A ju kujtohet çfarë ju thashë herën tjetër?

— Ju më folët kaq shumë sa kush i mban mënd? Çfarë më thatë herën tjetër? — tha ajo gjithë duke buzëqeshur e duke e vërtitur kokën kur në njerën anë, kur në tjetrën.

— Unë ju thashë se kam ardhur t'ju kërkoj ndjesë, — tha ai.

— Eh, gjithmonë këtë kini në gojë! T'ju kërkoj ndjesë, t'ju kërkoj ndjesë. . . Hiç, lereni këtë punë!. . . Do të bënit më mirë sikur. . .

— . . . dhe se desha ta ndreq gabimin tim, — vazhdoi Nekludovi — dhe ta ndreq jo me fjalë, por me vepra. Unë kam vendosur të martohem me ju.

Fytyra e saj shprehu befas një tmer. Syt'e saj vëngëroshë u ndalën një hop e iu qepën atij pa lëvizur.

— Edhe kjo na duhej!. . . — tha me fytyrë të prishur nga hidhërimi.

— E ndjej përpara zotit që duhet ta bëj këtë.

— Ç'hyn zoti këtu? Ju nuk dini ç'flisni! Zoti? Cili zot? Atëhere t'ju kishte rënë në mënd për zotin, jo tani! — tha ajo dhe ndali befas ashtu me gojë hapur.

Nekludovi vetëm tani e ndjeu erën e alkoolit që vinte nga goja e saj dhe e kuptoi shkakun e ekzaltimit që vinte re tek ajo.

— Qetësohuni, — i tha.

— S'kam pse të qetësohem! Mos kujton se jam e dehur? E dehur jam, por di se ç'them! — tha ajo befas me të shpejt, ndërsa bëhej flak'e kuqe në fytyrë: — Unë jam një e burgosurë, një k. . . kurse ju jeni një zotëri, një princ, prandaj s'kini pse të përgëreni me mua. Hajt, shko tek ato princeshat e tua, se me mua e rregullon kollaj, me dhjetë

rubla më shtie në dorë kur të duash! Kaq e kam çmimin unë...

— Sado të tmershme që janë fjalët që më thua. ti prapë kurrë nuk mund ta thuash atë që unë ndjej, — tha Nekludovi me një fije zëri, ndërsa dridhej i tëri. — Ti nuk mund ta marrësh me mënd gjer në ç'pikë e ndjej veten fajtor kundrejt teje!. . .

— E ndjej veten fajtor. . . — e përqeshi ajo me inat. — Atëhere nuk e ndjeje, po më dhe njëqind rubla e më le! Ja, kaq më çmove. . .

— E di, e di, po tani si t'ja bëj? — tha Nekludovi — Ja, tani kam vendosur mos të të le më vetëm, e kam vendosur dhe do ta bëj.

— Kurse unë them që s'ke për ta bërë! — tha ajo e ja shkrepi të qeshurit.

— Katjushë! — nisi ai me të butë e i preku dorën.

— Shporru nga unë! Unë jam e burgosur, kurse ti je princ! Ç'punë ke ti me mua? — thirri ajo me një çehre të tmerëshme në fytyrë, duke hequr me rrëmbim dorën nga dora e Nekludovit. — Ti kërkon të shpëtosh në kurrizin tim, — vazhdoi, duke u ngutur t'i zbrazte në fytyrë të gjitha sa i gufonin qëkur në shpirt — Bëre qejf me mua në këtë botë sa deshe dhe, ja, prapë nga unë e kërkon shpëtimin edhe në botën tjetër! T'urrej ty dhe ato syzat e tua të ndyra, dhe ata turinjtë e tu të pëgërë! Shporru, shporru të them! — ulëriti dhe, duke i dhënë trupit përpjetë sa mundi, brofi në këmbë.

Mbikqyrësi iu afrua.

— Moj, ç'ulërin kështu? Ku je këtu?

— Lereni, ju lutem, — ndërhyri Nekludovi.

— Jo, po duhet ta mbajë veten, — tha mbikqyrësi.

— Jo, jo, pritni, ju lutem, — tha Nekludovi.

Mbikqyrësi vajti e ndënji përsëri në dritare.

Masllova ndënji përsëri, uli sytë e shtërngoi duart.

Nekludovi qe kërrusur përmbi të e s'dinte ç'të bënte.

— Ti nuk më beson, — i tha më në fund.

— Që doni të martoheni? Kjo s'bëhet kurrë! Më mirë varem se sa. . . Ja, kështu!

— Sidoqoftë, unë do të të shërbej.

— Se ç'do bëni ju, kjo është punë për juve. Vetëm ju them që unë s'jua kam nevojën. E jua them me tërë mënd, — tha ajo — Ah, si nuk vdiqa atëhere! — shtoi dhe u shkreh në një vaj të çuditshëm.

Nekludovi nuk fliste dot. Edhe atij iu mbushën sytë me lot.

Ajo ngriti sytë e u çudit kur e pa që po qante. Pastaj nisi të fshinte me cepin e shamisë lotët që i vareshin faqeve.

Mbikqyrësi iu afrua përsëri, por këtë radhë për të lajmëruar se koha e caktuar për takim kish marrë fund. Masllova u ngrit.

— Ju tani jeni e tronditur. Unë, po të kem mundësi, do të vij prapë nesër. Ju, ndërkaq, mendohuni, — i tha Nekludovi.

Ajo nuk u përgjegj dhe, pa e kthyer më kokën që ta shikonte, doli e i shkoi pas mbikqyrësit.

XLIX

«Ja si qënka puna! Ja si qënka puna!» — mendonte Nekludovi duke dalë nga burgu. Ai vetëm tani po e kuptonte gjer në fund fajin e tij. Sikur të mos qe përpjekur ta ndreqte, ta shlyente atë faj, kurrë nuk do të kishte menduar se krimi që kish bërë ishte aq i rëndë sa po i dukej tani. Jo vetëm ai, por ndofta se ajo nuk do t'i kishte ndjerë të gjitha pasojat e këtij krimi. Por ja, ky krim i tmershëm, kishte dalë tani në dritë lakuriq. Ai e shihte kjartë se ja kishte prishur jetën asaj gruaje, dhe ajo e ndjente tani thellë të keqen që i kishin bërë. Në fillim Nekludovi kish luajtur me ndjenjën e pendesës së tij, e kishte përkëdhelur këtë ndjenjë, e kishte zbukuruar dhe qe mburrur me të. Por tani tmerohej. Që ta braktiste atë grua, e ndjente se s'qe i zoti. Por, në të njëjtën kohë, ai as që e merrte dot me mënd se si do të vazhdonin më tej marrëdhëniet e tyre.

Tamam në të dalë të burgut, Nekludovit iu afrua një gardian, me kryqe e me medalje varur në krahëror e me një shprehje tinzare e të ligë në fytyrë.

— Jam porositur nga një njeri t'ju jap këtë pusullë, shkëlqesia juaj. . . — tha ai duke i zgjatur Nekludovit një zarf.

— Kush është ky njeri?

— Lexojeni dhe do ta kuptoni. Është një e burgosur politike. Unë jam caktuar atje, në dhomën e tyre. E ja, m'u lut... E, sidoqë e kemi të ndaluar, nga njerzilleku, më kuptoni. . . — tha gardiani, e dukej kjartë që gënjente kur deshte të dukej i njerëzishëm.

Nekludovi habitej se si qe e mundur që një gardian i burgut politik të bëhej korrier i të burgosurve aty brënda në burg, pothuaj në sy të të gjithëve; ai nuk e dinte atëhere akoma që gardiani në fjalë ishte vërtet gardian, por ishte në të njëjtën kohë edhe spiun. Sidoqoftë, e mori pusullën dhe, porsa doli jashtë, e hapi dhe e lexoi. Në të, me një shkrim energjik, me lapës, qenë shkruar këto fjalë:

«Kam marrë vesh që ju vini herë pas here në burg dhe interesoheni për një të burgosur për faje ordinere. Mendova të përfitoj nga rasti që të takohem me ju. Kërkoni një takim me mua. Nuk do t'jua refuzojnë. Unë do t'ju vë në dijeni mbi shumë gjëra të rëndësishme lidhur me protezhenë tuaj e me grupin tonë. Do t'jua di për nder Vera Bogoduhovskaja».

Vera Bogoduhovskaja kish qënë mësonjëse dikur në një fshat të humbur të gubernës së Novgorodit, ku Nekludovi kishte shkuar një herë bashkë me disa shokë për gjah. Vera i qe lutur atëhere Nekludovit që t'i jepte hua një shumë të hollash. Nekludovi ja kishte dhënë të hollat që i kish kërkuar, por s'i kish rënë më ndër mënd për të. E ja, kjo grua tani ndodhej në burg dhe, si e kish marrë vesh me sa dukej historin' e tij, paraqitej i gatshëm t'i shërbente. Sa e thjeshtë kish qënë një her'e një kohë jeta e Nekludovit, dhe sa e lehtë! Kurse tani qe bërë kaq e rëndë, kaq e ndërlikuar. . . Nekludovi e përfytyroi me një gjallëri të jashtëzakonshme kohën kur qe njohur me Bogoduhovskën. Kjo kishte ndodhur në vigjiljen e karnavaleve, në një pyll nja gjashtëdhjetë kilometra larg vijës hekurudhore. Gjahu u kish vajtur mbarë, kishin vrarë dy arinj dhe, pasi kishin ngrënë bukë, po bëheshin gati të ngriheshin e të viheshin n'udhë, kur i zoti i izbës, në të cilën qe ndalur, erdhi e u tha se kishte ardhur aty e bija e dhiakut e se deshte të takohej me princin Nekludov.

— Është ndonjë çikë e mirë? — sekush pyeti.

Por Nekludovi e qortoi atë që foli, u bë hijerëndë, u ngrit nga tryeza dhe, ndërsa fshinte buzët e vriste mëndjen se përse vallë donte të takohej me të e bija e dhiakut, hyri në hatën [1]) e të zotit të shtëpisë.

Në dhomë ndodhej një vajzë me një kapuç shajaku në kokë, me peliçe, me një trup të hollë tërë muskla, me një fytyrë të hequr e të shëmtuar, ku vetëm sytë qenë të bukur dhe vetullat që ngriheshin përpjetë.

1) Hata = shtëpi fshati në Ukrainë dhe në Rusinë jugore.

— Hë, moj Vera Efremovna, llafosu tani me të! — tha një plakë që, me sa dukej, ishte e zonja e shtëpisë, duke u drejtuar nga vajza. — Ja, ky është princi, dora vetë! Unë ika, që t'u lë rehat.

— Ç'urdhëroni nga unë? — i tha Nekludovi.

— Unë. . . unë. . . Ja, si t'jua them, ju jeni i pasur dhe i bëni paratë rrush e kumbulla, në gjah, fjala vjen. Unë e di, — nisi të belbëzonte vajza e turbulluar. — Po unë dua vetëm një gjë: të bëhem e dobishme për njerëzit dhe ja, s'jam e zonja të bëj dot gjë se s'di asgjë.

Sytë e saj qenë të sinqertë, të butë dhe shprehja e vendosmërisë dhe e ndrojtjes, që vihej re në ta, qe kaq prekëse, saqë Nekludovi, siç i ndodhte dëndur edhe me të tjerë, u vu padashur në gjëndjen e saj, e kuptoi dhe e mëshiroi.

— Po unë ç'mund t'ju bëj?

— Unë jam mësuese, po desha të ndiqja shkollën e lartë. Mirëpo nuk më lënë. Jo se nuk më lënë, ata më lënë, por është puna se duhen të holla. M'i jepni ju, pra, këto të holla dhe unë, kur të mbaroj shkollën, do t'jua kthej. Njerëzit e pasur e humbasin kohën duke vrarë arinjtë e duke dehur muzikët. Unë mendoj se këto janë gjëra të kota. Përse të mos bëjnë të mira? Ja, unë kam nevojë vetëm për tetëdhjetë rubla. Ama, po s'm'i dhatë, mua aq më bën! — tha ajo me të rreptë.

— Përkundrazi, unë jam kundrejt jush shumë mirënjohës që më dhatë rastin. . . Ja, tani po jua sjell, — i tha Nekludovi dhe doli në hajat. Atje gjeti një shok, që po i përgjonte. Shokët nisën të tallen, por ai s'ua vuri veshin, nxori nga çanta të hollat dhe ja dha.

— Jo, jo, ju lutem mos më falënderoni. Përkundrazi, unë duhet t'ju falnderoj juve.

Nekludovit i vinte mirë t'i sillte ndërmënd tani të gjitha këto; i vinte mirë të sillte ndërmënd se si mënt u zu me një oficer, i cili kish dashur ta kthente këtë punë në një shaka pa kripë, se si një shok i kishte mbajtur krahun dhe kjo e kish bërë që të miqësohej me të akoma më shumë, se si gjahu kish qënë i mbarë e gazmor dhe se sa mirë e kishte ndjerë veten kur qenë kthyer natën në stacionin e trenit. Karvani i sajave, që vinin varg njera pas tjetrës, kur dy, kur tri së bashku, shkiste pa zhurmë por me vrap nëpër një monopat pyjesh, herë-herë të lartë, herë-herë të ultë, me bredha të mbuluar tejpërtej me borë. Dikush ndizte një cigare që kishte një kundërmim të këndëshëm dhe dukej si një

dritë që vezullonte në errësirë. Osipi, ndjellësi i gjahut, vraponte nga njera sajë në tjetrën me këmbët që i fundoseshin në borë gjer në gju dhe, tek u ndreqte kafshëve pajimet, fliste për drerët, që tani ecnin mbi borën e trashë e kafshonin lëvoret e shelgjeve, dhe për arinjtë, që shtriheshin tani ndër strofkullat e tyre e ja merrnin gjumit, ndërsa nga të çarat depërtonte jashtë afshi i ngrohtë i dihatjes së tyre të rëndë.

Nekludovi i solli ndërmënd të gjitha këto dhe, mbi të gjitha, atë ndjenjë lumturie që e pushtonte kur mendonte se ishte i shëndoshë, i fortë dhe pa halle në kokë. Mushkëritë tendosnin peliçen e gëzoftë mbi trup e thithnin një ajër të ngrirë e të pastër; fytyra spërkatej me çiklat e borës që binin nga degët e tundura, trupi ndjehej ngrohtë, fytyra ishte e freskët dhe në shpirtin e tij s'kishte asnjë shqetësim, asnjë qortim, asnjë frikë, asnjë dëshirë. Oh, sa mirë qe atëhere! Kurse tani. . . O zot i madh, sa të vështira e të dhimbëshme qenë të gjitha ato që po i ndodhnin tani!. . .

Me sa dukej, Vera Efremovna qe bërë revolucionare dhe prandaj e kishin futur në burg. Duhej të takohej me të edhe sepse ajo premtonte ta ndihmonte e ta këshillonte se si t'ja lehtësonte gjëndjen Masllovës.

L

Të nesërmen në mëngjes, kur u zgjua nga gjumi, Nekludovi solli ndërmënd të gjitha ato sa i kishin ndodhur një ditë më parë dhe u tmerua.

Por, pamvarësisht nga kjo, ai mendoi, i vendosur si kurrë ndonjë herë tjetër, se do ta shpinte gjer në fund punën që kish nisur.

Me këtë vetëdije të detyrës, që i kishte ngarkuar vetes, doli nga shtëpia e shkoi tek Maslenikovi për të marrë një leje që të vizitonte, përveç Masllovës, edhe të birin e plakës Menshova, sidhe Bogoduhovskën, e cila do të mund t'i jepte mbase Masllovës ndonjë ndihmë.

Nekludovi e njihte Maslenikovin që kur kishin qenë bashkë në ushtëri. Maslenikovi mbante n'atë kohë përgjegjësin'e financierit të repartit dhe ishte një oficer jashtëzakonisht i urtë e jashtëzakonisht i bindur, që mendonte se përveç regjimentit të tij dhe familjes së carit, në botë nuk kishte asgjë tjetër. Tani Nekludovi kishte marrë vesh se

qe bërë administrator dhe so kishte nje funksion të lartë në gubernë. Ai qe martuar me një grua të pasur dhe energjike, e cila e kishte këshilluar të jepte dorëheqjen nga shërbimi ushtarak dhe të ndiqte karierën civile. Kjo grua e pasur dhe energjike tallej me të dhe e përkëdhelte siç përkëdhelet një qengj i butë, manar. Nekludovi kishte qënë një herë tek ata vitin e kaluar, në dimër, por ai çift i qe dukur shumë bajat dhe që atëhere s'u kishte shkelur më në shtëpi.

Maslenikovi fluturoi nga gëzimi kur pa Nekludovin. Fytyra e tij ishte po aq e ngjallur dhe e kuqe si dikur n'ushtëri. Po aq i plotë e i dhjamur ishte edhe trupi i tij dhe po aq elegante e vërtet shik ishin edhe rrobat që kishte veshur. Vëndin e uniformës dhe të tuzhurkës [1]), përherë të pastër dhe të qepur sipas modës së fundit, e kishte zënë tani një kostum civil, i qepur edhe ky sipas modës së fundit, që i rinte si i derdhur e që i nxirrte në pah për mrekulli gjoksin e gjerë. Uniforma që kishte veshur ishte ajo e zëvëndës gubernatorit. Me gjithë ndryshimin e madh në moshë që kishte mes tyre (Maslenikovi ishte një burrë pothuaj në të dyzetat), ata i flisnin njeri tjetrit me «ti».

— E po të falemnderit që erdhe. Eja të shkojmë nga gruaja. Pas dhjetë minutash kam një mbledhje por, hëpërhë, jam i lirë. I madhi ka ikur, kështuqë tani, dua s'dua, jam i detyruar t'i mbaj unë frenat e gubernës në dorë, — tha ai me një kënaqësi që s'ishte në gjëndje ta fshihte.

— Kam ardhur tek ty për një punë.

— Ashtu? Hë? — ja bëri Maslenikovi me një zë të trëmbur e disi të rreptë, duke i dhënë befas fytyrës një çehre të merakosur.

— Interesohem për një të burgosur (kur u përmënd fjala «të burgosur», fytyra e Maslenikovit u bë edhe më e rreptë nga ç'kishte qenë) dhe ja, dua të takohem me të, jo në vëndin e caktuar për takimet, por në zyrë, dhe jo vetëm në ditët e caktuara por, po të jet'e mundur, edhe më dëndur. Pyeta dhe më thanë se këtë e ke në dorë ti.

— Natyrisht, mon cher [2]), unë jam gati të bëj çmos për ty, —tha Maslenikovi duke i prekur mysafirit gjunjët me të dy duartë, si për të zbutur gjer diku madhështinë që i jepte personit të tij ofiqi i lartë që i ishte besuar. — Kjo është punë që bëhet, vetëm një gjë duhet të dish: sot jam kalif vërtet, por nesër mbase s'jam, se vjen ai tjetri. . .

1) Tutë ushtarake.
2) I dashur (frëngj.)

— Atëhere, ke apo s'ke mundësi të më japësh një copë pusullë që të takohem me personin që të thashë?

— Ç'është ky person? Burrë apo grua?

— Grua.

— Po pse e kanë futur brënda, nuk më thua?

— Akuzohet se ka helmuar një njeri. Por akuza është e padrejtë.

— Po, po, për ju të zhurisë të gjitha akuzat janë të padrejta, ils n'en font point d'autres [1]) — tha ai duke iu tekur, kushedi përse, ta kthente befas bisedën frëngjisht. — E di që ti s'je dakord me mua, por s'ke ç'i bën, ç'est mon opinion bien arrêtée [2]), — shtoi ai duke çfaqur një opinion që, kur në një formë, kur në një tjetër, e kishte lexuar tërë atë vit nëpër faqet e një gazete reaksionare. — E di, ti je liberal.

— Jam liberal apo s'jam liberal, këtë s'e di, — tha duke buzëqeshur Nekludovi, që çuditej se si të gjithë ata që e njihnin mendonin se duhej të qe patjetër një njeri liberal, ngaqë, sa herë që vinte rasti për të gjykuar ndonjë person, ai përkrahte mendimin se duhej dëgjuar më parë edhe fjala e të gjykuarit dhe thoshte gjithashtu se njerëzit janë të gjithë të barabartë përpara ligjit, se nuk ishte e drejtë të mundohej e të rrihej njeriu, sado i rëndë të kish qenë faji që kish bërë, dhe aq më pak pastaj kur ende nuk qe provuar në se e kishte kryer fajin. — Jam apo s'jam liberal, këtë s'e di, vetëm këtë di që gjyqet e sotme, me gjithë të metat që kanë, janë shumë më të mirë nga gjyqet e mëparshëme.

— Ke biseduar me ndonjë avokat?

— Kam biseduar me Fanarinin.

— Ah, me Fanarinin! — tha Maslenikovi dhe u ngrys në fytyrë se iu kujtua se si, vitin e kaluar, Fanarini e kishte marrë në pyetje në gjyq si dëshmitar, duke e vënë në lojë me një mjeshtëri të madhe e me një mirësjellje të tepruar në sy të të gjithëve, plot një gjysmë ore, në mos më shumë. — Po të më dëgjosh mua, më mirë hiq dorë prej tij. Fanarini est un homme taré [3]).

— Dhe për një gjë tjetër do të lutem, — tha Nekludovi, pa iu përgjegjur. — Kam kohë që njihem me një vajzë, me një mësuese. Është një vajzë e mjerë. . . E kanë futur në burg e kërkon të takohet me mua. Ka mundësi të më japësh një leje që të takohem edhe me të?

---

1) Ata s'bëjnë gjë tjetër (frëngj.)
2) Për këtë unë kam bindje të plotë (frëngj).
3) Është një njeri i njollosur (frëngj).

Maslenikovi e anoi lehtë kokën e ndënji ashtu një çast i menduar.

— Ku e kanë? Në burgun politik?

— Po, kështu mora vesh.

— E di si është puna? Takimet me të burgosurit politikë lejohen vetëm për familjarët e tyre. . . Nejse, sidoqoftë, po të jap një leje të përbashkët për të dyja, për këtë dhe për atë tjetrën. Je sais que vous n'abuserez pas. . . [1] Si e quajnë atë protégée-në tuaj?. . . Bogoduhovskaja? Elle est jolie? [2]

— Hideuse [3].

Maslenikovi tundi kokën si pa qejf, iu afrua tryezës dhe, në një letër me vulë në krye, shkroi me vrull këto fjalë: «Princi Dmitri Ivanoviç Nekludov, lejohet të takohet në zyrën e burgut me të burgosurën Masllova, borgjeze, si edhe me ndihmës-mjeken Bogoduhovskaja». Në fund, Maslenikovi, me një lëvizje të gjerë të dorës, hoqi nja dy vija të trasha e të përdredhura.

— Ke për të parë sa rregull ka atje. Dhe që të mbash rregull atje është shum'e vështirë, sepse burgu tani është mbushur plot, sidomos me njerëzit e arrestuar pas trazirave të fundit; por unë i kam hyrë me qejf kësaj pune, e nuk lejoj të bëhet asnjë lëshim. Ke për të parë sa mirë janë ata atje e sa të kënaqur e ndjejnë veten. Vetëm se duhet të dish të sillesh me ta. Ja, fjala vjen, ca ditë më parë na ndodhi një gjë e pa pëlqyer: një rast mosbindjeje. Një tjetër në vëndin tim do t'i kishte dhënë karakterin e një revolte e kushedi sa veta do të merreshin në qafë. Mirëpo ne e mbyllëm këtë punë shpejt e shpejt e pa zhurmë. Në këtë zanatin tonë duhet, nga njera anë, përkujdesje për njerëzit por, nga ana tjetër, duhet edhe një dor'e fortë, — tha ai duke shtërnguar grushtin e tij lëkurëbardhë e të fryrë, me një unazë ngjyrë manushaqe në gisht që dilte pjesërisht nga mënga e bardhë e kollarisur e këmishës me polseta të florinjta. — Kështu, pra, përkujdesi dhe dora e fortë. . .

— Nuk e di, mbase është ashtu si thua ti, — tha Nekludovi. — Unë këtë di të them: dy herë që kam qenë atje, jam larguar me përshtypje jo të mira.

— E di si? Ti bën mirë të takohesh me kontesh̄ën Passek, — vazhdoi Maslenikovi i cili, tani që e kish zgjidhur

---

1) E di që ju nuk do ta shpërdoroni (frëngj).
2) Është e bukur? (frëngj)
3) E shëmtuar (frëngj)

gjuhën, e kishte zor të ndalej. — Ajo është dhënë me mish e me shpirt pas kësaj pune. Elle fait beaucoup de bién 1). Për hir të saj dhe, mbase, edhe për meritën time, mund të them, pa mburrje, se kemi arritur të bëjmë atje ndryshime rrënjësore, të tilla ndryshime, me një fjalë, që i kanë zhdukur kryekëput tmeret që kanë qenë më parë, aqsa tani ata e ndjejnë veten vërtet shumë mirë. Po është e kotë të zgjatem se ke për ta parë vetë. Ja, fjala vjen, Fanarini (unë atë personalisht nuk e njoh sepse, natyrisht, pozita që kam në shoqëri nuk më lejon n'asnjë mënyrë që të kem me të ndonjë kontakt të ngushtë). Fanarini, pra, sadoqë nuk e njoh, siç thashë, është për mua një njeri vërtet i lik! Dhe jo vetëm kaq, por ka edhe guximin të thotë në gjyq ca gjera, ca gjëra...

— Sidoqoftë, të faleminderit, — tha Nekludovi dhe, si mori lejen, u mat të dilte, pa pritur që shoku i tij të mbaronte së foluri.

— Po si, nuk do të shkojmë nga gruaja?

— Jo, kërkoj ndjesë, po tani s'mundem.

— Si kështu? Po si do t'i dal asaj përpara? — tha Maslenikovi duke e përcjellur Nekludovin gjer në sheshin e parë të shkallës, d.m.th. gjer atje ku përcillte zakonisht mysafirët e dorës së dytë ndër të cilët, sipas mendimit të tij, bënte pjesë edhe Nekludovi — Jo, jo, të lutem, eja të paktën t'i thuash dy fjalë.

Por Nekludovi nuk e ndryshoi vendimin që kish marrë dhe, ndërsa lakej dhe portieri hovnin t'i mbanin pallton, t'i jepnin bastunin dhe t'i hapnin derën që ruhej nga jashtë nga një polic, ai i kërkoi edhe një herë ndjesë Maslenikovit dhe doli.

— Atëhere eja të prëmten. Të prëmten ajo ka ditën e pritjes. Po e lajmëroj! — i thërriste pas Maslenikovi që nga shkalla.

LI

Po atë ditë, si doli nga Maslenikovi, Nekludovi shkoi në burg. Me t'arritur këtu, u drejtua menjëherë për nga shtëpia e drejtorit, ku kishte qenë edhe herë tjetër. Dëgjoi përsëri, si radhën e parë, tingujt e pjanos së keqe që luante tani, jo më rapsodin'e famëshme, por disa etude të Klementit, gjithë po me atë energji, kthjelltësi e shpejtësi ekzekutimi

1) Ajo bën shumë mirësira (frëngj).

të jashtëzakonëshëm. Shërbëtorja me një sy të lidhur, që doli e i hapi derën, i tha se kapiteni ndodhej në shtëpi dhe e shoqëroi në dhomën e pritjes. Kjo ishte një dhomë e vogël, që kishte për orendi një divan, një tryezë dhe një llambë mbështetur mbi një mbulesë leshi të qendisur. Nekludovi vuri re se abazhuri bojë trendafili i llambës qe djegur nga njera anë. Drejtori doli pas pak me një fytyrë të lodhur e të brengosur.

— Mirëseurdhëruat! Kishit ndonjë punë me mua? — tha ai duke mbërthyer pullën e mezit të uniformës.

— Isha tek nën-gubernatori dhe ja autorizimi, — tha Nekludovi duke i zgjatur pusullën, që i kish dhënë Maslenikovi. — Desha të takohesha me Masllovën.

— Markovën? — pyeti drejtori që s'dëgjonte mirë nga shkaku i muzikës.

— Masllovën.

— Aha! Po, po, e di!

Drejtori u ngrit në këmbë e iu afrua derës së dhomës që nga dëpërtonte jashtë ruladat e Klementit.

— Marusja, pa pusho një herë! — tha ai dhe, nga mënyra se si i tha këto fjalë, kuptohej kjartë se ajo muzikë që s'pushonte as ditë as natë, ja kishte bërë jetën varr. — S'dëgjohet hiç gjë!

Tingujt heshtën. U dëgjuan brënda në dhomë disa hapa të rënda dhe, po atë çast, dikush zgjati kokën në derë.

Drejtori, si i lehtësuar nga një barrë e rëndë, ndezi një cigare të trashë me duhan të butë dhe i ofroi edhe Nekludovit. Por Nekludovi nuk pranoi.

— Pra, siç ju thashë, desha të takohesha me Masllovën.

— Sot me Masllovën s'keni si të takoheni, — tha drejtori.

— Pse.

— Unë s'ju kam ndonjë faj, fajin e kini vetë, — tha drejtori me një buzëqeshje të lehtë. — Princ, mos i jepni të holla në dorë. M'i dorëzoni mua, po të doni, dhe s'ja prek njeri, ju siguroj. Se ja, dje, me sa duket, ju i dhatë ca të holla dhe ajo, se nga gjeti ca verë dhe u deh. Jo vetëm, por filloi të grindet. . . Eh, këtë ves nuk e çrrënjos dot kaq lehtë këtu në burg!

— Vërtet thoni?

— Nuk ju gënjej. M'u desh bile të merrja menjëherë masa të rrepta. E shpura në një qeli tjetër. Zakonisht sillet

mirë, s'i bie njeriu në qafë, po ç'e do, paratë e prishin. Pra, ju lutem, mos i jepni më. Është bela me këta. . .

Nekludovi solli ndërmënd atë që i kishte ndodhur dje me Maslloven dhe përsëri u tmerua.

— Po me Bogoduhovskën, në burgun politik, a mund të takohem?

— Me atë, po, mund të takoheni, — tha drejtori — Hë, po ti? — pyeti duke u drejtuar nga një vajzë e vogël ndonja pesë a gjashtë vjeçe, që kishte hyrë atë çast në dhomë. Vogëlushja çapitej për nga i ati, por kokën e mbante të kthyer nga Nekludovi. — Shiko se mos biesh! — i tha drejtori dhe buzëqeshi kur vuri re që vajza, ngaqë nuk shikonte përpara, u pengua në një qilim dhe vrapoi pastaj e trëmbur tek i ati.

— Atëhere, po të jetë e mundur. . .

— Po, po, besoj se kjo është e mundur, — tha drejtori duke përqafuar vajzën, që vazhdonte t'i mbante sytë kthyer nga Nekludovi. Pastaj u ngrit dhe, si e largoi butë-butë vogëlushen, doli në koridor.

Ndërsa shërbëtorja me sy të lidhur po i mbante pallton drejtorit që ta vishte, u dëgjuan përsëri gurgullimat e kjarta të ruladave të Klementit.

— E kisha në konservator, po atje ndodhën ca trazira. Gjynah, se ka shumë prirje, — tha drejtori, ndërsa zbritnin shkallët. — Ja, tani do që të marrë pjesë nëpër koncerte.

Drejtori dhe Nekludovi iu afruan burgut. Dera u hap menjëherë përpara tyre. Gardianët e nderonin drejtorin ushtarakisht dhe e shoqëronin me sy. Ndonja katër të burgosur, me kokë të rruara, që po transportonin disa vozga, u ndeshën me ta ballëpërballë dhe shtangën menjëherë në vënd porsa panë drejtorin. Njeri syresh u kërrus më tepër nga të tjerët dhe vrënjti vetullat, i zymtë, ndërsa sytë, që i kish të zes, iu përshkënditën me inat.

— S'do mënd, talenti do punuar, nuk do lënë që të fishket, por kur je ngushtë me shtëpi, më kuptoni, është pak e vështirë. . . — vazhdonte bisedën, ndërkaq, drejtori, pa e kthyer kokën fare nga të burgosurit e duke i hequr zvarrë këmbët e lodhura gjersa arriti bashkë me Nekludovin, në dhomën e takimeve.

— Me kë thatë se deshët të takoheshit? — e pyeti Nekludovin.

— Me Bogoduhovskën.

— Ajo është lart, në kullë. Do të pritni pak.

— Po gjatë kësaj kohe nuk ka mundësi të shoh të burgosurit Menshovi, t'emën e të birin, të akuzuar për djegëje?

— Këta janë në qelinë njëzet e një. Mirë, po jua sjellim këtu.

— Po sikur ta takoja Menshovin atje ku është, në qeli? Nuk do të jet'e mundur?

— Pse atje? Këtu në dhomën e takimeve ka më qetësi.

— Ashtu është, po do të më pëlqente më mirë ta takoja atje.

— Si të doni, po s'besoj të ketë atje ndonjë gjë që t'ju pëlqejë. . .

Atë çast, nga një derë anësore, doli një oficer me një uniformë elegante.

— Ja, shpjereni pak princin në qelinë e Menshovit. Qelia njëzet e një, — tha drejtori duke iu drejtuar oficerit, i cili ishte ndihmësi i tij. — Pastaj kthehuni në zyrë. Unë, ndërkaq, po dërgoj të thërasin atë tjetrën. Si e quajnë, thatë?

— Vera Bogoduhovskaja, — tha Nekludovi.

Ndihmës drejtori ishte një djalosh leshverdhë e me mustaqe të bojatisura që kundërmonin erë kolonjë.

— Urdhëroni! — tha ai, duke iu kthyer Nekludovit me një buzëqeshje të përzëmërtë. — Interesoheni, duket, për institucionin tonë?

— Po, interesohem për një njeri të cilin, me sa kam marrë vesh, e kanë futur në burg duke qënë krejt i pafajshëm.

Ndihmësi ngriti supet.

— Gjëra që ndodhin, — tha ai i qetë duke i hapur rrugë njerëzisht mysafirit nëpër një koridor të gjerë e të qelbur. — Gjëra që ndodhin, po dhe ata ama gënjejnë. Ju lutem!

Dyert e qelive qenë të hapura dhe disa nga të burgosurit kishin dalë në koridor. Ndihmësi ecte duke i përshëndetur me një lëvizje të lehtë të kokës gardianët që hasnin rrugës e duke i vështruar me bisht të syrit të burgosurit që, porsa e shikonin, ose nxitonin të shkonin nëpër qelit'e tyre duke shkarë rrëzë mureve, ose shtrinin krahët dhe e nderonin si ushtarë, duke e shoqëruar me sy. Si kaluan ashtu nëpër koridorin e parë, duallën në një koridor tjetër, në të majtë, që mbyllej me një derë të hekurt.

Ky koridor ishte më i ngushtë, më i errët dhe më i qelbur nga i pari. Nga të dy anët, dukej një sërë dyersh të mbyllura me dryna. Në çdo derë kishte nga një frengji ndo-

një gjysmë vërshoku [1]) të gjerë. Në koridor s'kishte asnjeri, me përjashtim të një gardiani plak, me një fytyrë tërë rrudha e të brengosur.

— Menshovi, ku është? — e pyeti ndihmësi gardianin.

— Në të tetën, nga e majta.

LII

— Ka mundësi të hedh një sy? — pyeti Nekludovi.

— Ju lutem! — iu përgjegj ndihmësi me një buzëqeshje të përzëmërtë, që diç nisi ta pyeste atë çast gardianin. Nekludovi vështroi përmes një frengjije. Pa një djalosh me shtat të lartë që ishte veshur vetëm me të linjta, me një mjekër të vogël e të zezë. Djaloshi vërtitej lart e poshtë me hapa të shpejta; kur dëgjoi zhurmë tek dera, ktheu kokën nga ajo anë, vrënjti vetullat e vazhdoi të ecte.

Nekludovi vuri syrin në një frengji tjetër: syri i tij ndeshi në një sy tjetër të zgurdulluar e të trëmbur, që vështronte edhe ai përmes frengjisë. Nekludovi u largua me shpejt. Përmes frengjisë së tretë, ai pa një të burgosur që dukej fare i shkurtër e që qe mbledhur kutulaç në shtrat me kokën mbështjellur në kapotë. Në qelinë e katërt, ndodhej një burrë i zbetë e shpatullgjerë, që e kish varur kokën poshtë e rrinte ashtu mbi shtrat me bërrylat mbështetur mbi gjunjë. Porsa dëgjoi hapat, ai ngriti kokën e hodhi sytë nga dera. Çdo tipar i fytyrës së tij, veçanërisht syt'e mëdhenj, mbanin vulën e një brënge të thellë. Dukej kjartë që atij aq i bënte se dikush po e vështronte, sepse, me ç'kuptohej, s'priste ndonjë të mirë prej askujt. Nekludovit i hypi një frikë dhe nuk vështroi më nëpër frengjit' e dyerve që vinin pas asaj, por shkoi drejt e tek qelia e Menshovit. Gardiani çeli drynin dhe e hapi derën tejpërtej. Pranë shtratit qëndronte në këmbë një djalosh i fortë e tërë muskula, me një zverk të gjatë, me dy sy të butë, të rrumbullaktë, e me një mjekër të shkurtër e të hollë. Djaloshi u ngut të vishej e vështroi i trëmbur ata që po hynin. Nekludovit i bënë përshtypje të madhe sidomos tek ai syt'e butë e të rrumbullaktë, që lëviznin or'e çast të trëmbur e të habitur, duke kaluar me radhë nga Nekludovi te gardiani e tek ndihmësi dhe anasjelltas.

— Ja, zotëria ka ardhur të të pyesi si e ke hallin.

---

1) Vershok = njësi gjatësie baraz me 4,4 cm. (sh. i përkth.)

— Faleminderit shumë.

— Më kanë folur për çështjen tuaj, — tha Nekludovi, që hyri në thellësi të qelisë e u ndal pranë dritares së ndytë, me hekura. — Po desha ta dëgjoj një herë nga goja juaj ngjarjen.

Menshovi, iu afrua edhe ai dritares dhe nisi të tregonte me një frymë, në fillim i ndrojtur e duke i kthyer sytë or'e çast nga ndihmës drejtori, por pastaj, dora dorës që tregonte, përherë më i çpenguar e më i qetë. Kur ndihmësi doli jashtë në koridor për të dhënë ca urdhëra, djaloshi mori edhe më shumë zëmër duke e përshkruar ngjarjen ashtu siç kishte ndodhur. Tregimi qe i vërtetë, sepse ai që e tregonte kishte gjuhën e gjestet e një muzhiku të thjeshtë, të padjallëzuar dhe Nekludovit i dukej çudi që ato fjalë dilnin nga goja e një të burgosuri me rrobat e ndyta të burgut mbi trup. Nekludovi dëgjonte, dëgjonte me vëmëndje të madhe e, ndërkaq, hidhte sytë rreth e rrotull, shikonte shtratin e ultë me dyshek prej kashte, shikonte dritaren me hekurat e trasha, shikonte muret e ndytë e të gërryer nga lagështira, shikonte fytyrën e vrerosur të atij fatkeqi aty, përpara tij, e atij muzhiku të gjymtyruar n'ato rroba që s'ishin për të, dhe një brengë e hidhur hidhte rrënjë për her'e më thellë në shpirtin e tij. I vinte të mos e besonte të vërtetën e kulluar që zbulohej në çdo fjalë t'atij njeriu të thjeshtë, sepse qe e tmershme të mendoje që njerëzit t'arrinin gjer aty sa të hakmirreshin padrejtësisht kundra një njeriu që s'i kishte fyer por e kishin fyer, dhe ta veshnin me ca rroba të ndyta për ta kalbur n'atë strofkull të qelbur. Por, nga ana tjetër, do të qe edhe më e tmershme të mendoje se ai tregim i vërtetë, se ajo fytyrë e thjeshtë, e butë, mund të fshihte një gënjeshtër, një trillim. Sipas fjalëve të muzhikut, mehanexhiu i fshatit ja kishte rrëmbyer gruan ca ditë pas martesës. Ai s'kishte lënë vënd pa u ankuar. Por mehanexhiu i kish blerë të gjithë me para dhe kështu askush s'ja vinte veshin. Ahere shkon dhe e merr gruan me forcë dhe e sjell në shtëpi. Por të nesërmen ajo i ikën. Ai ngrihet e shkon në shtëpin'e mehanexhiut. Ky i thotë se gruan s'e kish atje (por ai e pa kur hyri) dhe e dëboi. Ai s'deshi të largohej. Mehanexhiu ahere, bashkë me një sherbëtor, e kapi dhe e rrahu për vdekje, kurse të nesërmen u han fiala që hauri i mehanexhiut kish marrë zjarr e qe djegur. Për zjarrin ja hodhën fajin atij dhe s'ëmës. Por ai s'kishte patur gisht n'atë punë, se atë kohë kish ndodhur tek nuni.

— Domethënë, ti s'e dogje?

— Jo, im zot, pse do ta digjja? As që më shkoi ndërmënd! Po ai i paudhi, ai që më mori në qafë, e dogji vetë! Thonë se e kishte siguruar aty e ca ditë më parë. Po fajin na e hodhën neve, mua dhe mëmës se, thanë, deshëm ta frikësonim. Ç'është e vërteta, për të sharë e kam sharë atëhere që i shkova në shtëpi, se s'e mbaja dot. Po që për të djegur, s'e kam djegur. Dhe as që kam qënë aty kur ra zjarri. Po ai hidhet e thotë me qëllim se gjoja paskeshim qënë tek ai, unë dhe mëma, atë ditë që ra zjarri. Domosdo, se e dogji vetë, se e kish siguruar, e na e la neve!

— Kështu të jetë, vërtet?

— Kështu im zot, kështu është! Më vraftë zoti në ju gënjej! Po amani, vini dorën në zëmër! — Ai deshi të binte në gjunjë e të betohej, por Nekludovi s'e la. — Se më mori në qafë, më mori! — tha më në fund.

Dhe, befas, mishi në faqe iu rrënqeth e ai u shkreh në vaj e, duke përveshur mëngën e tutës, nisi t'i fshinte lotët me mëngën e këmishës së ndohtë nën të.

— Mbaruat? — pyeti ndihmësi.

— Po. Mos u dëshpëroni. Do të bëjmë ç'të jetë e mundur! — tha Nekludovi dhe doli jashtë. Menshovi vazhdonte të qëndronte në këmbë tek dera, kështuqë gardiani, kur e mbylli derën nga jashtë, ja përplasi me forcë në fytyrë. Ndërsa gardiani e mbyllte derën me dryn, Menshovi vështronte jashtë përmes frengjisë.

LIII

Ndërsa kthehej nëpër koridorin e gjerë (qe koha e drekës e qelitë qenë hapur) përmes të burgosurve veshur me tuta të verdha, me poture të shkurtëra e me këpucë të rënda në këmbë, të cilët e përpinin me sy, Nekludovin e pushtoi një ndjenjë e çuditëshme. Provonte nga njëra anë një keqardhje të thellë ndaj atyre njerëzve që ndodheshin këtu, një ndjenjë ngurrimi e tmeri ndaj atyre që i kishin futur e i mbanin në burg, kurse, nga ana tjetër, kushedi përse, i vinte turp për veten e tij që rrinte e i shikonte i qetë të gjitha këto.

Dikush vrapoi me këpucë të rënda tek dera e një qelie e, që andej, duallën disa të burgosur që i prenë rrugën Nekludovit dhe e përshëndetën.

— Jepni urdhër, shkëlqesi, ndonëse s'di as se si ju quajnë, të na bëhet ndonjë derman! — tha njeri syresh.

— Unë s'kam gjë në dorë.

— S'prish punë, u thoni makar atyre q'e kanë në dorë! — tha ai që kish folur si ndonjë i xhindosur. — Hiçgjë s'kemi bërë, po ja, kemi dy muaj që vuajmë!

— Si? Përse? — pyeti Nekludovi.

— Po ja, na rrasën këtu e s'na lëshojnë! Sot bëhen dy muaj plot. Se përse, as ne nuk e dimë.

— Është e vërtetë, — ndërhyri ndihmësi. — Këta i kanë arrestuar se s'kanë qenë në rregull me pasaportat. Duhet t'i kishim dërguar në krahinën e tyre, mirëpo burgu atje është djegur, kështu që muarrëm urdhër që hëpërhë të mos i nisnim. Ata që ishin nga krahinat e tjera, i shpërndamë që të gjithë, por këta jemi të detyruar t'i mbajmë.

— Dhe si, vetëm për këtë? — pyeti Nekludovi duke ndalur hapin.

Turma që përbëhej nga ndonja dyzet vetë, veshur që të gjithë me uniformën e burgut, e rrethoi Nekludovin dhe ndihmësin. Disa vetë menjëherë filluan të flasin. Por ndihmësi i ndaloi.

— Njeri le të flasë, — tha.

Atëhere nga turma u shkëput një fshatar me shtat të lartë e i pashëm, një burrë ndonja pesëdhjetë vjeç. Ai i shpjegoi me hollësi Nekludovit se si qe puna e tyre. I kishin arrestuar, se i kishin gjetur pa pasaporta. Pasaportat i kishin, jo se s'i kishin, por u kishte kaluar afati ndonjë javë apo dy. Kjo puna me pasaportat kështu ndodhte çdo vit, por gjer ahere s'u kishin thënë gjë. Kurse këtë radhë, i kishin futur brënda dhe ja, bëheshin dy muaj që po i mbanin aty si të qenë kriminela. . .

— Ne jemi të një arteli që të gjithë, që të gjithë ustallarë. Na thonë se burgu në gubernën tonë është djegur. Po ç'faj kemi ne se është djegur? Vini dorën në zëmër, shkëlqesi, e na shpëtoni nga ky hall.

Nekludovi, ndonëse mundohej të dëgjonte me vëmëndje ato që thoshte ai burrë plak e i pashëm, nuk kuptonte pothuaj asgjë, ngaqë i kish ngulur sytë tek një morr i madh, i zi, që po i varej të burgosurit nga flokët e po i binte mbi faqe.

— Si është e mundur një gjë e tillë? Për kaq gjë i mbajnë në burg këta njerëz? — tha Nekludovi duke iu drejtuar ndihmësit.

— Po, autoritetet këtu kanë bërë një gafë, sepse duhet t'i kishin dërguar nëpër vendbanimet e tyre dhe atje të gjykoheshin, — tha ndihmësi.

Porsa ndihmësi mbaroi së foluri, u shkëput nga turma një i burgosur, me trup të shkurtër që, duke e shtrëmbëruar or'e çast gojën në një mënyrë të çuditëshme, nisi të thotë se po i torturonin kot.

— Këta këtu, më keq nga qëntë na përdorin. . .

— More ti, shiko mos e tepro, se pastaj e di vetë. . .

— E pse, ç'do të më bësh? — tha në kulmin e dëshpërimit i burgosuri. — Hë, na tregoni, ç'faj kemi bërë?

— Hesht! — thirri ndihmësi, dhe shkurtua heshti.

«Ç'është kjo?» — pyeste veten Nekludovi duke dalë nga qelitë, ndërsa përmes frengjive të dyerve dhe nëpër koridor, me qindra sy e përgjonin.

Vërtet mbahen në burg njerëz krejt të pafajshëm! — tha Nekludovi kur dolën nga koridori.

— S'ke ç'i bën, gjëra që ndodhin. Po, ama, edhe ata gënjejnë, gënjejnë aq shumë sa s'keni idé. Sipas atyre asnjeri s'është fajtor, të gjithë janë të pafajshëm! — tha ndihmësi.

— Mirë, po ata që takuam qenë vërtet të pafajshëm më duket. . .

— Ata, po, ka mundësi. Vetëm se janë njerëz që s'u zihet besë, janë të gjithë maskarenj. Po s'u tregove i rreptë me ta, s'ke gjë në vijë. Apo s'ka pastaj disa të tjerë që zoti na ruajtë!. . . Ja, dje na u desh t'i dënonim nja dy.

— Si t'i dënonit? S'e marr vesh. . . — pyeti Nekludovi.

— Me thupra. I rrahëm. . .

— Po dënimet trupore sikur janë ndaluar.

— Jo për të gjithë. Për ata, që u janë mohuar të drejtat, qëndrojnë kurdoherë në fuqi.

Nekludovi solli ndërmënd ato sa kishte vënë re dje, kur po priste të takohej me drejtorin e burgut. S'kishte dyshim se rrahja, për të cilën bënte fjalë ndihmësi, kish ndodhur pikërisht atëhere. Duke i sjellur ndërmënd këto, ai kuptoi se po e pushtonte përsëri, si edhe një herë tjetër, por me një forcë të dyfishuar, po ajo ndjenjë e përzier kërshërie, trishtimi, ngurrimi e pështirimi moral, që kalonte dalngadalë në një pështirim të vërtetë, në kuptimin fizik të kësaj fjale.

Pa u vënë më veshin fjalëve të ndihmësit dhe pa vënë më re se ç'po ndodhte rreth tij, ai doli me të shpejt nga

koridori dhe shkoi drejt e në zyrë. Drejtori ndodhej në koridor dhe, i zënë me punë të tjera, kishte harruar ta thërriste Bogoduhovskën. Ju kujtua që i kishte premtuar Nekludovit se do ta thërriste vetëm kur ky hyri në zyrë.

— Ja, po dërgoj ta thërresin. Uluni! — i tha.

LIV

Zyra përbëhej nga dy dhoma. Në dhomën e parë, mu në mes ndodhej një sobë e gjatë, e vjetër. Në një qoshe, matanë dritareve të ndyta të dhomës, qe vendosur një matëse e zezë që shërbente për të matur lartësinë e të burgosurve kur vinin për herë të parë në burg, ndërsa në mur qe varur një ikonë e madhe me fytyrën e Krishtit, orendi kjo e rëndomtë që, për t'u tallur me mësimet e tij, i mundonin njerëzit e i poshtëronin. Në këtë dhomë ndodheshin gjithashtu edhe disa mbikqyrës. Në dhomën tjetër, kishin zënë vënd rrëzë murit grupe-grupe apo dy nga dy, ndo njëzet vetë që bisedonin që të gjithë me zë të lartë. Pranë dritares qe vendosur një tryezë shkrimi.

Drejtori u ul në tryezën e shkrimit dhe e ftoi Nekludovin në një karrige, që ndodhej aty pranë. Nekludovi ndënji dhe nisi t'i sodiste një e nga një e me kujdes personat që ndodheshin në dhomë.

Në fillim i tërhoqi vëmëndjen sidomos një djalosh me një setër të shkurtër e me një fytyrë të hijëshme, që qëndronte në këmbë përpara një gruaje me vetulla të zeza dhe pak si e shkuar nga mosha, dhe diç po i tregonte asaj me zjarr të madh e me gjeste. Aty afër qe ulur një burrë plak me syza të zeza, që rrinte si i ngrirë e dëgjonte ç'po i thoshte një grua e re e veshur me rroba burgu. Pak ku ja kishte shtërnguar dorën gruas dhe s'ja lëshonte tërë kohën. Një çunak gjimnazist, me një shprehje të trëmbur në fytyrë, ja kishte ngulur sytë plakut e s'ja hiqte. Pak më tutje, strukur në një rrëzë, ndodhej një çift: ajo ishte një vajzë e re, veshur me një fustan sipas modës, e hijëshme, me flokë të prera shkurt e të verdhë, dhe me një fytyrë energjike; ai qe një djalosh i pashëm, me tipare të mprehta, me flokë të dallgëzuara e me një tutë prej gutaperke. Ata pëshpëritnin kokë më kokë duke shkëmbyer, me sa dukej, fjalë dashurie. Përkëtej, nga an'e tryezës, ndodhej një grua me flokë të përthinjura e me fustan të zi. Ishte,

me ç'kuptonej, e ëma e djaloshit të zbetë, padyshim tuberkuloz, veshur edhe ai me tutë, të cilin ajo s'ngopej duke e parë. Herë-herë, matej t'i thoshte ndonjë fjalë, por s'mundej se s'e linin lotët. Djaloshi vërtiste me nervozizëm një letër që mbante në dorë. Aty pranë qe ulur edhe një vajzë me trup të plotë, me një fytyrë shumë të hijëshme, me faqe të kuqe, me dy sy shumë të këcyer, me një fustan bojëhiri dhe me një pelerinë të shkurtër, hedhur krahëve. Ajo rrinte ngjitur me gruan veshur me të zeza që qante dhe i lëmonte kurrizin. Çdo gjë dukej e bukur dhe e përsosur n'atë vajzë: dhe duart e mëdha e të bardha, dhe flokët e prera shkurt e të dallgëzuara, dhe hunda e theksuar, dhe buzët; por shija e rrallë e fytyrës së saj qëndronte sidomos tek sytë ngjyrëgështenjë e të këcyer, me atë shprehjen e tyre të butë dhe të sinqertë. Ata sy të bukur u shkëputën nga fytyra e s'ëmës atë çast kur hyri Nekludovi dhe u ndeshën në vështrimin e tij. Por, aty për aty, ajo uli kryet e diç nisi t'i thoshte gruas në të zeza. Nga ajo anë, ku ndodhej çifti i të rinjve, pak më larg, kish zënë vënd një burrë i zeshkët me qime nëpër duar e në fytyrë, që diç po i thoshte me një shprehje të rreptë e të zymtë një vizitori pa mjekër. Nekludovi qe ulur pranë drejtorit dhe vështronte me një kërshëri të ndemë të gjitha ato sa ndodhnin rreth e rrotull. Por befas ja hoqi vëmëndjen një fëmijë me kokën toç që iu afrua dhe e pyeti me një zë të hollë:

-- Po ju, kë pritni?

Pyetja e habiti Nekludovin. Por, duke hetuar me kujdes fytyrën e mënçur të çunakut dhe syt'e tij të gjallë e të vëmëndshëm, ai u përgjegj, ashtu siç do t'i përgjigjej një të rrituri, se priste të takohej me një grua, që e kishte të njohur.

— Po mirë, çfarë e kini? Mos e kini motër? — pyeti çunaku.

— Jo, jo, motër, — u përgjegj i habitur Nekludovi. — Po ti. nuk më thua, me kë je këtu? — e pyeti ai vogëlushin.

— Unë jam me mamanë. Mamaja ime është burgosur për politikë, — tha djali me mburrje.

— Maria Pavlovna, merreni Koljen, — tha drejtori që, me sa dukej, mendonte se biseda e Nekludovit me çunakun ishte në kundërshtim me rregullat e burgut.

Maria Pavlovna, pikërisht ajo vajza që i kish rënë menjëherë në sy Nekludovit porsa kish hyrë në dhomë, i dha trupit përpjetë, u ngrit dhe iu afrua Nekludovit e çu-

nakut me hapa të mëdha e të rënda, pothuaj si hapa burri.

— Do të dijë, mbase, se kush jeni, apo jo? — e pyeti ajo Nekludovin me një buzagaz të lehtë e duke e parë drejtë e në sy me një shprehje besimi e thjeshtësie të tillë që s'kishe se si të mos mendoje se marrëdhëniet e saj me njerëzit, me të gjithë njerëzit, ishin të thjeshta, të sinqerta e vëllazërore. — Ai të gjitha do t'i dijë! — tha ajo dhe i buzëqeshi në fytyrë kalamanit, kaq butë e kaq ëmbël, sa që, si çunaku, ashtu dhe Nekludovi, e vunë edhe ata pa dashur buzën në gaz.

— Po, më pyeti me kë do të takohem.

— Maria Pavlovna, sikur e dini më duket se nuk lejohen bisedat me të huajt, — ndërhyri drejtori.

— Mirë, mirë — u përgjegj ajo dhe, duke e kapur për dore Koljen me atë dorën e saj të madhe e të bardhë, u kthye bashkë me të tek e ëma e djaloshit të zbetë, tuberkuloz.

— I kujt është ky fëmi? — e pyeti Nekludovi drejtorin.

— I një të burgosure politike; ka lindur këtu në burg, — tha drejtori me një farë kënaqësie dhe si për t'u mburrur që në burgun e tij kishte ndodhur një gjë kaq e rrallë.

— Ashtu?

— Po, po; dhe tani do të shkojë në Siberi bashkë me t'ëmën.

— Po ajo vajza?

— Këtë s'mund t'jua them, — tha drejtori duke ngritur supet. — Po ja tek erdhi edhe Bogoduhovskaja.

LV

Nga dera e pasme hyri duke u lëkundur Vera Efemovna, një grua me flokë të prera shkurt, e hollë dhe e verdhë në fytyrë, me dy sy të mëdhenj e të butë.

— E po, faleminderit që erdhët, — tha ajo duke i shtërnguar Nekludovit dorën. — Më mbajtët mënd që atëhere? Ulemi!

— Nuk mendoja t'ju takoja këtu.

— Oh, unë këtu jam shumë mirë! Jam kaq mirë, sa s'di si t'ju them, — tha Vera Efremovna, duke e vështruar Nekludovin me syt'e saj të ndrojtur, të mëdhenj e të butë dhe duke e vërtitur herë në njerën anë herë në tjetrën qafën e saj të verdhë e të hollë, sa mënd këputej e me damarë që

ngriheshin përpjetë në sfondin e jakave të zhubrosura e të ndyta të bluzes.

Nekludovi nisi ta pyeste përse e kishin burgosur. Ajo filloi të flasë gjër' e gjatë për lëvizjen e fshehtë në të cilën kishte marrë pjesë. Fliste për propagandë, për grupet, për seksionet dhe nënseksionet e për shum'e shumë gjëra të tjera, për të cilat ajo kishte bindje të plotë se i dinin të gjithë, por që Nekludovi s'i kishte dëgjuar kurrë ndonjë herë.

Ajo i tregonte me nge të gjitha këto duke menduar se Nekludovi mezi ç'priste të dëpërtonte në të fshehtat e narodnovolstvos [1]) të cilat për të, ashtu si për të gjithë, duhej të qenë jashtëzakonisht të rëndësishme. Por Nekludovi, ndërkaq, sodiste zverkun e saj të ligur e të mjerë, flokët e rralla e të ngatërruara në kokë dhe mendonte i habitur përse vallë ajo ja tregonte të gjitha këto dhe përse i kishte bërë të gjitha ato sa i tregonte.

Ndjente se i vinte keq për të, por nuk ishte ajo keqardhje që kishte provuar për Menshovin, për muzhikun e mjerë që e kishin futur në burg, megjithëqë ishte i pafajshëm. I dhimbsej sidomos për atë kaos mend mesh që kishte në kokë. Ajo, me sa dukej, e pandehte veten një heroinë që është gati të bëjë fli edhe jetën për triumfin e çështjes së përbashkët. Por, çudi, nuk ishte në gjëndje as të shpjegonte se ç'ishte kjo çështje dhe si e qysh do të triumfonte!

Duke hyrë në bisedën për të cilën i qe lutur Nekludovit që të takohej me të, Vera Efremovna i tregoi se si një shoqe e saj, një farë Shustova, sadoqë nuk bënte pjesë fare në nëngrupin e tyre, qe arrestuar bashkë me të aty e pesë muaj më parë dhe mbahej në Kështjellën e Petropavlovskut vetëm se i kishin gjetur me vete libra e letra që nuk ishin aspak të saja por ja kishin dhënë për t'i ruajtur. Vera Efremovna mendonte se edhe ajo vetë ishte pjesërisht fajtore n'arrestimin e Shustovës dhe i lutej Nekludovit, që kishte lidhje e miq në shoqërinë e lartë, të bënte çmos që ta lironin. Bogoduhovskaja iu lut t'interesohej gjithashtu edhe për një farë Gurkeviç, që ndodhej edhe ky në Kështjellën

1) Narodnaja Volja = fjalë për fjalë: vullneti i popullit. Parti revolucionare në Rusi, aty nga fillimi i viteve të 80 të shek. XIX, sipas së cilës, lufta politike kundër autokracisë cariste duhej të bëhej nëpërmjet komploteve të fshehta dhe terrorit (shënim i përkth).

e Petropavloskut, e të ndërmjetësonte që ta lejonin të takohej me prindërit e t'i sillnin në burg ca libra shkencore që i duheshin për studime.

Nekludovi premtoi se do t'i kishte parasysh të gjitha këto, kur të shkonte në Peterburg.

Pastaj Vera Efremovna i rrëfeu historin'e saj. Tha se porsa kishte mbaruar shkollën për mami, kishte ardhur në kontakt me partinë e narodovolcëve dhe kishte punuar në radhët e tyre. Në fillim, punët kishin vajtur mbarë, kishin shkruar proklamata dhe kishin propaganduar nëpër fabrika. Mirëpo, më vonë, organet kishin vënë dorë mbi një eksponent të lëvizjes. Kishin gjetur edhe shumë dokumenta kompromentonjëse dhe kishin filluar menjëherë arrestimet në masë.

— Kështu, më arrestuan edhe mua dhe, ja, tani do të më internojnë. . . Po, nejse, s'prish punë. Unë e ndjej veten mirë dhe jam plotësisht e qetë, si ai Jupiteri plak dikur majë Olimpit, — e përfundoi ajo tregimin e saj duke i kërveshur buzët në një gaz të f.kur e të mjerë.

Nekludovi e pyeti për vajzën e bukur që i kishte rënë në sy. Vera Efremovna i tregoi se ishte e bija e një gjenerali, se kishte kohë që bënte pjesë në radhët e partisë revolucionare dhe se e kishin arrestuar ngaqë kishte marrë përsipër, ndonëse s'kishte gisht në fajin për vrasjen e një xhandari. E kishin caktuar të punonte në një shtëpi, ku ndodhej një shtypshkronjë ilegale. Një natë xhandarët e rrethuan shtëpinë për ta bastisur. Njerëzit, që ndodheshin brënda, vendosën të mbroheshin, i shuan dritat e nisën të zhduknin çdo gjë që mund t'i kompromentonte. Mirëpo, xhandarët u orvatën ta shpërthenin derën. Njeri nga komplotistët qëlloi atëhere me revole duke e plagosur njerin prej tyre për vdekje. Kur filluan hetimet për zbulimin e fajtorit, vajza tha se ajo kishte qëlluar, sadoqë s'kishte mbajtur kurrë në dorën e saj një revole dhe s'i bënte zëmra të vriste dot as një mizë. I besuan dhe e arrestuan. Dhe ja, tani, ishte dënuar me punë të detyruar në Siberi.

— Është një tip altruist, një njeri zemërmirë me tërë kuptimin e fjalës. . . — tha për të me admirim Vera Efremovna.

Një nga çështjet për të cilat Vera Efremovna kishte dashur të takohej me Nekludovin, ishte edhe puna e Masllovës. Ajo i kishte marrë vesh, ashtu sic mirret vesh çdo gjë në burg, marrëdhëniet që e lidhnin Nekludovin me të

dhe e këshillonte që të ndërmjetësonte ta transferonin në burgun politik ose, fundja, ta caktonin si infermiere në spitalin e burgut, ku tani kishte shumë të sëmurë e ndjehej një mungesë e madhe për njerëz që t'u shërbenin. Nekludovi e falënderoi për këshillën që i dha dhe tha se do të mundohej të përfitonte.

LVI

Biseda e tyre u ndërpre atë çast nga drejtori, i cili u ngrit në këmbë dhe njoftoi se koha e caktuar për takim kishte marrë fund. Nekludovi u ngrit, u përshëndet me Vera Efremovnën dhe u drejtua për nga dera, ku u ndal një hop për të vënë re se ç'po ndodhte ndërkaq në dhomë.

— Shkoi koha, zotërinj, shkoi koha! — thërriste drejtori, që herë ngrihej në këmbë e herë ulej përsëri.

Nga fjalët e drejtorit vihej re në të pranishmit vetëm një gjallëri e veçantë, por asnjeri prej tyre nuk tundej nga vëndi. Disa qenë ngritur e vazhdonin të bisedonin në këmbë. Disa të tjerë përshëndeteshin me njerëzit e tyre dhe qanin. Veçanërisht prekëse ishte skena e nënës me djalin tuberkuloz. Djaloshi vërtiste në dorë letrën dhe fytyra e tij, që bëhej përher' e më e egër, tradhëtonte sheshit përpjekjet e mëdha që duhej të bënte për të mos iu dorëzuar ndjenjës të së jemës. E ëma, porsa mori vesh që kishte ardhur koha të ndaheshin, iu var në qafë e nisi të qajë me dënesë. Vajza, që i kishte rënë në sy Nekludovit menjëherë porsa kishte hyrë aty, e të cilën ai e ndiqte tani pa dashur me sy, qëndronte në këmbë përpara nënës së mjerë e diç i thoshte për ta ngushëlluar. Plaku me syza të zeza e kish zënë të bijën për dore dhe e dëgjonte duke tundur kokën. U ngritën në këmbë dhe u zunë për dore, duke vështruar njeri-tjetrin në sy, edhe ata dy të rinjtë që dashuroheshin.

— Ja, vetëm këta s'duan t'ja dinë! — tha, duke treguar me dorë çiftin, një djalosh me setër të shkurtër, që qëndronte pranë Nekludovit e që, po ashtu si ai, sodiste i ngeshëm ata që po ndaheshin.

Duke vënë re që Nekludovi dhe djaloshi po i shikonin, dashnorët, — djaloshi me bluzë prej gutaperke dhe vajza e hijëshme me flokë të verdha — i shtrinë duart që i mbanin të bashkuara, e drejtuan trupin dhe nisën të vërtiten duke qeshur nëpër dhomë.

— Këta martohen sonte në burg e do të shkojnë bashkë në Siberi, — tha djaloshi.

— Kush është ai?

— Një i denuar me punë të detyruara. Mirë bëjnë që qeshin, se këta të tjerët na e këputën shpirtin! — shtoi djaloshi me setër të shkurter, duke kthyer atë çast sytë nga e ëma e djaloshit të zbetë që qante me dënese.

— Zotërinj! Ju lutem zotërinj! Mos më detyroni të marr masa! — thërriste me zë të lartë drejtori që përsëriste or'e çast po ato fjalë. — Epo, zotërinj, ç'është kjo? Ju lutem, zotërinj! — vazhdonte ai me një zë të mekur e të pavendosur. — Sikur e tepruat! S'bëhet kështu! Ju lajmëroj për herë të fund.t! — përsëriste me një zë të brëngosur, dhe herë e fikte, herë e ndizte rishtas cigaren e trasnë që mbante në dorë.

Kuptohej se drejtori, ndonëse u besonte arësyetimeve të rreme, bajate e të zakonshme që u lejonin njerëzve t'u bënin keq të tjerëve pa ndjerë për këtë asnjë përgjegjësi, nuk mund të mos pohonte se edhe ai vetë ishte fajtor për atë hidhërim që çfaqnin njerëzit që ndodheshin n'atë dhomë; dhe pra, duke ndjerë këtë, brengosej.

Më në fund, të burgosurit dhe vizitorët filluan të largohen në drejtime të kundërta: një palë nga dera e brëndëshme, pala tjetër nga dera e jashtme. Duallën kështu me radhë burrat me bluza prej gutaperke, djaloshi tuberkuloz dhe burri korrozi me qime; doli edhe Maria Pavlovna me djalin që kish lindur në burg.

Duallën edhe vizitorët. Doli duke ecur zvarrë-zvarrë edhe plaku me syza të zeza dhe, pas tij, doli edhe Nekludovi.

— Çudi e madhe si është kjo punë! — tha djaloshi me setër të shkurtër, që dukej pak llafazan, si në vazhdim të një bisede të ndërprerë pak më parë, tek zbriste shkallët bashkë me Nekludovin. — Pothuaj i lumtë kapitenit se është burr'i mirë e s'para i përmbahet pikë për pikë rregullit! Kështu, të paktën, flet me atë tëndin, e sheh e çmallesh sadopak.

— Mos doni të thoni se në burgjet e tjerë nuk lejohen të tilla takime?

— Çfarë? Takime?. . . E, eh. Atje, ta shikosh atë tjetrin më të rrallë nga vrima, dhe shumë e ke. Ja, kështu!

Kur Nekludovi, duke biseduar me Medincevin (kështu e quanin djaloshin) zbriti poshtë, drejtori, porsa e pa, iu afrua me një fytyrë të lodhur e të mërzitur.

— Kështu, pra, nëqoftëse dëshironi të takoheni me Masllovën, urdhëroni nesër, — tha ai duke dashur, me sa dukej, të tregohej me Nekludovin i përzëmërt.

— Shumë mirë! — tha Nekludovi dhe u ngrit të largohej.

Të tmershme qenë, pa dyshim, vuajtjet e padrejta të Menshovit, dhe jo aq vuajtjet e tij fizike se sa dyshimi, se sa mosbesimi që duhej të ndjente tani ndaj drejtësisë e ndaj zotit, duke parë sa të liq qenë njerëzit, sa egërsisht qenë hakmarrur kundër tij; e tmershme qe të mendoje se kishte me qindra njerëz të pafajshëm që poshtëroheshin e mundoheshin gabimisht; të tmershëm qenë dhe ata gardianë matufër që i torturonin nat'e ditë vëllezërit e tyre, me bindjen e verbër se kryenin një punë të mirë e të rëndësishme. Por tmeri i tmereve iu duk Nekludovit drejtori i burgut, ai plak i thinjur, shëndetlik, me një shpirt të butë e të ndjeshëm, që ndante djalin nga nëna, vajzën nga babai dhe, duke ndjerë se qenë edhe ata njerëz, siç ishte dhe ai vetë me fëmijët e tij, çfrynte e brengosej.

«Përse të ndodhin këto?» — pyeste veten Nekludovi, duke e provuar tani sa s'ka ndjenjën e poshtërimit moral e pothuaj fizik që e pushtonte atë përherë në burg. Po kësaj pyetje ai nuk i gjeti dot përgjegje.

LVII

Të nesërmen Nekludovi shkoi tek avokati dhe e vuri në dijeni mbi çështjen e Menshovëve, duke e lutur që ta merrte përsipër ai këtë çështje. Avokati e dëgjoi dhe tha se do ta shqyrtonte dhe se po të qe ashtu siç e parashtronte Nekludovi (dhe k'shte shumë mundësi që të qe vërtet ashtu) ai do ta mirrte përsipër mbrojtjen pa asnjë shpërblim. Duke përfituar nga rasti, Nekludovi i foli avokatit edhe për njëqind e tridhjetë personat që mbaheshin në burg vetëm për një keqkuptim dhe e pyeti kush e kishte në dorë këtë punë dhe kush e k'shte fajin. Avokati qëndroi i heshtur një copë herë, duke dashur, me sa dukej, të jepte një përgjegje të saktë.

— Kush e ka fajin? Asnjeri s'e ka fajin, — tha i vendosur. — Po të pyesni prokurorin, ai do t'ju thotë që fajin e ka gubernatori, po të pyetni gubernatorin ai do t'iu thotë që faji është i prokurorit. Kështu, pra, përgjegjësinë e këtij gabimi s'e merr njeri përsipër.

— Atëhere po i them një herë Maslenikovit.

— Kot e kini! — tha avokati duke buzëqeshur — se ai është një — po me leje t'ju pyes, mos kini të bëni gjë me të? — ai është, më falni për shprehjen, një hajvan i tërë, po ama hilet i di. . .

Nekludovi solli ndërmënd ato sa i kishte thënë Maslenikovi për avokatin dhe, pa dhënë asnjë përgjegje, u përshëndosh me të dhe shkoi drejt e tek Maslenikovi.

Nekludovi do t'i lutej Maslennikovit për dy gjëra: për transferimin e Masllovës në spital dhe për të njëqind e tridhjetë të burgosurit, që s'i kishin g etur në regull me pasaportat. Sadoqë i dukej një gjë shumë e rëndë t'i lutej një njeriu të cilin nuk e çmonte, ai nuk kishte asnjë rrugë tjetër për t'ja arritur qëllimit që i kishte vënë vetes e, pra, duhej të takohej pa tjetër me të.

Kur po i afrohej shtëpisë së Maslenikovit, vuri re jashtë, buzë verandës, disa karroca elegante që qenë vendosur varg njëra pas tjetrës. Ju kujtua menjëherë që atë ditë e shoqja e Maslennikovit kishte ditën e pritjes dhe se pikërisht për atë ditë e kishte ftuar në shtëpi edhe Maslennikovi herën e parë që e takoi. Ndërsa Nekludovi po i afrohej shtëpisë, një karrocë e mbyllur porsa qe ndalur në hyrjen e jashtme dhe një laké, me një kapele me kokardë, e me pelerinë, po ndihmonte që të zbriste shkallët një damë që kishte ngritur me dorë bishtin e fustanit duke zbuluar në këtë mënyrë këmbinjtë e thatë që spikatnin nën çorapet e holla, të zeza që kishte veshur. Ndërmjet karrocave që ndodheshin aty ai vuri re «landonin» (1) e mbyllur të Korçaguinëve. Karrocieri faqekuq e i përthinjur i Korçaguinëve i hoqi menjëherë kapelen, i qeshur e me respekt porsa e pa, siç do të bënte me një zotëri me të cilin njihej mirë. Nekludovi po matej të pyeste portierin a ndodhej në shtëpi Mihail Ivanoviçi (Maslenikovi), kur pikërisht atë çast ai vetë u çfaq në shkallën, që ishte shtruar që nga kreu e gjer në fund me qylym, duke përcjellur një njeri shumë të rëndësishëm, një nga ata mysafirë që i përcillte jo gjer tek sheshi i parë apo i dytë, por gjer në fund të shkallës. Ky mysafir shumë i rëndësishëm, veshur me uniformë ushtarake, ndërsa zbriste shkallët, fliste, në frengjishte, për një fushatë luftarake në dobi të azileve që do të ngriheshin në

1) Lando = një lloj karroce me pjesën e karrocërisë që mund të hapet e të mbyllet sipas dëshirës (Nga emri i qytetit Landau në Francë ku është ndërtuar për herë të parë. (sh. përkth.)

qytet dhe çfaqte mendimin se kjo ishte një gjë shumë e mirë për gratë, që do të kishin tani me se të mirreshin: «Dhe nuk mërziten dhe paratë mblidhen».

— Qu'elles s'amusent et que le bon Dieu les bénisse... [1] Ah, Nekludov, tungjatjeta! Nga na kini humbur kështu? Kemi kohë që s'ju kemi parë! — iu drejtua ai Nekludovit — Allez presenter vos devoirs à madame [2]. Këtu i ke edhe Korçaguinët. Edhe Nadina Bukshevden. Me një fjalë, toutes les jolies femmes de la ville [3] — tha ai duke i ngritur disi lart ato supet e tij prej ushtaraku nën kapotën madhështore me spaleta të arta që po vishte atë çast me ndihmën e lakeit. — Au revoir, mon cher! [4] — ai ja shtrëngoi edhe një herë dorën Maslenikovit dhe u largua.

— E po shkojmë sipër. Nuk mund ta marrësh me mënd sa u gëzova që erdhe! — tha i gëzuar Maslenikovi duke e kapur Nekludovin për krahu dhe duke e tërhequr me vete nëpër shkallët që i ngjiste shumë shpejt, sadoqë ishte i rëndë nga trupi.

Maslenikovi ishte entusiazmuar që e kishte burimin tek përkujdesi i veçantë që kishte treguar ndaj tij mysafiri i rëndësishëm. Mund të mendohej që, duke shërbyer në regjimentin e gardës, duke qenë në një kontakt të vazhdueshëm me rrethin mbretëror, Maslenikovit nuk duhej t'i bënin më edhe aq përshtypje nderimet, po duket poshtërsia rritet e forcohet me anë të përsëritjes. Kështu çdo kujdes që tregohej ndaj tij, e entuziazmonte Maslenikovin ashtu siç e entuziazmojnë qenushin përkëdheljet e të zotit kur e lëmon me dorë, i fërkon kokën dhe e krruan pas veshit. Qenushi tund bishtin nga qejfi, mblidhet shuk i tëri, dridhet e përdridhet e nuk di ç'të bëjë nga gëzimi. Po këto ishte gati të bënte tani edhe Maslenikovi. Ai nuk e vuri re shprehjen serioze që kishte fytyra e Nekludovit, bile as nuk e dëgjonte se ç'thoshte por vetëm e tërhiqte me vete për nga dhoma e pritjes me kaq vrull e këmbëngulje sa ishte e pamundur t'i kundërshtoje. Nekludovit iu desh, pra, të shkonte me të.

— Punët i lëmë për më vonë; ç'do më kërkosh, do ta plotësoj — tha Maslenikovi duke kaluar bashkë me Nekludovin përmes sallës — Njoftoni «gjeneraleshën» se ka ar-

---

1) Le të bëjnë qejf dhe zoti i bekoftë... (frengj.)
2) Shkoni paraqitni nderimet tuaja zonjës (frengj.)
3) të gjitha femrat e bukura të qytetit (frëngj.)
4) Mirë u pafshim, i dashur! (frëngj.)

dhur princi Nekludov! — i tha ai, në të ecur e sipër, lakeit. Lakei, duke ecur me nxitim, i arriti, i kaloi dhe bëri përpara. — Vous n'avez qu'a ordonner. [1]) Po gruas do t'i shkosh pa tjetër. Se atë radhën që shkoi nuk u ndava hiç mirë me të për punën tënde që nuk u hodhe një vrap ta shikosh.

Lakei porsa kishte njoftuar mbërritjen e Nekludovit, kur ai, bashkë me Maslenikovin, hynë në sallë dhe Ana Ignatievna, nën-gubernatoresha apo gjeneralesha, siç kishte qejf të vetëquhej, e përshëndeti me krye, e buzëqeshur, përmes kokave dhe kapeleve të mysafirëve, që e rrethonin. Në cepin tjetër të dhomës qenë ulur rreth një tryeze e pinin çaj ca zonja, ndërsa zotërinjtë që i shoqëronin, ndër të cilët kishte edhe ushtarakë, edhe civilë, qëndronin në këmbë pranë tyre. Që andej vinte një gumëzhimë e pandërprerë zërash.

— Enfin! [2]) Si nuk ju bie fare ndërmënd për ne? Çfarë ju kemi bërë?

Me këto fjalë, që nënkuptonin ndërmjet saj dhe Nekludovit një intimitet që s'kishte qenë kurrë, e priti Ana Ignatievna mysafirin e ri.

— Ju njiheni? Njiheni? Madamë Beljovskaja, Mihail Ivanoviç Çernov. Avituni.

— Missi, venez donc a notre table. On vous aporteraa votre thé. . . [3]) Edhe ju. . . — iu drejtua ajo oficerit që bisedonte atë kohë me Missin e të cilit, siç dukej, ja kishte harruar emrin. — Ja, këtu, ju lutem. Çaj, princ, dëshironi?

— Jo, n'asnjë mënyrë. n'asnjë mënyrë nuk mund të jem dakord me këtë që thoni! Sipas meje, ajo nuk e ka dashur, — thoshte një zë femre.

— Po, po. sic duket, i pëlqenin më tepër petullat, — ja priste një zë tjetër.

— Ah, gjithmonë po ato shakara pa kripë, — ndërhyri me të qeshur një damë tjetër me një kapele të lartë, që shëndriste e tëra nga mëndafshi dhe nga stolitë me ar e me gur të çmuar.

— C'est excellent [4]) këto vofëra dhe të lehta. Na sillni të tjera!

---

1) Ju vetëm urdhëroni (frëngj.).

2) Më në fund (frëngj.)

3) Missi, ejani pra në tryezën tonë. Jua sjellin këtu çajin. (frëngj.)

4) Janë të mrekullueshme (frëngj.)

— Atëhere së shpejti do të niseni, apo jo?

— Po, sot është dita e fundit. Prandaj edhe erdhëm t'ju shohim.

— Apo nuk është një pranverë e mrekullueshme këtë vit. Kush e di sa bukur do të jetë në fshatin tone!

Missi, me kapelë në kokë dhe me një fustan si të zi me kutia, që i derdhej në trup e i rrinte kaq mirë sa që mund të mendoje që kish lindur me të, dukej atë ditë shumë e bukur. Ajo u skuq, kur e pa Nekludovin.

— Kurse unë mendoja që ju do të kishit ikur. . .

— Do të kisha ikur, — iu gjegj Nekludovi, — por kam patur disa punë. Ja, edhe këtu për punë erdha.

— Kaloni nonjë ditë nga mamaja. Ajo ka shumë dëshirë t'ju shikojë, — tha ajo dhe, duke ndjerë që po gënjente dhe se ai e kuptoi, u skuq akoma edhe më tepër në fytyrë.

— S'besoj se do të kem kohë, — u gjegj i zymtë Nekludovi duke u munduar të hiqej sikur nuk kishte vënë re asgjë.

Missi vrënjti vetullat me të rreptë, ngriti supat dhe u drejtua nga oficeri elegant, që i mori nga dora filxhanin dhe e shpuri, si trim i mirë, në tryezën tjetër, ndërsa maja e shpatës i pengohej nëpër këmbët e karrigave.

— Edhe ju diç duhet të dhuroni për azilet.

— Jo, unë nuk është se s'pranoj, por dua ta ruaj bujarinë time për në kohën e fushatës. Atëhere do ta tregoj edhe unë veten.

— Shiko, shiko! — u ndëgjua një zë, që dukej qartë se mundohej të qeshte me pahir.

Dita e pritjes kish dalë vërtet e shkëlqyeshme dhe Ana Ignatievna mënt fluturonte nga gëzimi.

— Kam marrë vesh nga Mika që shkoni dëndur në burg. Unë e kuptoj shumë mirë këtë — i tha ajo Nekludovit. — Mika (Mika është i shoqi i saj trashaluq, Maslenikovi) mund të ketë të tiera të meta, por që e ka zëmrën flori, këtë e dini të gjithë. Të gjithë ata të burgosurit e mjerë i ka si fëmijët e tij. Ai të pakën kështu i konsideron. Il est d'une bonté. . . [1].

Dhe këtu ajo ngeci duke mos qenë në gjëndje të gjente fjalë të përshtatëshme për të shprehur «bontenë» e burrit të saj, me urdhër të të cilit i rrihnin njerëzit dhe, aty

1) Ai është kaq i mirë! (frëngj.)

për aty, u drejtua me buzëqeshje nga një zonjë plakë tërë rrudha në fytyrë e stolisur me gjithfarë fjongosh ngjyrë manushaqe, që po hynte atë çast në sallë.

Pasi foli aq sa duhej folur dhe ashtu në përgjithësi, siç duhej folur e siç e lypnin rregullat e mirësjelljes, Nekludovi u ngrit dhe iu afrua Maslenikovit.

— A mund të bisedojmë bashkë?

— Mirë. Ja hyjmë, këtu.

Ata hynë në një kabinet të vogël të stilit japonez dhe u ulën pranë dritares.

LVIII

— Je suis a vous [1]). Mos do ta ndezësh? Vetëm prit pak, se mos bëjmë nonjë hata, — tha ai dhe solli një taketuke. — E po?

— Kam ardhur tek ju për dy punë.

— Ashtu, ë?

Fytyra e Maslenikovit mori një shprehje të zymtë dhe të brengosur. Të gjitha gjurmat e entusiazmit të qenushit u zhdukën menjëherë tek ai.

Dëgjoheshin zëra që vinin nga salloni. Një zë gruaje thoshte: — Jamais, jamais, je ne croirais» [2]), kurse një tjetër nga cepi i sallës, një zë burri, diç po tregonte duke përsëritur orë e çast: «La comtesse Voronzoff et Viktor Apraskine» [3]). Nga cepi i tretë i sallonit vinte vetëm një gumëzhimë zërash e të qeshurash. Maslenikovi vuri veshin të dëgjonte se ç'po ndodhte në dhomën e pritjes dhe, në të njëjtën kohë, dëgjonte edhe ato sa i thoshë Nekludovi.

— Kam ardhur për atë gruan, — tha Nekludovi.

— Ajo që gabimisht është. . . po po e di.

— Unë do të të lutesha që ta shpinin në spital si infermiere. Siç mora vesh, kjo mund të bëhet.

Maslenikovi kafshoi buzët dhe ra në mendime.

— Zor se mund të bëhet, — tha ai. — Sidoqoftë do të bisedoj një herë për këtë punë dhe nesër do të të telegrafoj.

— Mua më thanë që atje ka shumë të sëmurë dhe kanë nevojë për njerëz që t'u shërbejnë.

---

1) Jam nën urdhërin tuaj. (frëngj.)

2) Kurrë, kurrë, nuk do ta besoja (frëngj.)

3) Kontesha Voronzov dhe Viktor Apraskin (frëngj.)

— Po, po. . . Nejse, sidoqoftë, do të të vë në dijeni.

— Ma bëj këtë te mirë, — tha Nekludovi.

Atë çast në sallon buçitën ca të qeshura të përbashkëta e bile, b.le të sinqerta.

— Ai e ka fajin, ai Viktori. . . — tha Maslenikovi duke buzëqeshur. — Kur i kërcen damari atij, për nder, se e mban dot gazin!

— Pastaj edhe një gjë tjetër, — tha Nekludovi. — Atje në burg janë nja njëqind e tridhjetë vetë, që i mbajnë vetëm e vetëm se nuk i kanë në rregull pasaportat. Ka ndonjë muaj që i kanë marrë.

Dhe ai nisi të tregojë me hollësira arësyet pse i mbanin këta njerëz në burg.

— Po këtë ti si e more vesh? — pyeti Maslenikovi dhe befas në fytyrën e tij u shpreh një shqetësim e një moskënaqësi e dukëshme.

— Unë po shkoja tek ai i pandehuri, për të cilin interesohem, kur ja, ata më panë në koridor dhe më rrethuan. . .

— Te cili i pandehur po shkoje?

— Tek një fshatar që është akuzuar me të padrejtë dhe të cilit i kam zënë një avokat. Po kjo s'ka rëndësi. Mua një gjë më habit: si është e mundur të mbahen në burg ca njerëz vetëm e vetëm sepse u ka skaduar afati i pasaportave dhe. . .

— Kjo është punë për prokurorin, — e ndërpreu me inat Maslenikovi. — Ja, ti që thua se gjyqet sot janë të drejta, e sheh? Prokurori e ka për detyrë t'i vizitojë burgjet e të marrë vesh se a mbahen a po jo me të drejtë të burgosurit që ndodhen aty. Mirëpo ai s'shkon fare. . . Domosdo, se i pëlqen më mirë të lozë vintin.

— Domethënë ti s'bën dot gjë? — tha i zymtë Nekludovi duke sjellur ndërmënd se si avokati i kishte thënë që gubernatori do t'ja hidhte tërë fajin prokurorit.

— Jo, përkundrazi, unë do të përpiqem. Ja që tani do ta shoh këtë punë.

— Aq më keq për të, c'est un souffre-douleur [1]), — u dëgjua nga salla një zë femre që dukej krejt indiferente për ato që thoshte.

— Atëhere, po e marr edhe këtë aq më mirë, — dëgjohej nga një cep tjetër një zë lozonjar burri dhe një e qeshur po aq lozonjare gruaje, që diç nuk deshte t'i jipte atij.

---

1) Është një martire (frëngj.)

— Jo, jo, n'asnjë mënyrë, — u dëgjua po ai zë femre.

— Kështu, pra, do t'i bëj të gjitha sa më the, — foli përsëri Maslenikovi duke shuar cigaren me dorën e bardhë ku shkëlqente një unazë e madne ngjyrë manushaqeje. — Tani shkojmë tek damat.

— Shiko, kam edhe një gjë tjetër, — tha Nekludovi pa hyrë akoma në sallë e duke u ndalur tek dera. — Më thanë që dje në burg u zbatuan ndëshkime trupore mbi dy të burgosur. Është e vërtetë kjo?

Maslenikovi u skuq në fytyrë.

— Ah, këtë deshe të më thuash? Eh, jo mon cher [1], këtej e tutje s'duhet të të lëmë të shkosh më atje, n'asnjë mënyrë. Ti të gjitha do t'i dish. Nejse, shkojmë, shkojmë, tani, ja e dëgjon Annetën si po më thërret? — tha ai duke e kapur për krahu po me atë entusiazmin e fillimit, kur kishte përcjellur mysafirin e rëndësishëm, por vetëm se tani më tepër i habitur se sa i gëzuar.

Nekludovi e çliroi me zor krahun dhe, pa u përshëndetur me njeri e pa i thënë njeriut asnjë fjalë, kaloi i zymtë përmes sallës e qëndroi në koridor përmes turmes së lakejve që i dilnin përpara me vrap që ta përcillnin e ta ndihmonin të vishej. Së fundi, doli jashtë në rrugë.

— Ç'pati? Mos i bëre gjë? — e pyeti Annetta të shoqin.

— Kjo është à la française [2], — se kush tha.

— A la française? Nuk thoni më mirë à la zoulou! [3]

— Ehu. kështu ka qënë ai gjithmonë.

Dikush u ngrit, dikush erdhi dhe bisedat nisën të thuren e të çthuren përsëri me nge si më parë. Episodi i Nekludovit u përdor n'atë shoqëri të nderuar si një burim i pashteruar diskutimesh në atë jour fixe [4].

Të nesërmen, Maslenikovi e vuri në dijeni Nekludovin se i kishte shkuar mjekut të burgut për transferimin e Maslovës dhe se kishte shumë mundësi që dëshira e tij të plotësohej. Ai ja njoftonte këtë me anë të një letre, shkruar mbi një fije të trashë me llustro me stemë e me vulë në krye. Në fund të letrës. me një shkrim madhështor dhe energjik, vinte ky nënshkrim: «shoku yt i vjetër që të do» dhe më poshtë nën emrin «Maslenikov» qe vizatuar një pie-

1) I dashur (frëngj.)
2) Kjo është sipas mënyrës franceze (frëngj)
3) Sipas mënyrës zulù (frëngj)
4) ditë fikse (frëngj)

destal vijash çuditërisht mjeshtërore, të forta e të gjera si për ta vënë më mirë në dukje atë emër.

— Çfarë hajvani! — çfryu me vete Nekludovi duke ndjerë i pështirosur që më atë fjalën «shok» Maslenikovi sikur deshte të dukej bujar duke e vënë Nekludovin në një rang me të, sadoqë, sipas mendimit të tij, ai qëndronte shumë më poshtë. Me fjalë të tjera, Maslenikovi, sadoqë kryente një detyrë moralisht të ndytë e të turpëshëm, kujtonte, të paktën kështu linte të kuptohej ai mbishkrim, se ishte një njeri shumë i rëndësishëm dhe prandaj, për të treguar se fama që gëzonte, ndonëse shumë e madhe, nuk kishte mundur ta prishte shpirtin e tij ashtu siç kishte ndodhur me shumë të tjerë, ai vërtet nuk i bënte lajka Nekludovit, por me gjithatë e ulte veten gjer atje sa ta konsideronte si një shok.

LIX

Një nga paragjykimet më të zakonëshme e më të përhapura ndër njerëz është mendimi se njeriu, se çdo njeri, ka vetëm disa cilësira të caktuara dhe s'mund të ketë njëkohësisht edhe të tjera. Me një fjalë, mendohet se një njeri mund të jetë ose i mirë ose i keq, ose i mënçur ose budalla, ose energjik ose apatik etj. Po njerëz të tillë nuk ka. Ne mund të themi për një njeri që është më shpesh i mirë se sa i keq, që është më shpesh i mënçur se sa budalla, që është më shpesh energjik se sa apatik dhe anasjelltas; por gabojmë nëqoftëse themi për një njeri që është i mirë apo i mënçur ndërsa për një tjetër që është i keq apo budalla. Mirëpo ne kështu i ndajmë njerëzit. Dhe kjo s'është e drejtë. Njerëzit janë si lumenjtë: ujët është po ai në të gjithë, mirëpo çdo lumë mund të jetë herë i ngushtë, herë i rrëmbyer, herë i gjerë, herë i qetë, herë i kulluar, herë i turbullt, herë i ftohtë dhe herë i ngrohët. Kështu edhe njerëzit. Çdo njeri ka në veten e tij të gjitha farët e cilësive njerëzore, po herë çfaq njërën, herë tjetrën dhe dëndur ndodh që humbet çdo gjasim me veten e tij, ndonëse mbetet po ai që ishte. Tek disa njerëz këto ndryshime nuk bëhen gradualisht, por me hope. Pikërisht ndër këta bënte pjesë edhe Nekludovi. Ndryshimet që viheshin re tek ai ndodhnin nën shtytjen e faktorëve truporë dhe shpirtërorë. Një ndryshim i tillë kishte ndodhur tek ai edhe tani.

Ajo ndjenjë entuziazmi dhe gëzimi, që kishte provuar pas gjyqit dhe pas takimit të parë me Katjushën, duke menduar se po përtëritej, se po bëhej një tjetër njeri, qe zhdukur pa gjurmë në shpirtin e tij për t'i lënë vënd, pas takimit të fundit që kishte patur me të, frikës dhe pështirosjes që ndjente tani ndaj saj. Ai kishte vendosur se nuk do ta braktiste, se nuk do ta ndryshonte në asnjë mënyrë vendimin që kishte marrë për t'u martuar me të, po të qe se ajo do të pranonte. Por ja, tani ky vendim i dukej shumë i rëndë dhe i vështirë.

Një ditë më vonë, pas bisedës që kishte patur me Maslenikovin, ai shkoi përsëri në burg që ta takonte.

Drejtori e lejoi, por këtë radhë jo në zyrë dhe as në dhomën e avokatëve, po në dhomën e takimeve të burgut të grave.

Sadoqë u suall me të i përzemërt si përherë, drejtori këtë radhë dukej më i përmbajtur: me sa kuptohej, bisedat e Nekludovit me Maslenikovin, kishin patur për pasojë një paralajmërim burgut që të silleshin më të matur me atë vizitor të jashtëzakonshëm.

— Ka mundësi të takoheni, — tha ai, — vetëm ju lutem, për punën e të hollave, siç ju kam biseduar dhe herë tjetër... E, për sa i përket kalimit të saj në spital, kjo mund të bëhet. Për këtë më shkroi edhe shkëlqesia e tij. Edhe mjeku bilé është dakord. Mirëpo ajo vetë nuk do. «Nuk e sheh, do të rri t'iu bëj yzmet ca të kromosurve!. . .» — kishte thënë. Ju, princ, këta s'i njihni, por më pyetni mua. . .

Nekludovi nuk foli fare, por iu lut që ta lejonte të takohej.

Drejtori i dha urdhër një mbikqyrësi që ta shoqëronte dhe Nekludovi hyri bashkë me të në dhomën e takimeve, ku atë kohë s'kishte njeri.

Masllova kishte ardhur atje më parë dhe doli menjëherë që nga pas rrietës së hekurt, e përmbajtur dhe e ndrojtur.

Ajo iu afrua Nekludovit fare pranë dhe, duke mos e parë në sy, i tha me një zë t'ulët.

— Më ndjeni, Dimitri Ivanoviç, se radhën tjetër nuk u solla mirë.

— Nuk jeni ju që duhet të më kërkoni ndjesë. . . — nisi të thotë Nekludovi.

— Po, sidoqoftë, hiqni dorë nga unë! — shtoi ajo dhe në sytë e saj, që i vëngëroi atë çast në një mënyrë të fri-

kështme, ai lexoi përsëri po atë shprehje armiqësie dhe dufi të përmbajtur.

— Përse të heq dorë nga ju?

— Ja. . . ashtu.

— Po pse?

Ajo e vështroi përsëri, siç iu duk atij, me armiqësi.

— Sepse kështu, — tha, — hiqni dorë nga unë, jua them me të vërtetë. Nuk mundem. Hiqni dorë, ju lutem, nga kjo punë, — tha ajo me buzët që i dridheshin dhe e preu. — Po, po, kështu. Më mirë të varem se sa. . .

Nekludovi ndjente në kundërshtimin e saj urrejtjen për të dhe pamundësinë për t'ia falur fyerjen e dikurëshme; por, në të njëjtën kohë, ndjente se kishte në të edhe diçka më fisnike dhe më të rëndësishme. Ajo përsëri e kundërshtonte po aq e vendosur, por këtë radhë, krejt e qetë dhe kjo i zhduku në shpirtin e Nekludovit të gjitha dyshimet, i ktheu përsëri atij ndjenjën e entuziazmit, të ngashërimit dhe të besimit në rëndësinë e veprës së tij.

— Katjusha, e thashë e prapë e them, — foli Nekludovi me një shprehje serioziteti krejt të veçantë në fytyrë — unë të lutem të bëhesh gruaja ime. Po nëqoftëse ti nuk pranon dhe gjersa ti të mos pranosh, ashtu si dhe më parë, atje ku do të jesh ti, do të jem edhe unë, ku do të të shpienë ty do të vij dhe unë.

— Kjo është puna juaj, nga unë mos pritni t'ju them gjë tjetër, — tha ajo dhe buzët iu drodhën përsëri.

Ai heshti duke e ndjerë se nuk ishte më në gjendje të fliste.

— Unë tani po shkoj në fshat, pastaj më vonë do të shkoj në Peterburg, — tha më në fund duke e marrë disi veten. — Atje do të përpiqem për çështjen tuaj, për çështjen tonë dhe, do zoti, e anullojnë vendimin.

— Edhe sikur të mos e anullojnë, një lloj është. Unë prapseprapë, e kam hak burgun. . . — tha Masllova dhe Nekludovi vuri re se, tek thoshte këto fjalë, asaj iu mbushën sytë me lot. — Po Menshovin, a e patë? — e pyeti ajo befas për të fshehur tronditjen që e kishte pushtuar. — Janë të pafajshëm, apo jo?

— Po, unë kështu mendoj.

— Ah, sa plakë e mirë është e shkreta!

Ai i tregoi një për një të gjitha ato që kishte marrë vesh për Menshovin dhe e pyeti në se kishte nevojë për ndonjë send; ajo iu përgjegj se nuk kishte nevojë për asgjë.

Heshtën përsëri që të dy.

— Në spital, — e prishi befas ajo heshtjen duke i hedhur atë vështrimin e saj vëngërosh, — po të doni unë po shkoj. . . dhe verë nuk po pij më. . .

Nekludovi e shikonte në sy i heshtur.

— Shumë mirë!

Vetëm këtë mundi të thotë ay dhe u përshëndosh me të.

«Po, po, ajo është krejt tjetër njeri» — mendonte Nekludovi duke provuar, pas dyshimeve që kishte patur, një ndjenjë të re, të paprovuar kurrë, që ishte besimi i patundur ne fuqinë mbinjerëzore të dashurisë.

Kur u kthye, pas këtij takimi, në qelinë e saj të ndytë, Masllova hoqi tutën dhe u ul mbi shtrat duke i leshuar krahët mbi gjunjë. Në qeli ndodheshin vetëm e veremosura me foshnjen në gji, plaka Menshova dhe rojtarja e trenit me të dy fëmijët. Të bijën e dhjakut e kishin gjetur të sëmurë nga trutë dhe e kishin shtruar një ditë më parë në spital. Gratë e tjera kishin shkuar të lanin rroba. Plaka qe shtrirë në shtrat dhe flinte; dera e qelisë qe hapur dhe fëmijët luanin jashtë në koridor. E veremosura me fëmijën në duar dhe rojtarja që thurte çarape duke i lëvizur shpejt shtizat që s'i hiqte nga duart, iu afruan menjëherë Masllovës, porsa e panë.

— Hë, si, e takove? — e pyetën.

Masllova rrinte ulur mbi shtratin e lartë me dhoga, duke tundur këmbët që nuk i arrinin gjer poshtë mbi dysheme e nuk përgjigjej.

— Moj po ti, ç'bën ashtu? Qan? — e pyeti rojtarja. — Mos, mos ashtu, se s'është mirë ta lëshosh veten. Eh, moj Katjusha! Hajde, hajde, lera ato! — tha ajo duke i lëvizur shpejt gishtërinjtë në çarape.

Masllova nuk përgjigjej.

— Tonat shkuan të lajnë rrobat. Ka patur shumë rroba sot! — tha e veremosura.

— Finashka! — thirri rojtarja duke zgjatur kokën në derë. — E ku shkove ashtu, mor lanet?

Ajo e nxori nierën shtizë nga çarapja, e nguli në lëmshin e leshit dhe hovi jashtë në koridor.

Jashtë u dëgjua atë çast një zhurmë hapash dhe disa zëra grash që atroneshin. Pas pak hyne ne qeli banorët e saj, zbathur, vetëm në këpucë, duke mbajtur secila në dorë nga një kulaç apo nga dy. Fedosja u afrua menjëherë tek Masllova,

— Ç'ke kështu? Mos të ndodhi gjë? — e pyeti duke e vështruar me dashuri Masllovën me sytë e saj të kaltër e të kthjellët. — Ja, kto i kemi për çajin, — tha duke i vendosur kuleçët mbi një dhogë të ngushtë që përdorej si sergjen.

— Mos ju prish gjë mëndja atij për martesë? — e pyeti Korableva.

— Jo, nuk se atij ju prish mëndja, por unë nuk dua, — u përgjegj Masllova. — Dhe ja thashë.

— Paske qënë e marrë! — ja priti me atë basin e saj të trashë Korableva.

— Mirë e ka, gjersa nuk rrojnë dot bashkë, pse të martohen? — u hodh e tha Fedosja.

— E-e, po ama yt shoq nuk po të lë vetëm! — ja priti rojtarja.

— Ndryshe puna e jonë, se ne jemi me kurorë, — tha Fedosja. — Po ai, përse, gjersa akoma nuk ka gjë me të?

— Shiko e marra ç'thotë! Përse? Po sepse, po të martohet me të ja shtron me flori ai, jo shaka!

— Ja, kështu më tha: «Kudo që të shpien ty, unë do të të vij pas» — tha Masllova. — Po, vjen apo s'vjen, mua aq më bën. S'kam pse i lutem. Tani do të shkoj në Peterburg që të shohë se mos rregullojë gjë. Ministrat ai i ka të tijët që të gjithë, — vazhdoi ajo. — Po unë, ama, as që ja kam nevojën, ç'të dojë le të bëjë!

— E-e, domosdo! — u çfaq befas e një mëndjeje Korableva duke hequr grykën e trastës e që, me sa dukej, pa e patur mëndjen atje. — E po qysh, do të pijmë një çikë?

— Unë nuk dua! — u përgjegj Masllova. — Ju, pini!

Fund i pjesës së parë

PJESA E DYTË

I

Çështja e Masllovës do të shqyrtohej nga senati pas dy javësh. Nekludovi mendonte të ndodhej në këtë kohë në Peterburg me qëllim që, në rast se senati do ta refuzonte apelimin, t'i drejtohej me një lutje për falje vetë Perandorit, ashtu siç e kishte këshilluar edhe avokati që kishte pajtuar. Po të qe se edhe lutja nuk do të merrej parasysh, gjë kjo që, sipas avokatit, mund të ndodhte fare mirë, meqenëse pretekstet e apelimit qenë shumë të dobëta, një numur të burgosurish, ndër të cilët bënte pjesë edhe Masllova, do të nisej për në Siberi aty nga ditët e para të qershorit. Prandaj Nekludovi, po të donte ta ndiqte Masllovën në Siberi, ashtu siç kishte vendosur, duhej të shkonte që tani në fshat që t'i sistemonte njëherë e mirë atje të gjitha punët që kishin të bënin me administrimin e pronave të tij.

Nekludovi shkoi në fillim në çifligun e madh të Kuzminskajës, më i afërti nga të gjithë çifliqet e tij, me toka të zeza pjellore, nga të cilat siguronte pjesën më të madhe të të ardhurave. Ai kishte banuar në këtë çiflik kur kishte qënë i vogël dhe, më vonë, në moshën e rritur, kish sjellur aty, i porositur nga e ëma, një administrator gjerman bashkë me të cilin kishte bërë një kontroll të imtë të pasurisë. Kështu Nekludovi e njihte që prej kohësh gjëndjen e çiflikut si edhe marrëdhëniet e fshatarëve me zyrën, d.m.th. me çifligarin. Këto marrëdhënie, duke u shprehur me takt, duheshin cilësuar si një mvarësi që kishin fshatarët nga zyra, kurse, duke u shprehur thjesht, duhej thënë se ishin të tilla që e vinin fshatarin në një gjëndje skllavërie të plotë. Kjo nuk ishte skllavëria në kuptimin e bujk-robërisë që u hoq më 1861, d.m.th. e drejta e pronësisë trupore që kishte çifligari mbi një numër të caktuar frymësh, por një formë tjetër skllavërie e përbashkët për të gjithë

fshatarët pa tokë ose me pak tokë, ndaj të gjithë çifligarëve të mëdhej në përgjithësi dhe ngandonjeherë, vetem ndaj atyre me të cilët lidhej ngusht puna e fshatarëve për të rrojtur. Nekludovi i dinte këto dhe s'kishte si të mos i dinte, se pikërisht mbi këtë skllavëri ngrihej edhe pasuria e tij dhe ai kishte marrë pjesë në organizimin e saj. Jo vetëm kaq por, për më tepër, Nekludovi e dinte se kjo ishte një gjë e padrejtë e barbare. Këtë e dinte që kur ishte student, pikërisht që atëhere kur kish predikuar e propaganduar teorinë e Henri Xhorxhit dhe, duke u mbështetur në këtë teori, ua kishte falur fshatarëve tokën që kishte trashëguar nga i ati, i bindur se prona e tokës ishte në kohën tonë një gjë kaq e turpëshme, sa kishte qënë aty e pesëdhjetë vjet më parë e drejta e bujkrobërisë. Është e vërtetë që, pas largimit nga ushtria dhe pasi u mësua të harxhonte njëzet mijë rubla në vit, ai s'e kishte parë më të domosdoshme t'i vinte në jetë ato që thoshte e mendonte, s'e kishte ngritur më kurrë problemin e qëndrimit që duhej të mbante ndaj punës, s'e kishte pyetur më veten mbi prejardhjen e të hollave që i dërgonte e ëma dhe, në përgjithësi, qe munduar t'i largohej të gjitha këtyre mendimeve. Por vdekja e s'ëmës, trashëgimi dhe nevoja e administrimit të pasurisë, kërkuan përsëri prej tij që ta përcaktonte qëndrimin që do mbante për pronësinë e tokës. Ndofta një muaj më parë, Nekludovi do të mendonte se ai nuk ishte i zoti ta ndryshonte rendin ekzistonjës, se fundja nuk ishte ai që e administronte çiflikun dhe kështu do të arrinte të çfajësohej deri diku përpara vetes. Por tani, ndonëse udhëtimi i afërt në Siberi dhe kontakti i vështirë e i ndërlikuar që e priste atje me botën e burgjeve, ku çdo gjë mund të arrihej vetëm me anë të parasë, ai vendosi të mos pajtohej me këtë gjëndje por ta ndryshonte, qoftë edhe duke shkuar kundra interesave të tij. Për këtë ai vendosi të mos e punonte vetë tokën por, duke ua dhënë fshatarëve me një çmim të lirë, t'u jepte atyre mundësinë që të bëheshin të pavarur në përgjithësi nga çifligarët. Më se një herë, duke krahasuar pronësin'e tokës, ashtu siç ishte tani, me bujkrobërinë, Nekludovi qe shtyrë të mendonte vetvetiu se, t'ua jepte tokën fshatarëve që ta punonin vetë në vënd që ta punojë me argatë, qe një hap përpara drejt përmirësimit të gjëndjes së fshatarësisë, ashtu siç qe dje një hap përpara në kohën

e bujkrobërisë, kalimi i fshatarëve nga burshçina [1] në obrok [2]. Nuk ishte një zgjidhje e problemit, por ishte një hap drejt zgjidhjes së tij, e ishte pikërisht kalimi nga një formë e violencës në një formë tjetër më të butë. Kështu kishte ndërmënd të vepronte edhe ai.

Nekludovi sosi në Kuzminskoje aty nga mesdita. Duke i qëndruar besnik vendimit që kishte marrë për ta bërë jetën e tij sa më të thjeshtë, ai nuk telegrafoi për të paralajmëruar mbërritjen por, me të zbritur nga treni, mori një karrocë dhe u nis. Karrocieri, një muzhik i ri e llafazan, me një podjovkë nankini [3] shtërnguar nën belin e hollë, qe ulur ashtu siç ulen zakonisht karrocjerët, d.m.th. shtrëmbër, në mënyrë që të shkëmbente nja dy fjalë me zotërinë e, në të njëjtën kohë, t'u hidhte edhe një sy kafshëve, një gërdalle të bardhë, të çalë e të kromosur, dhe një ati vraç me bark të fryrë, që ecnin që të dv në hap.

Karrocjeri e hodhi muhabetin tek administratori i Kuzminskojes dhe, duke mos e ditur që në karrocë kishte vetë çifligarin, (Nekludovi s'ia kishte thënë këtë me qëllim), nisi të fliste për të mbarë e prapë.

— Ama e mban veten ai gjermani! — thoshte karrocjeri që kishte banuar ca kohë në qytet e kishte lexuar romane. Ai rrinte në atë mënyrë që treguam, me një sy nga kuajt, me një sy nga Nekludovi, e herë e pushtonte atë kamzhikun e tij të gjatë nga maja e herë nga fundi, dhe mburrej e bënte çmos që të tregohej njeri me kulturë e jo dokudo. — Apo s'ka një troikë, apo s'ka ca kuaj për kokën e kuajve!. . . Dimërit që shkoi, për krishtlindje, kishte ujdisur në shtëpi të madhe një pishë me shkëndi elektrike! E pashë me këta sy, se shpura ca mysafirë. Për besë, se kish tjetër si ajo në tërë gubernën!. . . E po, domosdo, se vjedh me të dy duart miku, e i ka paratë me thes! Hesap s'i kërkon njeri, dorën s'ja zë njeri! Ja, thonë, ka blerë edhe një goxha çiflik!. . .

---

1) Kështu quhej në regjimin e vjetër të bujkrobërisë puna që fshatari detyrohej të bënte falas në dobi të çifligarit (sh. i përk).

2) Kështu quhej në regjimin e bujkrobërisë një nga format kryesore të shfrytëzimit të fshatarëve nga ana e çifligarit, që i lejonte këtij të fundit të merrte nga fshatari një përqindje në të holla apo në natyrë mbi t'ardhurat nga toka (sh. i përkth.).

3) Një lloj pëlhurë e trashë dhe e ashpër, zakonisht me ngjyrë të verdhë (nga emri i qytetit Nankin, në Japoni) (sh. i përkth.)

Nekludovi kish kujtuar gjer ahere se aq i bënte atij të dinte se në ç'mënyrë e qeveriste administratori gjerman çiflikun e tij. Mirëpo, kur dëgjoi ato sa i tregoi për të karrocjeri me bel të hollë, nuk i erdhi mirë. Ai i gëzohej asaj dite të bukur behari, reve të dëndura që nxinin aty-këtu nëpër qiell dhe e zinin herë-herë diellin, arave ku dukeshin muzhikë që hapnin brazda me parmëndë, blerimeve të dëndura dhe trumbave me lauresha që fluturonin përmbi to, drurëve mbuluar tanimë, veç lisit të vonshëm, me gjethe të reja, luadheve ku kullosnin tufa të larme bagëtish e kuajsh dhe arave ku dukeshin bujq që punonin. . . Por prapë ndjente sikur kishte një re të zezë n'atë gëzim të qetë dhe, kur ai e pyeste veten: «përse?», i kujtoheshin ato sa i kishte thënë karrocjeri për administratorin gjerman në Kuzminskoje.

Sidoqoftë, kur arriti në Kuzminskoje dhe u muarr me punë, Nekludovi e harroi këtë ndjenjë.

Kontrolli që u bëri librave të zyrës dhe biseda që pati me administratorin, i cili i vuri në dukje me naivitet leverdinë që paraqeste pakësimi i tokave të fshatarëve si edhe rrethimi i tyre me tokat e çiflikut, ja forcuan bindjen Nekludovit që duhej të hiqte dorë nga pasuria e t'ua jepte tokat fshatarëve. Nga librat e zyrës dhe nga ato që i tha administratori, ai mori vesh që, ashtu si edhe më parë, dy të tretat e tokës më të zgjedhur, çifliku i punonte me mjete moderne me punëtorët e vet. Për të punuar pjesën tjetër, pajtoheshin argatë që merrnin kundrejt punës që bënin pesë rubla për disjatinë [1]). Kjo do të thoshte që për pesë rubla, fshatari zotohej të punonte e ta prashiste tokën në verë, ta mbillte, ta korrte, të lidhte duajt e t'i çonte në lemë, d.m.th. të kryente një punë për të cilën një argat tjetër i lirë nga çdo mvarësi me çiflikun, do të kërkonte të paktën dhjetë rubla për desjatinë. Jo vetëm kaq, por fshatarët qenë të detyruar t'i blinin me çmime shumë të larta të giitha sa u duheshin nga zyra. Dhe, ndonëse punonin natë e ditë, vetëm për të siguruar barin, drutë e patatet, pothuajse të gjithë qenë në borxh ndaj zyrës. Kështu, për tokat jashtë fshatit, që u ishin dhënë me qira fshatarëve, merrej për çdo disjatinë katër herë më tepër se sa fitimi që do të mund të sillte çmimi i tyre i vendosur në bankë me një interes prej pesë përqind.

1) Njësi ruse për matjen e tokave = 1,09 hektar.

Të gjitha këto Nekludovi i dinte edhe më parë, por tani i shihte nën një dritë tjetër, dhe habitej se si ai, dhe të gjithë ata që ndodheshin në gjëndjen e tij, nuk kishin mundur të shikonin se sa anormale dhe të padrejta qenë këto marëdhënie. Të gjitha arësyetimet e administratorit që synonin të provonin se, po të qe se toka do t'u jepej fshatarëve do të shkonte dëm një pjesë e inventarit, se fshatarët, po ta merrnin tokën, do ta prisnnin dhe se, në përgjithësi, Nekludovi duhej të hiqte dorë nga një mendim i tillë që s'ishte në interes, por në dëm të tij, i provuan, përkundrazi, Nekludovit se ai kryente me të vërtetë një vepër te mirë po t'ua jepte tokën fshatarëve duke hequr dorë nga një pjesë e madhe e fitimeve që kishte prej saj. Ai vendosi ta përfundonte këtë punë sa më parë, pa humbur kohë. Grumbullimin dhe shitjen e drithit, shitjen e inventarit, haureve dhe plevicave që nuk do të qenë më të nevojshme në të ardhmen, të gjitha këto, ai do t'ja ngarkonte administratorit pasi të largohej. Kurse tani ai iu lut administratorit të mblidhte të nesërmen një përfaqësi të fshatrave të rrethuara nga tokat e Kuzminskojes, me qëllim që t'u çfaqte atyre mendimin e tij për dhënjen e tokave, e të merrej vesh me ta në Ldhje me çmimin.

Nekludovi doli nga zyra i kënaqur që u kishte bërë ballë me vendosmërin'e tij të gjitha arësyetimeve të administratorit, dhe i gatshëm si kurrë ndonjëherë tjetër për çdo sakrificë në dobi të fshatarëve. Duke e bluar me mëndjen e tij këtë punë, ai i ra qark shtëpisë, kaloi përmes lulishtes, që qe ngritur po atë vit përballë shtëpisë së administratorit e, që andej, nëpër sheshin e lawn-tennis-it, që kish filluar të mbulohej me bar dhe nëpër ulishten me blirë të lartë, ku shkonte dikur të pinte ndonjë cigare e ku aty e tre vjet më parë kishte flirtuar me Kirimovën, një zonjë e bukur që kish ardhur mysafire tek e ëma. Si e përpilloi shkurtimisht me mënd fjalimin që do t'u mbante të nesërmen fshatarëve, Nekludovi u kthye tek administratori dhe, si bisedoi edhe një herë me të, gjatë çajit, çështjen për likuidimin e pasurisë së tij, duke rënë dakord mbi të gjitha hollësirat, hyri në një dhomë të pregatitur për të e që ruhej zakonisht për mysafirët.

Dhoma nuk ishte dhe aq e madhe. Nëpër mure qenë varur disa kuadro me pamje të Venedikut dhe një pasqyrë. Ndërmjet dy dritareve, që vendosur një shtrat i pastër me

sustë dhe, pranë tij, një tryezë e vogël, një kanë me ujë, një kuti me shkrepse dhe një qiri. Mbi një tryezë tjetër, të madhe, përpara pasqyrës, qe vendosur valixhja e tij. Valixhja qe hapur dhe dukeshin ne te «neseseri»» i tualetes dhe disa libra, një rusisht, një anglisht dhe një gjermanisht, që flitnin që të tre për problemet dhe ligjet e kriminalitetit. Ai i kishte marrë me vete këto libra që t'i lexonte në kohën e lirë, gjatë udhëtimit të tij nëpër fshatra, por atë natë nuk i preku duke menduar se do të qe më mirë të flinte herët që të nesërmen, para se të takohej me fshatarët, t'i mendonte edhe një herë me nge ato që do t'u thoshte.

Në një qoshe të dhomës ndodhej një kolltuk i moçëm prej druri të kuq, të gdhëndur. Kur e pa atë kolltuk, që i kujtohej se kish qënë dikur në dhomën e fjetjes të s'ëmës, Nekludovi u pushtua befas nga një ndjenje krejt e papritur. Sakaq i erdhi keq edhe për shtëpinë që do të shkatërrohej, edhe për kopshtin që do të mbulohej me bar, edhe për pyjet që do të priteshin, edhe për të gjitha hauret e patozet e kafshëve, stallat, plevicat, depot e makinave, kuajt, lopët e, në përgjithësi, për tërë atë pasuri që qe ngritur e mbahej me aq mundime. Në fillim i qe dukur se do të qe e lehtë për të të hiqte dorë nga të gjitha këto, kurse tani po i vinte keq, jo vetëm për ato, por edhe për tokën, edhe për gjysmën e të ardhurave për të cilat tani kishte kaq shumë nevojë. Dhe ja, menjëherë, u paraqitën nën urdhërat e tij të gjitha arësyetimet që synonin të provonin se nuk ishte e arësyeshme t'ua jepje tokën fshatarëve dhe të hiqje dorë nga të drejtat e pronësisë.

«Unë duhet të heq dorë nga toka. Duke hequr dorë nga toka, unë nuk jam më në gjendje ta mbaj tërë këtë pasuri. Nga ana tjetër, unë tani po pregatitem të shkoj në Siberi e, pra, s'kam më nevojë as për shtëpinë dhe as për çiflikun», — fliste brënda tij një zë. «Kështu është vërtet, — përgjigjej një zë tjetër — por, në radhë të parë, mos harro se ti nuk do ta kalosh tërë jetën tënde në Siberi. Po të martohesh, mund të kesh fëmijë dhe çifligun duhet t'ua dorëzosh atyre në rregull, ashtu siç e more. Toka ka të drejtat e saja. Të falësh apo të shkatërrosh është pun'e lehtë, por është shumë më e vështirë t'i mbash e t'i shumëzosh ato që ke. Kryesorja është t'i përcaktosh mirë qëllimet që i ke vënë vetes dhe vetëm pas kësaj të marrësh, lidhur me pasurinë tënde, ato masa që mendon të nevojëshme. Po ti, a mendon se do ta zbatosh gjer në fund vendimin që ke marrë?

Pastaj, a është e vërtetë që ti vepron kështu siç po vepron, sepse je i bindur në drejtësinë e mendimeve të tua? Mos e bën vallë këtë për njerëzit, që të mburresh përpara tyre?» — e pyeste veten Nekludovi dhe nuk mund të mos pohonte se edhe fjalët, që do të thuheshin për të, kishin ndikuar në vendimin e tij. Dhe sa më tepër mendohej, aq më shumë pyetje i dilnin përpara dhe aq më e vështirë bëhej për të që t'u përgjigjej. Për t'i shporrur të gjitha këto mendime, ai u shtri mbi dyshekun e freskët që i kishin pregatitur me qëllim që të flinte e, nesër, pasi të ngopej me gjumë, të qe më i aftë për t'i shkoqitur të gjitha këto çështje, të cilat tani i dukeshin kaq të ndërlikuara. Por nuk mbylli dot sy për një kohë të gjatë; nga dritaret e hapura, bashkë me ajrin e freskët dhe dritën e hënës, depertonte në dhomë edhe të kuakurit e bretkocave që ndërpritej nga fërshëllima e largët e bilbilave në park dhe e njerit aty afër, nën dritare, në degët e lilakut, që porsa kishte çelur. Duke u vënë veshin bilbilave dhe bretkocave, Nekludovi solli ndër mënd muzikën që kish dëgjuar të luhej nga vajza e drejtorit të burgut; duke sjellë ndër mënd drejtorin, solli ndër mënd edhe Masllovën së cilës, po ashtu siç kuakmin bretkocat, iu drodhën buzët kur tha: «Hiqni dorë nga kjo punë». Pastaj zbriti tek bretkocat administratori gjerman. Duhej ta kish ndalur që të mos zbriste, por ai, jo vetëm që zbriti atje, por u bë si t'ishte ai vetë Masllova, dhe nisi ta qortonte: «Unë jam e burgosur, ju jeni princ». «Jo, jo, nuk dorëzohem» — mendoi Nekludovi dhe, si u zgjua në çast, pyeti veten: «Mirë apo keq është kjo që po bëj? Nuk e di, por as dua ta di. As dua ta di. Vetëm të fle, të fle, ja, këtë dua!» Dhe ai filloi të zbriste vetë atje ku kishin zbritur administratori dhe Masllova, dhe atje çdo gjë mori fund.

II

Të nesërmen Nekludovi u çua aty nga ora nëndë. Një nëpunës i ri, që punonte në zyrë dhe që e kishin ngarkuar t'i shërbente zotërisë, porsa dëgjoi zhurmë në dhomën e tij, i shpuri me të shpejtë këpucët, që shkëlqenin si kurrë ndonjëherë tjetër, dhe ujë të kulluar e të ftohtë burimi duke i thënë se fshatarët ishin lajmëruar për t'u mbledhur. Nekludovi kërceu nga shtrati dhe erdhi në vete. Keqardhjen për dhënien e tokave dhe për zhdukjen e pasurisë së tij, s'e

ndjente më tani. Ai e kujtonte atë i habitur. Tani gëzohej dhe krenonej padashur për punët që po e prisnin. Nga dritarja e dhomës së tij dukej sheshi, ku, të lajmëruar nga administratori, po mblidheshin fshatarët. Moti qe nxirë. Që në mëngjes kish filluar një shi i hollë, i vakët e pa erë, që rrëshqiste pikë-pikë mbi gjethet, në degët dhe fijet e barit. Nga dritarja, përveç aromës së bler.meve, depërtonte në dhomë edhe kundërmimi i tokës së lagur të etur për shi. Ndërsa vishej, Nekludovi hidhte herë-herë sytë nga dritarja dhe vështronte fshatarët, që mblidheshin tek sheshi. Ata vinin njeri pas tjetrit, nxirrnin shapkat apo kasketat, përshëndeteshin dhe uleshin për rreth, me bastun në duar. Administratori, një djalosh i shëndoshë, tërë muskla dhe i fuqishëm, i veshur me një setër të shkurtër me jakë të ngrirë, erdhi e i tha Nekludovit se qenë mbledhur të gjithë, por ai le të pinte më parë rehat kafenë apo çajin e të mos bëhej merak për fshatarët, se mund të pritnin.

— Jo, më mirë po shkoj, — tha Nekludovi që, duke menduar se kishte ardhur më në fund koha kur do të takohej e do të bisedonte me fshatarët, ndjeu befas se i vinte hem turp, hem frikë njëkohësisht.

Ai nisej t'u përmbushte fshatarëve një dëshirë, të cilën ata as kishin guxuar ta ëndërronin, nisej t'ua jepte tokat me një çmim të lirë, nisej t'u bënte, me fjalë të tjera, një të mirë e ja, prapë, kushedi përse, nuk e ndjente veten të qetë. Kur Nekludovi iu afrua fshatarëve dhe ata zbuluan kokët e tyre me flokë të kuq, me flokë kaçurrel, me flokë të thinjur, me flokë të rënur, ai u turbullua kaq shumë sa për një kohë të gjatë s'mundi të thotë dot asnjë fjalë. Shiu, shiu i hollë, vazhdonte të binte pikë-pikë mbi flokët, mbi mjekrat, mbi pushin e kaftaneve të fshatarëve. Fshatarët e vështronin barinin e prisnin të dëgjonin se ç'do t'u thoshte, por ai qe kaq i turbulluar, sa s'thoshte dot asgjë. Atë heshtje të zorshme e prishi gjermani, njeri shumë i qetë e i sigurt në vete, që hiqej si njohës i thellë i muzhikut rus dhe që e fliste rusishten fare mirë. Ky njeri i fuqishëm, i ushqyer mirë, po ashtu si edhe Nekludovi, bënte kontrast jashtëzakonisht të theksuar me fytyrat e hequra, pa mish e tërë rrudha të fshatarëve dhe me brinjët e tyre të thata që u spikatnin nën kaftane.

— Ja, princi do t'ju bëjë një të mirë, do që t'ju japë tokën, po ju ama, s'e kini hak, — tha administratori.

— Si nuk e paskemi hak, ore Vasil Karliç? Po pse, mos

qenë valle se s'të kemi punuar? E mjera zonjë, që zoti e ndjeftë, na ka ndihmuar, dhe ja dimë për nder, shumë për nder ja dimë. Po ja, i themi faleminderit tani edhe princthit, që duket nuk na harroi. . . — nisi të thotë një muzhik qimekuq që e kish gjuhën brisk.

— Unë ju kam mbledhur që, po të jetë se pranoni, t'jua jap juve të gjithë tokën, — tha Nekludovi.

Muzhikët rrinin të heshtur, sikur nuk kuptonin, apo nuk u besonin atyre që dëgjonin.

— Po si do të na e japësh, qysh është fjala? — u hodh e tha një muzhik, një mesoburrë me podjovkë.

— T'jua jap hua, që ta shfrytëzoni me një çmim të lirë.

— Kjo është punë e mirë, — tha një plak.

— Po, ama, thuaj të mos jetë shumë e rëndë paga, — tha një tjetër.

— Ne për tokë kemi nevojë, se me atë rrojmë!

— Ndryshe puna juaj, se ju i gjeni hazër nga të tjerët, pa mblidhni paratë e bëni gjynahe, — folën ca zëra.

— Gjynahet vetë i bëni, e vetë i pësoni, — u tha gjermani se të qe që të punonit e të mbanit rregull. . .

— Morepo rregulli është i mirë, po qysh ta mbajmë, ore Vasil Karliç? — e mori fjalën një plak i thatë, me hundë të mprehtë. — Se ti thua, pse e lëshova pelën nd'arë. Po kush e lëshoi? Mua, tërë ditën e perëndisë, më ra bretku duke kositur dhe, ja, u shtrita të prëhem ca. E po c'faj të kam unë që ajo u lëshua e hyri në thekrën tënde? Ç'faj të kam unë që ti pastaj zë e më rjep të gjallë, siç më rope?

— Po ja, prandaj duhet patur rregull.

— More, po ti s'thua keq, po ne si t'ja bëjmë, pa mirë, — ja priti një muzhik flokëzi e i paqethur.

— T'u bëni gardhe, kaq herë ju kam thënë.

— Po me se t'ua bëjmë gardhet? Drutë ku do t'i gjejmë? Se mos na i jep ti? — ndërhyri një muzhik i shkurtër një pëllëmbë, që s'e kishte as pamjen për të qënë. — Harrove si ma punove beharin që shkoi, kur desha të bëj gardhin? Më fute në burg që të ushqeja morrat tre muaj me radhë. Dhe ja, e bëra mirë atë gardhin që thua!

— Cfarë thotë? — e pyeti Nekludovi administratorin.

— Der erste Dieb im Dorfe [1]) — tha gjermanisht administratori. — S'ka vit që të mos e zëmë në pyll duke prerë dru pa leje. Po ti mësohu më mirë ta respektosh pronën e tjetrit, — tha gjermani.

---

1) Hajdut i parë i fshatit (gjermanisht).

— Po pse, s'të paskemi respektuar ty, apo qysh? — ja ktheu plaku. — E si mos të të respektojmë gjersa na ke në dorë? Apo s'na shëmb në dru. . .

— Tani, or vella, sikur e teprove; s'jeni nga ata ju që ja lini thatë tjetrit.

— Si e teprova? Po pse, s'ishe ti që m'i bëre copë turinjtë këtë behar që shkoi? Dhe si mbeti puna? Ja, ashtu mbeti. Po thuaj këtë: mos u ha me të pasurin, se të ha!

— Po ti, bëj si thotë ligji.

Ishte e qartë se n'atë përleshje fjalësh, as njeri nga ata që merrte pjesë nuk e kuptonte mirë përse fliste e çfarë desh të thoshte. Po vihej re, nga njera anë, një inat i tërbuar që përmbahej vetëm nga frika dhe, nga ana tjetër, — vetëdija e epërsisë dhe e forcës. Nekludovit nuk i vinte mirë t'i dëgjonte të gjitha këto dhe u ngut ta kthente bisedën atje ku qe nisur: të caktonte me fshatarët çmimet dhe afatet e pagesës.

— Atëhere, si do ta lëmë punën e tokës? A e doni? Dhe çfarë çmim do të caktoni po t'jua jap të gjithë tokën?

— Çmimin caktojeni vetë, se malli është juaji, s'është yni.

Nekludovi tha një çmim. Siç ndodh përherë, ndonëse çmimi që kishte caktuar Nekludovi ishte shumë i ultë nga ai me të cilin shiteshin tokat rreth e rrotull, muzhikët filluan të hahen në pazarllëk, duke thënë se çmimi në fjalë qe shumë i lartë. Nekludovi kujtonte se fshatarët do ta pritnin me gëzim të madh propozimin e tij, por, përkundrazi, nuk vuri re tek ata asnjë shënjë kënaqësie. Kështu Nekludovi arriti në përfundimin se propozimi i tij qe me të vërtetë shumë i leverdisëshëm për fshatarët vetëm kur u fol se kush do t'i merrte tokat, i tërë fshati, apo vetëm disa, dhe kur nisën grindje të ashpëra ndërmjet atyre që donin t'i përjashtonin nga blerja ata më të varfërit, që s'qenë në gjëndje t'i paguanin kështet n'afat, dhe atyre që mendohej të përjashtoheshin. Më në fund, me ndërmjetësinë e administratorit, çmimet dhe afatet e pagesës së kësteve u caktuan dhe fshatarët, duke biseduar me zë të lartë, u kthyen në fshat ndërsa Nekludovi shkoi në zyrë për të përpiluar atje, bashkë me administratorin, kushtet e shitjes.

Të gjitha u bënë ashtu siç kish dashur e kish shpresuar Nekludovi: fshatarët e muarrën tokën me një çmim që është nja tridhjetë përqind më i ulët nga ai që kishin tokat rreth e rrotull; të ardhurat nga toka pakësoheshin pothuaj për gjysmë, por qenë më se të mjaftueshme për Nekludovin

duke marrë parasysh edhe shumën që ai kishte marrë nga shitja e pyllit dhe atë që do të merrte pas nxjerrjes në shitje të inventarit. Çdo gjë, pra, qe në rregull, por, ja, Nekludovi prapë nuk ishte i qetë. Ai shikonte që fshatarët, sadoqë disa prej tyre flisnin për të me mirënjohje dhe e falënderonin, në përgjithësi ishin të pakënaqur ngaqë kishin pritur siç dukej, diçka më të madhe. Kështu, ndonëse ai kishte sakrifikuar një pjesë të madhe të pasurisë, prapë s'kishte mundur t'u jepte fshatarëve atë që ata kishin pritur prej tij.

Të nesërmen, kontrata e shitjes u nënshkrua dhe Nekludovi, i përcjellur nga një përfaqësi pleqsh, me moskënaqësinë e turbulltë që sjell vetëdija e një pune të papërfunduar, i hypi trojkës shik, siç thonte karrocjeri, të administratorit dhe u nis, pasi u la më parë shëndenë muzhikëve, që tundnin kokën si pa qejf dhe me mëdyshje. Nekludovi s'ishte i kënaqur nga vetja e tij. Përse s'ishte i kënaqur, as vetë nuk e dinte, por ndjente tërë kohës se i vinte turp dhe se nuk qe i lumtur.

III

Nga Kuzminskoje Nekludovi shkoi në çiflikun që i kishin lënë trashëgim tetot dhe ku qe njohur me Katjushën. Ai kishte ndër mënd t'i sistemonte edhe këtu punët, ashtu siç i kishte sistemuar në Kuzminskoje dhe, veç kësaj, të merrte vesh ato sa mund të merreshin akoma vesh për Katjushën dhe për fëminë që kishte patur me të: a qe e vërtetë që kishte vdekur dhe si kishte vdekur. Ai arriti në Panovo herët në mëngjes dhe gjëja e parë që i ra në sy, porsa shkeli në oborr, ishte gjëndja e mjeruar në të cilën ndodheshin tani banesat gjysmë të rrënuara e të braktisura të shërbëtorëve dhe, sidomos, shtëpia. Çatia e hekurt përmbi shtëpi, që kish qënë dikur jeshile, ngaqë kishte mbetur kaq kohë pa lyer, tani qe ndryshkur e dukej e kuqe. Vënde-vënde qenë hapur ca fletë, ndofta nga era; qeresteja në muret e shtëpisë qe shkulur aty-këtu nga njerëzit që e kishin shkulur pikërisht atje ku qe më e lehtë të shkulej, duke hequr gozhdët e ndryshkura që e mbanin. Verandat, që të dyja, sidomos e pasmja, të cilën ai e mbante mënd mirë, qenë kalbur dhe qenë thyer e s'u kishin mbetur veç trarët e skeletit, disa nga dritaret s'i kishin xhamet e qenë zënë me dhoga; krahu i shtëpisë, ku banonte administratori, kuzhina dhe stallat dukeshin si ca gërmadha të lashta e qenë të ftohta

dhe me lagështirë. Por kopshti, jo vetëm që nuk kishte atë pamje shkatërrimi që vihej re kudo, por, përkundrazi, kish marrë vrull, qe zmadhuar e egërsuar e tani qe mbuluar tejpërtej me lule që porsa kishin çelur; lulet e qershive, mollëve dhe kumbullave dukeshin përtej gardhit mu si re të bardha. Jargavanët kishin lulëzuar po ashtu si atë vit, aty e katërmbëdhjetë vjet më parë, kur Nekludovi kishte luajtur me Katjushën; atëhere ajo ishte tetëmbëdhjetë vjeçe vajzë; Nekludovi duke lozur qe rrëzuar e qe përcëlluar në ca hithra. Bredhi, që Sofia Ivanovna kishte mbjellë afër shtëpisë e që mbahej ahere me purtekë, qe bërë tani dru i madh për sharrë e qe veshur i tëri me hala verdhacuke, të buta e me push. Lumi qe fryrë nga shirat dhe dëgjohej si buçiste kur merrte të tatëpjetën e mullirit. Në luadh, përtej lumit, kullotnin tufa të larme bagëtish. Administratori, një seminarist me studime të pakryera, e priti Nekludovin në oborr, duke buzëqeshur; gjithë duke buzëqeshur, e ftoi të hynte në zyrë dhe, prapë duke buzëqeshur, sikur diç fshihte pas asaj buzëqeshjeje, u zhduk pas çatmasë. Pas çatmasë, u dëgjuan ca pëshpërima e pastaj u bë një heshtje. Karocjeri, si mori bakshishin, u largua bashkë me tringëllimën e zileve të kuajve dhe pastaj s'u dëgjua më asgjë. Pranë dritares, kaloi me vrap një vajzë këmbëzbathur dhe me një këmishë të qendisur. Pas vajzës, kaloi një muzhik duke përplasur me zhurmë mbi dheun e ngjeshur të monopatit çizmet e trasha me gozhda.

Nekludovi u ul në dritare. Vështronte nga kopshti dhe dëgjonte. Një fllad i freskët pranveror, që hynte nga dritarja e vogël me kanate duke sjellur me vete erën e tokës së punuar, i tundte lehtë flokët mbi ballin e dirsur e lëvizte ca fletë mbi pezulin e gërryer me brisk të dritares. Andej nga lumi «tra-pa-tap, tra-pa-tap» dëgjoheshin, kur më pak e kur më shumë, kopanet e grave që lanin rrobat, dhe kjo zhurmë përhapej mbi faqen e lëmuar të lumit, që shkëlqente nga dielli dhe, atje ku lumi vinte e ngushtohej, para se të hidhej në jazin e mullirit, dëgjohej rënia ritmike e ujit. Një mizë i kaloi pranë veshit dhe zhuzhiti e trëmbur.

Dhe ja, befas, Nekludovit iu kujtua se pikërisht kështu, dikur, kur ishte akoma i ri e i padjallëzuar, i kish dëgjuar mbi lumë, mes zhurmës ritmike të mullirit, goditjet e kopaneve mbi rrobat e njoma, se po ashtu, një fllad pranveror i kish tundur lehtë flokët mbi ballin e dirsur dhe kish lëvizur ca fije mbi pezulin e gërryer me brisk të dritares e,

pikër.sht po ashtu, i kishte kaluar pranë veshit duke zhuzhitur e trëmbur një mizë. Dhe atij, jo vetëm që iu kujtua vetja siç kishte qënë tetëmbëdhjetë vjeç djalë, por edhe e ndjeu veten pikërisht ashtu, po aq të freskët, po aq të pastër, po aq të bindur në mundësitë pafundimisht të mëdha që do t'i hapeshin në t'ardhmen. Por në te njëjtën kohë, ashtu siç ngjet në endërr, ai e dinte që këto të gjitha s'ishin të vërteta dhe ndjente sakaq një brëngë të hidhur e të dhimbëshme.

— Kur urdhëroni t'jua bëjmë gati drekën? — e pyeti administratori duke buzëqeshur.

— Kur të doni, unë s'kam uri. Po kaloj një herë nga fshati.

— Po nuk dëshironi t'i hidhni më parë një sy shtëpisë? Brënda çdo gjë është në rregull, megjithëse nga jashtë. . .

— Jo, jo, më vonë. Po nuk më thoni, ju lutem, banon këtu një Matrena Harina?

Kjo ishte tetua e Katjushës.

— Posi, posi, këtu banon, në fshat! Po ç'e do, s'para e ka mirë me mua. Shet verë e raki kondrabandë. E marr, i flas, e qortoj, po që ta padis më vjen keq, se është plakë, ka dhe nipër për të ushqyer. . . — tha administratori, po me atë buzëqeshje, që shprehte në të njëjtën kohë edhe dëshirën për t'u dukur i zellshëm ndaj padronit, edhe bindjen se Nekludovi, po ashtu si ai, merrte vesh nga çdo punë.

— Ku banon? Desha ta takoja.

— Në fund të fshatit, izba e tretë nga fundi. Do të shikoni më të majtë një izbë me tulla e ja, menjëherë pas asaj, vjen edhe kasollja e saj. Po më mirë po ju shoqëroj unë gjer atje, — tha administratori, duke buzëqeshur i gëzuar.

— Jo, ju falemnderit, e gjej vetë. Ju, ndërkaq, jepni urdhër ju lutem, t'i lajmërojnë muzhikët që të mblidhen: do të bisedoj me ta për punën e tokës, — tha Nekludovi, që mendonte të merrej vesh me muzhikët edhe këtu, po ashtu si në Kuzminskoje dhe, po të qe e mundur, po atë mbrëmje.

IV

Nekludovi [illegible] udhën e fshatit. Nëpër një monopol të rrahur, mbuluar aty këtu me barëra të këqinj dhe me gjëmba, ai pa që së largu një vajzë fshatare, me një shami ngjyra-ngjyra në kokë e me vathë në vesh, që ecte në drej-

ishin të kundër me të, duke revizur shpejt e shpejt ato këmbët e saj të zbathura e të trasha. Vajza, që ishte po ajo që ai kishte parë atë mëngjes, shtrëngonte fort në njërin krah një gjel të kuq, ndërsa krahun tjetër e tundte lart e poshtë përpara vetes. Lafsha e kuqe e gjelit lëkundej në mënyrë ritmike herë në një anë, herë në tjetrën, dhe ai vetë dukej fare i qetë. Vetëm më të rrallë gjeli zgurdullonte sytë dhe zgjaste këmbët e zeza duke ngulur ktnetrat në tustanin e vajzës. Kur ecte në fushë vajza e ngadalësoi hapin, pastaj u ndal, i dha pas kokës me vrull, u përkul thellë dhe vetëm, pasi ai kaloi dhe u largua, vazhdoi përsëri udhën e saj me kaposhin. Kur zbriti poshtë tek një pus, Nekludovi takoi një plakë të kërrusur, me një këmishë të ndohtë prej cohe të ashpër, ngarkuar me ujë. Plaka i shkarkoi me kujdes bucelat që mbante në kurriz dhe, kur e pa atë, iu përul.

Fshati niste tama tek pusi. Ishte një ditë e nxehtë dhe e kthjellët, vapa kishte filluar që n'orën dhjetë të mëngjesit, dielli vetëm rrallë e tek zihej nga retë. Rruga qe mbushur me erën e mprehët, të athët e të rëndë të plëhut që vinte si nga qerret që ngjitnin të përpjetën e malit ashtu, edhe nga oborret e fshatarëve, ku plëhu shkrifej e ngarkohej. Muzhikët që ngisnin qerret, këmbëzbathur, me këmishë e poture të përlyera, kthenin kokën or'e çast nga ai zotëri me shtat të lartë e me trup të mbushur që ecte, me një shirit të mëndafshtë rreth e rrotull kapelës së murme, duke prekur çdo dy hapa tokën me majën e bastunit të skalisur me kokë të ndritëshme. Muzhikët, që ktheheshin nga arat duke u lëkundur mbi qerret bosh. hiqnin shapkat dhe e ndiqnin me sy të habitur atë njeri të çuditshëm që ndeshnin rrugës. Gratë dilnin në dritare apo në çardak, ja ngulnin sytë dhe ja tregonin me gisht njëra tjetrës.

Tek dera e konakut të katërt, Nekludovi u ndal, sepse atë çast po dilnin që andej me një krismë rrotash ca qerre të ngarkuara me pleh e të mbuluara sipër me një rrogos për ndënje. Një çunak nja gjashtë vjeç u shkonte qerreve pas dhe që t'u hipte. Një muzhik i ri hiqte për kapistre kalin. Një mëz kaltërosh, këmbëgjatë, doli me vrik nga dera, por u trëmb kur pa Nekludovin, u ngjesh pas qerres duke përplasur thundrat në rrotë dhe hovi përpara s'ëmës. që hingëllinte lehtë e shqetësuar. Kalin, që vinte pas, e tërhiqte një plak i thatë e i gjatë, këmbëzbathur edhe ai, me një palë poture me kutiia, me një këmishë të gjatë e të ndytë, nën të cilin i dalloheshin çkoqur eshtrat e thata.

Kur kuajt duallën më në fund në rrugë, mbuluar aty këtu me ca bajga të reshkura, të përhime e si të shkrumbëzuara, plaku u kthye pas, iu përul Nekludovit dhe e përshëndeti.

— Mos je gjë nipi i zonjave, ç'thua?

— Po, ai jam, i nipi i tyre.

— E po, mirë se na erdhe! Duket dole një herë këtej të na shikosh, — tha plaku, që kuptohej se kishte shumë qejf të zinte muhabet.

— Po, po. Po si dukeni? — tha Nekludovi, që s'dinte ç'të thoshte.

— Lere mos e nga! Jetë më e poshtër se kjo jona s'ka si të bëhet! — çfryu plaku me një frymë si i kënaqur.

— Po pse qënka e poshtër? — pyeti Nekludovi duke u afruar për nga dera.

— Po pse jetë është kjo? Ku ka jetë më të poshtër nga kjo? — tha plaku duke e ndjekur Nekludovin nën strehën e derës. — Ja unë, bie llafi, bëhem vetë i dymbëdhjetë, — vazhdoi duke treguar me dorë nja dy gra me shamitë që u kishin shkarë mbi zverk, me fytyra të dirsura e të skuqura nga mundi, me pulpat e këmbëve të zhlyera gjer sipër me bajgë. Gratë qëndronin me cfurqe në dorë majë një pirgu me pleh. — Po s'bleva pesë pude drithë muaj për muaj e di që ngordh. Mirëpo ku t'i gjej që t'i blej pesë pudet, nuk më thua?

— Pse, nuk ju del ai që bëni vetë?

— Ai që bëjmë vetë?! — tha plaku duke u çkërmitur me përbuzje — Me atë tokë që kam unë s'mban dot as tri frymë jo dymbëdhjetë. Gjithë-gjithë, ç'mora nga ajo sivjet? Pesëdhjetë-gjashtëdhjetë duaj! S'shkuam dot me to as gjer në krishtlindje dhe s'kemi paguar dot as taksat.

— Po atëhere si ja bëni?

— E qysh do ja bëjmë? Ja, ashtu me të keq. Një nga djemtë e dhashë argat, mora edhe nga zotëria juaj një paradhënie. Po ç'e do, jam keq me taksat se, siç të thashë, s'i kam paguar.

— Sa bëhen taksat?

— Po nja shtatëmbëdhjetë rubla, po e po!. . . Ja, vetëm perëndia e di si do ja dalim mb'anë! Jetë e poshtër kjo. . .

— A mundem të hyj pak në izbën tuaj? — tha Nekludovi ndërsa e zgjidhte vëndin kur ecte që të mos shkelte mbi petët e verdha-shafran të plëhut të kthyer me cfurk që të shponte hundët nga era.

— Hyr, mor hyr, pse të mos hysh! — tha plaku dhe, duke nxituar përpara me këmbët e zbathura që shtypnin aty këtu nonjë bajgë të freskët që i ngjitej pas gishtërinjve, hapi derën e izbës dhe e ftoi të hynte.

Gratë, që çkriftëronin plehun, i ndreqën shamitë, i çpërvjelën fustanet e trashë prej zhgune dhe e vështruan me kërshëri e me frikë atë zotëri qibar, me pulseta floriri në mëngët e këmishës, që po hynte në shtëpinë e tyre.

Nga izba duallën jashtë me vrap dy vajza të vogla në këmishë. Nekludovi u kërrus, hoqi kapelen dhe hyri në hajat e, që andej, në një izbë të ndvtë, që mbante erë thartirë. Izba ca oe e ngushtë, ca ngushtohej edhe më tepër nga dy vegjë të vendosur në të dy anët. Në izbë, pranë sobës, qëndronte në këmbë një plakë. I kishte përvjelur mëngët dhe i dukeshin krahët e thatë, me damarë të nxira nga dielli.

— Ja, ky zotëria ynë deshi të na urdhërojë sot në shtëpi! — tha plaku.

— E po, mirë se të na urdhërojë! — tha plaka me një zë të ngjirur duke përveshur mëngët.

— Desha të shikoj se si rroni, — tha Nekludovi.

— Po ja kështu rrojmë, siç na sheh. Izba do të na shëmbet, rrezik mos të na zërë nonjë ditë. Po ky plaku im s'para bëhet merak, mirë që e kemi edhe këtë, thotë. E ja kështu rrojmë e mbretërojmë, siç i thonë fjalës, — foli plaka, që dukej shumë e gjallë, duke shkundur kokën me nervozitet — Tani po u bëj të hanë, se ai që punon do dhe të hajë, domosdo.

— Çfarë do t'u bëni?

— Çfarë do t'u bëj? Të gjitha të mirat! Të parë do t'u bëj një bukë me kvas, të dytë një kvas me bukë, — tha plaka duke kërcëllitur dhëmbët që i kishte të ngrënë gjer në mes.

— I lini mënjanë shakarat, më tregoni me tërë mënd çfarë do të hani sot?

— Çfarë do të hamë? — tha plaku duke qeshur. — Ne, ore barin, s'para e vrasim shumë mëndjen për të ngrënë. Pa hë, moj plakë, pa tregoja!

Plaka tundi kokën.

— Duket ta paska ënda t'i shikosh një herë këto gjellët tona fshatare. Hej, ore barin, po qënke merakli i madh zotrote, të gjitha do t'i shikosh! Po ja, të thashë: bukë me

kvas, pastaj edhe «shçi» se më prunë gratë dje ca lakra. . . e kështu, si të thashë, do t'u bëj edhe një «shçi». . . nja dy kokrra patate po i kam. . .

— Dhe vetëm kaq?

— E po dhe një çikë qumësht po të ketë. . . — tha plaka, ndërsa hidhte sytë nga dera duke vënë buzën në gaz.

Dera qe hapur dhe hajati qe plot me njerëz, me djem, me vajza, me gra me foshnje në gji, që ngjisheshin në derë dhe ja ngulnin sytë barinit të çuditshëm, që deshte të shikonte se si rronin fshatarët. Plaka, me sa dukej, mburrej që dinte të sillej me barinin dhe ja kishte përgjigjet në xhep.

— E ja kështu, ore barin, jetë e poshtër është kjo e jona, e poshtër sa s'ka ku të vejë! — tha plaku — Po ju aty? — ju çkreh ai atyre në derë.

— E po mirëmbetshi! — tha Nekludovi që, kushedi përse, nuk e ndjente më veten të çpenguar si në fillim dhe i vinte turp.

— Shumë të faleminderit që erdhe të na shikosh, — tha plaka.

Turma në hajat u nda më dysh që t'i hapte rrugë. Ai kaloi, doli jashtë dhe mori rrugën për ku qe nisur. Fill pas tij, duallën jashtë edhe dy djem të vegjël këmbëzbathur njeri, ai më i madhi, me një këmishë të ndytë që kishte qënë ndofta dikur e bardhë; tjetri, në një këmishë trëndafili të zbardhur. Nekludovi ktheu kokën pas dhe i pa.

— Po tani ku do shkosh? — e pyeti ai me këmishë të bardhë.

— Tek Matrena Harina. E njihni?

Ai më i vogli me këmishë trëndafili se përse qeshi, kur se ai tjetri pyeti me tërë mënd:

— Te cila Matrena? Është plakë?

— Po, plakë është.

— O-o — ja bëri ai — tek Semeniha!. . . Ajo e ka shtëpinë në fund të fshatit. Të shpiem ne. Fedka, hajt ta shpiem.

— Po kuajt?

— Ehû, kuajt! Punë e madhe!. . .

Fedka pranoi dhe, që të tre, iu ngjitën përpjetë fshatit.



V

Nekludovi e ndjente veten më të çpenguar me të vegjëlit se sa me të rriturit. Rrugës zuri të bisedojë me ta. Vogëlushi me këmishë bojë trëndafili tani nuk qeshte më, përkundrazi, fliste po aq shtruar dhe me kuptim sa edhe shoku i tij më i madh.

— Kush është këtu tek ju më i varfër nga të gjithë? — i pyeti Nekludovi.

— Kush është i varfër? Mihaili është i varfër, Semjon Markovi është i varfër. . . Pastaj dhe Marfa është shumë e varfër.

— Po Anisja ua kalon, se është më e varfër. Anisja s'ka as lopë dhe rron me të keq, — tha Fedka i vogël.

— Vërtet s'ka lopë, po s'janë shumë ata, tre janë, kurse Marfa bëhet vet i pestë, — ja ktheu ai çunaku më i madh.

— E, e, po ajo, fundja, është edhe e ve! — nguli këmbë çunaku me këmishë bojë trëndafili, duke i dalë zot Anisjes.

— Po zere se e ve është edhe Marfa, gjersa s'e ka këtu burrin, — vazhdoi më i rrituri.

— Pse, ku e ka burrin? — pyeti Nekludovi.

— Ja kanë futur në burg që t'ushqejë morrat, — tha çunaku, duke përdorur një shprehje që e kishte dëgjuar nga të mëdhenjtë.

— Beharin që shkoi preu nja dy mështekna në pyll dhe, ja, e zunë, — u ngut të thoshte më i vogli. — Bëhen nja gjashtë muaj që e kanë atje, në burg, dhe e shoqja e tij heq të zitë e ullirit se, veç që ka fëmijët për të ushqyer e s'ka me se, por do t'i bëjë yzmet edhe plakës, që s'është e zonja tani për hiçgjë, — foli ai tamam si një i madh.

— Po ku banon? — pyeti Nekludovi.

— Ja, ai atje është konaku i saj, — tha çunaku duke treguar me dorë një shtëpi, ku dukej në derë një fëmijë kokëbardhë, i vogël fare, që mezi mbahej duke u lëkundur mbi dy këmbë të shtrëmbëra, të përkulura nga jashtë. Vogëlushi bëri ca hapa e i doli përpara Nekludovit.

— Vaska, ku shkove ashtu, mor çamarrok? — i thirri një grua që doli me vrap nga izba. Gruaja, që kish veshur një këmishë të ndytë të murme e si të spërkatur me hi, u hodh përpara dhe, si e llahtarosur nga frika se mos Nekludovi i bënte ndonjë të keqe të voglit të saj, e rrëmbeu dhe e shpuri në izbë.

Gruaja ishte pikërisht e shoqja e muzhikut që kish prerë dru në pyllin e Nekludovit.

— Po Matrena, a është e varfër? — i pyeti Nekludovi fëmijët, kur iu afruan izbës së vogël të Matrenës.

— Çfarë e varfër, ore? Ajo bën tregëti me verë! — u përgjegj i vendosur çunaku thatim me këmishë trëndafili.

Kur sosën në izbën e Matrenës, Nekludovi i ktheu fëmijët, hyri në hajat e, që andej, në izbë. Kasollja e Matrenës plakë ishte gjithë-gjithë ndonja gjashtë arshina, kështuqë një njeri me trup të madh, s'kishte mundësi të shtrihej lirisht në shtratin që ndodhej pas sobës. «Pikërisht mbi këtë shtrat, — mendoi ai — lindi e lëngoi pastaj Katjusha». Kasollja zihej pothuaj e tëra nga një vegjë të cilën, ndërsa Nekludovi po hynte duke përpjekur kokën në derën e ultë, plaka, bashkë me të mbesën e madhe, qenë ulur dhe po e rregullonin. Fill pas barinit, nja dy nipër të vegjël të plakës, vrapuan kokëngulthi në izbë dhe u ndalën në prak, duke u kapur me të dy duart pas shtalkave të derës.

— Kë do? — pyeti me të rreptë plaka, që s'ishte në qejf nga shkaku i vegjës që s'po i rregullohej dhe nga frika që ndjente nga çdo i huaj për shkak të kontrabandës që bënte me verë.

— Jam çifligari. Desha të bisedoja pak me ju.

Plaka heshti, ja nguli mirë sytë Nekludovit dhe menjëherë e ndryshoi çehren.

— Ama ti qënke, more pëllumb? Ti qënke, mor të keqen? Po mua të marrës si m'i mori zoti mëndtë?. . . Do të jetë ndonjë shtegëtar, thashë. . . — nisi të flasë plaka tërë lajka. — Eh, more sokoli ynë, more xhani ynë. . .

— Desha të bisedoj pa njerëz të tjerë. . . — tha Nekludovi, duke hedhur sytë nga dera e hapur, ku qëndronin fëmijët dhe, pas tyre, një grua e thatë me një foshnje me fytyrë të fishkur, të zbetë e të sëmurë, dhe me një kapuç të rreckosur në kokë.

— Morepo ju atje, do ta thyeni qafën që andej apo t'u rrëmbej drunë? — iu shkreh plaka atyre që ndodheshin në derë — Do ta mbyllni derën, apo t'iu ngrihem?!

Fëmijët u larguan, gruaja me fëmijën në duar e mbylli derën.

— E, që thua ti, them me vete: kush do të jetë ky? Kur ky na paska qenë barini, dora vetë! Eh, ore barin, ore të keqen, ore kapedan i nënës! — tha plaka. — Po ayshi s'të erdhi ndoht që shkele këtu? E po më rrofsh, se atë zemër

që më paske ti, s'e paska njeri! Ja këtu ulu, shkëlqesi, ja, në këtë fronin këtu, — tha duke i marrë pluhurin fronit me cepin e perdes. — Djall-o punë, them unë, ç'është ky? Kur ky na paska qenë shkëlqesia jote, ky na paska qenë bar.ni ynë, që i qofshim falë, se pa të s'kemi jetë, se na ushqen e na mban gjallë frymën. . . E po më ndje, të keqen, se më shushati pleqëria, pa po s'para shoh mirë edhe nga sytë.

Nekludovi u ul, plaka i qëndroi përballë, e mbështeti mjekrën mbi dorën e djathtë, ndërsa me dorën e majtë shtrëngonte bërrylin e mprehtë të dorës së djathtë, dhe foli sikur po këndonte:

— Po qënke plakur, shkëlqesi. Më kujtohet që ke qënë si ai trifili i njomë, po ç'e do, tani ahà. . . Duket edhe ty të paskan rënë hallet në kokë.

— Ja ç'dua të të pyes: a e mban mënd Katerina Masllovën?

— Katerinën, the? Po qysh nuk e mbakam mënd? Po e kam mbesë, fjalë është kjo? Ja, kaq e kam këputur unë lotin për të! Se, mos pandeh, të gjitha i kam marrë vesh. E po, ore baba, kush është ai që s'ka fyer ndaj zotit e s'ka gabuar ndaj carit? Po ajo ka qenë edhe axhami ahere, dhe ja, ai qoftëlargu e gënjeu, i mori mëndjen dhe e shturi në gjynah. Ke ç'i bën? Të qe që të mos e kishe shikuar, e po ndryshe, po ti e ngope me para, se i dhe njëqind rubla, jo shaka! Po ç'bëri ajo, pa!. . . Po thuaj i mori perëndia mëndtë dhe s'më dëgjoi se, të më kish dëgjuar, kush do qe si ajo. Mbesë e kam, vërtet, po do t'jua them: s'para ka qenë vajzë e shtruar. I kisha gjetur një vënd lere mos e nga sa të mirë, po s'qëndroi se ngrihet, që thua ti, e marra, dhe na zihet me barin.n. Po hë, thuaj, ka bërë vaki të ngrihet yzmeqari e të shajë të zonë? E ja, domosdo, e dëbuan. Kështu edhe me atë pojakun, ku u fut në punë së dyti.

— Unë kam ardhur të pyes për fëminë se, me sa di unë, ajo ka lindur këtu, tek ju. Ç'u bë fëmija?

— Fëmijës unë, or baba, ja bëra të gjitha yzmetet. Se ajo qe sëmurë rëndë ahere dhe s'ngrihej dot në këmbë. Unë edhe e pagëzova djalin, sipas zakonit, dhe e shpura në edukatore. Se, mirë e ëma, po që të vuante edhe ai engjëll i vogël, qe gjynah. Të tjerët s'para çajnë kokën, e lënë fëmijën pa ushqyer dhe ja, u vdes; po unë thashë: pa dale se mos e shpëtojmë, dhe e dërgova në edukatore, siç të thashë. Pastaj, paratë i kishim, pse të mos e dërgonim.

— Kishte numër?

— Kishte, domosdo, se ja vumë numrin, po ç'e do se vdiq që atëhere. Ajo na tha: porsa që e suallët dhe vdiq.

— Kush ajo?

— E po ajo, de, ajo gruaja që banonte në Skorodni. Ajo me këtë punë merrej. Malania e quanin, po tani ka vdekur. Ka qenë grua e mençur, shumë grua e mençur. E merrte foshnjën në shtëpi dhe e ushqente. E ushqente dhe mirë e ushqente, or baba, gjersa e niste. Dhe niste tri a katër bashkë, porsa që ja sillnin. Po e kishte menduar mirë këtë punë, se kishte ujdisur një djep, po sa të madh? Ja, bën hesap, vinte sa një krevat nusërie e, që thua ti, atje i vinte që të katër, po këmbët ua mblidhte tok, se xheku përplasnin kokën dhe vriteshin. Pa u fuste edhe një biberon në gojë dhe ata s'lëviznin hiç.

— Edhe?

— Po ja, edhe foshnjën e Katerinës kështu e shpuri. Po që e ushqeu edhe në shtëpi, e ushqeu, dhe jo pak, po nja dy javë. Po ç'e do që s'e mori për mbarë shëndeti atë ditë-shkurtër.

— Ka qenë fëmijë e bukur? — pyeti Nekludovi.

— I bukur sa s'kish ku të shkonte! Fëmijë si ai janë të rrallë. Tëpkë i ati! — tha plaka duke shkelur synë e fishkur.

— Po si qe puna që u dobësua? Mos nuk e ushqyen mirë?

— E me se do ta ushqente ajo? Ja, me ca lëtyra, se, fundja, s'e kishte as të sajën. Po thuaj të paktën ta kishte shpurë të gjallë atje ku e shpuri! Po, siç më tha, i vdiq në duar pa sosur mirë në Moskë. Solli edhe dëshmimtarë dhe aq e bëri në rregull këtë punë sa s'ka. Ka qenë grua e mënçur, ç'i do llafet.

Këto qenë të gjitha sa Nekludovi mundi të merrte vesh për fëmijën e tij.

VI

Si e vrau përsëri kokën në të dy dyert, në izbë dhe në hajat, Nekludovi doli jashtë në rrugë. Fëmijët, ai i madhi dhe ai tjetri, me këmishë bojë trëndafili, po e pritnin. Qenë bashkuar me ta edhe fëmijë të tjerë. Qenë edhe ca gra me foshnje në duar e, ndërmjet tyre, edhe gruaja e thatë me fëminë e zbehtë me kapuç të rreckosur në krye. Fëmia ngërdheshte or'e çast atë fytyrën e tij të vockël, të zhubro-

sur si fytyrë plaku, lëvizte e tendoste gishtërinjtë e mëdhenj e të shtrëmbër të duarve e dukej sikur buzëqeshte. Por Nekludovi e kuptonte që foshnja vuante dhe prandaj ngërdheshej. Pyeti kush qe ajo grua.

— Është ajo Anisja që të thashë, — iu përgjegj më i rrituri nga djemtë.

Nekludovi iu drejtua Anisjës.

— Si rron? — e pyeti — Me se ushqehesh?

— Si rroj? Ja ashtu me të keq, — tha Anisja dhe qau.

Çilimiu me fytyrë plaku u ngërdhesh edhe më tepër këtë radhë duke përkulur këmbët e holla si krimba.

Nekludovi nxori kuletën e i dha Anisjës dhjetë rubla. Po s'kish bërë as dy hapa kur e arriti një grua tjetër me fëmi, pastaj një plakë, pastaj ca gra të tjera. . . I folën për varfërinë e tyre, i kërkuan ndonjë lëmoshë. Nekludovi u shpërndau të gjashtëdhjetë rublat, para të shkoqura që kishte në kuletë dhe, me zëmër të vrarë e i brengosur, u kthye në shtëpi, d.m.th. në banesën e administratorit. Administratori e priti Nekludovin me buzën në gaz dhe i tha se fshatarët do të mblidheshin atë mbrëmje. Nekludovi e falënderoi, por s'deshi të hynte në dhomë dhe shkoi të shëtiste në kopsht nëpër ulishtet mbuluar me lulet e rëna të mollëve dhe me bar, ku do t'i mendonte me nge ato sa kish parë.

Në fillim, në krah të shtëpisë ku banonte administratori s'ndihej asgjë, por pastaj erdhën që andej dy zëra grash, që çirreshin me inat e që ndërpriteshin më të rrallë nga zëri i qetë i administratorit. Nekludovi vuri veshin e dëgjoi.

— Po ti e di, ore faqezi, që jam keq e mos më keq, pse më merr në qafë? — thoshte njëra nga gratë e xhindosur.

— Po ja, sapo iku, — thoshte tjetra — Nëma, të them, se sos hajvanin që ma mundon, po m'i le edhe fëmijët pa qumësht.

— Nxir paratë ose shlyeje me punë që të ta jap, — përgjigjej zëri i qetë i administratorit.

Nekludovi doli nga kopshti dhe iu afrua verandës, ku qëndronin dy gra të rreckosura nga të cilat, njëra, dukej sheshit se qe me barrë dhe gati për të lindur. Administratori kapardisej majë shkallëve me duart në xhepet e palltos prej pëlhure të trashë. Porsa panë barinin, gratë heshtën menjëherë dhe nisën të ndreqnin shamitë që u kishin shkarë, ndërsa administratori i nxori duart nga xhepet dhe filloi të buzëqeshte.

Ja si kishte qënë puna. Muzhikët, sipas të thënave të administratorit, i lëshonin me qëllim viçat, bile edhe lopët e tyre, në livadhet e barin.t. Kështu edhe lopët e atyre grave qenë zënë tek kullotnin në luadhin e Nekludovit. Qenë zënë e qenë lidhur. Administratori kërkonte nga gratë, që t'ua lëshonte lopët, ose tridhjetë kopejka ose dy ditë punë. Gratë kundërshtonin duke thënë se, në radhë të parë, lopët porsa kishin hyrë në luadh, se, së dyti, s'kishin ku t'i gjenin paratë që t'ja jepnin atij për lopët dhe se, së treti, i jepnin fundja fjalën që do t'i punonin, po ama t'ua lëshonte që atë çast lopët, se kishin tërë ditën që po muitnin nga të pangrënët.

— U kam dalë borxhit se, jo një herë, po njëmijë herë. U kam thënë — tha administratori duke buzëqeshur ndërsa hidhte sytë nga Nekludovi sikur deshte ta merrte për dëshmitar — që kur i lëshoni bagëtitë vini edhe një njeri që t'jua ruaj.

— Po m'iku e flamosura sapo vajta t'i jap sisë foshnjës!

— Të mos kishe shkuar, kush të tha?

— Po foshnjen kush do të ma ushqente? Mos do vije ti t'i jepje sisë?

— Ta kish prishur luadhin, siç thua, gjene mirë se, të paktën, do ta kish mbushur barkun. Po ajo sa hyri. . . — tha tjetra.

— Të gjitha luadhet na i kanë prishur, — tha administratori, duke u kthyer nga Nekludovi — Po të mos marrësh masa, ahá, laji duart nga bari!

— Hë, mos gënje! — u hodh e thirri ajo me barrë — Kur i paske zënë zotrote herë tjetër të miat, që thua?

— Po ja t'i zura këtë radhë dhe tani o nxirr paratë o bëj aq punë sa të thashë!

— E po ç'do të bëj, do punoj, po lëshoma lopën, se ma le pa ngrënë e do më ngordhi! — thirri si e tërbuar nga inati gruaja me barrë. — Sos që mbeta në këmbë dit'e natë, sos që jam me burrë në burg e me vjehrrë të sëmurë, po na tani dhe kjo! E po marrtë hak zoti mbi ty, o katil, me atë punë që kërkon nga unë!

Nekludovi iu lut administratorit që t'i lëshonte lopët dhe u kthye përsëri në kopsht që ta shpinte gjer në fund fillin e mendimeve që kish nisur. Po tani nuk kishte më pse të mendohej. Tani nuk i mbetej tjetër veç të habitej se si njerë-

zit dhe ai vetë gjer ahere nuk kishin mundur të shikonin një gjë që dukej sheshit.

«Populli po vdes, populli është mësuar tanimë të vdesi dhe ka krijuar mënyrën e tij të jetesës në përshtatje me një gjëndje të tillë, kur fëmijët vdesin ngaqë s'ushqehen, kur gratë coptohen natë e ditë në punë, kur ushqimi është i pakët për të gjithë dhe, sidomos, për pleqt. Dhe populli është ambjentuar dalë nga dalë kaq mirë me këtë gjëndje sa nuk i duket më kaq e tmerëshme dhe nuk qahet. E ja, duke u nisur pikërisht nga kjo, ne arrijmë në përfundimin se kjo gjëndje është për të krejt e natyrëshme, se është, me fjalë të tjera, ashtu siç duhet të jetë». Tani për të qe e qartë, si drita e diellit, se shkaku kryesor i mjerimit të popullit, të cilin vetë populli e kishte vënë në dukje më se një herë, duhej kërkuar në faktin se çifligarët ja kishin marrë popullit tokën, që për të ishte i vetmi mjet jetese. Ishte në të njëjtën kohë po aq e qartë se fëmijët dhe pleqtë vdisnin ngaqë nuk kishte qumësht dhe nuk kishte qumësht sepse s'kishte tokë ku të kullotej bagëtia e ku të mblidhej drithi e bari. Ishte gjithashtu fare e qartë se mjerimi i popullit ose, në mos tjetër, shkaku kryesor e më i afërt i tij, duhej kërkuar në faktin se toka me të cilën ai ushqehet nuk është në duart e tij, po ishte në duart e disa njerëzve që, duke e shfrytëzuar këtë të drejtë që kishin mbi tokën, rronin në kurriz të tij. Dhe kështu toka, që është për njeriun kaq e nevojëshme sa pa të ai vdes, punohet nga populli i uritur e i rraskapitur, me qëllim që drithi që do të japi të shitet nga çifligarët jashtë shtetit e që, me këto të holla, të blihen kapele, bastune, karroca, skulptura bronxi, etj. Për të kjo është tani kaq e qartë sa ç'ishte edhe se çfarë do t'u ndodhte kuajve po t'i rrethonin në një vend të ngushtë dhe të mos i linin të kullotnin jashtë këtij caku: kuajt, pasi ta kullotnin barin që kishin nën këmbë, dalëngadalë do të dobësoheshin e do të ngordhnin... Dhe kjo ishte një gjë e tmershme, një gjë që dunej të mos ishte. Pra, duheshin gjetur mjetet që do ta zhduknin një gjëndje të tillë ose që, të paktën, ai vetë të mos merrte pjesë në të. «Dhe unë do t'i gjej patjetër këto mjete, — mendonte Nekludovi». Në shoqëritë e kulturuara nëpër institucionet shtetërore e nëpër gazeta analizohen gjerë e gjatë shkaqet e mjerimit të popullit, flitet qysh e tek t'i zhdukim këto shkaqe si edhe për mjetet që do të na lejojnë ta ngremë popullin në një livel jetese më të lartë. Po, çudi, nuk flitet për mjetin kryesor, për mjetin më

të sigurtë, **që vetëm** ai do të mjaftonte ta nxirrte menjëherë nga prapambetja dhe nga mjerimi, nuk flitet me një fjalë që t'ja kthejmë popullit tokën që i kemi rrëmbyer. — Me një gjallëri të madhe ai solli ndërmënd edhe një herë parimet kryesore të teorisë së Henri Xhorxhit mbi pronën e tokës si edhe entuziazmin që e kishte pushtuar kur për herë të parë i lexoi dhe u habit se si kish mundur t'i harronte të gjitha këto. — «Toka nuk është një send që mund të pronësohet, nuk është një send që mund të blihet apo të shitet. Toka u përket të gjithëve, toka është si uji, si ajri, si rrezet e diellit. Të gjithë kanë të drejta të barabarta mbi tokën dhe mbi të gjitha të mirat që vijnë prej saj». Ai e kuptoi tani pse i vinte turp të kujtonte se si i kishte sistemuar punët në Kuzminskoje. K'sh gënjyer veten. Sadoqë e dinte fort mirë që njeriu nuk mund të ketë të drejta të privilegjuara mbi tokën, ai kishte vepruar sikur ai vetë t'i kishte këto të drejta duke u falur fshatarëve një pjesë, nga ajo që e ndjente thellë në shpirt, se nuk ishte e tij. Po tani këtë nuk do ta përsëriste, bile dhe do ta rishikonte edhe vendimin që kishte marrë në Kuzminskoje. Ai hartoi në kokën e tij një projekt sipas të cilit toka do t'u jepej fshatarëve hua kundrejt një rente, rentë e cila, duke iu njohur fshatarëve si pronë personale, do të përdorej prej tyre për shlyerjen e taksave si edhe për aktivitete me karakter shoqëror. Kjo natyrisht nuk linte Single-tax [1]), por sidoqoftë ishte nga të gjitha reformat e mundura përbrënda rendit ekzistonjës, ajo që i afrohej më shumë. Ajo që kishte më shumë rëndësi ishte se ai tani hiqte dorë nga e drejta e pronës private mbi tokën.

Kur shkoi në shtëpi, administratori, duke buzëqeshur në një mënyrë krejt të veçantë këtë radhë, e ftoi për drekë duke e lutur atë të mos vonohej se ndryshe, gjellët që kish gatuar e shoqja, mund të zienin më tepër nga ç'duhej.

Tryeza qe mbuluar me një sofrabez prej cohe t'ashpër, vendin e pecetave e zinin disa peshqirë të vegjël të qëndisur. Në mes qe vendosur një vieuxsaxe [2]) me dorezë të thyer, mbushur me supë patatesh e me lëng gjeli. Pas supës, gjeli u servir së dyti, po këtë radhë i pjekur. Gjellët s'kishin asnjë shije, por Nekludovi hante pa vënë re, i zhytur në atë mendim që i kishte lindur tani së fundi e që ja kishte lehtësuar menjëherë brengën që kishte sjellë me vete nga fshati.

---

1) Taksë unike (frëngj.)

1) Enë porcelani e moçme Saksosie. (frëngj.)

Ndërsa vajza shërbente në tryezë, e shoqja e administratorit bënte ç'bënte e hidhte sytë nga dera; administratori vetë, duke u mburrur për mjeshtrinë e madhe që kish në të gatuar e shoqja, buzëqeshte përherë e më tepër i gëzuar.

Pas buke, Nekludovi mezi e kandisi administratorin të ulej dhe, me qëllim që ta kontrollonte edhe një herë saktësinë e mendimeve të tij dhe, në të njëjtën kohë, t'ja thoshte edhe një tjetri çështjen që e shqetësonte aq shumë, i parashtroi atij projektin për t'ua dhënë tokat fshatarëve dhe e pyeti se ç'mendonte. Administratori vuri buzën në gaz për t'i treguar gjoja se kjo i kishte shkuar në mëndje edhe atij vetë prej kohësh, sadoqë në të vërtetë nuk kuptonte asgjë, jo sepse Nekludovi nuk shprehej qartë, po sepse, sipas projektit, dilte që Nekludovi hiqte dorë nga interesat e tij në dobi të interesave të disa njerëzve të tjerë, gjë kjo, që sipas administratorit, ishte thjesht marrëzi, meqënëse çdo njeri duhet të përpiqet përkundrazi vetëm për të mirën e tij, qoftë edhe duke i bërë dëm tjetrit. Kjo pikëpamje qe ngulitur kaq thellë në shpirtin e administratorit saqë ai mendonte se diçi kishte shpëtuar pa e marrë vesh, kur Nekludovi i tha që të gjitha të ardhurat nga toka duhet të përfshihen në kapitalin e përbashkët të fshatarëve.

— E mora vesh. Ju, ahere, do të merrni një përqindje nga ky kapital, apo jo? — tha ai dhe sytë atë çast i shkëlqyen.

— Jo, jo. Si nuk po e kuptoni që toka nuk duhet të jetë një pronë private?

— Kjo është e vërtetë!

— Prandaj të gjitha të mirat që vijnë nga toka u përkasin të gjithëve.

— Mirë, po ju kështu nuk do të kini më të ardhura. . . — tha administratori dhe nuk po buzëqeshte më.

— Po sigurisht, gjersa them që heq dorë prej tyre.

Administratori psherëtiti thellë, po pastaj filloi përsëri të buzëqeshë. Tani po, tani e kishte kuptuar! Ai kuptoi më në fund që Nekludovi nuk qe fort në rregull nga trutë dhe, posa e kuptoi këtë, nisi të kërkojë në projektin e Nekludovit ndonjë mundësi që të dilte i fituar edhe ai në atë mes.

Por kur kuptoi se edhe kjo qe e pamundur, u mërzit dhe s'u interesua më gjatë për projektin sadoqë, sa për t'i bërë qejfin zotërisë, vazhdonte të buzëqeshte si më parë. Kur pa që administratori nuk ishte në gjëndje ta kuptonte, Nekludovi nuk e zgjati më bisedën me të, por u ul në një trye-

zë, të prerë vende-vende me thikë e të nxirë me bojë, dhe nisi të hedhi projektin e tij në letër.

Dielli po perëndonte pas blireve që sapo kishin rënë në lule, miskonjat futeshin në dhomë tufa-tufa dhe e pickonin Nekludovin. Kur ai mbaroi së shkruari, dëgjoi një blegërimë bagëtish që vinte nga fshati, ca zhurma dhe muhabetet e fshatarëve që po mblidheshin sipas porosisë së tij. Nekludovi e thirri administratorin dhe i tha se nuk qe nevoja që fshatarët të mblidheshin në zyrë, sepse ai do të shkonte vetë në fshat, në atë shtëpinë ku qenë grumbulluar. Si e piu shpejt e shpejt çajin, që i solli atë çast administratori, Nekludovi u nis e shkoi.

VII

Muzhikët qenë mbledhur në shtëpinë e starostes. Nekludovi shkoi atje. Porsa e panë që po afrohej, muzhikët i prenë muhabetet dhe, po ashtu si në Kuzminskoje, i hoqën një nga një shapkat dhe e përshëndetën. Fshatarët këtu dukeshin shumë më të varfer se ata në Kuzminskoje. Gratë dhe vajzat mbanin në vesh vathë, muzhikët qenë pothuajse të gjithë të veshur me kaftane që i kishin punuar vetë. Disa qenë zbathur dhe vetëm në këmishë, ashtu siç kishin ardhur nga puna.

Nekludovi deshte të fliste por s'mundte. Më në fund e mblodhi veten dhe, duke hyrë drejt e në thelbin e çeshtjes, u tha fshatarëve se kishte ndërmend t'ua falte tokën. Muzhikët rrinin të heshtur dhe në fytyrat e tyre nuk vihej re asnjë ndryshim.

— Unë mendoj, — tha Nekludovi duke u skuqur, — se toka nuk duhet të jetë e atij që nuk e punon dhe se të gjithë kanë të drejtë të kenë tokë.

— Ashtu është, posi! Ashtu, po! — thanë muzhikët.

Nekludovi vazhdoi të fliste akoma se të ardhurat nga toka duhet t'u përkisnin të gjithëve; prandaj ai propozonte që të gjithë të merrnin tokë kundrejt një çmimi të cilin ata do ta caktonin vetë e që do të përfshihej në kapitalin e tyre të përbashkët. U dëgjuan edhe këtë radhë disa zëra që e pëlqenin propozimin dhe e pranonin, por fytyrat e fshatarëve u bënë akoma edhe më të vrazhda nga fjalët e fundit të Nekludovit dhe muzhikët i mbanin tani sytë përdhe, sikur t'u vinte turp për cifligarin që kërkonte t'ua hidhte, por që ata ja kishin zbuluar hilenë.

Nekludovi foli në një gjuhë mjaft të thjeshtë dhe muzikët qenë njerëz që kuptonin, por pikërisht ashtu siç i kishte ndodhur më parë administratorit, atyre i dukej se diç i penguonte t'i kuptonin mirë fjalët e të zotit të tyre. Ata qenë thellësisht të bindur se cdo njeri përpiqet vetëm për të mirën e tij. Veç kësaj çifligarët i njihnin mirë, brez pas brezi, dhe e dinin mirë që ata kishin luftuar kurdoherë për interesat e tyre në dëm të fshatarëve. Prandaj kur çifligari i thërriste e u thoshte diç do t'u propozoj, fshatarët mendonin se kjo duhej marrë në kuptimin që ai kishte gjetur ndonjë mënyrë për t'i shfrytëzuar edhe më mirë nga ç'i kishte shfrytëzuar gjer ahere.

— E po atëhere sa mendoni ta tatoni tokën? — pyeti Nekludovi.

— Ç'pret nga ne ta tatojmë? Ne s'përzihemi dot në këtë punë. Tokën vet e ke dhe fuqinë po vetë! — u dëgjuan zëra nga turma.

— Nuk po merremi vesh; ju vetë do t'i përdorni këto të holla bashkërisht për nevojat tuaja.

— Këtë, ore tungjatjeta, s'e bëjmë. Ku kjo, ku ajo që thua ti...

— Mundohuni ta kuptoni se ku është fjala — ndërhyri duke buzëqeshur administratori me qëllim që t'ua sqaronte fshatarëve mendimin e Nekludovit. — Princi ua jep tokën kundrejt një shume të hollash, po këto të holla prapë tuajat janë, se i ka shoqëria dhe i përdor si të dojë.

— Ne e marrim vesh, jo se nuk e marrim vesh, — tha një plak hijerëndë, dhëmbë rënë, pa i ngritur sytë. — Kjo është si puna e bankës që i do t'ja paguash paratë me afat. Ne s'ka ç'na duhet, se edhe kështu keq jemi, e jo pastaj ashtu që do të shkatërrohemi fare!

— Jo, or jo, s'kanë ç'na duhen këto neve. Më mirë ashtu sic e kishim më parë! — u dëgjuan zërat e fshatarëve që flitnin tani me zë të lartë dhe aty këtu ndonjeri edhe me të rreptë.

Fshatarët filluan të kundërshtonin me këmbëngulje, sidomos atëhere kur Nekludovi u zuri në gojë kushtet që do të përpiloheshin e do të nënshkruheshin nga të dy palët, nga ai dhe nga fshatarët.

— E pse të nënshkruajmë? Ashtu siç kemi punuar ashtu do punojmë. Ç'janë këto yçkëla që na nxjerrin tani? S'para marrim vesh nga këto ne, se jemi njerëz pa gramë.

— Jo, jo, nuk duam, se s'na e merr dot mendja qysh

do jetë kjo punë. Kurrë s'e kemi dëgjuar! Më mirë ashtu siç ka qënë ashtu të mbetet. Ama po të na hiqje farën, s'do bëje keq, u dëgjuan zërat e fshatarëve.

Duke kërkuar që t'u hiqej fara, fshatarët donin të thoshin se tokat që mbilleshin me farën e tyre, të mbilleshin këndej e tutje me farën e çifligarit.

— Ahere nuk pranoni, nuk doni tokë? — pyeti Nekludovi duke iu drejtuar një fshatari mesoburrë, zbathur, me një kaftan të grisur, që e mbante shapkën e çjerrë në dorën e djathtë, tamam ashtu siç e mbajnë ushtarët kapën kur e heqin me komandë.

— Po, si urdhëron — foli fshatari që, me sa dukej, kish qënë ushtar e s'kish mundur të çlirohej akoma nga rregullat e ushtrisë.

— Duket që ju mjafton ajo tokë që keni? — tha Nekludovi.

— Jo, aspak! — u përgjegj fshatari, që mbante me kujdes përpara vetes shapkën e tij të çjerrë sikur bëhej gati t'ja jepte menjëherë kujdo që do t'ja kërkonte.

— Sidoqoftë, mendohuni mirë një herë për këto që ju thashë, — tha i habitur Nekludovi, dhe e përsëriti edhe një herë propozimin e tij.

— Nuk kemi pse të mendohemi. Ç'kishim për të thënë, e thamë! — foli plaku çehrengrysur e pa dhëmbë.

— Unë do të jem prapë nesër këtu. Në rast se do t'ju ndryshohet mëndja, të më lajmëroni.

Muzhikët s'iu përgjegjen fare.

Kështu Nekludovi u kthye në zyrë pa u marrë dot vesh me fshatarët.

— Dëgjoni princ, dëgjoni pak mua, — tha administratori, kur po ktheheshin në shtëpi — s'merreni dot vesh me ta; kanë një kokë që zoti ua faltë! Kështu përherë në mbledhje ata ngulin këmbë në atë të tyren dhe ec e tundi po të duash! Por nga frika e bëjnë. Se, pikërisht ata muzhikët që patë, ai i thinjuri dhe ai tjetri, i ziu, sadoqë kundërshtuan, janë që të dy finokë. Thirri në zyrë, jepu të pijnë edhe nga një çaj, — tha administratori duke buzëqeshur, — dhe ke për të parë se s'janë gjë hiç ministrat përpara tyre, aq mirë e bukur kuvëndojnë! Po në mbledhje hiqen sikur s'janë ata dhe vetëm që të prishin punë, se për të tjera nuk i ke!

— Po atëhere a thërresim disa nga fshatarët, pikërisht ata që kuptojnë më tepër? — tha Nekludovi. — Atyre do të mund t'ua shpjegoj të gjitha me hollësi.

— Punë që bëhet! — tha administratori, gjithë duke buzëqeshur.

— Atëhere, ju lutem, i lajmëroni që të mblidhen nesër.

— Hiç mos u bëni merak! Nesër i mbledh unë! — tha ai duke buzëqeshur. Po këtë radhë sikur fluturonte nga gëzimi.

— Jo, po thuaj, po të duash, që s'është dhelpër ai! — i thoshte duke u lëkundur mbi një pelë të ngosur një muzhik i zi, me një mjekër të pakrehur, një muzhiku tjetër plak e i hollë me një kaftan të grisur, që ecte pranë tij.

Qe natë. Muzhikët shkonin t'i kullotnin kuajt buzë xhadesë dhe, fshehurazi, në pyllin e çifligarit.

— Ta jap falas tokën, thotë, po nënshkruaj këtu! Se mos është hera e parë që kërkojnë të na e punojnë ata! Po, aha, tani është zgjuar populli, s'para ja hedh dot aq kollaj, — shtoi ai dhe nisi të ndjellë mëzin që kish mbetur pas. — Na, laro, na! — thirri duke ndalur pelën e duke kthyer kokën prapa. Po mëzi nuk qe prapa, po shkonte anas. — Hë, paska hyrë në pyll, dreqi!

— Ke ç'i bën? U mësua ai tani me barin e çifligarit dhe s'pyet fare! — tha muzhiku i zi mjekërgjatë, duke dëgjuar se si fëshfërinin këmbët e mëzit që vraponte trokthi e duke hingëllitur në barin e njomur nga vesa që përhapte rreth e rrotull një erë të këndëshme.

— Ka hipur bari, e sheh? Ndonjë të kremte të dërgojmë gratë t'na tëharin të mbjellat se, zoti mos e dhëntë, do na prishen kosat. — tha muzhiku i hollë me kaftan të grisur.

— Nënshkruaj, thotë, — vazhdonte të komentonte mjekërmadhi fjalët e barinit. — Nënshkruaj, thotë, se dua të të ha të gjallë.

— Ashtu, po, të gjallë, po! — iu përgjegj plaku.

Kaq thanë e s'folën më. Dëgjohej vetëm trokëllima e këmbëve të kuajve mbi dheun e fortë.

VIII

Kur u kthye në shtëpi, në zyrën që ishte bërë përkohësisht dhomë fjetje, Nekludovi gjeti një shtrat të lartë me një dyshek puplash, dy jastëkë dhe një jorgan të trashë prej mëndafshi të kuq me astar të qëndisur, që, me sa dukej,

ishte i pajës së shoqes së administratorit. Administratori e ftoi Nekludovin të hante me ato që kishin mbetur nga dreka. Por ky nuk pranoi dhe administratori u largua, si i kërkoi më parë ndjesë që nuk ishin në gjendje ta kënaqnin siç duhej.

Që fshatarët ja hodhën poshtë propozimin nuk e shqetësoi aspak Nekludovin. Përkundrazi, megjithëse atje, në Kuzminskoje, qe bërë ashtu siç kishte dashur ai dhe të gjithë e kishin falënderuar, këtu tregonin kundrejt tij mosbesim dhe mbanin qëndrim pothuajse armiqësor, ai e ndjente veten të qetë e të gëzuar. Zyra nuk qe e pastër, ajri në dhomë ishte i rëndë. Nekludovi doli në oborr dhe deshi të shkonte në kopsht, por iu kujtua ajo natë, dritarja në dhomën e shërbëtorëve, veranda e pasme dhe mendoi se do të qe shumë e rëndë për të t'i rishikonte ato vende të njollosura nga kujtimi i një krimi. Ai shkoi e ndenji përsëri në verandë dhe, ndërsa thithte erën e fortë të gjetheve të njoma të mështeknave, që shpërndahej nëpër ajrin e vakët të mbrëmjes, sodiste kopshtin e mbulohej nga muzgjet, dëgjonte zhurmën e mullirit, këngën e bilbilave dhe cicërimën monotone të një zogu tjetër diku aty afër. Në dritaren e dhomës, ku flinte administratori, drita u fik. Andej nga lindja, pas plevicës, qielli u skuq nga rrezet e hënës që ngrihej dalngadalë në horizont. Disa vetëtima të largëta ndriçonin për një çast, me një dritë përherë e më të fortë, kopshtin me lule që kishte filluar të mbulohej me bar dhe gërmadhat e shtëpisë së braktisur. U dëgjua së largu një bubullimë dhe qielli, gjer ahere i qëruar, nisi të mbulohej me re të zeza. Bilbilat dhe zogjtë heshtën. Përmes zhurmës së ujit në mulli dëgjohej gagaritja e patave. Pastaj në fshat e në oborrin e shtëpisë së çifligarit u dëgjuan këndezat që këndonin më heret nga ç'duhej, ashtu siç e kanë zakon në netët e nxehta me stuhi. Një fjalë e urtë thotë se kur këndezët këndojnë para kohe, do të thotë se nata do të jetë e mbarë. Për Nekludovin ajo natë ishte më e mbarë. Ajo ishte për të një natë gëzimi, një natë lumturie. Solli edhe një herë ndërmend kohën e djalërisë dhe të gjitha përshtypjet që i kish lënë ai behari i lumtur që kish kaluar atje kur qe akoma i ri e i pa djallëzuar. Ai e ndjeu edhe një herë veten ashtu siç kishte qenë dikur në çastet më të mira të jetës së tij, siç kishte qënë në moshën katërmbëdhjetë vjeç, kur i lutej zotit që t'i zbulonte të vërtetën, kur qante, çilimi, në prehërin e s'ëmës e i premtonte se do bëhej djal' i mirë dhe nuk

do ta mërziste kurrë. Ai e ndjeu veten ashtu siç kishte qënë atëhere kur, bashkë me Nikolenka Irtenevin, vendosën të ndihmonin gjithmonë njeri tjetrin që të bëheshin njerëz të mirë e t'i bënin të gjithë njerëzit të lumtur.

Atij iu kujtua tani se si në Kuzminskoje kish ngurruar një çast t'i vinte në jetë vendimet që kish marrë, se si i kishte ardhur keq edhe për shtepinë, edhe për pyllin, edhe për çiflikun, edhe për tokën... «Po tani a më vjen keq?» e pyeti ai veten dhe solli ndërmend një nga një të gjitha ato sa kishte parë atë ditë: gruan me fëmijën që kishte mbetur pa burrë se ja kishin futur në burg për dy mështekna që kish prerë pa leje në pyllin e tij, të Nekludovit; Matrenën, atë lugat me fytyrë njeriu, që mendonte, ose të paktën thoshte se si gratë si ajo e kanë për detyrë të bëhen të dashurat e zotërinjve të tyre; solli ndërmend se ç'mendonte ajo për fëmijët dhe për mënyrën se si i shpinin në edukatore, e i doli përpara ajo foshnja fatkeqe me një kapuç të rreckosur, me një fytyrë të mplakur që ngërdheshej nga uria e dukej sikur buzëqeshte, solli ndërmend gruan me barrë, të raskapitur që e detyronin të punonte falas për të sepse, e mbytur në punë, s'e kish ruajtur dot siç duhej lopën që mezi mbahej në këmbë nga të pangrënët. Aty për aty i solli ndërmend edhe burgun, kokat e rruara të të burgosurve, erën e qelbur të qelive, vargonjtë dhe, bashkë me këto, lluksin e çmëndur të jetës mondane në kryeqytet, nëpër qytete e nëpër çifliqe. Çdo gjë tani ishte e qartë e s'linte më as pikë dyshimi.

Hëna, pothuaj e plotë, u ngrit e ndriçoi përmbi plevicë. Nëpër oborr u zgjatën ca hije të zeza; majë shtëpisë, llamburiste hekuri i ndryshkur i çatisë.

Si për t'iu falur asaj drite, një bilbil, këndonte rishtas në kopësht duke përpjekur sqepin.

Nekludovit iu kujtua se si në Kuzminskoje kish nisur të mendohej mbi jetën e tij duke u munduar të zgjidhte një varg problemesh që do t'i paraqiteshin në të ardhmen, po s'ja kishte dalë dot në krye, aq të zorshme e të ndërlikuara i qenë dukur. Tani, përkundrazi, duke i shqyrtuar përsëri këto probleme, i dukej se mund të zgjidheshin fare lehtë. I dukej se mund të zgjidheshin fare lehtë sepse tani nuk preokupohej më për jetën e tij, nuk mendonte më se me çfarë do të merrej këtej e tutje e se si do të rronte në të ardhmen. Ai mendonte tani jo se çfarë do të bënte, por se çfarë duhej të bënte. Dhe çudi, se çfarë i duhej atij vetë ai nuk qe në gjendje ta përcaktonte, se çfarë u duhej të tjerëve këtë ai e,

dinte me siguri. Kështu, fjala vjen, ai e dinte me siguri që tokën duhej t'ua jepte fshatarëve dhe se nuk ishte mirë ta mbante vetë. E dinte me siguri që nuk duhej ta braktiste Katjushen, po duhej ta ndihmonte, duhej të bënte çmos ta shlyente fajin që kishte karshi saj. E dinte me siguri që duhej t'u hynte thellë të gjitha çeshtjeve që kishin të bënin me gjyqet e me dënimet, kur shihte diçka që nuk qe vënë re nga të tjerët. Se ç'pasoja do të kishin këto të gjitha ai nuk i kuptonte, por e dinte me siguri që e kishte për detyrë t'i bënte pa tjetër. Dhe ishte pikërisht kjo siguri që i ngjallte Nekludovit besimin në vetvete dhe i jepte një qetësi dhe një kënaqësi shpirtërore të pashpresuar.

Ret e zeza sakaq qenë afruar dhe tani nuk dukeshin vetëm vetëtimat, por dëgjoheshin edhe shkrepëtimat e rrufesë që e ndriçonin anembanë oborrin dhe atë shtepi — gërmadhe me veranda të shkatërruara. Zogjtë nuk pipëtinin fare, por zgjohej fëshfërima e gjetheve nga një erë e ngrohtë mbi ballin e Nekludovit. Ra një pikë shiu, pastaj një tjetër e një tjetër, trokëllitën mbi gjethet e mbi teneqenë e çatisë... Befas, ajri shkëlqeu si nga një flakë, u bë një heshtje dhe Nekludovi s'arriti të numërojë gjer në tre kur, përmbi kokë të tij, diç krisi e u rrokullye nëpër qiell me një gjëmë të llahtarëshme.

Nekludovi hyri brenda.

«Po, po, — mendoi — veprën e jetës sonë dhe qëllimin e kësaj vepre unë nuk i kuptoj, nuk kam se si ta kuptoj: ç'u deshën tetot? Përse u desh që Irtenevi të vdiste e unë të mbetesha gjallë? Përse e takova Katjushen? Përse u marrosa? Përse ndodhi lufta? Përse jeta e çthurur, jeta boshe që kam bërë gjer tani? Jo, jo, nuk është në dorën time t'i kuptoj të gjitha këto, nuk është në dorën time të kuptoj qëllimet e atij që ka dashur që këto të bëhen. Po që të bëj vullnetin e tij që është shkruar në ndërgjegjen time, po, këtë e kam në dorë! Dhe do ta bëj dhe e di që e bëj sa herë e ndjej ndërgjegjen time të qetë.

Shiu ndërkaq ja kishte marrë shtruar, e rridhte poshtë nga çatia duke gurgulluar nëpër ulluk; rrufetë përherë e më rrallë e ndriçonin tani oborrin dhe shtëpinë. Nekludovi hyri në dhomë, u xhvesh dhe u shtri mbi dyshek. Tapiseria e rjepur dhe e ndyrë e mureve i ngjallën dyshim se mbase atë natë nuk do të flinte rehat nga çimkat.

«Po, duhet të mos e ndjej veten zot, po shërbëtor,» — mendonte ai dhe gëzohej për këtë mendim.

Dyshimet e tij u vërtetuan. Porsa e shoi qirjun, një mizëri insektesh iu versulën nga të tëra anët.

T'ua jap tokën, të shkoj në Siberi... pleshtat, çimkat, ndyrësirat... E po, gjersa kështu duhet, do t'i duroj! «Por, megjithë vullnetin e tij të mirë, ai nuk mundi t'i durojë dhe, si u ngrit, u ul në dritare, nisi të sodisë retë që largoheshin dhe henen që shkëlqente përsëri në qiell.

IX

Nekludovi mundi të flerë vetëm aty nga mëngjesi dhe prandaj të nesërmen u çua vonë.

Në drekë shtatë muzhikë të zgjedhur nga administratori erdhën e u mblodhën në kopsht, nën një mollë, ku qe vendosur një tryezë. Fshatarët nuk pranonin t'i vishnin kapelet e të uleshin mbi bankë. Kaloi kështu një kohë e gjatë përpara se t'i kandisnin. Më tepër nga të gjithë kundërshtonte ai që kishte qënë dikur ushtar dhe që e mbante shapkën e tij të grisur përpara vetes, tamam sipas rregullores. Atë ditë i kishte mbështjellur këmbët me peca të pastra dhe kish vënë një palë llapti të reja. Po kur më në fund njëri nga fshatarët, një plak shpatullgjerë e i pashëm, me një mjekër të thinjur e kaçurrel si ajo e Moisiut të Mikel-Anxhelos, me flokë të bardhë e të dëndur, që i binin si një kurorë mbi ballin e gjerë, të nxirë nga dielli, e hoqi shapkën e madhe që mbante në krye e, duke çkopsitur kaftanin e ri, u ngjit mbi tezgë dhe u ul, atëhere të tjerët, që të gjithë, ndoqën shembullin e tij.

Nekludovi priti sa zunë vend. Pastaj u ul përballë tyre dhe, duke mbështetur bërrylat mbi tryezë përmbi letrën ku kish shkruar konspektin e projektit, nisi t'ua lexojë e t'ua shpjegojë.


Ndofta ngaqë numëri i muzhikëve këtë radhë qe më i vogël, apo ndofta nga që ishte i zhytur krejt në punën e tij e s'kishte nge të merrej me vetveten, Nekludovi nuk ndruhej si më parë. Tek fliste i mbante sytë sidomos nga plaku shpatullgjerë me mjekërën e përthinjur sikur priste prej tij që ta aprovonte apo t'i bënte ndonjë vërejtje. Por opinioni që kishte krijuar për të Nekludovi ishte i gabuar. Plaku i pakshëm, sidoqë e fundte vazhdimisht në shenjë pohimi atë koken e tij të bukur patriarkale dhe rudhte vetullat sa herë

që të tjerët kundërshtonin, shikonte qartë se mezi i kuptonte ato që thonte Nekludovi dhe vetëm atëhere kur fsnatarët ja shpjegonin në gjuhën e tyre. Shumë më tepër kuptonte, përkundrazi, një plak i shkurtër e i thatë pranë tij, qorr nga njeri sy, me një podjovkë të mballosur nankini, me një palë çizme të shtrembëruara e pothuaj pa mjekër fare, që, siç mori vesh Nekludovi më vonë, punonte si sobatërës. Ky i lëvizte shpejt vetullat duke u menduar të rrëmbente çdo fjalë dhe, porsa që e rrokte dhe e kuptonte, kthehej e ua shpjegonte edhe të tjerëve. Po aq shpejt si ai e kuptonte Nekludovin edhe një plak tjetër dërdënk me mjekër të bardhë, me sy të ndritshëm e të mënçur, i cili nuk linte t'i shpëtonte asnjë rast pa bërë, duke u mburrur, nonjë vërejtje apo ndonjë shaka të hollë rreth fjalëve të Nekludovit. Edhe ai që kishte qënë ushtar do të kishte kuptuar ndofta përse bëhej fjalë sikur të mos qe shastisur në ushtëri e të mos ngatërrohej or' e çast në formulat absurde të gjuhës ushtarake. Më serioz nga të gjithë ndaj problemeve që rrihte Nekludovi dukej një muzhik shtatëlartë, me një mjekër të shkurtër, me një hundë të gjatë që fliste me një zë të trashë basi dhe që kish vënë një palë rroba të pastra e një palë llapti të reja. Ky muzhik, ndonëse i kuptonte të gjitha, fliste më të rrallë dhe vetëm atëhere kur duhej folur. Dy pleqt' e tjerë — njeri, pikërisht ai me dhëmbë të rëna që në mbledhjen e djeshme ngrinte zërin dhe e kundërshtonte Nekludovin në çdo pikë; tjetri një plak i gjatë e i çalë, me një fytyrë të dobët me këmbët e holla si purtekë të shtrenguara fort me një palë pece të bardha, — rrinin të heshtur pothuajse tërë kohën, sadoqë i dëgjonin të gjitha sa thuheshin me vëmëndje të madhe.

Përpara se të fillonte leximin e projektit, Nekludovi deshi të fliste në përgjithësi mbi pikëpamjet e tij lidhur me pronësinë e tokës.

— Sipas mendimit tim, toka — tha ai — as nuk mund të shitet apo të blihet, sepse, po të shitej, ata që janë të pasur, do ta blinin të gjithë dhe do të merrnin pastaj, përkundrejt të drejtës për shfrytëzimin e saj, nga ata që do të mbeteshin pa tokë, sa të donin. Me fjalë të tjera, do ta përdornin tokën si një mall tregu, — shtoi duke shfrytëzuar një argument të Spenserit.

— Ndaj edhe atyre u duhen lidhur krahët. S'ka ilaç tjetër, — foli plaku me sy të qeshur e me mjekër të bardhë.



— Kjo është e vërtetë, — tha me basin e tij të trashë hundëgjati.

— Po, si urdhëron, — tha ai që kish qënë ushtar.

— S'guxon tjetri të këputi një fill bar për atë lopën ngordhësirë që ka, se e kapin dhe e fusin brënda, — tha plaku i çalë, me fytyrë të butë.

— Tokat e tua i ke pesë vjorsta larg, që të marrësh ndonjë copë tokë më afër, me ato çmimet që i shesin s'e merr dot, makar sikur dhe i gjallë të shitesh, — shtoi plaku çehrengrysur, me dhëmbë të rëna. — Bëjnë me ne si t'iu dojë qejfi, më keq se në kohën e barshçinës [1]).

— Pikërisht kështu si ju mendoj edhe unë, — tha Nekludovi — dhe jam kundra pronës private mbi tokën, se më duket një gjë e padrejtë. Prandaj dhe dua t'jua jap juve.

— Nuk e ke menduar keq, — tha plaku me kokën si Moisiu që, me sa dukej, kujtonte se Nekludovi deshte ta jepte tokën me qira.

— Pikërisht për këtë kam ardhur këtu: unë nuk dua të kem më tokë; por duhet menduar në ç'mënyrë do të mund të çlirohem prej saj.

— Në ç'mënyrë?! Po jepja ore, muzhikëve, dhe vuri vulën kësaj pune! — tha plaku çehrengrysur, pa dhëmbë.

Nekludovi aty për aty u turbullua duke ndjerë se me ato fjalë muzhiku tregonte se nuk kishte besim në sinqeritetin e qëllimeve të tij. Por e mori veten menjëherë dhe përfitoi nga vrejtja që iu bë për të hyrë menjëherë në thelbin e çështjes.

— Unë atë dua, ta jap, — tha ai — po kujt dhe në ç'mënyrë? Cilëve nga muzhikët? Përse fshatit tuaj dhe jo Deminskojes? (ky ishte një fshat aty afër që kishte fare pak tokë).

Të gjithë heshtnin. Vetëm ai që kishte qënë ushtar tha:

— Po, si urdhëron!

— Ja, pra, e shikoni? — tha Nekludovi — Tani më thoni: sikur cari të jepte urdhër që toka t'u merrej çifligarëve e t'u shpërndahej fshatarëve...

— Pse, mos është hapur ndonjë fjalë kështu? — pyeti përsëri ai plaku pa dhëmbë.

— Jo, nga cari nuk ka asgjë, po unë vetëm po ju them: sikur cari të jepte urdhër që toka t'u merrej çifligarëve e t'u jepej fshatarëve, ju si do ta bënit këtë punë?

---

1) Në kohën e bujkrobërisë ishte puna e detyrueshme që bënin falas fshatarët në dobi të çifligarit (sh. i përkth.).

— Qysh do ta bënim? Do ta ndanim barabar tokën pas frymëve. S'prish punë, le të merrnin edhe barinët... — tha sobabërësi duke përpëlitur nepallat.

— Po, pas frymëve domosdo, s'ka se si ndryshe! — tha plaku i çalë me fytyrë të dobët e me peca të bardha.

Me këtë mendim qenë shprehur edhe të tjerët.

— Po në ç'mënyrë pas frymëve se? — pyeti Nekludovi — Po dvorojeve a do t'u jepet?

— Jo aspak! — tha ai që kish qenë ushtar, duke u orvatur të dukej i qeshur e i giallë në fytyrë.

Por fshatari i gjatë, që dukej më i mënçuri nga të gjithë, u përgjegj ndryshe.

— Gjersa do ta ndajmë, ose e ndajmë barabar, ose hiç! — tha ai me atë basin e tij të trashë pasi u mendua një copë herë.

— Kjo s'ka si të bëhet! — tha Nekludovi, që e kishte gati përgjegjen. Po t'u jepnim pjesë të barabarta të gjithëve pa përjashtim, atëhere të gjithë ata që nuk punojnë tokën, — zotërinjtë, lakejtë, gjellëbërësit, nëpunësit, shkruesit, me një fjalë të gjithë njerëzit e qytetit — do ta merrnin pjesën që u takonte dhe do t'ua shitnin të pasurve. Dhe ja, toka do të grumbullohej përsëri në duart e pasanikëve. Kurse ata që, me shtimin e frymëve do të kishin përsëri nevojë për tokë, nuk do të kishin se ku ta merrnin, meqenëse toka qe ndarë. Kështu, pasanikët do t'i kishin përsëri në dorë ata me tokë të paktë.

— Ashtu, si urdhëron! — u ngut të thoshte ushtari.

— Ahere të ndalohet shitja e tokës dhe t'i jepet vetëm atij që e punon! — tha sobabërësi, duke ja prerë fjalën përmes ushtarit me të rreptë.

Por edhe këtë radhë Nekludovi kundërshtoi duke thënë se nuk kishte mundësi të kontrollohej a e punonte njeriu tokën për hesap të tij apo për ndonjë tjetër.

Atëhere muzhiku i gjatë, më i mënçuri nga të gjithë, propozoi që toka të punohej bashkërisht nga arteli.

— Secili të marrë sipas punës që bën dhe ai që s'punon të mos marrë gjë hiç! — tha ai me basin e tij të prerë e të vendosur.

Nekludovi, që e kishte parashikuar edhe këtë projekt komunist, i kishte pregatitur që më parë argumentet për ta hedhur poshtë. Ai tha se për këtë duhej që të gjithë të kishin plugjet e tyre, që kuajt t'i kishin të gjithë njëlloj e asnjeri të mos mbetej pas nga shokët, ose duhej që si plugjet,

ashtu dhe kuajt, ashtu dhe maqinat shirëse, me një fjalë, tërë ekonomia të qe e përbashkët. Por, që të arrihej kjo, duhej që të gjithë njerëzit të qenë në një mëndje.

— Tanët s'bien në një mendje kurrë, — tha plaku çehrengrysur.

— Do të kërcasë një sherr që ç'ke me të! — tha plaku me mjekër të bardhë e me sytë që i shkëlqenin. — Pa kur të shohësh gratë se si të kapen nga leshrat!

— Pastaj edhe një gjë tjetër: në ç'mënyrë ta ndash tokën sipas cilësisë? — tha Nekludovi — Përse disa të marrin çernozjon, kurse disa të tjerë argjilë apo rerë?

— Po të ndahet në ngastra që ta kenë të gjithë njëlloj, — tha sobabërësi. Nekludovi e kundërshtoi edhe këtë mendim duke thënë se nuk qe fjala për ndarjen e tokës vetëm në një shoqëri, por për ndarjen e tokës në përgjithësi ndërmjet gubernave të ndryshme. Gjersa toka do t'u jepej falas tërë fshatarëve, përse disa ta merrnin të mirë e disa të keqe? Të gjithë duan të marrin tokë të mirë.

— Ashtu, si urdhëron! — tha ushtari.

Të tjerët heshtnin.

— Pra, siç e shikoni, kjo punë nuk është dhe kaq e thjeshtë sa duket, — tha Nekludovi. — Dhe jo vetëm ne, po ka edhe shumë të tjerë që e kanë menduar. Dhe një amerikan, Xhorxh i thonë, ja se ç'ka menduar dhe unë jam plotësisht në një mëndje me të.

— Ti je vet zot, jepe në ke për ta dhënë, ç'e zgjat? Kush do të të kërkojë hesap? — tha plaku i rreptë.

Kjo ndërprerje e beftë e turbulloi një çast Nekludovin, por vuri re i kënaqur se s'kish qënë vetëm ai që e kishte gjetur pa vend.

— Po prit një herë, Semjon, lere të flasë! — tha muzhiku i mënçur me atë zërin e tij të vendosur.

Kjo i dha zemër Nekludovit dhe ai nisi të shpjegojë projektin e taksit unik sipas Henri Xhorxhit.

— Toka s'është e askujt, është e zotit, — nisi të thotë.

— Posi, ashtu është! Tamam ashtu! — u dëgjuan zërat e fshatarëve.

— Toka është një pasuri e përbashkët. Të gjithë kanë të drejta të barabarta mbi të? Po ka tokë që është më e mirë, ka tokë që është më e keqe. Dhe secili kërkon të marrë tokën e mirë. Po atëhere si duhet vepruar që ndarja të bëhet e barabartë? Duhet vepruar kështu: ai që ka tokë të të mirë, t'i paguajë atij që s'ka aq sa i bën toka, — tha Nek-

ludovi duke u përgjigjur vetë pyetjes që i kishte bërë vetes. Dhe meqënëse është e vështirë të përcaktohet kush duhet të paguajë e kujt duhet t'i paguajë e duhen mbledhur, nga ana tjetër, edhe të holla për nevoja shoqërore, atëhere të bëhet në mënyrë që ai, i cili zotëron tokë, t'i paguajë shoqërisë vlerën e tokës së tij. Kështuqë të gjithë do të jenë barabar. Do të marrësh tokë? Në e do të mirë, do ta paguash më shumë; në e do të keqe, do ta paguash më pak. Në s'do fare, atëhere, s'ke pse të paguash, sepse taksën për nevojat shoqërore do ta paguajnë për ty ata që kanë tokë.

— Kjo është e drejtë, — tha sobabërësi duke lëvizur vetullat. — Domosdo, se ai qe e ka më të mirë tokën, duhet të paguajë më shumë.

— Po pagesa të jetë sipas takatit... — tha muzhiku i gjatë që, me sa dukej, e, parashikonte se ku do të arrinte puna.

— Ama burrë me mënd ky Xhorxhi! — tha plaku i pashëm.

— Pagesa nuk duhet të jetë as shumë e vogël, as shumë e madhe... Po të jetë e madhe, do të ketë nga ata që nuk do të jenë në gjendje ta përballojnë, po të jetë e vogël, atëhere të gjithë do të fillojnë të blejnë nga njeri tjetri, d.m.th. ta përdorin tokën si mall për tregëti. Ja, pra, pikërisht kështu mendoj të veproj edhe unë.

— Mirë e ke, ashtu do bërë si thua ti, e drejta kështu e do! — thanë muzhikët.

— Ama burrë me mënd, ky Xhorxhi, — përsëriti plaku shpatullgjërë me mjekër. — Shiko, mor qerratai, si e ka gjetur!

— Po si i bëhet nëqoftëse edhe unë dua të marr tokë? — pyeti administratori, duke buzëqeshur.

— Po pati ndonjë parcelë të lirë, merreni dhe punojeni! — tha Nekludovi.

— Ç'e do tokën ti? Pak je majmur gjer tani! — tha plaku me fytyrë të dobët.

Me kaq mbledhja mori fund.

Nekludovi e përsëriti edhe një herë propozimin e tij, por nuk kërkoi një përgjegje aty për aty, duke u lënë kohë fshatarëve të këshilloheshin më parë me fshatin.

Fshatarët thanë se do ta bisedonin punën edhe me të tjerët e do t'i kthenin përgjegje. Pastaj e përshëndetën dhe u ndanë shumë të tronditur. Zhurma e madhe dhe muhabetet e tyre të gjalla u dëgjuan në rrugë për një kohë të

gjatë, gjersa u larguan. Por një gumzhimë zërash që vinte nga fshati e përhapej mbi lumë u dëgjua edhe në mbrëmje.

Të nesërmen fshatarët nuk punuan, por shqyrtuan propozimin e barinit. Fshati u nda në dy parti: njera që mendonte se propozimi i barinit duhej pranuar sepse u leverdiste e nuk paraqeste për ta ndonjë rrezik; tjetra që thoshte se barini u kish pregatitur një kurth nga i cili duhej ruajtur se duhej të qe shumë i rrezikshëm gjersa nuk arrin ta kuptonin. Por, megjithatë, ditën e tretë të gjithë ranë më në fund dakord për t'i pranuar kushtet e Nekludovit dhe i njoftuan atij, n'emër të fshatit, verdimin që kishin marrë. Në këtë ndikuan edhe fjalët e një plake që tha se barini ndofta vepronte ashtu ngaqë kishte bërë shumë mëkate në këtë dynja dhe donte t'i lante duke bërë të mira. Ky shpjegim, që nuk linte pikë dyshimi për sinqeritetin e qellimeve të barinit, përforcohej edhe nga lëmoshat e mëdha në të holla që kishte bërë nder të varfër Nekludovi kur erdhi në Panovo. Ai qe shtyrë t'i bënte këto lëmosha nga ajo shkallë ekstreme varfërie e mundimesh që vinte re për herë të parë tek fshatarët. I prekur thellë nga kjo varfëri, sadoqë e kuptonte se nuk qe e arësyeshme ajo që po bënte, ai nuk mundi të mos u shpërndajë atyre një pjesë nga të hollat që kishte grumbulluar nga shitja e pyllit një vit më parë në Kuzminskoje dhe nga paradhënia që kishte marrë për shitjen e inventarit.

Porsa u muarr vesh që barini u jepte të holla të gjithë atyre që i kërkonin, turma të tjera me njerëz, ku shumicën e përbënin sidomos gratë, u çkulën nga an'e anës dhe erdhën tek ai duke iu lutur që t'u vinte në ndihmë. Ai nuk dinte se si të vepronte dhe çfarë kriter të ndiqte në shpërndarjen e të hollave: kujt t'i jepte e sa t'i jepte. E ndjente që nuk bënte të mos u jepte atyre që i kërkonin, aq më tepër kur të hollat tani nuk i mungonin dhe i kishte bile me shumicë. Po, nga ana tjetër, t'u jepte rastësisht vetëm atyre që do t'i kërkonin, kjo nuk kishte kuptim. Pra, mënyra e vetme për të dalë nga ajo gjendje ishte që të largohej që andej sa më parë. Dhe ai u largua.

Ditën e fundit, që qëndroi në Panovo, Nekludovi shkoi në shtëpinë e tetove dhe u muarr atje me sistemimin e disa plaçkave të tyre në një dollap të moçëm prej druri të kuq e me vegëza bronzi që përfytyronin një kokë luani. Atje

ai gjeti në një sirtar një tok letrash e, ndërmjet tyre, një fotografi që paraqeste një grup ku bënte pjesë: Sofia Ivanovna, Maria Ivanovna, ai vetë student dhe Katjusha e bukur, e veshur pastër, me një fytyrë të hijëshme, të freskët e plot gjallëri. Nga të gjitha plaçkat, që ndodheshin në shtëpi, ai mori vetëm letrat dhe atë fotografi. Të tjerat ja la mullisit të fshatit që, me ndërmjetësinë e administratorit, e bleu tërë shtëpinë e Panovos bashkë me mobiljet me një të dhjetën e çmimit.

Duke sjellur ndërmend tani ndjenjën e keqardhjes për humbjen e pronave që kishte provuar në Kuzminskoje, Nekludovi habitej se si kishte mundur ta provonte atë ndjenjë; tani përkundrazi ai provonte një ndjenjë të herëshme çlirimi, një ndjenjë kënaqësie pak a shumë si ajo që duhet të provojë një udhëtar që zbulon për herë të parë një tokë të re.

X

Qyteti i bëri këtë radhë Nekludovit një përshtypje të madhe. Ai arriti në stacion aty nga mbrëmja, kur fenerët nëpër rrugë porsa qenë ndezur. Mori një karrocë dhe shkoi drejt e në shtëpi. Dhomat vazhdonin të binin erë naftalinë dhe Agrafena Petrovna, bashkë me Kornejin, dukeshin të lodhur e të këputur. Që të dy qenë shumë të pakënaqur nga ajo punë që kishte për qëllim sistemimin e disa plaçkave që s'i hynin më asnjeriut në punë dhe që laheshin, thaheshin, hekuroseshin e viheshin nëpër vende fare kot. Dhoma e Nekludovit qe e lirë, por akoma nuk qe fshirë e rregulluar siç duhej. Koridoret qenë zënë nga sepetet e nga gjithfarë rangulla të tjera kështu që ardhja e Nekludovit ndodhte në një kohë fare të pavolitëshme dhe. nga ana tjetër, pengonte gjer diku atë veprimtari të ethëshme që zhvillohej, nën efektin e një inercie të çuditëshme, n'atë shtëpi. Ajo punë e çmëndur, që bëhej atje, në të cilën edhe vetë Nekludovi kishte patur pjesë dikur, pas tërë atyre që kishte parë në fshat, i ngjallën atij këtë radhë një ndjenjë pështirimi. Ai vendosi të shkonte që të nesërmen në hotel duke ja lënë Agrafena Petrovnës rregullimin e shtëpisë, ashtu siç do ta shihte më të arësyeshme gjersa të vinte e motra, që do të vendoste një herë e mirë si do bëhej.

Nekludovi dolli të nesërmen që në mëngjes dhe, si zuri me qira nja dy dhoma me orendira të varfëra e jo fort të paqme në një hotel n'arfërsi të burgut, dha urdhër që t'ja shpinin atje plaçkat e u nis për te avokati.

Jashtë bënte ftohtë. Pas shtrëngatave dhe shirave që kishin rënë me bollek gjer ahere, moti qe ftohur e kishin filluar ngricat ashtu siç fillojnë zakonisht në pranverë. Të ftohtit qe kaq i madh dhe frynte një erë kaq e fortë dhe çponjëse sa që Nekludovi ngriu i tëri ndën pallton e lehtë që kishte veshur dhe i shpejtoi hapat që të ngrohej.

I kujtoheshin tërë kohës njerëzit që kishte parë në fshat: gratë, fëmijët, pleqtë dhe gjëndja e tyre e mjeruar të cilën, sikur të mos e kishte parë vetë me sy, nuk do ta kishte besuar mbase kurrë. I dilte përpara ajo foshnja me fytyrë plaku, me këmbët si skelet që ngërdheshej nga vuajtja e dukej sikur buzëqeshte. Dhe, ja, pa dashur, ai i krahasonte të gjitha këto me ato sa shihte tani në qytet. Duke kaluar pranë dyqaneve të kasapëve, të bakajve, të tregëtarëve të manifaturës, ai habitej, sikur qe hera e parë që i shikonte, se sa mirë qenë ushqyer tërë këta njerëz e sa mirë mbaheshin me ato rrobat e tyre të shtrenjta e të pastërta. Jo, në fshat s'të zinte kurrë syri ndonjë si ata! Këta njerëz qenë, pa dyshim, plotësisht të bindur se puna që bënin duke përfituar nga mirëbesimi i atyre që ua blinin mallin pa e njohur, nuk duhej përbuzur aspak po, përkundrazi, duhej çmuar si një punë shumë e dobishme. Po aq të ushqyer mirë si ata dukeshin edhe karrocierët me bythë të gjëra dhe me kopsa në kurriz, si edhe portierët në dyert e shtëpive llukoze me kapela në kokë dhe me shirita të qëndisur në krah, po ashtu edhe kamarierët më përparëse dhe me flokët «permanent» e po ashtu, dhe veçanërisht, karrocierët privatë të qethur shkurt që rrinin duke u lëkundur në karrocat e tyre e që u hidhnin këmbësorëve një vështrim përbuzës dhe të djallëzuar. Midis këtyre njerëzve atij i dukej se shikonte një nga ata fshatarët që kishte mbetur pa tokë dhe që skamja pastaj e kishte degdisur në qytet. Disa syresh kishin ditur t'u ambientoheshin kondita ve të qytetit, të përfitonin nga këto kondita e t'u ngjanin deri diku zotërinjve; të tjerët që, qenë treguar të pa zotë në këto kushte të reja, qenë katandisur përkundrazi edhe më keq se sa qenë në fshat. Të tillë ishin, sipas mendimit të Nekludovit, ca mballomaxhinj që i kishte vënë re në dritaren e një podrumi; të tilla qenë ato rrobalarëset kockë e lëkurë, të zbeta, të rraskapitura që he-

kurosnin me llërët pa mish të përvjelura përpara dritareve të hapura që nga përhapej jashtë një erë e rëndë sapuni. Të tillë qenë edhe nja dy bojaxhinj, që ecnin zbathur të lyer këmbë e kokë me bojë që Nekludovi hasi rrugës. Me krahët e tyre të pafuqishme, të nxira nga dielli e me damarë, me mëngët përveshur gjer mbi bërryl, ata mbanin në kurriz nga një kovë me bojë dhe grindeshin or'e çast. Fytyrat e tyre kishin një çehre të vojtur e të rreptë. Po atë çehre kishin edhe fytyrat e zeza e të pluhurosura të punëtorëve që ngisnin qerret e rënda me mall. Po atë çehre kishin edhe fytyrat e buhavitura të burrave e të grave të rreckosura që lypnin nëpër qoshet e rrugicave. Dhe po atë çehre kishin gjithashtu fytyrat që dukeshin përmes dritareve të hapura të një mehaneje pranë të cilës Nekludovi kaloi. Disa njerëz me fytyra të dirsura, të skuqura e të shushatura rrinin rreth tryezave të ndyta me shishe të zbrazura e me takëmet e çajit dhe, ndërsa kamarierët me rroba të bardha silleshin lart e poshtë duke u tundur, duke u penguar aty këtu në ndonjë karrige, ata thërrisnin e këndonin si të përgjumur. Njeri që kishte zënë vend tamam përballë dritares, shikonte diku përpara dhe sakaq i ngrinte vetullat e i varte buzët sikur diç kishte harruar e mundohej ashtu ta kujtonte.

«Përse janë mbledhur që të gjithë këtu?» — pyeste vetvetiu veten Nekludovi duke thithur, bashkë me pluhurin që ngrihej nga era, edhe erën e fortë që lëshonte vaji i një ndërtese të lyer rishtazi.

Ndërsa po kalonte në një rrugë, e arriti një karvan qerresh që transportonin një ngarkesë hekuri. Rrotat e gërvishnin kalldrëmin me një zhurmë kaq shurdhonjëse sa ai, për një çast, u shushat. Ndërsa po e zgjaste hapin që t'i dilte karvanit në krye, dëgjoi befas, përmes zhurmës së hekurave, se dikush po e thërriste. U ndal dhe pa, disa hapa më përpara, një ushtarak me mustaqe të holla, me majë e të hekurosura dhe me një fytyrë të qeshur e të ndritëshme që dukej si e llustruar. Ushtaraku i panjohur, kishte hipur në një karrrocë elegante dhe përshëndeste me dorë duke zbuluar me një buzëqeshje një sërë dhëmbësh shumë të bardhë.

— Nekludov! Ti je?

Ndjenja e parë që e pushtoi Nekludovin ishte një ndjenjë kënaqësie.

— A! Shenbok! — thirri ai i gëzuar por, aty për aty, e kuptoi që nuk kishte përse të gëzohej.

Ishte pikërisht ai Shenboku që kish ardhur tek tetot. Nekludovi kishte kohë që nuk e kishte parë, por kishte marrë vesh se, me gjithë borxhet e shumta, pasi qe larguar nga këmbësoria për të hyrë në repartet e kalorësisë, e kishte marrë prapë veten dhe, s'dihej se si, bënte përsëri një jetë mondane në rrethin e njerëzve të pasur. Këto të thena ja përforconte tani më së miri edhe fytyra e tij e qeshur dhe e kënaqur.

— Sa mirë që të kapa! Këtu në qytet tani s'ka mbetur hiçnjeri. Hej, or burrazer, po qënke mplakur! — tha ai duke këcyer poshtë nga karroca e duke i dhënë trupit përpjetë. Vetëm nga të ecurit të njoha. E po, a do të hamë drekë bashkë? Mos di ku ka këtu ndonjë restorant për të qënë?

— Nuk e di a do të kem kohë, — u përgjegj Nekludovi, që mendonte vetëm si e si të hiqte qafe shokun por pa e fyer. Po ti ç'do këtu? — e pyeti.

— Me punë kam ardhur, or vëlla, me punë! Me punët e tutelës. Se, besoj, e ke marrë vesh: jam bërë tutor. Punoj për llogari të Samanovit, të atij pasanikut, mbase e njeh. Një ramoli [1]) i tërë! Po tokë s'ka pak, se i bëhen nja pesëdhjetë e katër mijë disjatina! — tha Shenboku me një krenari të veçantë, sikur i kishte bërë ai vetë të giitha ato disjatina. Gjendja e çifligarëve është e mjeruar. Toka ishte e tëra në duart e fshatarëve. Ata s'paguanin hiç gjë, vetëm me taksat e prapambetura bëheshin ndonja tetëdhjetë mijë, në mos më tepër, po unë iu vura kësaj pune dhe, që thua ti, pa mbushur vitin, e përmbysa situatën. I rrita të ardhurat gjer në shtatdhjetë përqind. He, si të duket? — pyeti ai me mburrje.

Nekludovit iu kuitua se për Shenbokun flitej që tutelën e pasurisë së një çifligari të madh të shkatërruar ja kishte ngarkuar një njeri me influencë duke e ditur se kishte shumë borxhe dhe s'ishte në gjendje që t'i paguante. Pra, s'kishte dyshim se Shenboku rronte tani me të ardhurat që nxirrte nga tutela.

«Si të ndahesh prej tij pa e fyer?» — mendonte Nekludovi duke hedhur herë-herë sytë nga fytyra e tij e majmur me mustaqe spic dhe duke dëgjuar atë llomotitje të përçarme, ku bëhej fjalë për një restorant të mirë dhe për nië çiftë, ku bëhej fjalë për një restorant të mirë dhe për nië çiflik të shkatërruar kreit të cilin ai, siç thoshte me mburrje, e kishte ngritur në këmbë.

---

1) i currufjasur (frengj.)

— Atëhere si do vendosim? Ku ta hamë drekën?

— Të thashë se s'kam kohë! — iu përgjegj Nekludovi duke parë orën.

— Atëhere, shiko, do bëjmë kështu. Eja sonde në vrapimet. Atje takohemi? Mirë?

— Jo, nuk vij dot.

— Jo, jo, do vish! Unë kuaj të mi nuk kam, por luaj për ato të Grishinit. A të kujtohet Grishini? Stalla e tij tani është një nga më të mirat. Atëhere, pra, kështu, do vish; dhe darkën e hamë bashkë.

— Jo, s'të vij dot as për darkë, — tha Nekludovi duke buzëqeshur.

— Si kështu? Po tani ku po shkon? Do të të shpie me karrocë?

— Tek avokati. Po është këtu afër, në të kthyer të rrugës, — tha Nekludovi.

— Aha, harrova fare, ti tani sikur merresh me burgje. U del zot të burgosurve më kanë thënë. Nga Korçaguinët e mora vesh, — tha Shenboku duke qeshur. — Ata tani s'janë këtu, kanë ikur. Po, hë, më thuaj, si është puna?

— Po, po, ashtu është vërtet, — u përgjegj Nekludovi — po ç'të të tregoj. S'janë gjëra që mund të thuhen në rrugë!

— Po, po... Ti kështu ke qënë gjithmonë, i çuditshëm. Atëhere, si e lamë? Do të vish në vrapimet?

— Jo, të thashë, nuk vij dot dhe as që kam qejf të vij. Po, të lutem, ti mos u zëmëro.

— Jo, pse do të zëmërohem? Po me shtëpi ku rri? — pyeti ai dhe, befas, fytyra e tij u bë serioze, sytë vështruan diku ngultas pa lëvizur, vetullat u ngritën përpjetë. Me sa dukej, diç deshte të sillte ndërmend. Nekludovi vuri re një fytyrën e tij po atë shprehje idiote që i kishte rënë në sy te burri me vetulla të ngritura e me buzë të varura që kish parë në dritaren e mehanes.

— Shumë ftohtë bën, apo jo?

— Po, po.

— Plaçkat që blemë, ti i ke? — Ju drejtua ai karrocierit.

— Me kaq, hajt, lamtumirë; jam shumë, shumë i gëzuar që të takova, — tha Shenboku dhe, si ja shtrengoi fort dorën Nekludovit, kërceu në karrocë, duke tundur përpara fytyrës që shkelqente atë dorën e tij të gjërë veshur në një dorashkë të bardhë kamoshi të re e duke zbuluar me një buzëqeshje të zakonëshme dhëmbët shumë të bardhë.

«Kështu kam qënë edhe unë, si ai?» — mendonte Nek-

ludovi, ndërsa vazhdonte rrugën për të shkuar tek avokati. Ndofta jo tamam si ai, po të paktën ashtu kam dashur të bëhem duke kujtuar se ashtu do ta kaloja tërë jetën».

XI

Avokati e priti menjëherë Nekludovin dhe, duke hyrë drejtë e në temë, i foli për punën e Menshovëve, të cilën e kishte shqyrtuar shumë i revoltuar nga akuza që, sipas tij, duhej konsideruar krejt pa bazë.

— Nuk ke si të mos revoltohesh përpara një padrejtësie të tillë! — tha ai. — Ka të ngjarë që zjarrin ta ketë vënë pronari vetë për të marrë shpërblim nga zyra e sigurimeve por, sidoqoftë, çështja nuk qëndron këtu. Ajo që ka rëndësi është se faji i Menshovëve nuk është provuar n'asnjë mënyrë. Nuk ka asnjë provë kundër tyre. Kjo mund të shpjegohet vetëm me zellin e tepruar të gjykatësit hetues dhe pakujdesisë që ka treguar në këtë mes prokurori. Por, po të jetë se kjo çeshtje do të gjykohet këtu e jo në distrikt, zotohem ta marr vetë mbrojtjen përsipër pa ndonjë shpërblim dhe jua them që tani se do të fitojmë gjyqin. Tani, për sa i përket çeshtjes tjetër, lutjes për falje të Fedosia Birjukovës, drejtuar perandorit, lutja është gati. Po të shkoni në Peterburg merreni me vete, dorëzojeni dhe ndiqeni vetë. Se nuk është çudi t'i kalojë për shqyrtim ministrisë së drejtësisë dhe, po u ra atyre në dorë, ahere s'kemi gjë në vijë, se ata do gjejnë rrugën më të shkurtër për ta hequr qafet, d.m.th. nuk do ta marrin parasysh. Prandaj ju përpiquni që kjo çështje të shqyrtohet nga një instancë e lartë.

— Nga perandori?

Avokati qeshi.

— Jo, ajo është instanca më e lartë. Po instanca e lartë është, fjala vjen, sekretari i komisionit të faljeve ose, fundja, edhe zëvëndësi i tij. Dhe me kaq, sikur mbaruam?

— Jo, kam edhe një letër nga sektaitët... — tha Nekludovi, duke futur dorën në xhep. Nëqoftëse janë të vërteta këto që më shkruajnë, kjo është vërtet për t'u habitur. Sot do të mundohem të takohem me ta dhe ta shoh më afër këtë punë.

— Ju, me ç'po shikoj, jeni bërë ai muslluku, të themi kështu, që nga rrjedhin jashtë të giitha ankesat e burgut, — tha avokati duke vënë buzën në gaz. — Po janë shumë dhe nuk di a do t'ja dilni dot në krye...

— Jo, po kjo është vërtet një gjë e tmerrshëme! Ja, gjykoni edhe vetë, — tha Nekludovi dhe nisi të tregojë shkurtimisht thelbin e çështjes: disa njerëz në fshat mblidhen për të lexuar ungjillin. Vijnë atje autoritetet dhe i shpërndajnë. Po të djelën tjetër ata mblidhen prapë. Atëhere vjen këtë radhë komisari i policisë, i cili mban një proçes-verbal dhe i padit në gjyq. Hetuesia bën hetimet, prokurori shkruan akt-akuzën, gjyqi e aprovon akuzën dhe të pandehurit gjykohen. Sipas kërkesës së prokurorit, që e dokumenton pretencën e tij edhe me anë të ungjillit që iu gjet të pandehurve, gjyqi vendos dënimin e tyre me internim. Kjo është një gjë e tmerrëshme, — tha Nekludovi. — Sikur nuk të besohet...

— Nuk kuptoj ç'ka në këtë mes për t'u habitur?

— Po si të mos habitesh? Mirë komisari, sepse atë ashtu e kanë urdhëruar, po prokurori që shkroi proçes-verbalin. Ai është edhe një njeri me shkollë!

— Ja pikërisht këtu qendron gabimi, se neve na është bërë zakon të mendojmë që prokurori dhe të gjithë gjykatësit në përgjithësi janë, si të thuash, njerëz të rinj me pikëpamje liberale. E drejta është se ata dikur kështu kanë qënë vërtet, por tani janë krejt ndryshe. Tani nuk janë tjetër veç disa nëpunës të thjeshtë që përkujdesen vetëm për datën njëzet të çdo muaji, kur marrin rrogën që, natyrisht, lakmojnë ta kenë sa më të madhe. Dhe ja në këtë përmbledhen të gjitha parimet e tyre. Ai që akuzohet, gjykohet e denohet a është fajtor apo i pafajshëm, për ta kjo s'ka asnjë rëndësi. Vetëm rrogën ta marrin në rregull në njëzet të çdo muaji, siç ju thashë...

— Po si është e mundur që të denohet, të internohet me ligjë një njeri vetëm e vetëm sepse ka lexuar ungjillin në një rreth shokësh?

— Jo vetëm të internohet, si thoni ju por edhe degdiset në Siberi, mjaft që të provohet se, duke lexuar ungjillin, pati guximin ta interpretojë në një mënyrë tjetër, d.m.th. në kundërshtim me kishën. Kjo cilësohet sei një fyerje kundrejt besimit orthodoks dhe, sipas nenit njëqind e nëndëdhjetë, ndëshkimi që parashikohet në këtë rast është pikërisht internimi.

— S'është e mundur!

— Është pikërisht kështu si ju them unë. Unë gjithmonë u them zotërinjve gjykatës, — vazhdoi avokati që i shikonte përherë me një mirënjohje të thellë. — Pse do të më

pyetni. Po sepse që mua, juve dhe të gjithë neve s'na kanë futur akoma në burg, kjo i detyrohet vetëm e vetëm shpirtgjërësisë së tyre. Si, duhet të dini, s'ka gjë më e lehtë ta privosh cilindoqoftë nga të drejtat dhe ta degdisësh ku të duash.

— Po qe kështu, po qe se gjithshka mvaret nga trilli i prokurorit dhe i personave të tjerë që e kanë në dorë ta zbatojnë apo të mos e zbatojnë ligjin, përse është atëhere gjyqi?

Avokati qeshi me të madhe.

— Pyetje që bëni! Kësaj, or baba, i thonë fillozofi. Por, natyrisht, edhe për këtë mund të flitet. Ejani, po të doni, të shtunën. Do të takoheni këtu tek unë me njerëz të shkencës, me njerëz të letrave e me njerëz të artit. Atëhere do të mund të bisedojmë edhe për këto çështje të përgjithëshme, — tha avokati që i shqiptoi fjalët «çështje të përgjithëshme» me një pathos të veçantë dhe ironik. — Me gruan sikur njiheni?... Atëhere ejani pa tjetër!

— Po, do të mundohem, — u përgjegj Nekludovi duke e ndjerë se po gënjente dhe se do të mundohej përkundrazi të mos shkonte n'asnjë mënyrë n'atë mbrëmjen e avokatit, ku do të mblidheshin njerëz të shkencës, të letrave dhe të artit.

E qeshura, me të cilën e priti avokati mendimin e çfaqur nga Nekludovi se gjyqi nuk kishte asnjë rëndësi po të qe se gjyqtarët mund ta zbatonin apo të mos e zbatonin ligjin sipas qejfit të tyre dhe toni, me të cilin ai i shqiptoi fjalët: «filozofi» dhe «çështje të përgjithëshme» i dhanë të kuptojë Nekludovit se sa shumë ndryshonin pikëpamjet e tij nga ato të avokatit dhe, ndofta, edhe nga ato të miqve të tij. Ndonëse asgjë nuk e lidhte tanimë me shokët që kishte patur më parë, si fjala vjen me Shenbokun, Nekludovi ndjeu se aq më tepër nuk kishte më tani asgjë të përbashkët me avokatin dhe me njerëzit e rrethit të tij.

XII

Qe vonë dhe burgu ishte larg; prandaj, për të shkuar atje, Nekludovi mori një karrocë. Kur po kalonin në një rrugë, karrocieri, një mesoburrë me një fytyrë të hequr, u kthye nga Nekludovi dhe i tregoi një shtëpi të madhe që po ndërtohej.

— Shikoni sa e madhe është! Mal e jo shtëpi! — tha me mburrje, por edhe sikur qe ai fajtor që po ndërtohej.

Karrocieri kishte të drejtë: shtëpia që ndërtohej me një stil të ndërlikuar e jo të zakonshëm, ishte vërtet shumë e madhe. Një gardh i lartë prej pishash, e rrethonte ndërtesën nga të gjitha anët dhe e ndante nga rruga. Punëtorët tërë llaç silleshin lart e poshtë majë skelave e dukeshin së largu si miza dheu: disa ngrinin mur, disa sharronin dhoga, të tjerë zbritnin e ngjiteshin të ngarkuar me kova.

Një zotëri i shëndoshë, i veshur elegant, padyshim arkitekti, qëndronte përtej gardhit dhe, duke ngritur kokën lart, diç i tregonte asistentit që e dëgjonte me respekt të madh. Një varg qerresh shkonin të ngarkuara e ktheheshin bosh, duke kaluar fare afër arkitektit dhe asistentit të tij.

«Dhe sa të qetë janë që të gjithë, si ata që punojnë, ashtu edhe ata që i detyrojnë të punojnë. S'ka dyshim se të gjithë këta mendojnë se kryejnë një vepër të mirë. Grave të tyre në fshat, me barrë e të sëmura, u bie bretku në punë, fëmijëve të tyre, që u ka mbetur ndonjë kapuç i reckosur në kokë, u janë zbehur fytyrat nga vuajtjet e nga uria e duken sikur buzëqeshin, se ky pallat i kotë ngrihet pikërisht për një njeri idiot, i cili është një nga ata që i ka shkatërruar e grabitur; kjo, duket nuk u prish punë, nuk ua prish dot atë besimin e çmëndur që kanë në punën e tyre!» — mendonte Nekludovi duke kthyer kokën nga shtëpia.

— Kjo shtëpi është një budallallëk! — tha duke e shprehur me zë mendimin e tij.

— Si qenka një budallallëk? — ja ktheu karrocieri me inat. — Nuk thua shyqyr se s'mbeten njerëzit pa punë!

— Po është një punë e kotë...

— Meqë e ndërtojnë s'ka se si të jetë e kotë — foli karrocieri. — Po mos të ishin këto, me se do jetonte populli?

Nekludovi heshti, por ai nuk mund të dëgjonte nga shkaku i zhurmës që bënin rrotat. Pak më përpara se t'i afroheshin burgut, karrocieri doli nga kalldrëmi në një rrugë të asfaltuar, kështu që tani mund të bisedoje më lehtë. Ai e vazhdoi vetë i pari bisedën.

— Populli s'është grumbulluar këtë vit në qytet, ç'i do llafet! — tha karrocieri dhe, si u kthye nga Nekludovi, i tregoi me dorë një artel punëtorësh fshatarë me sharra, me sopata, me qyrqe të shkurtëra e me torba në krahë, që vinin për këtej.

— Më tepër nga vitet e kaluara? — pyeti Nekludovi.

— Ohu! Ku vitet e kaluara, ku këtë vit! Ja, bëj hesap, tani në një punë ku duhen dhjetë, ke dhjetëmijë! Pa po domosdo ata që e kanë punën në dorë, i vërvitin njerëzit si të jenë ashkla. Po, fundja, kanë edhe hak, se ku t'i shpien tërë ata?

— Po pse ndodh kështu?

— Po pse u shtuan. E ja, s'gjejnë dot vend.

— Dhe se u shtuan, po pastaj? Pse nuk qëndrojnë në fshat?

— E ç'të bëjnë në fshat? Tokë po s'ka.

Nekludovi ndjeu atë çast po atë që ndjen çdo njeri kur vritet në një vend që i dhëmb. Duket sikur diçka na shtyn ta mbajmë mëndjen në atë vend të sëmurë, por në të vërtetë s'është kështu dhe kjo ndodh vetëm pas një goditje më të ndieshme se të tjerat.

«Thua, po ajo gjëndje të jetë kudo?» — mendoi ai dhe nisi ta pyesë karrocierin se sa tokë kishte fshati i tyre, sa tokë kishte ai vetë dhe përse kishte ardhur në qytet.

— Ne, zotëri, tokë kemi një disjatinë për shtëpi. Bëhemi tre vetë, pa po bëj hesap vetë tani zotrote se sa na bie, — filloi të tregojë karrocieri. — Që thua ti, në shtëpi kam babanë, vëllanë dhe një vëlla tjetër ushtar. Ja ata merren me punët, po me se, hiç mos pyet, sepse s'kanë asnjë punë! Zaten njeri vëlla deshi të shkonte në Moskë.

— Po pse nuk merrni tokë me qira?

— E ku ma gjen dot ta marrësh me qira? Zotërinjtë, nga qenë e nga s'qenë, e bën fët të tyren! Dhe nga ata, aha, s'blen dot se i punojnë vetë. Andej nga ana jonë është një francez. I mori tokat nga zotnia ynë, mezallah se do t'i japë me qira!

— Cili francez?

— Djufar-francezi, mbase e kini dëgjuar. Punon në Teatrin e madh, ndreq paruka për artistët që punojnë atje. Ka punë të mirë, ndaj edhe u pasurua. E, siç të thashë, ja bleu zonjës sonë çiflikun. Tani në fshat atë kemi të parë. Bën si të dojë, njeri s'ja mban dorën. Pothua allaversen që është një bushtër ajo që zoti të të ruaj! I vjedh apo s'i vjedh fukarait, me të dy duart! Po sikur erdhëm: ja burgu. Ku t'ju zbres, te dera? Atje s'para lënë...

XIII

Duke menduar me zemër të dridhur dhe me tmerr se si do ta gjente këtë radhë Masllovën, kishte frikë gjithashtu përpara misterit që vinte re tek ajo dhe, në përgjithësi, në të gjithë të burgosurit e tjerë. Nekludovi i ra ziles në të hyrë të burgut. Derën ja hapi një gardian. Gardiani, si u informua, me kërkesën e Nekludovit, se ku ndodhej Masllova, e drejtoi në infermerinë e burgut. Roja e infermerisë, një plak i qetë e babaxhan, nuk i solli Nekludovit asnjë pengesë dhe, kur mori vesh se kë kërkonte të takonte, e përcolli menjëherë në pavjonin e fëmijëve.

Një mjek i ri, që lëshonte një erë të fortë acidi fenik, i doli përpara Nekludovit në koridor dhe e pyeti rëndë-rëndë se ç'farë dëshëronte. Ky mjek u bënte shumë lehtësira të burgosurve duke u grindur vazhdimisht për këtë me autoritetet e burgut si edhe me vetë kryemjekun. Prandaj, duke menduar se Nekludovi do t'i kërkonte ndonjë gjë që ishte në kundërshtim me rregulloren dhe, nga ana tjetër, duke dashur t'i tregonte se nuk bënte përjashtime për njeri, ai e hiqte tani veten sikur ishte me inat.

— Ne këtu s'kemi gra, ky është pavjoni i fëmijëve, — i tha.

— E di, por unë e kam fjalën për një të burgosur që e kanë caktuar këtu si infermiere.

— Kanë caktuar dy, jo një. Ju me cilën kërkoni të takoheni?

— Jam në marrëdhënie të ngushta me njerën prej tyre, me Masllovën, — tha Nekludovi — dhe desha ta takoj përpara se të shkoj në Peterburg, ku dua të bëj një apel për çështjen e saj. Pastaj desha t'i jepja edhe këtë. Nuk është veçse një fotografi e thjeshtë, — tha Nekludovi duke nxjerrë nga xhepi zarfin me fotografinë.

— Mirë, mirë, po jua plotësojmë dëshirën, — tha mjeku, që u zbut menjëherë dhe, si iu kthye një plake me përparëse të bardhë, i tha që të thërriste aty infermieren e burgosur Masllovën. — Po të doni mund të uleni, ose urdhëroni, fundja, në dhomën e pritjes.

— Ju falemnderit, — tha Nekludovi dhe, duke përfituar nga ai rast i favorshëm që ndodhej tek mjeku, e pyeti a qenë të kënaqur në infermeri nga Masllova.

— Çka, nuk punon keq, po të marrim parasysh edhe

kushtet në të cilat është ndodhur gjer tani, — tha mjeku — Po ja ku po vjen!

Atë çast u dha në derë plaka dhe, fill pas saj, Masllova. Ajo kishte veshur një fustan me kutija dhe, mbi të, një përparëse të bardhë. Kokën e kishte mbështjellur me shami, kështu që flokët nuk i dukeshin fare. Sapo e pa Nekludovin, u skuq e tëra në fytyrë, u ndal një hop si e pavendosur, pastaj vrënjti vetullat, uli sytë dhe u drejtua për nga ai me hapa të shpejta. Nekludovi nuk e kishte parë që nga biseda e fundit që kishte patur me të kur i kishte kërkuar ndjesë se nuk qe sjellur mirë. Ai mendonte se do ta gjente ashtu siç qe atëhere, po u gabua. Tani kishte një shprehje tjetër në fytyrë: më të përmbajtur, më të ndrojtur dhe, siç iu duk Nekludovit, më armiqësore kundrejt tij. Ai i përsëriti ato që i kish thënë më parë mjekut në lidhje me nisjen e afërt për në Peterburg dhe i dha zarfin me fotografinë që kish sjellë nga Panovo.

— E gjeta në Panovo. Është një fotografi e vjetër. Mbase do t'ju vijë mirë kur ta shikoni...

Ajo ngriti vetullat e zeza, e vështroi e habitur me sytë e saj vëngërosh sikur matej ta pyeste ç'rëndësi kishte tanimë për të ajo fotografi dhe, si e mori e heshtur zarfin, e fshehu nën përparëse.

— Pashë teton tuaj, — tha Nekludovi.

— E patë? — tha ajo me mospërfillje.

— Jeni mirë këtu? — pyeti Nekludovi.

— Çka, nuk jam keq, — tha ajo.

— Mos keni shumë punë?

— Jo, jo edhe aq. Po akoma nuk jam mësuar.

— U bë shumë mirë që erdhët këtu. Sidoqoftë, është shumë më mirë se atje.

— Ku «atje»? — tha ajo dhe u skuq menjëherë në fytyrë.

— Se atje në burg, — u ngut të thoshte Nekludovi.

— E pse është më mirë? — pyeti ajo.

— Po sepse unë mendoj që njerëzit këtu janë më të mirë. Nuk ka nga ata si atje.

— Edhe atje ka shumë njerëz të mirë, — tha ajo.

— Për Menshovët bëra ç'mos dhe besoj se do t'i lirojnë, — tha Nekludovi.

— Dhëntë zoti t'i lirojnë, se është një plakë shumë e mirë, — tha ajo duke përsëritur atë mendimin e saj për plakën dhe buzëqeshi lehtë.

— Sot nisem për në Peterburg. Çështja juaj do të shqyrtohet tani së shpejti, shpresoj se do të merren masa për anullimin e vendimit.

— Si ta anullojnë, si të mos e anullojnë, për mua tani nuk ka rëndësi, — tha ajo.

— Përse tani?

— Ashtu, — tha ajo, duke i hedhur atij një vështrim të shpejtë hetonjës.

Nekludovit iu duk se me ato fjalë dhe me atë vështrim ajo kërkonte të dinte a vazhdonte ai t'i qendronte besnik vendimit që kishte marrë apo kishte hequr dorë prej tij.

— Nuk po kuptoj dot përse për ju nuk ka rëndësi, — tha ai. — Për mua vërtet nuk ka asnjë rëndësi a do ta anullojnë ose jo. Sidoqë të bëhet puna, unë do të veproj ashtu siç ju kam thënë, — tha ai i vendosur.

Ajo ngriti kokën, i ndali një hop sytë e saj vëngërosh mbi fytyrën e tij e pastaj vështroi gjetiu, ndërsa fytyra sakaq i shkëlqente nga gëzimi. Por tha krejt të kundërtën e asaj që i shprehnin sytë.

— Këtë kot e thoni, — tha ajo.

— Jua them që ta dini.

— Ato që i thamë një herë s'kemi pse t'i zëmë prapë në gojë, — tha ajo duke përmbajtur me zor një buzëqeshje.

Në pavjon u dëgjua një zhurmë dhe, pas pak, një fëmi që qante.

— Po më thërresin më duket, — tha ajo duke kthyer kokën pas e shqetësuar.

— Atëhere, pra, lamtumirë! — tha ai.

Ajo bëri sikur nuk e vuri re dorën që ai i zgjati dhe nuk ja shtrëngoi. Pastaj i ktheu kurrizin dhe, duke u munduar ta fshihte triumfin e saj, u largua me hapa të shpejta nëpër koridor.

«Ç'po ndodh kështu me të? Çfarë mendon? Çfarë ndjen? Mos do të më vërë në provë apo me të vërtetë nuk mund të më falë? Nuk mund t'i thotë ato që mendon e që ndjen apo nuk do? Është zbutur kundrejt meje apo është egërsuar edhe më tepër?» — e pyeste veten Nekludovi dhe n'asnjë mënyrë nuk ishte në gjëndje t'i përgjigjej. Vetëm për një gjë nuk dyshonte: se ajo kishte ndryshuar, se në shpirtin e saj kishte ndodhur një ndryshim i rëndësishëm dhe ky ndryshim e afronte Nekludovin jo vetëm me Maslovën, por edhe me vetë atë, n'emërin e të cilit ky ndryshim kishte

ndodhur. Dhe pikërisht ky afrim e gëzonte, e entusiazmonte dhe e ngashëronte shumë.

Kur u kthye në dhomën e të sëmurëve me tetë shtretër të vegjël për fëmijë, me urdhërin e infermieres, Masllova nisi të rregullonte shtresat. Por, ndërsa shtrinte një çarçaf, u zgjat pak si tepër dhe mënd shkau. Një çunak, me qafë të lidhur që porsa qe ngritur nga shtrati, e vuri re dhe qeshi. Atëhere edhe Masllova s'e mbajti dot gazin dhe, si u ul në një cep të shtratit, shpërtheu në një të qeshur kaq të fortë dhe të çkujdesur sa i bëri edhe fëmijët e tjerë të qeshnin. Por infermjerja iu shkreh me të rreptë:

— Ç'qesh ashtu? Ku kujton se je këtu? Mos kujton se je atje ku ishe? Hajt, shko merr teshat!

Masllova heshti dhe, si i mblodhi enët, shkoi atje ku i thanë. Por, duke shkëmbyer një vështrim me çunakun me qafë të lidhur, e vuri prapë buzën në gaz. Tërë atë ditë, sa herë që mbetej vetëm, Masllova e nxirrte pak fotografinë nga zarfi dhe i hidhte një sy, por vetëm në mbrëmje, pasi mbaroi shërbimin dhe shkoi në dhomën e saj ku flinte bashkë me një infermiere tjetër, Masllova mundi ta shikonte më nge fotografinë. Ajo e nxori krejt nga zarfi dhe ja nguli sytë pa lëvizur për një kohë të gjatë duke vënë re me kujdes çdo tipar të fytyrave, çdo hollësi të veshjeve, të shkallëve, të luleve, në sfondin e të cilave spikatte qartë figura e tij, e saj dhe e tetove. E vështronte atë fotografi të zverdhur, të çngjyrosur nga koha dhe dukej sikur s'kishte të ngopur me bukurinë që zbulonte në të veçanërisht në fytyrën e saj akoma të njomë, të hijëshme e të freskët, me kaçurrelat e hollë që i binin lehtë mbi ballë. Dhe kaq shumë e vështronte saqë nuk e vuri re fare shoqen e saj kur hyri në dhomë.

— Ç'e ke atë? Ai ta dha? — e pyeti infermierja, një grua e trashë, duke u kërrusur mbi fotografinë. — Mos je ti ajo?

— Unë, po kush! — tha duke buzëqeshur Masllova.

— Po ky këtu? Po kjo, e ëma?

— Tetua. Po mirë, mua nuk më njohe? — e pyeti Masllova.

— E si do të të njihja? Kurrën e kurrës! Krejt tjetër fytyrë. E po domosdo, se kanë kaluar kaq vjetë që ahere!...

— S'e kanë fajin vitet, po jeta!... çfreu Masllova dhe befas tërë ajo gjallëri që e kishte pushtuar gjer atëhere, e

la. Një hije brënge ja mbuloi fytyrën, një rrudhë e thellë ja preu mespërmes ballin.

— Po pse, jeta «atje» duhet të ketë qenë e lehtë?

— Po, po, e lehtë, — tha Masllova, që mbylli sytë dhe tundi kokën. — Më keq nga katorga.

— Po përse, nuk e kuptoj?

— Ja ashtu. Nga ora tetë e mbrëmjes gjer në orën katër të mëngjesit. Dhe kështu çdo ditë.

— Po atëhere përse nuk ikin?

— Duan e duan të ikin, po kush i lë... Po ta mbyllim më mirë këtë bisedë! — tha Masllova dhe, si brofi në këmbë dhe e vërviti fotografinë në një sirtar të tryezës, vrapoi në koridor duke e përplasur derën, ndërsa sytë i përloteshin nga inati. Duke parë fotografinë ajo e kishte ndjerë veten ashtu siç ishte atje. Kish sjellur ndërmënd sa e lumtur qe atëhere, kish menduar sa e lumtur do të qe akoma tani, sikur ai të mos e kishte braktisur. Po fjalët e shoqes i kujtuan tjetër gjë. i kujtuan si qe tani, si kish qenë dhe çfarë kish qenë «atje» e, bashkë me këtë, tërë tmerrin e asaj jete të ndyrë të cilin e kishte ndjerë kaq a kaq herë në të turbullt, ndonëse s'kish guxuar t'ja pohonte kurrë vetes. Vetëm tani iu rikujtuan me një qartësi të jashtëzakonëshme të gjitha ato net të tmerrëshme dhe i doli si e gjallë përpara njera nga ato net, nata e karnevaleve kur priste me ankth një student, që i kish premtuar se do ta nxirrte që andej. Ju kujtua se si, me një fustan të kuq mëndafshi dekoltè e të fëlliqur me verë, me një fjongo të kuqe në kokë, me flokët e ngatërruara, e dërmuar, e rraskapitur, e dehur, pasi i përcolli klientët aty nga ora dy e natës, u lëshua mbi një karrige pranë gruas së hollë, të fishkur, që shoqëronte në pjano vjolinistin e kabaresë e se si kishin qarë hallet që të dyja për atë jetë të rëndë e të vështirë që bënin aty. Më vonë qe bashkuar me to dhe Klara e, që të trija, kishin vendosur ta braktisnin atë jetë. Kujtonin se atë natë po ndaheshin kur, papritmas, u dëgjuan në koridor ca zhurma dhe zërat e dehura të disa klientave të rinj. Vjolinisti nisi t'i bjerë përsëri vjolinës së tij të pa akorduar mirë, duke marrë me të shpejtë një fokstrot që luhet në figurën e parë të kuadriljes; ndërsa pjanistja po e shoqëronte. Një burrë trup vogël, i dirsur, që kundërmonte raki e rënkonte tërë kohën, me një kravatë të bardhë e frak të zi iu hodh Masllovës dhe e kapi, ndërsa një tjetër, i trashë, me mjekër, kapi Klarën... E kërcyen ashtu si të çmëndur me ritmin e një valle të

shpejtë, duke thirrur e duke pirë gjer në të gdhirë... Kështu kaloi një vit dhe pas tij një tjetër e një tjetër akoma... E si, pastaj, të mos ndryshojë?! Por fajin për të gjitha e kishte ai, ai e kishte marrë në qafë! Dhe përsëri në shpirtin e saj gufoi marazi i vjetër kundër tij, një mëri e egër që desh të çkrehej, të çfrynte... Tani i vinte keq që s'kish ditur të përfitonte nga rasti atë ditë që t'ja thoshte edhe një herë në fytyrë e të mos lejonte kurrë që të abuzonte me shpirtin e saj ashtu siç kishte abuzuar me trupin e të hiqej sakaq si njeri shpirtmirë e fisnik. Tani s'i mbetej rrugë tjetër veç ta mbyste në alkol keqardhjen e thellë që ndjente për veten, qortimin e pazot kundër tij që i lëvrinte në shpirt dhe e çponte dhe s'e linte rehat... Dhe në burg të kish qenë do të kish pirë, sidoqë kish marrë vendim të mos pinte më kurrë. Po atje për alkol duhej t'i drejtoheshe ndihmësmjekut dhe atij ajo s'guxonte t'i kërkonte, se e dinte që i vardisej. Tani çdo marëdhënie me burrat e neveriste. Si ndënji një kohë mbi një fron në koridor, ajo u kthye në dhomën e saj dhe, pa shkëmbyer më asnjë fjalë me shoqen, ra përmbys mbi shtrat e qau për jetën e saj të shkatërruar.

XIV

Në Peterburg Nekludovi kishte këto tri punë: të ndiqte apelin e Masllovës në senat, të interesohej për çështjen e Fedosja Birjukovës pranë komisionit të faljeve dhe, sipas porosisë që i kishte dhënë Vera Bogoduhovskaja, të ndërhynte në komandën e xhandarmërisë ose pranë Seksionit të Tretë për lirimin e Shustovës nga burgu dhe për nxjerrjen e një autorizimi për t'ëmën e një të burgosuri tjetër, që mbahej në kështjellën e Petropavlovskut, që të takohej me të birin. Për këtë çështjen e fundit Vera Bogoduhovskaja i shkruante posaçërisht një pusullë që i kish dërguar aty para ca kohe. Por që të dyja këto çështje, d.m.th. e treta dhe e katërta, përbënin për Nekludovin një çështje të vetme. Më në fund, Nekludovi do të interesohej në Peterburg edhe për punën e sektantëve, që i kishin internuar në Kaukaz sepse i kishin kapur ndërsa lexonin dhe komentonin ungjillin. Ai u kishte premtuar atyre e, më tepër, vetes së tij, se do të bënte çmos që ta sqaronte gjer në fund këtë çështje.

Që nga vizita e fundit që i kishte bërë Maslenikovit dhe, sidomos, fill pas udhëtimit në fshat, Nekludovi jo vetëm që nuk pajtohej më parimisht me ambjentin e tij, me atë ambjent ku kish bërë pjesë gjer ahere edhe ai vetë, por përkundrazi kishte filluar ta urrente me të gjitha fuqitë e shpirtit të tij, aq më tepër kur dinte se në këtë ambjent vuajtjet dhe mjerimet që u shkaktohen miliona e miliona njerëzve vetëm e vetëm për të siguruar rehatet e qejfet e disa pak të zgjedhurve janë fshehur me kaq merak sa edhe ata vetë nuk i shikojnë. Tani Nekludovi nuk mund të takohej me njerëzit e këtij ambjenti pa iu neveritur edhe vetvetja. Por, nga ana tjetër, atë e tërhiqnin në këtë ambjent zakonet që ishin rrënjosur thellë tek ai nga jeta që kish bërë më parë, e tërhiqnin lidhjet e gjakut e të miqësisë dhe, përmbi të gjitha, qëllimet që i kishte vënë tani vetes, d.m.th. t'i vinte në ndihmë Masllovës dhe të gjithë atyre njerëzve të tjerë që kishin nevojë për ndihmën e tij. Kështu, pra, dashur pa dashur, ai ishte i shtrënguar të përfitonte nga ndihma dhe nga favoret e njerëzve të këtij ambjenti, sidoqë nuk i çmonte dhe, për më tepër, i urrente.

Në Peterburg, Nekludovi shkoi e u vendos tek tetua e tij për nga e ëma, tek princesha Çarskij, e shoqja e një ish ministri. Duke banuar në shtëpinë e saj, ai u gjend tamam në qendrën e asaj bote aristokrate që ishte tani krejt e huaj për të. Kjo nuk i pëlqente por, nga ana tjetër, nuk kishte si të vepronte ndryshe. Sikur të shkonte në hotel, tetos do t'i mbetej qejfi dhe Nekludovi nuk do të mund të mbështetej më në përkrahjen e saj, që nuk ishte aspak për t'u nënvleftësuar, meqënëse tetua njihej e kishte lidhje të ngushta me njerëz që kishin influencë të madhe në të gjitha ato çështje për të cilat ai interesohej.

— Ç'kam dëgjuar ashtu për ty? Po bën gjera të çuditëshme, më kanë thënë! — i tha princesha Katerina Ivanovna që ditën e parë, ndërsa urdhëronte që t'i sillnin një kafe. — Vous posez pour un Howard![1]) Ndihmoni keqbërësit. Shkon nëpër burgje... Duket, po përkujdesesh për shpirtin.

— Kjo as që më shkon fare ndërmënd.

— Jo, jo, nuk e ke keq. Vetëm sikur ka këtu në mes diçka si një roman dashurie. Pa hë, pa më thuaj.

---

1) Ju e hiqni veten si një Hovard! (frëngj.)

Nekludovi i tregoi marrëdhëniet e tij me Masllovën, tamam ashtu siç qenë.

— E mbaj mënd, si nuk e mbaj mënd! Helena e shkretë diç më tha atëhere kur ti banoje tek tetot. Ato, më duket, sikur donin të të martonin me shërbëtoren e tyre (princesha Katerina Ivanovna i kish patur gjithmonë inat hallat e Nekludovit)... Domethënë, ajo është? Elle est encore jolie? [1]).

Tetua Katerina Ivanovna ishte një grua mbi të gjashtëdhjetat, e shëndoshë, e qeshur, energjike dhe llafazane. Nga trupi qe e lartë dhe shumë e plotë, mbi buzë i nxinte një push i hollë. Nekludovi kish ndjerë që së vogli për atë teto aq të qeshur dhe energjike një simpathi të veçantë.

— Jo, ma tante, [2]) tani çdo gjë ka marrë fund. Desha vetëm ta ndihmoj sepse e kanë dënuar pa të drejtë dhe sepse fajin për të gjitha, edhe për fatkeqësitë që pësoi në jetë, e kam unë. Prandaj ndjej se e kam për detyrë të bëj për të çmos.

— Por mua më kanë thënë sikur do edhe të martohesh me të?

— Është e vërtetë, por ajo nuk pranoi.

Katerina Ivanovna ngriti vetullat, i zgurdulloi sytë dhe e vështroi e habitur, pa thënë dot asnjë fjalë. Por befas fytyra e saj ndryshoi dhe mori një shprehje kënaqësie.

— Ja, e sheh? Ajo është më e mënçur nga ti! Ah, çfarë budallai! Po do të martoheshe vërtetë me të?

— Pa tjetër.

— Edhe duke e ditur se ç'ka qenë?

— Aq më tepër, gjersa faji është imi.

— Jo, jo, thuaj më mirë që je një makalush, — tha tetua duke e përmbajtur me zor veten që të mos qeshte. — Një makalush i tmershëm, por pikërisht se e di që je një makalush i tmershëm dhe të dua, — vazhdoi dhe dukej sheshit se, sipas mendimit të saj, vetëm ajo fjalë, më mirë se çdo fjalë tjetër, ishte në gjëndje të përcaktonte drejt cilësitë mendore dhe morale të nipit. — Po prapë je me fat, se Aline ka ndërtuar tani së fundi një azil për Madalenat që s'ka si të bëhet më i mirë. E pashë dhe unë, se shkova një ditë. Po të them, m'u pështiros. Me të dalë që andej, i bëra një banjë tërë trupit. Por Aline është dhënë pas kë-

---

1) Është e bukur akoma? (frëngj.)

2) Teto (frëngj.)

saj pune corps et âme [1]). Kështu që edhe atë tënden asaj do t'ja shpiem. Se, ose e ndreq Alina ose s'e ndreq dot njeri!

— Po s'ka se si se e kanë dënuar me katorga. Unë prandaj pikërisht për këtë kam ardhur, që të përpiqem për anullimin e vendimit. Kjo është çështja e parë për të cilën do t'ju lutesha të më ndihmonit.

— Aha, kështu qenka! Po, a nuk më thua, ku shqyrtohet çështja e saj?

— Në senat.

— Në senat? Po atje në senat kemi Lovushkën, cousin-in [2]) tim të dashur. Jo, më falë, ai është në departamentin e idiotëve. Kurse nga ata që janë atje, ku thua ti, s'njoh njeri. Një zot e di cilët janë. Ose janë gjermanë: Ge, Fe, De, me një fjalë tout l'alphabet [3]) ose janë ca Ivanovë, ca Semenovë, ca Nikitinë ose edhe Ivanenko, Simonenko, Nikitenko, pour varier [4]). Des gens de l'autre monde [5]). Po, sidoqoftë, do t'i them burrit. Ai i njeh. Ai të gjithë i njeh. Do t'i them. Po thuaj edhe ti dhe tregoja me hollësi se si qëndron puna, se me mua nuk merret vesh. Unë i flas e i flas, po ai hiçgjë s'kupton. C'est un parti pris [6]). Të gjithë kuptojnë, vetëm ai s'kupton.

Atë çast hyri në dhomë një lakè me çorape që solli mbi një disk të argjënd një letër.

— Po, po, nga Alina. Dhe ja sonde do të dëgjosh edhe Kizeveterin.

— Kizeveterin? Kush është ky?

— Kizeveteri? Ja, eja sonde që ta marrësh vesh kush është. Kur flet, ai, edhe ata keqbërësit më të tmerrshëm gjunjëzohen përpara tij dhe pendohen duke qarë.

Princesha Katerina Ivanovna, sadoqë kjo mund të dukej si një gjë shumë e çuditëshme e që nuk pajtohej, për më tepër, as me karakterin e saj, ishte një partizane e flaktë e një doktrine, e modës atë kohë, sipas së cilës esenca e fesë përmblidhej në besimin e thjeshtë dhe në shlyerjen e mëkateve me anë të pendesës. Ajo shkonte nëpër mbledhjet ku predikohej kjo doktrinë dhe mblidhte në shtëpi të saj ata që i besonin. Sadoqë kjo doktrinë i mohonte

---

1) Me mish e me shpirt (frëngj.)
2) Kushuriri (frëngj.)
3) Tërë alfabeti (frëngj.)
4) Sa për të ndryshuar (frëngj).
5) Njerëz të një shoqërie tjetër (frëngj.)
6) Një njeri që s'tundet nga mendimet e tij (frëngj.)

ritet fetare, ikonat e bile edhe misteret e fesë, në shtëpinë e princeshës Katerina Ivanovna ikonat i gjeje në çdo mur e kudo, sa edhe nën dyshekun e saj, dhe ajo vetë i kryente me përpikmëri të gjitha urdhërat e kishës, pa i rënë në sy aspak kontradikta që kishte në atë qendrim të dyanshëm.

— Ja, sikur ta dëgjonte ajo Madalena jote, ajo menjëherë do bëhej goxha vajzë, — tha princesha. — Po, sidoqoftë, ti shiko të mos mungosh! Është një njeri me të vërtetë i rrallë, ke për të parë!

— Mua këto gjëra nuk më interesojnë, ma tante.

— Jo, gabohesh, do të interesojnë. Dhe do vish pa tjetër, dëgjon? Pa, hë, tani, më thuaj, ç'do tjetër nga unë? Videz votre sac [1]).

— Kam edhe një punë në kështjellë.

— Në kështjellë? Atje është më lehtë se mund të jap një pusullë për baronin Krigsmuth. C'est un tres brave homme [2]). Po ti duhet ta njohësh. Ka qenë shok me babanë tënd. Il donne dans le spiritisme [3]). Po kjo s'prish punë se është burrë i mirë. Po s'më the ç'punë ke atje?

— Dua të marr një leje për një grua që do të takohet me të birin. Po më kanë thënë se këtë punë s'e ka në dorë Krigsmuthi, por Çervjanski.

— Ai Çervjanski s'para më pëlqen po, sidoqoftë, është burri i Mariettes. Ja themi asaj. Ajo mua nuk ma prish. Elle est trés gentille [4]).

— Pastaj, dua të pyes atje edhe për një grua tjetër. Ka disa muaj që e mbajnë atje, se përse asnjeri nuk e di.

— Eh, jo, jo. Le ta pyesin atë se ajo e di. E dinë, e dinë mirë ato. Dhe, meqë ra fjala, atyre kokëqethurave mirë u bëhet!

— U bëhet mirë apo keq, kjo s'dihet. Sidoqoftë, një gjë është e sigurtë: që vuajnë. Ju jeni e krishtere, i besoni ungjillit dhe, çudi, tregoheni kaq e pa mëshirë...

— Kjo s'ka të bëjë. Ungjilli është ungjill, kurse një gjë që të pështiros të pështiros e pikë. Më mirë kështu se sa të hiqem sikur i dua nihilistët dhe sidomos ato nihilistet kokëqethura, ndërsa në të vërtetë nuk i shoh dot me sy!

---

1) Zbrazeni thesin (frëngj.)
2) Është shumë burrë i mirë (frëngj.)
3) Merret me spiritizëm (frëngj.)
4) Është shumë e dashur (frëngj.)

— Po pse nuk i shihni dot me sy?

— Edhe pas një marsit më pyet përse?

— Po ka dhe nga ato që s'kanë marrë pjesë në një mars.

— Sidoqoftë, përse përzihen në çështje që s'u hyjnë në punë? Këto nuk janë punë për gra.

— Po, ja, për Marietten ju mendoni se mund të mirret me këto punë, — tha Nekludovi.

— Mariette? Marietta është Marietta. Kurse ato zoti e di se kush janë. Na ngrihet një Haltjupuinë e kërkon të na shesë mënd!

— Jo, nuk është fjala për të shitur mënd, por për t'i ardhur në ndihmë popullit.

— S'është nevoja të na e thonë ato, e dimë edhe vetë kush duhet ndihmuar e kush nuk duhet ndihmuar.

— Po, ndërkaq, populli vuan. Para se të vij këtu, isha në fshat. Ja, është e drejtë që muzhikët copëtohen në punë e rrinë pa ngrënë, kurse ne rrojmë në një lluks të tepruar? — tha Nekludovi, të cilin përzemërsia që tregonte tetua e nxiste pa dashur që t'i çfaqte dhe ai haptas mendimet e tij.

— Po ti mos do që unë të punoj e të mos ha gjë hiç?

— Jo, unë nuk dua që ju të mos hani, — tha Nekludovi duke buzëqeshur pa dashur, — unë dua që të punojmë e të hamë të gjithë.

Tetua i ngriti përsëri vetullat, i zgurdulloi përsëri sytë dhe e vështroi ngultas e me kureshtje.

— Mon cher, vous finirez mal [1]), — tha.

— Pse?

Atë çast hyri në dhomë një burrë i gjatë dhe shpatullgjerë, i veshur me një uniformë gjenerali. Ishte i shoqi i princeshës Çarskoj, ish ministri.

— Ah, Dimitri! Tungjatjeta! — tha ai duke i zgjatur një faqe të porsa rruar. — Kur paske ardhur?

Pastaj u kthye nga e shoqja dhe e puthi në ballë.

— Non, il est impayable [2]), — tha princesha Katerina Ivanovna duke iu drejtuar të shoqit. — Më urdhëron të laj rrobat në lumë dhe të ushqehem me një patate ditën. Është tmerrësisht idiot po, sidoqoftë, bëja ato që do të kërkojë. Është tmerrsisht makalush, — u korrigjua. — Po e more vesh për Kamenskajan? Është rrezik se mos vdesi nga dëshpërimi, —

---

1) I dashur, ju do mbaroni keq (frëngj.)

2) Jo, ai është i çuditëshëm (frëngj.)

shtoi duke iu drejtuar të shoqit, — bën mirë të shkosh një herë ta shohësh.

— Po, po, është e tmerrëshme, — tha i shoqi.

— Tani shkoni e bisedoni bashkë; unë ndërkaq po shkruaj disa letra.

Sapo Nekludovi kish dalë e kish hyrë bashkë me ministrin në një dhomë tjetër ngjitur me sallonin, ajo i thirri që andej:

— Atëhere t'i shkruaj Mariettës?

— Ju lutem, ma tante.

— Se çfarë kërkon për atë kokëqethurën këtë nuk po ja them, po e lë en blanc [1]). Jam e sigurtë që do t'i thotë të shoqit, i shoqi pastaj na e mbaron këtë punë menjëherë. Mos kujto se jam e keqe. Ato protèges e tua as që shihen dot me sy, se të pështirosin po, sidoqoftë, je ne leur veux pas de mal [2]). Zoti le t'i gjykojë! Tani, shko! Dhe sonde mbrëma do të vish pa tjetër se do të dëgjosh Kizeveterin. Dhe do të falemi. E po të kesh besim, ta dish se ça vous fera beaucoup de bien [3]). Se mos kujton që nuk e di, Heleni e ju të gjithë keni mbetur shumë pas nga punët e fesë. Atëhere, pra, mirëupafshim.

XV

Konti Ivan Mihailloviç, ish ministër, ishte njeri shumë i ngurtë në mendimet e tij.

Mendimet e kontit Ivan Mihailloviç ishin çfaqur që kur ai ishte akoma shumë i ri: ashtu siç e ka bërë natyra zogun të ushqehet me krimba, të jetë i mbuluar me pupla e të fluturojë në ajër, po ashtu edhe atë e kish bërë natyra të ushqehej me gjellë nga më të shtrënjtat, të pregatitura posaçërisht për të nga gjellëbërësit më të mirë, të vishej me rrobat sa më lluks, të udhëtonte me një karrocë sa më të rehatëshme që ta tërhiqnin kuaj nga më të shpejtit dhe t'i kishte përherë gati të gjitha këto kurdo që t'i kërkonte. Konti Ivan Mihailloviç mendonte gjithashtu se sa më shumë të holla të tërhiqte për vete nga buxheti, sa më shumë urdhëra e dekorata të merrte e sa më shpesh që të takohesh me njerëz me influencë nga të dy sekset, aq më mirë do të qe për të. Çdo gjë tjetër që

1) Bosh (frëngj.)
2) Nuk u dua të keqen (frëngj.)
3) Kjo do t'ju bëjë shumë mirë.

s'përfshihej në këto dogma themelore të kontit Ivan Mihaillloviç nuk kishte në sytë e tij asnjë rëndësi e nuk paraqiste për të asnjë interes. Në përputhje të plotë me bindjet që rrjeshtuam më lartë, konti Ivan Mihailloviç kishte kaluar në Peterburg dyzet vjet të jetës së tij duke zhvilluar një veprimtari të gjithëanëshme që i kishte lejuar më në fund të bëhej ministër.

Meritat kryesore të kontit Ivan Mihailloviç, që e bënë të zinte një post kaq të rëndësishëm, mund të përmblidheshin si më poshtë: në radhë të parë ai merrte erë nga ligjet, kuptonte gjithashtu edhe nga shkresat dhe ishte në gjëndje bile edhe t'i konceptonte vetë, ndonëse në një stil jo dhe aq elegant po, sidoqoftë, pa gabime ortografike; në radhë të dytë ishte jashtëzakonisht i pashëm, qe në gjëndje t'i jepte fizionomisë tij, shprehjen e dinjitetit, të krenarisë e të madhështisë, ose, kur ja donte puna, hiqej i përulur saqë bëhej servil dhe i poshtër; në radhë të tretë konti Ivan Mihailloviçi ishte njeri me parime morale e shoqërore dhe prandaj, kur ja donte puna, mund të binte dakord me këdo qoftë dhe mund të mos binte dakord me asnjeri në rast të kundërt. Duke vepruar në këtë mënyrë ai vetëm për një gjë bëhej merak: të ruante format dhe të tregohej, gjer diku e sa për sy e faqe, konsekuent me veten. A pajtohej ose jo me moralin kjo sjellja e tij, a i sillnin të mirë apo dëm Perandorisë Ruse dhe mbarë botës, kjo për të s'kishte fare rëndësi.

Kur u bë ministër, jo vetëm ata që i kishte në mvartësi, si të huajt ashtu dhe të tarafit, u bindeshin urdhërave të tij, por dhe të tjerë që s'kishin me të asnjë lidhje si edhe ai vetë, besonin se do të qe një burrë shteti i rrallë, i urtë e tejpamës. Por kur, pas ca kohe, u vu re që ai nuk bëri dot asnjë reformë e nuk ndërmori, në përgjithësi, asnjë inisjativë të re dhe kur, në saje të ligjit të luftës për ekzistencë, zyrtarë të tjerë, po aq të pashëm e të xhveshur parimisht si ai që merrnin erë nga ligjet e që kishin mësuar t'i bënin shkresat pa gabime ortografike tamam si ai, e përmbysën dhe ja zunë vendin duke e detyruar të dilte në pension; atëhere u bë e qartë për secilin që konti Ivan Mihailloviç s'ishte aspak i mënçur dhe tejpamës, por përkundrazi, një njeri mendërisht shumë i kufizuar e profan nga kultura (ndonëse shumë i sigurtë në vetvete) që në pikëpamjet e tij mezi ngrihej gjer në nivelin e kryeartikujve që botoheshin nëpër disa gazeta reaksionare nga më të ndytat. Doli në shesh se ai nuk kishte asgjë të vençantë nga ata zyrtarët me kulturë të pakët, me besim të shum-

të në veten e tyre që e kishin përmbysur. E kuptoi edhe ai vetë, por kjo në asnjë mënyrë nuk e tundi të besojë se kish të drejtat që gëzonte të tërhiqte çdo vit nga buxheti i shtetit një sasi të madhe të hollash si edhe t'i shtonte uniformës së tij të madhe stolira të reja. Kjo bindje ishte rrënjosur tek ai aq thellë, sa asnjeri nuk guxonte t'ja kundërshtonte dhe kështu konti Ivan Mihailloviç, ca si pension, ca si këshilltar shteti e pjesmarrës në gjithfarë komisione e komitete, merrte disa dhjetra mijë rubla në vit dhe fitonte, bashkë me këto, të drejtën t'u shtonte supeve dhe pantallonave të tjera shirita dhe kraharorit, nën frak, të tjera kordona e të tjera kryqe smalti. Këto të gjitha e bënin kontin Ivan Mihailloviç të kish lidhje të shumta e të ngushta me njerëz me influencë.

Konti Ivan Mihailloviç e dëgjoi Nekludovin ashtu siç dëgjonte një herë e një kohë shefat e zyrave, kur i thirrte në raport. Pastaj, si e dëgjoi mirë e mirë, i tha se do t'i jipte dy letra rekomandimi, njerën nga të cilat për senatorin Volf. në departamentin e apelimeve.

— Flasin shumë për të, por dans tous les cas c'est un homme tres comme il faut [1]), — tha ai. — Veç kësaj ka detyrime kundrejt meje dhe do të bëjë çmos.

Letra tjetër e kontit Ivan Mihailloviç ishte për një person me influencë në komisionin e faljeve. Çështja e Fedosja Birjukovës, ashtu siç ja tregoi Nekludovi, i bëri atij shumë përshtypje. Kur Nekludovi i tregoi se si kishte ndërmënd t'i shkruante për këtë një letër perandoreshës, ai tha se ngjarja ishte me të vërtetë prekëse dhe se ai, nga ana e tij, po të paraqitej rasti, do ta kishte parasysh. Sidoqoftë, nuk mund t'ja thoshte me siguri, sepse kjo varej nga rrethanat. Por, po të qe se do ta ftonin në petit comitè [2]) ndonjë të enjte, ai ndofta do të përpiqej të hidhte ndonjë fjalë për këtë çështje.

Si mori të dy letrat që i dha konti dhe pusullën për Marietten nga tetua, Nekludovi u nis menjëherë që t'i përvishej punës.

Shkoi në fillim tek Mariette, që ishte një aristokrate jo dhe aq e pasur. Atë e njihte që kur ishte akoma e vogël. Kishte marrë vesh për të se qe martuar me një njeri që kishte bërë karierë, jo për zotësinë që kishte se sa për trajtimin mizor që u bënte qindrave e mijërave të burgosurve po-

1) Por, sidoqoftë, është një njeri shumë korrekt (frëngj.)
2) Mbledhje e vogël intime (frëngj.)

litikë, të cilët. mendonte, se e kishte për detyrë t'i torturonte sa më egër. Nekludovit i vinte rëndë që, për t'u ardhur në ndihmë të shtypurve, t'u drejtohej pikërisht atyre që i shtypnin duke e pranuar tërthorazi, të paktën atij kështu i dukej, veprimtarinë e tyre si të ligjëshme gjersa do t'u lutej të hiqnin dorë sadopak dhe, për hir të miqësisë, nga mizoritë e tyre të zakonshme të cilat, ndofta, ata vetë nuk i vinin re. Në të gjitha këto raste ai s'e ndjente veten të kënaqur dhe bëhej një luftë në shpirtin e tij. Por ngurrimi i tij këtë radhë mori fund menjëherë kur mendoi se, sadoqë do ta ndjente veten si në gjëmba përpara asaj Mariettes dhe të shoqit të saj, do të kryente një vepër të mirë duke liruar nga burgu një grua fatkeqe që vuante e torturohej më kot në vetëminë e frikëshme të një qelie, ndërsa në shtëpi prindërit e ndiqnin me ankth fatin e saj. Por duhet thënë se ngurrimi i Nekludovit rridhte edhe nga diçka tjetër. Ai e ndjente tërë peshën e atyre rrethanave anormale për të që e detyronin të përfitonte nga miqësia e disa njerëzve të cilët, ndonëse ishin tanimë të huaj për të, ata vetë vazhdonin ta konsideronin të tyre. Por nuk qe vetëm kjo. Ai vinte re i tmeruar se ambjenti ku bënin pjesë këta njerëz dhe ku kish bërë pjesë dikur edhe vetë, po e tërhiqte përsëri në rjetën e thashethemeve të kota, të mëndjemadhësisë boshe, të marrëdhënieve imorale dhe të qendrimeve ironike karshi problemeve më të rëndësishme të jetës. Kjo i kishte rënë në sy atë mëngjes tek tetua, ku kishte folur për gjëra shumë serioze me tonin e shakasë.

Në përgjithësi, Peterburgu, ku nuk kishte qenë prej kohësh, e gjallëronte fizikisht, por e ndrydhte shpirtërisht. Pastërti, rregull e luks nga të katër anët, me pak kokëçarje, aq sa jeta të dukej më e lehtë këtu se në çdo vend tjetër.

Karrocieri, një burrë mjaft i pashëm, i pastër dhe i njerëzishëm, duke kaluar pranë rreshtave me policë, që edhe ata dukeshin të pashëm, të pastër e të njerëzishëm, buzë ndërtesave shumë të bukura që radhiteshin nga të dy anët e rrugës, e shpuri Nekludovin në shtëpi në breg të kanalit ku banonte Mariette.

Në të hyrë të oborrit, qendronte një çift kuajsh anglezë me veshore, ndërsa majë karrocës kapardisej me kamzhik në dorë një karrocier me livre dhe me baseta gjer në mes të faqes, tamam si anglezët.

Një portier me një uniformë mjaft të pastër hapi portën e vestibulit ku qendronte, me ca baseta të dëndura e të kre-

hura me shumë merak, lakeu që i shoqëronte zotërinjtë jashtë si edhe një roje me uniformë të re dhe me bajonetë të çveshur.

— Gjenerali nuk pret. Po ashtu edhe gjeneralesha, e cila tani bëhet gati të dalë.

Nekludovi dorëzoi letrën, që i kishte dhënë kontesha Katerina Ivanovna dhe, si nxori një kartvizitë, iu afrua tryezës së vogël mbi të cilën ndodhej një libër ku vizitorët shënonin emrin. Po matej të shkruante, se i kishte ardhur shumë keq që nuk e kishte gjetur zonjën në shtëpi kur, atë çast lakei u afrua në shkallë, portieri doli jashtë dhe thirri: «Të hyjë», ndërsa roja mori drejtqendrim dhe shtangu në vend duke shoqëruar me sy një zonjë të hollë me shtat mesatar, që po i zbriste shkallët më shpejt nga sa ajo mundte.

Mariette kishte vënë në kokë një kapele të madhe me pupël dhe qe veshur e tëra në të zeza, që nga fustani gjer te pelerina e lehtë, që kishte hedhur krahëve, si edhe dorëzat e reja që kishte vënë në dorë; në fytyrë kishte hedhur një vello.

Kur vuri re Nekludovin, ajo e ngriti vellon duke zbuluar fytyrën e saj të hijëshme me ata sytë e mëdhenj e të ndritshëm dhe vështroi e habitur atë.

— Ah, princi Dimitri Nekludov! — tha me një zë të ëmbël. — Mezi ju njoha...

— Po si, ma mbani mënd edhe emrin?

— S'do mënd se dikur dhe ime motër dhe unë kishim rënë në dashuri me ju — tha ajo duke e kthyer bisedën frëngjisht. — Po sa paskeni ndryshuar! Ah, sa keq që po dal! Sidoqoftë, ktheni një minutë — tha duke u ndalur një hop me mëdyshje, dhe ngriti sytë nga ora që ishte varur në mur.

— Jo, nuk mundem. Nxitoj se shkoj në pështirtje tek Kamenskaja. Ajo e ka ndjerë shumë këtë vdekje.

— Kush është kjo Kamenskaja?

— Si, nuk e keni marrë vesh?... I biri i saj u vra në duel. U ndesh me Pozenin. Dhe ishte djalë i vetëm. Tmer i madh. E ëma nuk di ç'të bëjë nga dëshpërimi.

— Po, diç kam dëgjuar. Jo, jo, më mirë po shkoj. Po ju ejani nesër ose edhe sonde, në mbrëmje, — tha ajo dhe çapiti me hapa të shpejta e të lehta nga dera e daljes.

— Sonde nuk besoj se mund të vij — u përgjegj ai duke dalë bashkë me të në verandë. — Erdha për një punë — shtoi dhe ktheu kokën nga çifti i kuajve të kuq që po i afroheshin atë çast verandës.

— Ashtu? Mund të ma thoni?

— Ja, kam për juve një letër nga tetua — tha Nekludovi dhe i zgjati një zarf të ngushtë me një stemë të madhe përsipër.- Kur ta lexoni do të kuptoni për ç'punë bëhet fjalë.

— E di, e di: kontesha Katerina Ivanovna kujton se unë mund të ndikoj shumë tek burri dhe mund të ndërhyj në punët e tij. Po gabohet. Unë, përkundrazi, nuk kam asgjë në dorë dhe në asnjë mënyrë nuk dua t'i ndërhyj atij në punët që nuk më përkasin. Por, s'do mënd, për konteshën dhe për ju mund të bëj një përjashtim. Po nuk ma tregoni me dy fjalë si qendron puna? — tha ajo ndërsa orvatej me shumë kujdes, por me kokën kthyer gjetiu, ta shtinte dorën e saj të vogël me dorashkë të zezë në xhep.

— Është fjala për një vajzë që mbahet në kështjellë dhe është e sëmurë dhe e pafajëshme.

— Si e ka emërin?

— Shustova. Lidia Shustova. E keni të shkruar në letër.

— Mirë, mirë, do të mundohem — tha ajo dhe, si hipi me një lëvizje të lehtë në karrocën elegante me kolltuqe të butë që shkëlqente në diell nga verniku i ri, hapi ombrellën. Lakei u ngjit pranë karrocierit dhe i bëri shenjë që të nisej. Karroca u tund, por, pikërisht atë çast, zonja e çpoi me majë të ombrellës karrocierin në kurris: pelat e pashme me këmbë delikate, u ndalën me kokën kërrusur nën forcën e frërit duke rrahur dheun me këmbët e holla.

— Kështu, pra, ejani ndonjë ditë, por, mundësisht pa ndonjë interes — tha ajo duke mbledhur buzët me një çast buzëqeshjeje të cilës ja njihte mirë vleftën. — Nisu! — shtoi duke iu drejtuar karrocierit, të cilin e çpoi përsëri me majën e ombrellës.

Nekludovi hoqi kapelen. Pelat e sojme kuqaloshe, çkrofëtinë, i ngulën thundrat në plloçat e kalldrëmit dhe karroca shkau e lehtë dhe e shpejtë duke hovur vetëm aty këtu, butë-butë, me rrotat e reja veshur me gomë, mbi ndonjë sop të rrugës.

XVI

Duke sjellur ndërmënd buzëqeshjen që kishte shkëmbyer me Marietten, Nekludovi tundi kokën.

«Është rrezik që kjo jetë të më rrëmbejë përsëri, pa e kuptuar...» — mendoi duke ndjerë një farë moskënaqësie

ndaj vetes dhe atë mëdyshje që e pushtonte sa herë qe i detyruar të kërkonte ndihmë nga njerëz të cilët nuk i çmonte. Si u mendua një copë herë ku të shkonte më parë, që të mos bënte dy herë po atë rrugë, Nekludovi vendosi të shkonte në fillim në senat. Kur arriti atje, e shoqëruan menjëherë në sekretari, në një lokal të mrekullueshëm, ku ai vuri re një mizëri nëpunësish shumë të sjellshëm e të pastër. Aty i thanë se e kishin marrë lutjen e Masllovës dhe se për çështjen e saj do të referonte senatori Volf, për të cilin Nekludovi kishte një letër rekomandimi nga i shoqi i tetos.

— Senati mblidhet këtë javë, po si zor të merret në shqyrtim edhe çështja e Masllovës. Sidoqoftë, ju mund të kërkoni që ajo të shqyrtohet, në mos të hënën, të paktën të mërkurën që vjen, — i thanë nëpunësit.

Ndërsa po priste në sekretari, Nekludovi dëgjoi të flitej përsëri për duelin dhe se si qe vrarë oficeri i ri Kamenskij.

Këtu për herë të parë ai mori vesh të gjitha hollësirat rreth kësaj ngjarjeje që kishte bërë një përshtypje të madhe asokohe në tërë Peterburgun. Ngjarja kish ndodhur në një mehane, ku oficerët hanin koce deti dhe pinin pa hesap, ashtu siç e kanë zakon. Njeri prej tyre diç tha kundra regjimentit ku bënte pjesë Kamenskij; ky i tha se gënjente. Atëhere ai i ra Kamenskit me shpullë. Të nesërmen, u zunë përsëri dhe Kamenskij mori një plumb në bark e, pas dy ore, vdiq. Vrasësi dhe dëshmitarët u arrestuan por, siç flitej, sadoqë i kishin futur në burg, pas dy jave do t'i lëshonin.

Nga sekretaria e senatit Nekludovi shkoi në komisionin e faljeve, ku shpresonte të takohej me një funksionar që kishte shumë influencë. Ky ishte baroni Vorobjev, që banonte në një apartament luksoz, pronë shtetërore. Portieri dhe lakej e pritën keq Nekludovin dhe i thanë se baroni priste vetëm në ditë të caktuara, kurse atë ditë ishte në audjencë tek perandori, ashtu edhe të nesërmen. Nekludovi dorëzoi letrën, që kishte për të, dhe shkoi tek senatori Volf.

Volfi porsa kishte ngrënë mëngjes dhe priste Nekludovin; kish ndezur, si zakonisht, një cigare dhe shetiste nëpër dhomë për të tretur ushqimin. Vladimir Vasiljeviç Volfi ishte me të vërtetë un homme très comme il faut. Këtë cilësi ai nuk e barazonte me asnjë tjetër dhe sipas asaj i gjykonte dhe njerëzit. Senatori Volf kishte të drejtë që e çmonte kaq lart këtë cilësi, se pikërisht ajo dhe vetëm ajo e kishte lejuar të bënte karierën që kish dashur, d.m.th. të siguronte me anë të martesës një të ardhur prej tetëmbëdhjetë mijë rubla në

vit dhe, si shpërblim për mundimet e tij, vendin e senatorit. Ai e pandehte veten jo vetëm un homme comme il faut, por edhe një njeri të ndershëm, siç kishin qenë dikur ata kalorësit e vjetër. Ndershmëri për të do të thoshte të mos pranojë rrushfete nën dorë nga njerëz të huaj. Por ndershmëri nuk do të thoshte të mos kërkoje shpërblime, gradime, dekorime duke kryer, për këtë qëllim, me një servilizëm prej skllavi, të gjitha ato sa kërkoheshin nga lart. Nuk do të thoshte ndershmëri gjithashtu të mos merrje më qafë qindra njerëz të pafajshëm duke i burgosur, duke i internuar, sepse mbronin popullin e tyre dhe fenë e të parëve, ashtu siç kishte bërë ai vetë kur kishte qenë gubernator në një nga gubernat e Mbretërisë polake. Përkundrazi, sipas mendimit të tij, këto të gjitha ishin shenjë fisnikërie, trimërie dhe patriotizmi; gjithashtu ai nuk mendonte se nuk ishte e ndershme të grabitje gruan dhe kunatën, ashtu siç kish bërë gjithashtu vetë. Jo vetëm kaq po, sipas mendimit të tij, kjo duhej cilësuar si një rregullim i arësyeshëm i jetës familjare.

Familja e Vladimir Vasiljeviçit përbëhej nga e shoqja, një grua pa personalitet, nga kunata, të cilës gjithashtu ai ja kishte përvetësuar pasurinë duke ja shitur çifligun e duke i vënë në bankë paratë në emër të tij dhe, më në fund, nga e bija, një vajzë e urtë, e ndrojtur dhe e shëmtuar, e cila bënte një jetë të vetmuar dhe monotone, ndonëse kohët e fundit kish filluar të gjente ngushëllim në mbledhjet e ungjillorëve në shtëpinë e Alinesë dhe të konteshës Katerina Ivanovna.

Vladimir Vasiljeviçi kishte dhe një djalë, por këtë e kishte dëbuar nga shtëpia, se nuk shkonte mirë në shkollë, kishte rënë në shoqëri të keqe dhe hynte borxh duke turpëruar kështu t'ane. I biri i Vladimir Vasiljeviçit kishte filluar të pinte nëpër mehane me gra të liga që porsa i kishte dalë mjekra, kur s'ishte akoma as pesëmbëdhjetë vjeç djalë dhe e kishte vazhduar atë zanat gjer në moshën njëzet vjeç, kur i ati e dëboi. Vladimir Vasiljeviçi kish larë një herë, për të birin, një borxh prej dyqind e tridhjetë rublash, kishte paguar edhe një herë tjetër gjashtëqind rubla; por e kishte paralajmëruar të birin se ajo ishte hera e fundit dhe se, po të mos shtrohej, do ta dëbonte nga shtëpia duke prerë me të çdo marrëdhënie. I biri jo vetëm që nuk u shtrua, por hyri akoma borxh ndo një mijë rubla dhe guxoi t'i thoshte t'et se qe mërzitur në atë shtëpi. Atëhere Vladimir Vasiljeviçi i tha troç të birit që mund të çporrej ku të donte, se nuk e kishte më për djalë. Që atëhere Vladimir Vasiljeviçi hiqej sikur nuk

kishte djalë dhe asnjeri në shtëpi nuk guxonte t'ja zinte në gojë; kështu ai ishte plotësisht i bindur se e kishte vënë në rregull jetën e tij familjare.

Si u përshëndet me Nekludovin, Volfi lexoi letrën, duke i shoqëruar të gjitha këto veprime me një buzëqeshje ledhatonjëse e gjer diku ironike, që i lejonte ta shprehte në një mënyrë krejt të natyrëshme epërsinë e tij prej njeriu comme il faut mbi të gjithë njerëzit e tjerë.

— Ju lutem të uleni e të më falni, — tha ai duke i futur duart në xhepa dhe duke shkelur lehtë-lehtë me hapa të vogla nëpër diagonalen e kabinetit të madh të mobiluar me një stil të veçantë. — Jam shumë i lumtur që njihem me ju dhe, natyrisht, që kam rastin t'i bëj një nder kontit Ivan Mihaillovič — shtoi dhe, si nxori një shtëllungë tymi aromatik të kaltëryer, e futi përsëri cigaren në gojë, por me shumë kujdes që të mos binte hiri.

— Unë do t'ju lutesha vetëm që çështja e saj të shqyrtohet sa më shpejt në mënyrë që, po të jetë se e pandehura do të shkojë në Siberi, të niset të paktën sa më parë — tha Nekludovi.

— E di, e di, me vaporet e parë nga Nizhnij — tha Volfi duke buzëqeshur me mirëdashje ashtu siç bënte gjithmonë sa herë që deshte të tregonte se i dinte që më parë ato që do t'i thonin, — si e ka emrin e pandehura?

— Masllova...

Volfi iu afrua tryezës dhe trazoi në një dosje.

— Po, po, Masllova. Mirë. Do t'u lutem shokëve ta shqyrtojnë çështjen e saj të mërkurën.

— Atëhere mund t'i telegrafoj avokatit?

— Kini edhe avokat? Po përse? Sidoqoftë, po të doni, mund t'i telegrafoni, pse jo...

— Argumentat e apelimit mund të jenë të dobëta — tha Nekludovi — por, po të lexohen proçes verbalet e gjyqit, unë besoj se do të dalë menjëherë në shesh se në dënimin që i është dhënë të pandehurës ka patur një mosmarrëveshje.

— Ndofta është ashtu si thoni ju po, sidoqoftë, senati nuk mund të marrë në shqyrtim thelbin e çështjes — tha Vladimir Vasiljeviçi rëndë-rëndë duke i hedhur një sy hirit. — Senati ka për detyrë të ndjekë vetëm ligji a është zbatuar dhe interpretuar drejt.

— Po mua më duket se ky është një rast i jashtëzakonshëm.

— E di, e di. Të gjitha rastet janë të jashtëzakonëshme. Po ja, do bëjmë atë që na përket. Ju, sikur vini rrallë në Peterburg, më duket? — tha Volfi duke e mbajtur cigaren që hiri të mos rrëzohej. Po hiri megjithatë filloi të bjerë dhe Volfi e shpuri cigaren me shumë kujdes tek një taketuke dhe atje e shkundi. — Sa e tmerrëshme ishte ajo fatkeqësia që ndodhi me Kamenskin! — shtoi. — Oh, lëre se ç'djalë ka qenë! Dhe qe i vetëm. Mund ta merrni me mënd dëshpërimin e s'ëmës, — tha ai duke përsëritur fjalë për fjalë atë që fliteshin kudo në Peterburg për Kamenskin.

Si tha nja dy fjalë edhe për konteshën Katerina Ivanovna si edhe për doktrinat e reja që ajo kish përqafuar kohët e fundit, të cilat ai si një njeri comme il faut as nuk i aprovonte, as i kundërshtonte, megjithëse i dukeshin krejt të kota, Vladimir Ivanoviçi i ra ziles.

Nekludovi u ngrit.

— Po të dëshironi, ejani ndonjë ditë për drekë tha Volfi duke i zgjatur dorën. — Ja, fjala vjen, të mërkurën. Kështu do të mund t'ju ap edhe një përgjigje të saktë.

Që vonë dhe Nekludovi shkoi drejt e në shtëpi, d.m.th. tek tetua.

XVII

Në shtëpinë e konteshës Katerina Ivanovna darka hahej në orën shtatë e gjysmë. Darka këtu servirej në një mënyrë krejt të panjohur për Nekludovin. Gjellët viheshin mbi tryezë dhe lakejt largoheshin pastaj menjëherë, kështuqë secili e merrte vetë pjesën e tij. Burrat, për t'u ardhur në ndihmë damave, ashtu siç i ka hije seksit të fortë, e mbanin trimërisht mbi supet e tyre barrën e rëndë të shpërndarjes së pjatave me gjellë dhe të mbushjes së gotave me verë. Mbas çdo gjelle, kontesha shtypte sustën e një zileje elektrike mbërthyer mbi tryezë dhe lakejt hynin pa zhurmë, i mblidhnin me të shpejtë pjatat, i ndërronin takëmet dhe sillnin gjellë të tjera. Në kuzhinën e madhe dhe plot dritë të shtëpisë punonte një kryegjellbërës francez me dy ndihmësa rusë, veshur që të tre në të bardha. Rreth tryezës qenë mbledhur e hanin bukë gjashtë veta: konti me konteshën, djali i tyre, një oficer i gardës me fytyrë të zymtë që i mbështeste pa të keq bërrylat mbi tryezë. Nekludovi, «lectriceja» fran-

ceze dhe kryeadministratori i çifligjeve të kontit, që porsa kishte ardhur atë kohë nga fshati.

Biseda u vërtit edhe këtu rreth duelit. U diskutua për qendrimin që do të mbante në këtë rast perandori. Dihej se perandorit i kishte ardhur shumë keq për t'ëmën e Kamenskut dhe, pra, që të gjithëve u vinte shumë keq për të. Por, meqënëse dihej gjithashtu se perandori, ndonëse kishte shprehur keqardhjen e tij për këtë ngjarje të papëlqyer, nuk kish ndërmënd të tregohej edhe aq i rreptë kundër vrasësit, që kishte mbrojtur në fund të fundit nderin e uniformës, asnjeri nuk guxonte të thoshte ndonjë fjalë të keqe për të. Vetëm Katerina Ivanovna, me atë mëndjelehtësinë e saj çapkëne, u hodh e tha se vrasësi duhej dënuar.

— Se ndryshe do të ndodhë që si ai do të dehen edhe të tjerë e do të mos e kenë për gjë t'i vrasin ata më të mirët! Jo, jo, ta kisha unë në dorë s'e lija kurrë pa e dënuar, — tha kontesha.

— Ja, këtë unë nuk e kuptoj, — tha konti.

— E di, e di, ti kurrë nuk i kupton ato që them unë, — tha kontesha duke u kthyer nga Nekludovi. — Të gjithë i kuptojnë, po burri jo, nuk i kupton! Unë them se më vjen keq për nënën dhe nuk dua që ai tjetri, që i ka vrarë të birin, të më kapardiset...

I biri i konteshës, që kishte heshtur gjer atëhere, u hodh dhe i doli zot vrasësit duke e sulmuar t'ëmën dhe duke i provuar me t'egër se ai qe oficer, nuk mund të vepronte ndryshe, sepse atëhere gjyqi i oficerave do ta detyronte të jepte dorëheqjen nga ushtria. Nekludovi dëgjonte pa u ngatërruar në atë bisedë dhe, si oficer i vjetër, i kuptonte, por nuk i aprovonte arsyetimet e atij çunaku. Ai solli ndërmënd, pa dashur, një djalosh të pashëm që kishte parë në burg, të cilin e kishin dënuar me katorga. Që të dy, si ai muzhiku i ri ashtu edhe oficeri, kishin vrarë duke qenë të dehur. Po muzhikun e kishin ndarë nga gruaja, nga njerëzit e tij, i kishin lidhur në këmbë hekura të rënda, ja kishin rruar kokën dhe ja tani e shpinin në Siberi; kurse ai tjetri rrinte në një dhomë luksoze të burgut ushtarak, hante nga gjellët më të shijëshme, pinte nga verërat më të mira, lexonte libra dhe, me sot me nesër, do të lihej i lirë të bënte atë jetë që kishte bërë më parë, me të vetmin ndryshim se këtej e tutje do të zihej në gojë nga të gjithë si një njeri i rrallë.

Ai i tha ato që mendonte. Në fillim kontesha Katerina Ivanovna u pajtua me mendimin e nipit të saj por, pastaj

heshti dhe s'tha më asnjë fjalë. Nekludovi e ndjeu se kish shkelur në dërrasë të kalbur.

Menjëherë, si hëngrën darkën, të gjithë kaluan në një sallë të madhe ku, tamam si për një konferencë, qenë vënë disa sërë karrigash me shpina të larta si edhe një tryezë e një kanë me ujë për konferencierin. Dalngadalë në atë sallë, ku pritej të vinte Kizeveteri i famshëm, u mblodhën edhe shumë njerëz të tjerë.

Karrocat luksoze të mysafirëve qenë radhitur në të hyrë të shtëpisë. Salla e madhe, e stolisur me një luks të rrallë, qe mbushur me dama veshur në mëndafsh, me fustane të shtrenjta prej dantellë të hollë, me parruka, me korsera të forta, që ua zgjatnin dhe ua hollonin belin. Pas grave vinin burrat, ndër të cilët kishte si ushtarakë ashtu dhe civilë, si dhe pesë burra të thjeshtë nga populli: dy shërbëtorë, një dyqanxhi, një lake dhe një karrocier.

Kizeveteri ishte një burrë i shëndoshë, qimethinjur. Ai fliste anglisht, po kishte me vete një përkthyese, një vajzë të re thatime me syza, që i përkthente mirë e shpejt të gjitha.

Ai fliste për gjynahet e njerëzve dhe thoshte se këto gjynahe ishin kaq të rënda e të shumta, sa i rëndë e i pashmangshëm ishte për pasojë edhe dënimi që meritonin.

— Le të mendojmë, vëllezër e motra, për veten tonë, për jetën tonë, se çfarë bëjmë, se si rrojmë, se si e zëmëroimë zotin tonë të plotmëshirshëm, se si e bëjmë të vuaj Krishtin dhe atëhere do të kuptojmë se nuk ka për ne falje, se nuk ka për ne rrugë shpëtimi, se që të gjithë ne jemi të humbur. Dhe kjo humbje është e tmerrëshme, vuajtja e amëshueshme na pret, — thoshte ai me një zë të dridhur e të vajtuar. — Si do ta gjejmë udhën e shpëtimit? Vëllezër, si do të shpëtojmë nga ky zjarr i tmershëm? Se ja shtëpia është në flakë dhe ne nuk kemi shteg nga të dalim...

Këtu ai heshti një copë herë dhe mbi faqet e tij u dukën vërtetë dy pika loti. Siç ndodhte përherë, me një përpikmëri të pagabueshme, në ato tetë vjetë që kishte filluar të predikonte, kur arrinte në këtë pjesë të ligjëratës së tij, ai ndjente një lëmsh në fyt, hundët e çponin dhe lotët i rridhnin nga sytë vetvetiu. Dhe këto lot e ngashërenin akoma më tepër. Në sallë u dëgjuan disa klithma vaji. Kontesha Katerina Ivanovna i kishte mbështetur bërrylet mbi një tryezë të vogël prej mozaiku, e kishte kapur kokën me të dy duart dhe lëvizte or'e çast shpatullat e trasha nga mallëngjimi. Karrocieri e vështronte gjermanin me një shprehje të trëmbur e të habitur

në fytyrë sikur t'i kish dalë përpara ndonjë këmbësor që ka zënë rrugën e s'bën mënjanë kur karroca është gati ta shtypë. Të tjerët rrinin pak a shumë në atë pozë që kish marrë kontesha Katerina Ivanovna. E bija e Volfit, që i përngjante t'et, veshur me një fustan të modës së fundit, që gjunjëzuar dhe e kishte mbuluar fytyrën me të dy duart.

Befas, oratori e zbuloi fytyrën dhe ja shkrepi gazit pak a shumë ashtu si aktorët kur duan të shprehin gëzimin. Pastaj me një zë të ëmbël nisi të thotë:

— Po ka një rrugë shpëtimi! Dhe është e lehtë, është e hareshme kjo rrugë! Shpëtimi ynë, o vëllezër e motra, është gjaku që derdhi për ne i biri i vetëm i zotit. Në gjakun e tij, në vuajtjet e tij, ja atje është shpëtimi! Vëllezër e motra, — vazhdoi ai përsëri me sy të përlotur, — le ta falenderojmë zotin që dha birin e tij të vetëm për shpëtimin e njerëzimit. Gjaku i tij i shenjtëruar...

Nekludovit i erdhi aq shumë ndoht sa u detyrua të ngrihet e të shkojë pa u ndjerë në dhomën e tij duke përmbajtur me zor krupën dhe turpin që i ngjallte ajo skenë.

XVIII

Të nesërmen, porsa Nekludovi u vesh e po zbriste poshtë, erdhi tek ai një lake, që i solli një kartvizitë nga avokati i tij në Moskë. Avokati kishte ardhur për ca punë të tija dhe, duke përfituar nga rasti, shprehu dëshirën të ndodhej në shqyrtimin e çështjes në senat, nëqoftëse ky nuk do të vonohej.

Telegramin që i kishte dërguar nuk e kishte marrë, se qe nisur më parë. Kur mësoi nga Nekludovi kur do të shqyrtohej çështja e Masllovës, ai vuri buzën në gaz.

— Secili është një tip më vete, — tha ai. — Volfi është prototipi i zyrtarit të Peterburgut, Skovorodnikovi është juristi i ditur, be-ja përkundrazi është juristi praktik dhe prandaj më i gjalli nga të tre. Tek ai sidomos duhen mbajtur shpresat. Po në komisionin e faljeve ç'ju thanë?

— Ja, sot do shkoj përsëri tek baroni Vorobjev, se dje nuk më lanë ta takoj.

— A e dini si e ka fituar titullin e baronit Vorobjevi? — tha avokati si për t'iu përgjigjur qesëndisë që mori gjer diku zëri i Nekludovit kur e shqiptoi këtë titull të huaj duke e

shoqëruar me një emër thjesht rus. — Pavlit i kishte ardhur shumë mirë për një shërbim që i kishte bërë gjyshi i Vorobjevit që, me sa thonë, ishte lakej personal i carit. Se çfarë shërbimi ishte ky nuk dihet. Dhe deshi t'ja shpërblejë. Po, që ta bënte fisnik nuk para i pëlqente dhe kështu e bëri baron. Baroni Vorobjev. Po i nipi, duket, e ka për mburrje. Është një dallkauk i madh.

— Ja, pra, tek ai do të shkoj, — tha Nekludovi.

— Shumë mirë. Shkojmë bashkë. Mund t'ju shpie gjer atje me karrocë.

Kur po dilnin, një lake i preu rrugën Nekludovit dhe i dorëzoi këtë letër nga Mariette:

«Pour vous faire plaisir, j'ai agi tout àfait contre mes principes et j'ai intercedé auprés de mon mari pour votre protegée. Il se trouve que cette personne peut être relaches immediatement. Mon mari a écrit au commandant. Venez donc pas interes. Je vous attend. [1]) M.»

— Si ju duket? — ju drejtua Nekludovi avokatit. — Nuk është e tmerrëshme? Ja një grua që mbahet shtatë muaj në burg në një qeli të vetmuar duke qenë krejt e pafajëshme! Mjaftoi një fjalë dhe e liruan...

— S'është as e para, as e fundit. Po, të paktën, ja arritët qellimit.

— Po, por ky sukses, në vend që të më gëzojë, më dëshpëron. Se atëhere del pyetja: ç'bëjnë kështu autoritetet? Përse i mbajnë kot njerëzit në burg?

— Jo, jo, më mirë mos u thelloni shumë në këto çështje. Atëhere, ju lutem, urdhëroni në karrocë! — tha avokati kur dualën jashtë dhe një karrocë elegante, e marrë me qira nga avokati, iu afrua verandës. — Thatë se do të shkonit tek baroni Vorobjev, apo jo?

Avokati i tha karrocierit se ku do të shkonin dhe kuajt, që ishin të rracës, e shpunë shumë shpejt Nekludovin në shtëpinë e baronit. Baroni atë ditë ishte në shtëpi. Në dhomën e parë, pas hyrjes, ndodhej një nëpunës i ri që kuptohej nga uniforma se ishte sekretari i baronit, me një qafë jashtëzakonisht të gjatë me fikth të këcyer dhe me një hap shumë të lehtë, si edhe dy dama.

---

1) Për t'ju kënaqur veprova krejt në kundërshtim me parimet e mia dhe ndërhyra pranë burit për mbrojtjen tuaj. Rezultoi se personi në fjalë mund të lihet i lirë menjëherë. Burri i shkroi komandantit. Ejani pra pa interes. Ju pres. M.

— Si e keni emrin — pyeti nëpunësi i ri me fikth të dalë, duke kaluar me një lëvizje shumë të lehtë e të hijëshme nga damat tek Nekludovi.

Nekludovi tha si e quanin.

— Baroni na ka folur për ju.

Nëpunësi hapi një derë, hyri brënda dhe doli që andej me një damë të veshur në të zeza, me sy të përlotur. Dama, për të fshehur lotët, me gishtërinjtë e saj të hollë tërë kocka, uli mbi fytyrë vellon.

— Urdhëroni, — tha nëpunësi i ri duke iu drejtuar Nekludovit dhe, si iu afrua derës së kabinetit lehtë-lehtë, e hapi dhe u ndal në këmbë para saj.

Kur hyri në kabinet, Nekludovi u ndodh përpara një burri të shkurtër me redingot, i cili qe ulur në një kolltuk pranë një tryeze shkrimi të gjerë e të gjatë dhe shikonte me sy të qeshur përpara vetes. Fytyra e tij e kuqe tërë shëndet bënte një kontrast që binte menjëherë në sy me flokët dhe mjekrën e tij të bardhë. Kjo fytyrë u ngërdhesh në një buzëqeshje ledhatonjëse, porsa ai pa Nekludovin.

— Jam shumë, shumë i lumtur që keni ardhur të më takoni. Unë e mëma juaj kemi qenë miq të ngushtë. Ju kam parë që kur ishit i vogël, ashtu edhe më vonë kur u bëtë oficer. Po uluni, uluni... Ç'urdhëroni nga unë?... Po, po — tha ai duke tundur kokën e thinjur e të qethur, ndërsa Nekludovi nisi të tregojë historinë e Fedosjës. — Vazhdoni, vazhdoni, i kuptova të gjitha; po, po, është një histori vërtet shumë prekëse. Mirëpo, a e kini dhënë lutjen?

— Lutjen e kam gati, — tha Nekludovi duke e nxjerrë nga xhepi. — Po desha të këshillohesha më parë me ju, duke shpresuar se, me ndërmjetësinë tuaj, do të tregohej ndofta më kujdes në shqyrtimin e saj.

— Dhe shumë mirë keni bërë. Unë do ta shtroj këtë çështje menjëherë, pa humbur kohë, — tha baroni, duke u orvatur t'i japë me zor një shprehje hidhërimi fytyrës së tij të qeshur. — Është vërtet një ngjarje që të mallëngjen së tepërmi. Është e qartë se ajo atëhere ka qenë fëmi, i shoqi në fillim është sjellur pak si ashpër dhe kjo pikërisht i ngjalli asaj, si të thuash, urrejtjen kundër tij; por pastaj, në një kohë të dytë, ata e njohën njeri tjetrin më mirë, u dashuruan... Po, po, do ta referoj patjetër këtë çështje.

— Konti Ivan Mihaillovič më tha se ndofta do të ndërhynte vetë pranë perandoreshës.

Menjëherë, porsa Nekludovi i shqiptoi këto fjalë, baroni e prishi çehren.

— Sidoqoftë, ju dorëzojeni lutjen pranë sekretarisë, pastaj shohim se çfarë mund të bëhet... — i tha ai Nekludovit.

Atë çast hyri në dhomë nëpunësi i ri që ecte, si përherë, duke u tundur.

— Ajo dama që ishte këtu pak më parë ka akoma dy fjalë për t'ju thënë.

— Mirë, mirë, le të vijë! Ah, mon cher, sa lot derdhen përpara syve të mi...

Dama hyri.

— Harrova t'ju them që të mos e lejoni atë ta japi vajzën, sepse ai...

— Po më duket sikur ju thashë që kështu do veproj.

— Zoti baron, në emër të zotit, bëni çmos që të shpëtoni një nënë!

— Po, po, ju thashë...

Kur dama doli, Nekludovi u ngrit dhe kërkoi leje të largohej.

— Pra, do të bëjmë ç'të jetë e mundur. Do të lidhemi me ministrinë e drejtësisë. Si të na përgjigjen, atëhere do të shohim se çfarë do mund të bëhet...

Nekludovi doli duke kaluar nga sekretaria. Edhe këtu, ashtu si në senat, në një ndërtesë madhështore dhe luksoze sa s'ka, ai pa përsëri një mizëri nëpunësish shumë të pastër, të sjellshëm dhe korrekt në të gjitha duke filluar që nga rrobat që kishin veshur e gjer tek përgjegjet e qarta dhe shumë të sakta që jepnin.

«Sa shumë janë! Një ushtri e tërë!... Dhe të gjithë duken të ushqyer mirë, me këmisha të pastëra, me duar delikate, me çizme të llustrosura me merak! Po kush ua bën të gjitha këto?... Sa ndryshim të madh kanë jo vetëm me të burgosurit por edhe me fshatarët...» — mendoi përsëri pa dashur Nekludovi.

XIX

Personi nga i cili varej zbutja e trajtimit të të burgosurve në Peterburg ishte një gjeneral me moshë të shkuar që rridhte nga brezi i vjetër i baronëve gjermanë, me merita të mëdha në shërbim e me dekorata të shumta, nga të cilat mbante zakonisht vetëm një kryq të bardhë. Thonin për të

se kohët e fundit nuk ishte në gjëndje mendore normale, ndofta nga pleqëria. Kryqin e bardhë që e kishte preferuar nga të gjitha dekoratat e tjera, gjersa e mbante gjithmonë me vete, e kishte fituar në Kaukaz sepse këtu, nën udhëheqjen e tij, disa muzhikë rusë, të qethur e të maskuar në uniforma, të armatosur me pushkë e me bajoneta, kishin vrarë më se njëmijë njerëz që mbronin lirinë, shtëpitë dhe familjet e tyre. Më vonë kishte shërbyer në Poloni, ku i kishte detyruar përsëri fshatarët rusë të kryenin një sërë krimesh mbi popullsinë e atjeshme, kjo dhe i kishte dhënë mundësinë ta pasuronte uniformën e tij me dekorata dhe shirita të tjera; pastaj kishte qenë dhe në vende të tjera, gjersa më në fund, kur u plak, mbeti në atë post nderi ku ndodhet tani, me një banesë të rehatëshme, ushqim të mirë dhe një rrogë të majme. Ai i kryente me përpikmëri e zell të madh për t'u lavdëruar të gjitha udhëzimet që merrte nga lart. Sipas mendimit të tij këto udhëzime nga lart kishin një rëndësi krejt të posaçme aq sa, sikur edhe çdo gjë në botë të ndryshonte, ato nuk mund të ndryshonin. Sipas detyrës që i qe ngarkuar, ai duhej të përkujdesej për të burgosurit dhe të burgosurat që mbaheshin për krime politike në qelira të vetmuara, kështu që brënda dhjetë vjetëve gjysma e tyre të çfarosej, një pjesë duke lojtur mënç, një pjesë nga tuberkulozi dhe një pjesë duke vrarë veten: kush nga uria, kush duke prerë me ndonjë qelq damarët e kush duke u varur e duke u djegur.

Gjenerali plak i dinte të gjitha këto sepse ndodhnin përpara syve të tij, por nuk i bënin asnjë përshtypje dhe nuk ja tronditnin në asnjë mënyrë ndërgjegjen, ashtu siç nuk mund t'ja tronditnin ndërgjegjen, fjala vjen, stuhitë, inondatat dhe fatkeqësitë e tjera të natyrës. Këto ngjarje të kobëshme në burgun e tij ndodhnin si pasojë e vënies në jetë të udhëzimeve që vinin nga lart d.m.th. nga vetë madhëria e tij perandori. Meqënëse, nga ana tjetër, udhëzimet në fjalë duhej të viheshin në jetë patjetër, natyrisht ishte krejt e kotë të vrisje mëndjen për pasojat që mund të lindnin. Kështu, edhe gjenerali plak nuk e vriste fare mëndjen për këto pasoja duke qenë i bindur se si patriot e si ushtar i mirë i ndalohej kategorikisht të mendohej mbi çdo gjë tjetër që nuk lidhej drejt përsëdrejti me ushtrimin e përpiktë të funksioneve që i kishin ngarkuar e që, sipas mendimit të tij, ishin shumë të rëndësishme.

Një herë në javë gjenerali plak, duke i qendruar besnik rregullave të shërbimit, i inspektonte të gjitha qelitë dhe i

pyeste të burgosurit në se kishin për t'i parashtruar ndonjë kërkesë. Të burgosurit i drejtoheshi me gjithfarë lutje. Ai i dëgjonte të gjitha këto i qetë, i heshtur, pa as më të voglën shenjë kompromentonjëse por, meqënëse ishin në kundërshtim me udhëzimet nga lart, nuk i merrte kurrë parasysh.

Kur Nekludovi po i afrohej rezidencës së gjeneralit plak, këmbanët e sahatit të madh në kullë, tringëllinë me një zë të hollë duke ekzekutuar avazin e ëmbël «Zoti qoftë lëvduar» dhe pastaj ranë dy herë. Duke dëgjuar sahatin, Nekludovi solli ndërmënd pa dashur ato që kishte lexuar në shënimet e dekabristëve mbi jehonën e trishtuar të asaj muzike të ëmbël që përsëritej çdo orë, në shpirtin e të burgosurve për jetë. Ndërsa Nekludovi i afrohej hyrjes së apartamentit të tij, gjenerali plak ndodhej në një sallon gjysmë të errët, përpara një tryeze dhe bashkë me një djalosh, që ishte i vëllai i një eprori të tij, vërtiste një pjatë. Gishtërinjtë e hollë, të dirsur e delikatë të piktorit gërshetoheshin me gishtrinjtë e ashpër, të rrudhur e me nyje të gjeneralit plak dhe që të gjithë këta gishtrinj vërtitnin së bashku atë pjatën e përmbysur mbi të gjitha gërmat e alfabetit që qenë shënuar në një copë letër. Pjata i përgjigjej pyetjes që i kishte drejtuar gjenerali se në ç'mënyrë do ta njihnin njeri tjetrin shpirtërat pas vdekjes.

Pikërisht në kohën kur një ordinancë hyri me kartvizitën e Nekludovit në sallon, po e merrte fjalën shpirti i Zhana d'Arkes. Shpirti i Zhana d'Arkes qe përgjegjur edhe një herë tjetër më parë sipas gërmave të shënuara në letër: «Do ta shohin njeri tjetrin». Por hyri ordinanca, pjata ndaloi së rrotulluari një herë tek gërma «p», pastaj tek gërma «o» gjersa arriti tek gërma «s» duke lëvizur herë këtej herë andej. Shkaku i lëkundjes ishte se, sipas gjeneralit, gërma tjetër duhej të qe «l»-ja, d.m.th. Zhana d'Arkes, sipas mendimit të tij, duhej të thoshte se shpirtërat do ta njohin njeri tjetrin vetëm pasi të spastroheshin nga çdo mbresë e jetës tokësore e kështu, pra, gërma tjetër duhej të qe patjetër «l»; piktori, përkundrazi, mendonte se gërma tjetër duhej të qe «v» që do të thoshte se shpirtërat do ta njihnin njeri tjetrin sipas dritës që do të lëshonte nga shpirti. Gjenerali, me një fytyrë të vrënjtur, duke i ngritur përpjetë vetullat e dëndura, s'i hiqte sytë nga duart dhe, duke menduar se pjata po lëvizte vetë; e rrotulloi lehtë-lehtë gjersa e shpuri gjer tek «l»-ja. Po kjo nuk i shpëtoi piktorit anemik, që vështronte pa lëvizur me dy sy të kaltër e të perënduar dikur

në një qoshe të sallonit. Ai lëvizi me nervozizëm buzët dhe, bashkë me to, edhe pjatën që e shpuri gjer tek «v»-ja. Gjenerali vrënjti vetullat dhe, duke e ndërprerë një hop atë dyluftim, mori kartvizitën, vuri syzat dhe, si lëshoi një ungurrimë nga një dhëmbje që ndjeu në mes, i dha përpjetë trupit të tij të madh dhe fërkoi gishtrinjtë e mpirë e të trashë me nyje.

— Fute në kabinet!

— Atëhere, me lejen tuaj, shkëlqesi, po e përfundoj vetë, — tha piktori duke u ngritur në këmbë.

— Mirë, mirë, përfundojeni, — tha me të rreptë gjenerali dhe u drejtua menjëherë për nga kabineti me një hap të matur e ritmik. — Gëzohem që ju shoh, — i tha Nekludovit duke i shqiptuar këto fjalë të përzërmërta me një zë të vrazhdë e duke i bërë shenjë me dorë në të njëjtën kohë që të ulej në një kolltuk që ndodhej afër tryezës. — Keni kohë që keni ardhur në Peterburg?

Nekludovi u përgjegj se nuk kishte shumë kohë.

— Po nënën si e kini? Si duket princesha, është mirë me shëndet?

— Nëna ka vdekur.

— Më falni, po më vjen shumë keq. Im bir më tha se ju kishte takuar.

I biri i gjeneralit kishte atë degë që kishte patur edhe i ati dhe, pas kryerjes së studimeve në akademinë ushtarake, kishte hyrë në shërbim pranë zyrës së informacioneve duke u mburur me atë punën që bënte atje, d.m.th. me stërvitjen dhe pregatitjen e spiunëve.

— Posi, posi, kam shërbyer bashkë me babanë tënd. Dhe kemi qënë shokë e miq të ngushtë. Po ju, ku jeni me punë?

— Jo, nuk jam në punë të shtetit.

Gjenerali bëri kokën mënjanë si me qortim.

— Zoti gjeneral, kam ardhur të më bëni një nder — tha Nekludovi.

— Posi, posi, me gjithë qejf! ç'urdhëroni?

— Nëqoftëse nuk do ta gjeni me vend lutjen time, ju lutem të më falni. Por, sidoqoftë, unë duhet t'jua them.

— Hë, si është puna?

— Ju keni këtu një farë Gurkeviç. Ja, e ëma e tij kërkon të takohet me të ose të paktën t'i jepet leje që t'i sjellë disa libra këtu në burg.

Gjenerali nuk çfaqi asnjë shenjë kënaqësie ose moskënaqësie në lidhje me kërkesën që i bëri Nekludovi, por kërra-

si kokën, vrenjti vetullat dhe u duk sikur ra në mendime. Por në të vërtetë ai nuk mendonte asgjë dhe as që tregonte ndonjë interes, sado të vogël, për atë që i tha Nekludovi duke e ditur mirë, që në fillim, se do t'i përgjigjej sipas ligjit. Ai rrinte në atë pozë vetëm për të shplodhur trutë e tij të lodhura.

— E di se ç'është... — nisi të thotë si u shplodh një copë herë. — Kjo nuk varet nga unë... Për takimet ka një dispozitë të veçantë, të aprovuar nga lart... Për sa u përket librave, ne kemi këtu bibliotekën tonë dhe atyre u jepet mundësia t'i lexojnë të gjitha librat që janë të lejuara.

— E kuptoj, por ky që ju them unë ka nevojë për libra shkencore, do të studjojë.

— Mos i besoni. — Gjenerali heshti. — Nuk i do për të studjuar, por ja ashtu kot, që të ngatërrojë dynjanë...

— Po më duket se në gjëndjen e rëndë në të cilën ndodhen, është një gjë e madhe për ta të merren me diçka... — tha Nekludovi.

— Ata përherë qahen, — tha gjenerali. — I njoh mirë. — Ai fliste për të burgosurit siç do të fliste për një rracë njerëzish të ulët. — Megjithatë ne kemi krijuar për ta të tilla komoditete që shumë rrallë mund të vihen re nëpër burgjet e tjera.

Dhe, si për t'u justifikuar, gjenerali nisi nga një përshkrim i hollësishëm i të gjitha komoditeteve që u ishin vënë në dispozicion të burgosurve aq sa, sipas fjalëve të tij, mund të mendohej se qellimi kryesor për të cilin qe ndërtuar burgu ishte vetëm për t'u siguruar atyre që mbaheshin atje një banesë sa më të rehatëshme dhe të këndëshme.

— Në fillim, ç'është e vërteta, trajtimi ka qenë shumë i rreptë, por tani trajtohen kaq mirë, sa s'ka ku të vejë më tepër. Hanë tri herë në ditë dhe medoemos një herë mish: qofte apo kotoleta. Të djelën kanë edhe ëmbëlsirë. Kështu që, dhëntë zoti, të hanë të gjithë rusët siç hanë ata!

Gjenerali, ashtu siç e kanë zakon të gjithë pleqtë, kur i hynte një bisede, nuk dinte të ndalej. Kështu dhe tani ai nisi të përsëris po ato që kishte thënë me qindra herë për të provuar mosmirënjohjen e të burgosurve.

— Për të lexuar u japim vazhdimisht, qoftë libra me përmbajtje fetare, qoftë edhe revista të vjetra. Në bibliotekë kemi nga të gjitha këto. Po ç'faj u kemi se nuk lexojnë? Në filim sikur tregojnë një farë interesi, por më vonë vëmë re se librat i shfletojnë gjer në një farë vendi, pastaj i brak-

tisin. Kjo duket nga faqet e paprera, kur librat janë të reja, ose nga faqet që janë të kthyera gjithmonë gjer në një vend të caktuar në rastin e librave të vjetra. Bile ne kemi bërë edhe një provë, si të thuash — tha gjenerali duke i mbledhur buzët në mënyrë që të sajonin diçka, që mund të dukej si një buzëqeshje — ja, kemi bërë kështu: kemi vënë ndërmjet faqeve të librit një copë letër. Dhe ç'kemi vënë re, thoni? Kemi vënë re që letra në fjalë nuk ka lëvizur vendit! Nuk i kemi penguar gjithashtu të shkruajnë-vazhdoi gjenerali. — Për këtë u kemi dhënë një pllakë të zezë si edhe një lapës plumbi; kështu që i kanë të gjitha mjetet e nevojëshme për këtë punë. Mund ta fshijnë pllakën e të shkruajnë përsëri sa t'u pëlqejë. Po ç'e do, nuk shkruajnë. Në fillim, çka, siç ju thashë, duken më të gjallë, por dalngadalë sikur mpihen, sikur plogështohen dhe bile vijnë e trashen... — tha gjenerali pa dyshuar mbi kuptimin e tmerrshëm që fshihej pas atyre fjalëve.

Nekludovi dëgjonte atë zë të ngjirur plaku, vështronte gishtrinjtë e tij të thatë me nyje, sytë e buhavitur nën vetullat e dendura, mollëzat me mishëra të varura që mbuloheshin gjer diku nga jaka e ngritur e uniformës, kryqin e bardhë me të cilin ky njeri mburrej se e kishte merituar në një kasaphanë jashtëzakonisht të tmerrëshme e të bujëshme dhe, duke i peshuar në mëndje të tij të gjitha këto, e kuptonte se ishte e kotë të kundërshtonte si edhe të orvatej t'i shpjegonte atij kuptimin e fjalëve që kishte thënë. Kështu, duke e përmbajtur me zor veten, e hodhi gjetkë fjalën dhe e pyeti për Shustovën që, siç i kishin thënë, duhej të lirohej po atë ditë.

— Shustova? Shustova... Nuk i mbaj mënd të gjithë me emër, se janë shumë, — tha ai dhe dukej qartë se u vinte faj atyre që ishin kaq shumë. Pastaj i ra ziles dhe dha urdhër të thërrisnin aty sekretarin.

Ndërsa sekretari nuk kishte ardhur akoma, gjenerali nisi t'i japë Nekludovit disa këshilla duke i thënë, ndërmjet të tjerave, se ata që i thonë vetes njerëz të ndershëm e fisnik, duke përfshirë, siç la të nënkuptohej, edhe veten e tij në radhët e këtyre njerëzve, duhet t'i shërbejnë carit... «dhe atdheut» — këtë fjalën e fundit e shtoi, me sa dukej, në mënyrë që fraza të kishte një ritëm më kumbonjës.

— Ja, unë, fjala vjen, jam plak por prapseprapë punoj me tërë fuqitë e mia...

Sekretari, një burrë thatim, me një fytyrë si të djegur por me një palë sy të shkathët e të mënçur, i raportoi gjeneralit se Shustova ndodhej në një vend pak a shumë si një fortifikatë e veçuar dhe se, në lidhje me lirimin e saj, akoma nuk kishte ndonjë urdhër nga lart.

— Porsa të na urdhërojnë, do ta lirojmë menjëherë, që atë ditë. Nuk e kemi zakon t'i mbajmë... Mos kujtoni se na pëlqen edhe aq shumë ajo shoqëria e tyre... — tha gjenerali, përsëri po me atë orvajtje të dështuar për t'i rrudhur buzët në një buzëqeshje tallëse.

Nekludovi u ngrit duke bërë çmos për të fshehur një ndjenjë të përzierë pështirimi dhe keqardhjeje që pati padashur kundrejt atij plaku të tmerrshëm. Plaku, nga ana e tij, mendonte se nuk i përkiste të tregohej dhe aq i rreptë me djalin mëndjelehtë dhe se nuk duhej ta linte të shkonte pa i dhënë akoma ndonjë këshillë.

— Atëhere, mirupafshim, i dashur; mos më mbani mëri për ato që ju thashë, se jua them nga që ju dua. Mos u përzini në punët e njerëzve që mbahen këtu. S'ka ndërmjet tyre asnjë që të mos jetë fajtor. Janë të gjithë të hurit e të litarit. Ne i njohim mirë, — tha me një ton që i jepte fund çdo dyshimi. Dhe me të vërtetë, ai vetë nuk dyshonte n'atë që thoshte, jo sepse ashtu ishte, siç thoshte ai, po sepse, po të qe ndryshe, nuk kishte si ta hiqte veten si një hero i dëgjuar e i nderuar që po ngryste me nder ditët e fundit që i kishin mbetur nga një jetë plot lavdi. Në këtë rast, do të qe i detyruar ta pohonte haptas se ishte një njeri i poshtër që e kishte shitur ndërgjegjen e tij dhe vazhdonte ta shiste akoma tani, në pleqëri. — Puna më e mirë për ju është të shërbeni — vazhdoi — Cari ka nevojë për njerëz të ndershëm... ashtu dhe atdheu, — shtoi. — Ja, mendoni, sikur unë, dhe të gjithë ne, të mos shërbenim? Kush do mbetej atëhere? Për ta kritikuar qeverinë ne jemi të vetmit, por që ta ndihmojmë, jo, këtë nuk e bëjmë!

Nekludovi psherëtiu, nderoi me një përulje të thellë dhe doli jashtë.

Gjenerali tundi kokën si me qortim dhe, duke fërkuar mezin, u kthye në sallon, ku e priste piktori që, ndërkaq, kishte marrë shënim mbi përgjegjen që kishte dhënë shpirti i Zhana d'Arkës. Gjenerali vuri syzet dhe lexoi: «Do ta njohin njeri tjetrin nga drita që do të lëshojnë trupat eterorë».

— Ah! — ja bëri gjenerali që dukej i kënaqur nga ajo përgjegje, duke mbyllur sytë. — Mirë, po vetëm një gjë. si



do të kuptohet drita është e njerit apo e tjetrit gjersa është e njëllojtë për të gjithë? — pyeti dhe, si i gërshetoi përsëri gishtrinjtë me piktorin, u ul pranë tryezës.

Karrocieri i Nekludovit qe larguar bashkë me karrocën, disa hapa nga burgu.

— Mërzi e madhe këtu, zotëri — tha, duke u drejtuar nga Nekludovi. — Mënt ika, pa ju pritur.

— Po, po, mërzitesh vërtet, — pranoi Nekludovi duke marrë frymë lirisht, ndërsa ndalte sytë, për t'u shplodhur, tek retë e shpupuritura që vozisnin në qiell dhe mbi ujërat e Nevës që shkëlqenin nga barkat dhe anijet që lundronin mbi të.

XX

Të nesërmen senati do të merrte në shqyrtim çështjen e Masllovës dhe Nekludovi shkoi në senat. Në hyrjen madhështore të ndërtesës së senatit, ku qenë rrjeshtuar një sërë karrocash luksoze, ai u takua me avokatin. Kur u ngjitën nëpër një shkallë tërë sqimë e madhështi në katin e dytë, avokati, që i njihte mirë atje të hyrat e të dalat, u drejtua për nga e majta tek një derë, që mbante mbishkrimin e datës së hyrjes në fuqi të kodit mbi proçedurën gjyqësore. Ajo dhomë, ku hyri Fanarini, ishte e gjatë dhe e ngushtë. Ai hoqi atje pallton dhe e pyeti portierin a kishin ardhur të gjithë senatorët. Portieri i tha se senatori i fundit porsa kishte kaluar pak më parë andej. Fanarini atëhere, pasi u çvesh duke nxjerrë në pah frakun e zi dhe kravatën e bardhë mbi kraharorin e tij, i sigurt dhe i qeshur, hyri në një dhomë tjetër, ngjitur me të parën. Në këtë dhomën e dytë, në të majtë, ishte vendosur një dollap i madh e një tryezë dhe që andej dukej gjithashtu një shkallë që gjarpëronte e ngjitej siprë, nëpër të cilën po zbriste poshtë atë çast një zvrtar elegant me uniformë dhe me një çantë nën sqetull. Porsa hyje në dhomë, të tërhiqte menjëherë vëmëndjen një plak me një pamje patriarkale, me flokë të bardhë e të gjatë, veshur me një setër e me një palë pantallona bojë hiri, në të dy anët e të cilit qendronin në këmbë me respekt të madh dy shërbetorë.

Plaku, i hollë dhe i shkurtër, me flokë të bardhë, hyri në dollap dhe atje u zhduk. Ndërkaq, Fanarini pa një koleg të tij, një avokat tjetër me kravatë të bardhë dhe me frak, iu

afrua menjëherë dhe nisi një bisedë të zjarrtë. Nekludovi hidhte syte rreth e rrotull dhe sodiste njerëzit që ndodheshin në dhomë. Atë ditë gjithsejt ishin nja pesëdhjetë vetë, ndër të cilët ishin edhe dy dama, njëra e re me syza, tjetra e shkuar nga mosha e me flokë të thinjur. Të gjithë këta kishin ardhur për të marrë pjesë në diskutimin e një padije kundra një çpifjeje në gazetë dhe prandaj qenë në pjesën më të madhe gazetarë.

Gjykatësi hetues, një burrë i pashëm, me faqe të kuqe, me një uniformë madhështore dhe me një copë letër në dorë, iu afrua Fanarinit dhe e pyeti t'i tregonte çështjen për të cilën kishte ardhur. Fanarini i shpjegoi se kishte ardhur për çështjen e Masllovës. Gjykatësi mori shënim dhe u largua. Atë çast dolli aty përpara plaku me pamje patriarkale, këtë radhë me një uniformë qëndisur me shirita dhe me disa stolira të tjera të ndritëshme mbi gjoks, që i jepnin pak a shumë pamjen e një zogu.

Me sa dukej, edhe vetë plakut i vinte turp nga ai kostum qesharak, që qe detyruar të vishte, sepse u drejtua nga porta dhe doli jashtë me një ritëm më të nxituar dhe me një hap më të shpejt se zakonisht.

— Ja, ai është Be-ja, një njeri me merita të rralla... — i tha Fanarini Nekludovit dhe si e njohu me kolegun e tij, tregoi me dy fjalë thelbin e çështjes që do të shqyrtohej pas pak dhe që, sipas mendimit të tij, paraqitej shumë interesante.

Seanca e parë e senatit filloi. Nekludovi, bashkë me publikun, hyri në një sallë të madhe në të majtë. Të gjithë, edhe Fanarini bashkë me të tjerët, zunë vend pas rrjetës së hekurt. Vetëm avokati i Peterburgut doli përpara dhe u ul pranë një tryezë matanë rrjetës ku ndodheshin senatorët.

Salla e debateve në senat ishte më e vogël se ajo e gjyqit të distriktit, qe më e thjeshtë për nga ndërtimi dhe, veç kësaj, këtu tryeza, rreth së cilës zunë vend senatorët, nuk ishte e mbuluar me një copë jeshile, por me një kadife të butë në një ngjyrë të kuqe të hapët të qëndisur anash me ar. Por, nga ana tjetër, ashtu si në çdo institucion tjetër që kishte për mision mbrojtjen e drejtësisë, edhe këtu nuk mungonin tri emblemat themelore: pasqyra-emblema e drejtësisë, ikona-emblema e hipokrizisë, portreti i carit-emblema e servilizmit. Po ashtu si në çdo gjyq, gjykatësi hetues shpalli me madhështi hapjen e seancës, po ashtu u ngritën në këmbë që të gjithë, po ashtu hynë në sallë senatorët me uniformat e

tyre, po ashtu u ulën në kolltuqet me shpina të larta, po ashtu i mbështeten bërrylat mbi tryezë dhe po ashtu u orvatën të marrin një pozë që të dukej sa më e natyrëshme.

Senatorët qenë katër: Nikitin, kryetari, një burrë me mjekër e pa mustaqe, me një fytyrë të ngushtë dhe me sy të çeliktë; Volfi, i cili i kafshonte or'e çast buzët në një mënyrë shumë kuptimplote dhe shfletonte dosjen e çështjes me duart e tij të bardha; Skovorodnikovi, një burrë i trashë, i kërrusur, me një fytyrë vrarëlije, që hiqej si një nga juristët më të ditur dhe, më në fund, Be-ja, pikërisht ai plaku me pamje patriarkale që kishte ardhur i fundit. Bashkë me senatorët, hynë gjithashtu sekretari dhe prokurori, ky i fundit një djalosh me flokë të shkurtëra dhe pa mjekër, me një trup mesatar, me fytyrë të zeshkët dhe me dy sy të zes e të brengosur. Nekludovi, me gjithë uniformën e çuditëshme që kishte veshur dhe sidoqë kish nja gjashtë vjet që nuk e kishte parë, njohu menjëherë në të një nga shokët e tij më të mirë në kohën kur ishte akoma student.

— Zëvëndës ober-prokurori mos quhet Selenin? — pyeti ai avokatin.

— Po. Pse?

— Njihem me të shumë mirë dhe e di që është një njeri shumë i zoti dhe shumë i ndershëm....

— Po, dhe merr vesh nga puna... Ja, atij t'i kishit thënë! — tha Fanarini.

— S'prish punë se, sidoqoftë, ai do të veprojë me ndërgjegje, — tha Nekludovi, duke sjellur ndërmënd marrëdhëniet e ngushta që kishte patur dikur me Seleninin si edhe thjeshtësinë, ndershmërinë dhe korrektesën e tij, në kuptimin më të mirë të këtyre fjalëve.

— Sidoqoftë, tani është vonë — pëshpëriti Fanarini, duke dëgjuar me vëmëndje fillimin e proçesit.

Proçesi filloi me leximin e ankesës kundra gjykatës së lartë që nuk kishte marrë masa për anullimin e vendimit të gjykatës së distriktit.

Nekludovi dëgjonte edhe ai me vëmëndje duke u munduar të kuptonte ku qendronte thelbi i çështjes. Por, ashtu siç i kishte ndodhur dikur edhe në gjyqin e distriktit, nuk kuptonte pothuajse asgjë, sepse ai që referonte nuk fliste aspak për vetë thelbin e çështjes, por për gjëra të tjera, që kishin një rëndësi të dorës së dytë. Ishte fjala për një artikull botuar në gazetë, ku demaskoheshin abuzimet e kryetarit të një shoqërie me aksione. Mund të mendohej se kishte rëndësi në

këtë mes të provohej se vërtet kryetari i shoqërisë aksioniste i kishte grabitur ortakët e tij dhe në ç'mënyrë duhej vepruar që të mos kishte mundësi t'i grabiste më këtej e tutje. Mirëpo për këtë as që bëhej fjalë. Përkundrazi, bëhej fjalë se, në bazë të ligjit, kishte apo nuk kishte të drejtë drejtori i gazetës ta botonte artikullin e feljetonistit dhe, duke e botuar, krimi që kish bërë duhej cilësuar si **difamacion** apo si **çpifje?** Pastaj vinin një varg argumentash që kishin për qëllim të sqaronin çështjen a e përfshinte difamacioni edhe çpifjen apo ndodhte krejt e kundërta, d.m.th. që çpifja e përfshinte edhe difamacionin etj. etj. si edhe shumë arsyetime të tjera të holla, që nuk mund të çmoheshin siç duhej nga profanët të cilët nuk i kishin parasysh të gjitha nenet, paragrafet e nënparagrafet e kodit mbi të cilat ata mbështeteshin.

Nekludovi mundi të kuptojë vetëm një gjë: që Volfi, i cili qe ngarkuar të referonte mbi çështjen, sadoqë dje ja kishte thënë në një mënyrë të prerë se senati nuk mund të hynte në brendinë e çështjeve që shqyrton, sot përkundrazi ishte e qartë se po referonte duke anuar haptas për apelimin e çështjes dhe për anullimin e vendimit të gjyqit. Nga ana tjetër Selenini, ndonëse kjo nuk pajtohej aspak me karakterin e tij të qetë e të përmbajtur, u shpreh kundra mendimit të Volfit në një mënyrë krejt të papritur dhe me shumë zjarr. Por nervozizmi që ai vuri re tek Selenini dhe që e habiti rridhte nga që Selenini e njihte kryetarin e shoqërisë aksionare për një njeri të poshtër e batakçi dhe, veç kësaj, kishte marrë vesh rastësisht se Volfi, pothuaj në vigjilje të shqyrtimit të çështjes në senat, kish qenë në shtëpinë e aksionistit në një drekë të pasur që kishte shtruar për nder të tij. Kështuqë tani, duke parë se si Volfi e parashtronte çështjen, duke u munduar të dukej i matur dhe i drejtë por, në të vërtetë me një anësi të dukëshme, Selenini u nxeh dhe e çfaqi mendimin e tij me një nervozizëm të tepruar, që nuk pajtohej aspak me banalitetin e çështjes që po shqyrtohej. U duk se fjalimi i tij e preku shumë Volfin: ai u skuq në fytyrë, u lëkund i tëri, bëri disa gjeste habije dhe pastaj rëndë-rëndë e me zemër të thyer u largua e hyri, bashkë me senatorët e tjerë, në dhomën e konsultimeve.

— Ju, në cilën çështje do të merrni pjesë? — e pyeti përsëri Fanarinin gjykatësi hetues porsa senatorët u larguan.

— Në çështjen e Masllovës. Më duket sikur jua thashë ... — u përgjegj Fanarini.

— Mirë, mirë. Kjo çështje do të shqyrtohet sot. Por...
— Çfarë? — pyeti avokati.
— Po ja, kam nderin t'ju vë në dijeni se kjo çështje ishte vendosur të shqyrtohej pa pjesmarjen e palëve. Kështuqë ndofta zotërinjtë senatorë nuk do të dalin përpara shpalljes së vendimit. Sidoqoftë po ju them...
— Si qenka kjo? Nuk e kuptoj.
— Po ju them, po ju them... — dhe gjykatësi diç shënoi në letrën që mbante në dorë dhe u largua.

Ashtu kishte qenë vërtet siç kishte thënë gjykatësi hetues. Senatorët qenë marrë vesh që, pas shpalljes së vendimit, mbi çështjen e çpifjes në gazetë, t'i shqyrtonin çështjet e tjera pa dalë nga dhoma e tyre gjatë çajit e duke pirë ndonjë cigare.

XXI

Porsa senatorët u ulën përreth tryezës në dhomën e konsultimeve, Volfi nisi të parashtrojë menjëherë me shumë gjallëri shkaqet për të cilat çështja duhej të apelohej.

Kryetari, që ishte zakonisht një nieri i zymtë, atë ditë dukej akoma edhe më i ngrysur. Ai e kishte formuar opinionin e tij mbi çështjen që kur ishin në sallë, kështuqë tani as që ja vinte fare veshin Volfit dhe dukej i zhytur në mendime. Këto mendime vërtiteshin rreth disa gjërave që kishte shkruar dje në kujtimet e tij me rastin e emërimit të Viljanovit në postin e rëndësishëm të cilin ai e lakmonte prej kohësh. Kryesenatori Nikitin ishte thellësisht dhe sinqerisht i bindur se gjykimi që kishte shprehur mbi nëpunësit e ndryshëm të të dy klasave të para me të cilat kishte patur të bënte gjatë kohës së shërbimit të tij, përbënin një material historik me një rëndësi të dorës së parë. Pasi kishte shkruar edhe në kujtimet e tij një kapitull, ku i kishin vënë me shpatulla në mur disa nëpunës që bënin pjesë në dy klasat e para, sepse e kishin penguar, siç shprehej, ta shpëtonte Rusinë nga katastrofa, ku po e shpinin qeveritarët e sotëm (por në të vërtetë vetëm e vetëm sepse e kishin penguar të merrte një rrogë më të madhe) ai mendonte tani se për ata që do të vinin më pas të gjitha këto çështje do të shiheshin krejt me një prizëm tjetër.

— Po, natyrisht, — tha ai duke iu përgjegjur fjalëve të Volfit, që s'e kishte dëgjuar fare.

Be-ja nga ana e tij e dëgjonte Volfin duke i dhënë fytyrës një shprehje të pikëlluar dhe sakaq e kalonte kohën duke vizatuar në një copë letër disa kurora. Be-ja ishte një liberal nga ata më të përsosurit. Ai i ruante me fanatizëm traditat liberale të vitit gjashtëdhjetë dhe, nëqoftëse nga ndonjëherë mbante ndonjë qendrim të pa anëshëm, këtë e bënte vetëm në favor të liberalizmit. Kështu, konkretisht, në çështjen që shqyrtohej atë ditë, Be-ja ishte kundra apelimit jo vetëm sepse kryetari i shoqërisë aksioniste që qe ankuar për shpifje në gazetë ishte një njeri i ndytë, por edhe sepse akuza që i bëhej një gazetari për shpifje duhej marrë si një formë e kufizimit të lirisë së shtypit. Kur Volfi hoqi një nga një të gjitha konkluzionet që rridhnin nga arsyetimet e tij, Be-ja, pa e përfunduar kurorën që kishte në dorë, si shumë i bezdisur që e detyronin të provonte disa gjëra që s'kishin nevojë për asnjë provë, me një zë të butë e të këndshëm tregoi me pak fjalë e me një mënyrë bindëse dobësinë e themeleve mbi të cilën ngrihej ankesa dhe pastaj, si e kërrusi përsëri atë kokën e tij të bardhë, vazhdoi i qetë vizatimin e kurorës që i kishte mbetur për gjysëm.

Skovorodnikovi, që kishte zënë vend përballë Volfit dhe që tërë kohës mblidhte me gishtrinjtë e trashë qimet e mjekrës dhe të mustaqeve dhe i fuste në gojë, porsa Be-ja mbaroi së foluri, pushoi menjëherë edhe ai së përtypuri dhe, me një zë të fortë e të ngjirur, tha se, sadoqë kryetari i shoqërisë aksioniste ishte një batakçi i tërë, ai do të shprehej me gjithë qejf për mos apelimin e çështjes, po të qe se në ligjë do të mund të gjëndeshin argumentat e nevojëshme për një gjë të tillë, por meqënëse, mjerisht, nuk qe kështu, ai bashkohej me mendimin e Ivan Semjonoviçit (Be). Duke thënë këto fjalët e fundit, Skovorodnikovit i qeshte fytyra, ndofta nga që iu dha rasti t'i këputë një thumb të mirë Volfit. Po atë mendim shprehu më në fund edhe kryetari dhe çështja mori një zgjidhje negative.

Volfi ishte i pakënaqur sidomos sepse i qe dukur sikur e kishin akuzuar tërthorazi për një anësi me paqëmendim. Ai u ngut t'i jepte përsëri fytyrës së tij një shprehje të qetë dhe si hapi dosjen ku përmbahej çështja e Masllovës, u zhyt në studimin e saj. Senatorët ndërkaq i ranë ziles dhe, si dhanë urdhër që t'u sillnin çajin, hapën një bisedë të gjatë mbi një ndodhi që kalonte atë kohë gojë më gojë në gjithë Peterburgun bashkë me duelin e Kamenskut.

Ishte fjala për një drejtor departamenti, i zënë në flag-

rancë ndërsa kryente krimin e parashikuar nga neni 995.

— Ç'maskarallëk! — tha me neveritje Be-ja.

— Pse? Ç'ka këtu ndonjë gjë të keqe? Unë mund t'ju tregoj në literaturën tonë projektin e një shkrimtari gjerman, i cili propozon haptas që martesa ndërmjet burrave jo vetëm të mos konsiderohet si një krim, por të shpallet përkundrazi si një gjë krejt e ligjëshme, — tha Skovorodnikovi, duke plasaritur buzët mbi cigaren e shtypur që e thithte me epsh të madh duke e mbajtur thellë ndërmjet gjishtrinjve, pothuaj mbi pëllëmbë. Pastaj, menjëherë ja shkrepi gazit.

— Nuk është e mundur! — tha Be-ja.

— Do t'jua tregoj, — tha Skovorodnikovi, duke cituar titullin e plotë të veprës, bile edhe datën e vendin e botimit.

— Thonë se tani do ta caktojnë gubernator në ndonjë qytet të Siberisë, — tha Nikitin.

— Shumë mirë. Peshkopi atje do t'i dali përpara me kryq. Po thuaj të jetë një peshkop tamam si ai. Unë ashtu do t'ua rekomandoja, — tha Skovorodnikovi dhe, si e përdrodhi bishtin e cigares në tavëll, mblodhi aq sa i nxinte dora qimet e mjekrës e të mustaqeve në gojë dhe nisi t'i përtypë.

Atë çast hyri në dhomë gjykatësi hetues, i cili i vuri në dijeni senatorët mbi dëshirën që kishin çfaqur avokati dhe Nekludovi për të qënë të pranishëm në shqyrtimin e çështjes së Masllovës.

— Kjo çështje është tamam një histori nga ato të romaneve! — tha Volfi dhe tregoi të gjitha sa kishte marrë vesh mbi marrëdhëniet e Nekludovit me Masllovën.

Si biseduan gjerë e gjatë edhe për këtë, pasi pinë çajin dhe cigaret, senatorët duallën më në fund në sallën e seancave, shpallën vendimin mbi çështjen që kishin shqyrtuar pak më parë dhe kaluan në shqyrtimin e çështjes së Masllovës.

Volfi parashtroi, me atë zërin e tij të hollë, kërkesën për apelim të Masllovës, në një mënyrë shumë të hollësishme dhe përsëri po me atë anësi të dukëshme që linte të kuptohej qartë se ai ishte në favor të apelimit.

— Kini ndonjë gjë për të shtuar? — pyeti kryetari duke iu drejtuar Fanarinit.

Fanarini u ngrit në këmbë dhe, si e nxori përpara gjoksin e gjerë me këmishë të bardhë të kollarisur, provoi me një llogjikë bindëse dhe me një saktësi të foluri të habitësh-

me se gjyqi i qe larguar interpretimit të drejtë të ligjit në shtatë pika dhe, përveç kësaj, mori guximin të prekte, qoftë edhe shkurtimisht, brendinë e çështjes dhe, lidhur me këtë, absurditetin flagrant të vendimit të marrë. Toni i përgjithshëm i fjalimit të shkurtër, por të fuqishëm të Fanarinit, linte të kuptohej se ai u kërkonte ndjesë zotërinjve senatorë që ngulnin këmbë në disa gjëra të cilat ata me mëndjemprehtësinë e tyre si edhe me njohjen e thellë të ligjeve i kuptonin fare mirë, porse Fanarini që i shtyrë ta bënte këtë vetëm e vetëm nga angazhimi që kishte marrë përsipër kundrejt klientit të tij. Pas fjalimit të Fanarinit, u duk se nuk mund të kishte më as pikë dyshimi që senati do ta anullonte vendimin e gjyqit. Si mbaroi së foluri, Fanarini u ul përsëri në vendin e tij duke buzëqeshur për fitoren që, mendonte, duhej të kish korrur. Duke kthyer kokën nga avokati i tij dhe duke vënë re atë buzëqeshje, Nekludovi u sigurua edhe një herë se çështja do të përfundonte patjetër në favor të tyre. Por, kur ktheu përsëri kokën nga senatorët, pa se ata nuk buzëqeshnin aspak si Fanarini. Përkundrazi, senatorët dhe zëvëndës ober-prokurori jo vetëm që nuk buzëqeshnin por, me atë çehren e mërzitur që kishin në fytyrë, dukej sikur thonin me vete: «Nuk na e mbush dot mëndjen. Ohu, sa kemi dëgjuar të tjerë kështu si ty!» Ata, që të gjithë, pa përjashtim, u çelën në fytyrë vetëm kur avokati i dha fund fjalimit dhe, njëkohësisht, edhe mërzisë që i kishte pushtuar gjatë kohës që ai fliste. Kryetari u ngrit në këmbë dhe ia dha fjalën pa humbur kohë zëvëndës ober-prokurorit. Selenini u shpreh shkurtimisht, por në një mënyrë të përpiktë dhe të qartë, kundra apelimit, meqënëse të gjitha argumentat pro ishin krejt të pathemelta. Fill pas kësaj, senatorët u ngritën dhe shkuan të konsultoheshin. Në dhomën e konsultimeve zërat qenë të kundërtë. Volfi ishte për apelimin; Be-ja, që i hyri menjëherë në thelb çështjes, nguli këmbë gjithashtu me vendosmëri që vendimi i gjyqit të anullohej, duke u përshkruar kolegëve një kuadro të gjallë të rrethanave që, sipas mendimit të tij, kishin ndikuar në përgjegjet e gabuara të zhurisë; Nikitini, që desh të tregohej përherë më i rrepti e njëkohësisht edhe më burokrati nga të gjithë, u shpreh kundra. Kështu çdo gjë tani varej nga qendrimi i Skovorodnikovit. Po edhe ky u bashkua me mendimin për refuzimin e apelit dhe këtë e bëri më tepër sepse revoltohej shumë duke menduar që Nekludovi, duke përmbushur një kërkesë të ndërgjegjes së tij, kishte vendosur të marto-

hej me një grua siç ishte Masllova.

Skovorodnikovi ishte materialist, darvinist dhe prandaj të gjitha çfaqjet e ndjenjës morale dhe, aq më tepër, ato të ndjenjës fetare, i quante si një marrëzi që duhet urryer e që e fyente edhe atë vetë personalisht. Tërë ajo zhurmë që bëhej për një prostitutë, prania atje, në senat, e një avokati të dëgjuar siç ishte Fanarini, që kishte ardhur për ta mbrojtur si edhe e vetë Nekludovit, e neveriste Skovorodnikovin aq sa s'thuhej. Prandaj, si e mbushi gojën me qime të mjekrës, u hoq, pa të keq, sikur nuk dinte asgjë për atë çështje por që, meqënëse argumentat e apelimit nuk ishin të mjaftueshme, pajtohej me mendimin e kryetarit për të mos marrë asnjë masë kundra vendimit të gjvqit.

Dhe kështu ankesa nuk u muarr parasysh.

XXII

— Po kjo është e tmerrëshme! — tha Nekludovi duke dalë jashtë në koridor bashkë me avokatin — Faktet duken sheshit po ata dhe këtu duan të ruajnë format dhe nuk i marrin parasysh. Kjo është e tmerrëshme!

— Fajin e kanë ata poshtë në gjyq! — tha avokati.

— Edhe Selenini e kundërshtoi. Tmerr, tmerr! — vazhdonte të përsëriste Nekludovi. — Po tani si i bëhet?

— T'i bëjmë një lutje për falje perandorit. Po ua shkruaj unë. Po, gjersa jeni këtu, mundohuni ta dorëzoni vetë.

Atë çast, Volfi, me atë trupin e tij të vogël veshur me uniformën e stolisur me kryqe në gjoks, doli edhe ai në koridor dhe iu afrua Nekludovit.

— Nuk ke ç'i bën, i dashur princ. Arësyet nuk ishin të forta — tha duke ngritur supet e ngushtë dhe u largua.

Menjëherë pas Volfit, doli edhe Selenini që kishte marrë vesh nga senatorët se Nekludovi, shoku i tij i vjetër, ndodhej atje.

— Nuk besoja se do të takohesha me ty këtu — tha ai dhe iu afrua Nekludovit duke buzëqeshur, vetëm me buzë, ndërsa sytë vazhdonin ta tregonin të brengosur. — Unë nuk e dinja që ti ishe në Peterburg.

— Kurse unë nuk e dinja që ti ishe ober-prokuror...

— Zëvëndës — e ndreqi Selenini. — Ç'të solli këtu në senat? — pyeti ai duke i hedhur shokut një vështrim të

brengosur e të pikëlluar. — Përse ke ardhur në Peterburg? Po këtu pse ke ardhur?

— Kam ardhur me shpresë se do të gjeja drejtësi e të shpëtoja kështu një grua që është dënuar duke qenë krejt e pafajshme.

— Cilën grua?

— Atë, n'atë çështje që u shqyrtua pak më parë.

— Ah, e ke fjalën për Masllovën! — tha Selenini. — Ankesa e saj s'kishte asnjë bazë.

— Nuk është fjala për ankesën, por për njeriun që është i detyruar të vuajë një dënim të padrejtë.

Selenini psherëtiti.

— Ndofta është ashtu si thua ti, por...

— Jo ndofta, por me siguri...

— Po ti nga e di kaq mirë?

— E di, sepse bëja pjesë në zhuri kur u gjykua dhe e di gabimin që kemi bërë.

Selenini u mendua një hop.

— Duhet ta kishe thënë që në krye.

— E thashë.

— Duhej të qe shënuar në proçes verbal. Sikur kjo rrethanë t'i qe shtuar kërkesës për apelim...

Selenini që ishte gjithmonë shumë i zënë me punë dhe që fare pak e frekuentonte shoqërinë, nuk dinte, me sa dukej, asgjë mbi marrëdhëniet e Nekludovit me Masllovën; Nekludovi, nga ana e tij, duke e vënë re këtë, mendoi që nuk ishte nevoja ta vinte në dijeni.

— Po sidoqoftë edhe tani dukej fare qartë që vendimi ishte krej absurd — tha ai.

— Senati nuk ka të drejtë ta thotë këtë. Sikur senati të ndërhynte për apelimin e vendimeve të gjyqit duke u mbështetur në pikëpamjen e tij mbi karakterin e ligjëshmërisë së këtyre vendimeve, jo vetëm që do të humbiste në këtë mënyrë çdo pikëmbështetje duke i shtuar e jo duke i pakësuar për pasojë rastet e padrejtësisë, por ajo që ka edhe më tepër rëndësi, do të pranonte tërthorazi që vendimet e zhurisë nuk kanë vleftë.

— Unë vetëm këtë di të them: që ajo grua është e pafajëshme dhe se tani nuk ka më asnjë shpresë për ta shpëtuar nga një dënim i pameritуar. Organi më i lartë i ligjëshmërisë e ka shkelur ligjin me këtë rast me të dy këmbët.

— Kjo nuk mund të thuhet sepse ai nuk është shprehur as pro as kundra, meqënëse shqyrtimi i çështjes në brendi dilte jashtë kompetencave të tij, — tha Selenini duke rrudhur sytë. — Ti, besoj, je ndalur tek tetua, — shtoi, duke dashur, me sa dukej, të hidhej në një temë tjetër. — Dje mora vesh prej saj që ti ishe këtu. Kontesha më ftoi që të merrja pjesë dje në një mbledhje, ku do të fliste një predikator që ndodhet rastësisht në Peterburg, — tha Selenini, duke buzëqeshur, si përherë, vetëm me buzë.

— Kam qenë n'atë mbledhjen që thua, po kam dalë andej i pështirosur, — tha me të rreptë Nekludovi, të cilit i erdhi inat që Selenini e hodhi bisedën gjetkë.

— E përse paske dalë i pështirosur? Fundja, sido që të jetë, duhet parë si një çfaqje e ndjenjës fetare, qoftë edhe e njëanëshme, sektare, — tha Selenini.

— Thuaj më mirë që duhet parë si një çfaqje e egër marrëzie! — ja ktheu Nekludovi.

— Eh, jo! Vërtet janë gjëra që na habitin, po kjo rrjedh nga se, duke e njohur fare pak doktrinën e kishës sonë, ato që nuk janë tjetër veçse dogmat e saja themelore ne i marrim për interpretime të reja dhe arbitrare të fesë, — tha Selenini sikur nxitonte t'i njoftonte ish shokut të tij të ngushtë pikëpamjet e tija të reja mbi fenë.

Nekludovi e vështroi Seleninin ngultas dhe i habitur. Po ashtu e vështroi edhe Selenini Nekludovin dhe sytë e tij kishin tani një shprehje jo vetëm të brengosur por edhe armiqësore.

— Po pse, ti beson në dogmat e kishës? — e pyeti Nekludovi.

— Besoj, sigurisht — u përgjegj Selenini duke e shikuar Nekludovin drejt e në sy me një vështrim të vdekur.

Nekludovi psherëtiu.

— Çudi... — tha.

— Sidoqoftë, për këto mund të flasim gjerë e gjatë një herë tjetër — tha Selenini. — Erdha! — shtoi duke u kthyer nga nëpunësi i zhurisë që i afrohej ndërkaq me shumë respekt. — Duhet të takohemi pa tjetër — tha me një psherëtimë, duke u kthyer përsëri nga Nekludovi. — Po nuk e di do të të gjej në shtëpi. Mua më gjen çdo ditë aty nga ora shtatë. Nadezhdinskaja shtëpia numër.... Eh. ka rrjedhur shumë ujë që atëhere — tha më në fund, duke u larguar gjithë po me atë buzëqeshje vetëm me buzë.

— Do të vi ndonjë ditë, po të kem kohë, — tha Nekludovi, i cili ndjente sakaq se Selenini që kishte qenë dikur për të një njeri aq i afërt e i dashur, menjëherë, pas asaj bisede të shkurtër, qe shndërruar befas në një njeri të largët e krejt të huaj, në mos në një armik të vërtetë, me tërë kuptimin e fjalës.

XXIII

Selenini student, ashtu siç e mbante mënd Nekludovi, ishte një njeri me cilësira të rralla, një shok besnik dhe, për moshën që kishte, një njeri me kulturë të madhe, me shumë takt, përherë elegant dhe i pashëm dhe, në të njëjtën kohë, i drejtë, i ndershëm. Në mësime shkonte shumë mirë dhe, pa e munduar veten, pa as më të voglën gjurmë të pedantizmit, fitonte vazhdimisht në disertacione medaljen e artë. Jo vetëm me fjalë, por edhe me vepra ai kishte treguar se i kishte vënë për qellim vetes ta vinte jetën e tij ende të njomë në shërbim të njerëzve. Po mendonte se do t'ja arrinte këtij qëllimi vetëm duke u marrë me ndonjë punë shtetërore, kështu që porsa e mbaroi universitetin, shqyrtoi sistematikisht një e nga një të gjitha aktivitetet ku mendonte se do të mund të qe më tepër i dobishëm për shoqërinë dhe vendosi. më në fund, të hynte në seksionin e dytë të Kancelerisë Perandorake që merrej posaçërisht me hartimin e ligjeve. Por, me gjithe se i kryente më së miri të gjitha ato sa kërkoheshin prej tij, ai nuk gjeti kënaqësi në këtë punë dhe nuk arriti dot të fitojë bindjen se po bënte pikërisht atë që duhej të bënte. Kjo pakënaqësi, për shkak të mosmarrëveshjeve të vazhdueshme që kishte me shefin e zyrës, njeri mëndjemadh dhe bosh, arriti gjer n'atë shkallë sa që ai u detyrua të japi dorëheqjen nga seksioni i dytë e të hynte në senat. Në senat ishte më mirë por, megjithatë, ndjenja e pakënaqësisë që kishte provuar në punën e mëparëshme e ndoqi edhe këtu.

Ai ndjente në të turbullt se nuk ishte pikërisht ajo punë që kishte dashur për veten e tij, dhe sikur kishte diçka në atë mes që nuk ishte në rregull. Gjatë kohës së shërbimit në senat, t'afërmit e tij ndërhynë që të emërohej gjithashtu kamer-junker dhe, pas kësaj, ai u detyrua të vishej me një uniformë të qëndisur, të vinte një përparëse të bardhë dhe të shkonte në karrocë derë më derë për të falënderuar

të gjithë ata të cilëve ua detyronte, drejtpërdrejt apo tërthorazi, ate titull dhe ate rrobe prej lakej. Ai qe munduar t'i gjente një kuptim të caësyeshëm këtij funksioni të rëndësishëm që i kishin ngarkuar, por më kot. Prandaj, ai ndjeu përsëri dhe me një forcë të dyfishuar këtë radhë, se ajo punë «sikur nuk qe pikërisht ajo që ai kish dashur». Por, nga ana tjetër, ai nuk kishte si të mos e pranonte këtë ofiq të ri, sepse e dinte që do t'i hidhëronte, po të vepronte në këtë mënyrë, të gjithë ata që, duke e emëruar n'atë ofiq të rëndësishëm, kishin qenë të sigurt se do t'i bënin një nder të madh. Veç kësaj, ky emërim lajkësonte gjer diku instinktet e ulta të natyrës së tij dhe atij i bëhej qejfi kur e shihte veten në pasqyrë me uniformën qëndisur me ar dhe i vinte mirë për respektin që ngjallte në shumë njerëz ky ofiq.

Po kjo i ndodhi edhe kur u martua. Atij i kombinuan një martesë që nga pikëpamja e shoqërisë mondane, nuk kishte si të bëhej më e shkëlqyer. Edhe këtë radhë ai pranoi kryesisht sepse, po të mos pranonte, do të hidhëronte të fejuarën, që kishte shumë qejf të martohej me të, po ashtu edhe ata të cilët e kishin kombinuar martesën. Veç kësaj i bëhej qejfi kur mendonte se do të martohej me një vajzë të re, të bukur, që rridhte nga një familje e dëgjuar. Por martesa doli edhe më tepër «jo ashtu siç duhej të qe» se sa shërbimi dhe ofiqi pranë Oborrit mbretëror. Pas fëmijës së parë, gruaja nuk deshi të ketë fëmijë të tjerë dhe nisi të bënte një jetë mondane dhe lluksoze në të cilën, dashur pa dashur, u detyrua të marri pjesë edhe ai. E shoqja, që nuk shquhej për ndonjë bukuri të veçantë, sidoqë i qëndronte besnike, e vazhdonte atë jetë me një rregullsi të përpikët, gjë kjo që ja helmonte jetën burrit dhe e vinte atë vetë në mundime e shqetësime të kota. Të gjitha përpjekjet e tij për ta kandisur të shoqen që të hiqte dorë nga kjo jetë kishin dështuar me turp përpara bindjes së saj dhe të njerëzve që e rrethonin se ashtu duhej rrojtur.

Fëmija që kishin, një vajzë me flokë të praruara, të gjata e kaçurrela dhe me kërcinj të hollë, ishte një qënie krejt e huaj për t'anë, ndofta edhe sepse e kishin edukuar jo ashtu siç kish dashur ai. Duke munguar nga të dy anët dëshira për ta kuptuar njeri tjetrin, ndërmjet bashkëshortëve u vendos një gjëndje e ndeme mosmarrëveshjesh të përditëshme si edhe një armiqësi e heshtur dhe e qetë që mbahej fshehur nga të huajt e që, ndonëse zbutej gjer diku nga rregullat e shoqërisë ja bënte atij jetën në shtëpi

shumë të rëndë. Kështu që jeta familjare ndodhi të jetë për të edhe me tepër «jo ashtu siç duhej të qe» se sa shërbimi dhe ofiqi pranë Oborrit mbretëror.

Por akoma dhe më tepër «jo ashtu siç duhej të qe» ishte qëndrimi që ai u detyrua të mbajë, nga rrethanat, kundrejt fesë. Ashtu si edhe të gjithë njerëzit e rrethit dhe kohës së tij, ai kish këputur, pa as më të voglin mundim por vetëm për hir të zhvillimit të tij mendor, të gjitha prangat e bestytnive fetare me të cilat e kishin mbërthyer që në vogëli, pa e ditur as vetë se në ç'kohë pikërisht që çliruar prej tyre. Duke qenë njeri serioz dhe i ndershëm, ai nuk e kishte fshehur këtë çlirim nga bestytnitë e fesë zyrtare në rini, gjatë kohës kur kish qenë student dhe kur kish zënë miqësi me Nekludovin. Por, me kalimin e viteve, me lartësimin në karrierë dhe sidomos me valën e reaksionit konservator që kishte vërshuar atëhere në shoqëri, kjo liri shpirtërore që bërë për të një pengesë. Pa marrë parasysh që në përshpirtjen e t'et i që dashur të shkonte në kishë e të falej, që në shtëpi e ëma e detyronte të mbante kreshëm ashtu siç mbanin të gjithë, në punë ai që i detyruar të merrte pjesë në një sërë ceremonish fetare me raste inaugurimesh, bekimesh e falënderimesh. Duke marrë pjesë në këto ceremonira, ai duhej të zgjidhte njerën nga këto të dyja: ose të bënte sikur besonte n'atë që nuk besonte (gjë që me atë karakterin e tij s'ishte në gjëndje ta bënte dot kurrë), ose, duke e pranuar haptas gënjeshtrën që fshihej pas tërë atyre formave të jashtme, ta ndërtonte jetën e tij në mënyrë të tillë që të mos që i detyruar të merrte pjesë në këtë gënjeshtër. Por kjo e fundit nuk ishte një punë aq e lehtë sa mund të dukej se, për këtë, jo vetëm që duhej të vihej në një gjëndje lufte të vazhdueshme me të gjithë njerëzit që e rrethonin, por duhej ta ndryshonte nga themeli edhe të gjithë pozitën e tij shoqërore e të hiqte dorë nga puna duke sakrifikuar në këtë mënyrë dobinë që mendonte se i sillte e do t'u sillte dhe më tepër në të ardhmen njerëzve n'atë punë. Këtë gjë mund ta bëjë vetëm një njeri që është plotësisht i bindur në vërtetësinë e pikëpamjeve të tij. Ai ishte një njeri i tillë. Ai ishte plotësisht i bindur në vërtetësinë e pikëpamjeve të tij ashtu si nuk ka se si të mos jetë i bindur në vërtetësinë e pikëpamjeve të tija lidhur me fenë çdo njeri me mënd në kokë i kohës sonë që e ka lexuar ndopak historinë, që e di prejardhjen e fesë në përgjithësi dhe prejardhjen e ndarjen e fesë kishëtare kristiane. Ai nuk

kishte se si të mos e dinte që kishte të drejtë duke e mohuar vërtetësinë e doktrinës kishëtare.

Por nën presionin e rrethanave të jetës, ai, njeriu i drejtë, i lejoi vetes një gënjeshtër të vogël sipas së cilës, për të provuar që ajo që s'është e arësyeshme, s'është e arësyeshme, duhet që ajo që nuk është e arësyeshme të studjohet me qëllim që të shihet në se është me të vërtetë e tillë. Kjo ishte një gënjeshtër e vogël por pikërisht kjo e kishte sjellur pas atë gënjeshtrën e madhe në të cilën ai tani përpëlitej.

Duke i bërë pyetje vetes në se feja orthodokse në të cilën ai kishte lerë e qe edukuar dhe së cilës qe i detyruar t'i besonte, sepse këtë e kërkonin që të gjithë prej tij dhe sepse ndryshe ai nuk do të qe më në gjëndje të vazhdonte punën e rëndësishme që bënte në dobi të njerëzve, Selenini i përgjigjej «po» kësaj pyetjeje që më parë. Dhe prandaj sqarimin e kësaj çështjeje nuk e kërkoi as tek Volteri, as tek Shopenhaueri, as tek Spenseri, as tek Konti, por në veprat fillozofike të Hegelit dhe në librat fetare të Vinet e të Homjakovit dhe, natyrisht, gjeti atje pikërisht atë që i duhej: një shëmbëllesë arësyetimi dhe justifikimi të doktrinës fetare me të cilën qe edukuar, që arësyeja prej kohësh nuk ja pranonte, por pa të cilën jeta mbushej plot me andralla. Kështu ai iu vu punës dhe i përvetësoi shpejt e shpejt të gjitha ato sofizma që orvaten të provojnë se njeriu nuk ka mundësi të njohi vetëm në veten e tij të vërtetën, se e vërteta mund të zbulohet vetëm nga një kolektiv njerëzish, se revelata është nën mbikqyrjen e fesë etj. etj. Kjo i lejoi, të merrte pjesë në përshpirtjen, në bekimet, falënderimet e ceremonitë e tjera fetare dhe të mbante kreshmë e të bënte kryqin përpara ikonave e gjithashtu të vazhdonte me ndërgjegje të qetë në punë një veprimtari që mendonte se ishte në dobi të njerëzve dhe që e çlironte gjer diku nga hallet e jetës së palumur familjare. Ai mendonte se besonte por, në të njëjtën kohë, ndjente se ai besim nuk ishte «tamam ashtu siç duhej të qe». Dhe këtë e ndjente me të gjitha forcat e shpirtit të tij e me një bindje që ishte më e fortë tek ai se çdo bindje tjetër.

Prandaj sytë e tij kishin kurdoherë një shprehje të brengosur. Prandaj kur pa Nekludovin, të cilin e kishte njohur në një kohë kur të gjitha këto gënjeshtra akoma nuk kishin hedhur rrënjë tek ai, atij iu kujtua vetja ashtu siç kishte qenë dikur dhe, tamam në çastin kur ngutej t'i çfaq-

te tërthorazi shokut pikëpamjet e tija të reja në lidhje me fenë, kish ndjerë më tepër se kurrë se këto pikëpamje nuk qenë «ato që duhej të qenë» dhe se në përgjithësi «nuk qe ajo që duhej të qe» as edhe vetë jeta e tij.

Pikërisht këtë, pas kënaqësisë që provoi kur u takua pas kaq kohe me shokun e tij të vjetër, ndjeu edhe Nekludovi.

Prandaj, si njeri, si tjetri, megjithëse i premtuan shoshokut se do të takoheshin përsëri, i trëmbeshin këtij takimi dhe nuk u takuan më sa kohë që Nekludovi qendroi në Peterburg.

XXIV

Kur dolën nga Senati, Nekludovi dhe avokati ecën të dy bashkë nëpër trotuar. Avokati e porositi karrocierin që t'i ndiqte pas me karrocë dhe nisi t'i tregonte Nekludovit punën e drejtorit të departamentit për të cilin kishin biseduar në mes tyre senatorët. Tha se pasi e kishin zënë në faj, në vend që ta dënonin sipas ligjit me punë të detyruar, e kishin emëruar gubernator në Siberi. Pasi e tregoi me të gjitha hollësitë këtë histori të ndytë ai foli, me një kënaqësi të dukëshme, edhe për një vjedhje të bujëshme që ishte kryer nga disa njerëz me pozitë që kishin vënë dorë mbi fondin e mbledhur për ngritjen e monumentit të papërfunduar përpara të cilit ata kishin kaluar atë mëngjes. Avokati tregoi gjithashtu edhe një sërë historirash e qyfyresh gjithfarë ku bëhej fjalë ndërmjet të tjerave për të dashurën e njërit që kishte fituar në bursë disa miljona, për një tjetër që i kishte blerë shokut gruan e për shumë krime të rënda si këto të kryera nga njerëz të dëgjuar që nuk ndodheshin aspak në burg, por në ofiqet më të larta të shtetit. Avokati i tregonte me shumë qejf të gjitha këto anekdota të vërteta sepse, me sa dukej, i jepnin mundësi të provonte më së miri se mjetet që përdorte ai vetë për të nxjerrë të holla duheshin cilësuar me plot të drejtë të ligjëshme dhe të lejueshme në krahasim me mjetet që përdoreshin për këtë qëllim nga funksionarët e lartë të Peterburgut. Prandaj avokatit i erdhi keq kur Nekludovi ja la përgjysëm një histori shumë interesante që po tregonte atë çast për hiletë e një nëpunësi të lartë dhe, si u nda prej tij, mori një karrocë dhe u kthye në shtëpinë e tetos në bregun e Nevës.

Nekludovi e ndjente veten shumë të brengosur. Kjo rridhte sidomos sepse senati kish vënë vulën e aprovimit të tij mbi vuajtjet e padrejta të Masllovës dhe sepse ky aprovim e bënte akoma dhe më të vështirë vendimin e tij të prerë për ta bashkuar fatin e vet me fatin e saj. Kjo brengë bëhej akoma dhe më e ndjeshme tek ai nga përshtypjet që i kishin lënë historitë e tmerrëshme mbi ligësinë e njerëzve për të cilët i kishte folur me aq qejf avokati dhe, veç kësaj, nga se atij i kujtohej vazhdimisht vështrimi i ftohtë, i lik dhe armiqësor i Seleninit, i atij që dikur kishte qenë shoku i tij më i mirë.

Kur Nekludovi u kthye në shtëpi, portjeri i dha me një farë përçmimi një pusullë që e kishte shkruar atje, në zyrën e portjerit, një grua që kishte ardhur ta takonte. Pusulla ishte nga e ëma e Shustovës. Ajo thoshte se kishte ardhur për ta falënderuar si shpëtimtarin e së bijës dhe i lutej t'u bënte një vizitë në shtëpinë e tyre, Vasiljevskaja, linja 5, apartamenti numur... Kjo ishte shumë e nevojëshme, shkruante ajo, për një arësye që lidhej ngushtë me fatin e Vera Efremovnës. Jo, jo, — thuhej më poshtë në pusullë — nuk do ta mërzitnin duke e falënderuar njëmijë herë për të mirën që u kishte bërë, por, ja, kishin qejf ta shikonin dhe të shkëmbenin me të dy fjalë. Po të kishte mundësi, le të vinte makar të nesërmen, në mëngjes.

Nekludovi mori edhe një pusullë tjetër: kjo ishte nga adjutanti Bogatirjev, të cilin ai e kishte lutur që t'i dorëzonte në dorë perandorit një lutje për falje n'emër të sektantëve. Bogatirjevi, me at shkrimin e tij të trashë dhe energjik, shkruante se do ta mbante fjalën dhe do t'ja jepte pa tjetër në dorë lutjen perandorit, por shtonte se kishte menduar që do të kishte qenë ndofta më mirë sikur Nekludovi të takohej më parë me personin nga i cili varej kjo çështje se, kishte të ngjarë që t'ja zgjidhte pa qenë nevoja për lutjen.

Nekludovi, pas ngjarjeve të ditëve të fundit në Peterburg, i kishte humbur të gjitha shpresat për t'i realizuar qëllimet që i kishte vënë vetes ashtu siç kishte dashur. Planet që kishte hartuar lidhur me këto, që kur ndodhej akoma në Moskë, i dukeshin pak a shumë si ato ëndërrat rinore që janë paracaktuar të dështojnë porsa njeriu fillon ta njohi mirë jetën. Por, megjithatë, duke qenë në Peterburg, ai e ndjente se e kishte për detyrë të bënte çmos për realizimin e tyre dhe pra vendosi që të nesërmen, pasi të takohej me

Bogatirjevin të shkonte edhe tek ai personi që e kishte në dorë çështjen e sektantëve.

Ndërsa po e nxirrte nga çanta lutjen e sektantëve dhe po i hidhte një sy, befas ra dera dhe hyri në dhomë lakej i konteshës Katerina Ivanovna që e ftoi të urdhëronte sipër për çaj.

Nekludovi tha se do të shkonte menjëherë dhe, si e futi përsëri lutjen në çantë, u ngjit tek tetua. Në shkallë hodhi sytë nga dritarja dhe pa në rrugë çiftin e kuajve kuqalosh të Mariette-s. Menjëherë erdhi në qejf dhe, pa e kuptuar as vetë përse, vuri buzën në gaz.

Mariette, me një kapele në kokë që s'ishte këtë radhë e zezë por me një ngjyrë të hapët dhe me një fustan të shndritëshëm e të larmë, kish zënë vend pranë poltronës së tetos e rrinte ashtu me një filxhan në dorë duke biseduar me të kokë më kokë ndërsa sytë e bukur tërë shkëlqim se përse i qeshnin or'e çast. Kur Nekludovi hyri në dhomë, Marriette porsa kishte thënë diçka që ishte kaq për të qeshur dhe në të njëjtën kohë kaq e ndytë (Nekludovi e kuptoi këtë nga karakteri i të qeshurit) sa që kontesha Katerina Ivanovna, me ato qimet e mustaqeve që i nxinin mbi buzë, u shqye gazit duke përpëlitur tërë trupin e saj të plotë; ndërsa Mariette me një shprehje të veçantë mischievous, duke e shtrëmbëruar lehtë gojën që i buzëqeshte e duke kthyer fytyrën e saj energjike dhe të qeshur pak mënjanë, e shikonte bashkëfolësen e saj pa thënë më dot asnjë fjalë.

Nga ca fjalë që dëgjoi, Nekludovi kuptoi se po flisnin për ngjarjen e dytë që kish bërë bujë atë kohë në Peterburg, domethënë për episodin e gubernatorit të ri të Siberisë. Ai kuptoi gjithashtu se Mariette, pikërisht në lidhje me këtë, kish thënë diçka kaq qesharake saqë konteshës iu desh shumë kohë para se ta merrte vehten nga gazi.

— Kam frikë se do të më bjerë të fikët — tha ajo duke u kollur. Nekludovi përshëndeti dhe u ul pranë tyre. Porsa matej ta gjykonte me veten e tij Mariette-n për mëndjelehtësinë që kishte treguar, kur ajo, duke vënë re shprehjen serioze dhe disi të pakënaqur të fytyrës së tij, për t'i pëlqyer (dhe kësaj kishte vendosur t'ja arrinte me çdo kusht që në takimin e parë) jo vetëm që i dha fytyrës një çehre tjetër por, në të njëjtën kohë, e ndryshoi aty për aty edhe gjëndjen shpirtërore në të cilën ndodhej atë çast. U bë e zymtë, si një njeri që është i pakënaqur nga jeta e tij, si një njeri që priret nga diçka më e lartë, që diç kërkon

dhe e kërkon më kot. Dhe këtë e bëri me një mënyrë të pavetëdijëshme ndofta edhe për atë vetë por që synonte, dhe kjo ishte e qartë, që të përvetësonte sa më shumë gjëndjen shpirtërore në të cilën ndodhej atë çast Nekludovi sido që me fjalë mbase nuk do t'ishte kurrë në gjëndje ta përcaktonte.

E pyeti se si i shkonin punët. Ai foli për humbjen që kishin pësuar në senat dhe për takimin e tij me Seleninin.

— Ah! Ç'njeri me shpirt të pastër! Ai është tamam le chevalier sans peur et sans reproche [1]), — thanë me një zë të dy damat duke i ngjitur Seleninit epitetin me të cilin njihej përgjithësisht në shoqëri.

— Po e shoqja e tij si është? — pyeti Nekludovi.

— Ajo? Jo, nuk dua të flas keq për të, por sidoqoftë një gjë është e vërtetë për të: që ajo nuk e kupton të shoqin! Po është e mundur që edhe ai të jetë shprehur kundra? — pyeti ajo me një keqardhje të thellë e të sinqertë. — Kjo është e tmerëshme! Ah, sa keq, sa keq! — shtoi dhe psherëtiu.

Nekludovi u mvrejt në fytyrë dhe e hodhi bisedën tek Shustova, të cilën e kishin nxjerrë nga burgu me ndërmjetësinë e të shoqit të saj. Ai e falënderoi atë dhe të shoqin dhe nisi të thoshte se ishte një gjë shumë e tmerrëshme që një grua dhe tërë familja e saj të vuante vetëm sepse asnjeriut s'i kishte rënë ndërmënd për ta. Por Mariette ja mori fjalën nga goja duke u shprehur po aq e revoltuar sa dhe ai.

— Hiç mos ma thoni — tha. — Porsa mora vesh nga im shoq që ajo e burgosura mund të lirohej menjëherë, pikërisht ky mendim më erdhi dhe mua. Thash me vete: po pse e paskan mbajtur në burg atëhere gjersa paska qenë e pafajëshme? — vazhdoi ajo me duf duke thënë po ato që matej të thoshte edhe Nekludovi — Kjo është një gjë që të revolton kaq shumë, kaq shumë sa s'ka ku të shkojë!

Kontesha Katerina Ivanovna po e shikonte që Marriette po bënte çmos për t'i pëlqyer të nipit të saj dhe kjo e zbaviste së tepërmi.

— E di se ç'dua të të them? — tha ajo kur që të dy heshtën — Eja nesër mbrëma tek Aline të dëgjojmë Kizeveterin. Eja dhe ti, — shtoi duke u drejtuar nga Mariette.

— Il vous a remarqué [2]) — i tha ajo të nipit. — Më

---

1) Kalorës guximtar dhe që s'ka të sharë.
2) Ai ju vuri re (frëngj.)

tha se të gjitha ato që më the ti — se ja tregova — janë shenjë e mirë dhe se s'ka dyshim që një ditë do të ndjekësh rrugën e Krishtit. Ja kështu më tha. Prandaj eja pa tjetër. Ja, thuaj Mariette që të vijë. Eja dhe vetë.

— Unë, konteshë, nuk kam, në radhë të parë, asnjë të drejtë t'i jap ndonjë këshillë princit, — tha Mariette, duke i hedhur Nekludovit një vështrim që kishte për qëllim të vendoste mes saj dhe atij një përputhje të plotë pikëpamjesh në lidhje me fjalët e konteshës dhe në lidhje me evangjelizmin në përgjithësi, — dhe, së dyti, siç mund ta dini, mua nuk më pëlqejnë dhe aq...

— Po, po, e di fort mirë që ti bën përherë ndryshe nga bota.

— Pse ndryshe? Unë besoj siç beson çdo grua e thjeshtë, e padjallëzuar — tha ajo duke buzëqeshur. — Dhe, së treti — vazhdoi — unë nesër shkoj në theatrin francez...

— Ah! Po atë a e pe? Atë... si e quajnë? — pyeti kontesha Katerina Ivanovna.

Mariette i përmëndi emrin e një aktoreje franceze të dëgjuar.

— Shko, shko pa tjetër, ajo me të vërtetë që të mahnit me lojën e saj!

— Po kë të shikojmë më parë, **ma tante** [1]), aktoren apo predikatorin? — tha Nekludovi duke buzëqeshur.

— Të lutem shumë, mos shiko të më kapësh në fjalë!

— Unë mendoj të dëgjojmë më parë predikatorin e pastaj të shkojmë në theatër, se ndryshe zor se do të mund ta shijojmë si duhet predikimin — tha Nekludovi.

— Jo, më mirë të fillojmë nga teatri francez e pastaj të bëjmë pendesë — tha Mariette.

— I lini mënjanë shakatë, mos kërkoni të talleni me mua! Predikatori nuk i prish punë theatrit, as theatri predikatorit. Secili bën punën e tij. Apo mos kujtoni që për shpëtimin e shpirtit duhet të rrimë ditë e natë duke i varur buçkat shtatë pashë? Kaq mjafton, s'është nevoja për gjë tjetër!

— Ju, ma tante, ua kaloni të gjithë predikatorëve.

— E dini ç'kam menduar? — tha Mariette pasi u mendua një copë herë — A nuk vini nesër në lloxhën time?

— Kam frikë se nuk do të kem kohë...

Biseda u ndërpre atë çast nga një lake që hyri për të laj-

---

1) Tezja ime.

mëruar se një zotëri deshte të takohej me zonjën konteshë. Ky ishte sekretari i një shoqërie mirëbërëse që kryesohej nga vetë Kontesha.

— Uf, sa i mërzitshëm që është ky njeri! Më mirë po e pres vetëm, në dhomën tjetër. Pastaj po vij prapë këtu. I jepni të pijë çajin, Mariette, — tha kontesha duke u larguar me hapa të shpejta e duke u lëkundur nga salla.

Mariette hoqi dorashkën duke zbuluar një dorë energjike, po dhe pak si të shtypur, ngarkuar me unaza.

— Dëshëroni? — tha ajo, duke marrë çajnikun e argjend që ndodhej mbi një primus me alkol, ndërsa e ngrinte përpjetë gishtin e vogël të dorës në një mënyrë të çuditëshme.

Fytyra e saj kishte marrë përsëri nji shprehje të zymtë e të brengosur.

— Nuk mund ta merrni me mënd se sa vuaj kur mendoj që edhe njerëzit, të cilët unë i çmoj më tepër nga të gjithë, më mveshin me të padrejtë të gjitha zotësirat që janë lidhur me pozitën time në shoqëri.

Duke shqiptuar fjalët e fundit ajo dukej sikur do të shkrepte në vaj. Këto fjalë, megjithëse po t'i shqyrtojmë pak thellë nuk kishin asnjë kuptim fort të rëndomtë, Nekludovit iu dukën jashtëzakonisht të thella, të sinqerta e me një domethënie të lartë. Por kjo, s'kish dyshim, i detyrohej kryesisht vështrimit të syve plot shkëlqim me të cilin i përcolli këto fjalë ajo grua e re, e bukur dhe e veshur mirë.

Nekludovi e vështronte i heshtur dhe s'ishte i zoti t'i hiqte dot sytë nga fytyra e saj.

— Ju, ndofta kujtoni se nuk u kuptoj, se nuk kuptoj ato që ndodhin në shpirtin tuaj. Po gaboheni. Nuk mund të ketë asnjeri që të mos jetë në gjëndje t'i çmojë ato që keni bërë ju. Ç'est le secret de polichinelle. Unë u admiroj dhe e aprovoj me gjith shpirt!

— Nuk e di se çfarë mund të ketë këtu për t'u admiruar. Gjer sot akoma nuk kam bërë ndonjë gjë të madhe.

— Kjo nuk ka të bëjë. Puna është tek ndjenjat që ju frymëzojnë dhe të cilat unë, për pjesën time, i kuptoj plotësisht. E po mirë, mirë, nuk po ju flas më për këtë — tha Mariette duke vënë re që Nekludovit nuk i vinte mirë që po e mburrnin. — Por do të më lejoni t'ju them që, sipas mendimit tim, duke parë vuajtjet e tmerret e burgjeve — tha Mariette që duke depërtuar thellë me intuitën e saj si femër në problemet që e mundonin atë çast shpirtin e tij, kërkonte

vetëm e vetëm si t'i hynte në qejf — ju doni t'u ndihmoni atyre që vuajnë kundra mospërfilljes dhe mizorisë së tmerrëshme të njerëzve... Ah, e kuptoj, e kuptoj fort mirë se si njeriu mund ta sakrifikojë edhe jetën e tij për një qëllim kaq të lartë. Edhe unë vetë do ta sakrifikoja. Po, dihet, secili ka fatin e tij në jetë...

— Mos doni të thoni që nuk jeni e kënaqur me fatin tuaj?

— Kush? Unë? — pyeti ajo, gioja si e habitur që mund t'i drejtohej një pyetje e tillë. — Unë duhet të jem e kënaqur dhe jam e kënaqur. Por herë-herë zgjohet në shpirtin tim një krimb...

— Atë krimb mos e lini kurrë të dremiti, kini besim n'atë që u thotë! — tha me zjarr Nekludovi, që ra kokë e këmbë në kurthin e gënjeshtrave të saja.

Më vonë Nekludovi e kujtoi kaq herë me turp këtë bisedë; solli ndërmënd jo vetëm fjalët e rreme që ajo i tha, por edhe atë fytyrë që mundohej dhe ja arrinte të merrte po atë shprehje që kishte edhe fytyra e tij atë çast, si edhe atë përqëndrim e ankth të tepruar që pikturohej në çdo tipar të saj kur ai i fliste për tmerret e burgut dhe për përshtypjet e tij nga fshati.

Kur u kthye kontesha, ata bisedonin mes tyre jo vetëm si dy miq të ngushtë që njiheshin prej kohësh, por edhe si dy njerëz që arrinin ta kuptonin plotësisht njeri tjetrin mes turmës që nuk i kuptonte.

Ata flisnin për regjimin që ishte i padrejtë, për vuajtjet e njerëzve, për popullin që ishte i varfër dhe për shumë gjëra të tjera por, sakaq, sytë e tyre që e shigjetonin or'e çast me një vështrim njeri tjetrin përmes zhurmës së bisedës, pyesnin me ngulm: «A mund të më dashurosh?» dhe gjegjeshin: «Po, mundem». Një ndjenjë thjesht seksuale, në njëmijë trajta të befta e të stërholluara i tërhiqte me forcë ndaj njeri tjetrit, ndonëse, ndofta ata vetë nuk e kuptonin.

Kur u ndanë, ajo i tha se do t'ishte përherë e gatëshme t'i vinte në ndihmë me sa të mundej dhe iu lut të takohej me të të nesërmen në theatër, qoftë edhe për një minutë, meqënëse do t'i fliste për diçka shumë me rëndësi.

— Po atëhere kur do të shihemi përsëri me ju? — shtoi duke psherëtitur dhe nisi ta futi me kujdes dorën e ngarkuar me unaza në dorashkë. — Më jepni, pra, fjalën se do të vini.

Ai ja dha fjalën.



Atë natë, kur mbeti vetëm në dhomë dhe, si e shoi qiriun, ra në dyshek, Nekludovi nuk i mbylli dot sytë menjëherë. Duke sjellur ndërmënd Masllovën, dështimin në seherë. Duke sjellur ndërmënd Masllovën, dështimin në Senat, vendimin e tij të prerë që ta ndiqte Masllovën në Siberi, fshatin dhe tokat që i kishte falur, Nekludovi, si për t'iu përgjigjur të gjitha problemeve që ngrinin kokë vetvetiu në trurin e tij, përfytyronte fytyrën e Mariettes, psherëtimin dhe vështrimin e saj kur tha: «Po atëhere kur do të shihemi përsëri me ju?» dhe pastaj buzëqeshjen e saj që e kishte në mëndje kaq të qartë sa i dukej sikur e shikonte dhe tani. «A bëj mirë që shkoj në Siberi? A bëj mirë që heq dorë nga pasuria?» — pyeti ai veten.

Të turbullta ishin përgjigjet që ai u dha këtyre pyetjeve në Peterburg në atë natën e qartë që depërtonte me shkëlqimin e saj përmes shtoreve gjysmë të unjura të dritareve. Çdo gjë ngatërrohej në kokën e tij. Ai u bënte thirrje ndjenjave që kishte patur dikur dhe mendimeve që e kishin vënë në atë pozitë në të cilën ndodhej tani; por mendimet nuk kishin më për të atë forcë bindëse.

Po sikur të gjitha këto të mos jenë veç pjellë e imagjinatës sime? Po sikur më vonë të pendohem? — i tha ai vetes dhe, duke mos qenë në gjëndje t'i mposhti këto shqetësime, ndjeu se pushtohej nga një mërzitje dhe një dëshpërim që s'e kishte provuar kurrë herë tjetër. Duke mos qenë në gjëndje të hidhte qoftë edhe një dritë të zbetë mbi të gjitha këto çështje, ai mbylli sytë e ra në një gjumë të rëndë, ashtu siç e kishte zakon një herë e një kohë kur humbiste ndonjë shumë të madhe në kumar.

XXV

Të nesërmen, kur u zgjua, Nekludovi pati përshtypjen se një natë më parë kish kryer një vepër të keqe.

Nisi të kujtohej: jo, nuk kishte bërë ndonjë vepër të keqe, por kishte patur disa mendime të këqija sipas të cilave rridhte se të gjitha qëllimet e tij — martesa me Katjushën dhe ralja e tokave fshatarëve, nuk ishin tjetër veçse ëndërra, ëndërra që nuk mund të viheshin kurrë në jetë, se ai nuk kishte aq forcë në veten e tij sa të mos lëkundej gjer në fund dhe se të gjitha këto gjëra që ai i kishte çpikur vetë nga mëndja ishin thjeshtë marrëzi dhe se duhej të rronte ashtu siç kish rrojtur më parë.

Pra nuk kishte në këtë mes asnjë vepër të keqe, po kishte diçka që ishte dhe më e keqe akoma se një vepër e keqe. Këto qenë mendimet e këqia nga të cilat burojnë të gjitha veprat e këqia. Veprën e keqe mund edhe të mos e përsëritësh dhe të pendohesh që e ke bërë, por mendimet e keq a mnain vetvet u veprimet e këqia.

Një vepër e keqe sheshon udhën për të tjera vepra të këqia, po mendimet e këqia të shtyjnë detyrimisht në këtë udhë.

Duke sjellur ndërmënd mendimet që kish patur një ditë më parë, Nekludovi habitej me veten e tij se si kishte mundur t'u besonte atyre, qoftë edhe për një çast. Sido që jeta që kishte vendosur të bënte ishte diçka e re dhe e vështirë, ai e kuptonte se vetëm ajo jetë ishte tanimë e mundëshme për të. Sidoqë fare lehtë do të mund të kthehej në jetën e mëparëshme, ai e kuptonte se kjo do të qe për të baraz me vdekjen. Mashtrimi i djeshëm i paraqitej tani atij si puna e atij njeriut që, ndonëse është zgjuar nga gjumi dhe nuk do më të flerë, prapë i pëlqen të rrijë shtrirë rehat në dyshek, megjithëse e di fort mirë që duhet të ngrihet se e pret puna.

Atë ditë, që ishte dita e fundit që do të qendronte në Peterburg, ai shkoi që në mëngjes tek Shustova, në ishullin Vasiljevskij.

Apartamenti i Shustovës ndodhej në katin e dytë. Nekludovi, sipas udhëzimeve që i dha portieri poshtë në të hyrë të ndërtesës, u fut në një koridor të errët e, që andej, duke u ngjitur në ca shkallë të rrëpira, doli drejt e në një kuzinë të ngrohtë që mbante erë gjellë. Një grua e shkuar nga mosha, me mëngë të përvjelura, me përparëse dhe me syza, qendronte pranë sobës dhe diç po trazonte me lugë në një tenxhere që avullonte.

— Ju kë kërkoni? — pyeti ajo me të egër duke ja hedhur sytë të panjohurit përmbi syzat mbi hundë.

Nekludovi po matej të thoshte si e quanin, por atë çast fytyra e gruas mori përnjëherësh një shprehje tjetër, një shprehje frike e gëzimi në të njëjtën kohë.

— Ah, princ! — klithi gruaja duke fshirë duart në përparëse. — Po pse hytë nga shkalla e pasme? Na kini bërë një të mirë që s'kemi si t'jua shpërblejmë! Unë jam e ëma e saj, dhe për pak na e muarën në qafë vajzën! E pse? Ja, ashtu kot! Po jua dimë për nder juve — tha ajo duke i kapur Nekludovit dorën e duke u orvatur që t'ja puthte. — Dje isha në

shtëpinë tuaj. M'u lut sidomos motra. Ja, këtu është edhe ajo. Këtej, nga kjo anë, urdhëroni, urdhëroni pas meje! — vazhdonte të thoshte e ëma e Shustovës, duke i hequr rrugë Nekludovit përmes një dere të ngushtë në një koridor të vogël e t'errët, ndërsa, duke ecur, herë ndreqte fustanin, herë rregullonte flokët. — Por për motrën time do të kini dëgjuar besoj, e quajnë Kornillova, — pëshpëriti me t'ulët duke u ndalur përpara një dere. — E kanë marrë për politikë kaq herë. Është grua e mënçur shumë.

Si e hapi derën në fund të koridorit, Shustova plakë e futi Nekludovin në një dhomë të vogël. Përpara tryezës, në një divan të vogël, që ulur një vajzë e plotë nga trupi, me shtat mesatar, me një këmishë të hollë me vija dhe me flokë të verdhë e kaçurrel që ia rrethonin nga të dy anët si një kurorë fytyrën e rrumbullakët e shumë të zbetë që ngjiste me atë të s'ëmës. Përballë saj që ulur, i thyer më dysh mbi tryezë, një djalosh me mustaqe, me një mjekër të hollë e të zezë dhe me një këmishë ruse me jakë të qëndisur. Që të dy qenë të dhënë pas bisedës që po bënin saqë nuk e ndjenë fare që dikush hyri në dhomë dhe e kthyen kokën vetëm kur Nekludovi ndodhej pothuaj përpara tyre.

— Lidia, princi Nekludov, ai vetë...

Vajza me fytyrë të zbetë brofi në këmbë me nervozizëm, duke ndrequr një cullufe flokësh, që i kishte shkarë mbi vesh, dhe i nguli Nekludovit sytë e saj bojëhiri e të trëmbur.

— Ju qenkeni ajo gruaja e rrezikëshme për të cilën m'u lut Vera Efremovna? — e pyeti Nekludovi dhe i shtriu dorën duke buzëqeshur.

— Po, unë vetë, — tha Lidia duke zbuluar me një buzëqeshje të pastër fëminore një sërë dhëmbësh të shëndoshë e të bardhë. — Tetua kishte shumë dëshirë t'ju shikonte. Teto! — thirri ajo duke u kthyer nga dera me një zë të butë e t'ëmbël.

— Vera Efremovnës i kish ardhur shumë keq që ju kishin arrestuar, — tha Nekludovi.

— Ja, uluni këtu; jo, këtu më mirë, — tha Lidia duke treguar kolltukun me një këmbë të thyer, që djaloshi e liroi atë çast menjëherë. — Kushëriri im, Zaharov, — shtoi vajza duke vënë re vështrimin që i hodhi Nekludovi djaloshit.

Djaloshi, me një buzëqeshje po aq të përzëmërt sa ajo e Lidës, e përshëndeti mysafirin dhe, kur Nekludovi u ul në vendin e tij, mori një karrige dhe ndenji atv pranë. Nga dera tjetër doli dhe një gjimnazist gjashtëmbëdhjetë vjeçar,

leshverdhë që, pa thënë asnjë fjalë, u ul mbi pezulin e dritares.

— Vera Efremovna është shumë shoqe me teton, po unë vetë asqë e njoh fare, — tha Lidia.

N'atë e sipër nga dhoma ngjitur doli një grua me një fytyrë shumë të hijëshme dhe të mënçur, me një bluzë të bardhë shtërnguar në bel me një brez të trashë lëkure.

— Tungjatjeta! E po falëminderit që erdhët — nisi të thotë ajo menjëherë porsa zuri vend në divan pranë Lidës. — Po Veroçkën si e kemi? E keni parë? Mërzitet ndopak në burg?

— Jo, ajo nuk qahet, — tha Nekludovi, — thotë se e ndjen veten si ato perënditë e moçme në Olimp.

— Ah, Veroçka, tamam fjalët e saj! — tha tetua e tundi kokën duke buzëqeshur. — Ashtu është ajo. Ka një karakter të çuditshëm. Gjithçka për të tjerët, për vete asgjë.

— Po, për veten e saj nuk bëhej fare merak, po i vinte shumë keq për mbesën tuaj. I vinte keq sidomos, siç më thoshte, se e kishin futur në burg kot, pa ndonjë arësye.

— Ashtu vërtet, — tha tetua. — Tmerr! Në vend që të më mirrnin mua, muarrën atë.

— Kjo, teto, nuk është aspak e vërtetë! — ndërhyri Lidia. — Unë, po të mos kishit qenë ju, do t'i kisha marrë vetë traktet.

— Prit, prit të flas unë një herë, se këtë e di më mirë nga ty! — tha tetua. — Që thoni ju, — vazhdoi ajo duke u drejtuar nga Nekludovi — kjo ndodhi sepse një person m'u lut t'i ruaja përkohësisht disa dokumenta të fshehta, mirëpo nga që s'kisha ku t'i mbaja duke mos patur shtëpinë time, ja dhashë kësaj. Po, do ti, po atë natë vinë dhe e bastisin shtëpinë, i gjejnë dokumentat që ju thashë dhe na e marrin edhe vajzën brënda, që ta detyrojnë t'u tregojë se kush ja ka dhënë.

— Po unë nuk ua tregova, — ndërhyri me të shpejtë Lidia, duke përdredhur me nervozitet cullufet e flokëve, që nuk po e bezdisnin as fare.

— Nëqoftëse e arrestuan Mitinin, kjo nuk ndodhi aspak për fajin tim! — tha Lidia duke u skuqur në fytyrë e duke hedhur sytë rreth e rrotull me shqetësim.

— Lëre atë muhabet, Lidoçka, — i tha e ëma.

— Jo, pse, dua ta tregoj si ka qenë puna, — tha Lidia, këtë radhë me inat e jo më duke buzëqeshur e, ndërsa sku-

qej në fytyrë, hidhte sytë rreth e rrotull e gjithë përdridhte me nervozizëm flokët kaçurrel.

— Harrove se ç'ndodhi dje, kur nise të na tregosh për këtë punë?

— Jo, nuk harrova... Po të lutem, mama, mos më pengo! Nga unë nuk ka dalë asnjë fjalë. Kur ai më pyeti dy herë për tetot dhe për Mitinin, unë i thashë se kurrë nuk do t'i përgjigjesha. Atëhere ai... Petrovi...

— Petrovi është një spiun, një xhandar i ndyrë. një njeri i poshtër, — ndërhyri tetua duke u drejtur nga Nekludovi.

— Atëhere ai — vazhdonte Lidia që dukej shumë e tronditur, — u mundua të ma prishi mëndjen. «Rrëfimet e tua, më tha, nuk do të dëmtojnë njeri, përkundrazi... do të lirohen shumë njerëz nga burgu të cilët, ndofta, vuajnë kot». Po unë ngula këmbë n'atë timen dhe thashë se nuk do të flas. Atëhere ai më tha: «Mirë, s'prish punë, mos flisni, po të paktën mos mohoni ato që do të them unë.» Dhe ai më zuri në gojë disa emra, ndërmjet tyre edhe emrin e Mitinit.

— Mirë, mirë, po lëre tani, — tha tetua.

— Ah, të lutem teto, mos ma prit fjalën... — tha Lidia gjithë duke përdredhur flokët dhe duke hedhur sytë rreth e rrotull. — Dhe ja, papritmas, të nesërmen, marr vesh, ç'marr vesh, thoni? Që Mitinin e kishin arrestuar! Ma thanë shokët me të trokitura në mur... E po, thashë me vete, unë e kallxova! Dhe kaq shumë, kaq shumë nisi të më brejë ndërgjegja, sa dhe për pak lojta mënç.

— Kurse në të vërtetë, siç doli në shesh më vonë, ata nuk e kishin zbuluar aspak nëpërmjet teje, — tha tetua.

— Po, po, mirëpo atëhere unë nuk e dija. Dhe ja kështu, m'u mbush mëndja se unë e kisha tradhëtuar. Vërtitesha lart e poshtë nëpër qelinë time dhe mendoja tërë kohën: e kallxova! Shtrihem të flë, mbulohem me batanie, kur dëgjoj një zë që më pëshpërit mu në vesh: «e kallxove, e kallxove Mitinin, e kallxove Mitinin». Ndonëse e dija që nuk ishte tjetër veçse një aluçinacion, prapë nuk mund të mos ja vija veshin atij zëri. Dua të flë — nuk mundem, dua të mos mendoj — prapë nuk mundem. Ah, nuk mund ta merrni me mënd se sa gjë e tmerrëshme! — tha Lidia me një tronditje përherë e me të dukëshme, ndërsa i përdridhte e i shpërdridhte prapë në gjisht bishtat e flokëve e vazhdonte të shihte rreth e rrotull e shqetësuar.

— Mjaft, Lidoçka, mjaft fole! Pusho tani! — i thoshte or'e çast e ëma duke e prekur në sup.

Po Lidoçka nuk ndalej dot më.

— Po ajo më e tmerrshmja është se... — nisi ajo përsëri, por nuk mundi ta mbarojë fjalën se u bë prush në fytyrë dhe, si brofi nga divani, duke u mbajtur nga shpina e kolltukut që të mos rrëzohej, vrapoi në dhomë. E ëma i ra pas.

— Këta të poshtër duhen varur, — tha gjimnazisti që qe ulur në dritare.

— Po ti? — e pyeti e ëma.

— Kush, unë? Jo, jo, hiç... — tha gjimnazisti dhe, si rrëmbeu një cigare që ndodhej mbi tryezë, e ndezi dhe e piu.

XXVI

— Po, s'ka më gjë të tmerrëshme për një të ri se sa të burgoset në një qeli të vetmuar, — tha tetua dhe tundi kokën duke ndezur edhe ajo një cigare.

— Unë mendoj për të gjithë, — tha Nekludovi.

— Jo, jo për të gjithë, — ja ktheu tetua. — Siç më kanë treguar, për revolucionerët e vërtetë, kjo është një shplodhje, një qetësim i përkohëshëm. Një ilegal rron përherë në ankth si për veto ashtu edhe për shokët e tij dhe për çështjen e përbashkët pa marrë parasysh pastaj mungesat materiale të cilave ai është i detyruar t'u nënshtrohet për ditë. Po ja e arrestojnë dhe atëhere çdo gjë për të merr fund. Nuk ka më asnjë çqetësim, nuk ka më asnjë përgjegjësi, kështu që mund të rrijë të shplodhet në burg i qetë. Bile, nuk e di se sa është e vërtetë po, të paktën kështu më kanë thënë, disa gëzohen kur i kapin. Por, natyrisht, për të rinjtë, për ata që janë të pafajshëm — dhe në fillim këta e pësojnë, si fjala vjen Lidoçka — për këta «shoku» [1]) i parë është me të vërtetë i tmershëm. Nuk është fiala për kufizimin e lirisë, për trajtimin e ashpër, për ushqimin e keq dhe, në përgjithësi, për të gjitha vuajtjet qe e presin njeriun në burg. Jo, jo, këto s'janë asgjë! Këto jo aq sa janë, po edhe sikur tri herë më tepër sikur t'ishin mund të duroheshin lehtë, sikur të mos qe ai «shoku» moral në të cilin ndesh patjetër kushdo që hyn për herë të parë në burg.

1) Choc (frëngj.): goditje.

— Po ju këtë e kini provuar?

— Unë? Unë kam qenë në burg dy herë — tha tetua me një buzëqeshje të këndëshme por edhe të trishtuar. — Kur më muarrën për herë të parë — dhe më muarrën kot fare — vazhdoi ajo — isha njëzet e dy vjeçe, kisha një fëmi dhe isha prapë me barrë. Po ju them, ndonëse ishte një gjë shumë e rëndë për mua humbja e lirisë si edhe ndarja nga fëmija e nga burri, të gjitha këto s'ishin gjë hiç në krahasim me atë që ndjeva kur kuptova që nuk isha më një njeri, por një plaçkë. Dua ta përqafoj për herë të fundit time bijë dhe, ja, më thonë që të hipi menjëherë në karrocë. Pyes se ku po më shpien, më thonë se do ta marr vesh pasi të arrijmë. Pyes ç'faj kam bërë e nuk më përgjigjen. Kur, pas hetimeve. më xhveshën, më veshën me rrobat e burgut, më ngjitën një numër, më shtynë nëpër koridor, hapën përpara meje një derë, më përplasën atje, e mbyllën derën me çelës dhe ikën duke më lënë vetëm me një roje me pushkë që lëvizte lartë e poshtë i heshtur dhe shikonte ndonjëherë më të rrallë përmes vrimës së derës së qelisë, nuk mund t'jua përshkruaj dot atë që ndjeva. Po, më kujtohet, nuk më dilte nga mëndja se si oficeri i xhandarmërisë, gjatë kohës që më pyeste, më tha nëse kisha qejf të ndizja një cigare. Pra, thosha me vete, ai e di fort mirë që njerëzve u pëlqen duhani, e atëhere s'ka se si të mos e dijë gjithashtu se sa u pëlqen njerëzve liria dhe drita dhe se sa e do një nënë fëminë dhe fëmija t'ëmën. Po si atëhere më çkëputën me forcë mua nga çdo gjë që ishte për mua e shtrënjtë dhe më mbyllën në një strofkë të ndyrë si t'isha ndonjë bishë e egër? Për këtë unë duhej pa tjetër të hakmirresha. Kushdo që beson në zot, kushdo që beson në dashurinë e njerëzve për njeri tjetrin, pas kësaj e humbet këtë besim. Kështu edhe unë që atëhere nuk u besova më njerëzve dhe u bëra e keqe, — e përfundoi tregimin e saj tetua duke vënë buzën në gaz.

Nga dera pas së cilës qe zhdukur Lidia, doli atë çast e ëma e saj dhe tha se Lidia nuk e ndjente veten mirë dhe kishte nevojë të shplodhej.

— E muarrën në qafë këtë vajzë! — tha tetua. — Dhe më vjen keq. sidomos, se, padashur, shkakëtare qesh unë.

— Do zoti, i bën mirë klima e fshatit, — tha Shustova plakë — do ta dërgojmë tek i ati.

— Të mos kishit qenë ju, mbase edhe do të kishte vdekur, — tha tetua. — Jua dimë për nder. Por unë desha të takohesha me ju edhe për një arësye tjetër. Do t'ju lutem t'i

jepni nga ana ime një letër Vera Efremovnës, — tha ajo duke nxjerrë nga xhepi një zarf të hapur. — Zarfin nuk e kam mbyllur me qëllim që, po të doni, ta lexoni letrën dhe ta ngrisni apo ta dorëzoni siç do t'ju duket më e arësyeshme të veproni, lidhur edhe me bindjet e juaja personale. Po, sidoqoftë, në letër nuk ka asgjë që mund t'ju kompromentojë.

Nekludovi e mori letrën dhe, si premtoi që do t'ja dorëzonte në dorë personit të cilit i adresohej, u ngrit, u përshëndet dhe doli.

Kur u gjënd në rrugë, e mbylli zarfin pa e lexuar letrën dhe e futi në xhep.

XXVII

Nekludovi nuk mund të largohej nga Peterburgu pa sqaruar më në fund edhe çështjen e sektantëve. Ai kishte bërë, n'emër të tyre, një lutje drejtuar vetë perandorit, të cilën mendonte t'ja dorëzonte në dorë carit me ndërmjetësinë e adiutantit të Oborrit Bogatirjev, që kishte shërbyer dikur bashkë me të në të njëjtin regjiment të gardës. Ai i shkoi Bogatirjevit në shtëpi që në mëngjes herët dhe e gjeti tek po hante bukë e po bëhej gati të dilte. Bogatirjevi ishte një burrë me shtat mesatar, i trashë, me trup të lidhur dhe i pasur, me një forcë fizike të jashtëzakonëshme aq sa ishte i zoti të përkulte, vetëm me fuqinë e duarve, një patkua kali. Bogatirjevi ishte një njeri i padjallëzuar, i ndershëm, i sinqertë e bile liberal. Por, sado e çuditëshme që mund të dukej, të gjitha këto cilësira nuk e kishin penguar të bëhej një njeri i besuar në oborrin mbretëror, ta donte carin dhe familjen e tij dhe, me anë të një metode krejt të posaçme, të shikonte në atë ambjent të lartë vetëm anët pozitive duke e ruajtur me kujdes veten nga çdo pa-pastërti që mund ta përlyente. Ai kurrë nuk e kishte zakon t'i gjykonte njerëzit si edhe qellimet e veprimet e tyre dhe, ose heshtëte ose e thoshte haptas e me një zë të lartë e të fortë, sa dukej sikur thërriste, atë që kishte për të thënë duke shpërthyer shpesh herë. pasi fliste, në një të qeshur të bujëshme. Të gjitha këto nuk i bënte aspak sepse e ndjente që duhej t'u përshtatej atyre rrethanave, por vetëm e vetëm sepse i tillë ishte karakteri i tij.

— I ke luajtur fenë që ke ardhur! Po nuk më thua, mos do të hash? Hajt, shtrou, mos bëj naze! Bufteku është kaq i mirë sa s'ngope duke ngrënë. Unë përherë me mish e hap, me mish e mbyll, se mishi është nga të gjitha ushqimet ai më i ushqyeshmi. Ha, ha, ha. Po, pi një gotë verë! — thirri ai duke treguar një kanë me verë të kuqe. — Mos kujto se e lashë në heshtje atë punën që më the. Lutjen do ta dorëzoj se s'bën. Do t'ja dorëzoj perandorit mu në dorë. Vetëm se thashë me vete: po sikur të flasësh një herë me Toporovin? Nuk është më mirë?

Nekludovi, kur dëgjoi atë emër, vrënjti vetullat.

— Ai e ka në dorë. Sido që të vijë puna, atë do ta pyesin pa tjetër. Kush e di, po t'i thuash një herë vetë, mbase ta zgjidh këtë çështje aty për aty.

— Me që ti kështu po më këshillon, po i shkoj.

— Dhe shumë mirë do bësh! Po, nuk më thua ç'përshtypje ke nga Piteri? — thirri Bogatirjevi.

— E ndjej se po hipnotizohem, — tha Nekludovi.

— Po hipnotizohesh? — pyeti Bogatirjevi dhe ja krisi gazit. — Nuk do? E po si të duash. — Ai fshiu me pecetë mustaqet. — Atëhere mbetëm dakord që do të shkosh. Kështu? Nëqoftëse ai nuk të bën gjë, ahere nëma mua dhe unë kam borxh t'ja dorëzoj në dorë — thirri ai dhe, si u ngrit nga tryeza e bëri kryqin me një lëvizje të gjerë të krahut dhe në një mënyrë krejt të pavetëdijëshme, ashtu siç kishte fshirë gojën me pecetë, nisi të mbërthejë këllëfin e shpatës. — Dhe me kaq mirëmbetsh! Ika se m'u bë vonë.

— Prit, se po dalim bashkë — tha Nekludovi, duke shtërnguar me kënaqësi pëllëmbën e gjërë e të fuqishme të Bogatirjevit dhe, me përshtypjen e këndëshme të një gjallërie të vetvetishme, të freskët që iu komunikua befas pa e kuptuar, u nda me shokun në verandë të shtëpisë së tij.

Megjithëse nuk kishte asnjë shpresë mbi rezultatin pozitiv të vizitës që do t'i bënte Toporevit nga i cili varej sipas fjalëve të Bogatirjevit, çështja e sektantëve, Nekludovi u nis e shkoi tek ai.

Funksioni që ushtronte Toporovi përmbante në vetvete një kundërthënie kaq të dukëshme sa që i binte në sy jo vetëm atij që ishte i metë nga mëndja ose që ishte i xhveshur nga çdo ndjenjë morale. Toporovi i kishte që të dyja këto cilësira negative. Kundërthënia mbi të cilën ngrihej detyra që i kishin ngarkuar ishte kjo: ai duhej të përkujdesej që ta mbante në këmbë dhe ta mbronte, qoftë edhe me mje-

te të jashtëme, pa përjashtuar këtu edhe dhunën, kishën që, sipas përkufizimit të saj, është ngritur me vullnetin e zotit dhe nuk mund të shëmbet apo të lëkundet kurrë as nga fuqit' e ferrit, as nga përpjekjet e njerëzve. Por, nga ana tjetër, ky institucion hyjnor i paprekshëm ndër shekuj duhej të mbante në këmbë e të mbronte institucionin njerëzor që kryesohej nga Toporovi me nëpunësit e tij. Toporovi nuk e shikonte ose nuk deshte ta shikonte këtë kundërthënie dhe prandaj përkujdesej me tërë mënd që ta mbronte kishën, e cila nuk mund të shkatërrohej as nga fuqitë e ferrit e jo pastaj nga ndonjë send, nga ndonjë pastor apo nga ndonjë sektant. Toporovi, ashtu si edhe të gjithë njerëzve të cilëve u mungon çdo ndjenjë fetare dhe nuk besojnë në idenë e barazisë dhe të vllazërimit të njerëzve, ishte plotësisht i bindur se populli ishte një grumbullim qëniesh të gjalla që s'kishin asgjë të përbashkët me të dhe se, prandaj, ishte shumë e nevojëshme që tek ai të nguliteshin bestytni të thella. Toporovi për veten e tij, nuk besonte asgjë dhe mendonte se kjo ishte një gjë shumë e mirë meqë i lejonte të bënte një jetë të çkujdesur e të këndëshme, por trëmbej se mos edhe populli mund të arrinte një ditë në këtë përfundim dhe, pra, e quante si një detyrë të shenjtë, siç thoshte, ta shpëtonte popullin nga kjo e keqe.

Ashtu si në librat e kulinarisë thuhej që gaforreve u pëlqen të ziejnë kur janë akoma të gjalla, tamam po ashtu edhe kv e thoshte haptas, dhe jo në kuptimin figurativ, siç është thënë kjo në librat e kulinarisë, por në kuptimin e drejtë, se popullit i pëlqen të jetë supërsticioz.

Qendrimi që ai mbante ndaj fesë ishte pak a shumë si ai i fshatarit ndaj kërmave, me të cilat ushqen pulat: Kërmat e pështirosin sa s'thuhet, mirëpo pulave u pëlqejnë dhe prandaj ai është i detyruar t'i ushqejë me to.

Nderimet që u bëheshin të gjitha atyre ikonave të Iverskut, të Kazanit, të Smolenskut s'kish dyshim se qenë idolatri dhe idolatri në kuptimin më të rëndomtë të fialës, mirëpo popullit këto u pëlqenin, populli u besonte e, pra, kjo bestytni duhej ruajtur. Kështu arësyetonte Toporovi dhe nuk i ndodhte kurrë të mendonte se popullit i pëlqenin këto bestytni vetëm e vetëm sepse ka patur gjithmonë e ka edhe tani njerëz, të tillë, siç ishte ai vetë. Toporovi, të cilët dritën e arësimit e përdorin jo për qellimin për të cilin duhet ta përdorin — për ta ndihmuar popullin që të dalë nga

errësira por përkundrazi, për ta kredhur edhe më thellë në të.

Ndërsa Nekludovi hynte në dhomën e pritjes, Toporovi në kabinetin e tij bisedonte me një murgeshë — igumene, me një grua të gjallë nga aristokracia, që përkujdesej për fenë në Lindjen e Largëme, n'atë pjesë të popullsisë që ishte kthyer me forcë n'orthodoksi.

Një nëpunës dezhur e pyeti Nekludovin me kë deshte të takohej e përse deshte të takohej dhe, kur mori vesh që Nekludovi kish ndërmënd t'i parashtronte një lutje perandorit për çështjen e sektantëve, e pyeti a kishte mundësi t'i hidhte edhe ay një sy. Nekludovi ja dha lutjen dhe nëpunësi, me të në dorë, hyri në kabinet. Murgesha, me kufje, me një vello të gjatë që valavitej lehtë, me një shall të zi që i zvarritej nga pas, me ca tespia topaci në duart e bardha, që i mbante të bashkuara përpara, mbi gjoks, doli nga kabineti dhe u largua. Por Nekludovin akoma nuk po e ftonin të hynte. Toporovi atë kohë po lexonte lutjen e, dora dorës që e lexonte, tundte kokën. Lutja qe shkruar me një qartësi dhe llogjikë bindëse që e habiste dhe e entusiazmonte.

«Sikur kjo të bjerë në dorë të perandorit, mund të na sjellë shumë ngatërresa e mosmarrëveshje të papëlqyera» — mendoi ai si e lexoi tërë lutjen. Pastaj, pa humbur kohë, e la mbi tryezë, i ra ziles dhe urdhëroi ta ftonin Nekludovin të hynte.

Atij i kujtohej fare mirë çështja e këtyre sektantëve, sepse ata i qenë drejtuar atij dhe më parë me një lutje. Këta qenë ca fshatarë të shkëputur nga feja orthodokse. Për këtë i kishin mbajtur në mbikqyrje ca kohë dhe, në një kohë të dytë, i kishin nxjerrë në gjyq. Mirëpo gjyqi u kishte dhënë pafajësinë. Atëhere kryepeshkopi bashkë me gubernatorin, duke u kapur pas pretekstit se martesat e tyre nuk qenë të ligjëshme gjersa ata që i bënin kishin dalë nga feja, kishin ndërhyrë prane autoriteteve që të ndahesh'n burrat nga gratë e nga fëmijët e t'i degdisnin të gjithë këta në vende të ndryshme që të mos kishin mundësi të bashkoheshin rishtas. Dhe, ja, kish'n qenë pikërisht këta burra të mbetur pa gra dhe pa fëmijë të cilët i qenë lutur atij. Toporovit, që të mos i ndahenin. Toporovit i kujtohej mirë kur e kishte marrë vesh për herë të parë këtë çështje. I kujtohej se atëhere qe matur një herë t'i kthente në gjirin e familjeve të tyre këta të mjerë. Por nuk e kish bërë, duke menduar se shtetit dhe kishës nuk mund t'i vinte asnjë e keqe po të qe se ai e aprovonte ven-

dimin për t'i shpërndarë andej këtej anëtarët e familjeve heretike. Veç kësaj, po të mos merreshin masa për shpërngulljen e tyre, kjo do të kishte pasoja të papëlqyera për pjesën tjetër të popullsisë që, duke u infektuar nga shembulli i tyre, mund të shkëputej edhe ajo nga orthodoksia; për këtë dëshmonte më së miri zelli i madh që tregonte në këtë mes kryepeshkopi. Prandaj, duke i peshuar të gjitha këto, Toporovi kishte vendosur të mos ndërhynte në atë punë, po ta linte të ndiqte udhën e saj.

Mirëpo tani, me një mbrojtës siç ishte Nekludovi, i cili kishte lidhje të ngushta e të shumta në Peterburg, kjo çështje mund t'i paraqitej perandorit si një akt barbarizmi e të çfrytëzohej nga shtypi i huaj për qëllime propagandistike. Prandaj, duke i peshuar të gjitha këto, Toporovi arriti në përfundimin se duhej marrë një vendim i menjëherëshëm.

— Tungjatjeta, — tha ai, me pamjen e një njeriu që është shumë i zënë me punë, duke e pritur Nekludovin në këmbë. — Unë jam në dijeni të kësaj çështjeje, — tha duke hyrë menjëherë në thelb. — Porsa u hodha një sy emrave që janë rrjeshtuar këtu, e solla menjëherë ndërmend këtë ngjarje të kobëshme, — shtoi duke marrë në dorë lutjen e duke ja treguar Nekludovit. — U jam shumë mirënjohës që ma kujtuat. Gubernatori është treguar vërtet pak si tepër i zellshëm... — Nekludovi rrinte i heshtur, duke vështruar me një antipati të dukëshme atë fytyrë-maskë, të zbetë e pa gjallëri, përpara tij. — Po, do të urdhëroj që kjo masë ndëshkimore të anullohet dhe që këta njerëz të kthehen përsëri në vend-banimet e tyre.

— Atëhere për lutjen nuk është nevoja? — tha Nekludovi.

— Aspak. Kur ju them **unë**, mund të mos dyshoni — tha ai duke e theksuar në një mënyrë të veçantë fjalën «unë», plotësisht i bindur, siç dukej, që nuk mund të kishte në botë garanci më të sigurtë se sa ndershmëria e tij, se sa fjala e tij. — Po më mirë po i vihemi kësaj pune që tani. Merrni mundimin të uleni e të pritni pak.

Ai iu afrua tryezës dhe diç nisi të shkruante. Nekludovi, duke vazhduar të qendronte më këmbë, sodiste kafkën e ngushtë e të shogur të Toporovit, dorën e tij të trashë e me damarë mavi që lëvizte shpejt mbi letër bashkë me penën dhe habitej se si mund të tregonte aq zell në një punë si ajo një njeri aq indiferent si ai.



— Ja, pra, kështu, — tha Toporovi duke e mbyllur shkresën në zarf, — i njoftoni për këtë klientët tuaj — shtoi duke i rrudhur buzët në mënyrë që të sajonin pak a shumë një buzëqeshje.

— Po, a nuk më thoni, pse paskan vuajtur atëhere këta njerëz? — pyeti Nekludovi duke marrë në dorë zarfin.

Toporovi ngriti kokën dhe buzëqeshi sikur pyetja që i bëri Nekludovi e zbaviste pa masë.

— Këtë unë nuk mund t'jua them. Mund t'ju them vetëm që interesat e popullit, që janë vënë nën mbrojtjen tonë, janë kaq të rëndësishme sa që një zell i tepruar ndaj çështjeve të fesë nuk është shumë më pak i dëmshëm se sa mospërfillja e tepruar që po tregohet tani ndaj tyre.

— Posi është e mundur që, nën parullën e fesë, të shkelen parimet themelore të mirësisë, — të prishen familjet...

Toporovi vazhdonte të buzëqeshte me mirëdashje e me një ironi të lehtë. Çfarëdo që të thoshte Nekludovi, Toporovi do ta gjykonte pa tjetër të njëanëshme dhe të papërfillëshme dhe, kjo, në saje të pozitës shoqërore që zinte, e cila, sipas mendimit të tij, ishte shumë e lartë dhe kishte një fushë veprimi shumë të gjerë.

— Nga një pikëpamje thjesht individuale, çështja ndofta qendron ashtu siç e paraqitni ju, — tha ai — por, nga pikëpamja shtetërore qendron krejt ndryshe. Po, sidoqoftë, nderimet e mia, — tha Toporovi duke unjur kokën e duke i shtrirë dorën.

Nekludovi ja shtërngoi dhe u ngut të dilte jashtë i heshtur, duke u penduar me vete të tij që e kishte shtërnguar atë dorë.

«Interesat e popullit, — përsëriti ai fjalët e Toporovit. — Interesat e tua, vetëm interesat e tua» — mendoi duke dalë në rrugë.

Duke i kaluar një nga një në mëndje të gjithë njerëzit mbi të cilët qe ushtruar veprimi i atyre institucioneve që kishin për detyrë të mëkëmbnin drejtësinë, të ruanin fenë, të edukonin popullin, nga gruaja që ish dënuar, sepse kish shitur vodkë pa leje, nga djaloshi — sepse kish vjedhur, nga endacaku — sepse nuk kishte shtëpi, nga bankieri — sepse kish grabitur arkën e gjer tek Lidia e shkretë, të cilën e kishin torturuar vetëm që t'i nxirrnin ndonjë fjalë, tek sektantët që akuzoheshin se kishin minuar bazat e orthodoksisë e tek Gurkeviçi që kalbej në burg sepse kishte luftuar për kushtetutën — Nekludovit, me një kthjelltësi të jashtëzako-

nëshme, i erdhi befas ideja se të gjithë këta njerëz i kishin kapur, i kishin burgosur, i kishin syrgjynosur, jo sepse kishin bërë ndonjë padrejtësi apo kishin shkelur ligjin, por vetëm sepse bëheshin pengesë për funksionarët e për të pasurit që të vazhdonin edhe këtej e tutje të ripnin popullin ashtu siç e kishin rjepur gjer atëhere.

Kështu, bëhej pengesë për këtë gruaja që shiste vodkë pa leje, hajduti që qarkullonte qytetin, Lidia me proklamatat, ashtu edhe sektantët që shëmbnin bestytnitë, ashtu dhe Gurkeviçi me kushtetutën si edhe shumë e shumë të tjerë. Prandaj për Nekludovin ishte tanimë e qartë se të gjithë këta funksionarë, duke filluar nga i shoqi i tetos së tij, nga senatorët e nga Toporovi e gjer tek ajo shoqëri e tërë me zotërinj të shkathët, të pastër qiqër e korrekt sa s'bëhej që mbushnin ministrirat, nuk bëheshin fare merak a qenë apo jo fajtorë ata që dënoheshin po, bëheshin merak vetëm si e si t'i vinin në dorë gjithë ata që mund të gjykoheshin të rrezikshëm.

Në këtë mënyrë jo vetëm që nuk respektohej parimi, sipas të cilit ishte më mirë të faleshin dhjetë fajtorë se sa të dënohej një i pafajshëm, por përkundrazi, sipas fjalës së moçme që thotë se bashkë me drunë e thatë shkon edhe i njomi, në dhjetë të pafajshëm dënohej një fajtor.

Ky shpjegim që i kishte gjetur më në fund realitetit që e rrethonte i dukej Nekludovit shumë i thjeshtë dhe i qartë; por ishte pikërisht kjo thjeshtësi dhe qartësi e habitëshme që e bënte Nekludovin të lëkundej e të mos e pranonte. Sipas mendimit të tij, nuk ishte e mundur që një fenomen kaq i ndërlikuar të shpjegohej në mënyrë kaq tmerrësisht të thjeshtë, nuk ishte e mundur që të gjitha fjalët që trumbetohesh n përmbi drejtësinë, përmbi mirësinë, ligjin, fenë dhe zotin etj. të qenë vetëm fjalë boshe pas të cilave fshihej vetëm hipokrizia më trashanike dhe egoizmi më i egër.

XXVIII

Nekludovi do të qe nisur nga Peterburgu që atë mbrëmje, mirëpo i kishte premtuar Mariettes se do të takohej me të në theatër dhe. megjithëse e dinte që këtë nuk duhej ta bënte. prapë e gënjeu veten duke menduar se duhej të takohej me të pa tjetër gjersa i kishte dhënë fjalën.

«A jam vallë i zoti t'u bëj ballë këtyre mashtrimeve? — pyeti ai veten, por jo me sinqeritet. — Le ta provoj këtë për herë të fundit».

Si u vesh në frak, ai u nis e arriti në theatër ndërsa po çfaqej akti i dytë i pjesës «Dame aux Camelias» 1) që atë kohë nuk hiqej nga skenat. Këtë radhë në këtë pjesë, një aktore e huaj po tregonte në mënyrë krejt origjinale se si vdesin gratë tuberkuloze.

Theatri ishte plot e përplot me njerëz, por Nekludovit, me të sosur aty, i treguan menjëherë dhe me shumë respekt, llozhën e Mariettës.

Jashtë, në koridor, një lake në livre e përshëndeti atë si një njeri të njohur dhe i hapi derën.

Të gjitha llozhat përballë qenë plot me spektatorë, ca ulur e ca në këmbë; poshtë në plate dukeshin me qindra kokë, të thinjura, gjysmë të thinjura, të shogura, me flokë: të shkëlqyera, të ngjyera e kaçurrel. Që të gjitha vështrimet ishin përqendruar mbi një aktore të hollë skelet, veshur me kadife e mbuluar me tantella, e cila përpëlitej duke u dredhur e përdredhur në një mënyrë të çuditëshme dhe recitonte, me një zë jo të natyrshëm, një monolog të gjatë. Një «ssst!» u dëgjua menjëherë porsa hyri Nekludovi, i cili u godit atë çast nga dy rryma ajri: një e ftohtë e një e ngrohtë.

Në llozhën e Mariettes ndodhej një damë me një mantele të kuqe, me ca flokë të mëdha të ngritura mbi krye, si edhe dy burra: njëri ishte gjenerali, i shoqi i Mariettes, një burrë i gjatë e i pashëm, me një fytyrë të rreptë e të ngurtë, në të cilën të binte në sy menjëherë një hundë e fortë, krrute dhe me një gjoks të ngritur e të ngrehur, ashtu siç e mbajnë zakonisht ushtarakët; tjetri ishte një burrë qimeverdhë, me kokë të shogur, me baseta të gjata e me një mjekër të shkurtër. Mariette, nazike, e hijëshme, elegante, dekolte, me ato shpatullat e saja të shëndosha e muskuloze, me një nishan që i nxinte rrëzë qafës, ktheu kokën menjëherë dhe, duke i treguar Nekludovit me elpazenë, që mbante në dorë, kolltukun bosh që ndodhej mbrapa saj, e përshëndeti me një buzëqeshje mirënjohëse e, siç iu duk atij, shumë kuptimplote. I shoqi, i qetë si gjithëmonë, e vështroi Nekludovin dhe e përshëndeti me kokë. Nga poza që mbante, nga vështrimi që shkëmbeu me të shoqen, dukej menjëherë se ai ishte sundimtari, pronari i asaj gruaje të bukur.

1) Zonja me Kamelie (frëngj.)

Kur monologu mbaroi, theatri gjëmoi nga duartrokitjet. Mariette u ngrit në këmbë dhe, duke mbajtur në dorë kindat e fundit të mëndafshtë që i fëshfëriste në çdo lëvizje, u tërhoq në pjesën e pasme të llozhës dhe e njohu të shoqin me Nekludovin. Gjenerali, që buzëqeshte parreshtur me sy, pasi tha «gëzohem», u hoq mënjanë dhe nuk foli më.

— Sot duhej t'isha nisur, por, meqë jua kisha dhënë fjalën... — nisi të thotë Nekludovi duke iu drejtuar Mariettes.

— Sidoqoftë, mundimi nuk u ka shkuar kot se, po të jetë që unë s jua mbush syrin, keni të paktën rastin të shikoni një artiste të mrekullueshme, — ja mori fjalën Mariette, duke iu përgjegjur nënkuptimit që fshihej pas fjalëve të tij. — Nuk të duket se sonte ka qenë vërtet e mrekullueshme, sidomos në skenën e fundit? — iu drejtua ajo të shoqit.

I shoqi tundi kokën.

— Mua këto nuk më bëjnë përshtypje, — tha Nekludovi. — Sot kam parë kaq vuajtje të vërteta, saqë...

— Ashtu? Po uluni, atëhere, na tregoni!

I shoqi i Mariettes që, e dëgjonte këtë bisedë pa marrë pjesë, vazhdonte të buzëqeshte me sy përherë e më ironikë.

— Isha tek ajo gruaja të cilën e liruan më në fund, pasi e mbajtën në burg kaq kohë; ishte bërë gjysmë njeriu.

— Është ajo gruaja për të cilën të kam folur, — i tha Mariette të shoqit.

— Po, e di, dhe u gëzova shumë kur mora vesh që u lirua — tha ai i qetë, duke tundur kokën e duke buzëqeshur këtë radhë nën mustaqe, siç iu duk Nekludovit, me një ironi krejt të hapët. — Unë po shkoj të pi një cigare.

Nekludovi mendonte se Mariette, duke përfituar nga rasti, do t'i thoshte tani atë që i kish premtuar dje; por ajo nuk i tha asgjë dhe, me sa dukej, as që kishte ndërmend t'i thoshte gjë. Përkundrazi, tallej e bënte shaka me të dhe fliste vazhdimisht për pjesën e cila, sipas mendimit të saj, Nekludovit veçanërisht duhej t'i kishte bërë shumë përshtypje, duke e prekur thellë në shpirt.

Nekludovi e shikonte kjartë se ajo nuk kishte asgjë për t'i thënë, por se kishte dashur vetëm t'i tregohej atij me tërë hijeshinë e talentit të saj mbrëmësor, me shpatullat lakuriq e me nishanin e zi. Atij i bëhej qejfi, vërtet, por, nga ana tjetër, ai s'kishte si mos të pështirosej duke e vënë re këtë.

Ajo cipë e hollë mashtrimi që i kishte mbuluar gjer ahere marrëdhënjet e tij me Mariette-n, jo vetëm që nuk ekzis-

tonte më për të, por ai, tani, e shikonte kjartë edhe se çfarë fshihej nën atë cipë. Ai, padyshim, e admironte Marietten, por tani kishte arritur të kuptonte se ajo nuk ishte një grua e sinqertë, se, përkundrazi, ishte një grua gënjeshtare që jetonte me një burrë, i cili kishte bërë karrierë me lotët dhe jetën e qindra e qindra njerëzve. Të gjitha ato që ajo i kishte thënë dje Nekludovit kishin qenë gënjeshtra: asaj nuk i bënin asnjë përshtypje mizoritë e të shoqit dhe vuajtjet e viktimave të tij dhe, në i kishte folur atij dje për këtë me aq pasion, këtë e kishte bërë vetëm e vetëm që t'i pëlqente e që ta nxiste të dashurohej me të. Duke i kaluar nëpërmënd të gjitha këto, Nekludovi ndjente se u nënshtrohej dy ndjenjave të kundërta: tërheqjes që ushtronte mbi të Mariette dhe përshtirimit që ajo nuk kishte se si të mos i ngjallte me gënjeshtrat e saj. Ai kaq herë mori kapelen dhe u mat të ngrihej, por nuk mundi. Më në fund. kur i shoqi i Mariette-s, me ato mustaqet e tij të dëndura që mbanin erë duhan, u kthye në llozhë duke i bedhur Nekludovit një vështrim autoritar e përbuzës, si të qe her'e parë që po e shikonte, ai nuk priti që dera të mbyllej përsëri por doli jashtë në koridor, veshi pallton dhe u largua nga theatri.

Duke u kthyer në shtëpi, buzë bregut të Nevës, ai vuri re padashur disa hapa para tij, një grua të gjatë, me një trup të hedhur e të zhdërvjelltë, veshur me një elegancë të rrallë e provokonjëse, e cila po ecte qetë-qetë mbi trotuarin e gjerë të rrugës. Fytyra e saj dhe tërë pamja e saj flisnin kjartë për atë pushtetin e tmerrshëm që ajo kishte mbi burrat dhe për të cilin ajo ishte plotësisht e ndërgjegjëshme. Të gjithë ata që ndesheshin me të apo i kalonin pranë, kthenin kokën dhe e shikonin. Fytyra e saj e lyer, ishte e bukur. dhe ajo i buzëqeshi Nekludovit dhe i përshkënditi sytë kur e pa. Dhe ja, kushedi përse, Nekludovit iu kujtua menjëherë Mariette. Kjo ndodhi ndofta ngaqë ai provoi përsëri po atë gjëndje admirimi e, në të njëjtën kohë, pështirimi, që kishte provuar në theatër Si e kaloi me të shpejtë, Nekludovi, i xhindosur me veten e tij, u kthye për nga Morskaja dhe, si doli në skelë, nisi të vërtitej lart e poshtë duke e habitur policin që bënte roje aty pranë.

«Po kështu më buzëqeshi dhe ajo në teatër kur më pa, — mendoi ai. — Dhe po atë kuptim kishin që të dyja këto buzëqeshje. Tërë ndryshimi qendron këtu: kjo më thotë haptas: «Në të pëlqej, merrëm, në mos, vazhdo rrugën»; kurse ajo tjetra shtihet sikur kjo gjë s'i shkon aspak në mëndje,

sadoqë, në të vërtetë, vetëm këtë ka në mëndje. Kjo thotë të vërtetën, kurse ajo gënjen. Jo vetëm kaq; kjo të paktën e bën nga nevoja, kurse ajo tjetra e bën sepse i pëlqen të lozi e të zbavitet me këtë ndjenjë të bukur por edhe të tmerrshme. Kjo është si ai uji i ndytë, i qelbur, që e pi kur etja që ke e mund përshtirimin; kurse ajo tjetra, në theatër, është si ai helmi që i helmon, pa e kuptuar, të gjithë ata që e prekin. — Nekludovi solli ndërmënd marrëdhëniet e fshehta që kish patur dikur me të shoqen e mareshallit të fisnikërisë, dhe një trumë kujtimesh të turpëshme e pushtoi. — Sa i përshtirë është ky instinkt shtazor tek njeriu, — mendoi ai, — por kur çfaqet haptas, ti, nga lartësia e jetës tënde morale, ke mundësi ta shikosh e ta përçmosh dhe, pamvarësisht a i nënshtrohe ose jo, mbete ai qe ishe; por kur ky instinkt shtazor fshihet nën një veshje të ashtuquajtur poetike dhe estetike dhe kërkon që ti ta nderosh, atëherë ti zhyte kok'e këmbë në të dhe, duke hyjnizuar kafshën që është tek ti, nuk je më në gjëndje të dallosh të mirën nga e keqja. Dhe kjo është e tmershme».

Nekludovi i shikonte tani këto gjëra shumë kjartë, aq kjartë sa edhe pallatet, rojet, kështjellën, lumin, barkat dhe bursën.

Ashtu si atë natë mungonte errësira, errësira e qetë, që i jep shplodhje tokës, dhe kishte një dritë të turbulltë, të zymtë, jo të zakonëshme, që s'dihej se nga buronte, po ashtu edhe në shpirtin e Nekludovit mungonte tanimë ajo errësira çlodhëse e injorancës. Çdo gjë tani ishte e kjartë. Për të ishte e kjartë se gjithçka që më parë i ishte dukur e mirë dhe e rëndësishme për njeriun, ishte, përkundrazi, e parëndësishme dhe e dëmshme për të, dhe se tërë ai lluks, tërë ai shkëlqim i jashtëm, shërbente vetëm për të mbuluar krimet e rëndomta të njerëzve të cilat, në vend që të dënohen, triumfojnë e vishen me të gjitha stolitë që ka mundur të shpikë mëndja e njeriut.

Nekludovi deshte të mbyllte sytë e të harronte, por kjo ishte tani për të e pamundur. Megjithëse ai nuk e shikonte burimin e dritës që e ndriçonte atë mbrëmje Peterburgun, megjithëse kjo dritë i dukej e turbulltë e zymtë dhe jo e zakonëshme, ai nuk mund të mos shikonte ato që ajo i zbulonte para syve dhe një gëzim e një shqetësim i pakuptuarshëm e pushtonte.

XXIX

Kur sosi në Moskë, Nekludovi shkoi në fillim në infermerinë e burgut për t'i dhënë Masllovës lajmin e hidhur që senati e kishte gjetur me vend vendimin e gjyqit dhe se prandaj duheshin bërë të gjitha pregatitjet e nevojëshme për udhëtimin në Siberi.

Pak shpresa kishte Nekludovi në lutjen për falje, drejtuar perandorit, që ja kishte përpiluar avokati, dhe që tani e kishte marrë me vete për ta nënshkruar nga Masllova. Mbase mund të dukej e çuditëshme, por ai tani as që deshte që kjo lutje të merrej parasysh. Ai ishte pregatitur shpirtërisht për udhëtimin e shpejtë që e priste për në Siberi dhe për jetën që do të bënte atje bashkë me të burgosurit, kështuqë ishte për të shumë e vështirë të përfytyronte marrëdhëniet që do të kishte në të ardhmen me Masllovën, po të qe se këtë do ta lironin. Atij i kujtoheshin fjalët e shkrimtarit amerikan Toro i cili, në periudhën e skllavërisë n'Amerikë, thoshte se burgu ishte nga të gjitha vendet, i vetmi që mund t'i përshtatej një qytetari të ndershëm në një shtet ku skllavëria mbrohet me anë të ligjit. Pikërisht kështu mendonte edhe Nekludovi, sidomos pas udhëtimit në Peterburg dhe pas gjithë atyre që pa e mori vesh atje. «Po, një njeri që i thotë vetes i ndershëm në Rusin'e sotme, vetëm në burg mund ta ndjejë veten të qetë, pa patur frikë se mund të fëlliqet!» — mendonte ai. E, ndërsa i afrohej burgut e futej thellë, nën strehën e tij, iu duk se e ndjente thellësisht këtë mendim.

Portjeri i infermerisë, porsa e pa Nekludovin dhe e njohu, e njoftoi menjëherë se Masllova nuk ndodhej më aty.

— Po ku ndodhet?

— Atje ku ndodhej dhe më parë, në burg.

— Po pse e hoqën që këndej? — pyeti Nekludovi.

— Ehu, pse, shkëlqesi!... — ja bëri portjeri dhe buzëqeshi me përçmim. — Po sepse e rregulloi me ndihmës-mjekun. Kryemjeku, me ta marrë vesh, e dëboi.

Nekludovit s'i kishte shkuar kurrë ndërmend se Masllova dhe cilësit'e saj morale do të mund ta preokuponin atë gjer n'atë pikë. Ky lajm e tronditi thellësisht. Ai provoi pak a shumë atë ndjenjë që provon çdo njeri kur i njoftojnë papritmas një mënxyrë. Kurrë në jetën e tij nuk i kish ndodhur të hidhërohej kaq shumë. Ndjenja e parë që e pushtoi nga ky lajm ishte turpi. Duke menduar se kishte shpresuar që

Masllova, nën ndikimin e tij do të ndryshonte dalngadalë e do të bëhej tjetër njeri. menjëherë iu duk vetja qesharak. Të gjitha fjalët, lotët dhe qortimet e saj për ta detyruar Nekludovin që të hiqte dorë nga sakrifica që ai kishte vendosur të bënte për të, i dukej atij tani se nuk kishin qenë tjetër veçse dredhirat e një gruaje të përdhosur e cila kishte patur për qëllim vetëm e vetëm që ta shfrytëzonte atë sa më mirë. Atij i dukej se gjatë takimit të fundit me të, kishte vënë re tek ajo disa shenja të sigurta të këtij korruptimi, i cili qe çfaqur tani sheshit. Të gjitha këto mendime kalonin vetëtimthi në kokën e tij kur ai e vuri përsëri instinktivisht kapelen e doli nga infermieria.

«Po tani, ç'të bëj? — e pyeti ai veten. — Mund të them se jam akoma i lidhur me të? Nuk kam të drejtë ta quaj këtej e tutje të këputur këtë lidhje, pikërisht për hir të kësaj që ndodhi?»

Por, menjëherë, porsa ja bëri vetes këtë pyetje, ai e kuptoi se, duke e quajtur veten e tij të lirë e duke e braktisur atë, ai nuk do të dënonte atë, ashtu siç kujtonte, por veten e tij, dhe kjo e tmeroi.

«Jo! Kjo që ngjau, nuk mund të ndryshojë asgjë mes nesh. Përkundrazi, kjo e forcon edhe më tepër vendimin tim. Ajo le të bëjë ç'të dojë, le ta rregullojë me ndihmës-mjekun gjersa kështu i pëlqen, kjo është punë për të... Kurse puna ime është të bëj atë që më dikton ndërgjegja, — i tha ai vetes. — E, pra, ndërgjegja më dikton ta flijoj lirinë time për të larë gjynahun që kam bërë, që të martohem me të, qoftë edhe në një mënyrë fiktive, dhe ta ndjek kudo që të shkojë», — i tha ai vetes i nxehur e me ngulm, dhe, me të dalë nga infermieria, u drejtua menjëherë me hap të vendosur, për nga dera e madhe e burgut.

Kur u afrua tek dera e burgut, iu lut dezhurnit të njoftonte drejtorin se deshte të takohej me Masllovën. Dezhuri e njihte Nekludovin e, duke biseduar me të, siç do të bisedonte me një njeri të njohur, i tregoi ngjarjen më me rëndësi në burg atë kohë: largimin e kapitenit dhe zëvendësimin e tij me një drejtor tjetër, shumë më të rreptë.

— Me këtë që ka ardhur tani, s'bëhet shaka, se gjen belanë kur të duash — tha mbikqyrësi dezhur. — Këtu është tani, po shkoj t'i them.

Pas pak drejtori i ri doli dhe u takua me Nekludovin. Ky ishte një burrë shumë i gjatë e i thatë, shumë i ngadaltë në lëvizje dhe i zymtë në fytyrë.

— Takimet me të burgosurit lejohen vetëm në ditët e caktuara dhe vetëm në sallën e takimeve për të gjithë, — tha ai pa e shikuar Nekludovin në sy.

— Po unë kam për të nënshkruar një lutje për falje.

— Mund të ma jepni mua.

— Unë dua të takohem vetë me të burgosurën. Më parë nuk di të më kenë sjellë ndonjë pengesë.

— Ndryshe ka qënë më parë, — tha drejtori duke i hedhur Nekludovit një vështrim të shpejtë.

— Unë kam për këtë një autorizim nga gubernatori, — nguli këmbë Nekludovi duke nxjerrë nga xhepi portofolin.

— Pa ta shohim, — tha drejtori, gjithë duke mos e parë Nekludovin në sy dhe, si e mori letrën që i zgjati Nekludovi me gishtrinjtë e tij kockë e lëkurë, të bardhë e të hollë, nga të cilët gishti tregonjës mbante një unazë të florinjtë, nisi ta lexonte mengadalë. — Urdhëroni, ju lutem, në zyrë, — tha, pasi e lexoi.

Atë çast, në zyrë nuk kishte njeri. Drejtori zuri vend pranë tryezës, gjoja për të vënë në rregull disa shkresa që ndodheshin aty, por, në të vërtetë, vetëm për të patur një pretekst për të qënë i pranishëm në takim. Kur Nekludovi e pyeti në se mund të takohej me të burgosurën politike Bogoduhovskaja, ai ja preu shkurt se nuk mund të takohej.

— Takimet me të burgosurit politikë nuk janë të lejueshme, — tha ai dhe vazhdoi të çfletësonte përsëri shkresat që kishte përpara.

Duke patur në xhep letrën për Bogoduhovskën, Nekludovit iu duk vetja për një çast pak a shumë si një njeri që zihet duke kryer një faj.

Kur Masllova hyri në zyrë, drejtori u ngrit në këmbë dhe, pa e kthyer kokën as nga Masllova, as nga Nekludovi por nga muri, tha:

— Filloni!

Fill pas kësaj, ai vazhdoi të merrej përsëri me çfletësimin e shkresave të tij.

Masllova ishte veshur përsëri si herën e fundit, me një bluzë të bardhë, me një fund dhe me një shami në kokë. Kur iu afrua Nekludovit dhe vuri re shprehjen e inatosur e të ftohtë të fytyrës së tij, ajo u skuq menjëherë dhe, duke ndrequr me dorë kindat e fundit, i uli sytë përdhe. Turbullimi i saj ishte për Nekludovin një dëshmi që vërtetonte më së miri fjalët e portierit të infermerisë.

Nekludovi deshte të sillej me të ashtu si dhe më parë, por nuk mundi t'i japë dot as dorën, dhe s'ja dha, kaq shumë e pështiroste tani vetë pamja e saj.

— Kam ardhur t'ju sjell një lajm të hidhur, — i tha ai me një zë që s'kishte asnjë ngjyrë, që s'shprehte asnjë ndjenjë, pa e parë në sy, — senati nuk e mori parasysh apelin.

— E dija, — tha ajo me një zë të çuditshëm, sikur mezi po merrte frymë.

Më parë, Nekludovi do ta kishte pyetur përse thoshte që e kishte ditur, kurse tani i hodhi vetëm një vështrim të shpejtë. Vuri re që sytë e saj qenë mbushur me lot.

Por kjo, jo vetëm që nuk ja zbuti, por ja shtoi dhe më tepër inatin kundër saj.

Drejtori u ngrit në këmbë e filloi të sillej lart e poshtë nëpër dhomë.

Megjithë neverinë e thellë që Masllova i ngjallte tani Nekludovit, atij iu duk e nevojëshme t'i çfaqte asaj keqardhjen e tij për dështimin që kish pësuar në senat.

— Mos u dëshpëroni dhe aq, — i tha — se, ndofta, lutja për falje mund të pranohet, dhe unë shpresoj se...

— Jo, nuk e kam për këtë... — tha ajo, duke i hedhur një vështrim të dhimbshëm me sytë e saj vëngërosh, të mbytur në lot.

— Po përse atëhere?

— Ju kini qënë në infermeri dhe atje sigurisht, do t'ju kenë folur për mua...

— E pastaj? Në punët e juaja unë nuk përzihem, — ja priti shkurt Nekludovi duke u vrënjtur në fytyrë.

Ndjenja e egër e krenarisë së fyer që qe topitur disi tek ai gjer ahere, ngriti kokë përsëri, me një forcë të dyfishuar, porsa ajo zuri në gojë infermerinë. Ai, një njeri i pasur dhe me shkollë, të cilin çdo vajzë e familjes më të mirë aristokrate do të qe e lumtur ta merrte për burrë, e kishte ulur veten gjer atje sa t'i propozonte një gruaje si ajo që të martohej me të, kurse ajo s'mund të priste, e kishte rregulluar menjëherë me një ndihmës-mjek!» — kështu mendonte Nekludovi dhe, ndërkaq, e vështronte Masllovën me urrejtje.

— Kështu, atëhere, do të nënshkruani lutjen... — tha ai dhe, si nxori nga xhepi një zarf të madh, e vuri mbi tryezë, e hapi dhe çpalosi letrën që ndodhej brënda. Ajo i fshiu sytë me cepin e shamisë, u ul përpara tryezës dhe e pyeti ku, e çfarë të nënshkruante.

Ai i tregoi se çfarë dhe ku duhej të nënshkruante dhe ajo zuri vend mirë në tryezë duke ndrequr me dorën e majtë mëngën e së djathtës; ai qendronte më këmbë pas saj dhe ndiqte i heshtur lëvizjet e kurrizit të saj që ish kërrusur mbi tryezë dhe që tronditej herë-herë nga disa shkrehje vaji të përmbajtur. Në shpirtin e tij, sakaq, bënin një luftë të ashpër e mira dhe e keqja; nga njëra anë, ndjenja e krenarisë së fyer, nga ana tjetër — ndjenja e keqardhjes për të dhe për vuajtjet e saja. Po, më në fund, ndjenja e dytë e mundi të parën.

Se si ndodhi kjo, ai nuk e kuptoi. Ndofta iu kujtua vetja e tij, iu kujtua që atë fajin për të cilin e dënonte Masllovën e kishte bërë edhe ai vetë. Sidoqoftë, i erdhi shumë keq për të dhe, në të njëjtën kohë, e ndjeu veten fajtor.

Si e nënshkroi lutjen dhe e fshiu gishtin e zhyer me bojë pas fustanit, ajo u ngrit dhe e vështroi në sy.

— Çfarëdo që të ndodhi, asgjë nuk mund të ndryshojë vendimin tim, — tha Nekludovi.

Mendimi që ai po ja falte Masllovës fajin ja shtoi dhe më tepër atij ndjenjën e keqardhjes për të. Nekludovi mundohej tani vetëm si e si ta ngushëllonte.

— Unë nuk kam ndërmend ta ha fjalën që ju kam dhënë. Kudo që do t'ju shpien, unë do të jem bashkë me ju.

— Është e kotë, — u ngut ajo ta ndërpriste, por sytë ndërkaq i shkëlqenin nga gëzimi.

— Mendoni se çfarë mund t'ju duhet për rrugë.

— Nuk besoj se do të më duhet gjë. Ju falemnderit.

Drejtori u afrua atë çast pranë tyre dhe Nekludovi, pa dashur të priste gjersa ai t'u thoshte se koha e takimit kish marrë fund, u përshëndet me Masllovën dhe doli jashtë duke provuar, si kurrë ndonjëherë tjetër gjatë tërë kohës, një ndjenjë gëzimi të qetë, një qetësi shpirtërore të thellë, një dashuri për të gjithë njerëzit. Mendimi që Masllova, sidoqë të vepronte, nuk do të mund ta detyronte kurrë të hiqte dorë prej saj, e entusiazmonte Nekludovin në një mënyrë krejt të posaçme dhe ja ngrinte lartë moralin. Ajo, po të deshte, le ta rregullonte me ndihmës-mjekun, kjo ishte punë për të; megjithatë, ai nuk do të hiqte dorë prej saj dhe do ta donte, ashtu siç e kishte dashur më parë, jo për të mirën e tij, po për zotin.

«Ngjarja» me ndihmës-mjekun, për të cilën Masllovën e kishin dëbuar nga infermeria dhe së cilës Nekludovi i kishte besuar, ishte shkurtimisht kjo: Masllova, sipas urdhërit

të kryeinfermerisë, kishte shkuar në farmacinë e infermerisë, që ndodhej në fund të një koridori të gjatë, për të marrë pak lule bliri për të sëmurët. Atje kish gjetur ndihmës-mjekun Ustinov, djalosh me shtat të lartë e me një fytyrë mbuluar me puçra, i cili i vardisej prej kohësh. Masllova i shpëtoi nga duart me zor dhe, ndërsa përpiqej të çlirohej, i dha një të shtyrë kaq të fortë, saqë e përplasi te një raft, duke rrëzuar disa shishe me barna përdhe e u thyen.

Atë kohë po kalonte në koridor kryemjeku. Ky, kur dëgjoi zhurmën që bëhej brënda në farmaci dhe kur e pa Masllovën që po dilte që andej me vrap me fytyrë të skuqur e me flokë të shprishura, u ndal dhe iu shkreh me të rreptë:

— Shiko, moj vajzë e mbarë, në ke ardhur këtu që të tërbohesh, shko më mirë atje ku ke qenë! Ç'është kështu? — shtoi pastaj duke u drejtuar nga ndihmës-mjeku dhe duke e vështruar atë përmbi syza me të rreptë.

Ndihmës-mjeku vuri buzën në gaz dhe nisi të çfajësohej. Por kryemjeku s'ja vuri veshin dhe tundi kokën. Pastaj u largua por, po atë ditë, i tha drejtorit të burgut që t'i dërgonte në vënd të Masllovës një të burgosur tjetër, se ajo nuk qe në rregull. Ja, në këtë mënyrë «e kishte rregulluar» Masllova me ndihmës-mjekun. Ajo e ndjeu thellë këtë poshtërim që i kishin bërë, duke e dëbuar me turp nga infermeria, edhe sepse, pas takimit me Nekludovin, marrëdhëniet me burrat në përgjithësi, tanimë e mërzitnin dhe e pështirosnin. Asaj i vinte keq për veten e saj dhe i mbusheshin sytë me lot kur mendonte që çdo njeri, si fjala vjen ai ndihmës-mjeku me puçra, duke u nisur nga e kaluara e saj dhe nga gjëndja në të cilën ajo ndodhej tani, mendonte se kishte të drejtë ta fyente e të habitej kur ajo nuk ja plotësonte dëshirën. Kur i thanë se Nekludovi kishte ardhur ta takonte, Masllova mendoi për një çast të çfajësohej përpara tij për këtë akuzë të padrejtë që i kishin bërë dhe të cilën ai, sigurisht, do ta kish marrë vesh. Por, që në fjalët e para, ajo e ndjeu se ai nuk do t'i besonte, se përpjekjet e saj për ta çfajësuar veten do t'ja përforconin atij edhe më tepër dyshimin. Prandaj heshti, sadoqë në fyt i mblidhej një lëmsh vaji.

Masllova ja mbushte mëndjen vetes se do të vazhdonte ta urrente gjithmonë Nekludovin për të keqen që i kishte bërë dikur. Këtë ajo ja kishte thënë atij haptas që në takimin e dytë. Por, megjithatë, ajo ndjente se e donte Nekludovin, dhe e donte kaq shumë saqë, pa e kuptuar as vetë

se si, i bënte menjëherë të gjitha ato që ai i kërkonte. Kështu, e kishte lënë pijen, e kishte prerë duhanin, qe bërë më e sjellëshme dhe, së fundi, kish pranuar të hynte shërbyese në infermeri. Ajo i kishte bërë të gjitha këto sepse e dinte që atij do t'i vinte mirë. Në se, megjithëkëtë, e kundërshtonte me vendosmëri Nekludovin sa herë që ky i fliste për martesë, këtë e bënte vetëm sepse i pëlqente t'i përsëriste ato fjalë të forta e krenare që i kish thënë në fillim dhe, sidomos, nga që e dinte mirë se, duke u martuar me të, ai do të mirrej në qafë. Kështu, ndonëse kishte vendosur të mos pranonte kurrë sakrificën e tij, ajo nuk mund të mos vuante tmerësisht kur mendonte se ai vazhdonte ta përbuzte, se ajo vazhdonte të qe për të ajo që kish qenë dhe se ai nuk vinte re ndryshimin, sadopak të vogël që ajo kish bërë. Mendimi se Nekludovi do të mund të dyshonte rreth ngjarjes në infermeri, e tmeronte atë tani më tepër se sa lajmi i dënimit të saj përfundimisht me punë të detyruar në Siberi.

XXX

Masllova mund të përfshihej në numërin e të burgosurve që do të niseshin për në Siberi dhe prandaj Nekludovi duhej të bëhej gati për udhë. Por kishte kaq shumë punë, sa i dukej se nuk do t'i mbaronte dot kurrë në kohën e duhur. Ajo që i ndodhte tani ishte krejt e kundërta e asaj që i kish ndodhur më parë. Më parë ai duhej ta vriste shumë mëndjen që t'i gjente vetes ndonjë punë dhe, të gjitha punët e tij, pa përjashtim, kishin si pikësynimi Dimitër Ivanoviçin, mirëqënjen e tij dhe interesin e tij; prandaj, i dukeshin ndofta edhe shumë të mërzitëshme. Tani, përkundrazi, të gjitha punët e tij kishin të bënin me njerëz të tjerë, jo më me Dimitër Ivanoviçin, këto e tërhiqnin e i dukeshin shumë interesante dhe ishin kaq të shumta, sa që ai nuk dinte nga t'ja fillonte më parë.

Jo vetëm kaq, por më parë, kur merrej me ndonjë punë që kishte të bënte drejtpërdrejt me Dimitër Ivanoviçin, ai mërzitej e bëhej nervoz; kurse tani këto punë, që s'ishin të tijat po të botës, e bënin t'ishte pothuajse përherë me qejf.

Punët për të cilat duhej të interesohej tani Nekludovi mund të klasifikoheshin në katër grupe; ai vetë i kishte

klasifikuar kështu me atë pedantizmin e tij të zakonshëm, duke caktuar një dosje të veçantë për çdo grup.

Çështja e parë kishte të bënte me Masllovën dhe me ndihmën që ai duhej t'i jepte asaj. Kjo punë kërkonte ndërhyrjen pranë ndonjë personi me influencë me qëllim që të merrej parasysh lutja për falje, drejtuar perandorit, si dhe pregatitjet e duhura për udhëtimin në Siberi.

Çështja e dytë ishte sistemimi i çifligjeve. Në Panovo ai ua kishte dhënë tokën fshatarëve me konditë që ata të paguanin një rentë që do të përdorej për të përballuar nevojat e përgjithëshme të fshatarësisë. Por që kjo marrëveshje të merrte një formë të prerë edhe nga pikëpamja zyrtare, duheshin përpiluar dhe nënshkruar kushtet dhe testamenti. Në Kuzminskoje puna kishte mbetur akoma ashtu siç e kishte lënë, domethënë që të hollat për dhënien e tokave duhej t'i merrte ai vetë, por, megjithatë, mbeteshin për të caktuar afatet e pagesave dhe, veç kësaj, duhej vendosur se sa prej këtyre të hollave do të tërhiqeshin prej tij dhe sa do të mund t'u liheshin fshatarëve që t'i përdornin për nevojat e tyre. Duke mos qenë në gjëndje t'i parashikonte shpenzimet që do t'i duheshin gjatë udhëtimit për në Siberi, ai mendoi se nuk kishte ardhur akoma koha që të hiqte dorë plotësisht nga këto të ardhura dhe se hë për hë kishte bërë mjaft në këtë drejtim duke i pakësuar gjer në gjysëm.

Çështja e tretë ishte ndihma që duhej t'u jipte të burgosurve të cilët drejtoheshin tani tek ai përherë e më dëndur.

Në fillim, porsa vinte në kontakt me të burgosurit që i kërkonin atij ndonjë ndihmë, ai menjëherë i përvishej punës dhe ndërmjetësonte pranë ndonjë personi të njohur që t'u bënin lehtësirat që kërkonin; mirëpo, dalngadalë, ata që drejtoheshin tek ai për ndihmë u bënë kaq shumë sa që ai e kuptoi se ishte e pamundur që t'i ndihmonte të gjithë dhe, dashur pa dashur, të gjitha ankesat e tyre i përmblodhi në një çështje të katërtë, së cilës ai i kushtonte atë kohë një rëndësi të madhe.

Kjo çështje e katërtë përfshinte zgjidhjen e këtyre problemeve: çfarë është në të vërtetë, përse nevojitet e si ka lindur institucioni i çuditshëm që quhet «gjyqi penal» e që ka për rezultat burgun, me banorët e të cilit ai qe njohur pjesërisht, si edhe të gjitha vendet e tjera të burgosjes, duke filluar nga kështjella e Petropavlovskut e gjer në Sahalin, ku dergjeshin me qindra e me mijëra njerëz.

Nga marrëdhënjet personale që kishte me të burgosurit, nga bashkëbisedimet që kishte patur me avokatin, me priftin e me drejtorin e burgut, si edhe nga listat emnore të të burgosurve, Nekludovi kishte arritur në përfundimin se të burgosurit «kriminelë» mund të ndaheshin, sipas karakterit të krimit të tyre, në pesë kategori.

Në kategorin e parë hynin të gjithë ata që, duke qenë krejt të pafajshëm, kishin rënë viktima të ndonjë gabimi gjyqësor në dëm të tyre. Kështu ishin, fjala vjen, Menshovi, Masllova e të tjerë. Njerëzit që bënin pjesë në këtë kategori nuk ishin shumë; këta, sipas të thënave të priftit, përbënin pothuaj shtatë përqind të numërit të përgjithshëm të të burgosurve, mirëpo pozita e tyre paraqiste një interes krejt të posaçëm.

Në kategorinë e dytë bënin pjesë njerëz të dënuar për akte të kryera në rrethana të jashtëzakonëshme siç ishin, fjala vjen, inati, xhelozia, dehja, etj., domethënë për të tilla vepra, që në të njëjtat rrethana, do t'i kishin kryer pothuajse me siguri edhe vetë ata të cilët i kishin dënuar. Kjo kategori përfshinte, sipas të dhënave që kishte Nekludovi, pothuajse më tepër se gjysmën e numurit të përgjithëshëm të kriminelëve.

Në kategorinë e tretë bënin pjesë njerëzit që ishin dënuar sepse kishin kryer disa veprime që, sipas mendimit të tyre, duhet të cilësoheshin të zakonëshme e, bile, si të mira, por që, sipas mendimit të atyre që i hartonin ligjet, cilësoheshin si krime. Në këtë kategori hynin ata që shitnin verë pa leje, që bënin kontrabandë, që kullotnin bagëtinë në livadh të huaj, që bënin dru në pyjet dhe në pronat e gjigarëve. Në këtë kategori bënin pjesë gjithashtu cubat e malësive të Kaukazit si dhe ata që vidhnin e shitnin ikonat e kishave.

Kategoria e katërtë përbëhej nga persona që qenë futur në radhën e kriminelëve nga që qendronin moralisht më lartë nga niveli mesatar i shoqërisë. Të tillë qenë sektantët, të tillë qenë polakët e çerkezët, që kishin ngritur krye për pavarësinë e vendit të tyre, të tillë qenë gjithashtu të burgosurit politikë, socialistët dhe grevistët që mbaheshin në burg për veprimtari kundër pushtetit. Përqindja e këtyre njerëzve që përbënin pjesën më të shëndoshë të shoqërisë, sipas informatave që kishte Nekludovi, ishte shumë e lartë.

Kategoria e pestë, më në fund, përbëhej nga të tillë njerëz, fajet e të cilëve ndaj shoqërisë mund edhe të mos

përfilleshin në krahasim me fajet që kish vetë shoqëria ndaj tyre. Këta qenë njerëz të braktisur, të idiotizuar nga rrethanat mbytëse dhe nga ambjenti mashtronjës ku kishin rrojtur vazhdimisht. I tillë ishte, fjala vjen, ai çunaku që kishte vjedhur shkorsat e me qindra të tjerë që Nekludovi i kishte vënë re jo vetëm në burg, por edhe jashtë e që prireshin nga krimi llogjikisht e sistematikisht, nga vetë rrethanat e jetës. Ndër këta bënte pjesë, sipas mendimit të Nekludovit, një numër shumë i madh hajdutësh dhe vrasësish, disa prej të cilëve ai i kishte njohur personalisht. Mbasi e studjoi mirë këtë kategori, ai mendoi se këtu mund të përfshiheshin gjithashtu dhe njerëz të korruptuar e të çthurur që, sipas gjuhës që përdor shkolla e re, përbëjnë tipin e njeriut kriminel dhe që, gjoja me qënien e tyre, provojnë nevojën e zbatimit të kodit penal. Këta njerëz, të ashtuquajtur tipa të degjeneruar, kriminelë, anormalë, sipas mendimit të Nekludovit, ishin po ata njerëz që qenë shumë më pak fajtorë ndaj shoqërisë se sa ishte vetë shoqëria ndaj tyre. Vetëm se, në këtë rast, faji i shoqërisë nuk qe kryer drejtpërdrejt mbi ta, por mbi prindërit, mbi gjyshërit dhe stërgjyshërit e tyre. Nekludovi kishte patur rast të njihej me disa nga këta njerëz të cilët paraqitnin interes të veçantë për të kontrolluar tezat e shkollës italiane të kriminologjisë. Njëri prej këtyre ishte hajduti recidiv [1]) Ohotin, biri i paligjshëm i një prostitute, rritur e edukuar në një azil për të varfër, që, gjer në moshën tridhjetë vjeç, nuk kish takuar në jetën e tij një njeri me cilësira morale më të larta se sa ato të një polici. Që kur ishte akoma fare i ri, ai qe bashkuar me një bandë hajdutësh dhe, pikërisht për këtë, qe dënuar. Ndonëse i degjeneruar dhe i çthurur, Ohotini ishte një njeri i pajisur me një talent komik të theksuar, me të cilin i bënte për vete të gjithë. Duke biseduar me Nekludovin, ai tallej me veten e tij, me gjykatësit, me burgun, si edhe me të gjitha ligjet njerëzore e mbinjerëzore që sundojnë në botë. Një tjetër ishte djaloshi i pashëm Fedorov, i cili qe dënuar se kishte vrarë e grabitur një nëpunës plak, bashkë me një bandë hajdutësh që kryesohej prej tij. I ati i Fedorovit kish qenë një fshatar i çpronësuar padrejtësisht. Pas çpronësimit, i biri kish shkuar ushtar. N'ushtëri, kish vuajtur sepse kish rënë në dashuri me të dashurën e një oficeri. Fedorovi ishte për nga natyra një njeri me karakter të zjarrtë e sim-

1) Recidiv = ai që përsërit po të njëjtin faj (Shën. i përkth.)

patik që deshte mbi të gjitha e me çdo kusht të dëfrente. Ai nuk kishte rastisur kurrë në jetë të tij njerëz që të hiqnin dorë për një arësye a për një tjetër nga qejfet e tyre dhe as kish dëgjuar kurrë që jeta e njeriut, përveç qejfit, mund të ketë një qellim tjetër. Sipas Nekludovit, të dy këta qenë njerëz me një natyrë të pasur shpirtërore, e cila qe fishkur e gjymtuar tek ata, ashtu siç fishket e gjymtyrohet një pemë që lihet pas dore. Nekludovi kishte parë gjithashtu në burg një vagabond dhe një grua, që të dy me një shprehje kaq tmerësisht idiote e pa kuptim në fytyrë, sa të llahtarosnin por, sidoqoftë, ai nuk kishte mundur të zbulonte n'asnjë mënyrë tek ata atë tipin kriminel, për të cilin bën fjalë shkolla italiane. I qenë dukur njerëz antipatikë, dhe vetëm kaq. Po të tillë kishte plot jo vetëm në burg, por dhe jashtë, bile shumë syresh ishin në frak, me spaleta dhe me fustane dekolte.

E ja, pra, në hetimin e këtij problemi, domethënë përse e tërë ajo masë e larmë njerëzish qe futur në burg, kurse njerëz të tjerë, që s'kishin nga të parët asnjë ndryshim, ishin lënë të lirë të bënin ç'të donin, bile edhe të gjykonin e të dënonin njerëz të tjerë, qendronte ajo çështja e katërtë të cilës Nekludovi i kishte kushtuar atë kohë një vëmëndje aq të madhe.

Në fillim Nekludovi shpresonte se zgjidhjen e këtij problemi do t'ja jepnin librat dhe i bleu të gjitha ato që i dukej se kishin të bënin me të. Kështu bleu librat e Lombrozo-s, bleu librat e Garofolo-s, të Ferrit, të Listit, të Maudsleit e të Tardit dhe i lexoi këto libra gjer në fund. Por dora dorës që i lexonte, bindej përherë e më tepër se nuk do të mund të gjente në to ato që kërkonte. Atij i ndodhte ajo që i ndodh kujtdo që i drejtohet shkencës, jo sepse kërkon të fitojë ndonjë farë diturie e të luajë më vonë një rol në shkencë: të shkruajë, të diskutojë e të shes mënd, por vetëm për të shtjelluar në kokën e tij disa çështje të thjeshta, themelore që kanë lidhje drejtpërdrejt me jetën. Shkenca u përgjigjej mijëra pyetjeve të ndryshme, të holla e shumë interesante, që kishin të bënin me të drejtën e ndëshkimeve penale, por nuk i përgjigjej n'asnjë vend pyetjes që i bënte ai. Dhe pyetja që i bënte ai ishte shumë e thjeshtë. Ai deshi të dinte përse, e me çfarë të drejte, disa njerëz burgosin, torturojnë, syrgjynosin e vrasin disa njerëz të tjerë, gjersa asgjë nuk të lejon të bësh një dallim ndërmjet nierëzve? Po librat i përgjigjeshin me disa arësyetime që kishin për që-

llim të zbulonin a është i lirë vullneti i njeriut apo jo. A është e mundur që, duke u mbështetur vetëm në të dhënat e matjeve mbi kafkën e një njeriu, të përcaktohet a bën pjesë ky apo jo në tipin e njeriut kriminal? Çfarë roli lot trashëgimia në lindjen e krimit? A mund të thuhet se ekziston një imoralitet i lindur? Ç'përfaqëson në vetvete morali? Ç'është marrëzia? Ç'është degjenerimi? Ç'është temperamenti? Si ndikojnë në lindjen e krimit klima, ushqimi, injoranca, imitimi, ipnotizimi dhe pasionet? Ç'është shoqëria? Cilat janë detyrat e saj? Etj. etj.

Këto arësyetime i kujtonin Nekludovit se si i qe përgjegjur një herë një fëmijë e vogël që po kthehej nga shkolla. Nekludovi e kishte pyetur fëminë a kishte mësuar të shkruante. «Kam mësuar, po» — qe përgjegjur djali. «E po atëhere shkruaj fjalën: putra». — «Cilën putër? Atë të qenit?» — qe përgjegjur me djallëzi çunaku. Ja, pikërisht të tilla përgjegje në trajtë pyetjesh gjente Nekludovi edhe në librat shkencore në lidhje me pyetjen e tij.

Në të trajtoheshin në një mënyrë ndofta edhe fort gjeniale shumë çështje interesante, por nga të gjitha çështjet as që prekej fare ajo me e rëndësishmja: nga e marrin të drejtën disa njerëz të dënojnë të tjerë? Jo vetëm që kësaj pyetjeje nuk i jepej asnjë përgjigje por, përkundrazi, të gjitha arësyetimet prireshin ndaj shpjegimit dhe justifikimit të dënimit, nevoja e të cilit pranohej si një aksiomë. Nekludovi lexonte shumë, por me hope, dhe pamundësinë e gjetjes së një përgjegjeje ja ngarkonte pikërisht studimeve të tija të përcipta, duke shpresuar se do ta gjente në t'ardhmen përgjegjen që kërkonte. Prandaj edhe nuk i lejonte vetes që ta pranonte si të drejtë atë përgjegje që përherë e më dëndur i çfaqej në mëndje ato kohët e fundit.

XXXI

Nisja e grupit të të burgosurve, ku bënte pjesë edhe Masllova, ishte caktuar për më datën 5 korrik. Po atë ditë qe pregatitur të nisej bashkë me të edhe Nekludovi. Një ditë më parë motra e Nekludovit, bashkë me të shoqin, kishte ardhë në qytet që të takohej me të vëllanë.

E motra e Nekludovit, Natalia Ivanovna Ragozhinskaja ishte dhjetë vjeç më e madhe se i vëllai. Ai qe rritur pjesërisht nën ndikimin e saj. Ajo e kishte dashur shumë kur ish-

te i vogël dhe, më vonë, gjersa u martua, qe sjellur me të si me një bashkëmoshatar të saj, sadoqë, kur ajo ishte njëzet e pesë vjeç vajzë, ai s'ishte akoma as pesëmbëdhjetë vjeç. E motra e Nekludovit kishte rënë në dashuri atë kohë me një shok të tij, me Nikolenka Irtenjevin, i cili më vonë kishte vdekur. Që të dy e kishin dashur Nikolenkën dhe tek ay, ashtu si në veten e tyre, kishin dashur të gjitha ato cilësira që shërbejnë për të mirën e njerëzve dhe për vllazërimin e tyre.

Por më vonë qenë prishur që të dy: ai në ushtëri, ajo — duke u martuar me një njeri të cilin e dashuronte me gjithë shpirt por më tepër nga një dashuri seksuale dhe, nga ana e tij, ai jo vetëm që s'ndjente asnjë simpati për të gjitha ato që dikur kishin qenë kaq të shtrenjta e të shenjta për Natalien dhe për Dimitrin, por, përkundrazi, mendonte se aspirata për një jetë morale të përsosur, përpiekjet dhe flijimi i vetvetes në dobi të njerëzve, që përbënin dikur qëllimin e jetës së gruas së tij dhe të vëllait të saj, nuk mund të shpjegoheshin ndryshe, veçse nga dëshira e çmëndur për t'u dalluar në një mënyrë apo në një tjetër nga turma.

Ragozhinski ishte një njeri që s'kishte as nam, as pasuri, por kishte vetira, që nuk mund të viheshin në dyshim, si një nëpunës i shkathët që, me akrobacitë e tij ndërmjet liberalizmit dhe konservatorizmit, duke çfrytëzuar, sipas kohës dhe rrethanave, atë nga këto dy rryma që mund t'i siguronte rezultate më të mira për jetën e tij, dhe, sidomos, duke përfituar nga disa dhunti natyrore për hir të të cilave u hynte shpejt në qejf grave, kish ditur të bënte, në sektorin e gjyqeve, një karierë që mund të quhej pa fjalë e shkëlqyeshme. Pothuaj mesoburrë, ai qe njohur jashtë shtetit me familjen e Nekludovit e kish arritur që Natasha, edhe ajo atëhere jo dhe aq e re, ta dashuronte e të martohej me të pothuajse kundra dëshirës të s'ëmës, që e quante këtë martesë një mesalliance [1]). Nekludovi, sadoqë ja fshihte vetes dhe bënte çmos për ta luftuar këtë ndjenjë, e urrente të kunatin. E urrente për ato ndjenjat e tij vullgare, për krenarinë boshe të një njeriu me mëndje të kufizuar dhe e urrente akoma më tepër kur mendonte që motra e tij ushqente një dashuri aq të zjarrtë, aq egoiste dhe seksuale për një qënie me një shpirt aq të varfër, duke arritur gjer atje sa, për t'i bërë qej-

1) martesë e pa barabartë nga pikëpamja e gjëndjes shoqërore (sh. i përk.).

fin atij, të shtypte mizorisht gjithshka ishte e mirë dhe e pastër në shpirtin e saj. Nekludovi kurrë nuk mund të mendonte, pa ndjerë një dhimbje të thellë, që Natasha ishte gruaja e një njeriu fodull, me kokën tullë, me qime në duar e në fytyrë, siç ishte i kunati i tij. Ai nuk mund t'i shikonte pa u pështirosur as fëmijët e saj. Bile, sa herë që merrte vesh që motra e tij po priste të bëhej nënë, ai kishte përshtypjen sikur ajo kishte marrë përsëri një sëmundje të ndytë nga ai njeri i huaj.

Ragozhinskët kishin dy fëmijë, një vajzë e një djalë, por nuk i kishin marrë me vete. Ata kishin zënë me qira një nga apartamentet më të mira të një hoteli lluksoz të qytetit. Natalia Ivanovna kishte shkuar menjëherë në shtëpinë e vjetër të s'ëmës por duke mos e gjetur atje të vëllanë dhe duke marrë vesh nga Agrafena Petrovna se qe çpërngulur që andej e kishte vajtur të banonte në hotel, u nis për atje. Një shërbëtor me rroba e me fytyrë pis, që takoi në koridorin e errët dhe me ajër të prishur që ndriçohej edhe ditën, e njoftoi se princi kishte dalë.

Natalia Ivanovna tha se deshte t'i shkruante të vëllait një pusullë. Shërbyesi e shoqëroi në dhomën e tij.

Ajo i kqyri me kujdes të dyja dhomat e vogla që Nekludovi kishte zënë me qira. Vuri re në çdo gjë atë pastërtinë dhe atë rregullin që i njihte mirë, por u habit me thjeshtësinë e tepruar të orendive që ishte për të diçka krejt e re. Mbi tryezën e shkrimit vuri re një prerëse letrash me një qen prej bronxi që kishte qenë dikur në shtëpinë e tyre, si edhe po ato takëme boje të shtëpisë, dosjet me letra, vëllimet e kodit penal, një libër anglisht të Henri Xhorxhit dhe një tjetër frëngjisht të Tardit, ndërmjet faqeve të të cilit qe vendosur një thikë prej fildishi me majë të kthyer, që i kujtohej se e kishte prekur me dorë kaq e kaq herë.

Ajo u ul përpara tryezës dhe nisi t'i shkruante një letër në të cilën i thoshte që të takohej me të patjetër, po atë ditë. Pastaj, duke tundur kokën e habitur për ato qe kishte parë, doli nga dhoma e u largua nga hoteli.

Natalia Ivanovnën e interesonin në lidhje me të vëllanë këto dy çështje: martesa e tij me Katjushën, për të cilën kishte dëgjuar të flitej në qytetin e saj nga të gjithë dhe, në radhë të dytë, dhënia e tokave fshatarëve, për të cilën i kishin folur si për një hap shumë të rrezikshëm, me kuptim politik. Martesa me Katjushën i pëlqente nga njëra anë Natalia Ivanovnës. Ajo e çmonte tek i vëllai atë çfaqje vendos-

mërie dhe ndershmërie gjer në fund, sepse kjo i kujtonte kohen e lumtur përpara martesës së saj, kur po ato qëllime dhe ato dëshira fisnike kishin patur që të dy. Por, në të njëjtën kohë, ajo nuk kishte se si të mos të tmerohej kur mejtonte që i vëllai i saj do të martohej me një grua siç ishte Masllova. Ndjenja e dytë e mundëte të parën dhe ajo kishte vendosur të ndikonte mbi të e të bënte çmos për t'ja mbushur mëndjen që të hiqte dorë nga një gjë e tillë, sadoqë e dinte shumë mirë se ishte shumë zor që t'ja arrinte qëllimit.

Dhënia e tokave fshatarëve nuk ishte një çështje që e shqetësonte dhe aq tepër Natalia Ivanovnën. Por i shoqi i saj qe tronditur shumë kur e kishte marrë vesh këtë lajm dhe kishte kërkuar me këmbëngulje nga e shoqja që të ndikonte me çdo mjet tek i vëllai. Ignati Nikiforoviç thoshte se një veprim i tillë ishte kulmi i mungesës së gjykimit, i mëndjelehtësisë dhe krenarisë dhe se, një hap kaq i pamatur, mund të shpjegohej vetëm me dëshirën për t'u çquar nga njerëzit e tjerë dhe për të shitur mënd, sepse ndryshe nuk mund të shpjegohej në asnjë mënyrë.

— Ç'kuptim ka t'ua japësh tokat fshatarëve duke i detyruar t'i paguajnë vetes së tyre? — thoshte ai. — Në qoftëse nuk i rrihej pa e bërë një gjë të tillë, mund t'ua shiste fundja atyre nëpërmjet bankës fshatare. Kjo do të kishte të paktën një farë kuptimi. Por, në përgjithësi, të gjitha sjelljet e tij, tregojnë se kemi të bëjmë me një njeri që nuk është fort në rregull nga trutë, — thoshte Ignat Ivanoviçi, duke menduar se do t'i takonte atij të bëhej tutor i pronave të Nekludovit, dhe ngulte këmbë pranë së shoqes që ta bisedonte seriozisht me të vëllanë këtë punë.

XXXII

Kur u kthye në hotel dhe gjeti, mbi tryezë pusullën që i kishte lënë e motra, Nekludovi u nis e shkoi menjëherë tek ajo. Ishte koha e mbrëmjes. Ignat Nikiforoviçi po shplodhej në dhomën tjetër. Natalia Ivanovna e priti vëllanë vetëm. Qe veshur me një fustan të zi mëndafshi, me një fjongo të kuqe në gjoks; flokët e gjatë e të zez i kish krehur e i kish ngritur përpjetë sipas modës së fundit. Kuptohej që mundohej të dukej sa më e re që t'i pëlqente të shoqit. Kur e pa të vëllanë, brofi në këmbë nga divani dhe i doli përpara me hap të shpejtë, duke fëshfëritur fundin e

mëndafshtë. Dhe atëhere ndodhi ai shkëmbim vështrimesh që është kaq i mistershëm, kaq plot domethënie të thella dhe kaq i shpejtë, sa nuk mund të përshkruhet me fjalë, por ku çdo gjë ishte e vërtetë. Menjëherë pas tij filloi një shkëmbim fjalësh, ku tanimë ajo e vërtetë qe zhdukur. Ata nuk qenë parë që nga koha kur u kishte vdekur e ëma.

— Je trashur dhe je përtëritur, — i tha ai.

Asaj nga gëzimi i lëvizën çipat e buzëve.

— Kurse ti je dobësuar.

— Ignati Nikiforoviç si është me shëndet? — pyeti Nekludovi.

— Mirë është. Tani po shplodhet. S'ka fjetur tërë natën.

Kishte shumë gjëra për të thënë, por fjalët nuk thonin asgjë, kurse vështrimet thonin se ato që duheshin treguar, nuk qenë thënë.

— Kam qenë atje tek ty.

— Po, e di. Kam ikur nga shtëpia. Ishte shumë e madhe për mua, mërzitesha vetëm. Mobiljet dhe të gjitha plaçkat që kam lënë aty nuk më duhen më. Kështu që, po të duash, mund t'i marrësh.

— Po, po, më tha Agrafena Petrovna. Isha edhe atje. Të faleminderit shumë, por...

Atë çast lakei i hotelit hyri duke sjellë në duar një takëm çaji të argjëndtë.

Ata nuk shkëmbyen më asnjë fjalë gjersa lakei e vendosi takëmin mbi tryezë. Natalia Ivanovna shkoi e u ul në një poltronë përballë dhe e hodhi çajin nëpër filxhanë. Nekludovi ndërkaq rrinte i heshtur.

— Dimitri, unë të gjitha i kam marrë vesh, e prishi befas heshtjen Natasha, duke e parë në sy.

— E po atëhere aq më mirë...

— Po pse, me të vërtetë shpreson se mund ta ndreqësh atë duke e ditur se çfarë jete ka bërë gjer tani? — pyeti Natalia Ivanovna.

Nekludovi qe ulur në një karrige të ulët, e mbante trupin drejt pa u mbështetur, dhe dëgjonte me vëmëndje duke u munduar të kuptonte e të përgjigjej mirë. Gjëndja shpirtërore që i kishte lindur pas takimit të fundit me Masllovën, vazhdonte të çfaqej tek ai nëpërmjet një gëzimi të qetë dhe me një simpathi e dashuri që ai ndjente në përgjithësi kundrejt të gjithë njerëzve.

— Nuk dua të ndreq atë, po veten — u përgjegj ai.

Natalia Ivanovna psherëtiu.

— Për këtë ka edhe mjete të tjera, përveç martesës.

— Kurse unë mendoj se ky është mjeti më i mirë. Nga ana tjetër, më jep mundësi të njihem me njerëz që kanë nevojë për ndihmën time.

— Sidoqoftë, unë nuk mendoj — tha Natalia Ivanovna — se kjo do të mund të të bëjë të lumtur.

— Nuk është fjala për lumturinë time.

— E kuptoj por, megjithatë, ajo, po të jetë se është një grua që ndjen e që ka zemër, do ta kuptojë se kjo martesë nuk mund ta bëjë të lumtur dhe as që mund ta dojë një gjë të tillë.

— Jo, ajo nuk e do.

— E kuptoj, po jeta...

— Hë, çfarë, jeta?

— Kërkon gjëra të tjera.

— Asgjë tjetër nuk na kërkon veçse të bëjmë atë që e kemi për detyrë, — tha Nekludovi duke ngritur sytë mbi fytyrën e së motrës, që ishte akoma e hijëshme, sadoqë e mbuluar përreth syve dhe buzëve me disa zhubra të lehta.

— Nuk e kuptoj, — tha ajo dhe psherëtiti.

«E dashura, e shkreta motra ime! Si është e mundur të ketë ndryshuar kaq shumë?» — mendoi Nekludovi duke e përfytyruar Natashën ashtu siç kishte qenë përpara se të martohej, e duke provuar ndaj saj një dhemshuri që ishte gërshetuar në shpirtin e tij me kujtime të panumërta fëmijërie.

Ignati Nikiforoviç hyri atë çast në dhomë me kokën ngritur lart, si përherë, dhe me gjoksin e gjerë të ngrehur me kapadsillëk, duke ecur lehtë e me ngadalë e duke buzëqeshur, ndërsa syzat, tulla në kokë dhe mjekra e zezë i shkëlqenin.

— Oho, mirëmbrëma e mirë se erdhët! — tha ai me një përzëmërsi që dukej sheshit se ishte e rremë.

(Megjithëse fill pas martesës kishin dashur e qenë munduar të përdornin në mes tyre «ti»-në dhe jo «ju»-në, prapë ata vazhdonin t'i drejtoheshin njeri tjetrit me «ju»)

Shtrënguan duart dhe Ignati Nikiforoviçi u lëshua lehtë-lehtë në një kolltuk.

— Mos jua preva muhabetin?

— Jo, unë nuk i fsheh nga të tjerët ato që them dhe atë që bëj.

Porsa pa atë fytyrë dhe ato duar me qime, porsa dëgjoi atë ton autoritar dhe mospërfillës, të gjitha ndjenjat e mira, që kishte Nekludovi gjer atë minutë, u zhdukën si për magji.

— Po bisedonim për qëllimet e tij, — tha Natalia Ivanovna. — Do të të hedh një filxhan çaj? — shtoi duke marrë çajnikun.

— Po, po, hidhmë, po nuk përtove; nuk mund të më thoni, në çfarë konsistojnë këto qëllime?

— Dua të shkoj në Siberi me një grup të burgosurish, ku bën pjesë edhe një grua ndaj së cilës e ndjej veten fajtor, — tha Nekludovi.

— E kam marrë vesh, por më kanë thënë sikur nuk kini ndërmend vetëm ta përcillni, por të bëni për të edhe diçka tjetër.

— Po, dua të martohem me të, po të jetë se ajo do pranojë.

— Aha, kështu! Po nëqoftëse nuk ju vjen rëndë, nuk m'i shpjegoni pak arësyet që ju kanë shtyrë të merrni një vendim të tillë? Unë, nga ana e ime, s'mund ta kuptoj dot.

— Arësyet janë këto... se ajo grua... dua të them që hapi i saj i parë në rrugën e degjenerimit... — Nekludovi sa s'plaste nga inati që nuk ishte i zoti të gjente fjalët e nevojëshme për ta shprehur me saktësi mendimin e tij. — Arësyet janë këto: unë jam fajtor, kurse ajo është e pafajshme por, gabimisht, dënimin që duhej ta kisha pësuar unë, e ka pësuar ajo.

— Gjersa e kanë dënuar, kuptohet vetvetiu se nuk mund të jetë e pafajëshme.

— Ajo është krejtësisht e pafajëshme.

Dhe Nekludovi, shumë i tronditur e me një gjallëri fare pa vend, e tregoi çështjen që nga fillimi.

— Po, kjo është një pakujdesi që ka treguar kryetari e që ka sjellë si pasojë një përgjegje të pamatur të zhurisë. E kuptoj. Po, në këtë rast, mund t'i drejtoheshit senatit.

— Senati nuk e mori parasysh lutjen.

— Gjersa nuk e mori parasysh, do të thotë që nuk ka patur arësye të forta për apelim, — tha Ignati Nikiforoviçi që, me sa dukej, ishte i mendimit, si shumë të tjerë, se e vërteta duhet konsideruar si një rezultat i proçedurës gjyqësore. — Senati nuk mund ta shqyrtojë çështjen në

thelb. Nëqoftëse vërtet është bërë një gabim nga ana e gjyqit, atëhere duhet bërë një lutje për falje.

— Edhe këtë lutje e kemi bërë, po shpresat janë të pakta. Se, pa tjetër, do kërkojnë informata nga ministria e drejtësise, ministria do t'i drejtohet senatit, senati do të përsëriti vendimin që ka marrë dhe, si zakonisht, i pafajshmi nuk do t'i shpëtojë dot dënimit.

— Më falni, por pikësëpari ministria nuk do t'i drejtohet senatit, — tha Ignati Nikiforoviçi me një buzeqeshje të lehtë si për të vënë në dukje, por pa të keq, që Nekludovi nuk kishte përvojë në të tilla çështje — por do ta kërkojë rrjedhjen e çështjes drejtpërdrejt nga gjyqi dhe, po të jetë se do të konstatojë se vërtet është bërë një gabim gjyqësor, do të marri, në përputhje me këtë, ato masa që do t'i duken të nevojëshme. Veç kësaj, nuk është e vërtetë që gjyqi dënon edhe njerëz të pafajshëm. Kjo mund të ndodhi vetëm në një rast të jashtëzakonshëm. Ata që dënohen nuk kanë se si të mos jenë fajtorë, — tha pa u ngutur e duke buzëqeshur i kënaqur Ignat Nikiforoviçi.

— Të pafajshëm? Në ç'kuptim?

— Të pafajshëm në kuptimin e vërtetë të fjalës, siç ishte e pafajshme në rastin e helmimit ajo gruaja për të cilën folëm, siç ishte i pafajshëm një fshatar që e kam njohur tani e që akuzohet për vrasje; siç janë të pafajshëm një nënë bashkë me të birin e saj që akuzoheshin për djegien e një hauri, kurse djegien e kishte bërë vetë i zoti.

— Që gabime gjyqi ka patur, ka edhe do të ketë gjithmonë, këtë nuk mund ta mohojë njeri. Gjyqi është një institucion njerëzor dhe, si i tillë, nuk mund të jetë i përsosur.

— Veç kësaj, pjesa më e madhe janë të pafajshëm — vazhdoi Nekludovi, — sepse të edukuar në një ambjent të caktuar, nuk mendojnë se bëjnë krim duke kryer disa veprime të ndaluara.

— Më falni, po kjo që thoni ju, nuk është e drejtë; hajduti, fjala vjen, e di fare mirë që nuk është një gjë e mirë të vjedhësh dhe se nuk duhet vjedhur, e di fare mirë, me fjalë të tjera, që vjedhja është një veprim imoral, — tha Ignati Nikiforoviçi gjithë po me atë buzëqeshje të qetë, të kënaqur e lehtësisht mospërfillëse që, më tepër se çdo gjë tjetër tek ai, ja ngrinte peshë nervat Nekludovit.

— Jo, përkundrazi, nuk e di; i thonë: mos vidh, mirëpo ai e sheh dhe e di që fabrikantët ja vjedhin punën, ja hanë

hakun, se qeveria me të gjithë ata nëpunësit e saj e xhvat përditë nëpërmjet taksave.

— Po këtij i thonë anarkizëm, — tha i qetë Ignati Nikiforoviçi, duke përcaktuar në këtë mënyrë domethënien që kishin për të fjalët e kunatit.

— Se si i thonë nuk e di, po unë them atë që është, — vazhdoi Nekludovi, — ai e di që qeveria e grabit; ai e di që ne, çifligarët, kemi filluar ta grabitim që prej kohësh, duke i rrëmbyer tokën që duhej të qe pasuri e përbashkët; por ne, kur e kapim duke mbledhur ndonjë degë të thatë nga kjo tokë e rrembyer që i duhet ndofta që të bëjë pak zjarr e të ngrohet ne i hidhemi në fyt, e rrasim në burg, e quajmë hajdut. Por ai e di mirë që hajdutët jemi neve dhe jo ai, dhe prandaj çdo restitucion [1]) i mallit që i kanë vjedhur, ka në sytë e tij një kuptim të ligjshëm.

— Nuk ju kuptoj ose, nëqoftëse ju kuptoj, nuk jam dakord me ju. Toka s'ka se si të mos jetë pronë e dikujt. Po të jetë se ju do ta ndani, — nisi të thotë Ignati Nikiforoviçi i qetë dhe plotësisht i bindur këtë radhë se Nekludovi ishte socialist, dhe se një nga kërkesat themelore të doktrinave socialiste në përgjithësi ishte që toka të ndahej në pjesë të barabarta. Kjo, sipas mendimit të tij, ishte një budallallëk me okë dhe ai ishte i sigurtë se mund ta provonte këtë fare lehtë. — Po të jetë se ju do ta ndani sot në pjesë të barabarta, nesër ajo do të kalojë prapë në duart e atyre që janë më punëtorë dhe më të zot.

— Kush ju thotë se toka duhet ndarë në pjesë të barabarta? Toka nuk duhet të jetë pronë e askujt. ajo as nuk mund të blihet, as nuk mund të shitet. as nuk mund të jepet me qira.

— E drejta e pronësisë ka lindur bashkë me njeriun. Pa të drejtën e pronësisë do të mungonte çdo interesim për punimin e tokës. Hiqeni të drejtën e pronësisë, dhe të kthehemi menjëherë në njeriun e egër të shoqërisë primitive! — tha Ignati Nikiforoviçi duke i shqiptuar të gjitha këto si një njeri me kompetencë të rrallë. por, në të vërtetë, duke përsëritur fjalë për fjalë atë argumentin e zakonshëm për të justifikuar pronësinë e tokës që mbahet si i pakundërshtueshëm dhe që mbështetet në faktin se, lakmia që tregojnë njerëzit për të patur tokë, e legalizon më së miri të drejtën e pronës mbi të.

---

1) kthim (frëngj.)

— S'është aspak e vërtetë! Përkundrazi, atëhere toka do të punohet më mirë dhe nuk do të mbetet shkretë si tani kur çifligarët, me gjithëse vetë nuk janë në gjëndje ta çfrytëzojnë si duhet, nuk ua japin atyre që janë në gjëndje.

— Më falni, Dimitri Ivanoviç, por do të më lejoni t'ju them se po flitni marrëzira! Po si është e mundur të hiqet në kohën tonë prona e tokës? E di që kjo marrëzi juve u ka ardhur dërmënd që kur, por më lejoni t'jua them haptas... — këtu Ignati Nikiforoviçi u zverdh, zëri iu drodh dhe nga shprehja e fytyrës së tij kuptohej qartë që kjo çështje e prekte fare nga afër. — Unë do t'ju këshilloja ta mendonit mirë këtë punë para se ta vinit në jetë.

— Ju e kini fjalën për punët e mia personale?

— Po. Unë mendoj se të gjithë ata që si ne kanë një farë pozite në shoqëri, janë të detyruar të përballojnë përgjegjësinë që rrjedh nga kjo pozitë duke bërë çmos për ruajtjen e atyre kushteve të jetesës në të cilat ne kemi lindur dhe që i kemi trashëguar nga të parët tanë e të cilat duhet t'ua lëmë ashtu siç i kemi gjetur edhe atyre që do të vinë pas nesh.

— Unë mendoj se e kam për detyrë...

— Jo, do më falni, — vazhdoi Ignati Nikiforoviçi pa e lënë Nekludovin të fliste, — unë nuk flas për veten time dhe për fëmijët e mi. E ardhëshmja e fëmijëve të mi është e siguruar dhe unë fitoj aq sa na mjafton për të jetuar, dhe mendoj që edhe fëmitë e mi nuk do jetojnë keq. Prandaj protesta ime kundër veprimeve tuaja që, me lejen tuaj, do t'i cilëscj si fort të pamatura, nuk ka si shtytje aspak cënimin e interesave të mia personale, por shkeljen e disa parimeve themelore të shoqërisë sonë që nuk më lejon në asnjë mënyrë të pranoj sjelljen tuaj. Unë, nga ana ime, do t'ju këshilloja t'i vinit gishtin kokës, të lexonit ndonjë libër...

— Se si duhet t'i kryej unë punët e mia, se çfarë duhet të lexoj e çfarë nuk duhet të lexoj, do të më lejoni t'jua them se kjo është një çështje që mund ta zgjidh vetë, pa ndihmën tuaj, — tha Nekludovi, ndërsa zbehej në fytyrë dhe, duke ndjerë se po i ftoheshin duart e se nuk ishte më i zoti ta përmbante vehten, heshti dhe nisi të pijë çajin.

XXXIII

— Fëmijtë ç'bëjnë? — e pyeti Nekludovi të motrën, si e mori pak veten.

Natalia Ivanovna i tha se fëmijtë kishin mbetur me gjyshen dhe, e gëzuar që diskutimi i rreptë i vëllait me të shoqin kish marrë fund, nisi të tregojë se si fëmijtë e saj luanin duke bërë gjoja sikur po udhëtonin, tamam ashtu si dikur edhe ai vetë me ato dy kukllat e tij, me arapin e zi dhe me një kukëll tjetër që e quante «la Francaise».

— Edhe këtë e mban mënd? — tha Nekludovi duke buzëqeshur.

— Po, e mbaj mënd shumë mirë. Ja, pikërisht kështu lozin dhe ata. Nuk është për t'u çuditur?

Përshtypja që kish lënë biseda e mëparëshme qe zhdukur. Natasha tani ishte e qetë por, prapë, nuk deshte të fliste në prani të burrit për gjëra që i dinte vetëm ajo dhe Nekludovi dhe, për të hapur një bisedë, ku të merrnin pjesë të gjithë, foli për lajmin që kishte ardhur gjer atje nga Peterburgu mbi mënxyrën që e kishte pllakosur t'ëmën e Kamenskit, e cila e kishte humbur birin e saj të vetëm në një dyluftim.

Ignat Nikiforoviçi tha se nuk pajtohej me dispozitat që ishin tani në fuqi, të cilat nuk lejonin që vrasjet në duel të futeshin në radhët e krimeve ordinere.

Nekludovi tha se nuk ishte i atij mendimi dhe përsëri mbi këtë themë u ndez një diskutim i zjarrtë ku arsyetimet nga të dy anët nuk shkonin gjer në fund, ku mbeteshin shumë gjëra për të thënë dhe që, në fund të fundit, i la të dy kundërshtarët të patundur në mendimet e tyre krejt të kundërta.

Ignat Nikiforoviçi e ndjente fare mirë që Nekludovi e urrente, që e përbuzte fund e krye të gjithë veprimtarinë e tij dhe, pra, donte me çdo kusht t'i provonte se gënjehej. Nekludovi, nga ana e tij, pa zënë në gojë inatin që ndjente kur shikonte se si kunati përzihej në çështjet që kishin të bënin me pronat e tij (thellë në shpirt ai e ndjente se kunati, e motra e tij dhe fëmijtë e tyre, si trashëgimtarët e tij më të afërtë, e kishin këtë të drejtë), ziente i tëri përbrënda nga marazi kur mendonte që njeri aq injorant dhe i trashë me gjakftohtësinë dhe sigurinë më të plotë vazhdonte ta quante të arësyeshme një gjë që, përkundrazi, siç i dukej tani Nekludovit, ishte marrëzia dhe krimi më i

madh që mund të mendohej. Ishte pikërisht kjo vetsiguri e fryrë dhe mospërfillëse që e nevrikoste më tepër se çdo gjë tjetër Nekludovin.

— Po pse, sipas mendimit tuaj, gjyqi çfarë do të bënte? — pyeti ai.

— Do të dënonte njerin prej të dy duelantëve, si një vrasës ordiner, me punë të detyruar.

Nekludovi ndjeu se duart po i ftoheshin përsëri dhe tha i nxehur:

— E ç'del nga kjo?

— Nga kjo del se, në këtë rast, do të respektohej drejtësia.

— Kush ju dëgjon juve, mund të mendojë se qëllimi i gjyqit është drejtësia! — tha Nekludovi.

— Po ç'tjetër?

— Ruajtja e interesave të klasave në fuqi. Gjyqi, sipas mendimit tim, nuk është tjetër veçse një armë administrative për të mbrojtur rendin në fuqi, interesat e klasës sonë.

— Jam i detyruar të pohoj se kjo është një pikëpamje me të vërtet origjinale, — tha Ignati Nikiforoviçi i qetë dhe duke vënë buzën në gaz. — Zakonisht, gjyqit nuk i atribuojnë pikërisht këto funksione që thoni ju.

— Teorikisht, por jo praktikisht, siç kam patur rastin të bindem vetë. Gjyqi ka për qëllim vetëm ngurtësimin e shoqërisë në ato forma të cilat ndodhet tani dhe, në përputhje me këtë, ka për detyrë t'i përsekutojë dhe t'i dënojë të gjithë ata që duke qëndruar për veten e tyre në një nivel më të lartë, kërkojnë të ngrenë në këtë nivel edhe shoqërinë (këta janë të ashtuquajturit kriminelë politikë) si edhe ata që qëndrojnë në një nivel më të ulët, d.m.th. t'ashtuquajturit tipa kriminelë.

— Nuk mund të pranoj në radhë të parë që kriminelët politikë, siç thoni, ju, dënohen sepse qëndrojnë më lart se niveli mesatar i shoqërisë. Në pjesën më të madhe, këta janë llumi i shoqërisë dhe po aq të degjeneruar, qoftë edhe në një drejtim tjetër, sa edhe ata tipat kriminelë që, simbas mendimit tuaj, qëndrojnë nën nivelin mesatar.

— Kurse unë njoh njerëz që moralisht qëndrojnë shumë më lart nga ata që i dënojnë; kështu, për shembëll, sektantët, të gjithë sektantët pa përjashtim, janë njerëz me moral të shëndoshë, me bindje të forta....

Por Ignat Nikiforoviçi, ashtu siç e kanë zakon përgjithësisht ata që nuk pranojnë kurrsesi t'i ndërpresin kur fillojnë të flasin, nuk ja vinte veshin Nekludovit dhe, duke e nxehur me këtë atë dhe më tepër, vazhdonte të fliste në të njëjtën kohë me Nekludovin.

— Nuk mund ta pranoj së dyti që gjyqi ka për qëllim të ruajë rendin në fuqi. Gjyqi ndjek të tjera qëllime: ose t'i ndreqi...

— Oh, i ndreqin mirë në burg, s'ke se ç'thua, — ndërhyri Nekludovi.

— ... ose t'i mënjanojë këta njerëz, këta tipa të degjeneruar, këta përbindësha në trajtë njeriu, që vënë në rrezik vetë ekzistencën e shoqërisë njerëzore— vazhdoi me këmbëngulje Ignat Nikiforoviçi.

— Po pikërisht atje është puna se nuk bën as njerën as tjetrën. Shoqëria nuk i ka mjetet për një gjë të tillë.

— Çfarë doni të thoni me këtë? Nuk ju kuptoj, — pyeti Ignat Nikiforoviçi duke buzëqeshur me zor.

— Dua të them se dënimet e arësyeshme, në kuptimin e vërtetë të fjalës, janë vetëm dy dhe janë pikërisht ato që përdoreshin në kohët e vjetra: dënimi trupor dhe dënimi me vdekje. Por këto, dora dorës që ndjenjat e njerëzve bëhen më të buta, përdoren përherë e më rrallë, — tha Nekludovi.

— Ja një gjë e re, dhe është për t'u çuditur që po e dëgjoj nga ju.

— Po, është e arësyeshme t'i shkaktosh një dhëmbje njeriut që të mos e përsëriti në të ardhmen fajin për të cilin e ka merituar dhimbjen, dhe është plotësisht e arësyeshme që t'i pritet koka një njeriu të dëmshëm e të rrezikshëm për shoqërinë. Po ç'kuptim ka që një njeri i degjeneruar nga papunësia dhe nga shëmbulli i keq të mbyllet në burg e të detyrohet të jetojë në kushtet e një papunësie të detyruar e të garantuar, në një shoqëri njerëzish po aq të degjeneruar, në mos më tepër të degjeneruar nga ai? Ose të transportohet me shpenzimet e shtetit (dhe ky transport kushton për secilin të paktën pesëqind rubla) nga guberna e Tulës në atë të Irkutskut apo të Kurskut...

— Të gjithë, në përgjithësi, u trëmben këtyre udhëtimeve me shpenzimet e shtetit, por sikur të mos qenë ato, sikur të mos qenë burgjet, ne nuk do të bisedonim rehat-rehat me njeri tjetrin, siç po bëjmë tani.

— Këto burgje që kemi ne, në asnjë mënyrë nuk mund të na garantojnë sigurinë, sepse njerëzit që mbyllen aty pas ca kohe dalin. Përkundrazi, këto institucione i rrokullisin këta njerëz gjer në shkallën më të ulët të vesit e të degjenerimit dhe, në këtë mënyrë, i bëjnë edhe më të rrezikshëm për shoqërinë.

— Ju mbase doni të thoni që sistemi i burgjeve ka nevojë të përsoset.

— Në asnjë mënyrë nuk ka se si të përsoset. Përsosja e burgjeve do të kushtonte shumë më tepër se sa harxhohet në vendin tonë për arësimin e popullit dhe këtij do t'i shtohej akoma edhe një barrë tjetër e rëndë.

— Por të metat e sistemit të burgjeve nuk e cënojnë aspak vetë gjyqin, — vazhdoi ligjërimin e tij Ignat Nikiforoviçi duke mos ja vënë veshin edhe këtë radhë kunatit.

— Nuk është e mundur që këto të meta të zhduken, — tha Nekludovi duke e ngritur zërin.

— E po atëhere, çfarë duhet bërë? Mos duhet t'i vrasim këta njerëz? Apo, ashtu siç propozonte një burrë shteti, t'u nxjerrim sytë? — tha Ignat Nikiforoviçi me një buzagaz ngadhënjimi.

— Po, kjo do të qe diçka e egër vërtet, po të paktën do të kishte një kuptim. Kjo që bëhet tani, jo vetëm që është një gjë e egër e pa asnjë kuptim, por është edhe një marrëzi kaq e fortë, është një idiotizëm kaq i madh saqë nuk kuptohet se si është e mundur që, njerëz të shëndoshë nga trutë, të marrin pjesë në një punë kaq pa mënd dhe kaq egërsisht të tmerrëshme siç është veprimtaria e gjyqit penal.

— Ju harroni se në të bëj pjesë edhe unë, — tha Ignat Nikiforoviçi duke u zbehur.

— Kjo është punë për juve. Por unë, nga ana ime, siç ju thashë, nuk e kuptoj.

— Unë mendoj se ju nuk kuptoni shumë gjëra, — tha me zë të dridhur Ignati Nikiforoviçi.

— Unë pashë në gjyq se si prokurori mundohej me çdo mjet të provonte fajësinë e një djaloshi kaq fatkeq e të mjerë, sa të këpuste shpirtin; e di pastaj se si një prokuror tjetër, duke e marrë në pyetje një sektant e ka cilësuar lexitmin e ungjillit si një krim penal; me një fjalë, është e qartë se e gjithë veprimtaria e gjyqeve në përgjithësi, përmblidhet në të tilla veprime të çmëndura e çnjerëzore.

— Po të mendoja kështu si ju, unë me siguri nuk do të shërbeja, — tha Ignati Nikiforoviçi, dhe u ngrit në këmbë.

Nekludovi vuri re një shkëlqim të posaçëm nën syzat e kunatit. «Mos janë lot?» — mendoi. Lot ishin vërtet, por lot të një njeriu të fyer që qante nga inati. Ignat Nikiforoviçi shkoi në dritare, nxori shaminë, dhe u kollit dy a tri herë, nisi të fshinte syzat dhe pastaj, si i hoqi, fshiu dhe sytë. Si u kthye e ndenji përsëri në divan, Ignat Nikiforoviçi ndezi një cigare dhe nuk e hapi më gojën. Nekludovit i erdhi keq e tanp që e kishte hidhëruar kunatin dhe motrën, aq më tepër kur mendonte se të nesërmen do të nisej në një udhëtim të largët e nuk do t'i shihte më kurrë. I turbulluar e i trondituar u përshëndosh me ta dhe u kthye në shtëpi.

«Ka shumë mundësi që të kem patur të drejtë n'ato që thashë, të paktën ai nuk qe i zoti të më kundërshtonte. Po, sidoqoftë, nuk duhej folur ashtu siç fola. Duket fare pak paskam ndryshuar gjersa nuk jam i zoti ta përmbaj veten e arrij të fyej atë haptas e t'i jap një hidhërim kaq të madh Natashës së shkretë», — mendonte ai.

XXXIV

Grupi i të burgosurve në të cilin bënte pjesë edhe Masllova do të nisej me trenin e orës tre, kështuqë Nekludovi, për t'i parë të burgosurit kur të dilnin nga burgu dhe të shkonte bashkë me ta gjer në stacion të trenit, kishte vendosur të ndodhej në burg përpara orës dymbëdhjetë.

Si i sistemoi plaçkat dhe dokumentat, letrat edhe librat që do të merrte me vete, Nekludovi mori në dorë ditarin dhe nisi ta çfletojë. U ndal e lexoi me vëmëndje sidomos faqet e fundit. Përpara se të nisej për në Peterburg kishte shkruar: «Katjusha nuk pranon që unë të sakrifikohem për të, ajo do që të sakrifikohet vetë. U bë si deshi ajo. Po u bë edhe ashtu si desha unë. Ajo po më gëzon me atë ndryshim të brëndshëm që më duket e kam frikë ta besoj se po ndodh në të. Kam frikë ta besoj, por më duket se ajo po lind në një jetë të re». Fill pas këtyre, më poshtë qe shkuar: «Kam ndjerë një hidhërim të madh por edhe një gëzim të madh. Mora vesh se ajo nuk qe sjell mirë në infermeri. Dhe, ja, befas, ndjeva një dhëmbje të thellë. Nuk e kisha besuar se do ndjeja një dhëmbje kaq të thellë. I fola me neveri e me urrejtje por pastaj, befas, solla ndërmënd veten time se si

shumë herë, bile edhe atë çast, kisha qenë fajtor, të paktën në mendime, pikërisht për atë gjë që e kisha urryer. E neverita atëhere veten dhe m'erdhi keq për të. Po shpirti m'u ngroh dhe m'u gëzua. Ah, sa të mirë do t'ishim sikur ta shikonim dot në kohë trarin në syrin tonë!». Dhe më pastë, atë ditë, ai shkroi: «Isha tek Natasha dhe, ndofta sepse më ka hyrë vetja në qejf, nuk u solla mirë me të. Më vonë u pendova. Po ç'u bë, u bë! Që nga dita e nesërme fillon për mua një jetë e re. Pra, lamtumirë jetë e vjetër, lamtumirë përgjithmonë! Shumë gjëra kam vënë re këto kohët e fundit, por akoma nuk jam në gjëndje t'i shpjegoj».

Të nesërmen, porsa u zgjua, ndjenja e parë që provoi Nekludovi ishte ndjenja e pendesës që e pushtoi nga qëndrimi që kish mbajtur dje kundrejt kunatit.

«Kështu nuk mund të nisem, — mendoi — duhet të shkoj tek ata e ta ndreq fajin që bëra».

Por, duke i hedhur një sy orës, pa se tani ishte vonë për këtë dhe se duhej të ngutej t'i shihte të burgosurit kur t'i nxirrnin nga burgu. Si u bë gati me të shpejtë dhe si i dërgoi në stacion plaçkat me një shërbyes të hotelit dhe me Tarasin, të shoqin e Fedosjes, i cili do të nisej bashkë me të, Nekludovi zuri me qira karrocën e parë që i doli përpara dhe shkoi në burg.

Treni i të burgosurve nisej dy orë më parë nga treni i postës, me të cilin do të udhëtonte Nekludovi dhe prandaj ai e lau që atë ditë llogarinë me hotelin me qënë se kishte vendosur të mos kthehej më atje.

Ishim në ditët e nxehta të korrikut. Vapa shtrëngonte. Gurët e rrugëve e të shtëpive, hekurat e çative nuk kishin mundur të ftoheshin gjatë natës dhe ja kthenin tani nxehtësinë ajrit të ndezur, përvëlonjës dhe të palëvizur. Nuk kishte erë dhe, kur fillonte të frynte më të rrallë, ishte sa për të përhapur rreth e rrotull një grahmë të qelbur bojrash vaji dhe për të ngritur përpjetë një re pluhuri të nxehtë e të thatë. Rrugët qenë pothuajse fare të shkreta dhe ata njerëz të pakët që dukeshin aty këtu mundoheshin të ecnin rrëzë mureve, nën hije. Vetëm ca fshatarë që merreshin me ndërtimin e rrugëve, me fytyra të nxira nga dielli, qëndronin në mes të rrugës dhe ngulnin me çekan në rërën e përvëluar gurët e kalldrëmit. Policë të zymtë, me uniforma të

lehta verore, mbi të cilat kishin shkuar kordonin ngjyrë portokalli të revolverit që mbanin në brez, qëndronin edhe ata në mes të rrugës, duke u mbështetur të mërzitur herë në njerën këmbë, herë në tjetrën. Ca vagona të hequr nga kuaj me kokën mbështjellë me ca kapuçë të bardhë me të çara për veshët, me xhamet mbuluar me perde tejpërtej nga ana e diellit, shkitnin lart e poshtë nëpër udhë me një tringëllimë zilesh.

Kur Nekludovi iu afrua burgut, të burgosurit akoma nuk kishin dalë. Në burg vazhdonte akoma ajo puna e madhe për dorëzimin dhe marrjen në dorëzim të të burgosurve që kish filluar që në orën katër të mëngjezit. Në grupin e të burgosurve, që do të nisej atë ditë, bënin pjesë gjashtëqind e njëzet e tre burra dhe gjashtëdhjetë e katër gra. Që të gjithë këta duheshin numëruar, duheshin kontrolluar emërat e tyre sipas regjistrave të burgut, duheshin ndarë veç të sëmurët dhe ata që paraqiteshin të dobët, duke i caktuar nën kujdesin dhe mbikqyrjen e veçantë të ushtarëve që do t'i përcillnin të burgosurit gjatë udhëtimit. Drejtori i ri i burgut, dy ndihmësa të tij, mjeku, ndihmës mjeku, oficeri marrës në dorëzim dhe shkruesi kishin zënë vend rreth një tryeze rrëzë murit, nën hije, mbi të cilën qenë vendosur regjistrat, listat dhe takëmi i bojës dhe, si i thirrnin një nga një të burgosurit, i kontrollonin dhe i pyetnin duke mbajtur shënim për të gjitha.

Tani pothuajse gjysma e tryezës nuk ishte më nën hije. Qe bërë një vapë e një zagushi që të merrte fryma, ca nga mungesa e erës dhe ca më tepër edhe nga fryma e tërë asaj turme të burgosurish qe qenë ngjeshur e grumbulluar aty afër.

— Siç duket, nuk do të mbarojmë dot kurrë! — tha, duke thithur cigaren oficeri marrës në dorëzim që ishte një burrë i gjatë e i trashë, me një fytyrë të kuqe, me supe të ngritur përpjetë e krahëshkurtër, që nuk pushonte së tymosuri një çast nëpërmes mustaqeve të dendura që i mbulonin gojën. — Për nder që na doli shpirti! Nga na i paskeni mbledhur të gjithë këta? Ka edhe shumë akoma?

Shkruesi pa regjistrin.

— Akoma edhe njëzet e katër veta, përveç grave.

— Ju ç'më rrini atje, bëni përpara!... — u thirri oficeri të burgosurve që nuk ishin kontrolluar akoma e ngjishin njeri pas tjetrit.



Të burgosurit kishin më se tri orë që pritnin radhën dhe jo ulur, po në këmbë, jo në hije, po në diell.

Kjo punë bëhej përbrënda mureve të burgut, ndërsa jashtë, tek dera, qendronte si zakonisht një roje me pushkë dhe një sërë qerresh, ndo njëzet, që do të ngarkoheshin me plaçkat e të burgosurve dhe me ata prej tyre që ishin të dobët e të sëmurë. Në të kthyerën e rrugicës që dilte tek burgu qe mbledhur një turmë njerëzish e përbërë nga farefisi dhe nga miqt' e të burgosurve që prisnin sa të dilnin për t'u thënë ndonjë fjalë apo për t'u dhënë ndonjë gjë. Me ta u bashkua edhe Nekludovi.

Ai qendroi aty ndonjë orë. Më në fund, pas derës u dëgjua një tringëllimë prangash, një zhurmë hapash, disa komanda, të kollitura dhe gumëzhima e lehtë e një turme të madhe njerëzish që po afrohej. Vazhdoi kështu ndonja pesë minuta. Gjatë kësaj kohe mbikqyrësat hynin e delnin parreshtur nga një derë anësore. U dëgjua më në fund një komandë më e fortë nga të tjerat.

Dera u hap me zhurmë, trigëllima e prangave u degjua më çkoqur dhe disa ushtarë me pushkë, me uniforma të bardha verore, duallën jashtë dhe u vendosën si për një manevër të zakonëshme, në trajtë harku, përpara derës e në të dy anët e saj. Menjëherë pas kësaj, u dëgjua një komandë tjetër e të burgosurit filluan të dilnin dy e nga dy, me shapka të sheshta mbi kokët e rruara, me nga një trastë në krah, duke hequr zvarrë këmbët me pranga e duke tundur njerën dorë, ndërsa me tjetrën mbanin torbën që u varej mbi kurriz. Në fillim duallën të burgosurit e dënuar me punë të detyruar, veshur që të gjithë me petka të murme e që kishin që të gjithë një haso karè në shpinë si shenjë dalluese. Që të gjithë — të rinj, pleq, të hollë, të trashë, të zbetë, të kuq, të zez, me mustaqe, me mjekër, pa mjekër, rusë, tartarë, çifutë — dilnin duke tringëllitur prangat e duke e lëvizur me gjallëri njerën dorë, sikur po niseshin për një udhëtim shumë të largët, por, pa bërë mirë as dhjetë hapa, ndaleshin dhe vendoseshin të bindur në rresht për katër, njeri pas tjetrit. Fill pas tyre vërshuan nga dera po të tillë njerëz si ata, me kokë të rruar, me petka të murme, por pa pranga në këmbë dhe me duar të lidhura. Këta ishin të dënuarit me internim... Po ashtu si të parët, edhe këta, ecnin me gjallëri gjersa u ndalën e u shpërndanë duke u vendosur në rresht për katër. Pas tyre vinin të dënuarit nga komunitetet, pastaj gratë, edhe këto sipas një rregulli të cak-

tuar: në krye ato me punë të detyruar, me fustanet e shamitë e murme të burgut, pastaj t'internuarat e, më në fund, gratë që ndiqnin burrat e tyre e që ishin veshur me fustane gjithfarësh, me veshje fshatare e qytetare. Disa nga gratë mbanin në gji foshnjet duke i mbuluar me palët e fustanëve për të mos i vrarë dielli.

Gratë hiqnin pas edhe fëmijët e tyre më të rritur që ecnin vetë. Fëmijtë dukeshin si ata mëzat e vegjël që lëvrijnë andej këtej nëpër kopetë e kuajve e ngjishen pas mëmave. Burrat rrinin të heshtur dhe vetëm më të rrallë dëgjohej aty-këtu në radhët e tyre ndonjë e kollitur apo ndonjë pështyrimë me zë të ulët. Gratë, përkundrazi, pështyritnin parreshtur. Nekludovit iu duk se e vuri re Masllovnën tek po dilte; por pastaj e humbi dhe nuk e gjeti dot më në atë turmë të murme qëniesh me fëmijë e me trasta që dukej sikur kishte humbur çdo tipar njerëzor dhe çdo karakteristikë femërore.

Megjithëse të burgosurit i kishin numëruar një herë përpara se të dilnin nga burgu, ushtarët që i shoqëronin i numëruan edhe një herë tjetër me qëllim që të siguroheshin për saktësinë e listave sipas të cilave i kishin marrë në dorëzim. Kjo punë vazhdoi për një kohë të gjatë meqënëse disa nga të burgosurit lëviznin duke kaluar nga një vend në një tjetër, duke e ngatërruar në këtë mënyrë numërimin. Ushtarët i shanin e i shtynin të burgosurit ngatërrestarë, të cilët ktheheshin përsëri në vendet e tyre të bindur, por me fytyra të ndezura nga inati. Kështu, numërimi u përsërit disa herë. Më në fund oficeri, të cilit i qe besuar shoqërimi i të burgosurve në stacion, dha një komandë dhe, menjëherë, turma u vu në lëvizje. Ata nga të burgosurit, burra, gra e fëmijë, të cilët qenë ndarë veç gjatë numërimit, si të zëmurë, u drejtuan për nga qerret e, si hodhën mbi to plaçkat, hypën dhe vetë. Hypën një e nga një gratë me foshnjet që u qanin në duar, fëmijët e vegjël që ziheshin kush e kush të zinte vendin më të mirë, burrat çehrengrysur, të zymtë.

Disa të burgosur iu afruan oficerit e, duke hequr shapkat, diç i thanë. Nekludovi e mori vesh më vonë se ata i qenë lutur që t'i lejonte të hypnin në qerre. Ai pa se si oficeri, pa thënë asnjë fjalë, pa begenisur që t'i kthente sytë nga ata që i luteshin, vazhdonte të thithte cigaren dhe se si pastaj e ngriti atë krahun e tij të shkurtër përpjetë e u mat të qëllonte njerin prej tyre, ndërsa ky i fundit, duke e strukur



kokën e rruar ndënë sqetull, kërceu pas si ndonë plesht.

— Të bëj unë fisnik [1]). e të tillë fisnik që të mos e harrosh tërë jetën! Marrsh, më këmbë! — ulëriti oficeri.

Oficeri lejoi që të hypte në karrocë vetëm një plak të gjatë me pranga që mezi mbahej në këmbë. Nekludovi pa se si plaku e hoqi shapkën e sheshtë nga koka, bëri kryqin, iu afrua qerres e u mundua të hypte, por s'qe i zoti të ngrinte këmbën, ca nga që e kishte të drobitur e ca më tepër nga pesha e hekurave. Një grua që ndodhej në qerre i shtriu dorën dhe e ndihmoi.

Kur qerret u mbushën plot e përplot me trasta dhe mbi to zunë vend të gjithë ata që u lejuan, oficeri hoqi kapelen, fshiu me shami ballin, kokën e shogur dhe qafën e trashë e të kuqe e bëri kryqin.

— Para, marrsh! — komandoi ai.

Ushtarët vrigëlluan armët, të burgosurit hoqën shapkat e nisën të bënin kryqin (disa me dorën e mëngjër); njerëzit e afërt, që kishin ardhur t'i shikonin për herë të fundit, diç u thanë me të thirrura, të burgosurit diç iu përgjigjën, gratë nisën të vajtonin me të madhe e, më në fund, turma e të burgosurve, e rrethuar nga të dy anët me ushtarë me uniforma të bardha verore që i shoqëronin, u tund dhe u vu në udhë, duke ngritur përpjetë me këmbët tërë pranga një re të dendur pluhuri. Në krye ecnin ushtarët, pas tyre të dënuarit me punë të detyruar, në rresht për katër, që e mbushnin vendin me zhurmën e vargonjëve, pastaj të internuarit me internim, pastaj të dënuarit nga komunitetet, të lidhur nga dora dy e nga dy, pastaj gratë. Më në fund vinin qerret, ngarkuar me trastat e me të sëmurët. Mbi njerën syresh qe ulur, disi më larg nga të tjerët, një grua që rrinte e kuspullosur dhe kish vënë kujen.

XXXV

Kolona e të burgosurve ishte kaq e gjatë saqë, kur kreu qe larguar shumë sa nuk dukej më, qerret me trastat e me të sëmurët akoma nuk kishin lëvizur nga vendi. Kur, më në fund, u tundën edhe qerret, Nekludovi i hypi karro-

1) Përveç të sëmurëve e të burgosurve politikë, kishin të drejtë ta bënin rrugën me karrocë edhe ata që ishin me origjinë fisnike (shënim i përkthyesit).

cës që po e priste dhe e urdhëroi karrocierin të dilte në krye të kolonës e pastaj të kalonte me qëllim që të shihte se mos kishte ndonjë të njohur ndërmjet burrave, dhe, ndërmjet grave, të kërkonte Masllovën e ta pyeste a i kishte marrë sendet që i kishte dërguar. Vapa sa vinte e shtrëngonte dhe më tepër. Nuk frynte fare erë dhe pluhuri i ngritur nga mijëra e mijëra këmbë qendronte si një re e përherëshme mbi kokat e të burgosurve, që ecnin në mes të udhës. Të burgosurit ecnin me hapa të shpejta dhe kali gërdallë i karrocës mbi të cilën kishte hipur Nekludovi, mezi i arriti dhe i kaloi. Një mijë qënie të panjohura me një pamje të çuditëshme të frikëshme ecnin në radhë njeri pas tjetrit, të gjithë të veshur e të mbathur njëlloj, të gjithë duke e tundur lart e poshtë krahun e lirë në ritmin e hapit, si për t'i dhënë zemër vetes n'atë udhëtim të gjatë. Ishin kaq shumë, ngjisnin kaq shumë mes tyre dhe ishin vënë në kondita kaq të çuditëshme të njëllojta, saqë Nekludovi kishte përshtypjen se ata që kalonin përpara tij nuk ishin njerëz si gjithë njerëzit e tjerë, por ca qënie të llahtarëshme e fantastike. Dhe kjo përshtypje nuk u zhduk tek ai gjersa dalloi mes turmës vrasësin Fedorov, komikun Ohotin, dhe një të burgosur tjetër, një endacak i cili i qe lutur një herë të ndërhynte që ta lironin. Të burgosurit, pothuajse që të gjithë, kthenin kokën nga karroca që u kalonte pranë e drejtonin sytë nga zotëria që kish hipur në të. Federovi e tundi kokën dhe e ngriti lart në shënjë se e kishte njohur Nekludovin; Ohotini shkeli synë. Por asnjeri, as tjetri nuk e përshëndetën duke menduar se kjo ishte e ndaluar. Kur erdhi në një radhë me gratë, Nekludovi menjëherë e vuri re Masllovën. Ajo ndodhej në rreshtin e dytë të grave. E para në të majtë në këtë rresht ishte një grua me fytyrë të skuqur nga vapa, me këmbë të shkurtëra, me sy të zez, me bluzën futur ndën brez e, në përgjithësi, shumë e shëmtuar. Kjo ishte «Bukuroshja». E dyta, po në atë krah, ishte një grua me barrë dhe e treta — Masllova. Ajo e kishte hedhur trastën pas krahëve dhe e mbante kokën drejt pa e lëvizur. Fytyra e saj dukej e qetë dhe kishte një shprehje të vendosur. E katërta në rreshtin e saj ishte një grua e re dhe e bukur që dukej shumë e gjallë, me një fustan të shkurtër dhe me një shami në kokë që e kishte lidhur ashtu siç e lidhin zakonisht plakat. Kjo ishte Fedosja. Nekludovi zbriti nga karroca dhe iu afrua grave me qëllim që të pyeste Masllovën për plaçkat dhe se si e ndjente veten

Por një nënoficer që ishte caktuar të ruante kolonën nga ajo anë, porsa e pa, iu afrua me vrap dhe e ndaloi.

— Është e ndaluar, zotëri, t'i afrohesh kolonës — është e ndaluar, — thirri ai që së largu.

Kur u afrua dhe njohu nga fytyra Nekludovin (Nekludovi ishte bërë një vizitor i përhershëm i burgut, prandaj e njihnin pothuajse të gjithë), nënoficeri vuri dorën në strehën e kapelës dhe, duke u ndaluar përpara Nekludovit, tha:

— Tani nuk lejohet. Pritni sa të shkojmë në stacion. Këtu është e ndaluar. Asnjeri të mos ndalet! Përpara, marrsh! — u bërtiti ai të burgosurve dhe, me gjallëri të madhe, ndonëse bënte shumë vapë, u kthye duke vrapuar trokthi në vendin e tij, ndërsa çizmet e reja llustrofini i shkëlqenin nga dielli.

Nekludovi u kthye në trotuar dhe, si e urdhëroi karrocierin që ta ndiqte pas me karrocën, vazhdoi të ecte në krah të kolonës. Kudo që kalonte një kolonë e gjatë me të burgosur, njerëzit ndaleshin dhe e shikonin të tmeruar e me keqardhje. Ata që ndodheshin në karroca zgjatnin kokën nga dritarja dhe i ndiqnin me sy të burgosurit gjersa largoheshin e nuk dukeshin më. Këmbësorët shtangeshin në vend dhe soditnin të nemitur atë pamje të llahtarëshme. Disa afroheshin e jepnin ndonjë lëmoshë. Lëmoshat mblidheshin nga ushtarët. Disa të tjerë i binin pas kolonës si të hipnotizuar, por pastaj ndaleshin dhe vetëm e ndiqnin me sy duke tundur kokën. Njerëzit i bënin zë njeri tjetrit dhe nxitonin të dilnin nëpër dyert e shtëpive, apo nëpër dritare, pa i hequr dot sytë për një kohë të gjatë nga ai procesion i çuditshëm. Në një nga bulevardet e qytetit, kolona pengoi kalimin e një karroce lluksoze. Karrocën e ngiste një karrocier bythmadh, me një fytyrë të kuqe që i shkëlqente nga shëndeti, me një sërë kopsash mbi kurriz. Mbrënda në karrocë, nga ana e pasme, qënë ulur një burrë me të shoqen: ajo e thatë dhe e zbetë, me një kapele të çelët, me një ombrellë dielli të çelët; ai, me cilindër dhe me një pallto të çelët, elegante. Përballë qenë ulur fëmijtë e tyre: një vajzë e vogël veshur me rrobat e mira, e freskët si ndonjë lule, me flokët e verdhë e kaçurrel lëshuar mbi supe dhe me një ombrellë të vockël, të çelur edhe ajo si e ëma, dhe një djalë ndonja tetë vjeç, me një qafë të hollë e të gjatë, me supe të ngritura vetvetiu, me një kapele marinari stolisur me ca fjongo të gjata e me ngjyra. Babai e

qortoi me të rreptë karrocierin që nuk e kishte parashikuar me kohë atë ndalesë të mërzitëshme, mëma i picërronte sytë si e pështirosur dhe rrudhte ballin duke u mbrojtur nga dielli dhe nga pluhuri me ombrellën të cilën e kishte afruar pothuajse përmbi fytyrë. Karrocieri bythmadh e ngryste përherë e më tepër fytyrën dora dorës që dëgjonte vërejtjet e padrejta të padronit të tij që e kishte urdhëruar vetë të kalonte nga ajo rrugë, dhe sakaq hiqte zor të madh t'i përmbante kuajt e sojmë kuqaloshë, të dirsur nga vapa, që turhatnin me padurim e kërkonin të shkonin përpara.

Polici në rrugë me gjithë qejf do t'i bënte një nder pronarit të asaj karroce lluksoze duke i dhënë mundësi që të kalonte. Mirëpo për këtë duhej ndaluar kolona e të burgosurve dhe ai ndjente se n'atë vargan kishte një madhështi të zymtë që nuk mund të prishej në asnjë mënyrë, qoftë edhe për një zotëri aq të pasur. Prandaj u kufizua të vinte dorën në strehë të kapeles në shenjë përulje përpara pasurisë, dhe u hodhi të burgosurve një vështrim të rreptë si për të treguar që, sidoqoftë, ishte gati ta mbronte në çdo rast pronarin, karrocën dhe familjen e tij nga ata njerëz të ligj. Kështu që karrocës iu desh të priste sa të kalonte e gjithë kolona e të nisej vetëm atëhere kur u largua me kërkëllimë edhe qerrja e fundit, ngarkuar me trasta e me të sëmurë, e kur gruaja histerike që ndodhej në mes tyre, që kish heshtur një hop duke parë atë karrocë elegante, filloi përsëri të vajtojë e të rënkojë me të madhe. Vetëm atëhere karrocieri ua lëshoi lehtë frerat kuajve dhe mëzat kuqaloshë e këmbëshpejtë. duke kërcitur thundrat mbi kalldrëmin e rrugës, e tërhoqën butë-butë karrocën e lehtë me rrota gome duke u dreituar nga një vilë në periferi, ku shkonin të dëfrenin burri, gruaja, vajza me djalin me qafë të gjatë dhe me supe të ngritura vetvetiu.

Por as babai, as mëma nuk u dhanë fëmijëve të tyre ndonjë shpjegim rreth asaj që kishin parë. Kështuqë fëmijët u detyruan t'i gjenin vetë një kuptim asaj pamieje.

Vajza, duke hetuar shprehien që kishin fytyrat e prindërve të saj, arriti në përfundimin se ata nuk ishin njerëz si të gjithë njerëzit e tjerë. nuk ishin si babi, si mami, por ishin njerëz të këqij dhe prandaj, tamam ashtu duhej t'i përdornin, siç po i përdornin. Prandaj edhe ajo u tremb shumë kur i pa dhe u gëzua kur nuk i pa më.

Por i vëllai i saj, çunaku me qafë të hollë e të gjatë që s'ua hoqi sytë të burgosurve gjersa u zhdukën, e zgjidhi

këtë çështje krejt ndryshe. Ai e dinte mirë, e dinte pa qenë e mundur që të gabohej, se ja kishte thënë vetë zoti, se ata ishin po të tillë njerëz siç ishte edhe ai vetë, siç ishin të gjithë njerëzit e tjerë dhe se prandaj diç duhej t'u kishin bërë, duhet t'u kishin bërë me siguri një gjë që s'ishte e mirë, një gjë që s'duhej t'ua kishin bërë. Atij i erdhi keq për ta, u tmerua kur i pa me kokë të rruar e me pranga në këmbë, u tmerua kur mendoi se sa të këqij, shumë më të këqij, duhej të kishin qenë ata që i kishin katandisur n'atë gjëndje. Buzët iu mblodhën përherë e më tepër kur i shikonte dhe bëri çmos që të mos shpërthente në vaj, duke menduar se ishte turp të qante në një rast të tillë.

XXXVI

Nekludovi ecte po aq shpejt sa edhe të burgosurit por, sido që ishte veshur lehtë, kishte kaq shumë vapë sa që nuk mund të duronte dhe ndjente një zagushi nga pluhuri e nga ajri përvëlonjës e i palëvizur, sa i dukej sikur do t'i merrej fryma. Si bëri ndonjë çerek vjorste më këmbë, i hipi karrocës. Por edhe në karrocë u duk se bënte shumë vapë. U mundua të sillte ndër mënd fialët që kishte shkëmbyer një ditë më parë me kunatin gjatë bisedës se rreptë që kishte patur me të, por tani këto fjalë nuk i bënin më përshtypjen që i kishin bërë atë mëngjes. Me sa dukej, kishin ardhur përshtypjet shumë të forta të nisjes së kolonës me të burgosur, me të gjitha hollësitë që e kishin shoqëruar, dhe i kishin fshirë të parat. Rrëzë një gardh, rën hije, nia dy gjimnazistë kishin hequr kapelet e qenë kërrusur që të dy mbi një shitës akulloresh, që qe ulur në gjunjë përpara tyre. Njëri nga të dy e kishte ngrënë me sa dukej pjesën e tij, se atë kohë kishte nxjerrë gjuhën e po lëpinte një lugë të vogël prej ashti. Tjetri po priste akulloren e tij duke bërë sehir shitësin që mbushte një gotë me diçka të verdhë.

— Ku ka këtu ndonjë vend për të pirë diçka? — e pyeti Nekludovi karrocierin duke ndjerë se nuk duronte dot më nga vapa dhe se kishte patjetër nevojë të pinte ndonjë gjë të ftohtë që të freskohej.

— Tani këtu kanë ndërtuar një kafene të mirë. — tha karrocieri dhe, si u kthye në qoshe të udhës, e ndaloi karro-

cën përpara një ndërtese njëkatëshe me një tabelë të madhe përpara.

Një dyqanxhi me fytyrë të fryrë, e kishte hequr setrën nga vapa e qendronte pranë banakut, ndërsa dy kamarierë, me ca rroba që duhet të kishin qenë dikur të bardha, në mungesë të myshterinjve, qenë ulur në një tryezë e po rrinin. Porsa hyri Nekludovi, ata i kthyen menjëherë sytë nga ay klienti i rrallë dhe u treguan të gatshëm që t'i shërbenin. Nekludovi kërkoi që t'i sillnin një gotë me ujë Seltz-i dhe ndënji pak më tej dritares, tek një tryezë e vogël me një mbulesë të ndyrë.

Nja dy myshterinj të tjerë kishin zënë vend në një tryezë aty pranë përpara një samovari me çaj dhe një shisheje me xham të bardhë; fshinin or'e çast djersën nga balli dhe bënin disa hesape. Njëri ishte i zeshkët dhe me flokë të rëna, por edhe ato pak flokë të zeza e të rralla që i kishin mbetur mbi kokë, i suallën përsëri në mëndje Nekludovit Ignat Nikiforoviçin, bisedën që kishte patur një ditë më parë me të dhe dëshirën për t'u takuar edhe një herë me të kunatin dhe me motrën përpara se të nisej. «Po t'u shkoj në hotel, është rrezik se do të humbas trenin, — mendoi — më mirë po u shkruaj një letër». Kërkoi nga kamarieri që t'i sillte një letër, një zarf dhe një pullë dhe, duke pirë gllënkë pas gllënkë ujin e ftohtë me shkumë, nisi të mendohej se çfarë do t'u shkruante. Por mendimet i ngatërroheshin, i shpërndaheshin nga të katër anët dhe, pas ca kohe, ai kuptoi që nuk do t'ishte i zoti ta shkruante letrën.

«E dashur Natasha, nuk mund të nisem me përshtypjen e hidhur të bisedës së djeshme me Ignat Nikiforoviçin...» — nisi të shkruante. «Po tjetër ç't'i them? T'i kërkoj ndjesë për ato që i thashë dje? Atë që mendoja, ato i thashë! Ai do të mendojë që jam penduar dhe se e kam kuptuar edhe vetë gabimin. Po, fundja, kush ja ka fajin? Ç'i duhet atij të fusi hundët në punë që nuk i përkasin?... Jo, nuk mundem!» — dhe duke ndjerë që përsëri po i ndizej inati dhe po i ngjallej urrejtja kundër atij njeriu mëndjemadh që nuk arrinte apo, ndofta, nuk deshte ta kuptonte, Nekludovi e futi në xhep letrën të pa përfunduar, thirri kamarierin që të paguante, pagoi, doli jashtë dhe u nis me karrocë që t'arrinte kolonën.

Vapa qe bërë akoma edhe më e padurueshme. Dukej sikur muret e gurët vezullonin zjarr. Kalldrëmi i rrugës, kur e prekje me këmbë, të përvëlonte dhe Nekludovi, kur

vuri dorën rastësisht mbi parafangon me vernik të karrocës pati përshtypjen se e dogji.

Kali ja kishte marrë një trokthi të plogësht duke trokitur me monotoni potkonjtë mbi kalldrëmin e çrregullt e me pluhur të rrugës; karrocieri dremiste tërë kohën, kurse Nekludovi rrinte, me kokën e zbrazur, pa mendime, dhe hidhte përpara një vështrim të vdekur. Në një kthesë të rrugës, përkundrejt derës së një godine të lartë, qendronte një tufë njerëzish dhe një ushtar me pushkë, nga ata që shoqëronin kolonën. Nekludovi i tha karrocierit të ndalej.

— Ç'ka ngjarë? — e pyeti portierin e shtëpisë.

— Se çfarë i ka ndodhur një të burgosuri.

Nekludovi zbriti nga karroca dhe iu afrua turmës. Mbi gurët e ashpër të trotuarit, me kokën më poshtë nga këmbët, qe shtrirë një i burgosur shpatullgjërë, i shkuar nga mosha, me një mjekër të kuqërreme, i kuq nga fytyra, me një hundë të shtypur, me një setër të murme e me një palë pantallona po n'atë ngjyrë. Ai qe shtrirë mbi kurriz, me krahët hapur nga të dy anët, me pëllëmbët e duarve mbuluar me quka kthyer përmbys, dhe, kohë pas kohe, ngrinte kraharorin e madh e të fuqishëm e rënkonte duke vështruar qiellin me sytë e zgurdulluar, të palëvizur, si të spërkatur me gjak. Mbi të qenë kërrusur një polic me fytyrë të vrenjtur, një shitës ambulant, një postjer, një dyqanxhi, një grua plakë me ombrellë dhe një çunak kokë toç, me një kanistër bosh.

— Janë dobësuar kaq kohë në burg e tani i nxjerrin jashtë me këtë diell! — tha dyqanxhiu, sikur po i shkrehej dikujt, duke u kthyer nga Nekludovi.

— Me sa duket, nuk e paska të gjatë! — tha me një zë sikur qante gruaja me ombrellë.

— Duhet t'ja zbërthejmë këmishën, — tha portjeri.

Polici nisi të zgjidhte, ndërsa i dridhej dora, lidhësen e jakës që i shtrëngonte fytin e kuq me damarë të të burgosurit. Ndonëse dukej i tronditur e i turbulluar, ai e pa të nevojëshme t'i drejtohej turmës.

— Ç'jeni mbledhur kështu? Largohuni, mos ja zini frymën!

— Duhet që doktori t'i kishte parë që në fillim, sa pa u nisur, dhe ata të dobëtit të mos i kishin ngritur. E jo t'i mundojnë ca si ky, që janë me shpirt ndër dhëmbë! — tha dyqanxhiu që kuptohej se deshte të shiste mënd, duke tregguar se i njihte mirë rregullat.

Polici, si e zgjidhi lidhësen e këmishës, i dha trupit përpjetë dhe u pa rreth e rrotull.

— Shpërndahuni, ju them. S'është puna juaj! Apo s'keni parë kurrë ndonjë njeri të sëmurë? — tha ai duke u drejtuar nga Nekludovi duke menduar se ky do të pajtohej me mendimin e tij; por, duke mos e gjetur në vështrimin e tij pajtimin e shpresuar, i ktheu sytë nga ushtari.

Po ushtari qe hequr mënjanë dhe po kqyrte me vëmëndje takunin e këpucës që po i binte, me një shprehje në fytyrë që e tregonte krejt indiferent ndaj vështirësive të cilat po haste atë çast polici.

— Ata që e kanë për detyrë, ata s'e çajnë kokën. Po pse, rregull është ky që t'i vdesin njerëzit?

— I burgosur është vërtet, po prapë është njeri, — pëshpëritej në turmë.

— Ngrijani më lart kokën dhe i jepni të pijë ujë, — tha Nekludovi.

— Për ujë kemi dërguar, — u përgjegj polici dhe, si e kapi të burgosurin nga sqetullat, ja ngriti disi kraharorin më lart.

— Ç'është tërë ky kallaballëk? — u dëgjua befas një zë i vendosur, autoritar, dhe turmës që ishte grumbulluar rrotull të burgosurit iu afrua me hapa të shpejta një komisar policie, me një uniformë jashtëzakonisht të pastër e të shëndritëshme, e me një palë çizme me qafa të larta, që ishin edhe më të shëndritëshme akoma se uniforma. — Shpërndahuni, hajt! Shikoni punën tuaj! — iu shkreh turmës, pa e marrë vesh akoma përse qe mbledhur.

Kur u afrua dhe pa të burgosurin që po vdiste, bëri një shenjë me kokë, sikur ta kish parashikuar atë që kish ndodhur dhe, duke iu drejtuar policit, e pyeti:

— Si kështu?

Polici i raportoi si kish qenë puna duke i treguar se i burgosuri bënte pjesë në kolonën që kish kaluar pak më parë.

— E ç'e mbani këtu? Shpjereni në postkomandë. Një karrocë!

— Tani porsa shkoi portjeri i shtëpisë këtu, — tha polici duke ngritur dorën në strehën e kapeles.

Dyqanxhiu diç nisi të thonte për vapën.

— Po ti, ç'hyn në këtë punë? Ty kush të pyeti, ë? Ti shiko punën tënde e hajt, shporru që këndej! — iu shkreh komisari e i hodhi një vështrim kaq të rreptë, saqë ai, dashur pa dashur, heshti e s'u ndie më.

— Duhet t'i jepni të pijë pak ujë, — tha Nekludovi.

Komisari e vështroi me të rreptë edhe Nekludovin, por nuk foli. Kur portjeri solli një shtamë me ujë, ai e urdhëroi policin që t'ja jepte të burgosurit. Polici i ngriti kokën që lëkundej dhe u mundua t'ja hidhte ujët në gojë, por i burgosuri nuk e shkonte dot poshtë; uji u derdh nëpër mjekër duke njomur bluzën dhe këmishën e ashpër e të pluhurosur.

— Hidhja në kokë! — urdhëroi komisari, dhe polici, si i hoqi shapkën e sheshtë, ja derdhi ujin mbi flokët e kuqërremë, si dhe në pjesën e rruar të kafkës.

Syt' e të burgosurit u çakërritën edhe më, si me tmerr, por gjendja e tij nuk ndryshoi. Fytyrës i rridhnin çurga uji të ndyrë me pluhur, por goja e tij nxirrte vazhdimisht një rënkim, ndërsa trupi vazhdonte t'i dridhej i tëri.

— Ja një karrocë! Shpejt, shko e sille këtu! — iu drejtua komisari policit, duke i treguar me dorë karrocën që kish zënë me qira Nekludovi. — Ej, ti! Afrohu!

— Jam zënë, — u përgjegj karrocieri i zymtë, pa i ngritur fare sytë.

— Është karroca ime, — ndërhyri Nekludovi, — por mund ta merrni. Do të të paguaj, — shtoi, duke u drejtuar nga karrocieri.

— Hë, pse rrini me duar kryq? — thirri komisari. — Kapeni!

Polici, portjeri dhe ushtari e ngritën të burgosurin, e shpunë në karrocë dhe e vunë ndenjur mbi kolltuk. Por ai nuk mund të mbahej dot vetë: koka i varej nga pas dhe trupi i shkiste nga kolltuku.

— Vure shtrirë! — komandoi komisari.

— S'prish punë, fisnikëria juaj, se dhe kështu mund ta shpiem, — tha polici duke zënë vend mirë pranë të burgosurit që po jepte shpirt e duke i vënë krahun e tij të fortë nën sqetull.

Ushtari i ngriti këmbët me këpucë, por pa peca, ja shtriu dhe ja mbështeti në pjesën e përparme të karrocës.

Komisari ktheu kokën rreth e rrotull e, si vuri re në rrugë shapkën e sheshtë të të burgosurit, e ngriti dhe ja ngjeshi atij nga pas mbi kokën e lagur.

— Marsh! — komandoi.

Karrocieri ktheu sytë nga pas me të rreptë, tundi kokën dhe, i shoqëruar nga ushtari që ecte në këmbë, u kthye duke e ngarë kalin në hap tek një postkomandë policie që ndodhej aty afër. Polici, që kish zënë vend pranë të bur-

gosurit, e tërhiqte or'e çast trupin e tij që shkiste poshtë dhe mundohej t'i mbante drejt kokën që lëkundej nga të tëra anët. Ushtari i ndreqte hera herës këmbët. Nekludovi i ndiqte pas.

XXXVII

Si arriti në postkomandën e policisë ku bënte roje një zjarrfikës, karroca me të burgosurin hyri në oborr dhe u ndal përpara derës së infermerisë.

Disa zjarrfiksa të tjerë në oborr kishin përveshur mëngët dhe po lanin disa karro, duke biseduar e duke qeshur sakaq me të madhe.

Menjëherë porsa karroca ndaloi, disa policë u afruan me të shpejtë, e rrethuan, e kapën nga sqetullat e nga këmbët trupin e ngrirë të të burgosurit dhe e hoqën nga karroca.

Polici, që e kishte shoqëruar të burgosurin, zbriti edhe ai nga karroca dhe, si e shkundi nja dy herë krahun që i qe mpirë, hoqi kapelen e bëri kryqin. Të vdekurin e futën brënda dhe e ngjitën nëpër një shkallë. Nekludovi u shkoi nga pas.

Në dhomën e vogël e të ndytë ku e shpunë të vdekurin, ndodheshin katër shtretër. Në dy prej tyre rrinin ndenjur dy të sëmurë me pizhama, njeri me gojë të shtrëmbër e me qafë të lidhur, tjetri i veremosur. Dy shtretërit e tjerë qenë bosh. Të burgosurin e shtrinë mbi njerin prej tyre. Një burr'i vogël, një pëllëmbë përmbi dhe, me ca sy të shëndritshëm e me një palë vetulla që i lëviznin parreshtur, pothuajse fare lakuriq, në brek'e në çarape, iu afrua të burgosurit me hapa të lehta, e vështroi, i ngriti pastaj sytë nga Nekludovi dhe ja shkrepi gazit. Ky ishte një i marrë që mbahej përkohësisht nën vrejtje në postkomandën e policisë.

— Duan të më trembin, — tha. — Po, ama, s'kanë për t'ja dalë dot në krye.

Fill pas policëve që suallën të vdekurin, hynë në dhomë gjithashtu komisari dhe ndihmës-mjeku.

Ndihmës-mjeku, si iu afrua të vdekurit, preku dorën e tij të zverdhëlleme, të mbuluar me quka, akoma të butë, por që tanimë kish ngrirë. Pastaj e lëshoi dhe ajo ra si një copë dru mbi barkun e të vdekurit.

— Ky i lau hesapet, — tha ndihmës-mjeku duke tundur kokën por, me sa duket, duke dashur të vepronte sipas rregullave, e zbërtheu këmishën e ashpër e të lagur të kufomës dhe, si zbuloi veshin nga flokët kaçurrel që ja mbulonin, e ngjeshi atë pas kraharorit të zverdhëllemë, të ngrirë e të kërcyer të të burgosurit. Asnjeri nuk fliste. Ndihmës-mjeku u ngrit, tundi përsëri kokën dhe i mbylli me gisht qepallat mbi kokërdhokët e syve të çakarritur e të kaltëryer të të vdekurit.

— Nuk më trëmbni dot, jo, nuk më trëmbni dot, — thoshte i marri, duke pështyrë gjatë tërë kohës në drejtim të ndihmës-mjekut.

— E po? — pyeti komisari.

— E po? — përsëriti ndihmës-mjeku. — Duhet shpurë në dhomën e përmortëshme.

— Jeni i sigurt? — pyeti komisari.

— Ashtu them, — tha ndihmës-mjeku që, kushedi përse, ja mbërtheu përsëri këmishën të vdekurit. — Sidoqoftë, le të vijë ta shohë një herë edhe Matvej Ivaniçi. Petrov, shko e thirre! — tha ndihmës-mjeku e u hoq mënjanë.

— Shpjereni në dhomën e përmortëshme! — i urdhëroi policit komisari. — Ti pastaj do të vish në sekretari që të përpilojmë proçesverbalin, — shtoi duke u drejtuar nga ushtari i cili nuk ndahej nga i burgosuri.

— Si urdhëron! — u përgjegj ushtari.

Policët e ngritën të vdekurin dhe e zbritën përsëri poshtë nëpër shkallë. Nekludovi deshi të shkonte pas tyre, por i marri e ndaloi.

— Ti nuk je me këta, apo jo? Ahere, hë, nëm një cigare. I marri, duke lëvizur shpejt e shpejt vetullat, nisi të tregonte me një frymë se si po e mundonin prej kohësh me gjithfarë frikësimesh.

— Ata janë të gjithë kundra meje, dhe më mundojnë nat'e ditë me anë të mediumeve...

— Mua do të më falni, — tha Nekludovi dhe, pa ja vënë veshin, doli jashtë në oborr për të marrë vesh se ku do ta shpinin të vdekurin.

Policët, bashkë me ngarkesën e tyre, kishin përshkuar ndërkaq oborrin dhe po zbritnin në një bodrum. Nekludovi u mat t'u afrohej, por komisari e ndaloi.

— Po ju, çfarë doni?

— Unë? Asgjë! — u përgjegj Nekludovi.

— Kur s'doni asgjë, ahere largohuni.

Nekludovi u bind dhe shkoi tek karroca që po e priste. Karrocieri ja kish marrë gjumit. Nekludovi e zgjoi dhe i tha të nisej përsëri për nga stacioni.

S'kishin bërë as njëqind hapa, kur u ndeshën përsëri me një qerre që shoqërohej nga një ushtar me pushkë, mbi të cilën qe shtrirë një i burgosur i cili, me sa dukej, kishte vdekur. I burgosuri qe shtrirë mbi kurriz dhe koka e tij e rruar me shapkën e sheshtë, që i kishte shqitur përmbi hundë, si edhe mjekra e zezë, tundej e shkundej në çdo të lëkundur të qerres. I zoti i qerres, me ca çizme të rënda, e ngiste kalin duke i ecur pranë. Pas tyre vinte një polic. Nekludovi e preku karrocierin në sup duke i bërë shenjë që të ndalej.

— Shiko se ç'bëhet! — tha karrocieri duke e ndalur kalin.

Nekludovi i zbriti karrocës dhe iu qep pas qerres duke hyrë përsëri bashkë me të në postkomandën e policisë. Zjarrfikësit e kishin përfunduar tani larjen e qerreve dhe nuk ndodheshin më n'oborr. Në vend të tyre Nekludovi vuri re një major të policisë, të hollë, të gjatë, kockë e lëkurë, me një rreth të kaltërt në berretë, i cili i kishte futur duart në xhep dhe vështronte me të rreptë një mëz me një qafë si të vrarë, që e shetiste posht'e lart përpara tij një zjarrfikës. Mëzi çalonte nga këmb'e parë dhe majori diç po i thoshte me të rreptë veterinerit.

Ndodhej atje dhe komisari. Ai e pa të vdekurin dhe iu afrua.

— Po ky, ku vdiq? — pyeti ai duke tundur kokën i bezdisur.

— Në Staroj Gorbatovskoj — u përgjegj polici.

— Ç'është, i burgosur? — pyeti majori.

— Po, si urdhëron.

— Me këtë, sot bëhen dy, — tha komisari.

— Shumë në rregull i kanë punët! Po, fundja, s'kanë faj, me këtë vapë që bën. . . — tha majori dhe, duke u kthyer nga zjarrfikësi që tërhiqte nga frëri mëzin e çalë, thirri: — Shpjere n'atë shtallën atje në qoshe! Do të ta tregoj unë, qen bir qeni, se si t'i sakatosh herë tjetër këta kuaj që vlejnë njëmijë herë më tepër nga ty!

Të vdekurin e zbritën nga qerrja dhe e shpunë përsëri n'atë dhomën e vogël ku kishin shpurë dhe atë tjetrin më parë. Nekludovi i ndiqte nga pas policët si i hipnotizuar.

— Po ju? — e pyeti një polic.

Ai nuk u përgjegj, por vazhdoi të ecte pas të vdekurit. I marri kish hypur majë shtratit dhe pinte me duf cigaren që i kishte dhënë Nekludovi.

— Aha, u kthyet! — tha ai dhe ja shkrepi gazit. Kur pa të vdekurin u vrënjt. — Prapë, ë? — tha. — Më mërzitën! E ç'kujtojnë këta, se mos jam ndonjë çilimi që të trëmbem? Unë nuk jam çilimi, apo jo? — tha e u kthye nga Nekludovi duke i buzëqeshur.

Nekludovi, ndërkaq, vështronte të vdekurin fytyra e të cilit tani dukej fare mirë sepse ja kishin hequr shapkën që e mbulonte gjer ahere. Aq sa i shëmtuar kish qenë ai tjetri, po aq i bukur ishte ky, si nga fytyra ashtu dhe nga trupi. Ishte një djalosh në lulen e rinisë. Ndonëse koka e tij dukej si e sakatosur nga ajo e rruara përmes që i kishin bërë, balli jo dhe aq i lartë, por i rrëpirë e i ngritur përmbi sytë e zez, tanimë pa jetë, ishte shumë i bukur, po ashtu dhe hunda e vogël krrute që ngrihej mbi fijet e mustaqeve të holla e të zeza. Mbi buzët e mavijosura qe ravizuar një buzëqeshje e lehtë; mjekra e shkurtër e rrethonte pjesën e poshtëme të fytyrës si një kurorë dhe, mbi pjesën e rruar të kafkës, dukej një vesh i rregullt, i hijëshëm. Fytyra kishte në të njëjtën kohë një shprehje qetësie, rreptësie e mirësie të thellë. Duke lënë mënjanë mundësirat për një jetë të lartë shpirtërore që viheshin në dukje shkoqur nga tiparet e rregullta të fytyrës, eshtrat e holla të duarve e të këmbëve në pranga, muskujt e fuqishëm, të shpërndarë në mënyrë të harmonishme në të gjitha pjesët e trupit, flitnin kjartë se çfarë kafshe e mrekullueshme njerëzore kish humbur bashkë me atë njeri, çfarë kafshe e fuqishme, e shkathët, shumë më e përsosur në llojin e saj se sa ai mëzi i çalë për të cilin qe nxehur majori, kish shkuar dëm nga një pakujdesi që mund të evitohej. Por këtë kafshë e kishin vrarë dhe asnjeriut s'i kishte ardhur keq për të, jo vetëm si njeri, por as edhe si një kafshë pune që kishte humbur kot. Vdekja e tij ngjallte tek njerëzit vetëm një ndjenjë mërzie për të gjitha ato mundime që paraqiste zhdukja e kufomës që kish filluar të shkatërrohej.

Në dhomë hynë pas pak mjeku, ndihmës-mjeku dhe komisari i policisë. Mjeku ishte një burrë i shkurtër e i trashë me një bluzë të gjatë prej mëndafshi, me një palë pantallona edhe këto prej mëndafshi, dhe kaq të ngushta sa i rrinin të ngjitura pas këmbëve. Komisari qe dhe ky një burr'i shkurtër e i trashë me një fytyrë të rrumbullakët

e të kuqe, e cila bëhej akoma më e rrumbullakët nga zakoni që kishte t'i frynte bulçitë me ajër e t'i çfrynte pastaj dalngadalë. Mjeku u ul buzë krevatit ku qe shtrirë i vdekuri dhe, po ashtu si ndihmës-mjeku, i preku duart, i vuri veshin tek zemra e u çua në këmbë duke ngritur pantallonat.

— Më i vdekur se kështu, s'ka si bëhet, — tha.

Komisari e mbushi gojën me ajër e nisi pastaj ta nxjerrë pak nga pak.

— Nga ç'burg është? — pyeti ai duke iu drejtuar ushtarit.

Ushtari u përgjegj dhe tregoi me kokë hekurat që shtrëngonin këmbët e të vdekurit.

— Do të jap urdhër t'ja heqin; shyqyr zotit, kovaçët nuk na mungojnë, — tha komisari dhe, si i fryu përsëri bulçitë duke i çfryrë ato dalngadalë, u largua.

— Pse kështu? — e pyeti Nekludovi mjekun.

Mjeku e vështroi ngultas përmes syzave.

— Si përse kështu? Pse vdesin nga dielli doni të thoni? Po është e natyrëshme, sepse duke qendruar pa lëvizur dhe pa dritë gjatë tërë dimrit kur dalin menjëherë në diell, në një ditë si kjo sot, kur pëlcet edhe derri nga vapa, dhe pastaj ashtu të gjithë grumbull, ngjeshur njeri pas tjetrit sa që ajri s'ka nga të qarkullojë, është e natyrëshme, siç ju thashë, që ndonjeri ta pësojë.

— Atëhere, pse i nisin kështu?

— Ata e dinë. Po, a s'më thoni, ju kush jeni?

— Unë jam një i jashtëm.

— A-a!... Nderimet e mia, atëhere, mua më falni! — tha mjeku dhe, duke i shkundur pantallonat me inat që t'i rrinin të derdhura, u drejtua nga shtretërit e të sëmurëve.

— Hë, ti, si i ke punët? — i tha atij të sëmurit të zbetë, me gojë të shtrëmbër e me qafë të lidhur.

I marri, ndërkaq, kish hypur mbi shtratin e tij, e kish fikur cigaren dhe këpuste tani ca të pështyra në drejtim të mjekut.

Nekludovi zbriti poshtë n'oborr dhe, duke kaluar përmes kuajve, pulave dhe rojes me kaskë në kokë, doli në rrugë, e zgjoi karrocierin që kishte rënë përsëri në gjumë dhe u nis për nga stacioni i trenit.

XXXVIII

Kur Nekludovi arriti në stacion, të burgosurit kishin hyrë me kohë në vagonat e tyre me rrjeta të hekurta në dritaret. Disa njerëz që kishin ardhur për të përciellur të burgosurit, qëndronin në platformë nga që nuk i linin t'u afroheshin vagonave. Ushtarët dhe nënoficerët të ngarkuar me mbikqyrjen e kolonës, dukeshin shumë të zënë me punë dhe si të hutuar. Gjatë rrugës nga burgu në stacion, përveç atyre dy të burgosurve që kishte parë Nekludovi, kishin vdekur nga dielli edhe tre të tjerë: njerin e kishin shpurë, si edhe ata dy më parë, në një postkomandë policie, kurse dy të tjerët kishin vdekur me të arritur në stacion [1]). Por në se mbikqyrësit e kolonës dukeshin të shqetësuar, kjo nuk rridhte nga që në kolonën e tyre kishin vdekur pesë njerëz që mund të ishin akoma gjallë. Ata për këtë nuk bëheshin aspak merak, po bëheshin shumë merak përkundrazi se si t'i kryenin sa më shpejt të gjitha formalitetet që kërkoheshin në të tilla raste: t'i dorëzonin të vdekurit atje ku duheshin dorëzuar bashkë me plaçkat e me dokumentat përkatëse, duke i fshirë emrat e tyre nga listat e të burgosurve që do të dorëzoheshin në Nizhni. Dhe kjo, me tërë atë vapë që po bënte, nuk ishte një punë edhe aq e lehtë.

Ja, pra, me këtë punë po merreshin ushtarët dhe nënoficerët e kolonës dhe prandaj, gjersa të mbaronin, nuk e lejuan Nekludovin, dhe as të tjerët, që iu lutën, t'u afroheshin vagonave. Por, megjithatë, Nekludovin më në fund e lejuan, se ky diç i dha nën dorë një nënoficeri, i cili iu lut vetëm të mbaronte punë sa më shpejt, sa pa kaluar aty ndonjë epror. Vagonat qenë gjithë-gjithë ndonja tetëmbëdhjetë dhe, që të gjithë, përveç vagonit ku pritej të zinin vend autoritetet, qenë plot e përplot me të burgosur. Duke kaluar pranë dritareve të vagonave, Nekludovi vinte veshin e dëgjonte. Në të gjitha vagonat tringëllima prangash, biseda gjithfarësh e fjalë të ndyta, po asnjeri nuk fliste, ashtu siç kishte menduar Nekludovi, për shokët që kishin vdekur rrugës. Përmëndeshin or'e çast fjalët «ujë», «trastë» dhe «vend». Duke hedhur sytë në dritaren e një vagoni, Nekludovi vuri re në mes, në koridor, disa ushtarë që po u hiqnin të bur-

1) Në fillim të vitit 1880, nga që u pat rënë dielli në kokë, vdiqën në një ditë pesë të burgosur të cilët bënin pjesë në një kolonë që nisej nga fortesa e Bertirit për në stacionin e Nizhni-Novgorod (shën. i autorit).

gosurve prangat nga duart. Të burgosurit shtrinin krahët dhe një ushtar hapte me një çelës drynat e prangave dhe ua hiqte. Pas tij, vinte një ushtar tjetër që i mblidhte prangat. Si i kaloi të gjitha vagonat e burrave, Nekludovi iu afrua atyre të grave. Tek vagoni i dytë dëgjoi një zë të ngjirur gruaje që rënkonte dhe përsëriste or'e çast, me një rithëm të caktuar, po ato fjalë: «O-o-o! **batjushka, o-o-o natjushka!**».

Nekludovi u largua dhe vazhdoi rrugën më tej gjersa arriti tek vagoni i tretë ku, sipas udhëzimeve që i kishte dhënë nënoficeri, shpresonte të gjente Masllovën. Porsa e afroi kokën tek dritarja, ai ndjeu një afsh të nxehtë trazuar me një erë të fortë djerse, që i ra mbi fytyrë, dhe dëgjoi disa piskama grash. Gratë kishin zënë vend që të gjitha nëpër frone, me fytyra të dirsura, të skuqura dhe bisedonin me zë të lartë. Fytyra e Nekludovit, që spikati atë çast pas hekurave të dritares, ua tërhoqi menjëherë vëmëndjen. Ato që ndodheshin më afër heshtën dhe lëvizën për nga ajo anë. Masllova, që e kishte hequr setrën dhe shaminë nga vapa, qe ulur pranë dritares që ndodhej për karshi. Pranë saj qe ulur Fedosia e qeshur dhe lëkurëbardhë. Kur e vuri re Nekludovin, ajo i ra Masllovës me bërryl duke i treguar me dorë dritaren. Masllova u ngrit me të shpejt, hodhi mbi flokët e zez shaminë dhe, me një fytyrë të qeshur, të dirsur e të skuqur, iu afrua dritares dhe u kap pas hekurave.

— Ama vapë! — tha ajo duke buzëqeshur e gëzuar.

— I muarrët plaçkat?

— I mora, faleminderit.

— Mos kini nevojë për ndonjë gjë? — pyeti Nekludovi duke ndjerë një afsh përvëlonjës që depërtonte nga vagoni.

— Jo, s'kam nevojë për asgjë, faleminderit.

— Të kishim pak ujë, nuk do të qe keq, — tha Fedosia.

— Pse, nuk kini ujë?

— Na suallën, po u mbarua.

— Atëhere, po u them t'u sjellin përsëri. Gjer në Nizhnij tani nuk shihemi më.

— Po pse, edhe ju do të vini? — e pyeti Masllova, sikur të mos e dinte, duke i hedhur sytë Nekludovit e gëzuar.

— Do të nisem me trenin tjetër.

Masllova kësaj radhe nuk foli fare, por vetëm psherëtiti.


Ж.Д

— Nuk na thoni, barin, a është e vërtetë një fjalë që është hapur se sot paskan vdekur dymbëdhjetë të burgosur? — tha me një zë të vrazhdë mashkulli një e burgosur, një grua plakë me fytyrë të rreptë.

Kjo ishte Korableva.

— Nuk e di a kanë qenë dymbëdhjetë. Po dy i pashë vetë, — tha Nekludovi.

— Po ja, kështu thonë, dymbëdhjetë. E po qysh s'u bëjnë gjë këtyre të mallëkuarve që marrin në qafë dynjanë e i vdesin njerëzit rrugës?

— Po nga gratë, ka ndonjë të sëmurë? — pyeti Nekludovi.

— Gratë s'duan t'ja dinë, janë më të forta nga burrat! — tha me të qeshur një e burgosur tjetër, një grua e paktë nga trupi dhe e shkurtër. — Po ja, njerës iu tek që të lindë. E gjeti kohën! Apo s'ka vënë një pikë ulërime që të shurdhon fare, për zotin e vërtetë! — tha ajo duke treguar me kokë vagonin e dytë që nga vinin ulërimat.

— Ju më pyetët a kisha nevojë për ndonjë gjë, — tha Masllova, ndërsa mundohej t'i përmbante buzët që buzëqeshnin vetvetiu nga gëzimi. — Ja, nuk mund t'u thoni ndonjë fjalë atyre që e kanë në dorë, të mos e nisin atë grua? Po vuan shumë, e shkreta...

— Do t'u them.

— Pastaj, edhe një gjë tjetër: a nuk bën të takohet kjo pak me Tarasin, me të shoqin ?— vazhdoi Masllova duke treguar me bisht të syrit Fedosjen. — Ju sikur do të udhëtoni bashkë, apo jo?

— Zotëri, është e ndaluar të bisedoni me të burgosurit, — u dëgjua atë çast zëri i një nënoficeri prej atyre që shoqëronin kolonën. Ky ishte një nënoficer tjetër, jo ai me të cilin Nekludovi qe marrë vesh.

Nekludovi u hoq mënjanë dhe pastaj filloi të hidhte sytë rreth e rrotull se mos shikonte përgjegjësin e kolonës që t'i thoshte për gruan shtatzanë dhe për Tarasin. Por përgjegjësi nuk dukej gjëkundi dhe nënoficerët dhe ushtarët që pyeti nuk i dhanë dot një përgjegje të saktë se ku ndodhej. Ata dukeshin shumë të zënë me punë dhe s'kishin nge të merreshin me të. Bile as që ndaleshin fare kur ai i pyeste. Disa shoqëronin të burgosur, ca të tjerë vrapoinin të blinin ushqime për rrugë, kush vendoste plaçkat nëpër vagona e kush i shërbente një dame që, me sa dukej, ishte e shoqja e ndonjë oficeri.

Nekludovi e takoi përgjegjësin e kolonës vetëm pas ziles së dytë, kur treni bëhej gati të nisej. Oficeri, duke fshirë me dorën e tij të shkurtër mustaqet që i mbulonin gojën, ngrinte or' e çast supet e diç po i thoshte një mvartësi të tij.

— Konkretisht, çfarë kërkoni nga unë? — e pyeti ai Nekludovin.

— Në tren është një grua që po lind, prandaj mendova se do të qe mirë që ta...

— Le të lindë një herë, pastaj shohim e bëjmë... — tha oficeri dhe, si i ktheu krahët Nekludovit, u drejtua për nga vagoni i tij, duke i tundur me gjallëri krahët e tij të shkurtër me një lëvizje ritmike.

Një konduktor kaloi atë kohë para Nekludovit me një bilbil në dorë; u dëgjua zilja e fundit, një fishkëllimë, dhe pastaj të qara e rënkime që vinin nga vagoni i grave dhe nga turma e njerëzve në platformë. Nekludovi qendronte bashkë me Tarasin në platformë dhe shikonte se si lëviznin përpara tij vagonat me rrjeta të hekurta, përmes së cilave dukej një çast, e pastaj zhdukej menjëherë, ndonjë kokë e rruar. Pastaj lëvizi, duke ardhur në një rrafsh me ta, edhe vagoni i parë i grave, pastaj i dyti e, më në fund, vagoni i tretë në të cilin ndodhej Masllova. Ajo rrinte bashkë me ca gra të tjera në dritare dhe e vështronte Nekludovin me një buzëqeshje të trishtuar.

XXXIX

Mbeteshin akoma edhe dy orë para se të mbërinte treni i pasagjerëve me të cilin Nekludovi do të nisej. Nekludovi kishte menduar në fillim që gjatë kësaj kohe të shkonte një vrap tek e motra, por tani, pas përshtypjeve që kishte patur atë mëngjes, e ndjente veten kaq të tronditur e të lodhur sa që, kur u ul pak që të shplodhej në një divan të klasit të parë, kuptoi befas se po i vinte gjumë; u kthye mbi njerin krah, mbështeti kokën mbi pëllëmbë dhe fjeti menjëherë.

E zgjoi një lakè me frak, me një pllakëzë në jakë dhe me një pecetë hedhur mbi sup.



— Zotëri, zotëri, mos jeni ju princi Nekludov? Është një zonjë që po ju kërkon.

Nekludovi u zgjua, fërkoi sytë dhe u mundua të kujtohej ku ndodhej.

Ju kujtuan: kolona e të burgosurve, të vdekurit, vagonat me hekura në dritare dhe gratë që ndodheshin aty, nga të cilat njera ulërinte nga dhëmbjet e lindjes dhe një tjetër e vështronte me një buzëqeshje të vrerosur që nga pas hekurave. Po, kur hapi sytë dhe i hodhi rreth e rrotull, pa të tjera gjëra: një tryezë mbushur me shishe, me vazo, me shandane, disa lakej të shkathët që lëviznin rrotull tryezës. Në thellësi të dhomës, pas vazove me fruta e me shishe, bufetjeri dhe kurrizet e udhëtarëve që kishin shkuar në bufe të blinin.

Në kohën që, duke qenë shtrirë, po ngrihej e po ulej mbi divan, Nekludovi vuri re se të gjithë ata që ndodheshin në dhomë kishin kthyer kokën nga dera dhe diç po shikonin me kureshtje. E ktheu edhe ai kokën nga ajo anë dhe pa një karvan njerëzish që mbanin në krah një damë shtrirë mbi kolltuk me një vello të lehtë që i mbështillte kokën. Nga mbartësit, ai në krye ishte një lakè që Nekludovit iu duk si një fytyrë e njohur. Gjithashtu i njohur iu duk Nekludovit edhe ai i pasmi, një portier me një kapele të stolisur me shirita. Nga mbrapa kolltukut ecte një shërbyese elegante me përparëse dhe me flokë kaçurrel e cila mbante në duar një bohçe, një send tjetër të rrumbullakët me këllëf lëkure si edhe disa ombrella për diell. Fill pas saj, vinte princi Korçaguin, me atë qafën e tij prej apoplektiku, me buzët e trasha që i rrinin varur, me krahërorin e fryrë dhe me një kapele turisti në kokë. Akoma më mbrapa ishin Missi, Misha, kushëriri i parë i Missit si edhe dipllomati Osten, një burrë me një qafë të gjatë, me fikthin e gërmazit të kërcyer, gjithëmonë i qeshur dhe gazmor, të cilin Nekludovi e njihte mirë. Ai ecte për krah Missit dhe po i tregonte diçka për të qeshur. Në fund fare vinte doktori me një cigare në gojë dhe me një çehre shumë të ngrysur.

Korçaguinët ktheheshin nga çifligu i tyre në periferi të Moskës dhe shkonin në çifligun e të motrës së princeshës, n'afërsi të Nizhni Novgorodit.

Vargani i përbërë nga lakejt që e mbanin princeshën në krahë, nga shërbyesja dhe nga doktori, u drejtua për nga dhoma e damave duke ngjallur tek të pranishmit një kureshtje të madhe dhe një respekt të thellë. Princi plak u

ndal në gjysmë të rrugës përpara një tryeze, i bëri zë lakejt ame diç e porositi. Missi me Ostenin u ndalën edhe ata atje dhe po matesh.n të uleshin, kur panë një grua të njohur që po kapërxente atë çast prakun e derës. Kjo grua e njohur ishte Natalia Ivanovna. Natalia Ivanovna, e shoqëruar nga Agrafena Petrovna, hyri në sallë duke hedhur sytë rreth e rrotull. Ajo vuri re pothuajse në të njëjtën kohë si të vëllanë, ashtu edhe Missin. Në fillim iu afrua Missit duke e përshëndetur Nekludovin vetëm me kokë; por, si u puth me Missin, u drejtua menjëherë nga ai.

— Të gjeta më në fund! — tha.

Nekludovi u ngrit në këmbë, u përshëndet me Missin, me Mishën dhe me Ostenin dhe qendroi në mes të tyre duke biseduar. Missi i toli për shtëpinë në fshat që i ishte djegur duke i detyruar të kalonin verën tek tetua. Osteni përfitoi nga rasti për të treguar një anekdotë në lidhje me zjarrin.

Nekludovi, pa ja vënë veshin Ostenit, u drejtua nga e motra.

— Sa mirë bëre që erdhe! — i tha.

— Unë kam ardhur qëkur, — tha ajo. — Jam bashkë me Agrafena Petrovnën. — Ajo ktheu kokën nga Agrafena Petrovna me kapele e me një **Waterproof** e cila, duke u përulur, e përshëndeti princin së largu si e turbulluar e me një buzëqeshje të përmbajtur, por nuk u afrua, duke mos dashur të përzihej n'atë bisedë intime ndërmjet vëllait e motrës. — S'kemi lënë vend pa të kërkuar.

— Më kishte zënë gjumi këtu. S'mund ta marrësh me mënd sa mirë ke bërë që ke ardhur, — tha edhe një herë Nekludovi. — Kisha filluar të të shkruanja një letër, — shtoi.

— Vërtet? — tha ajo si e trëmbur. — Po përse?

Missi dhe kavalierët e saj, duke parë që vëlla e motër po fillonin një bisedë intime, u hoqën mënjanë. Ndërkaq, Nekludovi me Natashën u ulën në një divan shtruar me kadife pranë dritares, ku qenë lënë ca plaçka, një **plaid**, e disa kutija prej kartoni.

— Dje mbrëma, kur dola nga ju, desha të kthehem që t'ju kërkoja ndjesë, po nuk e dija se si do të ma merrte ai, — tha Nekludovi. — Fola pak ashpër me burrin tënd dhe isha i shqetësuar.

— Unë e dija, unë isha e sigurt, — tha e motra — që ti nuk deshe, po të shpëtoi. Sepse ti e di që...

Sytë iu mbushën me lot dhe ajo u lëshua në krahët e tij. Kjo frazë nuk ishte dhe aq e qartë, por ai e kuptoi fare mirë. Me ato fjalë ajo donte të thoshte që, përveç dashurisë për burrin, pas të cilit qe e dhënur me mish e me shpirt, për të qe shumë e shtrenjtë dhe shumë e rëndësishme edhe dashuria për të vëllanë, dhe se prandaj ajo nuk mund ta ndjente veten kurrë të lumtur, po të mos shkonte mirë me të.

— Të falemnderit, të falemnderit shumë... Ah, sikur ta dish se çfarë kam parë sot! — tha ai duke sjellur ndërmënd. befas, fytyrën e të vdekurit të dytë që kish parë atë ditë. — I vranë dy të burgosur!

— Si i vranë?

— Ja ashtu, i vranë. I nisën me këtë vapë. Dhe nja dyve u ra dielli në kokë dhe vdiqën.

— Nuk është e mundur! Si? sot? tashti?

— Po, tashti. Pashë kufomat e tyre.

— Po përse i vranë? Kush i vrau? — tha Natalia Ivanovna.

— I vranë ata që i detyruan të niseshin, — tha i nxehur Nekludovi duke ndjerë se ajo po e shikonte edhe këtë çështje me sytë e të shoqit.

— Ah, zot i madh! — tha Agrafena Petrovna që u afrua që t'i dëgjonte më mirë.

— Ne as që kemi ide se ç'u punojnë këtyre të mjerëve. Po kështu nuk bën! — tha Nekludovi duke kthyer kokën nga princi plak, i cili kishte lidhur një pecetë në qafë dhe qe shtruar përpara një gote me birrë e po gëlltiste ca mezera. Pikërisht atë çast, e ktheu edhe ai kokën nga Nekludovi.

— Nekludov! — thirri — a nuk vjen edhe ti këtu të freskohesh? E di sa mirë bën për rrugë?

Nekludovi nuk pranoi dhe i ktheu krahët.

— Mirë, po ti ç'do të bësh? — vazhdoi Natalia Ivanovna.

— Atë që të mundem. Nuk e di, por e ndjej se diç duhet të bëj.

— Po, po e marr vesh. Po me këta... — tha ajo me një buzëqeshje duke treguar me sy Korçaguinin, — vërtet e prishe?

— Po, e prisha dhe, sipas mendimit tim, pa ndonjë keqardhje nga të dy palët.

— Gjynah! Mua më vjen keq. Unë kam simpathi për atë vajzë. Po, fundja, le të themi se është kështu si thua ti. Po

me atë tjetrën, pse do të lidhesh? — shtoi ajo me ndroje. — Përse po nisesh?

— Po nisem se duhet të nisem, — i ra shkurt Nekludovi, sikur ajo bisedë e bezdiste, dhe deshte ta mbyllte sa më parë.

Por menjëherë u pendua që sillej aq ftohtë me motrën. «Përse të mos ja them të gjitha ç'mendoj? — tha me vete. — Fundja, le t'i dëgjojë edhe Agrafena Petrovna» — i tha përsëri vetes duke kthyer koken nga guvernantja plakë. Prania e Agrafena Petrovnës sikur qe për të një nxitje më tepër për ta vënë në dijeni të motrën mbi vendimin e tij.

— Ti e ke fjalën për martesën time me Katjushën? Unë, në të vërtetë, kisha vendosur të martohesha me të dhe ja thashë, mirëpo ajo ma preu, më tha se nuk pranonte n'asnjë mënyrë, — tha ai, dhe zëri iu drodh, ashtu siç i dridhej gjithmonë sa herë që e zinte në gojë këtë. — Dhe ja, prandaj po i shkoj pas, në mënyrë që ku të jetë ajo të jem edhe unë e të bëj çmos që ta ndihmoj, që t'ja lehtësoj sadopak vuajtjet.

Natalia Ivanovna nuk e hapi më gojën. Agrafena Petrovna i hodhi Natalia Ivanovnës një vështrim pyetës dhe tundi kokën. Atë çast u duk përsëri ai karvani i mëparshëm duke dalë nga dhomat e damave. Princeshën e mbanin në krah edhe këtë radhë bukuroshi Filip dhe portieri. Po ajo u dha urdhër mbartësve të saj që të ndaleshin, i bëri një shenjë me dorë Nekludovit që të afrohej dhe, duke psherëtirë si e brengosur thellë, i zgjati dorën e bardhë, të hollë, me unaza, sikur të kishte frikë se mos ja shtrëngonte shumë.

— Epouvantable![1] — tha ajo për vapën. — Unë këtë nuk mund ta duroj. Ce climat me tue[2]. — Dhe, si foli një copë herë për tmeret e klimës ruse dhe si e ftoi Nekludovin t'u bënte një vizitë, ajo u bëri shenjë shërbetorëve që të nisheshin. — Ejani pa tjetër, — shtoi duke kthyer n'udhë e sipër fytyrën e saj të hollë nga Nekludovi.

Nekludovi doli në platformë. Karvani i princeshës u drejtua më të djathtë, për nga klasa e parë. Nekludovi, përkundrazi, me një hamall që i mbante plaçkat dhe me Tarasin që e kishte hedhur krahëve trastën e tij, shkuan nga e majta.

— Ja, këtë do të kem shok, — i tha Nekludovi së motrës

---

1) E tmerrshëme (frëngj.)
2) Kjo klimë më vret (frëngj.)

duke i treguar Tarasin, historinë të cilit ja kishte treguar më parë.

— Si? Në klasën e tretë ke ndërmënd të udhëtosh? — pyeti Natalia Ivanovna kur Nekludovi u ndal përpara një vagoni të klasës së tretë, dhe hamalli me plaçkat dhe Tarasi hynë brënda.

— Po, këtu jam më rehat, jemi bashkë me Tarasin, — tha ai. — Ja se ç'dua të të them akoma, — shtoi, — gjer më sot unë nuk jua kam dhënë akoma tokën fshatarëve të Kuzminskojes, kështu që, në rast se unë vdes, e trashëgojnë fëmijtë e tu.

— Dimitri, ç'janë këto fjalë? — tha Natalia Ivanovna.

— Po nëqoftëse do t'jua jap, atëhere mund të të them këtë: gjithë pjesa tjetër e pasurisë është e tyre, meqë unë zor se martohem por, edhe në u martofsha, nuk do të kem fëmijë... kështuqë...

— Dimitri, të lutem, mos fol kështu — tha Natalia Ivanovna por, në të njëjtën kohë, ai vuri re se asaj iu bë qejfi nga këto fjalë.

Kureshtarët përpara vagonit ku kishin hipur princeshën Korçaguinë qenë rralluar. Njerëzit qenë shpërndarë të gjithë nëpër vende. Pasagjerët e vonuar vraponin duke kërcitur këmbët mbi dërrasat e platformës; konduktorët përplasnin dyert dhe i ftonin ata që do të niseshin të hipnin dhe ata që kishin ardhur për t'i përcjellur të zbritnin.

Nekludovi hyri në një vagon kaq të nxehur nga dielli, e kaq të qelbur, sa u detyrua të dali menjëherë në koridor.

Natalia Ivanovna qendronte përballë vagonit, me kapelën e saj sipas modës së fundit dhe me mantelin e lehtë, pranë Agrafena Petrovnës dhe, me sa dukej, kërkonte të thoshte ndonjë fjalë, por nuk dinte ç'të thoshte. Nuk mund të thoshte më as: «Ecrivez» [1] sepse qe tallur kaq herë bashkë me të vëllanë me këtë fjalë bajate që thonë zakonisht ata që ndahen. Ato pak fjalë që shkëmbyen lidhur me pasurinë dhe trashëgimin, i shkatërruan në çast lidhjet intimevëllazërore që u duk sikur po rivendoseshin përsëri midis tyre; ata e ndjenin veten tani përsëri të huaj ndaj njeri tjetrit. Kështu që Natalia Ivanovna u gëzua kur më në fund treni u nis dhe, pra, s'i mbetej tjetër veç se të tundëte kokën dhe të thoshte duke i dhënë fytyrës një shprehje në të njëjtën kohë edhe të brengosur, edhe ledhatoniëse: «Lamtumirë. lam-

1) «Më shkruani» (frëngj.).

tumirë, pra, Dimitri!». Por, kur treni u largua, ajo mendoi vetëm se si do t'ja thoshte të shoqit bisedën që kishte patur me vëllanë, dhe fytyra e saj mori, menjëherë, një shprehje tjetër: një shprehje serioze e të merakosur.

Po ashtu edhe Nekludovi, sadoqë e donte të motrën e kishte ndjerë veten si në gjëmba gjatë tërë kohës që kishin biseduar bashkë, dhe sikur mezi ç'kishte pritur që të çlirohej prej saj. Ai e kishte ndjerë se nuk kishte të bënte më me atë Natashën që kishte qenë dikur kaq afër zemrës së tij, por me skllaven e një burri të zi e me lesh, të cilin nuk e shihte dot me sy. Ai këtë e kuptoi fare qartë kur vuri re që fytyra e saj gjer atëhere e ngrysur, u çel menjëherë kur ai zuri në gojë atë çështjen që e shqetësonte kaq shumë të shoqin e saj — dhënien e tokave fshatarëve dhe çështjen e trashëgimisë. Kjo e hidhëroi dhe zemra e tij u ftoh.

XL

Vapara n'atë vagon të madh të klasës së tretë plot e përplot me njerëz, që ishte nxehur nga rrezet e zjarrta të *diellit* gjatë tërë ditës, ishte kaq e padurueshme, saqë Nekludovi nuk hyri fare në vagon, por vazhdoi të qendronte në koridor. Por edhe këtu ajri qe i rëndë dhe mbytës, kështuqë Nekludovi mundi të marrë frymë lirisht vetëm kur treni doli në fushë të hapur dhe filloi të frynte një fllad i lehtë. «Po, i vranë» — përsëriti ai fjalët që i kishte thënë atë ditë së motrës. Duke depërtuar nëpër atë tok përshtypjesh të shumta që kishte patur atë ditë, doli përsëri si e gjallë përpara tij, fytyra nazike e të vdekurit të dytë, me një buzëqeshje të turbullt mbi buzë, me ballin e rreptë, me veshin e vogël por të përsosur që i spikaste çkoqur në kafkën e kaltëryer. «Dhe tmeri i tmereve është se e vranë dhe asnjeri nuk di të thotë se kush e vrau. E vranë, po, po! E nisën me urdhër të Maslenikovit, ashtu si edhe të gjithë të burgosurit e tjerë. Por është e qartë se Maslenikovi nuk ka bërë gjë tjetër veç se ka përmbushur një formalitet, ka nënshkruar, me atë firmën e tij prej idioti, një shkresë me stemë në krye dhe, nuk ka se si të mendohet se ai e ka fajin. Aq më pak mund të quhet fajtor mjeku që i vizitoi të burgosurit para nisjes. Ai e kreu me përpikmëri detyrën e tij duke i ndarë veç të sëmurët. Ku ta dinte ai se do të bënte vapë kaq e tmershme? Si mund ta parashikonte se të burgosurit do t'i

nisnin aq vonë dhe në turmë? Mos e kishte atëhere fajin drejtori?... Por drejtori kish zbatuar një urdher sipas të cilit në datën kaq do të nisen kaq të burgosur, kaq burra, kaq gra... Po ashtu nuk mund t'i vihej faj oficerit qe i kishte marrë të burgosurit në dorëzim, sepse përkërisht ajo ishte detyra e tij: të merrte një numër të caktuar të burgosurish në dorëzim e të dorëzonte po aq. Kolonën ai e udhëhoqi si përherë dhe s'kishte se si ta parashikonte se do t'i binin n'udhë e sipër dy njerëz aq të shëndoshë e të fuqishëm, siç ishin ata të dy që pa Nekludovi. Asnjeri, pra, nuk ishte fajtor e, megjithatë, këta njerëz ishin vrarë pikërisht nga ata të cilëve nuk mund t'u vihej asnjë faj per vdekjen e tyre».

«Dhe kjo ndodh — mendonte Nekludovi — sepse të gjithë këta njerëz që janë gubernatorë, drejtorë, komisarë e policë, mendojnë se në disa rrethana të caktuara të jetës, marrëdhënjet njerëzore nuk janë të domosdoshme. Kështu duhet të jetë pa tjetër sepse, që të gjithë këta njerëz si, fjala vjen, Maslenikovi, drejtori i burgut dhe policët, që të gjithë keta, sikur të mos kishin qenë gubernatorë, drejtora burgu dhe policë, do të qenë menduar njëzet herë para se të nisnin një turmë kaq të madhe njerëzish me një vapë si kjo, do ta kishin ndalur njëzet herë rrugës kolonën e, duke parë se ndonjërit po i bënte të fikët dhe po i merrej fryma, do ta kishin hequr mënjanë, do ta kishin lënë më ndonjë vend të pushonte në hije, do t'i kishin dhënë ujë dhe, po të kishte vdekur, do t'u kishte ardhur keq për të. Por ata nuk e bënin këtë, bile nuk i linin as të tjerët ta bënin këtë, sepse nuk mendonin se kishin të bënin me njerëz dhe nuk i shihnin detyrat që kishin ndaj tyre si njerëz, po shikonin vetëm shërbimin që u qe ngarkuar, kërkesat e të cilit ata i vinin përmbi kërkesat e marrëdhënieve njerëzore. Dhe, ja, me këtë shpjegohen të gjitha — mendonte Nekludovi. — Kur mendohet se ka diçka që është më e rëndësishme se sa ndjenja e dashurisë për njerëzit, qoftë edhe për një çast, qoftë edhe në një rast të jashtëzakonshëm, atëhere, duke mos e ndjerë veten aspak fajtor, njeriu është në gjëndje të kryejë çdo krim».

Nekludovi u zhyt kaq tepër në këto mendime sa që nuk vuri re se si, ndërkaq, moti ndryshoi: dielli u fsheh pas disa reve të ulta, të shpupuritura, kurse nga ana perëndimore e horizontit përpa·onte një re e madhe, ngjyrë hiri e çelur, që ishte shkarkuar pjesërisht diku atje larg, nëpër ara e pyje, nëpërmjet një shiu të imët e të tërthortë. Ajri

dukej i lagësht. Reja çahej në të rrallë më dysh nga ndonjë rrufe dhe gjëma e bubullimave të largëta përzihej përherë e më dëndur me zhurmën monotone të vagonave. Reja sa vinte afrohej dhe pikat e tërthorta të shiut, të shtyra nga era, nisën të çikrojnë mbi platformën e trenit dhe mbi pallton e Nekludovit. Ai u tërhoq nën strehë dhe, duke thithur freskinë e ajrit dhe aromën e këndëshme të tokës së etur për ujë, vështronte panoramën që rridhte e shpejtë si valë lumi përpara syve të tij: kopështet, pyjet, arat e zverdhura me thekër, brezat ende jeshilë të tërshërës dhe brazdat e zeza të dheut ku dalloheshin fletët e gjelbëra të patateve që kishin zënë tani lule. Çdo gjë dukej si e mbuluar nga një shtresë e hollë vërniku: jeshilja dukej më jeshile, e verdha — më e verdhë, e zeza — më e zezë.

— Jepi, jepi! — murmuriste Nekludovi duke vënë re i gëzuar se si gjallëroheshin nga ai shi i mbarë arat, bahçet dhe kopshtet.

Po ai shi i vrullshëm nuk zgjati shumë. Reja u shkarkua pjesërisht, u çkoq dhe u largua dhe mbi dheun e lagur binin tani dendur e drejt pikat e fundit, të imta të shiut. Dielli e nxori përsëri kokën që nga pas reve dhe gjithshka mori përsëri shkëlqimin e mëparshëm, ndërsa andej nga lindja kërrusej atë çast në horizont i këputur vetëm në një anë, një ylber i unjtë por i fortë ku mbizotëronte mbi të gjitha ngjyrat, manushaqja.

«Për çfarë po mendoja pak më parë? — pyeti vehten Nekludovi, kur të gjitha ato ndryshime në natyrë muarrën fund dhe treni po varej në shpatin e rrëpirë të një lugine. — Ah, po! Po mendoja se të gjithë këta njerëz, d.m.th. drejtori, policët e të tjerë, me një fjalë të gjithë këta njerëz që kanë ndonjë nëpunësi shtetërore e që, në përgjithësi, janë njerëz të butë e zemërmirë, bëhen të këqij pikërisht nga nëpunësia që kanë».

Ai solli ndër mënd se me sa gjakftohtësi e dëgjonte Maslenikovi kur ai i fliste për ato që bëheshin në burg, solli ndër mënd rreptësinë e drejtorit, zemërgurësinë e oficerit që i qëllonte me pëllëmbë ata që i luteshin ta bënin udhën hipur e që s'bëhej merak fare për gruan që po lindte në tren. «Që të gjithë këta njerëz janë të imunizuar dhe kanë një mburojë të sigurtë që i mbron gjer edhe nga depërtimi i ndjenjës më të thjeshtë të dashurisë për njerëzit, sepse kanë një nëpunësi, sepse shërbejnë. Si të tillë, si nëpunësa, ndjenja e dashurisë për njerëzit has tek ata një pengesë të pakapër-

xyeshme, siç has në një pengesë të pakapërxyeshme n'atë tokë gurore shiu — mendonte Nekludovi duke soditur kalldrëmin e shpatit shtruar me gjithfarë gurë të luginës, ku uji nuk thithej nga toka por shkiste e mblidhej nëpër rrëkera që kullonin diku poshtë. — Ndofta ka qenë e nevojëshme që kjo luginë të shtrohej me gurë po, sidoqoftë të vjen keq kur e sheh të çveshur nga çdo bimësi këtë tokë, ku mund të rriteshin fare mirë gruri, bari, lulet... — Po kështu edhe me njerëzit, — mendonte Nekludovi, — ndofta të gjithë këta gubernatorë, drejtorë e policë janë të nevojshëm, ndofta nuk ka sesi të bëhet pa ta, por është e tmerrëshme të shikosh një njeri që është i çveshur gjer edhe nga cilësia e parë e njeriut: nga ndjenja e dashurisë dhe e keqardhjes për vëllezërit e tij.

Kjo rrjedh — mendonte Nekludovi — ngase këta njerëz, duke mos patur një kuptim të qartë mbi ligjin, quajnë ligjë atë që nuk është ligjë dhe, përkundrazi, nuk pranojnë për ligjë atë që është ligji themelor, shekullor e i pandryshueshëm i fisit njerëzor të cilin vetë zoti e ka shkruar në zemrat e njerëzve. Prandaj ndofta unë e ndjej veten si ndër gjemba, kur rri me këta njerëz, — mendonte Nekludovi. Po, unë i kam frikë këta njerëz. Dhe është me të vërtetë për t'i patur frikë këta njerëz. Banditit, fundja, edhe mund t'i vijë keq, por këtyre s'u vjen kurrë keq sepse ndryshimi që kanë pësuar nën barrën e shërbimit që kryejnë, ua ka bërë zemrën shterpë për çdo lloj keqardhje, ashtu siç janë shterpë për çdo lloj bimësie këta gurë këtu. Pikërisht për këtë edhe janë kaq të tmerrshëm. Thonë për Pugaçevin dhe për Razinin se kanë qenë të tmershëm. Po këta janë njëmijë herë më të tmershëm, — vazhdonte ai të mendonte. — Sikur të shtrohej ky problem psikollogjik: si duhet vepruar në mënyrë që njerëz të kohës sonë, të fesë së krishtere e me ndjenja humanitare, njerëz të mirë me fjalë të tjera të kryejnë krimet më të poshtra pa e ndjerë në të njëjtën kohë veten fajtorë, ky problem mund të kishte vetëm një zgjidhje: duhej vepruar pikërisht ashtu si në fakt qe vepruar, d.m.th. duhej që këta njerëz të bëheshin gubernatorë, drejtorë burgu, oficerë e policë ose, ta themi ndryshe, duhet që në radhë të parë këta njerëz të besojnë e të kenë bindje se çdo njeri që futet në punë shtetërore, mund t'i trajtojë njerëzit një lloj siç traiton sendet, d.m.th. jo nën pikëpamjen e njerëzimit dhe të vëllazërimit, dhe, në radhë të dytë, duhet që këta njerëz, të cilëve u ngarkohet një përgjegjësi shtetërore, të sigurohen nga

pasojat e krimeve të tyre në mënyrë që asnjeri të mos e ndjejë mbi veten e tij përgjegjësinë e fajit të kryer. Jashtë këtyre kushteve është e pamundur që të bëhen në kohën tonë të tilla vepra të shëmtuara si ato që pashë sot. Pra gjithë puna qendron këtu, se njerëzit mendojnë që ekzistojnë disa rrethana që i lejojnë njeriut të sillet ndaj njeriut pa dashuri. Po në të vërtetë të tilla rrethana nuk ka. Me sendet mund të sillesh si të duash, d.m.th. edhe pa dashuri. Kështu, për shëmbull, mund t'i presësh pemët, t'i pjekësh tullat e ta kalitësh hekurin, pa ndjerë ndaj kësaj pune asnjë dashuri, por, në marrëdhënjet me njerëzit, dashuria është kaq e domosdoshme sa është i domosdoshëm, fjala vjen, kujdesi me bletët. Po të sillesh me to pa kujdes, do t'u bësh dëm atyre dhe vetes. Po kështu ndodh edhe me njerëzit. Dhe nuk ka as si të jetë ndryshe, se dashuria reciproke ndërmjet njerëzve është ligji themelor i jetës njerëzore. Është e vërtetë që njeriu nuk mund t'ja detyrojë vetes dashurinë si mund ta detyrojë veten, fjala vjen, që të punojë, por nga kjo nuk rrjedh se mund të hysh në marrëdhënje me njerëzit pa i dashur, aq më pak pastaj kur diç kërkon prej tyre. Nëqoftëse nuk ndjen dashuri ndaj njerëzve, largohu prej tyre, — mendonte Nekludovi dhe këtë ja thoshte më tepër vetes, — merru me veten tënde, me sendet dhe me ç'të duash, por vetëm jo me njerëzit. Që ushqimi të të bëjë mirë, duhet të hash vetëm kur ke uri, po ashtu edhe me njerëzit, që të mos kesh dëm prej tyre, duhet që t'i duash. Por nëqoftëse do t'i lejosh vetes të sillesh me njerëzit pa dashuri, ashtu siç u solle dje me kunatin tënd, atëhere dije mirë se nuk ka cak që të kufizojë egërsinë dhe ligësinë tënde, ashtu siç pate rast të vëresh sot, dhe se, gjithashtu, nuk ka cak që të kufizojë vuajtjet e tua, ashtu siç e ke provuar vetë gjatë tërë jetës tënde. Po, po, është pikërisht kështu, — i thoshte vetes Nekludovi. — Dhe është mirë, është shumë mirë që është kështu!» — vazhdonte t'i përsëriste ai vetes duke provuar një kënaqësi të dyfishtë, që rridhte nga freskia lehtësonjëse pas vapës kapitëse, dhe nga vetëdija që ai kish arritur tanimë shkallën më të lartë të kthjelltësisë në një çështje që e kishte munduar kaq kohë.

XLI

Në vagonin në të cilin ndodhej Nekludovi, pothuajse gjysma e vendeve qe zënë nga njerëz gjithfarësh, prej të gjitha shtresave e të gjitha kategorive, nga shërbëtorë, nga zanatçinj, nga puntorë fabrikash, nga kasapë, nga çifutë, nga matrapazë, nga gra, nga një ushtar dhe nga dy zonja: njëra e re, tjetra e shkuar në moshë, me krahë lakuriq dhe me byzylyqe. Në vagon ndodhej gjithashtu edhe një zotëri me pamje të rreptë, me një kapelë të zezë me strehë e me një kokardë mbi të. Që të gjithë këta njerëz që kishin bërë aq zhurmë gjersa kishin gjetur një vend, tani rrinin të qetë dhe vetëm aty-këtu ndonjeri lëvizte që të rehatohej më mirë, ndonjë tjetër ndizte cigaren dhe të tjerë akoma hapnin ndonjë muhabet me fqinjët e tyre.

Tarasi, me një çehre të çkujdesur, qe ulur në krahun e djathtë të vagonit, duke ruajtur një vend edhe për Nekludovin, e po bisedonte me gjallëri me një burrë tërë muskla, me një padjofkë të zbërthyer përpara, i cili kish zënë vend përballë tij dhe që, siç mori vesh më vonë Nekludovi, kthehej në qytet ku punonte diku si bahçevan. Pa arritur gjer tek Tarasi, Nekludovi u ndal në mes të koridorit pranë një plaku të pashëm me mjekër të bardhë, me një padjofkë nankini, që po bisedonte me një grua të re e veshur si fshatare. Pranë gruas qe ulur një vajzë e vogël, nja shtatë vjeçe, që s'i arrinin këmbët gjer përdhe, veshur me një sarafan të ri, me një gërshetë të hollë, pothuaj të bardhë, që i zbriste nga krahët poshtë. Vajza përtypte tërë kohës ca farë luledielli. Si ktheu kokën nga Nekludovi, plaku mblodhi kindat e padjofkës nga faqja e llustruar e fronit mbi të cilin qe ulur vetëm, dhe i tha me përzëmërsi:

— Urdhëroni e uluni!

Nekludovi falënderoi dhe u ul. Gruaja, që në këtë kohë e sipër e kishte prerë muhabetin, e rifilloi përsëri. Ajo po tregonte se si e kish pritur i shoqi në qytet, ku kish shkuar për ta parë.

— Kam qenë tek ai për të lidhura, po ja, siç e sheh, u kthyesh — thoshte ajo. — Tani, dhëntë zoti, do piqemi prapë për krishtlindje.

— Mirë bën që i vete hera-herës, — tha plaku duke kthyer kokën nga Nekludovi — se të rinjtë xheku azdisen andej nga qyteti.

— Jo, mor babagjysh, ç'thua ashtu, s'është nga ata ai imi. Jo se të mburrem, po i ka të rrallë shokët, është namuzli. Ç'fiton shtëpisë ja dërgon, gjer në kopejkën e fundit. Apo sa u gëzua, sa u gëzua kur pa çupën! — tha gruaja duke buzëqeshur.

Vajza, që pështynte or'e çast celfat e farëve, si për t'i mbështetur fjalët që tha e ëma, ngriti syt' e saj të qetë e të zgjuar duke e vështruar plakun e Nekludovin në fytyrë.

— E po, kur qenka me mënd në kokë, aq më mirë, — tha plaku. — Po asaj, a ja thotë ndonjë çikë? — vazhdoi, duke treguar me sy një çift, një burrë e një grua, që të dy punëtorë me sa dukej, që kishin zënë vend në krahun tjetër të vagonit.

Ai kish ngritur kokën lart, kish ngjeshur në gojë grykën e një shisheje me vodkë e po pinte, kurse ajo, mbante në dorë trastën që nga e kishin nxjerrë shishen, dhe e vështronte të shoqin ngultas pa ja hequr sytë.

— Jo, ai imi, s'e vë në gojë rakinë, dhe as duhanin nuk e pi, — tha gruaja që bisedonte me plakun dhe, duke përfituar nga rasti, nisi ta lëvdëronte përsëri të shoqin. — Atë, or babagjysh, një herë e ka bërë nëna. Lere se ç'burrë është! — tha ajo duke iu drejtuar në të njëjtën kohë edhe Nekludovit.

— E po ca më mirë, ahere, — tha plaku, që kish kthyer kokën nga punëtori i cili po rrëkëllente atë kohë shishen me vodkë.

Punëtori piu sa piu nga shishja dhe ja dha gruas. E shoqja e mori shishen e, gjithë duke qeshur e duke tundur kokën, e vuri dhe ajo në buzë. Duke vënë re se Nekludovi dhe plaku po e shikonin, punëtori u kthye nga ata dhe tha, duke iu drejtuar Nekludovit:

— E pse na shikon ashtu, or barin? Apo mos çudite që na sheh duke pirë? Kur punojmë, aha, s'na sheh njeri, po kur pimë të gjithë tek ne i kanë sytë, për perëndi! Po dhe në pi, djersën time pi. Dhe ja, të them: zoti më lëntë vodkën e më lëntë gruan se për tjetër s'kam nevojë.

— Po, po — tha Nekludovi që s'dinte ç'të thoshte.

— Apo s'e kam mirë, or barin? Dhe mos pandeh, gruan e kam asllane, jo shaka! E jam i kënaqur prej saj sa më s'bëhet, se e di që i vjen keq për mua. Është kështu, apo s'është kështu, Mavra?

— Hë, na tani, merre! S'dua më, — i tha e shoqja duke

i kthyer shishen. — Dhe mjaft llomotite, rri urtë tani! — shtoi ajo.

— Ja, e patë? — vazhdoi punëtori. — E mirë, e mirë, po kur i ngrihet damari asaj zë e kuis, or vëlla, si ajo qerrja kur e lënë pa vaj. Është kështu apo s'është kështu, Mavra?

Mavra, duke qeshur, tundi dorën me një lëvizje prej të dehuri.

— Ama, prapë fillove ti?...

— E, siç thashë, e mirë, e mirë, po në ja lëshofsh frërin, të hypën në zverk e hiqe po të duash... Ja, kështu. Më falni, or barin, se mbase ju mërzita. Po, djallo punë, kam pirë ca, dhe pija i ka llafet... — tha punëtori dhe, si u shtri duke mbështetur kokën në prehërin e së shoqes, që ndërkaq buzëqeshte parreshtur, ja mori gjumit.

Nekludovi qendroi një copëherë me plakun, i cili i foli për veten e tij duke i treguar se kishte punuar gjer ahere si sobabërës, se kish ndrequr kaq e kaq soba sa as që mund të bëheshin hesap, dhe se tani kish vendosur të shplodhej njëher' e mirë, po ç'e do se hallet prapë nuk po e linin rehat. Ja, një dizaj kish qenë në qytet e i kish rregulluar djemtë në punë, kurse tani po hidhej një vrap nga fshati për ca punë të tjera. Nekludovi, si e dëgjoi gjer në fund tregimin e plakut, u ngrit e u drejtua tek ai vendi që kishte ruajtur Tarasi për të.

— Uluni, or barin, uluni! Ja gjejmë vendin trastës, — tha me përzëmërsi bahçevani që ndodhej përballë Tarasit, duke i ngritur sytë lart e duke ja drejtuar Nekludovit.

— Miq të kemi pa çka se ngushtohemi, — tha duke buzëqëshur Tarasi me një zë sikur këndonte dhe, si e ngriti atë trastën e tij prej dy pudësh si të qe ndonjë pupël, e vendosi pranë dritares. — Vend ka plot po, edhe sikur të mos kishte, pun'e madhe se do rrish në këmbë apo do ulesh nën fron! Naze të mos ketë njeriu, pa kudo bën rehat! — tha ai duke fluturuar nga gëz'mi.

Tarasi thoshte për veten e tij se, kur nuk pinte, nuk dinte të fliste, po kur e lagte sado pak gërmazin, gjuha i bëhej brisk vetvetiu, dhe ahere veç ta dëgjoje! Ashtu qe me të vërtetë, se, kur ishte esëll, Tarasi më shumë rrinte pa folur por, kur rrëkëllente ndonjë gotë, gjë kio i ndodhte më të rrallë e në disa rrethana të posaçme, ahere bëhej një llafazan i madh, sadoqë s'e humbiste kurrë fillin e mendimit e bisedonte shtruar e bukur. Fliste me një thjeshtësi të madhe dhe vetëm për gjëra të vërteta e të ndjera e, sidomos, me një

përzëmërsi të ngrohtë që dukej sikur rrezatohej nga sytë e tij të butë kaltërosh dhe nga buzëqeshja ledhatonjëse dhe e sinqertë që s'i hiqej kurrë nga goja.

N'atë gjëndje shpirtërore ndodhej dhe atë ditë. Kur u afrua Nekludovi ai e la përmes një bisedë që kish filluar. Por, si e rregulloi trastën, u ul përsëri në vendin e tij, i mbështeti duart e mëdha e të regjura në punë mbi gjunjët e fortë dhe, duke e vështruar në sy bahçevanin, e vazhdoi tregimin atje ku e kishte lënë. Tarasi po i tregonte bahçevanit me të gjitha hollësirat historinë e gruas së tij, përse e kishin dënuar dhe përse ai po e ndiqte tani në Siberi.

Nekludovi nuk kishte patur rast ndonjë herë tjetër të dëgjonte hollësisht këtë histori dhe prandaj mbante vesh me kureshtje. Tarasi kishte arritur n'atë pikë të tregimit kur në familjen e tij e kishin marrë vesh që helmin në kulaç e kishte hedhur Fedosja.

— Po i tregoj për atë mënxyrën time — tha Tarasi duke iu drejtuar Nekludovit ashtu siç do t'i drejtohej një shoku të ngushtë. — Ja, hasa në një njeri zemërmirë që po ma qan hallin e ka nge të më dëgjojë dhe kështu m'u zgjidh gjuha...

— Po, po — tha Nekludovi.

— E ja, që thua ti, kështu siç të thashë, na u zbulua kjo punë. Ahere mëma e merr atë kulaçin e, pa një pa dy, vendosi ta shpinte atje ku duhej. «Po vete, thotë, tek komisari». Po im atë ishte plak me mënd në kokë dhe i drejtë sa s'bëhej tjetër, ndaj edhe i tha: «Dale, moj plakë, mos u rrëmbe ashtu, se nusja është akoma foshnje dhe nuk e di as vetë pse e bëri atë që bëri. Duhet të na vijë keq e t'ja falim kësaj radhe, pa do pendohet, më dëgjo mua!» Po pse, dëgjonte ajo? Meazallah! «E, o, e, mirë thua, ta mbajmë këtu që të na çfarosi të gjithë si mizat». E, ja, kështu, or burazer, atje e tek komisari. Ky një të çatisur bën në shtëpinë tonë e kërkon të na marrë për shahit...

— Po ti, qysh? — pyeti bahçevani.

— E çdo të bëja unë? Mua më shkonin ca të prera në bark që ç'të të them! Apo s'më kishte ardhë një e vjellë! Ja, bëj hesap, sa s'krreva dhe zorrët e barkut ahere! Po im atë një të mbrehur qerren, një të ngarkuar Fedosjen e revan tek stanovoj. Që atje e tek gjyqtari hetonjës. Po ajo, ore vëlla, i rrëfeu që të gjitha në sy të gjyqtarit, ashtu, për besë, siç qenë, pa fshehur gjë. Dhe ku e kishte marrë helmin dhe se qysh e kishte mbrujtur brumin me të. «Po pse e bë-



re? — i thonë. — «Po, sepse, tha, s'e shihja dot me sy. Më mirë, thotë, të vete në Siberi se sa të rroj me të», demek me mua, — tha Tarasi duke buzëqeshur. — E kështu, siç të thashë, i pranoi të gjitha. E futën në burg, domosdo, se çdo ta bënin? E, ja, im atë kthehet vetëm në shtëpi. Mirëpo vinë të korrat, puna po do krahë, po krahë nuk kemi se nëna s'para kishte takat dhe s'ja dilte dot mb'anë dhe arës dhe shtëpisë. E po si t'ja bëjmë, qysh t'ja bëjmë? Po sikur të zihemi garant e ta marrim në shtëpi ca kohë, të paktën sa të kalojë vala e punës? Shkon im atë e llafoset me një nga ata që e kanë në dorë këtë punë. S'ujdis me të, e shkon tek një tjetër. Po ç'e do, i shkrepi bosh llafi me të gjithë sa u takua. Dhe me kaq, i premë shpresat fare; kur desh zoti, ndeshëm në një nëpunës, një pëllëmbë njeri ishte qerratai, po, ama, i shkathët: shpuzë! «Për pesë rubla, thotë, ua marr unë përsipër këtë punë». I dhamë tri e pranoi, por edhe ato të tri i muarrëm hua, se s'kishim, lamë peng çarçafet e pajës që na i dhanë. Një kartë shkroi ai — dhe këtu Tarasi e zgjati zërin sikur pas kësaj pritej të dëgjohej ndonjë e shtënë pushke — një kartë shkroi dhe puna u mbarua. Atë kohë unë qeshë ngritur në këmbë ndaj dhe shkova vetë në qytet ta marr. Shkoj, unë, që thua ti, në qytet. E lë pelën aty në një han, e vrap e në burg. «Hë, më thonë, ç'do?» Kështu e kështu, u them, dua gruan që e kam në burg. «Po ndonjë dëftesë, më thonë, ke?» — «Kam, i them» dhe fët e nxjerrë dhe ja jap. E sheh ai dhe më thotë «Prit». Ulem unë e pres. Dielli tani po kish marrë shumë. Vjen aty i madhi i burgut. Më thotë: «Ti je Vargushovi?» — «Unë jam, i them, i tëri!» — «Na, më thotë, merre!». Papo një të krisur bëjnë dyert dhe kur del ajo, veshur e stolisur me rrobat e saj, ashtu siç qe. «E po, eja të shkojmë, i them». — «Po ti më këmbë, paske ardhë?» — «Jo kam marë pelën». Vamë tek ai hani që të thashë, i pagova ustait qiranë, mora dhe një dorë sanë, e mbreha pelën dhe u bëra hazër. Hipi ajo, e mblodhi kokën me shami dhe ndënji. U nisëm. Gëk ajo, gëk unë. Po tek i afroheshim fshatit, kthehet e më thotë: «Po mëma gjallë është?» — «Gjallë, i them». «Gjallë dhe babai?» — «Gjallë». — «Falmë, o Taras, më thotë, se s'kam qenë në vete. Nuk dija se ç'bëja» — «S'kemi pse e zëmë në gojë, i them, se të kam falur qëkur». Kaq, e nuk foli më. Me të vajtur që shkuam në shtëpi, i bie mëmës në këmbë. Im më i thotë: «Zoti do të të fali, moj bijë!» Babai e merr në qafë dhe i thotë: «Të shkuara të harruara. Tani rro e gëzo të ri-

të e tu. Le që s'ja kemi edhe ngenë tani se na presin të korrat. Apo s'na është bërë sivjet një thekër, që zoti e faltë, sa një bojë njeriu e koqe-plot marshalla! E do korrur se s'pret. Ja, nesër që me natë do të dalësh n'arë bashkë me Tarasin». Pa po t'i vihet punës ajo, ore vëlla, posi? Me xhan! Hej të punuar që bënte! Kishim asokohe me qira tri dimjatina tokë dhe, daç thekra, daç tërshëra, atë vit qenë bërë për hata. Unë korr, ajo lidh. Herë-herë korrnim që të dy. Unë jam qen i punës po, ja, të them, ajo ma kalonte! Si nuk pushonte një herë, xhanëm! Apo e kolme, apo e shëndoshë, apo e re! E, që ta kisha fjalën, kaq u harrua pas punës sa ngandonjëherë dhe xheku e qërtoja. Kthehemi nga ara të lodhur, me duart plagë dhe, domosdo, kushdo të jetë do të shtrihet një copë herë të pushojë, mirëpo ajo, vrap e në plevicë që të pregatisi liziturat për të nesërmen. Ja, kaq shumë kishte ndryshuar!

— Po me ty, qysh, a ndryshoi ndopak? — pyeti bahçevani.

— Ndryshoi, thua? Aq ndryshoi, ore burazer, sa s'kishim më asnjë të ndryshuar unë e ajo. Kaq u lidh pas meje, sa m'i shihte edhe mendimet që kisha në kokë. Qe pataksur dhe mëma se, e sertë e sertë, po një ditë s'iu durua dhe më tha: «Më duket se na e kanë ndërruar Fedosjen, se s'është ajo që qe». Se si ra llafi një herë tek po lidhnim ca duaj e rrinim ashtu kokë më kokë, i them: «Po si, moj Fedosja, t'u çpif ta bësh atë punë?» — «Ja ashtu m'u çpif dhe e bëra, më tha, se nuk doja të rronja me ty. Më mirë njëmijë herë, thoja me veten time, të vdes». — «Mirë, po tani?» — e pyes. — «Tani, më thotë, të kam në zemër». — Tarasi heshti një hop dhe buzëqeshi i gëzuar duke tundur kokën me habi. — Porsa kishim mbaruar të korrat dhe e kisha shpënë kërpin që të rrihej, kur një ditë që kthehem në shtëpi, shoh: një letër nga gjyqi! Dhe ne, për perëndi, gjyqin e kishim harruar fare se nuk dinim ç'kishte mbetur më për të gjykuar.

— Ai qoftëlargu e ka shtyrë, tha bahçevani — se njeriu vetë përse do të marrë shpirtin e tij në qafë? Ja kështu edhe në fshatin tonë kemi patur një... — dhe bahçevani nisi të tregonte edhe ai një histori, po treni atë çast ndaloi.

— Më duket se erdhëm në stacion — tha, — s'do qe keq ta lagnim një çikë gojën.

Biseda u ndërpre dhe fill pas bahçevanit, Nekludovi zbriti nga vagoni dhe shkeli mbi dhogat e njomura të platformës.

XLII

Nekludovi, pa dalë akoma nga vagoni, vuri re në sheshin e stacionit disa karroca elegante me nga tre e nga katër kuaj të ushqyer mirë e me zile; kur zbriti pastaj mbi platformën e lagur nga shiu, ai pa para një vagoni të klasës së parë një turmë njerëzish. Në mes të turmës shquhej një damë e trashë dhe e gjatë, me pupla të çmuara në kapele, të cilën e shoqëronte një djalosh me këmbë të holla, veshur me kostum çiklisti dhe një qen i madh, bullduk, me një qafore të pasur lëkure. Pas tyre qendronin disa shërbetorë me mushama e me ombrella si dhe një karrocier që, me sa dukej, kish dalur për të pritur zotërinjtë. Të gjithë njerëzit që bënin pjesë n'atë grup, duke filluar që nga zonja e trashë e gjer tek karrocieri, i cili mbante me dorë kindat e kaftanit të tij të gjatë, dukeshin të qetë, pa halle e telashe në kokë. Përreth këtij grupi u formua menjëherë një rreth kureshtarësh e njerëzish të tjerë që në mënyrë servile i faleshin pasurisë: shefi i stacionit, me një kapelë të kuqe me strehë, një xhandar, një vajzë e hollë me veshje fshatare, e cila e kish bërë zakon të ndodhej gjithmonë gjatë verës kur soste treni, një telegrafist dhe disa pasagjerë: burra e gra.

Tek ai djalosh me qenin Nekludovi njohu menjëherë të birin e Korçaginëve që vazhdonte akoma mësimet në gjimnaz, kurse ajo dama e trashë ishte e motra e princeshës që i kishte ftuar Korçaginët në çiflikun e saj. Kryekonduktori i trenit, me shiritat në gjoks e çizmet prej llustrofini që i shkëlqenin, e hapi derën dhe, si për nder, e mbajti ashtu vetë me dorë gjersa Filipi dhe një burrë tjetër me përparëse të bardhë duallën duke mbajtur në krahë princeshën mbi kolltukun e saj të rehatshëm; motrat u përshëndetën, u bisedua frengjisht se si do të qe më mirë të transportonin princeshën, në një karrocë të rëndë apo në një karrocë të lehtë, dhe vargani, që mbyllej në fund nga shërbyesja me flokë kaçurrelë, me ombrellat dhe me atë sendin në këllëf, u drejtua për nga dyert e stacionit.

Nekludovi, duke mos dashur t'i takonte, sepse do të qe pastaj i detyruar të ndahej prej tyre e të përshëndetej me ta, u nda disa hapa më përpara nga dera e stacionit duke pritur gjersa të dilnin të gjithë. Princesha me të birin, Missi, doktori dhe shërbyesja ecnin përpara, kurse princi plak vinte

më pas, bashkë me të kunatën, dhe Nekludovi dëgjonte tek tuk ndonjë frazë të shkëputur nga biseda e tyre frengjisht. Një nga këto fraza, që u shqiptua nga princi, ashtu siç ndodh shpesh, kushedi perse, iu ngulit në mëndje Nekludovit me të gjitha hollësitë e tonit dhe të zërit me të cilin u tha.

— Oh, il est du vrai grand monde [1]) — se për kë tha princi, me atë zërin e tij të fortë e të sigurtë, duke kaluar bashkë me të kunatën derën e stacionit përcjellur me nderime nga konduktorët dhe nga hamenjtë.

Tamam në këtë kohë u duk në platformë një turmë punëtorësh me llapti, me ca gozhupe të shkurtëra e me ca trasta krahëve, që s'dihej se nga vinin. Punëtorët iu afruan vagonit të parë me hap të vendosur, por pa bërë zhurmë, dhe deshën të hypnin në të, por u dëbuan në çast nga konduktori. Punëtorët, pa u ndalur, vazhduan udhën duke i shkelur këmbën nga nxitimi njeri tjetrit, gjersa sosën tek vagoni tjetër. Por, ndërsa po kacavjerreshin me trastat në duar, në derë të vagonit, dhe pothuaj kishin hyrë brënda, një konduktor tjetër që i pa nga larg stacionit, iu shkreh me të rreptë dhe i urdhëroi të largoheshin. Punëtorët s'ja bënë dysh fjalën por, përkundrazi, u ngutën të dilnin e, duke ecur përsëri me hap të vendosur e pa zhurmë, vazhduan udhën për tek një vagon tjetër që ishte pikërisht ai në të cilin kishte zënë vend Nekludovi. Konduktori s'i la as atje. Ata u ndalën e po mateshin të largoheshin, por Nekludovi u tha se n'atë vagon kishte vende plot e mund të hypnin. Ata e dëgjuan dhe, fill pas tyre, hypi në vagon edhe Nekludovi. Punëtorët me të hyrë, u turrën për të zënë ndonjë vend, zotëria me kokardë dhe damat, që të dyja, duke e quajtur këtë si një orvajtje për të cënuar dinjitetin e tyre dhe si një fyerje personale, i kundërshtuan me vendosmëri dhe i dëbuan. Punëtorët, që bëheshin ndonja njëzet vetë, ndër të cilët kishte edhe shumë pleq edhe shumë të rinj, që të gjithë me ato fytyra të thara, të vojtura, të nxira nga dielli, me ato trastat që i pengonin të rrotulloheshin, duke e ndjerë veten si të kapur në faj, u drejtuan menjëherë për nga dera e daljes së vagonit, të gatshëm, me sa dukej, të shkonin edhe prapa diellit e të uleshin makar edhe mbi gozhdë, mjaft që të mos u thonin gjë.

---

1) Oh, është njeri i shoqërisë së lartë, i një shoqërie me vërtetë të lartë. (frëngj.)

— Ku shkoni ashtu, mor djaj! Ja, vendosuni këtu, — u thirri një konduktor tjetër që u doli përpara e u preu rrugën.

— Voila encore des nouvelles![1] — tha atë çast njera nga të dy damat, e bindur se me atë shqiptimin e përsosur që i bënte gjuhës frengjishte do t'ja tërhiqte pa tjetër vëmëndjen Nekludovit. Kurse dama me byzylyke i mirrte erë një shisheje të vogël me kolonjë dhe thoshte duke rrudhur vetullat se do t'ishte vërtet një gjë shumë e këndëshme sikur të të ulej pranë një nga ata muzhikët e qelbur.

Punëtorët gjatë kësaj kohe, duke provuar gëzimin dhe qetësinë shpirterore të një njeriu që ka kapërcyer një rrezik të madh, u ndalën dhe nisën të shpërndaheshin nëpër vende duke lëshuar në shesh, me një lëvizje të supeve, trastat e rënda që mbanin në krahë e duke i futur pastaj thellë nën frone.

Bahçevani që kish biseduar pak më parë me Tarasin, u ngrit e shkoi në vendin e tij, kështu që, nga të dy krahët e Tarasit dhe përballë tij, kishte tani tre vende të lira. Në këto vende u ulën tre punëtorë, por, kur panë Nekludovin që po u afrohej, rrobat e tij të pasura prej zotërie, u turbulluan kaq shumë sa brofën me një herë në këmbë dhe u matën të iknin; por Nekludovi nuk i la, iu lut të mos tundeshin nga vendi dhe për vete u ul mbi mbështetësen e fronit, nga ana e koridorit.

Njëri nga punëtorët, një burrë nja pesëdhjetë vjeç, u pa në sy me atë tjetrin, më të riun, që qe ulur në krah të tij, i habitur, bilé si i frikësuar. Nekludovi, në vend që t'i shante e t'i dëbonte, ashtu siç i përkiste një zotërie, u kishte liruar përkundrazi vendin e tij. «Po kjo!» — mendonin ata. Dhe, nga që s'dinin se si ta shpjegonin këtë gjë, kishin frikë se mos u ndodhte ndonjë gjë e keqe. Por duke parë se këtu nuk kishte ndonjë dredhi dhe se Nekludovi bisedonte lirisht me Tarasin, ata u qetuan, i thanë atij më të voglit prej tyre të ulej mbi trastë dhe iu lutën Nekludovit që të ulej përsëri në vendin e tij. Në fillim, ai më plaku nga punëtorët, që qe ulur përballë Nekludovit, rrinte si i ngrirë dhe kujdesej që t'i mblidhte sa më tepër ndaj vetes ato llaptet e ndyra që kish në këmbë, se mos për bela e fshikte me to barinin, por pastaj iu shtrua muhabetit me Nekludovin dhe me Tarasin në një mënyrë kaq të përzëmërtë, saqë e çoku në gjunjë Nekludovin

1) Ja dhe një e re tjetër. (frëngj.).

me kurrizin e dorës kushedi sa herë, kur qe fjala për t'i vënë në dukje rëndësinë e ndonjë pjese të tregimit të tij. Ai u tha se të gjithë ata punonin në disa këneta torfi dhe se tani po ktheheshin në shtëpi, pasi kishin punuar atje ndonja dy muaj e gjysëm, e kishin fituar nga dhjetë rubla për kokë, veç atyre që kishin marrë përpara se të pajtoheshin në punë. Puna që bënin, sipas asaj që tregonte, fillonte që pagdhirë e mbaronte natën, me një pushim prej dy orësh në drekë. Po e keqja qe se duhej të futeshe n'ujë gjer në gjunjë.

— Ata që s'janë mësuar, e kanë zor, domosdo, — tha ai, — por kur njeriu e bën zakon, s'para i bën përshtypje. Vetëm ushqimi të jetë i mirë. Në fillim ushqimin s'e kemi patur të mirë. Po pastaj u qamë dhe na e përmirësuan, kështuqë edhe puna na u duk më e lehtë.

Pastaj ai nisi të tregojë se kish njëzet e tetë vjet që pajtohej me punë jashtë. Ç'nxirrte nga puna ja dorëzonte shtëpisë, në fillim babait, pastaj vëllait të madh dhe tani sëfundit nipit, se atij ja kishin ngarkuar qeverrisjen e shtëpisë. Nga të pesëdhjetë apo gjashtëdhjetë rublat që fitonte në vit, mbante për vete vetëm nja dy a tri: për duhan e për shkrepse.

— Pastaj, xheku bëjmë edhe ndonjë gjynah, xheku e kthejmë dhe nga ndonjë gotë, — shtoi ai duke buzëqeshur si me faj.

Ai tregoi gjithashtu se punët në shtëpi ua kishin lënë grave, se si ai sipërmarrësi i kishte gostitur atë ditë, para se të niseshin, me një gjysmë kove me vodkë dhe se si njeri prej tyre kishte vdekur në pun'e sipër, kurse një tjetër po e shpinin në shtëpi të sëmurë. I sëmuri për të cilin ai e kishte fjalën, ndodhej po n'atë vagon e kishte zënë vend në një qoshe. Ky ishte një çunak, pothuaj akoma fëmijë, me një çehre të zbetë, të murrëtyer, me buzë të mavijosura. Me sa dukej qe katandisur ashtu nga ethet. Nekludovi u ngrit dhe iu afrua, por çunaku i nguli një vështrim kaq të rreptë, në të njëjtën kohë kaq të vojtur e të munduar, sa Nekludovit s'i bëri zemra ta shqetësonte me ndonjë pyetje dhe, si u kthye përsëri tek plaku, e porositi t'i blente kinina duke shkrojtur në një copë letër emrin e ilaçit. Deshi t'i jepte edhe disa të holla, por punëtori plak i tha se s'qe nevoja se paratë i vinin vetë.

— Kam bredhur shumë në jetën time dhe kam parë shumë, po kurrë s'më ka zënë syri një zotëri si ky. Se ky jo vetëm që nuk të dëbon, po të lëshon dhe vendin. Demek,

edhe këta zotërinjtë qënkan gjithfarësh — e përfundoi ai duke iu drejtuar Tarasit.

«Po, një tjetër botë, një botë krejt e re», — mendonte Nekludovi duke ua hedhur sytë gjymtyrave të thata, musklave të punëtorëve, rrobave që ua kishin qepur gratë, fytyrave të tyre të pjekura nga dielli, të thjeshta e të lodhura, e, duke e ndjerë veten si të rrethuar nga të gjitha anët nga disa njerëz të rinj, me interesat e tyre serioze, me gëzimet dhe vuajtjet e tyre të vërteta, me vështirësirat e një jete me të vërtetë të denjë për njeriun.

«Ja, le vrai grand monde», — mendonte Nekludovi, duke sjellur ndërmënd frazën që kishte shqiptuar princi Korçagin, si edhe atë botën luksoze dhe boshe të Korçaginëve, me ato interesat e saja të ulëta e të kota.

Ai provonte tani atë gëzimin e udhëtarit që ka zbuluar një botë të re, një botë të mrekullueshme e të panjohur.

Fundi i pjesës së dytë.

PJESA E TRETË

I

Kolona në të cilën ndodhej Masllova kishte bërë thuaj pesë mijë vjorsta rrugë. Gjer në Permi, si në tren ashtu edhe në vapor, Masllova kishte udhëtuar bashkë me të burgosurit ordinerë por, kur arritën në këtë qytet, Nekludovi u përpoq dhe ja arriti që ta transferonin në seksionin e të burgosurve politikë, ashtu siç e kishte këshilluar Boguduhovskaja, që udhëtonte edhe ajo vetë me ata.

Udhëtimi gjer në Permi kish qënë shumë i vështirë për Maslloven qoftë fizikisht, qoftë edhe moralisht. Fizikisht, se vëndi qe i ngushtë, ambienti i ndyrë dhe insektet të neveritshëm, që nuk e linin rehat, dhe moralisht, se burrat, jo më pak të neveritshëm se insektet, ndonëse qenë të ndryshëm në çdo kohë të udhëtimit, e mërzitnin tamam si ata dhe nuk e linin rehat. Midis të burgosurve dhe të burgosurave, midis gardianëve dhe ushtarëve që i shoqëronin, ish rrënjosur një cinizëm aq pa cipë, sa gratë, sidomos të rejat duhej të kishin gjithnjë mëndjen që mos të binin në këtë zvetnim të përgjithshëm. Të rroje kështu gjithnjë me frikë dhe me sytë katër, ishte vërtet shumë e rëndë dhe më tepër nga të gjithë këtë e ndjente Masllova, të cilën burrat e ngacmonin edhe më shumë, qoftë se ishte shumë e bukur, qoftë edhe për të shkuarën e saj, që ja njihnin të gjithë. Ajo u bënte ballë me ngulm atyre ngacmimeve dhe këtë kundërshtim burrat e quanin si një fyerje personale, ndaj edhe çdo ditë e më tepër shtohej mëria kundër saj dhe lakmia për ta shtënë në dorë. Dhe do ta kish patur vërtet pisk po mos të ndodhej me Fedosjen e mirë dhe me Tarasin që, sapo mësoi rreziqet që e kërcënonin të shoqen dhe për të mbrojtur nderin e saj, që nga Nizhni-Novgorod kërkoi të udhëtonte bashkë me të dënuarit e tjerë.

Transferimi në seksionin e të burgosurve politikë e përmirësoi krejt gjëndjen e Masllovës. Ta lëmë se këta të



burgosur strehoheshin dhe ushqeheshin më mirë, trajtoheshin më me njerëzi, po transferimi i Masllovës në atë seksion e lehtësonte gjëndjen e saj dhe e çlironte nga ato ndjekjet e paprera të burrave, që i kujtonin or' e çast të shkuaren e saj të hidhur. Por, përveç kësaj, kishte dhe një përfitim tjetër, ndoshta edhe më me rëndësi: Masllova pati fatin të njihej me dy njerëz që do të ushtronin në tërë jetën e saj një ndikim vendimtar.

Vetëm në pushimet e ndryshme Masllova mund të qëndronte me të burgosurit politikë, po rrugën do ta bënte në këmbë me gjithë të burgosurit e tjerë ordinerë, se ishte e re dhe e shëndoshë. Bashkë me të ecnin gjithashtu edhe dy të dënuar politikë: Maria Pavllovna Shçetinina, një vajzë me sy çuditërisht të bukur dhe e qetë, që i kishte bërë shumë përshtypje Nekludovit në takimin me Boguduhovskajen, si edhe një farë Simonsoni, një meso burrë leshtor e i zeshkët, me gropat e syve të futura thellë ndër ballë, që e internonin në krahinën e Jakutskut, të cilin Nekludovi e kishte vënë re për herë të parë gjatë këtij udhëtimi. Maria Pavlovna ecte në këmbë sepse ja kishte lëshuar vëndin në qerre një të burgosure ordinere me barrë, kurse Simonsoni — sepse nuk desh të përfitonte nga një privilegj klase, që sipas tij ishte i padrejtë. Ai dhe të dy gratë, veç nga të burgosurit e tjerë politikë, që vinin më vonë me qerre, ngriheshin që në mëngjes e viheshin n'udhë bashkë me të burgosurit ordinerë. Kështu ata kishin vazhduar gjersa arritën në një qytet të madh, ku kolonën e të burgosurve e mori në dorëzim një oficer tjetër.

Ishte një mëngjes shtatori i ngrysur e plot lagështi. Binte një shi i përzier me borë dhe frynte me furi një erë e ftohtë. Të gjithë të burgosurit që bënin pjesë në kolonë, katërqind burra dhe nja pesëdhjetë gra, ishin grumbulluar në oborrin e burgut të përkohshëm, ku një pjesë e tyre qenë rrjeshtuar përpara një nënoficeri i cili u shpërndante përgjegjësve të grupeve të hollat për dy ditë ushqim; pjesa tjetër ishte duke blerë ndonjë gjë për të ngrënë tek disa gra që kishin marrë leje ta shitnin mallin e tyre në oborr të burgut, që gumëzhinte nga zërat e të burgosurve, të cilët numëronin të hollat e blinin ushqime për rrugë, dërdëllisnin ose grindeshin shok me shok apo me shitësët.

Katjusha, bashkë me Maria Pavllovnën, që të dyja të veshura me çizme e me nga një gozhup të shkurtër, me kokën të mbështjellur me shami, duallën nga burgu në oborr

dhe u drejtuan tek shitësët që, për t'u mbrojtur nga era, kishin zënë vënd rrëzë murit dhe u reklamonin myshtërinjve mallin e tyre: gjizë të freskët, peshk, kashë, mëlçi, mish dashi, vezë, qumësht; njëra prej tyre shiste bile edhe derrkuc të pjekur.

Simonsoni, i veshur me një bluzë dhe me një palë galloshe gome që i kishte shtrënguar nga sipër me spango (Simonsoni ishte vegjetarjan dhe mendonte se ishte givnah të përdorje lekurën e kafshëve të vrara,) kish dalë edhe ai në oborr për të pritur nisjen e kolonës. Atë çast qe mbështetur tek parmaqet e shkallës dhe po shënonte në një bllok një mendim që iu shkrep.

«Sikur — shkruante ai — një bakter të kishte mundësi të vrente e të studjonte thoin e njeriut, ai do të arrinte pa tjetër në përfundimin se kishte të bënte me një lëndë organike. Po kështu edhe ne, duke studjuar tokën, po të vrenim vetëm korën e saj, do të arrinim pa dyshim të pohonim se toka përbëhet nga një lëndë jo organike, do të arrinim kështu në një përfundim të gabuar».

Ndërsa Masllova po fuste në trastë vezët, peshkun, vargun me kullure dhe çyrekët e bukës së grurit të ngrohtë që kishte blerë, dhe Maria Pavllovna po i jepte shitëses të holla, një rrëmujë e madhe u bë në oborrin e burgut. Pllakosi një heshtje e përgjithëshme dhe njerëzit filluan të viheshin në rresht. Oficeri që kish marrë në dorëzim kolonën, doli diku në krye dhe dha udhëzimet e fundit më parë se të niseshin.

Pastaj filluan veprimet e zakonëshme: u numëruan të burgosurit, u kontrolluan vargonjtë, u lidhën dy nga dy ata që do të ecnin me pranga në duar. Por, befas, u dëgjua britma e oficerit të xhindosur, zhurma e disa të rrahurave mbi trup dhe e qara e një fëmije. Heshtja ra përsëri për një çast dhe pastaj një pëshpëritje e mbytur kaloi gojë me gojë. Masllova dhe Maria Pavllovna rendën te vëndi i ngjarjes.

II

Kur u afruan te vendi i përleshjes, Maria Pavllovna dhe Katjusha vunë re se oficeri, i cili ishte një burrë shpatullgjerë e i shëndoshë me një palë mustaqe të verdha e të gjata, po fërkonte me dorën e majtë pëllëmbën e djathtë që e kishte vrarë kur qëlloi në fytyrë një të burgosur dhe,

në të njëjtën kohë, këpuste ca të shara të rënda e të ndyra. Përpara tij, duke fshirë me njerën dorë gjakun që i rridhte nga fytyra e duke mbajtur me dorën tjetër një vajzë të vogël, mbështjellur kokë e këmbë me një shall, qëndronte një i burgosur i gjatë e i thatë, me gjysmën e kokës të rruar, me një kapotë të shkurtër dhe me një palë pantallona të shkurtëra, që ulurinte me një zë të ngjirur e të hollë.

— Ta tregoj unë ty (i jep një të sharë të ndyrë), ta tregoj unë ty (prapë një të sharë) të flasësh tjetër herë... Do t'ua japësh grave, — ulërinte oficeri. — Vëri hekurat!

Oficeri kërkonte t'ja lidhnin duart atij të burgosuri sadoqë nuk ishte ndonjë kriminel i rrezikshëm por vetëm një i internuar i thjeshtë dhe sadoqë gjatë gjithë rrugës e kishte mbajtur vetë në krah vajzën që i kishte lënë e shoqja, e cila kishte vdekur nga tifua në Tomsk. I burgosuri kishte kundërshtuar dhe kish thënë se me duart e lidhura nuk kishte si ta mbante vajzën, po oficeri, që kish qënë edhe më parë i nxehur, mori inat dhe më tepër dhe e dërmoi me grushte të burgosurin që kish guxuar të kundërshtonte urdhërin e tij. [1])

Pranë oficerit ndodhej një ushtar dhe një i burgosur mjekërzi që mbante një prangë të varur në njërën dorë, i cili i hidhte sytë e zymtë herë oficerit dhe herë shokut të tij fatkeq, babait të vajzës. Oficeri ja përsëriti ushtarit urdhërin për t'ja hequr të burgosurit vajzën. Pështëritjet e të burgosurve bëheshin gjithnjë më të forta.

— Gjer në Tomsk i zgjidhur ka qënë, — u dëgjua një zë i ngjirur nga radhët e fundit.

— Është fëmi, s'është këlysh...

— E ku ta lërë ai i ziu të voglën?

— Kjo është kundra ligjit, — tha dikush.

— Kush foli kështu? — thirri oficeri si ta kishin shpuar më gjilpërë dhe çau turmën. — Ta tregoj unë ligjin! Kush qe ai që foli? Mos ishe ti? Mos ishe ti?

— Të gjithë folën, sepse... — tha një i burgosur shpatullgjërë e i shkurtër.

Por s'e mbaroi dot fjalën. Oficeri iu hodh në grykë dhe e shqepi me grushte në fytyrë me të dy duart.

— Kryengritje dashkeni të bëni ju? Jua tregoj unë kryengritjen. Do t'ju çfaros të gjithëve si mizat. Do t'u

---

1) Ngjarja e përshkruar në librin e D. A. Linevit: «Nëpër qëndresë» (Sh. I Tolstoit).

pushkatoj! Dhe autoritetet do të ma dinë për nder, për nder, posi! Hiqjani vajzën!

Të gjithë heshtën. Një ushtar ja shkëputi me forcë të burgosurit nga duart vajzën që s'pushonte së qari, një tjetër i mbërtheu prangat të dënuarit që i shtriu vetë duart këtë radhë pa kundërshtuar.

— Shpjere te gratë! — e urdhëroi oficeri ushtarin, duke ndrequr rripin e shpatës.

Vajza që përpiqej t'i nxirrte doçkat nga shalli qe nxirë nga të qarit e ulurinte pareshtur. Atë çast Maria Pavllovna u çkëput nga turma e iu afrua oficerit.

— Zoti oficer, po të më lejoni, e marr unë vajzën.

Ushtari që mbante vajzën u step.

— Ti kush je? — pyeti oficeri.

— Një e burgosur politike.

Fytyra e bukur e Maria Pavllovnës, me ata sytë e saj të mëdhenj e me flokët e zes, duket se e goditi atë oficer, që e kish vënë re edhe më parë, kur kishte marrë në dorëzim të burgosurit. Ai ja nguli sytë edhe një herë, pastaj uli kokën i turpëruar.

— Për mua është njëlloj, merreni po të doni. Ju vjen keq, për këta rezila, eh? Ama, po të ikin, nuk përgjigjeni ju...

— Po si mund të iki me vajzën në krah? — tha Maria Pavllovna.

— S'kam kohë të merrem me ju. Merreni vajzën, po të doni dhe ikni.

— A t'ja jap? — pyeti ushtari.

— Jepja!

— Eja me mua, — i tha Maria Pavllovna vajzës, duke e marrë me të mirë.

Po vajza, që desh të shkonte me t'anë, lëshoi një ulurimë dhe nuk deshi t'i qasej Maria Pavllovnës.

— Dale, Maria Pavllovna, mbase do me mua, — ndërhyri Masllova dhe nxori nga trasta vargun e kullureve.

Vogëlushja, që e kishte parë Masllovën dhe herë tjetër, kur pa dhe kulluret i shkoi menjëherë.

Pllakosi përsëri heshtja. Dyert u hapën dhe kolona e të burgosurve doli jashtë dhe u rrjeshtua; pastaj u përsëritën edhe një herë veprimet e zakonshme: numërimi i të burgosurve, lidhia e trastave, pregatitja për rrugë, vendosja e atyre që ishin të dobët e të sëmurë mbi qerre. Masllova me vajzën në krah, kishte hyrë në rreshtin e grave, pranë Fedosjes. Simonsoni, që e kishte ndjekur që nga fillimi



gjithë skenën, iu afrua me hapa të mëdha e të vendosura oficerit që, pasi i kishte dhënë të gjitha udhëzimet, po hipte tani në karrocën e tij.

— U suallët keq, zoti oficer, — tha Simonsoni.

— Ju shkoni në vend! S'është puna juaj!

— E kam për detyrë t'jua them, dhe jua përsëris, se u suallët keq, — tha Simonsoni dhe ja nguli sytë oficerit nën vetullat e tij të dendura.

— Gati? Kolona, marsh! — thirri oficeri, pa ja vënë veshin Simonsonit dhe, si u kap pas shpinës së ushtarit që ngiste kuajt, hipi në karrocë.

Kolona lëvizi dhe doli në rrugën me baltë, që kish kanale të thella nga të dy anët dhe që kalonte mespërmes një pylli të dëndur.

III

Pas asaj jete të përdhosur, tërë lluks dhe të ndytë, që kishte bërë në ato gjashtë vjetët e fundit në qytet, dhe atyre dy muajve që kishte kaluar në burg me të burgosu it ordinerë, jeta tani me të dënuarit politikë, sado e vështirë, i dukej Katjushës shumë e këndëshme. Marshimet prej njëzet gjer më tridhjetë vjorste në ditë, ushqimi i mirë dhe një ditë pushim në çdo dy ditë, e kishin forcuar fizikisht; nga ana tjetër të qënët me ata shokët e rinj i hapte jetës së saj një horizont të ri e të papritur. Ajo jo vetëm që nuk kishte njohur kurrë, siç thosh vetë, njerëz aq të «jashtëzakonshëm» por as që e merte me mënd se mund të kishte në botë si këta.

— Qava, kur më dënuan, — thoshte, — kurse duhet t'i kisha falenderuar një mijë herë ata që më dënuan, sepse ndryshe mbase s'do t'i kisha mësuar kurrë tërë ato që mësova.

Ajo i kuptoi lehtë dhe pa e vrarë shumë mëndjen arësyet që i kishin shtyrë ata njerëz të vepronin ashtu siç kishin vepruar dhe, meqë rridhte nga një shtresë e ulët e shoqërisë, u pajtua menjëherë me idetë e tyre. E kuptoi se ata mbronin popullin kundra sundonjësve dhe duke qënë vetë të pasur e zotërinj, kishin sakrifikuar privilegjet, lirinë dhe jetën e tyre për të mirën e popullit, ndaj ajo i çmonte dhe i admironte me gjithë shpirt.

Ajo i admironte të gjithë shokët, po sidomos Maria Pavllovnën, të cilën jo vetëm e admironte, por edhe e donte me një dashuri të veçantë e plot respekt. Ajo habitej kur

vinte re se si kjo vajzë kaq e bukur dhe e pasur, e bija e një gjenerali, që fliste tri gjuhë, sillej si të qe ndonjë punëtore e thjeshtë, ua shpërndante të tjerëve të gjitha të hollat që i dërgonte i ati i saj i pasur dhe vishej e mbathej, jo thjesht, po bile shumë keq, pa u bërë fare merak a dukej mirë apo jo. Kjo cilësi, d.m.th. mungesa e plotë e çdo përkujdesi për të shkëlqyer mes njerëzve e habiste sidomos Masllovën më tepër se çdo tjetër dhe e bënte të anonte përfundimisht nga ai admirimi i pakufizuar që kishte karshi saj. Masllova e shihte që Maria Pavllovna e dinte se ishte e bukur dhe bile i vinte mirë, megjithatë ajo vetëm nuk gëzohej kur vinte re përshtypjen që bënte tek burrat pamja e saj por, përkundrazi, i trëmbej kësaj përshtypjeje dhe i vinte frikë e pështirë që të dashurohej me ndonjërin prej tyre. Shokët e saj, që ja dinin këtë, edhe po të binin në dashuri me të, n'asnjë mënyrë nuk i lejonin vetes t'ja çfaqnin këtë dashuri dhe silleshin me të si me ndonjë burrë, si me ndonjë shok të tyre. Por burrat që nuk e njihnin i vardiseshin dëndur dhe nga ato ndjekjet e tyre të mërzitëshme e kishte shpëtuar gjer ahere, siç tregonte, vetëm forca e madhe fizike me të cilën i pëlqente shpesh herë të mburrej. «Një herë, — tregonte ajo duke qeshur — në rrugë m'u ngjit pas një zotni dhe nuk më çqitej. Atëhere unë iu ktheva e kapa me të dy duart dhe e shkunda nja dy a tri herë kaq fort sa ai u tmerua dhe ua mbathi këmbëve menjëherë».

Ajo kishte hyrë në radhët e revolucionarëve sepse, siç tregonte, që së vogëli e neveriste jeta e zotërinjve dhe i pëlqente jeta e njerëzve të thjeshtë. Në shtëpi gjithmonë e qortonin sepse rrinte më tepër në dhomat e shërbëtorëve, në kuzhinë dhe në stallë se sa në dhomën e bukës apo në sallon.

— Kurse me gjellëbërëset dhe karrocierët unë e kaloja shumë mirë dhe mërzitesha shumë kur më detyronin të rrija në sallon me damat dhe me zotërinjtë, — thoshte ajo. — Më vonë, kur fillova të kuptoj, e pashë se sa e keqe ishte jeta që bëhej në shtëpinë tonë. Mëma më kishte vdekur, babanë nuk e doja. Kur u bëra nëntëmbëdhjetë vjeçe, ika nga shtëpia bashkë me një shoqe dhe hyra punëtore në një fabrikë.

Si kishte dalë nga fabrika kishte banuar në fshat dhe më vonë qe kthyer në qytet, në një shtëpi ku ndodhej një tipografi ilegale; atje e kishin arestuar duke e dënuar më vonë me punë të detyruar. Maria Pavllovna nuk e kishte thë-

në kurrë vetë, por Katjusha e dinte nga të tjerët se Maria Pavllovnën e kishin dënuar me punë të detyruar, sepse e pati marrë përsipër vetë fajin për vrasjen e një xhandari që në të vërtetë ish vrarë nga një e shtënë në errësirë gjatë rrethimit të shtëpisë prej një revolucionari tjetër.

Që kur e kishte njohur, Katjusha kishte vënë re se kudo dhe në çfarëdo rrethane që të ndodhej, ajo nuk mendonte kurrë për veten e saj por kurdoherë bëhej merak vetëm e vetëm se si t'u bënte ndonjë të mirë e t'u vinte në ndihmë me sa mundte të tjerëve. Një nga shokët e saj të burgut, Novodvorovi, thoshte për të me shaka, se i kishte hyrë në qejf «sporti i vetmohimit». Kjo ishte e vërtetë. I vetmi qëllim i saj në jetë ishte si e si të gjente rast për të bërë të mira ashtu si gjahtari bën çmos të ndjellë prejen e tij. Por këtë e bënte me aq thjeshtësi sa të gjithë ata që e njihnin përfitonin nga vetëmohimi i saj.

Kur Masllova u bashkua me ta, Maria Pavllovna kishte ndjerë ndaj saj neveri e të përshtirë. Katjusha e kishte vënë re, por më vonë kishte kuptuar gjithashtu se Maria Pavllovna e kish mbajtur veten dhe kish filluar të sillej me të me një kujdes e me një përzëmërsi të veçantë. Kujdesi dhe përzëmërsia e një gruaje aq të thjeshtë, siç ishte Maria Pavllovna, e prekën Masllovën kaq shumë sa ajo iu dorëzua asaj me mish e me shpirt duke i përvetësuar në një mënyrë të pavetëdijëshme pikëpamjet e saj dhe duke u munduar t'i ngjante pa dashur në të gjitha. Kjo dashuri e pastër e Katjushës nuk kishte se si të mos e prekte Maria Pavllovnën, e cila filloi të ndjente për të një dashuri të vërtetë.

Të dy gratë i bashkonte gjithashtu edhe neveria që provonin për dashurinë seksuale. Njera e urrente këtë dashuri se e kishte njohur mirë tërë tmerrin e saj; tjetra — se nuk e kish njohur, ndaj nuk ishte në gjëndje ta merrte me mend; po, edhe sikur ta merrte me mënd, i dukej si diçka e përshtirë, që poshtëronte dinjitetin e njeriut.

IV

Maria Pavllovna ushtronte një ndikim të madh mbi Masllovën ngaqë ajo e donte shumë këtë vajzën e re. Po edhe një ndikim tjetër, kish lënë vragë mbi Masllovën: ndikimi i Simonsonit ngaqë ky e dashuronte Masllovën.

Të gjithë njerëzit rrojnë dhe veprojnë, herë sipas mendimeve të tyre dhe herë sipas mendimeve të të tjerëve. Një nga ndryshimet kryesore tek ata qëndron në atë se sa njerëzit rrojnë sipas mendimeve të tyre ose sipas mendimeve të të tjerëve. Disa, në të shumtën e rasteve, mendimet e tyre i vërtitin si një lojë mendore, të gjykuarit e përdorin si ndonjë rrotë ingranazhi, nga e cila është hequr rripi i transmetimit dhe, në sjelljet e tyre, u nënshtrohen ndikimeve që ushtrojnë mbi ta mendimet e të tjerëve: zakoneve, traditave, ligjeve; kurse disa të tjerë, duke pranuar se mendimet duhet të jenë për njeriun, burimi i vetëm për çdo veprimtari praktike, u vënë veshin kurdoherë kërkesave të arësyes së tyre dhe u nënshtrohen duke ndjekur vetëm me të rrallë dhe, në çdo rast, pas një kritike paraprake, ndonjë shëmbull të jashtëm. I tillë ishte dhe Simonsoni. Ai çdo gjë ja nënshtronte arësyes, e zgjidhte me anë të logjikës së fjalës, vendoste siç i thosh arësyeja e tij dhe, me të marrë një vendim e vinte menjëherë në jetë.

Kur qe student në gjimnaz, e kuptoi se i ati, një gjykatës i pasur, nuk e kishte fituar me nder pasurinë e tij, ndaj i tha se e kishte për detyrë t'ja kthente përsëri popullit. Kur i ati, jo vetëm që nuk e dëgjoi, por e qërtoi, ai iku nga shtëpia dhe u prish me të. I bindur se injoranca e popullit ishte burimi i të gjitha të zezave, me të dalë nga universiteti ai u bashkua me narodnikët, u bë mësues në një fshat dhe fliste haptazi me nxënësit e fshatarët si të mbronin të vërtetën dhe të shtypnin gënjeshtrën. E kishin arrestuar dhe dërguar në gjyq.

Ai mendonte se gjyqi nuk kishte të drejtë ta gjykonte, dhe këtë ua tha haptas gjykatësve. Kur këta nuk pranuan mendimin e tij dhe vazhduan ta gjykonin, ai vendosi të mos përgjigjej dhe nuk hapi gojë gjersa e dënuan. E syrgjynosën në gubernën e Arkangelsit. Atje ai kish përpunuar për veten e tij një doktrinë fetare dhe sillej në jetë tamam sipas kësaj gjer në hollësirat më të vogla. Sipas kësaj doktrine fetare, në botë çdo gjë është e gjallë, nuk ka asgjë të vdekur, dhe të gjitha objektet që neve na duken të vdekura, inorganike, nuk janë tjetër veçse pjesët e një trupi të madh organik të cilin ne nuk jemi në gjendje ta përqafojmë; prandaj detyra e çdo njeriu, duke qenë ky një thërrmijë e vogël e këtij organizmi të madh, është që ta ruajë jetën e këtij organizmi dhe të të gjithë pjesëve të gjalla që e përbëjnë. Për këtë arësye do të ishte një krim të zhdukje një qënje të

gjallë, dhe ai vetë ishte kundër luftës, kundër dënimeve me vdekje dhe kundër të gjitha vrasjeve, jo vetëm të njerëzve, por edhe të kafshëve. Edhe në lidhje me martesën ai kishte një teori të tijën të veçantë, sipas së cilës shtimi i njerëzve është një nga funksionet e ulta të njeriut, kurse funksioni më i lartë për të është t'u shërbejë qënieve të gjalla. Kjo teori vertetohej më së miri edhe nga roli që luanin globulet e gjakut në trupin e njeriut. Njerëzit e pamartuar, sipas mendimit të tij, ishin tamam si ato globulet e gjakut që kishin për detyrë të ndihmonin pjesët e dobëta apo të sëmura të organizmit. Me të krijuar këtë teori, e kish vënë në jetë sadoqë, në të ri, kish qenë i përdhosur. Tani, si veten ashtu edhe Maria Pavllovnën, ai i quante një fagocit shoqëror.

Dashuria që ndjente për Katjushën, nuk ishte në kundërshtim me këtë teori, se ai dashuronte në një mënyrë platonike dhe mendonte se një dashuri e tillë, jo vetëm nuk e pengonte veprimtarinë e fagocitëve shoqërorë për të mirën e njerëzimit, por bile, e nxiste edhe më tepër.

Ai kishte zgjidhur, sipas mëndjes së tij, jo vetëm këto çështje themelore të moralit, por, gjithashtu, edhe një numur të madh çështjesh praktike. Të gjithë veprimtarinë praktike e kishte mbërthyer në disa rregulla që i kishte caktuar vetë. Kështu kishte një rregull për kohën e punës, një rregull për kohën e pushimit e rregulla të tjera për ushqim, për t'u veshur, për të ndezur sobën e për të ndriçuar dhomat.

Prapseprapë, Simonsoni ishte shumë i ndrojtur dhe i përulur me njerëzit. Por, kur e vendoste një gjë, s'kish zot që ta ndalonte për ta zbatuar.

Ja, ky ishte njeriu që, duke e dashuruar Masllovën, mundi të ushtrojë mbi të një ndikim aq vendimtar. Masllova, me atë instinktin e saj femëror, e kuptoi sakaq dhe mburrej kur sillte ndërmend se kish mundur të bëjë të dashuronte një njeri aq «të jashtëzakonshëm». Kur Nekludovi i tha se do ta merrte për grua, Masllova e kishte kuptuar menjëherë se kështu ai donte të tregohej shpirtmadh dhe të ndreqte gabimin që kish bërë, kurse Simonsoni e dashuronte ashtu siç qe tani, dhe e dashuronte jo për njerën apo tjetrën arësye, por sepse e ndjente këtë dashuri. Gjithashtu Masllova kish vënë re se Simonsoni e dashuronte dhe për ato cilësitë e larta morale që kish zbuluar tek ajo, të cilat rrallë mund t'i gjejë te ndonjë grua tjetër. Se cilat qenë pikërisht këto vetija as vetë Masllova nuk e dinte, por, sidoqoftë, që ai të ishte i bindur në shpresat e tij, ajo bënte

çmos për t'u pajisur me ato cilësira që mendonte se ai i çmonte më tepër se çdo gjë tjetër. Kështu Masllova me sa mundte përpiqej që të ishte sa më e mirë.

Ky proçes kishte filluar në shpirtin e Masllovës që në burg, kur, gjatë takimeve me të burgosurit politikë, ajo kish vënë re se si e vështronin me ngulm, nën ballin e lartë e vetullat e dëndura, ata syt' e tij të kaltër, të butë e të padjallëzuar. Ajo vuri re që atëhere se ai nuk ishte si gjithë të tjerët dhe se nuk e shikonte si ata; vuri re gjithashtu kontrastin e çuditshëm t'asaj fytyre të rreptë, me flokët e ngritura e me vetullat e vrënjtura, me thjeshtësinë fëminore dhe me kthjelltësinë shpirtërore që shquhej në vështrimin e tij. Më vonë, në Tomsk, kur e transferuan në seksionin politik, ajo e pa atë përsëri. Sadoqë nuk kishin shkëmbyer asnjë fjalë, prapseprapë vetëm vështrimi i tyre thoshte se e mbanin mënd dhe s'do ta harronin kurrë njëri tjetrin. Ndonjë bisedë të rëndësishme mes tyre nuk pati as më vonë, por Masllova e ndjente se, kur ai fliste në sy të saj, fliste më tepër për të se sa për të tjerët, duke u munduar të shprehej në një gjuhë sa më të kuptueshme. Marëdhëniet e tyre u bënë edhe më të ngushta që ditën kur filluan të udhëtonin në këmbë bashkë me të burgosurit ordinerë.

V

Që nga Nizhni gjer në Perni Nekludovi mundi të takohej me Katjushën vetëm dy herë: një herë në Nizhni, në dhomën e takimeve të burgut përpara se të burgosurit të çoheshin në një barakë të rrethuar me tela dhe një herë tjetër në Perni, prapë në dhomën e takimeve të burgut. Në të dyja këto takime, ajo i kish ndënjur pa folur e me inat. Kur ai e kish pyetur a e ndjente veten mirë dhe a kishte nevojë për ndonjë send, ajo i kish bërë bisht pyetjeve si e revoltuar kundër tij, dhe ish sjellë si me neveri. Këtë bile ai e kishte vënë re edhe më parë tek ajo. Kjo gjëndje e saj shpirtërore e zymtë që kish lindur nga ngacmimet e vazhdueshme të burrave që i binin më qafë dhe s'e linin rehat atë kohë, e kishte hidhëruar Nekludovin sa s'ka. Ndën ndikimin e atyre kushteve të rënda e degjeneruese që kishte vënë re gjatë udhëtimit, ai kish frikë se mos ajo kthehej përsëri n'atë gjëndjen e mëparëshme, që ja shtonte

urrejtjen kundër tij dhe e shtynte që t'i harronte të gjitha, të pinte verë e duhan pa hesap. Por ai nuk kishte se si ta ndihmonte sepse, gjatë gjithë kohës së udhëtimit nuk pati asnjë mundësi të takohej me të. Vetëm pasi Masllovën e transferuan në seksionin e të burgosurve politikë, ai u bind se dyshimet dhe frika e tij kishin qënë fare të kota e, bile vinte re, se ai ndryshim i brëndëshëm të cilin e priste të ndodhte tek ajo me aq padurim, po mirrte tani disa trajta përher'e më të spikatura. Në takimin e parë në Tomsk, ajo u suall me të ashtu siç qe sjellë edhe ditën e nisjes nga burgu: nuk u vrënjt e nuk u turbullua kur e pa, por përkundrazi, e priti mirë dhe e gëzuar, duke e falënderuar për të gjitha sa kish bërë për të dhe, veçanërisht, për transferimin e saj në seksionin e të burgosurve politikë.

Pas dy muaj udhëtimi, u vu re tek ajo një ndryshim edhe në pamjen e jashtme: ishte dobësuar e nxirë nga dielli dhe sikur qe plakur, në tëmbla dhe rreth gojës ravizoheshin disa zhubra të lehta, flokët nuk i mbante më të lëshuara mbi ballë, si dikur, por i lidhte me shami, dhe ajo që binte në sy më tepër, të veshurit, të krehurit, sjellja me njerëzit nuk tregonin më tiparet e një femre mëndjelehtë. Ky ndryshim që kish ndodhur e që vazhdonte të ndodhte në shpirtin e saj ngjallte parreshtur tek Nekludovi një gëzim të veçantë.

Atij i kish lindur tani një ndjenjë që s'e kishte provuar kurrë më parë, po që nuk kishte të bënte aspak me atë dashurinë poetike që pat ndjerë dikur për të, dhe aq më pak me dashurinë seksuale që kish provuar më vonë. Atij vetëm i vinte keq e ndjente dhëmshuri, si ajo që kishte provuar kur qe takuar për herë të parë me të në burg, dhe më vonë fill pas dëbimit të Masllovës nga infermieria kur ai ja kish falur gabimin në atë «historin» e çpifur me ndihmës mjekun, që, siç doli në shesh më vonë, nuk kish qenë e vërtetë; ishte pikërisht po ajo ndjenjë, me të vetmin ndryshim se atëhere kish një karakter të përkohëshëm, kurse tani qe bërë e qëndrushme. Tani, me çfardo pune që të merrej, me cilindo që të bisedonte, gjendja shpirtërore e tij lidhej kryesisht me atë keqardhje e dhëmshuri që ai ndjente jo vetëm kundrejt saj, por edhe kundrejt të gjithë njerëzve të tjerë, pa përjashtim.

U duk, pra, sikur në shpirtin e Nekludovit u çel burimi i asaj dashurie që e kish mbajtur mbyllur më parë në vetvete dhe që tani po e çfaqte tek gjithë njerëzit me të cilët ai takohej.

Gjatë tërë kohës së udhëtimit, Nekludovi e ndjente veten në një gjëndje ekzaltimi të posaçëm që e shtynte të tregohej i dashur e i kujdesëshëm me të gjithë njerëzit, me të cilët kishte të bënte, duke filluar nga karrocjeri e nga rojet e të burgosurve, gjer te drejtori i burgut dhe guvernatori.

Në këtë kohë e sipër, sidomos pas transferimit të Masllovës në seksionin e të burgosurve politikë, Nekludovi pati rastin të njihej me shumë prej tyre, në fillim në Ekaterinburg ku ata i trajtonin disi më lirisht duke i mbajtur që të gjithë së bashku në një qeli të madhe dhe, më vonë, gjatë rrugës, me ato pesë gra dhe ata pesë burra, me grupin e të cilëve qe bashkuar Masllova. Afrimi i Nekludovit me të internuarit politikë solli si pasojë një ndryshim rrënjësor në pikëpamjet që ai kish patur gjer ahere mbi veprimtarin' e tyre.

Që kur lindi për herë të parë lëvizja revolucionare në Rusi dhe sidomos pas një marsit [1]), Nekludovi i kishte përbuzur gjithnjë revolucionarët e bile i kishte urryer. E revoltonin sidomos egërsia dhe fshehtësia që ata tregonin në luftë kundër qeverisë, e sidomos, vrasjet e tmerrëshme që kryenin si dhe mëndjemadhësia e besimi që kishin të gjithë në drejtësinë e kauzës së tyre. Por kur i njohu më afër, kur pa se si dënoheshin e përsekutoheshin, shpesh herë duke qenë krejt të pafajshëm, ai arriti shpejt në përfundim se ata nuk mund t'ishin ndryshe nga ç'ishin.

Ndonëse torturat që pësonin t'ashtuquajturit të burgosur ordinerë ishin tmerrësisht pavënd, prapseprapë si para dhe pas gjykimit, kundrejt tyre ruhej të pakën ajo hija e formaliteteve ligjore, kurse me të dënuarit politikë nuk ruhej as kjo hije, ashtu siç kishte patur Nekludovi rastin të vinte re në çështjen e Shustovës e, më vonë, në shumë çështje të tjera. Me këta njerëz vepronin ashtu siç vepron peshkatari që tërheq rrjetën dhe e nxjerr në breg, pastaj zgjedh ata peshqit e mëdhenj që i duhen, kurse për të tjerët, për të vegjëlit, që nuk i duhen, nuk çan kokën fare, por i lë të ngordhin e të thahen në rërë. Kështu, duke arrestuar me qindra njerëz, të cilët dukej sheshit se jo vetëm që nuk qenë fajtorë, por edhe se nuk mund të ishin n'asnjë mënyrë të rrezikshëm për qeverinë, ata i mbanin

---

1) 1 Marsi 1881 është data e vdekjes së carit Aleksandri i II, i cili u vra nga një bombë që i hodhën nikilistët (Shënim i përk).

me vjete nëpër burgje gjersa sëmureshin nga tuberkulozi, ose çmëndeshin ose vrisnin veten; i mbanin vetëm sepse nuk kishin ndonjë arësye që t'i lironin dhe, nga ana tjetër, duke qenë në burg, do të mund të jepnin informata e prova kundër të tjerëve që do të arrestoheshin rishtas. Fati i këtyre njerëzve, të pafajshëm edhe nga pikpamja krejt ligjore, varej nga qejfi, nga të tekurat, nga shpirtgjerësia e oficerit të policisë, e spiunit, e prokurorit, e hetuesit, e guvernatorit ose e ministrit. Kur ndonjeri nga këta donte të tregohej i zellshëm, apo mërzitej se s'kishte me ç'të merrej, ahere bënte arrestime dhe, sipas gjëndjes shpirtërore në të cilën ndodhej, domethënë, sipas rastit, në qe i gëzuar apo i mërzitur, ose i mbante njerëzit në burg, ose i lironte. Po ashtu edhe eprori më i lartë, sipas rastit, në ja lypte puna të tregohej i zellshëm ose jo, sipas marëdhënieve që kishte me ministrin, ose i dërgonte këta prapa diellit, ose i burgoste në biruca të veçanta, ose i syrgjynoste, ose i dënonte me punë të detyruar apo me vdekje, ose i linte të lirë kur për këtë i lutej, fjala vjen, ndonjë damë. Silleshin kundrejt tyre si në luftë dhe, pra, ishte e natyrëshme që edhe ata të përdornin po ato mjete. Nga ana tjetër, ashtu si ushtarakët rrojnë gjithmonë të rrethuar nga atmosfera e opinionit publik e cila, jo vetëm që ua fsheh atyre tiparet e krimit, por i paraqit këto si heroizma, po ashtu edhe revolucionarët i shoqëronte në çdo hap opinioni publik i rrethit të tyre; të gjitha veprimet çnjerëzore që ata kryenin, duke rrezikuar lirinë, jetën dhe çdo gjë tjetër që është e shtrenjtë për njeriun, jo vetëm që nuk i dënonte, por, përkundrazi, i ngrinte lart si shëmbulla të rralla vetmohimi. Vetëm në këtë mënyrë Nekludovi mund ta spjegonte atë fenomen të çuditshëm kur disa njerëz të pajisur për nga natyra me një shpirt kaq të butë saqë nuk ishin të zotë, jo vetëm t'i shkaktonin, por edhe as t'i shihnin dot vuajtjet që u bëheshin të tjerëve, pregatiteshin me gjakftohtësinë më të madhe për të kryer vrasje dhe, pothuaj që të gjithë, e cilësonin vrasjen në disa rrethana të caktuara, si armë vetëmbrojtjeje e njëkohësisht si një mjet të drejtë e të ligjshëm kur qe fjala për lumturinë e përgjithëshme të njerëzimit. Opinioni që ata kishin për veprimtarinë e tyre dhe, për pasojë, edhe për veten e tyre, rridhte vetvetiu nga rëndësia që u jepte vetë qeveria si edhe nga dënimet e tmerëshme me të cilat i dënonte. Nga ana tjetër pa patur një opinion të tillë për

veten e tyre, ata nuk do të qenë kurrë në gjëndje t'i duronin të gjitha ato që hiqnin.

Duke i njohur më afër, Nekludovi u bind se ata nuk qenë keqbërës me kuptimin e plotë të fjalës, siç i paraqitnin disa, dhe as heronj të kulluar, siç mendonin për ta disa të tjerë, — por qenë njerëz të zakonshëm ndër të cilët, ashtu si kudo, kishte edhe të mirë, edhe të këqij, edhe mesatarë. Kishte ndërmjet tyre nga ata të cilët qenë bërë revolucionarë sepse mendonin serjozisht se e kishin për detyrë të luftonin kundër së keqes që sundonte në shoqëri; por kishte dhe nga ata të cilët e kishin zgjedhur këtë veprimtari të shtyrë nga fodullëku dhe egoizmi; në përgjithësi, shumica qe bashkuar me revolucionin nga një ndjenjë të cilën Nekludovi kishte patur rast ta njihte mirë gjatë luftës. Kjo ishte dëshira që vjen kur jeta rrezikohet orë e çast dhe që e kanë zakonisht të gjithë të rinjtë, sidomos kur janë energjikë. Vihej re, — dhe kjo ishte në dobi të tyre, — se këta ndryshonin nga të tjerët, sepse ishin shumë më të ngritur moralisht. Që të gjithë këta, në përgjithësi, qenë njerëz të matur, të kufizuar në dëshirat e tyre, të drejtë, të sinqertë, të ashpër në jetë dhe kurdoherë të gatshëm për të bërë fli veten e tyre për të mirën e kauzës së përbashkët. Ata që qëndronin përmbi nivelin mesatar qenë me karakter shumë të fort, një shëmbull i shkëlqyer dhe i rrallë lartësimi moral; kurse ata që qëndronin nën nivelin mesatar, ishin shumë të ulët dhe, shpesh herë bëheshin hipokritë, gënjeshtarë e, në të njëjtën kohë, krenarë e të vrazhdë. Kështu, disa nga këta shokë të tij të rinj, Nekludovi i nderonte dhe i donte me gjithë shpirt, kurse të tjerët i shikonte me mospërfillje dhe pothuaj me përbuzje.

VI

Nekludovit i kishte hyrë në zëmër sidomos një djalosh i prekur nga tuberkulozi që bënte pjesë në grupin me të cilin qe bashkuar Katjusha, i quajtur Krilcov, i dënuar me punë të detyruar në Siberi. Nekludovi e kishte njohur që kur ishte në Ekaterinburg dhe më vonë, gjatë udhëtimit, qe takuar e kishte biseduar dendur me të. Njëherë, gjatë verës, Nekludovi kishte kaluar me të pothuaj një ditë të tërë dhe Krilcovi, i dalldisur pas muhabetit, i kishte tre-

guar historin' e tij dhe se si qe bërë revolucionar. Historia e tij gjer kur e kishin futur në burg ishte shumë e shkurtër. I ati, pronar i pasur i një guberne në jugë, kish vdekur kur Krilcovi ishte akoma fëmijë. Ishte djalë i vetëm dhe e kish rritur e ëma. Me mësime kishte shkuar mirë, si në gjimnaz ashtu dhe më vonë n'universitet, në fakultetin e matematikës, ku kishte dalë i pari. I kishin propozuar të qëndronte si pedagog pranë universitetit e të dilte për studime jashtë shtetit. Por ai kish ngurruar të pranonte se dashuronte një vajzë që mendonte ta merrte për grua dhe, përveç kësaj, ëndëronte për ndonjë nëpunësi në Zemstvo. Shumë dëshira i zjenin në kokë, ndaj s'vendoste dot lehtë. Në këtë kohë e sipër shokët e universitetit i kërkuan një shumë të hollash për një organizatë shoqërore. Ai e dinte se kjo ishte organizata e revolucionarëve për të cilën as e kish çarë kokën gjer ahere, por, për mos t'ua prishur qejfin shokëve dhe për mos t'u dukur e të mos mendonin se trembej, ua dha të hollat që i kërkuan. Mirëpo këto të holla i kapën; u gjet bile edhe një pusullë nga u kuptua se i kishte dhënë Krilcovi; e arrestuan, në fillim e mbajtën nën vrejtje në një postkomandë, por më vonë e futën në burg.

— Në burg — i tregoi Krilcovi Nekludovit (ai qe ulur mbi një shtrat të lartë, i kishte mbështetur bërrylet mbi gjunjë dhe vetëm më të rrallë ja hidhte Nekludovit ata sytë e tij të mrekullueshëm, të shndritshëm, të zgjuar e të ëmbël), — n'atë burg ku më futën mua nuk u treguan aq të rreptë: ne, jo vetëm që merreshim vesh me njeri tjetrin duke trokitur në mur, po edhe shëtitnim në koridor, bisedonim, ndanim bashkë ushqimet dhe duhanin e, bile, mbrëmjeve edhe këndonim. Unë kisha zë të mirë. Po. Sikur të mos më vinte keq për nënën — ajo qe pikëlluar shumë nga arrestimi im, — unë nuk do bëhesha merak fare në burg, bile do të kisha patur qejf të rrija aty e nuk do të mërzitesha kurrë. Atje u njoha, ndërmjet të tjerëve, edhe me Petrovin e famshëm (që më vonë vrau vehten në burg, duke u prerë me qelq) dhe me shumë revolucionarë të tjerë. Por unë vetë nuk isha revolucionar. U njoha gjithashtu edhe me dy të burgosur të tjerë që ndodheshin në birucat ngjitur me timen. I kishin zënë me proklamata nëpër duar dhe i kishin dënuar se qenë orvatur të arratiseshin nga kolona e të arrestuarve të tjerë, kur po i çonin me tren. Njeri prej tyre ishte polak dhe quhej Luzinski, kurse tjetri, Rozovski, ishte çifut. Po. Po ky Rozovski ishte pothuaj akoma kalama. Thosh-

te se ishte shtatëmbëdhjetë vjeç, por në të parë s'i jepje as pesëmbedhjetë. Ishte i hollë, thatim, me dy sy të zes që i shkëlqenin parreshtur, shumë i gjallë dhe, si të gjithë çifutet në përgjithësi, kishte shumë vesh për muzikë. Zëri akoma nuk i qe trashur, por prapë këndonte shumë bukur. Po. I pashë të dy kur i muaren që t'i shpinin në gjyq. I muarren një mëngjes herët. Mbrëmanet u kthyen dhe na thanë se i kishin dënuar me vdekje. Këtë s'e priste njeri. Qenë arrestuar për një çështje fare të pa rëndësishme: vertet kishin dashur të iknin, por nuk kishin plagosur njeri. Veç kësaj, ishte e pamundur të dënohej me vdekje një fëmijë, s.ç ishte Rozovski. Ndaj të gjithë ne të burgosurit menduam se i kishin dënuar kështu vetëm sa për t'i trëmbur, po kurrë nuk do t'i ekzekutonin. Në fillim u tronditëm, por pastaj u qetësuam përsëri dhe jeta vazhdoi ashtu siç kishte vazhduar gjer ahere. Po. Por një mbrëmje mbikqyrësi i burgut vjen në derën time e më thotë fshehurazi se kishin arrahur ca zdrukthëtarë për të ndërtuar trikëmbëshat. Unë, në fillim, nuk kuptova gjë. Ç'donte të thoshte? Ç'ishin këto trikëmbëshe? Por mbikqyrësi plak dukej kaq i tronditur sa, kur i hodha sytë, e kuptova menjëherë se qenë për ata dy tanët. Doja të trokitja në mur e t'i vija shokët në dijeni, por kisha frikë se mos më dëgjonin. Shokët gjithashtu nuk ndiheshin. Siç dukej, të gjithë e kishin marrë vesh. Në koridor dhe nëpër birucat pllakosi tërë atë mbrëmje një heshtje prej varri. Nuk trokitëm në mure dhe nuk kënduam. Aty nga ora dhjetë, mbikqyrësi u afrua prapë tek dera ime dhe më tha se kishte ardhur xhelati nga Moska. Kaq më tha dhe u largua. Unë i thirra që të kthehej. Por, befas, dëgjoj zërin e Rozovskit që më thërret nga biruca e tij: «Ç'kini? Pse e thërrisni»? S'më kujtohet mirë se ç'i thashë, po më duket se e gënjeva, i thashë se gjoja e kisha thirrur që të më sillte pak duhan, por ai sikur e kuptoi dhe nisi të më pyeste përse nuk këndonim e përse nuk trokitnim më në mur. Nuk më kujtohet se çfarë iu përgjegja, por e mbaj mënd se u largova nga dera që të mos i flisja më. Po ka qenë një natë e tmerrëshme. Tërë atë natë rrija e përgjoja edhe zhurmën më të vogël. Befas, aty nga mëngjesi, dikush hapi derën e koridorit dhe pastaj u dëgjuan disa hapa që po afroheshin. Qenë shumë. Iu afrova derës dhe pashë nëpër frengji. Në koridor qe ndezur një llambë. Kaloi i pari drejtori i burgut. Më duket se qe një burrë i trashë, mëndjemadh dhe i vendosur. Po kësaj radhe dukej i zbetë

në fytyrë, kishte një çehre të ngrysur e të trëmbur. Pas tij vinte ndihmësi, i zymtë por dhe i vendosur; në fund një roje. Kaluan përpara derës sime dhe u ndalën përpara birucës pranë meje. Vë veshin e dëgjoj ndihmësin që me një zë të cilin s'ja kisha dëgjuar kurre, thërret: «Lozinski, çohuni, vishni ndërresat e pastra!» Po. Pastaj dëgjova derën që kërciti, ata u futën brënda dhe ndjeva hapat e Lozinskit. Unë shikoja vetëm mbikqyrësin. Që zbehur dhe tërë atë kohë mbërthente e zbërthente pullat e ngrinte supet. Po. Befas, u hoq mënjanë si i trëmbur: n'atë çast kaloi pranë tij Lozinski, i cili iu afrua derës sime. Lere se ç'djalë ishte! Shpatullgjerë, me ballin dy pëllëmbë, flokëverdhë me kaçurrela të holla e të gjata. Sytë i kishte të kaltër, të bukur. Dhe që i shëndoshë, i pashëm, i zhdërvjellët e i shkathët. Një nga ata tipat e bukur të racës polake. Ai qëndroi përpara frëngjisë sime, kështuqë tani e kisha ballë-përballë. Ç'të shihje? Një fytyrë të ngrirë, të nxirë, të llahtarëshme! «Krilcov, mos ke ndonjë cigare?» U mata t'i jap, po ndihmësi, sikur trëmbej se mos bëhej vonë, nxori mënjëherë tabakerën e tij dhe ja zgjati. Ai mori një cigare, ndihmësi ja ndezi me shkrepse. Thithte cigaren dhe sikur mendohej. Pastaj sikur diç iu kujtua dhe nisi të thotë: «Ky është një veprim mizor e i padrejtë. Unë nuk kam bërë ndonjë krim. Unë. . .» Diç lëvriu e u drodh atë çast n'atë gushën e tij të bardhë e të freskët nga e cila unë nuk i hiqja sytë, dhe ai u ndal. Po. Atë çast dëgjoj zërin e hollë prej çifuti të Rozovskit që thërriste nga koridori. Diç thoshte, por nuk arrija të kuptoja. Lozinski e flaku bishtin e cigares dhe u largua nga dera. Përpara frëngjisë sime u dha atë çast Rozovski. Fytyra e tij fëminore, me ata syt' e zes e të njomur, dukej e skuqur dhe e dirsur. Edhe ai kishte veshur ndërresa të pastra, por pantallonat i rrinin shumë të gjera dhe i tërhiqte lart me të dy duart ndërsa drihej i tëri. Ai e afroi fytyrën e tij të zbetë tek frengjia ime: «Anatoli Petroviç, nuk është e vërtetë që doktori më ka dhënë ilaçe për të pirë? Unë jam i sëmurë, unë pi akoma ilaçe». Asnjeri nuk iu përgjegj dhe ai hidhte sytë herë nga unë herë nga gardiani. Se ç'donte të thonte me këtë, akoma edhe sot nuk e kuptoj. Po. Befas, ndihmësi i dha fytyrës një shprehje të rreptë dhe, me një zë të hollë, të çjerrë, bërtiti: «Leri shakatë! Përpara!» Rozovski, që me sa dukej nuk ishte në gjendje të kuptonte se çfarë e prisnte dhe sikur ngutej që ta merrte vesh, u nis pothuaj duke

rendur nëpër koridor. Pasi bëri disa hapa, shtangu në vend dhe e dëgjova se si qante me të madhe si ndonjë fëmijë. U dëgjuan ca zhurma, ca këmbë që përplaseshin. Ai ulërinte dhe qante parreshtur. Pastaj zhurmët u larguan dalëngadalë, u dëgjua dera e koridorit që mbyllej e pastaj u bë një heshtje... Po. Dhe i varën. I mbytën që të dy me litar. Një mbikqyrës, jo i pari, një tjetër, që i kishte parë, më tregoi se Lozinski nuk kishte kundërshtuar, por Rozovski kishte luftuar për një kohë të gjatë aq sa e kishin zvarritur me zor dhe ja kishin vënë me forcë lakun në fyt. Po. Ai mbikqyrësi që ma tregoi ishte pak budalla. «Mua më kishin thënë o barin, se të ngjethet mishtë t'i shikosh me sy. Po jo, xhanëm! Nuk ishte dhe aq punë e llahtarshme! Kur po i varnin, vetëm nja dy herë ja bënë fërc-fërc supeve, — ai tregoi se si u tkurën supet e tyre, — pastaj xhelati një të hequr ja bën litarit, që laku të shtërngonte më mirë, siç më thanë, dhe me kaq, çdo gjë mbaroi: s'ja bënë më as mëk, as gëk». «Nuk është aspak frikë» — tha Krilcovi, duke përsëritur fjalët e mbikqyrësit, e deshi të vinte buzën në gaz por, në vënd që të buzëqeshte, rënkoi.

Pastaj heshti për një kohë të gjatë, duke psherëtitur thellë dhe duke u munduar të gëlltiste një lëmsh vaji që i mblidhej në fyt.

Kish hyrë në partinë e narodnikëve dhe bile ishte bërë edhe kryetar i një grupi që kishte për qëllim të terorizonte qeverinë dhe ta shtrëngonte të hiqte vetë dorë nga pushteti e t'ja jepte fuqinë popullit. Ndaj ai shkonte herë në Peterburg, herë jashtë shtetit, herë në Kiev e herë në Odesë dhe gjithnjë ja kish dalë në krye çdo pune. Po më në fund, një njeri i besuar e kishte tradhëtuar. E kishin arrestuar, gjykuar e kishin mbajtur dy vjet në burg dhe e kishin dënuar me vdekje, po më vonë këtë dënim ja kishin ulur me burgim të përjetshëm e me punë të detyrueshme.

Në burg qe bërë tuberkoloz dhe tani, me atë jetë që bënte, ta pret mëndja që i mbeteshin vetëm edhe pak muaj. Ai e dinte dhe nuk ishte i penduar për atë që kishte bërë, përkundrazi, thoshte se edhe sikur ta fillonte përsëri jetën nga e para, do të vepronte ashtu siç kishte vepruar, domenga e para, do të vepronte ashtu siç kishte vepruar, domethënë për të përmbysur një rend shoqëror, që lejonte të ndodhnin të tilla gjëra si ato që ai kishte parë vet me syt' e tij.

Historia e këtij njeriu të mjerë ja bëri të qartë Nekludovit shumë gjera, që s'kish mundur t'i kuptonte dot më parë.

VII

Atë ditë kur ndodhi grindja midis oficerit dhe të burgosurve për shkak të fëmijës, Nekludovi, që kishte fjetur natën në një han, u zgjua vonë dhe, veç kësaj, u muarr për një kohë të gjatë me disa letra që do t'i dërgonte në kryeqëndrën e gubernës, kështuqë doli nga hani më vonë se zakonisht dhe, pa e arritur dot kolonën rrugës, siç bënte përherë mbriti në fshatin, ku bëhej një pushim i shkurtër, ndaj mbrëmjes.

Edhe n'atë fshat kishte një han. Hanxhesha ishte një grua e trashë, e shkuar nga mosha, me një qafë jashtëzakonisht të bardhë e të gjerë. Si piu një çaj në një dhomë të pastër, ku priteshin vetëm mysafirët me rëndësi, dhe e stolisur me shumë ikona e tabllora gjithfarësh, Nekludovi u ngrit me shpejt që të shkonte tek oficeri i kolonës për t'i kërkuar një leje takimi me Masllovën.

Në të gjashtë etapat e mëparëshme, oficerët që komandonin kolonën, sidoqë ndërroheshin vazhdimisht, ja kishin mohuar që të gjithë Nekludovit hyrjen në lokalin ku mbaheshin të burgosurit, kështuqë ai kishte më se një javë pa e takuar Katjushën. Ishin aq të rreptë se pritej të kalonte andej një funksionar i lartë i burgjeve. Por tani funksionari në fjalë kish kaluar, pa begenisur t'u hidhte një sy të burgosurve, kështuqë Nekludovi kishte shpresë se oficeri që e kishte marrë atë mëngjes kolonën në dorëzim, do ta lejonte më në fund të takohej me të burgosurit.

Hanxhesha i tha Nekludovit ta shpinte gjer në vendin e qëndrimit të burgosurve, që ndodhej në fund të fshatit, me karrocën e saj, por Nekludovi iu përgjegj se i pëlqente të shkonte më mirë në këmbë. Kështu u nis i shoqëruar nga një shërbyes i hanit, një djalosh shpatullgjerë e trupmadh, me një palë çizme të mëdha të porsa lyera me katran që kundërmonte. Kish rënë një mjergull e dëndur e qe kaq errësirë, sa që kur djaloshi që e shoqëronte largohej ndonja dy a tri hapa nga ai, në ndonjë vënd që nuk ndriçohej nga drita që vinte prej dritareve, Nekludovi nuk e dallonte më, por dëgjonte vetëm pllacaritjen e çizmeve të tij në baltën e trashë që i ngjitej nëpër këmbë.

Pasi kaluan sheshin e kishës dhe përshkuan një rrugë të gjatë që ndriçohej nga dritat e forta të dritareve të shtëpive që ngriheshin nga të dy anët e saj, Nekludovi, bashkë me djalosh.n që i hiqte udhën, u ndodh në fund të fshatit në një vënd të hapur, ku sundonte errësira e plotë. Por dhe në atë terr filluan të shquheshin dalëngadalë disa rreze fenerash që shpërndaheshin nëpër mjergull dhe që vinin, me sa dukej, nga vëndi i përqendrimit të të burgosurve. Njollat e kuqërreme të dritave bëheshin përher' e më të mëdha e më të shndritëshme; filluan të shquhen hunjt'e gardh.t. figura e zezë e një roje që lëvizte, një shtyllë vija-vija dhe kalibja e rojës. Roja thirri si zakonisht: «Ndal! Kush je ti?» — dhe, si mori vesh se ata që po afroheshin qenë të huaj, u tregua kaq i rreptë, saqë nuk donte t'i lejonte n'asnjë mënyrë të pritnin afër gardhit. Por djaloshi, që shoqëronte Nekludovin, s'e prishi fare gjakun nga rreptësia e rojes.

— Ama, i sertë fortë paske qenë, or byrazer! — i foli ai. — Hajt, bëni zë atij të madhit tënd, pa po rrimë këtu e po presim.

Roja nuk u përgjegj, por ktheu kokën mënjanë e diç thirri me zë të lartë e pastaj u ndal duke vështruar ngultas djaloshin shpatullgjerë, që po u hiqte baltën me një ashkël çizmeve të Nekludovit nën dritën e fenerit. Nga ana tjetër e gardhit dëgjohej një gumzhimë zërash të trashë e të hollë. Pas ndonja tre minutave u dëgjua një tringëllimë hekurash, deriçka e gardhit u hap dhe, duke dalë nga errësira, u dha përpara në dritën e fenerit një nënoficer me një kapotë hedhur krahëve, i cili i pyeti të huajt se çfarë kërkonin. Nekludovi i dha kartvizitën e tij mbi të cilën kishte shkruajtur disa fjalë, dhe iu lut që t'ja dorëzonte oficerit. Nënoficeri nuk ishte aq i rreptë sa roja por, ama, ishte shumë kureshtar. Ai deshi të dinte patjetër përse Nekludovi k'shte nevojë të takohej me oficerin dhe cili ishte. Me sa duket, ai i kishte rënë n'erë gjahut dhe nuk donte t'i shpëtonte nga dora. Nekludovi iu përgjegj se ashtu kishte një punë me të dhe iu lut t'ja dorëzonte pusullën duke i thënë se do t'ja dinte për nder. Nënoficeri e mori pusullën dhe u largua duke tundur kokën. Pas pak kohe deriçka u hap përsëri me zhurmë e që andej nisën të dilnin disa gra të ngarkuara me shporta, me kanistra e me thasë. Që të gjitha, pa përjashtim, qenë veshur jo si fshatare, por si qytetare, me pallto dhe me peliçe; fundet e fustaneve i kishin përvjelur gjer

lart dhe flokët i kishin mbështjellur me shami. Ato e hetuan me kureshtje Nekludovin dhe atë që e shoqëronte, nën dritën e fenerit. Njera prej tyre, me sa dukej e gëzuar që kish takuar djaloshin shpatullgjerë, filloi t'i këpuste menjëherë, pa të keq, ca të shara në dialektin e Siberisë.

— Po ti, or djall i madh, nga bive këtu? — iu drejtua ajo atij.

— Po ja, jam me këtë që më sheh, — u gjegj djaloshi. — Po ti, ç'solle ashtu?

— Ca bulmetra, më kishin porositur që në mëngjes.

— Po qysh? S'të mbajtën për të fjetur? — pyeti djaloshi.

— Shih, shih, i paudhi, ç'thotë! — thirri ajo duke qeshur. — Leri llafet, po eja tani të na përcjellësh në fshat.

Djaloshi diç i tha dhe një fjalë tjetër që e bëri këtë radhë dhe rojen të qeshte, pastaj u kthye nga Nekludovi:

— E po si, do ta gjeni dot vetëm! S'do ngatërrohi?

— E gjej, e gjej.

— Si të kaloni kishën, konaku i dytë, pas shtëpisë me dy kate. Na, po u jap dhe shkopin, — tha ai duke i dhënë Nekludovit një shkop të gjatë, mbi një bojë njeriu, që mbante me vete dhe, duke pllacaritur në baltë ato cizmet e tij të rënda dhietë okë, u zhduk në errësirë bashkë me gratë.

Kur krisi e u hap dera e gardhit e u dha në prak nënoficeri që e ftoi Nekludovin ta ndiqte gjer tek oficeri, zëri i tii, i ndërprerë or' e çast nga ai i grave, vazhdonte të dëgjohej akoma përmes errësirës.-

VIII

Vëndi i pushimit të shkurtër që organizuar njëlloj si vendet e pushimeve të gjata gjatë rrugës së Siberisë. Në një oborr të rrethuar me një gardh hunjsh me majë, ndodheshin tri banesa njëkatëshe. Në njerën prej tyre, n'atë më të madhe, me hekura në dritare, qenë vendosur të burgosurit, në të dytën kishin zënë vënd ushtarakët që i shoqëronin, ndërsa e treta shërbente si vëndbanimi për oficerin e, njëkohësisht, si zyrë. Që të tria këto banesa i kishin të ndezura tani dritat që, si gjithëmonë, e veçanërisht këtu, të jepnin përshtypjen e rreme se aty brënda njeriu duhet ta ndjente veten rehat. Përpara verandave të banesave qenë ndezur gjithashtu disa fenerë dhe ndonja pesë fenerë të

tjerë qenë ndezur edhe murëve për të ndriçuar oborrin. Duke ecur mbi një dhogë të shtrirë për tokë, nënoficeri i priu Nekludovit tek banesa më e vogël. Kur arritën tek shkallët e jashtme, si bëri nja dy-tri hapa, ai u hoq mënjanë e, duke i hapur rrugë princit, e shoqëroi në sallën e hyrjes që ndriçohej nga një llambë, e cila përhapte rrotull një erë të rëndë tymi. Një ushtar me një këmishë prej cohe të ashpër, me gravatë, me një palë pantallona të zeza, qëndronte pranë sobës dhe i frynte zjarrit, ku kish vënë samovarin, me një çizme të verdhë që kishte hequr nga këmba. Kur pa Nekludovin, ushtari e la samovarin, e ndihmoi Nekdovin që të hiqte peliçen prej lëkure dhe hyri në një dhomë më të thellë.

— Erdhi, fisnikëria juaj.

— E po i thuaj të hyjë! — u dëgjua nga brënda një zë i rreptë.

— Hyni, — tha ushtari dhe, fill pas kësaj, nisi të mirrej përsëri me samovarin.

Në dhomën që ndriçohej nga një llambë e varur në tavan, përpara një tryeze mbi të cilën dukeshin mbeturinat e një dreke si dhe nja dy shishe, qe ulur një oficer i veshur me një bluzë austriake që i mbështillte gjoksin e gjerë dhe krahët me një palë mustaqe të verdha e të gjata dhe me një fytyrë të kuqe. Në këtë dhomë të ngrohët, përveç erës së duhanit, ndjehej edhe era mbytëse e një përfumi shumë të rëndë. Kur pa Nekludovin, oficeri u ngrit sapak mbi karrige dhe i hodhi një vështrim ironik e të dyshimtë.

— Çfarë dëshironi? — tha ai dhe, pa pritur përgjegjen, thirri duke u kthyer nga dera: — Bernov! Do të ziejë ndonjë herë ai samovari, apo jo?

— Ja, tani!

— Mirë, pa pastaj ta tregoj unë pastaj atë «taninë!» — thirri oficeri duke përshkënditur sytë.

— Ja, e solla! — thirri ushtari duke hyrë në dhomë bashkë me samovarin.

Nekludovi priti gjersa ushtari të vendoste mbi tryezë samovarin (oficeri e shoqëronte me ata syt' e tij të vegjël e të liq ordinancën çap më çap, sikur të mirrte nishan se ku ta qëllonte). Kur samovari u vendos më në fund mbi tryezë, oficeri e mori dhe mbushi një filxhan. Pastaj nxori nga valixha një shishe të vogël katërqoshe me konjak, si edhe një pako me biskota Albert. Pasi i vendosi të gjitha këto mbi tryezë, ai u kthye përsëri nga Nekludovi.

— Ç'urdhëroni nga unë?

— Do t'ju lutesha të më lejonit të takohesha me një të burgosurë — tha Nekludovi, duke vazhduar të qëndronte në këmbë.

— Politike? Kjo është e ndaluar me ligjë — tha oficeri.

— Gruaja për të cilën e kam fjalën, nuk është një e burgosurë politike, — tha Nekludovi.

— Po pse qëndroni në këmbë? Uluni, ju lutem, — tha oficeri.

Nekludovi u ul.

— Nuk është një e burgosurë politike, — tha ai përsëri — por, sipas kërkesës sime, është lejuar të bashkohet me grupin e të dënuarve politikë.

— Ehë, e di, — e ndërpreu oficeri. — Një e vogël; e zeshkët? Po, po, kjo mund të bëhet. Mos dëshironi ta ndizni?

Ai i zgjati Nekludovit një kuti me cigare dhe, si mbushi me kujdes dy gota me çaj, ja afroi njerën prej tyre Nekludovit.

— Urdhëroni, — tha.

— Ju falemnderit, por unë do të doja të takohesha...

— Nata është e gjatë, ka kohë. Do të jap urdhër t'ua sjellin këtu.

— Nuk do të qe e mundur të shkoja unë atje? — pyeti Nekludovi.

— Tek të burgosurit politik? Eshtë kundra ligjit.

— Po mua më kanë lejuar disa herë. Nëqoftëse është nga frika se u jap ndonjë gjë, këtë mund ta bëj fare bukur edhe nëpërmjet saj.

— E jo, këtë s'e bëni dot, sepse e kontrollojnë, — tha oficeri, dhe qeshi në një mënyrë të shëmtuar.

— Po atëhere, le të më kontrollojnë dhe mua.

— Jo, s'është nevoja, do ta bëjmë ndryshe, — tha oficeri, që i hoqi ndërkaq tapën shishes dhe e afroi përmbi gotën e Nekludovit. — Më lejoni? E po, si të dëshironi. E kuptoni dhe vetë se këtu në Siberi, të takohesh me një njeri të kulturuar, është një gjë e rrallë e, natyrisht, të vjen mirë. Se sa i rëndë është shërbimi këtu, s'është nevoja t'ua them. Pastaj, një njeri që ka parë botë, më kuptoni... Se disa kujtojnë që ne oficerët që shoqërojmë të burgosurit, jemi njerëz të vrazhdë, pa edukatë e pa kulturë dhe as që dyshojnë fare se kjo mund të mos jetë e vërtetë.

Fytyra e kuqe e oficerit, ai parfumi i fortë që kish he-

dhur, unaza që mbante në gisht, e sidomos të qeshurit e tij të shëmtuar, i bënë Nekludovit një përshtypje shumë të keqe, por atë mbrëmje, si edhe gjatë tërë kohës së udhëtimit, ai ndodhej në një gjëndje shpirtërore që e detyronte të tregohej i matur e i kujdesëshëm me të gjithë e që nuk i lejonte të sillej me mendjelehtësi e me përçmim me këdo qoftë, por, përkundrazi, të bisedonte me çdo njeri «me zemër në dorë», sipas përcaktimit që ai i kishte dhënë vetë këtij qëndrimi të tij. Pasi e dëgjoi oficerin me durim, duke kujtuar se ajo gjëndje e tij shpirtërore rridhte nga pjesëmarrja e vështirë në vuajtjet që u shkaktoheshin njerëzve që i qenë besuar, ai tha me tërë mënd:

— Unë mendoj se në detyrën tuaj ju mund të gjeni një ngushëllim në lehtësimin e vuajtjeve të njerëzve.

— E ç'janë vuajtjet e tyre? Ju s'i njihni ata, s'mund ta merrni me mënd ç'njerëz janë.

— Mos doni të thoni se janë ndryshe nga njerëzit e tjerë? — tha Nekludovi. — Mua, përkundrazi, më duket se janë njëlloj si të gjithë. Ndërmjet tyre ka edhe nga ata që janë krejt të pafajshëm.

— Natyrisht, ka nga të gjitha llojet. Që të vjen keq, të vjen keq, sigurisht. Të tjerët as që e çajnë kokën fare, kurse unë, me sa mundem, përpiqem t'u bëj ndonjë lehtësi sa më mirë, them me vete, të vuaj unë se sa ata. Të tjerët, për gjënë më të vogël, s'e zgjatin por menjëherë zbatojnë ligjin e, bile, dhe i pushkatojnë. Kurse mua, siç ju thashë, më vjen keq. Dëshironi? Pijeni dhe një — tha ai, duke ja mbushur përsëri gotën me çaj. — Po, nuk më thatë: ajo gruaja me të cilën dëshironi të takoheni, përse mbahet në burg?

— Eshtë një grua e pafat që hyri nga e keqja në një shtëpi publike dhe atje e akuzuan, pa të drejtë, sikur kishte helmuar një njeri. Eshtë një grua shumë e mirë, — tha Nekludovi.

Oficeri tundi kokën.

— Po, ndodh ngandonjëherë. Ja, t'ju them, kështu ka qënë dhe një në Kazan. E quanin Emma. Hungareze e kishte prejardhjen, por sytë i kishte tamam si ato grat' e Persisë, që janë me nam për bukurinë, — vazhdoi ai dhe duke u zhytur n'ato kujtime, nuk mundi të mos buzëqeshte. — Apo s'mbahej shik! Ju betohem, princeshat s'janë hiç gjë përpara saj...

Nekludovi e ndërpreu oficerin dhe u kthye në bisedën e mëparëshme.

— Unë mendoj se ju mund ta lehtësoni gjëndjen e këtyre njerëzve gjersa janë nën mvarësinë tuaj. Duke vepruar kështu, unë jam i sigurt se ju do të ndjeni një gëzim të madh, — tha Nekludovi, duke u përpjekur t'i shqiptonte fjalët mengadalë e në një mënyrë sa më të qartë, ashtu siç flitet me të huajt apo me të vegjëlit.

Oficeri e vështronte Nekludovin me sy të përshkënditur dhe, me sa dukej, priste me padurim sa të mbaronte, që të vazhdonte tregimin mbi atë hungarezen me sy persiane që, siç kuptohej, i përfytyrohej si e gjallë e s'i hiqej nga mëndja.

— Po, mbase është ashtu siç thoni ju, — tha ai. — Dhe mua më vjen keq për ta. Po desha t'ju tregoj akoma për atë Emmën. Ja, ajo e dini se ç'bënte?...

— Kjo nuk më intereson, — tha Nekludovi. — Dhe ju them haptas se unë, për vete, sadoqë më parë kam qenë kështu si ju, tani e urrej këtë qëndrim kundrejt grave.

Oficeri e vështroi Nekludovin i tmeruar.

— Mos dëshironi akoma pak çaj? — tha.

— Jo, ju faleminderit.

— Bernov! — thirri oficeri, — shoqëroje tek Vakullovi dhe thuaj ta lerë të hyjë në dhomën e seksionit politik; mund të qëndrojë atje gjersa të bëhet apeli.

IX

I shoqëruar nga ushtari, Nekludovi doli përsëri në oborrin e errët, i ndriçuar turbull nga drita e kuqe e fenereve.

— Ku po shkon? — e pyeti një ushtar tjetër që ndeshën në rrugë ushtarin që shoqëronte Nekludovin.

— Në sallën numur pesë.

— Këndej s'kalon dot, se është mbyllur, do t'i biesh nga dera e jashtme.

— Pse, kush e mbylli?

— E mbylli reshteri, se shkoi në fshat.

— E po, ahere, hajt të kalojmë andej.

Ushtari i priu Nekludovit në një të hyrë tjetër të ndërtesës, duke kaluar mbi një dysheme prej dërrasash. Pa kaluar akoma prakun e derës, dëgjuan një gumzhimë zërash dhe disa zhurma njerëzish që shkonin e vinin e që të kujtonin atë zhurmën e njohur në një zgjua bletësh në të roitur. Kur Nekludovi u afrua më afër dhe hapi derën, kjo

gumzhimë u bë edhe më e fortë e u dëgjuan shkoqur disa zëra që thërritnin, që shanin e qeshnin. U dëgjua gjithashtu tringëllima e çjerrë e hekurave si edhe era e zakonëshme dhe e rëndë e plehrave dhe e katranit.

Që të dyja këto përshtypje — gjëma e zërave me tringëllimën e prangave dhe ajo era e tmershme — shkriheshin përherë tek Nekludovi në një ndjenjë të vetme që mund të cilësohej si një pështirosje morale e cila kalonte dalëngadalë në një pështirosje në kuptimin fizik të fjalës. Dhe, që të dyja këto përshtypje, përziheshin dhe forconin njera -tjetrën.

Kur hyri brënda në hajat ku qe vendosur një vozgë e qelbur të cilën të burgosurit në gjuhën e tyre e quanin «paraha», njeriu i parë që i ra në sy Nekludovit ishte një grua që kish hypur e rrinte majë vozgës. Përballë saj qëndronte një burrë me shapkën e sheshtë mbi kokën e rruar hedhur mbi sy. Ata diç po bisedonin mes tyre. I burgosuri, kur pa Nekludovin, i shkeli synë e i tha:

— Kësaj, as cari s'i shpëton.

Gruaja uli me turp kindat e kapotës dhe u skuq në fytyrë.

Pas hajatit vinte një koridor në të dy anët e të cilit qenë vendosur dyert që të shpinin në qelitë e të burgosurve. Qelia e parë ishte ajo e të burgosurve me familje, pastaj vinte qelia e madhe e beqarëve dhe, në fund të koridorit, ndodheshin dy qeli të vogëla të cilat qenë caktuar për të burgosurit politikë. Ky lokal, që ish parashikuar për njëqind e pesëdhjetë veta, për ata katërqindët që qenë strehuar në të, qe kaq i ngushtë, saqë të burgosurit, duke mos gjetur dot vënd nëpër qelira, kishin dalë në koridor. Disa qenë ulur apo qenë shtrirë mbi dysheme, kurse disa të tjerë lëviznin lart e poshtë me disa çajnikë bosh apo të mbushur me ujë të nxehtë. Ndër këta ishte dhe Tarasi. Ai i ra pas Nekludovit dhe, si e arriti, e përshëndeti me përzëmërsi. Fytyra e ëmbël e Tarasit qe shëmtuar aq sa s'njihej nga disa pllanga mavi mbi hundë dhe nën sy.

— Ç'të ka ndodhur kështu? — pyeti Nekludovi.

— Ja, ashtu qe një punë, — tha Tarasi duke buzëqeshur.

— Këta s'dinë tjetër, veç të rrihen — tha me përbuzje ushtari.

— Për sebep të grave, — shtoi një i burgosur, që ecte pas tyre. — U zu me atë Fedkën, që është me një sy.

— Po Fedosja si duket? — pyeti Nekludovi.

— Çka, mirë është. Ja, po i shpie ujin e nxehtë për çaj, — tha Tarasi dhe hyri në qelinë e familjarëve.

Nekludovi zgjati kokën në derë. Qelia qe plot e përplot me burra e me gra. Ca qenë shtrirë mbi shtrat, ca të tjerë nën shtrat. Qelia qe mbushur me avullin e rrobave të lagura që tereshin. Dëgjoheshin të thirurat e pandërprera të grave. Dhoma që vinte pas ishte qelia e beqarëve. Të burgosurit këtu qenë edhe më të shumtë, aq sa një pjesë prej tyre kishin dalë në derë nga që nuk kishin vend brënda. Në koridor, pranë derës, qe e grumbulluar një turmë të burgosurish me rroba të lagura. Ushtari i spjegoi Nekludovit se ata njerëz qenë mbledhur atje për të marrë të hollat, që iu shpërndante përgjegjësi i grupit, duke i dhënë secilit nga një biletë me kundërvleftë për blerjen e ushqimeve. Po shumë prej tyre i kishin humbur të hollat që iu përkitnin në kumar dhe s'kishin ç'mirrnin. Kur panë zotërinë dhe ushtarin që e shoqëronte, ata më afër tyre heshtën menjëherë dhe i vështruan me një armiqësi të hapur. Ndërmjet të burgosurve që ishin grumbulluar aty, Nekludovi vuri re edhe Fjedorovin, që mbante përherë pas një djalosh me një pamje të mjeruar, me ca vetulla të ngritura përpjetë, me një fytyrë të bardhë, të buhavitur, si edhe një endacak me fytyrë të vrarë lie, pa hundë e i pështirë në të parë, që njihej mirë nga të gjithë sepse një herë që qe arratisur vet' i dytë në tajgë thuhej se e kishte vrarë shokun dhe qe ushqyer me mishin e tij. Endacaku qëndronte në koridor me një kapotë të lagur hedhur mbi një krah, dhe vështronte Nekludovin në një mënyrë të paturpëshme dhe ironike, pa u hequr mënjanë përpara tij. Nekludovi bëri një kthesë që të mos i kalonte afër.

Sidoqë ajo pamje për Nekludovin tanimë qe e njohur, sidoqë ata të katërqind të burgosurit ordinerë që ndodheshin aty i kishte parë tre muaj rresht në të gjitha situatat e jetës së tyre; edhe në vapë, edhe përmes reve me pluhur që ata ngrinin përpjetë me hekurat e rënda nëpër këmbë, edhe gjatë ndalesave rrugës, edhe në oborret e burgjeve provizorë ku kishin ndodhur përpara tij skena të llahtarshme kurvërimi, megjithë këtë, sa herë që ndodhej mes tyre, ai kishte përshtypjen se ata të gjithë e shikonin me vëmendje të madhe dhe provonte një ndjenjë turpi e vuante tmerësisht duke e ndjerë veten fajtor përpara tyre. Por, më e rënda nga të gjitha, ishte se, me ndjenjën e turpit dhe me

vetëdijen e fajit, përzihej në shpirtin e tij një ndjenjë pështirimi dhe tmeri që ishte kaq e fortë sa ai nuk ishte i zoti ta përmbante. Ai e dinte se ata nuk mund të qenë ndryshe nga ç'ishin në ato rrethana në të cilat i kishin detyruar të jetonin, por, megjithatë, nuk mund të mos pështirosej kur i shikonte.

— Më vafshin shëndoshë këta, bëjnë pallë, — i ra në vesh Nekludovit një zë kur po i afrohej derës së qelisë ku mbaheshin të burgosurit politikë, — s'duan t'ja dinë hiç, as barku u dhëmb, as gjë prej gjëje, — tha një zë i ngjirur, duke i shoqëruar të gjitha këto me një tok të shara të ndyra dhe, fill pas tij, u dëgjuan ca të qeshura me të gajasur, por të liga e thumbonjëse.

X

Pasi kaluan qelin' e beqarëve, nënoficeri që shoqëronte Nekludov.n i tha se do të vinte ta mirrte përpara apelit dhe u largua. Nënoficeri s'qe larguar akoma mirë, kur Nekludovit iu afrua me hapa të shpejta një i burgosur këmbëzbathur, që i mbante me dorë prangat për të mos bërë zhurmë i cili, ndërsa e mbyste me atë erën e rëndë e të athët të trupit të tij të dirsur, i pëshpëriti me fshehtësi në vesh:

— Ndërhyni, o barin, se po e futin në kurth atë të ziun. I dhanë të pijë dhe ja prishën mëndjen. Sot, kur u bë dorëzimi, ai u hoq si të ishte Karmanovi. Ndërhyni se ne s'kemi se si, se na vrasin, — tha i burgosuri duke vërtitur kokën, i shqetësuar, dhe, fill pas këtyre fjalëve, u largua menjëherë.

Puna qëndronte kështu: një farë Karmanovi, i dënuar me punë të detyruar, ja kishte mbushur mëndjen një djaloshi që i ngjante nga fytyra, të cilin e kishin dënuar vetëm me internim, që të këmbehej me të në mënyrë që ai vetë të internohej, kurse djaloshi të shlyente burgun në vënd të tij.

Nekludovi kishte patur dijeni edhe më parë për këtë punë meqënëse, po ai i burgosur që e kishte lutur të ndërhynte, ja kishte vënë në vesh këtë çkëmbim të paligjëshëm që një javë më parë. Nekludovi tundi kokën në shenjë se e kishte kuptuar përse qe fjala dhe se do të përpiqej të bënte diçka. Pastaj, pa e kthyer më kokën rreth e rrotull, vazhdoi rrugën.

Nekludovi e kishte njohur këtë të burgosur që kur ndodheshin në Ekaterinburg, ku ky i qe lutur që t'i nxirrte një leje për të shoqen, të cilën deshte ta marrte më vete. Ky ishte një burrë nja tridhjetë vjeç, me shtat mesatar, me pamjen e zakonshme të fshatarit rus i cili dërgohej në katorga për një tentativë grabitjeje të shoqëruar me vrasje. E quanin Makar Djevkin. Krimi, për të cilin akuzohej, qe me të vërtetë shumë i çuditëshëm. Ky krim, siç i kishte treguar Nekludovit, nuk kishte qënë vepër e tij, e Makarit, por e atij, të paudhit. Siç tregonte Makari, tek i ati i tij kishte ardhur një shtegëtar dhe për dy rubla i kishte zënë me qira slitën gjer në një fshat ndonja dyzet vjorsta më tej. I ati i tha Makarit ta shpinte shtegtarin atje ku kish punë. Makari e mbrehu pelën në slitë, u vesh dhe, para se të niseshin, piu bashkë me atë shtegëtarin një çaj. Tek pinin çajin, shtegtari i rrëfeu që e kish hallin se do martohej dhe se kish me vete edhe ndonja pesëqind rubla që i kish fituar në Moskë. Me të dëgjuar këtë, Makari doli jashtë, atje ku qe slita, mori sëpatën dhe e fshehu ndën barin që kishte marrë me vete për pelën.

— As vetë nuk e di se përse e mora atë sëpatë, — i tregonte ai. — «Merre, më thoshte, sëpatën!» Dhe ja, e mora. Hypëm dhe u nisëm. Rruga na shkoi mbarë. Dhe çudi, s'më ra ndër mënd fare për sëpatën. Kishim arritur thuajse në të hyrë të fshatit, bëheshin a s'bëheshin ndonja gjashtë vjorsta akoma sa të hynim brënda. E ja, aty, xhadeja mirrte për të përpjetë. Zbres unë dhe vihem pas slitës, mirëpo ai më flet në vesh: «Mor, po si e ke hallin? Ç'pret akoma? Kaptove malin, erdhe në fshat, s'i bën dot gjë. Dhe, aha, ua merr të keqen parave! Hë, ç'ke për të bërë, bëje një or' e më parë!». Krrusem unë përmbi slitë, gjoja se po ndreq barin, kur, do ti, ajo sëpatë, fap e më kërcen vetë në duar! Ai miku diç kuptoi se ktheu kokën pas. «Ç'bën ashtu?» — më thotë. Po unë, një të ngritur i bëj sëpatës dhe desha t'ja këpus me të kokës, pa një pa dy. Mirëpo ishte burr' i shkathët, qerratai, e i shpejtë erë! Një të kërcyer bën nga slita e m'i mbërthen duart sa s'i lëviz dot më as as andej, as këndej. «Paske qenë i lig, më thotë, ç'bën kështu?...» Pa po më shtriu në borë dhe më mbërtheu akoma më mirë. Po dhe unë, ama, s'i dola zot vetes dhe u bëra teslim menjëherë. Nxori brezin e m'i lidhi duart e më ngarkoi në slitë. Atje e drejtë e në stan. Më futën në burg. Më nxorën në givq. Po shoqëria foli mirë dhe tha për mua se s'i kisha rënë në qafë

njeriut gjer ahere. Po ashtu dhe ata zotërinjtë ku rronim, mirë folën. Po ç'e do, që të mirrja një abllakat, s'kisha me se, — vazhdoi Makari — dhe kësisoj ma prenë me katër vjet.

Dhe ishte pikërisht ky njeri që duke dashur të shpëtonte një bashkëfshatar të tij, ndonëse e dinte mirë që vinte jetën e tij në rrezik, i kishte zbuluar Nekludovit një të fshehtë burgu, me gjithë që, po ta mirrshin vesh shokët, do ta kishin shqyer të gjallë.

XI

Lokali i të burgosurve politikë përbëhej nga dy qelira të vogëla që i kishin dyert nga një anë e koridorit që ndahej nga ana tjetër nëpërmjet një çatmaje prej dërrase. Duke hyrë n'atë pjesë të koridorit që rrethohej nga çatmaja, fytyra e parë që vuri re Nekludovit ishte ajo e Simonsonit, i cili kish veshur atë bluzën e tij të zakonshme dhe që ulur në bisht, me një kucur pishe në dorë, përpara deriçkës së një sobe që tronditej nga zjarri i porsa ndezur.

Ai e pa Nekludovin, por nuk u çua në këmbë, vetëm e vështroi nga poshtë lart përmes vetullave të dëndura dhe i dha dorën.

— Gëzohem që ju shoh: kam nja dy fjalë me ju, — tha ai me një vështrim kuptimplot, duke e par Nekludovin drejt në sy.

— Përse është fjala? — e pyeti Nekludovi.

— Më vonë. Tani jam i zënë.

Kaq tha Simonsoni e nisi të mirrej përsëri me sobën, të cilën po e ndizte sipas një teorie të tij që lejonte të evitoheshin sa më shumë humbjet e energjisë kalorike.

Nekludovi po matej të hynte në derën e parë kur, nga e dyta, doli Masllova, e krrusur, duke shtyrë me fshesë për nga soba një tog të madh me plehra e me pluhur. Ishte veshur me një bluzë të bardhë, me një fund, gjithashtu të bardhë e të përvjelur, dhe që vetëm në çorape, pa këpucë. Në kokë kishte një shami të bardhë që i zbriste gjer poshtë mbi vetulla dhe e mbronte nga pluhuri. Kur pa Nekludovin, ajo i dha trupit përpjetë, e la mënjanë fshesën dhe, e skuqur dhe e gjallëruar në fytyrë, i fshiu duart me fustan dhe qëndroi drejt në këmbë përpara tij,



— Po pastroni? — e pyeti Nekludovi duke i dhënë dorën.

— Po, s'e kam harruar zanatin e vjetër, — tha ajo duke buzëqeshur. — S'mund ta merrni me mënd sa pis bëhet këtu. Nat' e ditë rrimë me fshesë në dorë. Hë, a u tha plaid-i? — tha ajo, duke u drejtuar nga Simonsoni.

— Pothuaj, — u përgjegj Simonsoni duke ngritur kokën nga an' e saj, me një vështrim që i bëri Nekludovit shumë përshtypje.

— Atëhere, po vi ta marr dhe po sjell peliçet që t'i vëmë të thahen. Këtu i keni të gjithë, — i tha ajo Nekludovit ndërsa largohej, e i tregonte me dorë derën e parë.

Nekludovi e hapi derën dhe hyri në një qeli të vogël që ndriçohej dobët nga një llambë e vogël metalike, vendosur mbi një shtrat. Në dhomë bënte ftohtë e mbante erë lagështirë e duhan. Llamba prej teneqeje ndriçonte mirë vetëm sendet që ndodheshin përreth saj, kurse shtretnit qenë pothuaj që të gjithë në terr dhe mureve lëviznin lloj-lloj hije.

Ndodheshin në dhomë pothuaj që të gjithë banorët e saj, me përjashtim të dy burrave të ngarkuar me furnizimin e ushqimeve, të cilët kishin shkuar që të mirrnin ujin e nxehtë për çaj. Këtu ndodhej gjithashtu edhe Vera Efremovna e cila qe tharë e zverdhur akoma më tepër, me ata syt' e saj të mëdhenj, të trëmbur, e me atë damarin e kërcyer në ballë, me një bluzë bojëhiri e me flokë të shkurtëra. Ajo kishte shtruar përpara një gazetë me duhan e po mbushte me të ca kallëpe cigaresh, duke i lëvizur duartë shpejt e me të prera.

Përveç asaj ishte edhe një e burgosur tjetër politike, ndaj së cilës Nekludovi ndjente një simpati të veçantë, një farë Emilia Ranceva, që mirrej me mirëmbajtjen e dhomës duke i dhënë, edhe në ato kushte të rënda, një hije e një shije thjesht femërore. Ajo qe ulur pranë llambës, i kish përvjelur krahët e saj të shkathët, të bukur e të pjekur nga dielli, dhe po fshinte ca gota e ca filxhanë që kishte përpara, duke i vendosur mbi një çarçaf të cilin e kishte shtruar mbi shtrat. Ranceva ishte një grua e re dhe, ndonëse nuk qe e bukur, kishte një fytyrë të ëmbël e të mënçur që kishte cilësin' e rrallë, sa herë që buzëqeshte, të shndërrohej e tëra duke marrë një shprehje të gëzuar, të gjallë e magjepsëse. Pikërisht me një buzëqeshje të tillë e priti ajo këtë radhë Nekludovin.

— Ne mendonim se ju ishit kthyer në Rusi, — tha ajo.

Ndodhej këtu gjithashtu, në një qoshe të errët, edhe

Maria Pavllovna, e cila po mirrej atë kohë me një vajzë të vogël, kokëbardhë, që diç belbëzonte parreshtur me atë zërin e saj të ëmbël e të hollë fëminor.

— Sa mirë bëtë që erdhët. U takuat me Katjushën? — e pyeti ajo Nekludovin. — Ja, shikojeni një herë këtë mysafiren tonë. — Si ju duket? — Ajo tregoi me dorë vajzën, që mbante në prehër.

Nekludovi gjeti atje dhe Anatoli Krilcovin. I thatë e i zbetë në fytyrë, me këmbët futur në valenki, të mbledhura nën vete, ai qe ulur i krrusur, duke u dridhur i tëri, mbi një shtrat andej nga fundi dhe, duke i mbuluar duart me mëngët e peliçes, e vështroi Nekludovin me syt' e tij të skuqur nga ethet. Nekludovi deshi t'i afrohej por, atë çast, vuri re se, më të djathtë të derës, qe ulur mbi një shtrat e diç po kërkonte në një trastë, një burrë me flokë kaçurrelë e të kuqërremë, me syza, me një bluzë prej gutaperke. Ky ishte revolucionari i famshëm Novodvorov. Novodvorovi, ndërsa gërmonte në trastë, bisedonte në të njëjtën kohë me të burgosurën Grabjec, një grua e lezeçme, e re dhe përherë e qeshur. Ai u ngut të përshëndetej me të. Dhe këtë e bëri sepse nga të gjithë të burgosurit politikë, Nekludovi ndjente se vetëm Novodvorovi nuk i kishte hyrë e nuk do t'i hynte kurrë në zemër. Novodvorovi i përshkënditi sytë e tij të kaltërt duke kthyer kokën atë çast nga Nekludovi dhe, duke vrënjtur vetullat, i shtriu dorën e tij të vogël.

— Hë, apo ju pëlqen udhëtimi? — e pyeti ai në një mënyrë thjesht ironike.

— Po, ka shumë gjëra interesante, — u përgjegj Nekludovi, duke bërë, gjoja, sikur nuk e kishte vënë re ironinë, dhe iu afrua Krilcovit.

Për sy e faqe Nekludovi linte të kuptohej se qe indiferent kundrejt Novodvorovit, por në të vërtetë nuk qe aspak ashtu. Ato fjalë të Novodvorovit, zakoni i tij për t'i thënë kurdoherë ndonjë gjë të papëlqyeshme, ja prishën Nekludovit atë gjendjen shpirtërore plot mirëdashje për njerëzit në të cilën ai ndodhej dhe ai e ndjente veten menjëherë të pikëlluar e të brengosur.

— Si shkoni me shëndet? — tha ai, duke shtrënguar dorën e ftohtë të Krilcovit që dridhej parreshtur.

— Çka, po ç'e do, kam shumë ftohtë, jam bërë qull, — tha Krilcovi duke u ngutur ta fuste përsëri dorën në mën-

gën e peliçes. — Apo s'bën ftohtë këtu: edhe derri ngrin! Janë thyer dhe xhamet. — Ai tregoi me kokë dritaren me hekura dhe xhamat e thyer në dy vënde. — Po ju, si e pësuat kështu? Pse s'na keni ardhur kaq kohë?

— Nuk lënë, e kanë shtërnguar. Vetëm sot qëlloi një oficer disi më i butë.

— Oh, lere sa i butë është ai! — tha Krilcovi. — Thuaj Mashës të të tregojë se ç'ka bërë sot në mëngjes.

Maria Pavllovna, pa u ngritur nga vëndi i saj, nisi të tregojë ngjarjen me vajzën e të burgosurit që kish ndodhur para se të burgosurit të viheshin n'udhëtim.

— Sipas mendimit tim, duhet të bëjmë një protestë kolektive, — tha me një zë të vendosur Vera Efremovna, ndërsa, në të njëjtën kohë, kthente kokën e pavendosur dhe me frikë, herë nga njeri, herë nga tjetri. Vladimiri e bëri të tijën, por kjo s'mjafton.

— Çfarë proteste? — tha Krilcovi duke vrënjtur fytyrën me inat. Me sa dukej, toni jo i thjeshtë, artificjal, i Vera Efremovnës, dhe nervoziteti i saj i tepruar, e kishin mërzitur atë prej kohësh. — Ju, kë kërkoni? Katjen? — iu drejtua ai Nekludovit. — Ajo s'rri një minutë rehat. Punon e pastron tërë ditën. Ja, dhomën e burrave ajo e pastroi; tani po pastron atë të grave. Por pleshtave që po na hanë të gjallë, s'ka ç'i bën. Po Masha, ç'po bën atje? — pyeti ai duke kthyer kokën për nga qoshja ku ndodhej Maria Pavllovna.

— Po kreh bijen e saj të adoptuar, — tha Ranceva.

— Mirë, mirë, po mos na lëshojë ndonjë nga ata miqtë! ... — tha Krilcovi.

— Jo, jo, se e kam vetë kujdes. Tani është qiqër, — tha Maria Pavllovna. — Nuk e mbani pak ju? — iu drejtua ajo Rancevës, — unë po shkoj t'i ndihmoj Katjes. Po sjell dhe plaid-in.

Ranceva e mori vajzën në duar dhe me një dhëmshuri prej nëne të vërtetë, duke i ngjeshur në gjirin e saj krahët e vockëla, lakuriq e topolakë të foshnjës, e vuri atë mbi gjunjë dhe i dha një copë sheqer.

Maria Pavllovna doli jashtë dhe, fill pas kësaj, hynë në qeli dy të burgosur me ujë të nxehtë e me ushqime.

XII

Njëri nga ata që hyri ishte një djalosh thatanik, me një shtat mesatar, me një peliçe të mbyllur dhe me një palë çizme të larta. Ai ecte me hapa të shpejta, të lehta, duke mbajtur ndër duar dy çajnikë të mëdhenj me ujë të nxehtë që nxirrnin avull dhe, nën sqetull, dy çyreqe me bukë të mbështjellur me shami.

— Na paska ardhur prapë princi, — tha ai, duke i lënë çajnikët mbi tryezë pranë filxhanave dhe duke ja dorëzuar bukët Masllovës. — Kur të merrni vesh se ç'kemi blerë, do të habiteni, — tha duke e hequr peliçen e duke e flakur tek një shtrat në qoshe. — Markeli ka blerë qumësht e vezë; sot, si të thuash, do të kemi festë. E po i lumtë edhe Kirilovnës me atë pastrimin e saj estetik! — shtoi me buzëqeshje, duke u drejtuar nga Ranceva. — Tani sa më shpejt çajin!

Çdo gjë tek ai njeri, lëvizjet e tij, tingëllimi i zërit, mënyra e të shikuarit, jepnin përshtypjen e një energjije dhe hareje të pashterueshme. Kurse ai tjetri, që hyri bashkë me të — i shkurtër, i hollë, me një fytyrë të përhime, ku spikatnin tepër mollëzat e faqeve të kërcyera, me dy sy të blertë e të çakarritur, me buzë të holla — ishte, përkundrazi, një njeri i zymtë e me një pamje të pikëlluar. Kish veshur një pallto të vjetër të mbushur me pambuk dhe në këmbë kish mbathur një palë çizme me galloshe. Mbante në duar dy çini prej balte dhe dy shporta. Si e shkarkoi përpara Rancevës ngarkesën e tij, ai e përshëndeti Nekludovin duke kërrusur qafën dhe, gjatë tërë kohës që qëndronte ashtu, ja qepi sytë. Pastaj, si i zgjati si paqef dorën e tij të dirsur, nisi të vinte nëpër vende, me plogështi, ushqimet që kishte nxjerrë nga shportat.

Që të dy këta të burgosur politikë ishin njerëz të thjeshtë të dalë nga populli: i pari quhet Nabatov e kishte qenë fshatar, i dyti, Markel Kondratjevi, kishte punuar si punëtor në një fabrikë. Markeli kishte hyrë në lëvizjen revolucionare vetëm kur ishte pothuaj tridhjet'e pesë vjeç burrë, kurse Nabatovi që në moshën tetëmbëdhjetë vjeç. Shkollën fillore e kish mbaruar në fshat por, për aftësit'e tij të shkëlqyera në mësime, e kishin dërguar në qytet, në gjimnaz, dhe Nabatovi, duke dalë kurdoherë i pari në mësime, e kish mbaruar gjimnazin me medalje të artë. Megjithatë, ai nuk vazhdoi studimet e larta, n'universitet, sepse, që kur ishte në klasën e VII-të, kish vendosur të kthehej për-

sëri tek populli, nga i cili kish dalë, për të përhapur dritën e arësimit ndër vëllezërit e tij që vazhdonin të jetonin n'errësirë. Kështu vendosi dhe kështu bëri: në fillim hyri si sekretar në një fshat të madh, por nuk vazhdoi dot për shumë kohë në këtë punë, sepse e arrestuan duke e akuzuar se u këndonte fshatarëve broshura të ndaluara dhe se kish organizuar mes tyre një kolektivë konsumi e prodhimi të përbashkët. Herën e parë e mbajtën në burg tetë muaj dhe e lëshuan duke e mbajtur nën vrejtje. Me të dalë nga burgu, ai u nis e shkoi menjëherë në një gubernë tjetër, në një fshat tjetër, dhe, si hyri atje si mësues, bëri përsëri po atë punë. E arrestuan për të dytën herë dhe këtë radhë e mbajtën në burg një vit e dy muaj. Në burg ai i përforcoi edhe më tepër bindjet e tij të mëparëshme.

Si e nxuarrën edhe këtë radhë nga burgu, e internuan në gubernën e Permit. Ai u arratis. E zunë përsëri dhe, si e mbajtën shtatë muaj në burg, e internuan në gubernën e Arkangjelskit. Që andej, meqënëse nuk kish pranuar të betohej për carin e ri, e kishin degdisur n'internim në krahinën e Jakuckës; kështuqë ai e kish kaluar gjysmën e rinisë së tij në burg dhe n'internim. Që të gjitha këto vuajtje, jo vetëm që nuk ja kishin prishur shëndetin, por nuk ja kishin topitur as energjinë e cila, përkundrazi, kish ardhur tek ai gjithëmonë duke u shtuar. Nabatovi ishte një njeri heroik, me një stomak të shëndoshë, përherë njëlloj aktiv, i çkujdesur dhe i gjallë. Ai kurrë nuk pendohej për atë që kish bërë dhe kurrë nuk i hidhte sytë larg, në të ardhmen, por, përkundrazi, me të gjitha fuqit' e mëndjes dhe me të gjitha aftësitë e tij si njeri i shkathët e praktik, punonte vetëm e vetëm për të tashmen. Kur ishte i lirë, punonte për qellimin të cilit ja kishte kushtuar jetën, d.m.th. që të përhapte arsimin në popull e sidomos ndër fshatarë, e që t'i bashkonte ata në një masë kompakte; kur ishte në burg, punonte në një mënyrë po aq energjike dhe praktike për të vendosur lidhjet me botën e jashtme, si edhe për të organizuar një jetë sa më të mirë në kushtet e dhëna, si për veten e tij, ashtu dhe për shokët. Ai qe pikësëpari një komunist në kuptimin më të gjërë të kësaj fjale. Për veten e tij ai s'kishte nevojë për asgjë dhe kënaqej me fare pak, por, për shokët kërkonte shumë dhe mund të bënte çdo punë, si mendore ashtu dhe fizike, pa u shplodhur fare, duke qendruar pa gjumë e pa bukë. Si çdo fshatar i vërtetë, ai qe punëtor i madh, i regjur në jetë, i shkathët në punë, i përmbajtur nga natyra dhe i

kujdesëshëm, jo vetëm ndaj ndjenjave, por edhe ndaj mendimeve të të tjerëve. E ëma, një plakë e ve, fshatare, pa shkollë, plot bestytnira, rronte akoma. Nabatovi e ndihmonte dhe, kur ishte i lirë, shkonte e e shikonte hera- herës. Gjatë kohës që ndodhej në fshat, në shtëpi'n' e tij, ai hynte në të gjitha hollësirat e jetës së s'ëmës, e ndihmonte në punë dhe përtëritte lidhjet me djemt' e fshatit që i kish patur dikur shokë; pinte me ta tytynin [1]) me putër qeni [2]), rrihej me ta me grushte dhe i mësonte duke u thënë se i kishin gënjyer dhe se ata duhej të bënin çmos që të çliroheshin nga gënjeshtëra në të cilën i mbanin. Kur mendonte ndryshimet që do të sillte revolucioni në dobi të popullit ai e përfytyronte popullin pothuajse në ato kushte në të cilat ndodhej tani, por vetëm zot i tokës dhe pa zotërinj e pa zyrtarë mbi krye. Revolucioni, ashtu siç e përfytyronte ai, nuk duhej t'i ndryshonte trajtat themelore që kishte marrë jeta e popullit — dhe në këtë ai nuk ishte në një mendje as me Novodvorovin, as me dishepullin e tij Markel Kondratjevin, — revolucioni, sipas mendimit të tij, nuk duhej ta shëmbte të gjithë ndërtesën, por vetëm të bënte një ndryshim brënda përbrënda kësaj ndërtese të lashtë, madhështore, të shëndoshë, të madhe, për të cilën ai ushqente një dashuri të zjarrtë.

Po ashtu, edhe përsa i përket fesë, qëndrimi i tij ishte tipik fshatar: ai nuk mirrej kurrë me çështjet metafizike, nuk e vriste kurrë mëndjen mbi pse-në e pse-ve dhe mbi jetën pas vdekjes. Zoti ishte për të, ashtu si edhe për Aragonë, vetëm një hipotezë për të cilën ai gjer ahere nuk kish patur kurrë nevojë [3]).

Aq i bënte atij se si kish filluar bota, sipas Moisiut apo sipas Darvinit, dhe darvinizmi të cilit shokët e tij i jepnin një rëndësi kaq të madhe, nuk ishte për të veç se një lojë mendore e lezeçme, ashtu siç ishte edhe krijimi i botës në gjashtë ditë.

Problemi i prejardhjes së botës nuk e shqetësonte për arësye se për të kishte interes më të madh problemi se si qe më mirë të rrojë në të. Për botën tjetër gjithashtu ai nuk mendonte kurrë, sepse kishte thellë në shpirt një bindje të

---

1) Tytym është një lloj duhani nga ai më i dobëti (shën. i përkth.)

2) Putra e qenit = një lloj pipe prej kartoni që përdornin muzhikët dhe puntorët e fabrikave (shën. i përkth.)

3) Përkthenjësi frëng S. Halperine-Kaminski e ndreq gabimin e Autorit dhe, në vend të Arago-së, vë Laplacin (shën. përkth.)

patundur, të qetë, të cilën e kishte trashëguar nga stërgjyshërit e tij dhe që është e përbashkët në përgjithësi për të gjithë fshatarët. Kështu, ai mendonte se, po ashtu si në botën e kafshëve e të bimëve, asgjë nuk zhduket por shndërohet vazhdimisht nga një formë në një tjetër, si bije fjala, plehu kthehet në grurë, gruri në pulë, krimbi në flutur, lëndja në lis, ashtu edhe njeriu nuk zhduket, por vetëm ndryshon trajtë. Ai i besonte kësaj dhe prandaj e shikonte vdekjen në sy, pa frikë, bile i qeshur, dhe i duronte pa u ankuar të gjitha vuajtjet që të shpinin tek ajo, sidoqë nuk i pëlqente dhe nuk dinte të fliste për të. Atij i pëlqente të punonte dhe përherë që i zënë me ndonjë punë praktike duke i nxitur dhe shokët e tij që të mirreshin me punë të tilla.

I burgosuri tjetër politik, Markel Kondratjevi, ishte një njeri i një kallëpi tjetër. Ai kishte hyrë në punë që kur ishte pesëmbëdhjetë vjeç dhe që atëhere kishte filluar të pinte duhan e vodkë për të mbytur vetëdijën e turbulltë të një poshtërimi që, sipas mendimit të tij, i kishte bërë shoqëria. Këtë poshtërim ai e kishte ndjerë për herë të parë kur, akoma fëmijë, e kishin shpurë, bashkë me ca shokë të tij, tek pema e krishtlindjes, në shtëpinë e fabrikantit që ishte pronari i uzinës së tyre; atij, ashtu si dhe gjithë fëmijëve të tjerë të punëtorëve që punonin në uzinë, i kishin dhuruar një bilbil nga ata që kushtonin një kopejkë, një mollë, një kokërr arrë të veshur me letër ari, dhe nja dy kokrra rrush të thatë, ndërsa fëmijëve të pronarit iu dhanë disa lodra të cilat ai i kishte parë si i magjepsur dhe që, siç mori vesh më vonë, kishin kushtuar lart nga pesëdhjetë rubla. Kondratjevi ishte njëzet vjeç kur në fabrikën e tij kish hyrë të punonte një revolucionare e dëgjuar e cila, duke vënë re aftësitë e shkëlqyera të Kondratjevit, i dha atij për të lexuar disa libra dhe disa broshura, duke i shpjeguar shkaqet që i kishin tresjellë punëtorët n'atë gjëndje të mjerueshme e duke i treguar mjetet për përmirësimin e saj. Kur ai më në fund e pa të qartë mundësin'e çlirimit të tij dhe të shokëve nga zgjedha e çfrytëzimit që rëndonte mbi ta, padrejtësia e gjëndjes në të cilën ndodhej iu duk akoma dhe më e madhe se sa më parë, kështuqë, jo vetëm që deshi të çlirohej me çdo kusht, por mendoi se duhej bërë çmos për t'u dhënë dënimin e merituar atyre që e kishin shkaktuar dhe që e përkrahnin këtë padrejtësi kaq të tmerëshme. I thanë se mundësia për t'ia arritur kësaj, gjëndej në shkencë dhe Kondratjevi, pa humbur kohë, iu përvesh shkencave me dëshirë të

madhe. Ai nuk e kishte të qartë se në ç'mënyrë do të mund të realizohej ideali socialist me anë të shkencës, por kishte besim se shkenca, ashtu si kishte zbuluar padrejtësinë e gjëndjes së tij, do t'i tregonte edhe mjetet për ta ndrequr këtë padrejtësi? Veç kësaj, shkenca, sipas mendimit të tij, do ta lartësonte atë, Kondratjevin, përmbi njerëzit e tjerë dhe prandaj, ai, si e preu duhanin dhe të pirët, tërë kohën e lirë, sidomos kur u caktua si magaziner i një depoje, ja kushtoi studimit.

Revolucionarja që e mësonte habitej me aftësin' e madhe që kishte Kondratjevi për t'i gëlltitur si i uritur të gjitha ato që i mësonte. Ai mësoi në dy vjet algjebrën, gjeometrinë, historinë, për të cilën ndjente një dashuri të veçantë, dhe lexoi një pjesë të madhe të letërsisë artistike e të shkrimeve kritike, sidomos ato që kishin të bënin me idetë socialiste.

Revolucionaren e arrestuan bashkë me Kondratjevin, të cilit iu gjënden libra të ndaluara. Në fillim i futën në burg, më vonë i internuan në gubernën e Volldës. Atje ai u njoh me Novodvorovin, lexoi dhe shumë libra të tjera revolucionare, u formua politikisht e u bind edhe më tepër mbi drejtësinë e pikëpamjeve të tija socialiste. Pas internimit, kish udhëhequr një grevë të madhe punëtorësh që kish përfunduar me shkatërrimin e një fabrike dhe me vrasjen e drejtorit të saj. E kishin arrestuar dhe dënuar më vonë me heqjen e të drejtave civile dhe me internim.

Ndaj fesë, ai mbante po atë qendrim armiqësor si edhe kundrejt rendit ekonomik në fuqi. Si arriti të kuptojë zbrazësinë e besimit në të cilin qe rritur e si u shkëput prej tij, në fillim me ndrojë e më vonë më me guxim e me vendosmëri, si për t'u hakmarrur kundër këtij mashtrimi që i ishte bërë atij dhe stërgjyshërve të tij, ai tallej me përbuzje e shkrehej, kur vinte rasti, me një inat të tërbuar kundër priftërinjve dhe dogmave të fesë.

Asket për nga natyra, kënaqej me fare pak dhe, duke i patur muskujt shumë të zhvilluar, ashtu siç i kanë gjithë njerëzit që mirren me punë që së vogli, ishte në gjëndje të kryente me lehtësinë më të madhe çfarëdo lloj pune fizike, megjithëse i pëlqente më mirë të mos punonte, që të vazhdonte të mirrej me studimet e tij edhe në burg. Ai po studjonte tani vëllimin e parë të «Kapitalit» të Marksit dhe e mbante këtë libër në trastën e tij, duke e ruajtur me kujdes të madh si gjënë më të çmuar. Me shokët sillej i përm-

bajtur e i ftohët, me përjashtim të Novodvorovit për të cilin kishte një respekt të madh dhe mendimet e të cilit mbi çfarëdo çështje i pranonte si disa të vërteta që nuk mund të viheshin në dyshim.

Te gratë ai shikonte një pengesë për arritjen e qëllimeve të tij dhe prandaj i përbuzte. Por për Maslloven i vinte keq e sillej me të shumë butë, duke parë tek ajo një shembull tipik të çfrytëzimit që ushtrohej mbi popullin nga klasat e larta. Prandaj dhe nuk ja shtërngoi dorën atij, por vetëm u kufizua t'ja zgjaste kur ai e përshëndeti.

XIII

Soba u ndez, u ngroh, çaji u zbraz nëpër filxhana e gota dhe u zbardh pastaj me qumësht. Mbi tryezë u shtruan franxhollat e bardha, çyreçet e bukës së grurit të ngrohtë e të shijëshme, gjalpi, koka dhe këmbët e viçit. Që të gjithë u bënë rreth një shtrati që shërbente si tryezë dhe filluan të pinë, të hanë e të bënin muhabet. Ranceva qe ulur mbi një arkë dhe ndante çajin. Vetëm Krilcovi që kishte hequr peliçen e lagur dhe qe mbështjellur në **plaidin** e tharë, vazhdonte të qendronte i shtrirë në vendin e tij duke biseduar me Nekludovin.

Pas të ftohtit e lagështirës gjatë marshimit, pas baltës dhe pisllëkut që kishin gjetur këtu, pas mundimit që u ishte dashur të bënin për të vënë një farë rregulli, duke ngrënë bukë e duke pirë çajin e ngrohtë, që të gjithë e ndjenin veten të shplodhur e të lumtur.

Zhurma që bënin aty pas murit të burgosurit, të thirrurat e të sharat e tyre, sikur ua kujtonin or' e çast ambjentin në të cilin qenë të detyruar të rronin, gjë kjo që ua bënte ta shijonin e ta çmonin edhe më tepër mirëqënien e tyre. Ashtu si një ishull midis detit, këta njerëz e ndjenin veten të mbrojtur nga ato valë poshtërimesh e vuajtjesh të cilat i rrethonin dhe, prandaj, ndodheshin në një gjëndje shpirtërore të ekzaltuar dhe entuziaste. Ata bisedonin për të gjitha. Nuk bisedonin vetëm për gjëndjen në të cilën ndodheshin dhe për vuajtjet që i pritnin në t'ardhmen. Përveç kësaj, ashtu siç ndodh gjithmonë ndërmjet burrave e grave të reja, veçanërisht kur afrohen rastësisht, ndërmjet tyre kishin lindur simpatira të ndryshme që gërshetoheshin në llojshin lindur simpatira të ndryshme që gërshetoheshin në llojshin

lloj mënyra. Ata kishin rënë pothuajse të gjithë në dashuri. Novodvorovi kish rënë në dashuri me Grabecin. Grabeci, një vajzë e hijëshme dhe e qeshur, përpara se të burgosej vazhdonte mësimet n'universitet. Gjatë kësaj kohe, nuk qe marrë kurrë ndonjëherë me problemet e revolucionit, përkundrazi, qe treguar ndaj tyre krejt indiferente. Por, dashur padashur, i qe nënshtruar ndikimit të kohës, qe kompromentuar me lëvizjen dhe, si pasojë, e kishin arestuar. Para se ta arrestonin, qëllimi i jetës së saj kishte qenë t'u pëlqente burrave; këtij qëllimi ajo vazhdoi t'i qëndrojë besnike edhe pas arrestimit, gjatë hetimeve në burg, edhe n'internim. Tani, gjatë udhëtimit, ajo ngushëllohej me dashurinë që i kishte çfaqur Novodvorovi, me të cilin edhe ajo vetë qe dashuruar. Vera Efremovna, që dashurohej shumë lehtë por që s'kishte fat në dashuri, binte në dashuri herë me Nabatovin, herë me Novodvorovin. Si dashuri mund të cilësoheshin deri diku edhe marrëdhënjet e Krilcovit me Maria Pavllovnën. Krilcovi, ndonëse e deshte Maria Pavllovnën ashtu siç i duan zakonisht burrat gratë, duke e njohur qëndrimin e saj ndaj dashurisë, mundohej ta fshihte këtë ndjenjë nën veshjen e miqësisë dhe të mirënjohjes ndaj kujdesit që ajo tregonte për të më tepër se për këdo tjetër. Nabatovi dhe Ranceva kishin mes tyre disa marrëdhënie shumë më të ndërlikuara. Ashtu si Maria Pavllovna ishte, si vajzë, krejt e papërlyer, po ashtu edhe Ranceva ishte, si grua e martuar, krejt e papërlyer.

Në moshën gjashtëmbëdhjetë vjeç, kur ishte akoma në gjimnaz, ajo kishte rënë në dashuri me Rancevin, atëhere student n'universitetin e Peterburgut. Pas tre vjetësh, ajo qe martuar me të pa pritur që ai ta mbaronte universitetin. I shoqi, kur vazhdonte akoma vitin e katërtë të fakultetit, qe ngatërruar në ca trazira që kishin ndodhur në universitet, qe shpërngulur nga Peterburgu dhe qe bërë revolucionar. Ajo e braktisi menjëherë fakultetin e mjekësisë, në të cilin qe regjistruar, shkoi bashkë me të dhe, duke ndjekur shëmbullin e tij, u bashkua edhe ajo me revolucionin. Sikur i shoqi i saj të mos qe, siç i dukej asaj, njeriu më i mirë e më i zgjuar në botë, ajo nuk do ta kishte dashuruar dhe, duke mos e dashuruar, nuk do të qe martuar me të. Po gjersa u dashurua dhe u martua me një burrë që, sipas mendimit të saj, ishte nga të gjithë njerëzit në botë më i miri dhe më i mënçuri, ishte e natyrëshme që ajo ta kuptonte jetën dhe qëllimin e saj, pikërisht ashtu si e kuptonte ai njeriu më i

mirë e më i mënçur në botë. Ai në fillim mendonte se qëllimi i njeriut në jetë është të mësojë dhe, po kështu, e kuptonte edhe ajo atëhere qëllimin e njeriut në jetë. Kur ai u bë revolucionar edhe ajo u bë revolucionare, duke përvetësuar shpejt e shpejt një tok njohurish që e vinin në gjëndje të provonte fare lehtë se rendi në fuqi nuk duhej të qe në fuqi dhe se çdo njeri e kishte për detyrë të luftonte me këtë rend e të përpiqej për vendosjen e një regjimi politik dhe ekonomik që do t'i jepte mundësi njeriut të zhvillonte lirisht personalitetin e tij etj. etj. Ajo i mbronte këto mendime e këto ndjenja sepse i kishte menduar e i kishte ndjerë vetë, por, në të vërtetë, ajo mendonte me mëndjen e të shoqit dhe ndjente me zemrën e tij duke bërë çmos që të arrihej një përputhje e plotë ndërmjet pikëpamjeve të tyre e, mundësisht, që shpirtërat e tyre të shkriheshin në një shpirt të vetëm, gjë kjo që do ta bënte atë përsosurisht të lumtur...

Ndarja me të shoqin dhe me fëmijën, të cilën ja kish marrë për t'ja mbajtur e ëma, që shumë e rëndë për të. Por ajo e përballoi këtë ndarje e qetë dhe e vendosur duke ditur se e përballonte për të shoqin dhe për një çështje e cila, gjer edhe ai i shërbente, duhet t'ishte padyshim e drejtë. Ajo e kishte mëndjen përherë tek ai dhe, ashtu si më parë nuk kishte dashuruar njeri tjetër veç burrit të saj, ashtu dhe tani nuk mund të dashuronte asnjë tjetër përveç atij. Por, megjithatë, dashuria e pastër dhe e sinqertë e Nabatovit, nuk mund të mos e prekte. Ai, si njeri, me karakter dhe me cilësira morale të larta dhe, nga ana tjetër, si shok i burrit të saj, përpiqej të sillej me të si me një motër, por në marrëdhënjet mes tyre ngatrrohej, padashje, edhe diçka tjetër: një «diçka» që i tmeronte që të dy, por që në të njëjtën kohë ua bënte më të lehta vuajtjet.

Kështu, të vetmit që kishin shpëtuar pa rënë në dashuri n'atë rreth, ishin Maria Pavllovna dhe Kondratjevi.

XIV

Mbasi e pat lënë që të takohej me Katjushën veçmas pas caiit dhe darkës, ashtu si zakonisht, Nekludovi qe ulur pranë Krilcovit dhe po bisedonte me të. Ai i tregoi atij, ndërmjet të tjerave, dhe atë që i kishte ndodhur me Makarin, si edhe historinë e krimit të tij. Krilcovi e dëgjonte me vë-

mëndje të madhe duke e shikuar drejt e në fytyrë, me sytë që i përshkënditeshin nga ethet.

— Po, — tha ai papritmas. — Ky mendim s'më le rehat: ja, udhëtojmë bashkë, vuajmë bashkë me ta, po cilët janë «ata»? Pikërisht ata njerëz për të cilët ne kemi sakrifikuar çdo gjë. Por, në të njëjtën kohë, ne, jo vetëm që nuk i njohim, por as që duam t'i njohim. Dhe më e keqja është se ata na urrejnë, na quajnë armiq! Kjo është e tmershme.

— Këtu nuk ka asgjë të tmershme, — tha Novodvorovi që i kishte vënë veshin bisedës. — Masat vetëm pushtetin adhurojnë, kjo dihet, — tha ai me atë zërin e tij të ngjirur. — Pushtetin e ka qeveria, prandaj dhe ata adhurojnë qeverinë dhe na urrejnë neve që jemi kundër saj, po neser, kur pushteti të jetë yni, adhurimi tyre do të kthehet nga ne...

Atë çast matanë murit shpërtheu një grindje, u dëgjuan disa të goditura në mur, një zhurmë ﬁekurash, ulërima e të thirrura. Dikush po rrihej, dikush thirri: «Roja!»

— Ja, shikoni se ç'bisha janë! E, pra, si mund të ketë ndonjë gjë të përbashkët ndërmjet nesh e atyre? — tha i qetë Novodvorovi.

— Ti thua se janë bisha. Por ja, tani, Nekludovi më tregoi për njerin prej tyre që ka bërë një vepër, të cilën mund ta bëjë vetëm një hero — e kundërshtoi Krilcovi me nervozitet dhe përsëriti ato që i kishte treguar Nekludovi për Makarin, i cili kishte rrezikuar jetën për të shpëtuar një bashkëfshatar të tij, — të cilën vetëm një hero mund ta bënte e jo kurrë një bishë.

— Sentimentalizma të kota! — tha me ironi Novodvorovi. — Ne e kemi të vështirë t'i kuptojmë emocionet e këtyre njerëzve dhe arësyet e veprimeve të tyre. Ti mendon se e ka bërë nga zëmërgjërësia, por ai mund ta ketë bërë fare bukur nga zilia për atë të burgosurin.

— Përse nuk do të shikosh kurrë tek të tjerët ndonjë gjë të mirë? — tha papritmas, e nxehur, Maria Pavllovna (ajo u fliste të gjithëve me «ti»).

— Një gjë që nuk ekziston, nuk ka si të shikohet.

— Si nuk ekziston? Tjetri rrezikon jetën e tij!

— Unë mendoj, — tha Novodvorovi, — se ne, po të duam ta shpiem gjer në fund veprën tonë, duhet në radhë të parë (Kondratjevi e la mënjanë librin që po lexonte pranë llambës dhe i ngriti veshët për të dëgjuar mësonjësin e tij) të mos mirremi me fantazira, por t'i shikojmë gjërat

ashtu siç janë. Të bëjmë për masat e popullit gjithçka, por të mos presim prej tyre asgjë; masat janë objekti i veprimtarisë sonë, por nuk mund të bashkëpunojnë në asnjë mënyrë me ne gjersa do të jenë në atë gjëndje inercie në të cilën gjënden tani, — nisi me tonin e një profesori që po lexon një leksion. — Dhe prandaj, është kryekëput iluzore të besosh në ndihmën e tyre, gjersa të mos jetë zhvilluar plotësisht tek ato një proçes zhvillimi, pikërisht ai proçes zhvillimi për të cilin ne po i pregatisim.

— Çfarë proçes zhvillimi? — u hodh Krilcovi që qe skuqur i tëri në fytyrë. — Ne themi se jemi kundra despotizmit, po nuk është ky despotizmi më i tmershëm që mund të mendohet?

— Këtu nuk ka asnjë despotizëm, — u përgjegj i qetë Novodvorovi. — Unë them vetëm se e di rrugën nëpër të cilën duhet të ecë populli me se mund t'ua tregojë edhe të tjerëve këtë rrugë.

— Po nga e fiton ti bindjen se rruga që tregon ti, është e vetmja rrugë e vërtetë? Nuk është ky një despotizëm, nuk është ky ai despotizmi që polli inkuizicionin e tmeret e revolucionit të madh? Dhe ata kështu thonin, se e njihnin, gjoja, rrugën e vërtetë.

— Nëse ata kanë qenë gabuar, kjo nuk provon në asnjë mënyrë gabimin tim. Veç kësaj ka një ndryshim të madh ndërmjet përçartjeve të ideologëve dhe të dhënave pozitive të shkencës ekonomike.

Zëri i Novodvorovit e mbushte tërë dhomën. Vetëm ai fliste, të tjerët heshtnin.

— Ja, kështu grinden gjithëmonë, — tha Maria Pavllovna, kur ai heshti një hop.

— Po ju, ç'mendoni për këtë? — e pyeti Nekludovi Maria Pavllovnën.

— Mendoj se Anatoli ka të drejtë, se mund ta detyrojmë popullin që të pranojë pikëpamjet tona.

— Katjusha, po ju? — pyeti duke buzëqeshur Nekludovi, me frikë se mos ajo thoshte ndonjë gjë tjetër për tjetër.

— Unë mendoj se s'po pyesin fare për popullin, — tha ajo, flakë e kuqe në fytyrë, — hiç fare s'po pyesin për popullin e shkretë.

— Mirë e thatë, Mihaillovna, shumë mirë e thatë, — thirri Nabatovi, — hiç fare s'pyesin për të, po, po, ashtu.

Po do pyesin se s'bën. Këtu duhet të synojë dhe puna jonë.

— Ja një ide e çuditëshme mbi detyrat e revolucionit, — tha Novodvorovi dhe nisi të thithte cigaren, i heshtur, i rreptë në fytyrë.

— S'bisedoj dot me të, — pëshpëriti Krilcovi dhe heshti.

— Është shumë më mirë të mos bisedoni fare, — tha Nekludovi.

XV

Megjithëse Novodvorovi çmohej e nderohej shumë nga të gjithë revolucionarët, megjithëse ishte shumë i ditur dhe e hiqte veten shumë të mënçur, Nekludovi, për veten e tij, e fuste atë në kategorinë e atyre revolucionarëve që, duke qenë për nga vetit' e tyre morale nën nivelin e njeriut mesatar, qëndronin në një shkallë shumë më të ulët se ky. Fuqitë mendore të këtij njeriu qenë të mëdha; por opinioni që ai kishte për veten — s'kishte kufi dhe ua kishte kaluar prej kohësh fuqive të tij mendore.

Ky ishte një njeri i një kallëpi shpirtëror krejt të kundërt me atë të Simonsonit. Simonsoni ishte nga ata njerëz me brumosje epërsisht burrnore, veprimet e të cilëve rrjedhin drejtpërdrejt nga veprimtaria e mendimit dhe përcaktohen plotësisht prej saj. Novodvorovi, përkundrazi, bënte pjesë në atë kategori njerëzish me brumosje epërsisht femërore tek të cilët veprimtaria e mendimit drejtohet pjesërisht nga arritja e qëllimeve që përcaktohen nga ndjenjat, dhe pjesërisht nga argumentimi i veprimeve që kryhen nën shtytjen e ndjenjave.

E gjithë veprimtaria revolucionare e Novodvorovit, megjithëse ai dinte ta mbështeste me një gojtari të rrallë mbi disa arësyetime të shëndosha dhe bindëse, Nekludovit i dukej si e mbështetur vetëm në mëndjemadhësinë dhe në dëshirën e tij për të dalë në krye. Në fillim, në saje të aftësisë që kishte t'i përvetësonte mendimet e të tjerëve e t'i riprodhonte në një mënyrë të përpikët, gjatë kohës që ishte në shkollë, n'ambjentin e nxënësve e të mësonjësve, ku kjo aftësi çmohet së tepërmi (në gjimnaz, n'universitet), ai shkëlqen e ndër të tjerë, e ndjente veten të kënaqur. Por, kur i mbaroi studimet e mori diplomën dhe kur, për pasojë, u zhdukën edhe kushtet e epërsisë së tij, ahere ai, befas, siç i kishte treguar Nekludovit Krilcovi, i cili e

urrente Novodvorovin, që të gjente një sferë të re për epërsin' e tij, i ndryshoi kryekëput pikëpamjet e tij dhe, nga liberal evolucionist, siç kishte qenë gjer ahere, u bë i kuq, narodovolc. Meqënëse karakteri i tij ishte i varfër për nga vetitë morale e estetike që e bëjnë njeriun shpesh herë të dyshojë e të lëkundet, ai arriti në një kohë shumë të shkurtër të zinte në botën e revolucionit vendin e udhëheqësit të partisë, gjë kjo që ja kënaqi plotësisht ambicjen. Kur mirrte një mendim apo zgjidhte një drejtim, Novodvorovi nuk dyshonte për të më kurrë e nuk lëkundej, dhe, prandaj, ishte i bindur se asnjëherë në jetë të tij nuk kishte gabuar. Atij çdo gjë i dukej jashtëzakonisht e thjeshtë, jashtëzakonisht e qartë, jashtëzakonisht e natyrëshme. Dhe me të vërtetë po të gjykohej nga pikëpamja e tij e ngushtë dhe e njëanëshme, nuk kishte dyshim se çdo çështje paraqitej e thjeshtë dhe e qartë dhe, për zgjidhjen e saj, siç thoshte ai, nga njeriu nuk kërkohej asgjë tjetër përveç logjikës. Vetësiguria e tij ishte kaq e madhe saqë, ose i bënte armiq njerëzit, ose i nënshtronte. Por, meqënëse ai e kishte zhvilluar veprimtarin' e tij në një rreth të rinjsh pa përvojë, që shikonte n'atë vetësigurin' e tij të pamatur, një pjekuri të rrallë e një gjykim të thellë, pjesa më e madhe i qe nënshtruar dhe ai kishte korrur një sukses të madh në qarqet revolucionare. Veprimtaria e tij kishte për qellim të pregatiste kryengritjen që do t'i lejonte atij ta kapte vetë në dorë tërë pushtetin dhe të mblidhte asamblenë. Asamblea pastaj do të shqyrtonte programin që do të propozohej prej tij dhe ky program do të aprovohej patjetër, si i vetmi që i zgjidhte më së miri të gjitha problemet.

Shokët e nderonin si njeri të guximshëm e të vendosur, por nuk e donin. Ai, nga ana e tij, nuk donte asnjeri, dhe me të gjithë ata që shquheshin për ndonjë cilësi sillej si t'i kishte kundërshtarë e do të kishte vepruar me gjithë qejf me ta, po të qe e mundur, siç veprojnë meshkujt pleq të majmunëve me të rinjtë. Ai do t'ua kishte rrëmbyer të gjithë mënçurinë dhe të gjitha aftësitë njerëzve të tjerë, vetëm e vetëm që mos të pengonin çfaqjen e aftësive të tij. Ai sillej mirë vetëm me ata që i përuleshin. Kështu sillej tani, gjatë udhëtimit, me punëtorin Kondratjev, të cilit i kishte propaganduar pa u lodhur teoritë e tij, si edhe me Vera Efremovnën dhe me Grabecin e lezeçme të cilat, që të dyja, kishin rënë në dashuri me të. Sidoqë, parimisht, ai ishte pro emancipimit të gruas, në thellësi ai mendonte

se të gjitha gratë ishin mëndjelehta e s'kishin ndonjë vlerë, me përjashtim të atyre me të cilat ai hynte në marrëdhënje sentimentale, siç ishte, fjala vjen, tani Grabeci, dhe të cilat, gjatë kësaj kohe, ai i cilësonte si gra të jashtëzakonëshme e me merita të larta, që vetëm ai ishte në gjëndje t'i vinte re e t'i çmonte siç duhej.

Problemi i marrëdhënjeve ndërmjet dy sekseve, ashtu si edhe çdo problem tjetër, i dukej atij shumë i thjeshtë, i kjartë e përfundimisht i zgjidhur nëpërmjet teorisë së dashurisë së lirë.

Për veten e tij ai kishte një grua fiktive dhe një grua të vërtetë me të cilën qe ndarë, mbasi kishte arritur në përfundim se mes tyre nuk kishte një dashuri të vërtetë. Tani po bëhej gati të lidhte një tjetër martesë të lirë me Grabecin.

Ai e urrente Nekludovin sepse, siç thoshte, «i bënte lajka» Masllovës dhe, sidomos sepse i lejonte vetes të mendonte mbi të metat e regjimit shoqëror në fuqi dhe për mjetet e ndreqjes së tij jo fjalë për fjalë siç mendonte ai, Novodvorovi, por bile, në një mënyrë origjinale, në rolin e princit, domethënë në rolin e budallait. Nekludovi e dinte mirë se ç'mendonte për të Novodvorovi dhe, megjithëse i vinte keq, e ndjente se, pavarësisht nga ajo gjëndje shpirtërore që e frymëzonte për një dashuri të pakufishme ndaj njerëzve në të cilën ndodhej gjatë kohës së udhëtimit, ai do të hakmerrej me të në të njëjtën mënyrë, meqënëse nuk ishte i zoti ta mposhte kurrsesi antipatin'e madhe që i ngjallte ai njeri.

XVI

Në dhomën pranë u dëgjuan disa zëra të rrepta. U bë një heshtje e, fill pas kësaj, hyri në dhomë nënoficeri i burgut bashkë me dy ushtarë. Vinte për apelin dhe numëroi të gjithë një e nga një me gisht. Kur i erdhi radha Nekludovit, duke u drejtuar nga ai, i tha me një zë të butë e miqësor:

— Tani, princ, pas apelit nuk mund të qendroni më. Duhet të shkoni.

Nekludovi, që e kuptonte se ku e kishte hallin, iu afrua dhe i futi fshehurazi nën dorë të tri rublat të cilat i kishte bërë gati që më parë.

— E po mirë, mirë, fundja qendroni dhe pak!

Nënoficeri bashkë me dy ushtarët po matej të dilte kur, atë çast, hyri në dhomë një nënoficer tjetër dhe, fill pas tij, një i burgosur, i hollë e i thatë, me një mjekër të rrallë e me një sy të nxirë.

— Kam ardhur për çupën, — tha i burgosuri.

— Babi, — u dëgjua befas një zë kumbonjës fëminor dhe një kokë e vockel e bardhë, u ngrit që nga pas Rancevës e cila bashkë me Maria Pavllovnën dhe me Katjushën po i qepnin vajzës një fustan të ri me një fund të vjetër të Rancevës.

— Unë jam, moj bijë, unë, — tha me një zë përkëdhelës Buzovkini.

— Lereni këtu se mirë është, — tha Maria Pavllovna, duke hedhur sytë me keqardhje nga fytyra e vrarë e Buzovkinit.

— Zonjat po më qepin një llopot [1]) të ri, — tha vajza duke i treguar t'et fustanin e papërfunduar që kishte në dorë Ranceva. Sa i bukur është, i kuq!

— Do të rrish sonde këtu? — e pyeti Ranceva duke e përkëdhelur.

— Dua edhe babin.

Ranceva buzëqeshi.

— Babin jo, nuk bën, — tha ajo. — Lereni këtu, — i tha ajo t'et.

— Lereni, — tha nënoficeri i parë dhe, si qendroi një hop në derë, doli jashtë bashkë me atë tjetrin.

Me të larguar nënoficerët dhe ushtarët që i shoqëronin, Nabatovi iu afrua Buzovkinit dhe, duke e prekur në sup, i tha:

— Nuk më thua, or burazer, është e vërtetë që Karmanovi kërkon të shkëmbehet me një tjetër?

Fytyra e butë, ledhatonjëse e Buzovkinit, u prish befas dhe sytë sikur iu veshën me një cipë të hollë.

— S'e kemi dëgjuar. Si zor, — tha ai dhe, pa e hequr atë cipë që i vishte sytë, shtoi: — E po, moj Aksjutka, bëj qejf ahere me zonjat!

Dhe me kaq, Buzovkini u ngut të largohej.

— I di të gjitha dhe si duket qenka e vërtetë që ai dashka të shkëmbehet, — tha Nabatovi. — Po ju, ç'kini ndërmënd të bëni?

---

1) Llopot = në dialektin e Siberisë do të thotë fustan. (Shën. i përk.)

— Sa të arrijmë në qytet, do t'i vë në dijeni autoritetet. I njoh me fytyrë që të dy, — tha Nekludovi.

Heshtnin të gjithë sepse, me sa dukej, kishin frikë se mos shpërthente përsëri ndonjë grindje.

Simonsoni, që kish ndenjur i heshtur gjatë tërë asaj kohe, i shtirë në krevatin e tij në qoshe, u drejtua befas, brofi në këmbë i vendosur dhe, duke ecur me kujdes që të mos shtynte njeri, iu afrua Nekludovit dhe e pyeti:

— Ka mundësi tani t'ju them dy fjalë?

— Pse jo? — tha Nekludovi dhe u çua për t'i rënë pas.

Duke kthyer kokën nga Nekludovi që po ngrihej, Katjusha ndeshi në vështrimin e tij dhe menjëherë u skuq në fytyrë e tundi kokën si e hutuar.

— Ja ç'kisha për t'ju thënë, — nisi Simonsoni kur doli bashkë me Nekludovin në koridor. Në koridor dëgjoheshin fare çkoqur disa zhurma dhe zëra të egërsuara të burgosurish. Nekludovi shtrëmbëroi buzët, por Simonsonit, me sa dukej, nuk i bëri përshtypje:

— Duke ditur marrëdhënjet tuaja me Katerina Mihailovnën, — filloi ai duke e vështruar me ngulm Nekludovin drejt e në fytyrë me ata syt' e tij të butë. — e ndjej për detyrë... — këtu Simonsonit iu desh të ndalonte sepse, pikërisht atë çast, tamam atje tek dera, u dëgjuan dy zëra që haheshin me të madhe:

— S'janë të miat, sa herë do të ta them, or kokëderr! — thërriste një zë.

— E po në djall të vesh me gjithë to! — ja kthente një zë tjetër i ngjirur.

N'atë e sipër doli në koridor Maria Pavllovna.

— Këtu s'kini si bisedoni, — tha ajo, — ejani nga kjo anë. Përveç Veroçkës, s'ka njeri tjetër. — Duke thënë kështu, ajo u drejtua nga një dhomë e vogël që do të kish qenë, mbase, më parë, ndonjë qeli izolimi por që tani e kishin caktuar për gratë e seksionit politik. Në një shtrat që shtirë Vera Efremovna me kokën futur nën kapotë.

— I dhëmb koka, po nuk iu dëgjon se po flë. Ja, dhe unë po iki! — tha Maria Pavllovna.

— Jo, mos ikë! — i tha Simonsoni, — unë punët e mia nuk ja fsheh njeriu, aq më pak pastaj ty.

— Mirë, si të duash, — tha Maria Pavllovna dhe, duke e lëvizur tërë trupin sa nga një anë në anën tjetër, ashtu siç bëjnë nganjëherë fëmijët, dhe, duke u futur me këtë lëvizje më përbrëndazi në shtrat, vuri veshin të dë-

gjonte se çfarë do të thuhej, ndërsa syt' e saj të bukur e të qetë shikonin diku larg.

— Desha t'ju them, pra, — filloi nga e para Simonsoni, — se meqenëse jam në dijeni të marrëdhënjeve që keni me Ekaterina Mihaillovnën, e ndjej për detyrë t'ju bëj të ditur nga ana ime, qendrimin tim kundrejt saj.

— Ç'doni të thoni me këtë? — pyeti Nekludovi që nuk mund të mos admironte thjeshtësinë dhe sinqeritetin me të cilin i fliste Simonsoni.

— Me këtë dua të them se unë dua të martohem me Ekaterina Mihaillovnën...

— Kjo është për t'u habitur! — tha Maria Pavllovna, duke ja ngulur sytë Simonsonit.

— ...dhe kam vendosur t'i lutem asaj për këtë, domethënë që të bëhet gruaja ime, — vazhdoi Simonsoni.

— Po unë ç'hyj në këtë mes? Kjo varet prej saj, — tha Nekludovi.

— Po, por ajo nuk vendos pa juve.

— E pse?

— Po sepse gjersa çështja e marrëdhënjeve tuaja me të nuk do të jetë zgjidhur përfundimisht, ajo nuk mund të marrë asnjë vendim.

— Nga ana ime kjo çështje është zgjidhur përfundimisht. Unë kam dashur të veproj ashtu si mendoja se e kisha për detyrë të veproja, domethënë ta lehtësoja gjëndjen e saj; por, n'asnjë mënyrë, nuk dua që të bëhem për të një pengesë.

— Po, por ajo nuk e pranon sakrificën tuaj.

— Këtu s'ka ndonjë sakrificë.

— Dhe, me sa di unë, vendimi i saj është i prerë.

— Po, ahere, ç'është nevoja të bisedoni me mua? — tha Nekludovi.

— Ajo do që këtë vendim ta pranoni dhe ju.

— Si mund të pranoj unë një vendim që më detyron të mos bëj atë që e kam për detyrë? Unë vetëm këtë mund t'ju them: ajo është e lirë e mund të bëjë si të dojë, kurse unë s'jam i lirë.

Simonsoni heshti dhe u mendua një hop.

— Mirë, kështu po i them. Mos kujtoni se jam dashuruar me të, — shtoi ai. — Nëqoftëse e dua, e dua si një njeri të rrallë, si njeri të mrekullueshëm që ka vuajtur shumë në jetë. Unë prej saj nuk kërkoj asgjë, por kërkoj, kërkoj me çdo kusht që t'i vij në ndihmë, që t'ja lehtësoj gjën...

Nekludovi habitej kur dëgjonte se si i dridhej zëri Simonsonit.

—... t'ia lehtësoj gjëndjen, — vazhdoi Simonsoni. — Nëqoftëse ajo nuk do ta pranojë ndihmën tuaj, le të pranojë timen. Nëqoftëse ajo do të jetë dakord, unë do kërkoj që të më internojnë në të njëjtin vend me të. Katër vjet nuk janë shumë. Duke jetuar pranë saj, ndofta, do të mund t'ia lehtësoj gjën... — ai ngeci dhe këtu pa vazhduar dot më tutje nga mallëngjimi.

— E ç'tju them unë? — tha Nekludovi. — Gëzohem që paska gjetur një mbrojtës të tillë...

— Ja, pikërisht këtë doja të dija, — vazhdoi Simonsoni. — Doja të dija nëse, duke e dashur, duke i dashur asaj të mirën, e quani një gjë të mirë martesën tonë?

— Patjetër! — tha Nekludovi pa ngurruar.

— Çdo gjë varet prej saj, unë dua vetëm që shpirti i saj i lodhur të shplodhet, — tha Simonsoni, duke e vështruar Nekludovin me një butësi kaq feminore që nuk mund të pritej kurrsesi nga një njeri aq i zymtë.

Simonsoni u ngrit dhe, si e tërhoqi Nekludovin për nga vetja, i afroi fytyrën, i buzëqeshi me ndroje dhe e puthi.

— Ahere, kështu po i them, — tha ai dhe doli.

XVII

— E patë? — tha Maria Pavllovna. — Është dashuruar, është dashuruar me tërë mënd. Kurrë nuk do ta kisha besuar që Vladimir Simonsoni të dashurohej kështu, marrëzisht, si një fëmijë. Çuditem dhe, t'ju them të vërtetën, më vjen keq, — e përfundoi ajo duke psherëtitur.

— Po Katja? Po ajo ç'mendim ka? Dini gjë?... — pyeti Nekludovi.

— Ajo? — Maria Pavllovna u ndal një hop duke dashur, me sa dukej, të përgjigjej saktë. — Ajo?... Ja, si t'ua them... Ajo, me gjithë të kaluarën e saj, është për nga natyra një njeri me cilësira morale shumë të larta,... një njeri që ndjen shumë hollë... Ajo ju do, ju do me një dashuri të sinqertë dhe do të qe e lumtur sikur të bënte të paktën për ju një mirësi negative, si të thuash, t'u detyronte me fjalë të tjera të hiqnit dorë prej saj. Martesa me ju do të qe për të një gjë e tmershme, shumë më e tmershme se ajo që pat

ndodhur më parë mes jush dhe, prandaj, ajo nuk do ta pranonte kurrë një gjë të tillë. Sidoqoftë prania juaj e çqetëson.

— Po unë, atëhere, ç'duhet të bëj? Të zhdukem? — tha Nekludovi.

Maria Pavllovna buzëqeshi, me atë buzëqeshjen e saj të ëmbël feminore.

— Po, pjesërisht.

— Në ç'mënyrë të zhdukem pjesërisht?

— Më falni, se ju gënjeva, por qëllimi im ishte t'ju vija në dukje se ajo, s'ka dyshim, e sheh se dashuria entuziaste e Simonsonit për të (ai akoma nuk i ka thënë asgjë), është fare pa vend dhe, nëse nga një anë i vjen mirë, nga ana tjetër ka shumë frikë. Siç e dini unë nuk jam kompetente në të tilla çështje, por, megjithatë, mua më duket se ajo ndjenja e tij është krejt e rëndomtë, është si ajo e të gjithë burrave kundrejt grave, sadoqë e maskuar. Ai thotë se kjo dashuri ja shton energjitë, se është një dashuri platonike. Por unë e di mirë se, edhe sikur të jetë një dashuri e jashtëzakonëshme, në thelb, ka patjetër diçka të ndyrë... Ashtu si në rastin e Novodvorovit me Ljuboçkën.

Maria Pavllovna u kap pas temës së saj të preferuar dhe u largua nga thelbi i bisedës.

— Po atëhere, pra, ç'duhet të bëj unë? — pyeti Nekludovi.

— Unë mendoj se duhet të bisedoni me të. Është më mirë që çdo gjë të jetë e kjartë. Po të doni, po ua thërres, — tha Maria Pavllovna.

— Do t'ju lutesha, — tha Nekludovi.

Maria Pavllovna doli.

Një ndjenjë e çuditëshme e pushtoi Nekludovin kur u ndodh vetëm n'atë qeli të vogël, duke dëgjuar frymëmarrjen e lehtë të Vera Efremovnës që ndërpritej hera herës nga ndonjë e rënkuar, dhe gumëzhimën e të burgosurve ordinerë që dëgjohej parreshtur nga të dy dyert.

Ato që i kishte thënë Simonsoni e çlironin Nekludovin nga një zotim që, në çastet e dobësisë, i dukej i rëndë dhe i çuditshëm, por ai, në vend që të gëzohej, u hidhërua. Propozimi i Simonsonit e errësonte në syt' e tij dhe në syt'e të tjerëve vlerën e sakrificës që ai kishte bërë dhe me të cilën, gjer diku, mburrej përpara vetes: kur një njeri, dhe një njeri kaq i mirë, që s'kishte asnjë detyrim karshi saj, shprehej i gatshëm të martohej me të, ahere, ç'rëndësi i mbetej, në krahasim me këtë, sakrificës së Nekludovit?

Ç'ishte ajo përpara asaj që po bënte Simonsoni? Natyrisht, diçka shumë e vogël. N'atë ndjenjë që provonte tani Nekludovi përzihej, mbase, edhe xhelozia: ai tanimë qe mësuar me dashurinë e saj dhe nuk mund të pranonte që ajo të dashuronte një tjetër. Më në fund, fjalët e Simonsonit ja përmbysnin Nekludovit planin që kish hartuar për të jetuar pranë saj gjersa ajo të shlyente dënimin. Sikur ajo të martohej me Simonsonin, atëhere ai duhej të largohej, se s'kishte më kuptim të rrinte më atje, pranë saj, dhe, prandaj, duhej të bënte një tjetër plan për jetën e tij. Por ai nuk pati kohë t'i analizonte të gjitha këto ndjenja sepse, përmes derës së hapur, depërtuan zërat e të burgosurve, këtë radhë akoma më të forta, dhe atë çast hyri në qeli Katjusha.

Ajo iu afrua duke nxituar.

— Më dërgoi Maria Pavllovna, — tha, duke u ndalur pranë tij.

— Po, kam nevojë të bisedoj me ju. Po uluni, uluni! Vladimir Ivanoviçi më foli.

Ajo u ul, lidhi duart mbi gjunjë dhe në fillim dukej e qetë por, kur Nekludovi zuri me gojë emrin e Simonsonit, u skuq menjëherë në fytyrë.

— E çfarë ju tha? — pyeti.

— Ai më tha se do të martohet me ju.

Fytyra e saj, befas, u ngërdhesh duke marrë një shprehje mjerimi. Nuk foli më dhe uli sytë.

— Ai kërkon pëlqimin tim, ose, të paktën, këshillën time. Unë i thashë se çdo gjë varet nga ju, se ju duhet të vendosni.

— Ah, ç'janë këto? Përse? — tha ajo, dhe me atë vështrimin e saj të vëngërt, të çuditshëm, që ushtronte përherë një ndikim kaq të fortë tek Nekludovi, e shikoi atë drejt e në sy. U panë ashtu në sy disa sekonda me një vështrim që ishte kuptimplot për të dy.

— Ju duhet të vendosni, — tha përsëri Nekludovi.

— Ç'të vendos? — tha ajo. — Kjo është vendosur qëkur.

— Jo, ju duhet të vendosni nëse do ta pranoni apo jo propozimin e Vladimir Ivanoviçit, — tha Nekludovi.

— E ç'grua do t'isha unë për të? Një e dënuar me punë të detyruar... Përse ta marr në qafë dhe Vladimir Ivanoviçin? — tha ajo duke vrenjtur vetullat.

— Mirë, po sikur t'ju falnin? — tha Nekludovi.

— Ah, lemëni, ju lutem! Këtë është e kotë ta bisedojmë, — tha ajo, dhe u ngrit e doli nga dhoma.



XVIII

Kur Nekludovi u kthye, fill pas Katjushës, në qelin'e burrave, këtu të gjithë dukeshin shumë të tronditur. Nabatovi, që fuste hundën kudo, që s'linte njeri pa takuar e s'linte gjë pa vënë re, kish sjellur një lajm, i cili i kish habitur të gjithë. Ai kish gjetur në një mur një mbishkrim të cilin e kish lënë revolucionari Petlin, i dënuar me punë të detyruar. Të gjithë mendonin se Petlini tani do të qe në Kara, kurse, papritmas, u muarr vesh se ai porsa kishte kaluar n'atë rrugë me një kolonë të burgosurish ordinerë.

«Më 17 gusht, — thuhej në këtë mbishkrim, — u nisa me një kolonë të burgosurish ordinerë. Ishte me mua edhe Neverovi, i cili vari veten në Kazan, në një çmëndinë. Me shëndet jam mirë, ashtu dhe me moral dhe e shoh me shpresë t'ardhmen». Bisedohej për gjëndjen në të cilën ndodhej Petlini si edhe për shkaqet e vetëvrasjes së Neverovit. Të gjithë merrnin pjesë në diskutimet, përveç Krilcovit, që dukej i përqëndruar e shikonte diku përpara tij, me sytë që i xixëllonin nga ethet.

— Im shoq më thoshte se Neverovi vuante nga alucinacioni që kur ishte në kështjellën e Petropavllovskut, — tha Ranceva.

— Po, ka qenë një poet, një njeri i ekzaltuar. Njerëzit si ai nuk e durojnë dot vetëminë, — tha Novodvorovi. — Ja, unë, kur më veçonin, e frenoja fantazinë time dhe e përdorja kohën në një mënyrë sa më simetrike. Në këtë mënyrë, i duroja të gjitha fare mirë.

— E pse mos t'i durosh? Mbase nuk u besohet, por ua them me tërë mënd se mua më bëhej qejfi kur më fusnin brënda, — tha Nabatovi me një zë energjik, duke dashur, me sa dukej, ta largonte pikëllimin që vinte re në fytyrat e brengosura të shokëve. — Kur je i lirë, rron me frikë në zemër: ke frikë se mos të kapin, se mos komprometon shokët e njëmijë frikëra të tjera. Por kur je brënda, atëhere mbaron çdo përgjegjësi dhe mund të shplodhesh i qetë. S'ke më telashe e s'të mbetet gjë tjetër veçse të rrish aty rehat e të pish duhan.

— E ke njohur? — pyeti Maria Pavllovna duke hedhur sytë, e shqetësuar, nga Krilcovi që u pre, befas, në fytyrë.

— Neverovi, një njeri i ekzaltuar? — foli papritmas Krilcovi, ndërsa i merrej frymа sikur kish thirrur apo kish kënduar për një kohë të gjatë. — Neverovi ishte nga ata

njerëz të cilët, siç thoshte ai portjeri ynë, vetëm një herë i bën nëna... Po... ishte njeri i kristaltë, mund ta shikoje tej-përtej. Po... ai, jo vetëm që s'gënjente dot, po nuk ishte i zoti as t'i fshihte mendimet e tij. Të thuash që lëkura e tij ishte e hollë, është pak: ai s'kishte fare lëkurë, ishte me nerva përjashta... Po... ishte njeri me një natyrë të pasur, të ndërlikuar, jo si... Po më mirë le ta lëmë këtë bisedë!... — Ai heshti një hop, pastaj filloi përsëri, çehrengrysur e me inat: — Ne hahemi këtu se si është më mirë: a është më mirë ta nxjerrim më parë popullin nga injoranca e pastaj t'i ndryshojmë format e jetës, apo të ndryshojmë më parë format e jetës? Pastaj, si duhet luftuar? Me propagandë paqësore apo me terror? Ja, kështu rrimë e diskutojmë, jo po kështu, jo po ashtu... Kurse ata, ata nuk diskutojnë, ata e dinë se ç'duhet të bëjnë dhe s'pyesin a marrin në qafë me dhjetra e me qindra njerëz, e çfarë njerëz! Përkundrazi, ata këtë kërkojnë, t'i zhdukin ata më të mirët. Po, Herceni thoshte se kur dekabristët i hoqën nga mezi, niveli i përgjithëshëm i shoqërisë ra në një shkallë shumë të ulët. E si të mos binte! Pastaj hoqën nga mezi edhe Hercenin vetë me shokët e tij. Kurse tani e kanë radhën Neverovët...

— E po të gjithë nuk i zhdukin dot, — ndërhyri me atë zërin e tij energjik Nabatovi. — Do të mbeten edhe ca për të larë hesapet me ta.

— Jo, nuk do të mbeten, po të jetë se neve do të na vijë keq për ta, — tha Krilcovi duke ngritur zërin. — Më jep një cigare.

— Po ti nuk je mirë, Anatol, — tha Maria Pavllovna, — të lutem, mos pi cigare.

— Lemë rehat! — tha ai me të rreptë dhe e ndezi cigaren, por menjëherë e mbyti kolla dhe i erdhi për të vjellur. Pastaj, si pështyu, vazhdoi: — Jo, s'e kemi mirë, nuk e kemi mirë. S'është puna të arësyetojmë, por të bashkohemi të gjithë si një bllok... dhe t'i zhdukim. Po.

— Po ju harroni se dhe ata janë njerëz, — tha Nekludovi

— Jo, ata nuk janë njerëz... ata që bëjnë këto... Ja, thonë kanë çpikur bomba dhe ballona. Po, këta e duan t'u ngrihesh përpjetë me një ballon e t'i çfarosësh nga lart me bomba si ato çmkat... Po. Sepse... — po s'e mbaroi, sepse u skuq i tërë, e mbyti befas një kollë dhe gjaku i shpërtheu çurg nga goja.

Nabatovi vrapoi menjëherë jashtë që t'i sillte ca borë. Maria Pavllovna hodhi disa pika valerianë në një gotë



dhe ja afroi në gojë; por Krilcovi i mbante mbyllur sytë, e shtynte gotën me atë dorën e tij të bardhë e të thatë, e gjithë vazhdonte të merrte frymë thellë e dëndur. Kur bora dhe uji i ftohtë e qetësuan disi, ai kërkoi ta shtrinin në krevat. Nekludovi u ngrit, u përshëndet me të gjithë dhe, bashkë me nënoficerin që kishte ardhur ta merrte dhe që kishte qëkur që po e priste, doli jashtë.

Të burgosurit tani nuk ndjeheshin më. Shumica e tyre flinte. Megjithëse ata që ndodheshin në qelira nuk kishin lënë asnjë pëllëmbë vend pa çfrytëzuar, duke u shtrirë edhe nën shtretërit prej dërrase, shumë prej tyre nuk kishin gjetur dot vend aty dhe qenë shtrirë në çimenton e thatë të koridorit duke vënë nën kokë trastat e duke u mbuluar me kapotat që i kishin të lagura.

Dëgjoheshin të gërhitura, rënkime e të përçartura në gjumë. S'kishte vend që të mos shikoje njerëz të shtrirë, ngjeshur njëri pas tjetrit, të mbuluar me kapotë. Vetëm në qelin'e beqarëve kishte nja dy-tre të burgosur që s'po flinin akoma, por qenë ulur rreth një bisht qiriri të cilin e fikën menjëherë porsa panë nënoficerin. Po ashtu edhe në koridor, një plakë po rrinte lakuriq pranë një llambe e po qëronte morrat nga këmisha. Ajri i prishur i lokalit, ku mbaheshin të burgosurit politikë, dukej krejt i pastër në krahasim me atë ajrin e qelbur e mbytës që kishte këtu. Llamba dukej si përmes ndonjë mjergulle dhe të gjithë mezi merrnin frymë. Që të kaloje nëpër koridor pa shkelur ndonjë nga ata që flinin dhe pa u penguar në hekurat që mbanin në këmbë, duhej të mateshe mirë para se ta hidhje hapin e, pasi të bëje një hap, duhej të zgjidhje vendin për hapin tjetër. Nja tre veta që, me sa duket, s'kishin gjetur dot vend në koridor, qenë shtrirë në hajat, tamam nën atë vozgën e qelbur që të burgosurit e quanin «paraha» nga e c'la rridhte një lëng i pështirë. Njeri nga këta ishte një plak budalla të cilin Nekludovi e kishte vënë re kaq herë gjatë udhëtimit. Tietri ishte një djalë nia dhjetë viec që qe shtrirë ndërmjet dy të burgosurve dhe flinte mbi këmbën e njërit, me dorën nën faqe.

Kur doli jashtë, Nekludovi u ndal dhe e mbushi gjoksin, me sa mundi, me ajrin e ngrirë të mbrëmjes.

XIX

Jashtë, qielli shkëlqente nga yjet. Pasi u kthye në hanin e tij, duke ecur nëpër rrugën e ngrirë nga të ftohtit e vetëm aty-këtu me një baltë të njomë, Nekludovi trokiti në xhamin e errët të dritares. Djaloshi shpatullgjërë i hanit, doli zbathur, i hapi derën dhe e priu në hajat. Në të djathtë të hajatit dëgjoheshin gërrhimat e forta të karrocierëve që flinin në izbën e përbashkët; përpara, pas derës, n'oborr, dëgjohej zhurma që bënte një numër i madh kuajsh duke mbllaçitur tagjinë. Në të majtë vinte dera që të çonte në dhomën e pastër që rezervohej për klientat e zgjedhur. Në dhomë ndjehej një erë e fortë pelini. Pas një çatmaje dëgjohej gërrhima ritmike e një njeriu të shëndoshë. Një llambë me xham të kuq flakëronte përpara ikonave. Nekludovi u çvesh, shtroi **plaid-in** dhe jastëkun e tij prej lëkure mbi një divan prej dru panje dhe u shtri, duke sjellur ndërmënd të gjitha ato sa kish parë e kish dëgjuar atë ditë. Nga sa që kish parë atë ditë, më e tmerëshme i dukej Nekludovit pamja e kalamanit që flinte mbi lëngun e pështirë që rridhte nga «paraha», me kokën e mbështetur mbi këmbën e të burgosurit. Megjithëse bisedat që kishte patur atë ditë me Simonsonin dhe me Katjushën, kishin qenë për të fare të papritura dhe kishin një rëndësi shumë të madhe, ai nuk u ndal mbi këtë ngjarje meqënëse qendrimi që duhej të mbante kundrejt saj ishte tepër i ndërlikuar dhe, në të njëjtën kohë, akoma i papërcaktuar. Prandaj ai i largoi nga vetja të gjitha mendimet që kishin të bënin me të dhe, përkundrazi, përfytyroi me një giallëri të jashtëzakonëshme të burgosurit e mjerë që mezi merrnin frymë nga ajri mbytës i qelive dhe që qenë shtrirë, për mungesë vendi, mbi lëngun e ndytë që rridhte nga vozga e qelbur. S'i dilte nga mëndja sidomos ajo fytyra e njomë e kalamanit që flinte mbi këmbën e të burgosurit.

Tjetër është të dish që diku larg ka njerëz që torturohen me lloj-lloj poshtërime e vuajtje, dhe tjetër është t'i shikosh me sy gjatë tre muajve këto poshtërime e vuajtje. Nekludovi tani këtë e kuptonte mirë. «Unë jam vallë i marrë që shikoj gjëra të cilat të tjerët nuk i shikojnë, apo të marrë janë ata që i bëjnë ato që unë shikoj?» — e kishte pyetur ai veten kaq e kaq herë gjatë atyre muajve. Po nierëzit (dhe qenë shumë) i kryenin ato që atë e habisnin dhe e tmeronin, kaq të qetë e kaq të sigurtë se kryenin një

vepër të rëndësishme e të dobishme, sa që qe e vështirë të mendoje se këta njerëz qene të marrë; por, nga ana tjetër, ai nuk mund të pranonte se qe vetë i marrë, sepse qe plotësisht i ndërgjegjshëm për ktnjellësin' e mendimeve të tij. Prandaj dhe ndodhej përherë në një gjëndje ngurrimi e cila e paralizonte në çdo veprim.

Sa kishte pare gjatë atyre tre muajve, ai i përmblidhte pak a shumë në këtë mënyrë: nga të gjithë njerëzit e lrë, nëpërmjet gjyqit dhe organeve administrative, zgjidheshin dhe futeshin në burg tipat më nervozë, më gjaknxehtë, më të ekzaltuar, më të talentuar dhe më energjikë e, në të njëjtën kohë, më pak dinakë e më pak të matur se sa të tjerët. Këta njerëz, që nuk ishin për shoqërinë me tepër të rrezikshëm dhe nuk ishin ndaj saj më tepër fajtorë se sa ata që liheshin të lirë, mbylleshin në radhë të parë në burg dhe degdiseshin nëpër fusha përqëndrimi e në Siberi, ku mbaheshin muaj e vite me radhë në një gjëndje papunësie të plotë, duke i vënë në pamundësi që të mendonin për jetën e tyre, duke i larguar nga natyra, nga familja, nga puna, domethënë nga të gjitha kushtet e një jete njerëzore, të natyrëshme dhe morale. Kjo, në radhë të parë. Në radhë të dytë, këta njerëz i poshtëronin, pa qenë nevoja, në lloj-lloj mënyra: duke i lidhur me hekura, duke u rruar kokën, duke i veshur me uniformën e torpëshme të burgut. Në këtë mënyrë u hiqej atyre frika e opinionit publik, turpi, dhe vetëdija e dinjitetit të tyre si njerëz, domethënë, të gjitha ato shtytje për një jetë morale për të cilën kanë nevojë njerëzit e dobët. Nga ana tjetër, duke rrezikuar vazhdimisht jetën e tyre, për shkak të sëmundjeve ngjitëse që përhapeshin vazhdimisht nëpër burgje, për shkak të torturave, të rrahjeve me njeri-tjetrin, pa marrë këtu parasysh rastet e jashtëzakonëshme të vdekjes nga dielli, nga përmbytjet dhe nga zjarri, këta njerëz viheshin detyrimisht në një gjëndje shpirtërore të tillë në të cilën çdo njeri, qoftë edhe ai më i miri, qoftë dhe ai më i përsosuri nga pikëpamja morale, shtyhet, nga instinkti i vetëmbrojtjes, të kryejë me lehtësinë më të madhe, qoftë edhe krimin më të shëmtuar. Në radhë të katërt, këta njerëz, detyroheshin të bashkëjetonin me njerëz të përdhosur plotësisht nga ky ambjent, me pushtër, me vrasës, me keqbërës, të cilët vepronin mbi të gjithë ata që nuk ishin të përdhosur akoma plotësisht nga mjetet e përdorura më parë, po ashtu siç vepron tharmi në brumë. Më në fund, të gjithë këtyre njerëzve u futej në kokë, me

anë të një metode që ishte më e sigurta nga të gjitha, e, pikërisht, nëpërmjet gjithfarë veprimesh çnjerëzore që kryheshin mbi ata vetë, me anë të torturave që u bëheshin fëmijëve, grave, pleqve, me anë të rrahjeve me thupër e me kamzhik, me anë të çmimeve që u jepeshin atyre që e kapnin të gjallë apo të vdekur shokun e tyre të arratisur, me anë të ndarjes së burrave nga gratë, me anë të bashkëjetesës së përbashkët të grave të huaja me burra të huaj, me anë të pushkatimit e me anë të vrasjes, — u futej, pra, në kokë, me një metodë fare të sigurtë, se dhuna, krimi, shtazërimi, jo vetëm që nuk ndalohen nga qeveria, por edhe përkrahen kur kjo është në interes të saj dhe aq më tepër, pra, u lejohen atyre që janë nën zgjedhë dhe që i bëjnë nga e keqja dhe nga skamja.

Mund të thuhej se të gjitha këto institucione qenë krijuar me të vetmin qëllim për ta ngritur korruptimin dhe vesin në shkallën më të lartë që mund të mendohej e që nuk mund të arrihej kurrsesi në rrethana të tjera, dhe për ta përhapur pastaj në një përpjestim sa më të gjërë e me një kualitet sa më të lartë, në masat e gjera të popullit. «Veprohet tamam sikur kërkojnë për të gjetur metodën më të mirë e më të sigurtë për të korruptuar sa më shumë njerëz», — mendonte Nekludovi duke patur parasysh ato që bëheshin nëpër burgje. Me qindra mijë njerëz ngriheshin çdo vit në shkallën më të lartë të korruptimit dhe, pasi korruptoheshin gjer në fund, liheshin të lirë me qëllim që ta përhapnin korruptimin që kishin përvetësuar në burg në mbarë popullin.

Në burgjet e Tjumenit, të Ekaterinburgut, të Tomskut, si edhe në të gjitha burgjet provizorë gjatë rrugës për në Siberi, Nekludovi kish vënë re se kjo detyrë që dukej sikur shoqëria i kishte vënë vetes, po realizohej me sukses. Njerëz të thjeshtë, të zakonshëm, të pajisur me parimet morale të shoqërisë së shëndoshë ruse, të fshatarësisë e të fesë së krishtere, i flaknin këto parime dhe përvetësonin parime të reja, ato të burgut, sipas së cilave, çdo njeri kishte të drejtë ta dhunonte, ta fyente, ta poshtëronte e ta vriste tjetrin kur ta donte puna. Ata që kishin jetuar nëpër burgje, duke parë ato që u punonin, qenë bindur dalngadalë se të gjitha ligjet morale të respektit e të dashurisë për njeriun, të cilat trumbetoheshin nga kisha e nga shteti, në të vërtetë nuk kishin asnjë fuqi dhe se, prandaj, ata nuk kishin sepse t'u përmbaheshin. Nekludovi e kishte vënë re këtë gjë tek të gjithë

të burgosurit që njihte: tek Fedorovi, tek Makari e, bile, dhe tek Tarasi i cili, në dy muaj që kishte jetuar me të burgosurit, qe çthurur në një mënyrë të habitëshme. Rrugës, Nekludovi kish marrë vesh se të burgosurit që arratiseshin në tajgë, merrnin me vete edhe ndonjë shok dhe, si e vritnin, ushqeheshin me mishin e tij. Ai kishte parë me syt' e tij një prej këtyre njerëzve që akuzohej dhe e pohonte se e kishte kryer këtë vepër të tmerëshme. Por më e tmershmja ishte se këto raste nuk qenë të rralla, por, përkundrazi, përsëriteshin vazhdimisht.

Vetëm duke i kushtuar kultivimit të vesit një kujdes të veçantë, ashtu siç bëhej në këto institucione, kishte mundësi që njeriu rus të kthehej, ashtu si ata të arratisurit, në antropofag, duke paralajmëruar kështu teorin' e re të Niçes. Vetëm kështu kishte mundësi të arrihej gjer në asgjesimin e plotë të çdo kufizimi moral, duke e përhapur këtë teori në fillim ndërmjet të burgosurve e, më vonë, në mbarë popullin.

Ashtu siç shkruhej në libra, të gjitha këto bëheshin për t'i kufizuar krimet, me qëllim frikësimi, ndreqjeje dhe nën pretekstin e hakmarrjes ligjore të shoqërisë. Por, në të vërtetë, nuk bëhej asnjëra nga këto. Krimet, në vënd që të kufizoheshin, shtoheshin. Keqbërësit, në vend që të frikësoheshin, nxiteshin edhe më tepër për të kryer krime e shumë prej tyre, si për shëmbull endacakët, kërkonin vetë të futeshin në burg. Njerëzit, në vënd që të ndreqeshin, infektoheshin përkundrazi në një mënyrë sistematike me të gjitha llojet e veseve. Në vënd që t'i pritej hovi hakmarrjes nëpërmjet të dënimeve administrative, ajo zhvillohej edhe më tepër dhe përhapej edhe atje ku më parë nuk njihej.

«Po, ahere, pse i bëjnë të gjitha këto?» — e pyeste veten Nekludovi, pa qenë në gjëndje të përgjigjej.

Ajo që e habiste me tepër Nekludovin ishte se të giitha këto nuk ndodhnin rastësisht apo për ndonjë keqkuptim, s'ndodhnin një herë po vazhdimisht, shekuj me radhë, me të vetmin ndryshim se, më parë, të burgosurve u shkulnin hundën, u prisnin veshët, i damkosnin me hekur të nxehtë e i zvaritnin me qerre, kurse tani i lidhnin me pranga e i transportonin me vapor.

Nekludovi nuk bashkohej me mendimin e personelit të burgjeve, sipas të cilit, të gjitha tmeret që ai vinte re nëpër burgje, rridhnin ngaqë këto kishin akoma shumë të meta të cilat do të mund të zhdukeshin duke ndërtuar një burg

të tipit të ri. Ai ndjente se të gjitha ato që e revoltonin nëpër burgje, nuk e kishin aspak burimin tek të metat e tyre. Ai kishte lexuar në libra për disa burgje të përsosur, me zile elektrike, ku ekzekutimet me vdekje kryheshin me anë të korentit, ashtu siç propozonte Tarde. Por dhuna që kryhej me mjete moderne, e revoltonte atë edhe më tepër.

Ajo që e revoltonte sidimos Nekludovin ishte se nëpër gjyqe e nëpër ministrira kishte njerëz të cilëve populli u paguante një rrogë të madhe që të konsultonin ca libra të përpiluara nga po të tillë njerëz, siç ishin dhe ata vetë, dhe me anë të tyre t'i kategorizonin njerëzit që shkelnin ligjet e shkruara prej tyre; duke i ndarë këta nëpër kallëpet e neneve e të nën-neneve, duke i degdisur pastaj sipas këtyre kallëpeve larg e më larg, që të mos i shikonin më me sy, dhe ku, të braktisur në duart e disa drejtorave, gardianëve e inspektorëve zemërgurë, vdisnin me miliona shpirtërisht e fizikisht.

Duke i njohur burgjet përsëafërmi, Nekludovi vinte re se të gjitha veset që lindnin tek të burgosurit: alkolizmi, kumari, shtazërimi si edhe të gjitha krimet e tmerëshme që kryheshin nga të burgosurit, bile edhe vetë antropofagjia, nuk ishin gjëra të rastit dhe as çfaqje të degjenerimit, të tipit kriminel, të përbindëshit, ashtu siç duan të provojnë disa shkencëtarë matufë për të justifikuar qeverinë, por ishin një pasojë e pashmangëshme e besimit të gabuar që kanë njerëzit se kanë të drejtë ta denojnë njëri-tjetrin. Nekludovi vinte re se antropofagjia nuk fillonte në tajgë, por nëpër ministritë, nëpër komitetet dhe nëpër departamentet e shtetit dhe vetëm përfundonte në tajgë; se kunati i tij, për shëmbëll, ashtu si edhe të gjithë gjykatësit e nëpunësit e tjerë, duke filluar nga ftuesi i gjyqit e gjer te ministri, as që e çante fare kryet për drejtësinë dhe për të mirën e popullit, siç thoshte, por bëhej merak vetëm për ato rublat që merrte çdo muaj e që ja paguanin për të kryer të gjitha ato veprime, të cilat kishin për pasojë degjenerimin dhe vuajtjet. Kjo ishte krejt e kjartë.

«Ahere, pra, të gjitha këto s'qenkan tjetër veçse pasojë e një keqkuptimi? Po si mund të veprohet që t'u sigurohet të gjithë këtyre nëpunësve një rrogë e, bile, t'u jepet edhe një shpërblim, vetëm e vetëm që të heqin dorë nga ato që po bëjnë?» — mendoi Nekludovi. Dhe, në këto mendime, si këndoi edhe këndezi i dytë, ai mbylli sytë e fjeti, megjithë

pleshtat që kërcenin nga trupi i tij si ujët e një shatërvani edhe në lëvizjen më të vogël.

XX

Kur Nekludovi u zgjua nga gjumi, karrocierët kishin ikur qëkur. Hanxhesha, pasi piu çajin duke fshirë me shami qafën e saj të trashë, të dirsur, erdhi e i tha se një ushtar kish prurë për të një pusullë. Pusulla ishte e Maria Pavllovnës. Ajo i shkruante se kriza e Krilcovit ishte shumë më e rëndë se sa kishin menduar. «Ne në fillim vendosëm të mos e merrnim me vete por ta linim këtu gjersa të bëhej më mirë, mirëpo këtë nuk na e lejuan. Jemi shumë në merak për të, kemi frikë se mos na pësojë gjë rrugës. Përpiqu që, po të jetë se do të na e lejojnë, ta shtrojmë diku në ndonjë spital në qytet e të mbetet dhe ndonjë prej nesh që t'i shërbejë. Nëqoftëse për këtë është e nevojëshme që unë të martohem me të, unë, natyrisht, jam gati».

Nekludovi dërgoi shërbëtorin e hanit për të zënë kuajt me qira në stacionin më të afërt e nisi të bënte gati plaçkat. Nuk e kishte pirë akoma gotën e dytë të çajit, kur trojka e shërbimit postar iu afrua hanit me një tringëllimë zilesh dhe me një trokëllimë rrotash mbi baltën e ngrirë të rrugës. Si i shleu llogarinë hanxheshës së trashë, Nekludovi doli pa humbur kohë e, si zuri vend në një qoshe të talikes, e urdhëroi karrocierin që t'i ngiste kuajt sa më shpejt, me qëllim që të arrinte kolonën e të burgosurve, e cila duhej të qe nisur me kohë. Ata i arritën qerret e ngarkuara me trasta e me të sëmurë që përbënin bishtin e kolonës e që kërkëllinin me zhurmë mbi baltën e ngrirë, tashmë të dystuar, të rrugës, pothuaj në të dalë të fshatit. Oficeri nuk qe atje, sepse kishte dalë në krye. Ushtarët që, me sa dukej, kishin pirë para se të niseshin, ecnin në të dy anët e rrugës duke biseduar mes tyre çakërqejf. Qerret qenë të shumta. Të burgosurit ordinerë, ata prej tyre që ishin të sëmurë e të dobët, qenë ngjeshur në qerret e kreut nga gjashtë e nga gjashtë, kurse të burgosurit politikë qenë vendosur tre nga tre në qerret e pasme. Në qerren e fundit fare kish zënë vend Novodvorovi, Grabjeci dhe Kondratjevi, kurse në të parafundit — Ranceva, Nabatovi si edhe ajo gruaja e dobët me reumatizëm, së cilës Maria Pavllovna i

kishte liruar vendin e saj. Krilcovi ndodhej në qerren e tretë nga fundi, i shtrirë mbi kashtë dhe me disa jastëkë nën krye. Pranë tij qe ulur Maria Pavllovna. Nekludovi i thirri karrocierit të ndalej pranë Krilcovit dhe, si zbriti nga talikja, iu afrua. Një ushtar i dehur që ruante kolonën, ja bëri me dorë Nekludovit që të largohej, por Nekludovi s'ja vuri veshin dhe vazhdoi të ecte pranë qerres duke u kapur me dorë pas saj. Krilcovi, me një «tulup» në trup e me një berretë astrakani në kokë, me gojën lidhur me një shami, dukej akoma më i hollë e më i zbetë. Syt' e tij të bukur të linin përshtypjen se ishin edhe më të mëdhenj, edhe më të shëndritshëm se sa qenë në të vërtetë. Duke u lëkundur lehtë nga tronditjet e qerres, ai s'i hiqte sytë nga Nekludovi dhe, kur ky e pyeti se si ishte me shëndet, nuk foli por vetëm mbylli sytë dhe tundi kokën me një çehre të rreptë në fytyrë. Gjithë energjia e tij, me sa dukej, shpenzohej për të përballuar tronditjet e qerres. Maria Pavllovna kish zënë vend në anën tjetër të qerres. Ajo shkëmbeu me Nekludovin një vështrim kuptimplot që shprehte të gjitha shqetësimet e saj mbi shëndetin e Krilcovit dhe, menjëherë pastaj, duke thirrur me zë të lartë që të dëgjohej nga Nekludovi përmes zhurmës që bënin rrotat e qerres, tha e gëzuar:

— Me sa duket, oficerit i erdhi turp. Buzovkinit ja hoqën prangat. Ai e mban tani vetë vajzën. Bashkë me ta janë Katja dhe Simonsoni, si edhe Veroçka që shkoi në vendin tim.


Krilcovi diç përshpëriti që nuk u dëgjua, duke kthyer sytë nga Maria Pavllovna, dhe tundi kokën, i zymtë, me që. me sa dukej, i vinte për të kollur. Nekludovi zgjati kokën e iu afrua. Atëhere Krilcovi e nxori gojën nga shamia dhe belbëzoi:

— Tani jam shumë më mirë. Po, thuaj, të mos ftohem.

Nekludovi i dha të kuptojë me kokë se e mori vesh se ç'i tha, e shkëmbeu një vështrim me Maria Pavllovnën.

— Po ai problemi i tre trupave si u bë? — pëshpëriti akoma Krilcovi, duke u munduar të buzëqeshte. — I dhatë ndonjë zgjidhje të arësyeshme?

Nekludovi nuk e kuptoi përse i thoshte, por Maria Pavllovna i spjegoi se ky ishte problemi i famshëm matematik mbi përcaktimin e raportit ndërmjet tre trupave qiellorë, domethënë ndërmjet diellit, hënës dhe tokës dhe se, Krilcovi, me shaka, kish dashur të bënte një krahasim me raportet ndërmjet Nekludovit, Katjushës dhe Simonsonit. Krilcovi



tundi kokën për të treguar që Maria Pavllovna i kishte rënë në të.

— S'më përket mua ta zgjidh, — tha Nekludovi.

— E muarrët pusullën që ju dërgova? Do të përpiqeni? — pyeti Maria Pavllovna.

— Patjetër, — u përgjegj Nekludovi e, duke vënë re një shprehje pakënaqësie në fytyrën e Krilcovit, hypi në taliken e tij dhe, duke u mbajtur fort që të mos rrëzohej në çdo të hovur përpjetë nepër gropat e rrugës, u lëshua të dilte në krye të kolonës së të burgosurve me kapota të murme e me gozhupe të shkurtëra, me hekura në këmbë e me pranga në duar. N'anën e kundërt të rrugës, Nekludovi çquajti shamin' e kaltërt të Katjushës, pallton e zezë të Vera Efremovnës, bluzën, shapkën e leshtë dhe çorapet e bardha, të shtërnguara nga sipër e nga poshtë me ca rrypa në trajtë opingash, të Simonsonit. Ai ecte krah për krah me gratë e diç po u fliste atyre me gjallëri.

Kur panë Nekludovin, gratë e përshëndetën me kokë, kurse Simonsoni ngriti lart shapkën rëndë-rëndë. Nekludovi, meqë s'kishte ndonjë gjë për t'u thënë, nuk u ndal, por vazhdoi rrugën e i kaloi. Duke dalë përsëri n'atë pjesë të xhades që ishte e shtruar me kalldrëm, karrocieri i ngau kuajt edhe më shpejt por, hera-herës, i duhej të zbriste në pjesën e pashtruar të rrugës që të mënjanohej nga qerret që zvarriseshin në të dy anët e saj. Rruga, tërë gropa e vazhda të thella, kalonte përmes një pylli të errët, me pishë e me bredha, që shtrinin nga të dy anët ato gjethet e tyre ngjyrë rërë, gati për të rënë. Pylli mbaronte pothuaj aty nga mezi i rrugës; u dukën nga të dy anët fusha të gjera dhe, diku larg, kryqet e artë dhe kubetë e një manastiri. Moti ndërkaq qe hapur, retë qenë shpërndarë, dielli qe ngritur përmbi pyll dhe gjethet e lagura të pemëve, llugat, kubetë dhe kryqet e kishës shkëlqenin nga dielli. Përpara, më të djathtë, në horizontin e largët mavi, zbardhëllenin disa male. Trojka hyri në një fshat të madh që ndodhej në periferi të qytetit. Rruga e fshatit qe plot me njerëz, si me rusë ashtu dhe me siberianë, me ato shapkat dhe veshjet e tyre karakteristike. Gra e burra, të dehur e esëll, qenë grumbulluar e bënin zhurmë rreth mehaneve, dyqaneve e qerreve të ngarkuara. Ndjehej menjëherë afërsia e qytetit.

Duke fshikëlluar kalin e anës e duke ndenjur shtrëmbër me qëllim që t'i kishte frerët nga e djathta, karrocieri, duke dashur me sa dukej të mburrej, i lëshoi kuajt në re-


van dhe, pa i ndalur asnjëherë gjatë tërë rrugës, arriti buzë lumit, kalimi m'anën tjetër të të cilit bëhej me trap. Nekludovit nuk iu desh të priste shumë. Trapi që po lundronte atë çast kundër rrymës, i rrëmbyer nga valët e shpejta të lumit, iu afrua pas pak skelës.

Trapanxhinjtë, ca djelmosha shtatlartë e shpatullgjërë, muskulozë e të heshtur, me guzhupe e me opinga, me njëdorë të shkathët e të stërvitur, hodhën litarët, i lidhën pas shtyllave, ulën urën, pritën sa të zbritnin në breg qerret e ngarkuara në trap, pastaj nisën të ngarkonin qerret e tjera që do të kalonin matanë lumit, duke i ngjeshur këto njerën pas tjetrës e, bashkë me to, dhe kuajt që kishin frikë nga ujtë. Valët e shpejta të lumit të gjerë përplaseshin mbi barkat e trapit duke i tendosur litarët. Kur trapi u mbush plot dhe talikja e Nekludovit dhe kuajt e zgjidhur të saj, të rrethuar nga qerret, u strukën në një qoshe, trapaxhinjtë e ngritën urën dhe, pa u vënë veshin lutjeve të atyre që kishin mbetur pa hypur, i mblodhën litarët e u nisën. Mbi trap nuk dëgjohej më asnjë zhurmë përveç lëvizjeve që bënin trapaxhinjtë dhe trokëllimës së thundrave të kuajve mbi dhogat e trapit.

XXI

Nekludovi qëndronte në këmbë buzë trapit dhe sodiste lumin e gjerë që rridhte shpejtë. S'i hiqej nga mëndja fytyra e zymtë e Krilcovit që po vdiste, koka e tij që lëkundej lehtë në çdo të tronditur të qerres. S'i hiqej gjithashtu nga mëndja Katjusha që ecte buzë rrugës me një hap të gjallë, të vendosur, krah për krah me Simonsonin. Përshtypja që i kish lënë pamja e Krilcovit i cili po vdiste dalngadalë pa e kuptuar, ishte e hidhur, e rëndë. Përshtypja tjetër, ajo e Katjushës, që kishte mundur të dashurohej nga një njeri i tillë siç ishte Simonsoni, e që kthyer përfundimisht me ndihmën e tij në rrugën e drejtë, mund të mendohej se do të qe për të e këndëshme, e gëzueshme, por, përkundrazi, kjo ishte për Nekludovin shumë më e rëndë.

Uji i lumit përcolli gjer në trap tringëllimën dhe drithërimën kumbonjëse të një kambane të madhe bakri që vinte nga qyteti. Karrocieri i Nekludovit, ashtu si të gjithë karrocierët e njerëzit e tjerë që ndodheshin në trap,



hoqi shapkën e bëri kryqin. Një plak leshatar, me trup të shkurtër që qëndronte mu në buzë të trapit dhe të cilin Nekludovi në krye nuk e kishte vënë re, nuk e bëri kryqin por ngriti kokën lart dhe e ktheu vështrimin nga Nekludovi. Plaku kishte veshur një kaftan të arnuar, një palë poture zhguni dhe i kishte këpucët të grisura e me mballoma nga të gjitha anët. Kish hedhur në krah një trastë dhe në kokë kishte një shapkë të lartë gëzofi vënde-vënde të rjepur.

— Po ti, or plak, pse nuk fale? — i tha karrocieri i Nekludovit, duke vënë përsëri në kokë shapkën. — Apo s'të kanë pagëzuar?

— E kujt t'i lutem, a nuk më thua? — ja ktheu me akërrim plaku leshatar, duke i shqiptuar shpejt e shpejt rrokjet njerën pas tjetrës.

— Po dihet se kujt, zotit, — ja ktheu karrocieri me ironi.

— Po ku është ky zoti që t'i falem, nuk më thua?

Shprehja që mori fytyra e plakut kur ai tha këto fjalë, ishte kaq hijerëndë dhe e vendosur, saqë karrocieri, duke e ndjerë që kishte të bënte me një njeri të fortë, u hutua. Por, megjithatë, nuk e dha veten që të kuptohej dhe, që të mos ja linte thatë e të mos turpërohej në sy të publikut, që po e ndiqte atë diallog të kureshtur, ja ktheu shpejt e shpejt:

— Ku? Po dihet se ku, në qiell.

— Po ti, ke qenë atje?

— Kam qenë, s'kam qenë, kjo s'ka të bëjë, po s'ka njeri që të mos e dijë se duhet t'i falemi zotit.

— Zotin asnjeri s'e ka parë, asnjeri s'e di ku është. I biri tij, që është nga një brumë me të, ai e shpalli, — tha me të rreptë plaku, po me atë të folur të shpejtë, si në fillim, e me fytyrë të ngrysur.

— Ti, si duket, s'qenke i krishterë. I fale djallit, duket, — tha karrocieri duke futur kamzhikun në brez e duke ndrequr pajimet e kalit.

Dikush qeshi.

— Po ti, or babagjysh, çfarë feje ke? — e pyeti një mesoburrë që qëndronte në një qerre buzë trapit.

— S'kam fe unë. Sepse unë, veç vetes time, s'i besoj njeriu, — u përgjegj plaku menjëherë dhe gjithë po aq i vendosur.

— Po si mund t'i besohet vetes? — tha Nekludovi, du-

ke marrë pjesë në bisedë. — Kështu njeriu edhe mund të gabohet.

— Kurrën e kurrës! — u përgjegj plaku duke tundur kokën i vendosur.

— Po përse atëhere kemi të gjitha këto fe që janë sot? — pyeti Nekludovi.

— Po sepse nuk i besojnë vetes, por u besojnë njerëzve. Ja, dhe unë u besova njerëzve dhe e humba rrugën si në tajgë; kaq keq u ngatërrova sa m'u bë koka çorbë. Të gjithë këta starovjerët, subptnikët, hlistët, popovcët, bespopovcët, austriakëy, mollokanët, skopckët [1]) e shumë e shumë të tjerë, mburrin fenë e tyre e thonë se vetëm ajo është e vërtetë, kurse të tjerat janë gënjeshtra. E ja, kështu, njerëzit janë përçarë ca andej, ca këtej, si ata këlyshët e verbër që s'dinë se ku përplasen. Fetë janë të shumta, por shpirti është një i vetëm. Dhe ai që është tek unë, është dhe tek ti, është dhe tek ai. Ndaj, po të qe që secili do t'i besonte shpirtit të tij, njerëzit do të qenë të bashkuar. Le të qendrojë njeriu ai që është dhe ahere që të gjithë do të jenë njëlloj.

Plaku fliste me zë të lartë dhe kthente kokën vazhdimisht rreth e rrotull duke dashur, me sa duket, që ta dëgjonin të gjithë.

— K'ni kohë me këtë besim? — e pyeti Nekludovi.

— Kush, unë? Kam posi! Ja, bëhen plot njëzet e tre vjet që po më ndjekin.

— Si ju ndjekin?

— Po ja, ashtu siç ndiqnin Krishtin, më ndjekin dhe mua. Më kapin e më shpien nëpër gjyqe, nëpër priftërinjë e nëpër farisenitë; një herë më flakën në një çmendinë. Po mua s'kanë ç'më bëjnë se unë jam i lirë. «Si të quajnë?» — më thonë. — Kujtojnë se po u them që quhem kështu, apo ashtu. S'e dinë që unë nuk kam emër, s'e dinë që unë i shporra të gjitha, me emër e me shtëpi e me të gjitha. Unë jam ai që jam, dhe kaq. Si të quajnë? Njeri më quajnë. «Po sa vjeç je?» — unë u them, s'para e kam zakon ti numëroj vjeçët. Le pastaj që s'kam edhe si t'i numëroj, sepse gjithmonë kam qenë, jam e do të jem. — «Po yt atë, më thonë, e jot ëmë, si quhen?» — Baba, them unë, kam zotin dhe nënë kam tokën. «Po carin, më thonë, a e njeh?» — E pse të mos e njoh? Ai është car për veten e tij, unë jam

1) Sekte të ndryshme fetare të shkëputura nga ortodoksia (shënim i përkth.)

car për veten time. — «Ehu, më thonë, me ty nuk flitet!» — E kush u tha të flitni me mua? — u them unë. E ja, kështu, më mundojnë.

— Po tani, ku po shkoni? — e pyeti Nekludovi.

— Atje ku të më shpjerë zoti. Punoj dhe, kur s'kam punë, dal e lyp, — e përfundoi plaku duke u hedhur një vështrim krenar atyre që e rrethonin.

Trapi, ndërkaq, kishte arritur në bregun matanë. Nekludovi nxori e i dha plakut disa të holla. Por plaku nuk i pranoi.

— Këto s'i marr unë. Bukë, po, — tha ai.

— Atëhere më falni.

— E pse të të fal? Ti s'më ke fyer. Le që s'ka njeri që të më fyej mua! — tha plaku duke hedhur trastën krahëve. Ndërkaq, taliken e Nekludovit e zbritën nga trapi dhe i mbrehën kuajt.

— E ç'humbitni kohë me të, barin? — i tha karrocieri Nekludovit kur ai, pasi u dha nga një bakshish trapaxhinjve, hypi në talike. — Ai duket se çështë, një bagabond, ç'tjetër?

XXII

Kur duallën në majë të kodrës rrëzë së cilës shtrihej qyteti, karrocieri ktheu kokën pas e pyeti:

— Në cil n hotel doni t'u shpie?

— Cili është më i miri?

— Më i miri është «Sibirskij.» Por edhe tek Djukovi nuk është keq.

— Atëhere më shpjer ku të duash.

Karrocieri e ktheu përsëri kokën përpara dhe i nxiti kuajt që të ecnin më shpejt. Qyteti ishte siç ishin në përgjithësi n'ato vise të gjitha qytetet: po ato shtëpi me çatira të blerta, po aio katedrale, po ato dyqane e po ata policë nëpër rrugë. Vetëm shtëpitë ishin pothuaj të giitha prej druri dhe rrugët nuk qenë të shtruara me kalldrëm. Karrocieri e ndali karrocën përpara derës së një hoteli, që ngrihej në një nga rrugët kryesore të qytetit. Por n'atë hotel dhomat qenë zënë që të giitha, kështu që iu desh të shkonin tek ndonjë tjetër. Në dhomën që zuri me qira tek hoteli i Diukovit, Nekludovi u ndodh përsëri, për herë të parë pas kaq muajve, pak a shumë në po ato kushte jetese, pastërtie dhe rehatie të këndaqëshme në të cilat ai qe më-

suar të jetonte. Gjëja e parë që duhej të bënte tani ishte të pastrohej nga morrat, nga të cilat asnjëherë nuk kishte mundur të çlirohej plotësisht gjatë udhëtimit. Kështu, si i sistemoi plaçkat, ai shkoi menjëherë në banjë dhe, që andej, si u ndërrua dhe u vesh me rrobat e qytetit, u nis e shkoi drejt e tek gubernatori i përgjithshëm. Një karrocë e lehtë luksoze, që tërhiqej nga një palë kirgize trupmadhe dhe e ushqyer mirë, e shpuri Nekludovin në të hyrë të një ndërtese të lartë e madhështore, përpara së cilës bënin roje disa policë. Përpara dhe pas ndërtesës, shtrihej një kopsht i madh ku, përmes degëve të zveshura të lisave dhe të mështeknave që ngrinin kryet lart, nxinin, të dëndura, pishat dhe bredhat.

Gjenerali atë ditë ishte pa qejf dhe nuk priste. Me gjithatë Nekludovi nguli këmbë pranë lakejt që t'i jepte në dorë kartvizitën e tij. Lakej u largua dhe u kthye pas pak me një fytyrë të qeshur.

— Mund të urdhëroni, — i tha.

Hyrja, lakej, ordinanca në derë, shkalla, salla me parket të shkëlqyer, të gjitha këto të kujtonin menjëherë Peterburgun, vetëm se këtu mungonte ajo pastërtia e atjeshëme dhe ambienti, në përgjithësi, kishte një pamje madhështore. Lakej e priu Nekludovin në kabinetin e gjeneralit.

Gjenerali ishte një tip sanguin, me një fytyrë pak si të buhavitur, me një hundë si patate, me disa gunga mjaft të dukëshme mbi ballë, tullac dhe me qeskëza nën sy. Qe mbështjellur me një robdëshambër të bollshëm mëndafshi alla tartarçe dhe rrinte ulur përpara tryezës duke pirë me një dorë cingaren dhe me tjetrën një gotë çaji me pjatarë të argjëntë.

— Tungjatjeta, batjushka! Më falni se ju pres me robdëshambër, po më mirë kështu se sa të mos ju prisja fare, — tha ai, duke mbuluar me robdëshambër zverkun e tij të majmë, palë-palë e të fishkur — Nuk jam mirë me shëndet dhe nuk dal pothuaj fare. Po juve çfarë ere ju solli këtej, në fund të dynjasë?

— Shoqëroj një kolonë të burgosurish, ku bën pjesë edhe një nieri i imi, — tha Nekludovi — Dhe ja, pikërisht për këtë njeri kam ardhur t'i lutem Shkëlqesisë suaj, si edhe për diçka tjetër.

Gjenerali thithi cingaren, piu një gllënkë çaj, e shuajti bishtin e cingares në një taketuke prej malakiti dhe, pa i hequr nga Nekludovi sytë e tij të vegjël, të zhytur në

dhjamë, që i xixëllonin, nisi ta dëgjonte me vëmëndje. Një herë vetëm e ndërpreu, kur deshi ta pyeste a dëshëronte të ndizte një cingare.

Gjenerali hynte n'atë kallëpin e ushtarakëve me shkollë, të cilët besojnë se mund të pajtohen idetë liberale dhe humanitare me profesionin e tyre. Por, duke qënë prej natyre njeri i mënçur dhe zëmërbardhë, ai e kishte ndjerë shumë shpejt pamundësinë e këtij pajtimi dhe, që të mos e shikonte kontradiktën e dukëshëme mbi të cilën kishte ndërtuar jetën e tij, qe dhënë përherë e më tepër pas pijes, ashtu si shumë shokë të tij, gjersa, pas tridhjetë e pesë vjet shërbimi, kishte arritur të bëhej alkolist. Alkoli tani i kishte hyrë thellë në gjak. Mjaftonte që të pinte fare pak që të dehej menjëherë. Pija ishte bërë për të një gjë kaq e domosdoshme saqë ishte e pamundur të rrinte, qoftë edhe një kohë të shkurtër, pa pirë. Mbrëmjeve sidomos, nuk ndodhte kurrë që të mos bëhej tapë, sadoqë mbahej aq mirë saqë nuk i merreshin këmbët dhe mund të rrinte edhe pa thënë ndonjë budallallëk. Por, fundja, edhe sikur të thoshte ndonjë budallallëk, posti që zinte ishte kaq i rëndësishëm saqë do t'ia mirrnin pa tjetër për ndonjë fjalë shumë të urtë. Vetëm në mëngjes, pikërisht n'atë kohë kur Nekludovi u takua me të, ai kishte një përgjasim pak a shumë të kënaqëshëm me një njeri të arësyeshëm që mund të kuptojë gjer diku ato që i thonë dhe që është në gjëndje të zbatojë në praktikë fjalën e urtë ruse: «I dehur dhe me sy në ballë — ja një gjë e rrallë». Eprorët e dinin që ishte pijanec por, duke marrë parasysh se, sidoqoftë, kishte më shkollë nga të tjerët (megjithqë studimet e tij kishin marrë fund menjëherë porsa kishte filluar të pinte) dhe, veç kësaj, ishte një njeri guximtar, i shkathët, i pashëm dhe dinte, qoftë edhe i dehur, të sillej me takt, vazhdonin ta mbanin n'atë vënd me rëndësi në të cilin ai ndodhej atë kohë.

Nekludovi i tregoi se personi, për të cilin ai interesohej, ishte një grua, se e kishin dënuar padrejtësisht dhe se për këtë, ai i kishte drejtuar një lutje për falje vetë perandorit.

— Kuptoj. Edhe? — tha gjenerali.

— Në Peterburg më premtuan se do të më njoftonin mbi përfundimin e lutjes të shumtën brënda këtij muaji, këtu. . .

Pa i hequr sytë nga Nekludovi, gjenerali zgjati gishtërinjtë e shkurtër të dorës për nga tryeza, i ra ziles dhe

vazhdoi të dëgjonte i heshtur, gjithë duke tymosur e duke u kollur herë pas here me zë të lartë.

— Do t'ju lutesha, pra, që, po të qe e mundur, e burgosura në fjalë të mbahej këtu në pritje të përgjegjes së lutjes. . .

Atë çast hyri në dhomë lakej, i veshur me rroba ushtarake.

— Shko shiko a është çuar Ana Vasiljevna — i tha gjenerali — dhe na sill akoma çaj. — Ç'keni tjetër veç kësaj? — pyeti duke u kthyer përsëri nga Nekludovi.

— Lutja tjetër që do t'ju bëj — vazhdoi Nekludovi — ka lidhje me një të burgosur politik, që bën pjesë po në këtë kolonë.

— Ashtu? — ja bëri gjenerali me një lëvizje kuptimplote të kokës.

— Ai është i sëmurë rëndë, është pothuaj gati për të vdekur. Që do ta shtrojnë në spital, kjo është e sigurtë, të paktën unë kështu mendoj. Por, me këtë rast, një grua, një e dënuar politike edhe ajo, kërkon që t'i qëndrojë pranë. . .

— Ç'ka të bëjë ajo me të?

— Jo, nuk ka të bëj gjë, por ajo është gati të martohet me të, po të jetë se vetëm në këtë mënyrë do t'ja arrijë qëllimit.

Gjenerali e vështronte ngultas Nekludovin me ata sytë e tij që xixëllonin si për ta hetuar me atë vështrim bashkëfolësin e tij dhe dëgjonte i heshtur duke pirë vazhdimisht duhan.

Kur Nekludovi mbaroi, ai nxorri nga sirtari i tryezës një libër dhe, duke i niomur gishtërinjtë me pështymë, shfletësoi disa faqe, gjersa gjeti më në fund nenin që fliste për martesën, dhe e lexoi.

— Me se e kanë dënuar? — pyeti, mbasi mbaroi së lexuari, duke ngritur sytë nga libri.

— Me punë të detyruar.

— Atëhere gjëndja e të dënuarit, si pasojë e martesës, nuk mund të përmirësohet.

— Po mirë. . .

— Më falni. Edhe sikur me të të martohej një nënshtetas i lirë, ajo prapseprapë duhej ta shlyente dënimin. Çështja qëndron kështu: kush nga të dy ka dënimin më të rëndë? Ai apo ajo?

— Që të dy janë dënuar me punë të detyruara..

— E po atëhere qenkan barabar, asnjërit s'ka pse t'i mbetet hatri, — tha duke qeshur gjenerali. — Ai, meqë është i sëmurë, mund të qëndrojë, — vazhdoi — dhe kuptohet vetvetiu që do të behet ç'të jetë e mundur për t'ja lehtësuar gjëndjen; por ajo, edhe sikur të martohet, nuk ka se si të lihet këtu, bashkë me të. . .

— Gjeneralesha është duke pirë kafenë — raportoi atë çast lakej duke hyrë përsëri në dhomë.

Gjenerali tundi kokën dhe vazhdoi:

— Sidoqoftë, po shohim një herë se ç'mund të bëhet. Si i quajnë? Ja, i shënoni këtu.

Nekludovi i shënoi emrat mbi një copë letër.

— Nuk mund t'jua bëj dot as këtë — tha gjenerali duke iu përgjegjur pyetjes së Nekludovit a kishte mundësi të takohej me të sëmurin. Nuk është se kam dyshim tek ju, s'do mënd, — tha ai — po është puna që ju nuk interesoheni vetëm për të, por edhe për të tjerë dhe, veç kësaj, paratë nuk ju mungojnë. Kështuqë mund t'i blini të gjithë se, këtu tek ne, s'ka nëpunës që të mos shitet. Më porositin vazhdimisht nga lartë: të çrrënjoset akraballëku, më thonë. Po, ju lutem shumë, si ta çrrënjos kur që të gjithë, pa përjashtim, marrin rushfet? Sa më i ulët që të jetë nëpunësi aq më lirë shitet dhe aq më shpejt e pranon rushfetin. E po si ta ruaj unë? E ku ta di unë a merr apo s'merr rushfet kur ai është, fjala vjen, pesëmijë vjorsta larg? Ai atje është një car i vogël, ashtu siç jam edhe unë këtu, — gjenerali qeshi. — Ja, juve sigurisht jeni takuar me të burgosurit politikë, d'ç keni dhënë nën dorë dhe ju kanë lejuar. Është kështu apo jo? — pyeti ai duke vënë buzën në gaz.

— Po, është e vërtetë.

— Unë ju jap të drejtë. Ju kështu duhet të veproni. Ju doni të shikoni atë të burgosurin politik, për të cilin më folët sepse ju vjen keq për të. E kuptoj. Drejtori apo garfolët sepse ju vjen keq për të. E kuptoj. Drejtori apo gardiani i burgut, nga ana tjetër, nuk ka si të mos i marrë ato që ju i jepni nën dorë se është njeri hallexhi, ka fëmijë dhe ato dy dvuhgrivenike [1]) që merr nuk ka ku t'i shpjerë më parë. Njëlloj do të kisha vepruar edhe unë, sikur t'isha ndodhur në vëndin e tij, apo në vëndin tuaj. Por, në vëndin ku jam, domethënë në vëndin tim, unë nuk mund t'i lejoj vetes një shmangëie, sado të vogël, nga ligji i shtyrë nga keqardhja apo nga ndonjë arsye tjetër, pikë-

1) Monedhë me vleftë baras me 20 kopekë.

risht sepse mua më përket, më tepër se kujtdo tjetër, të kerkoj zbatimin e përpiktë të ligjit. Me fjalë të tjera, unë jam i detyruar ta meritoj besimin që më është ngarkuar, duke më zgjedhur në këtë vënd. Kështu, pra. Më duket se u sqaruam. Tani më tregoni, ç'kemi andej nga Metropoli?

Gjenerali e pyeti hollësisht Nekludovin për të rejat e Petërburgut, duke e ndërprerë hera-heres për të çfaqur edhe ai vetë ndonjë mendim që kishte për qëllim të vinte më mirë në dukje kulturën dhe ndjenjat e tij humanitare.

XXIII

— E dini ç'është? Ju, ku kini zënë vënd? Tek Djukovi? Dhe atje keq e mos më keq është! Po të mundeni ejani sot për drekë tek ne, — tha gjenerali duke e përcjellë Nekludovin tek dera. — Ju e flitni inglishten?

— Po, e flas.

— Atëhere shumë mirë. E dini pse jua them? Sepse na ka ardhur një ingliz, një turist. Qëllimi i ardhjes së tij është studimi i burgjeve dhe i vëndeve të internimit në Siberi. Sot do të jetë për drekë këtu tek ne. Kështu, pra, ejani edhe ju. Drekën e hamë më pesë, siç ju thashë, dhe gruan e kam shumë të përpiktë. Këtë është mirë ta dini. Mbase atëhere do të jem në gjëndje t'ju jap një përgjegje më të saktë për të burgosurën, për të cilën interesoheni, dhe për atë të sëmurin. Kam shpresë që diç do mund të rregullojmë. . .

Si u përshëndet me gjeneralin, Nekludovi i pushtuar nga një dëshirë për një veprimtari të ethëshëme, u nis e shkoi në postë.

Zyra e postës ishte një dhomë me tavan të ulët e me qemere. Nëpunësit qenë ulur nëpër bankot e tyre dhe qenë zënë me shpërndarjen e postës. Një nëpunës, me kokën vajisur mënjanë, trokiste vulën mbi zarfat që i kalonte me shkathtësi nëpër duar.

Nekludovin nuk e lanë të priste shumë por menjëherë, porsa muarrën vesh se si quhej, i dhanë një vandak të tërë me letra. Ndërmjet tyre, kishte edhe disa çeke të hollash, disa libra si edhe një numër të ri të «Otjeçestvineje Zapiski». Si i mori letrat që i kishin ardhur, Nekludovi u hoq më-

njanë dhe vajti u ul në një fron, ku po rrinte një ushtar me një regjistër në dorë që diç po priste. Nekludovi zuri vënd pranë ushtarit dhe nisi të çfletësonte korespondencën. I ra menjëherë në sy një letër e porositur, me një zarf të bukur, me një vulë të qartë përsipër, mbyllur me dyllë të kuq. Ai u ngut ta çirrte zarfin dhe, duke gjetur aty një letër të Seleninit, bashkangjitur me një shkresë zyrtare, ndjeu menjëherë se gjaku i hipi në fytyrë dhe buza e poshtme iu drodh. Atje ishte vendimi në lidhje me çështjen e Katjushës. Po çfarë vendimi? Mos vallë lutja nuk qe marrë parasysh? Nekludovi i hodhi një sy shpejt e shpejt letrës që ishte shkruar me një shkrim të imtë, të ngatërruar, ku kishte shumë germa të lëna përgjysëm dhe psherëtiu thellë i gëzuar: ishte vendimi i faljes!

«I dashuri mik! — shkruante Selenini — Biseda e fundit që pata me ty më ka lënë një përshtypje të thellë. Ti kishe të drejtë në lidhje me çështjen e Masllovës. E shqyrtova me kujdes proçes-verbalin e gjyqit dhe arrita në përfundimin se në dëm të saj është kryer me të vërtetë një padrejtësi. Por për ndreqjen e kësaj padrejtësie duhej drejtuar në komisionin e faljeve, pikërisht atje ku ti u drejtove. Munda të ndërhyj për zgjidhjen e kësaj çështjeje dhe, ja, po të dërgoj një kopje të aktit të faljes ne adresën që më dha kontesha Katerina Ivanovna. Kopja origjinale e vendimit i është dërguar burgut ku ajo ndodhej gjatë kohës së veprimeve gjyqësore por që andej, s'ka dyshim, se do ta dërgoinë menjëherë në administratën përkatëse në Siberi. Mezi ç'prita të ta jap këtë lajm të gëzuar. Të shtrëngoj dorën përzëmërsisht. **I yti Selenini»**.

Përmbajtja e shkresës ishte kjo: «Kanceleria e madhërisë së tij perandorit, ngarkuar me shqyrtimin e lutjeve për falje... çështja... data... Sipas urdhërit lëshuar nga drejtoria e kancelerisë së madhërisë së tij perandorit, në lidhje me lutjen për falje, drejtuar madhërisë tij perandorit, njoftohet e quajtura Ekaterina Masllova, borgjeze, se madhëria e tij perandori, duke u mbështetur në të dhënat e shqyrtimit të lutjes në fjalë, pati zemërgjerësinë ta marrë parasysh kërkesën e saj dhe pati mirësinë të urdhërojë që dënimi i të quajturës Ekaterina Masllova me punë të detyruara të lehtësohet në shkallën e internimit të saj në një vënd në afërsi të Siberisë».

Ky ishte një lajm i gëzuar dhe i rëndësishëm: Përpjekjet e Nekludovit qenë kurorëzuar më në fund me

sukses dhe kjo gjë e ndryshonte menjëherë gjëndjen e Katjushës dhe, për pasojë, edhe atë të Nekludovit. Natyrisht, ky ndryshim i ngatërronte pa dyshim marrëdhëniet e tyre. Gjersa ajo ishte një e burgosur dhe, për më tepër, një e burgosur me punë të detyruara, martesa e tyre nuk mund të ishte veçse fiktive dhe asgjë më tepër se sa një mjet për lehtësimin e vuajtjeve të saja. Kurse tani për një jetë të përbashkët nuk kishte më asnjë pengesë. Por për këtë Nekludovi nuk ishte i pregatitur. Pastaj, ç'kuptim kishin fjalët që ajo i kishte thënë dje? Po sikur ajo të lidhej me Simonsonin? Sadoqë ta vriste mëndjen, ai nuk ishte në gjëndje t'u përgjigjej këtyre pyetjeve dhe prandaj, hë për hë, i la mënjanë «Çdo gjë do të kthjellohet me kohë, — mendoi, — kurse tani unë duhet të takohem me të sa më parë që t'i jap lajmin e gëzuar të lirimit dhe ta nxjerr nga burgu». Ai kujtonte se për këtë mjaftonte kopja e aktit të faljes, që kishte në dorë. Prandaj, me të dalë nga zyra e postës, hipi në karrocë dhe i tha karrocierit ta shpinte drejt e në burg.

Me gjithë se gjenerali nuk i kishte dhënë leje atë mëngjes që të hynte në burg, Nekludovi, duke e ditur nga praktika që shpesh herë punët rregullohen shumë më mirë me të vegjëlit se sa me të mëdhenjtë, vendosi të bënte çmos për t'u futur në burg pa humbur kohë, bile që atë çast, për t'i dhënë Katjushës lajmin e faljes, për ta nxjerrë mundësisht nga burgu dhe për të marrë vesh, në të njëjtën kohë, si ishte me shëndet Krilcovi dhe për t'i treguar atij e Maria Pavllovnës fjalët e gjeneralit.

Drejtori i burgut ishte një burrë me një pamje madhështore, i gjatë dy metra dhe i trashë pa hesap, me mustaqe dhe me një palë baseta që i spërdridheshin nga të dy anët e i vareshin mbi gojë. Ai e priti Nekludovin shumë rreptë dhe ja preu shkurt duke i thënë se nuk mund të lejonte këdoqoftë që të takohej me të burgosurit. Kur Nekludovi nisi t'i thotë që edhe në kryeqytet e kishin lejuar kaq e kaq herë, drejtori ja ktheu:

— Mund të jetë edhe kështu siç thoni, po ja unë nuk u lejoj. — Toni me të cilin i shqiptoi këto fjalë sikur deshte të thoshte: «Ju, njerëzit e kryeqytetit, kujtoni se mund të na çuditni me ato që dini edhe të na kapni në fjalë. Por edhe ne, këtu në Siberinë e largët, s'e hamë bukën thatë dhe i dimë mirë rregullat, ndofta edhe më mirë nga ju!»

Kopja e aktit të faljes, lëshuar nga kancelaria e madhërisë tij perandorit, nuk i bëri atij asnjë përshtypje. Ai nuk pranoi kurrsesi që ta lejonte Nekludovin të hynte në burg. Kur Nekludovi çfaqi me naivitet mendimin se, mjaftonte ajo kopja e vendimit për të urdhëruar lirimin e Masllovës, drejtori buzëqeshi me tallje, duke thënë se nuk mund të nxirrte nga burgu asnjë të burgosur, pa patur për këtë një urdhër të posaçëm nga eprori i tij më i afërt. Sidoqoftë, ai premtoi se do ta vinte në dijeni Masllovën mbi aktin e faljes dhe se nuk do ta mbante në burg asnjë orë më tepër porsa të merrte urdhërin e lirimit të saj nga gubernatori.

Në lidhje me shëndetin e Krilcovit ai nuk pranoi gjithashtu të jepte asnjë njoftim duke deklaruar se, në cilësinë e drejtorit të burgut, nuk kishte të drejtë të thoshte as në se kishte një të burgosur me atë emër. Dhe ja kështu, pa bërë dot asgjë. Nekludovi i hipi karrocës dhe u kthye në hotel.

Qëndrimi i rreptë i drejtorit të burgut shkakëtohej kryesisht nga se numri i të burgosurve në burg ishte më tepër nga ç'duhej të qe në kushte normale dhe se, veç kësaj, ndërmjet të burgosurve kish rënë një tifo epidemike. Karrocieri i tregoi Nekludovit rrugës se në burg mileti po vdiste dita-ditës. Se ç'u ka rënë një sëmundje, — tha ai, — pa po i kallin në dhe nga njëzet e nga dyzet në ditë, në mos më shumë!»

XXIV

Me gjithë dështimin që kishte pësuar në burg, i pushtuar nga ajo dëshira për një veprimtari të ethëshme që thamë, Nekludovi u nis e shkoi në sekretarinë e gubernatoratit për të marrë vesh a kishte sosur atje shkresa mbi faljen e Masllovës. I thanë se akoma nuk kishin marrë gjë dhe prandaj, si u kthye në hotel, Nekludovi u ngut t'i shkruante për këtë, pa humbur kohë, Seleninit dhe avokatit të tij. Si i mbaroi së shkruari letrat, ai i hodhi një sy orës: ishte tamam koha për të shkuar për drekë tek gjenerali.

Rrugës ai filloi të mendonte përsëri se si do ta priste Masllova faljen. Ku do ta shpërngulnin? Si do të bashkë-

jetonte ai me të? Po Simonsoni? Gjer ku shkonin vallë marrëdhëniet e tij me të? Ju kujtua ndryshimi që kishte ndodhur tek ajo, nisi të shqyrtojë shkaqet e këtij ndryshimi, solli ndërmend të kaluarën e saj. . .

«Duhet t'i harroj, duhet t'i fshij të gjitha këto kujtime, — mendoi ai duke u ngutur t'i largonte sa më parë të gjitha mendimet që kishin të bënin me Katjushën. — Çdo gjë do të kthjellohet kur t'i vijë kona, — i tha vetes dhe nisi të mendonte se çfarë do t'i thoshte gjeneralit.

Dreka në shtëpinë e gjeneralit, e cila u servir me atë luksin e njohur për Nekludovin të njerëzve të pasur e të nëpunësave të lartë, pas mungesës së vazhdueshme jo vetëm të luksit por gjer edhe të kushteve më themelore për një jetë të rehatëshme, i shkaktoi atij një kënaqësi të thellë.

E zonja e shtëpisë ishte një grande dame [1]) e brumit të vjetër, dikur frejlinë [2]) në Oborrin e Car Nikollës, e cila e fliste frengjishten si gjuhën e saj dhe rusishten si një gjuhë të huaj. Trupin e mbante qiri dhe, sa herë që i lëvizte duart, kujdesej që të mos i largonte n'asnjë mënyrë bërrylet nga gjiri. Ndaj të shoqit mbante një qëndrim disi si të bezdisur e të qetë, ndonëse plot nderim, kurse ndaj mysafirëve sillej përkundrazi me një përzëmërsi të tepruar e me nuanca të ndryshme për sejcilin. Ajo e priti Nekludovin si një njeri të rrethit të saj, duke e mburrur lehtë-lehtë dhe duke i dhënë të kuptonte me shumë takt se e dinte qëllimin e vërtetë por fisnik të udhëtimit të tij në Siberi dhe se, prandaj, e çmonte atë si një njeri të jashtëzakonshëm. Lajkat e holla të damës i ngjallën përsëri Nekludovit besimin e humbur në meritat e tij dhe, bashkë me ambjentin luksoz në shtëpinë e gjeneralit, e shtyn që t'i dorëzohej plotësisht kënaqësive që gjente aty, duke filluar që nga gjellët e shijëshme e gjer tek bisedat e mënçura, të çkujdesura e plot edukatë. Për një çast atij iu duk se të gjitha ato që i kishin ndodhur kohët e fundit nuk kishin qënë veçse një ëndërr dhe se tani ai qe zgjuar më në fund për t'u kthyer në jetën reale.

Përveç njerëzve të shtëpisë, — vajzës së gjeneralit, burrit të saj dhe adjutantit — në drekë merrnin pjesë gji-

---

1) zonjë mondane (frëngj.)
2) zonjushë nderi (frëngj.)

thashtu ai inglizi, për të cilin Nekludovit i kishin folur, një tregëtar, pronar i një miniere ari, si edhe një guvernator province, që vinte nga një qytet i largët. Nekludovi u njoh me kënaqësi me tërë këta njerëz.

Inglizi, një burrë i shëndoshë e faqekuq, që e fliste frengjishten shumë keq, por që anglisht shprehej me një oratori vërtet shumë të hollë dhe bindëse, ishte një njeri që kishte udhëtuar shumë, që kishte parë shumë. Ai tregoi shumë gjera interesante mbi Amerikën, mbi Indinë, Japoninë dhe Siberinë.

Tregëtari, pronar i një miniere ari, një djalosh bir muzhiku, veshur me një frak, që e kishte qepur në Londër, me pulseta diamanti në këmishë, zotëronte një bibliotekë shumë të pasur, kishte investuar kapitale të mëdha në vepra bamirësie dhe ishte një mbrojtës i flaktë i ideve liberale. Ai i hyri Nekludovit menjëherë në qejf dhe i pëlqeu si një tip shumë interesant: tipi i një shartese të goditur i kulturës europjane me trungun e shëndoshë e t'egër të fshatarit rus.

Gubernatori i provincës, që vinte nga një qytet i largët, ishte pikërisht ai drejtori i departamentit për të cilin qe folur aq shumë në Peterburg gjatë kohës që Nekludovi qe ndodhur atje. Ky ishte një burrë majmok, me flokë kaçurrel e të rrallë, me një palë sy të butë kaltërosh, me bark të këcyer, me duar topolake e të bardha të ngarkuara me unaza dhe me një buzëqeshje të përzëmërt, që dukej sikur i rrinte varur mbi buzë. I zoti i shtëpisë kishte një simpati të veçantë për të sepse, nga të gjithë mvartësit e tij, ishte i vetmi që nuk merrte ryshfet. E zonja e shtëpisë, qeflie e madhe pas muzikës dhe pjaniste e përsosur edhe ajo vetë, e çmonte si një muzikant të mirë dhe lozte me të në pjano me katër duar. Gjëndja shpirtërore, në të cilën ndodhej Nekludovi atë ditë, karakterizohej nga një dashuri kaq e thellë për njerëzit sa edhe ay njeri iu duk atij mjaft simpatik.

Adjutanti, një oficer i qeshur, energjik, me mjekrën mavi të porsa rruar, bëhej copë që t'u shërbente mirë e shpejt të gjithëve dhe tregohej shumë i përzëmërt.

Por, më shumë nga të gjithë, i pëlqeu Nekludovit çifti i ri, që përbëhej nga e bija e gjeneralit dhe nga i shoqi i saj. Vajza e gjeneralit, ç'ishte e vërteta nuk mund të quhej kursesi një grua e bukur por, megjithatë, kishte një shije krejt të posaçme n'atë fytyrën e saj të njomë e të

padjallëzuar dhe dukej e dhënë me mish e me shpirt pas fëmijëve. . . I shoqi, me të cilin qe martuar me dashuri duke hyrë në luftë me prindërit, ishte një njeri modest dhe i zgjuar. Kandidat liberal i universitetit të Moskës, ai kishte një nëpunësi të thjeshtë dhe merrej me problemet e statistikës, lidhur sidomos me popullsinë vëndase, të cilën ai e studjonte me një dashuri të veçantë duke u munduar ta shpëtonte nga një çfarosje e plotë.

Të gjithë tregoheshin të dashur e të përzëmërt me Nekludovin dhe, dukej qartë që u vinte mirë e gëzoheshin që u kishte rënë rasti të takoheshin me një njeri interesant si ai. Gjenerali, i cili zuri vënd në krye të tryezës, veshur me uniformën ushtarake dhe me një kryq të bardhë në qafë, u përshëndet me Nekludovin si me një njeri me të cilin njihej qëkur dhe menjëherë i ftoi mysafirët të provonin mezet e të pinin nga ndonjë gotë vodkë. Pastaj, duke u kthyer përsëri nga Nekludovi, e pyeti se si e kishte kaluar ditën pasi qe takuar me të. Nekludovi i tregoi se kishte qënë në postë, ku kishte mbërrijtur në adresën e tij një kopje e aktit të faljes të asaj të burgosurës, për të cilën ai i kishte folur atij atë mëngjes dhe iu lut edhe një herë që t'i lëshonte një autorizim për të hyrë në burg.

Gjenerali, të cilit nuk i erdhi mirë, me sa dukej, që po flitej në bukë për punë zyre, u vrënjt në fytyrë dhe nuk dha asnjë përgjegje.

— Dëshëroni vodkë? — iu drejtua ai frengjisht inglizit, që ndërkaq ishte afruar. Inglizi tha se me gjithë qejf do ta pinte një gotë dhe, si e piu, tregoi se atë ditë kishte vizituar katedralen dhe një uzinë, por i kishte mbetur akoma pa parë burgu.

— Shumë mirë, — tha gjenerali, duke u kthyer nga Nekludovi — atëherë mund të shkoni bashkë. Lëshou një autorizim! — shtoi duke iu drejtuar adjutantit.

— Ju kur kini ndërmënd të shkoni? — e pyeti Nekludovi inglizin.

— Mua zakonisht burgjet më pëlqen t'i vizitoj në mbrëmje, — tha inglizi — sepse në këtë kohë të gjithë janë nëpër vendet e tyre, nuk ka pregatitje të veçanta dhe e sheh çdo gjë sheshit, ashtu siç është.

— Aha, dashka ta shikojë burgun në të gjithë bukurinë e tij të rrallë! E po le ta shikojë. Unë kaq herë i kam paralajmëruar, por s'ma kanë vënë veshin. Le ta marrin vesh atëherë nga shtypi i huaj, — tha gjenerali duke u

kthyer nga tryeza, ku qe shtruar dreka, ndërsa zonja e shtëpisë u tregonte mysafirëve ku të uleshin.

Nekludovi u ul ndërmjet zonjës dhe inglizit. Përballë tij zuri vënd e bija e gjeneralit dhe ish drejtori i departamentit. Gjatë bukës, biseda u vërtit me hope herë rreth Indisë, për të cilën Inglizi tregoi shumë gjëra, herë rreth ekspeditës së Tonkinit, të cilën gjenerali e kritikoi ashpër dhe herë rreth batakçinjëve dhe ryshfetçinjve të shumtë në radhët e nëpunësve që shërbenin në Siberi. Të gjitha këto ishin biseda që nuk paraqitnin për Nekludovin pothuajse asnjë interes.

Por, pas buke, në sallën e pritjes, ku pinë kafenë, ndërmjet inglizit dhe zonjës së shtëpisë u ndez një bisedë shumë interesante përmbi Gladstonin, në të cilën ndërhyri edhe Nekludovi duke çfaqur me këtë rast disa mendime që, siç iu duk atij, qenë shumë me vend dhe u vunë re edhe nga bashkëfolësit e tij. Pas asaj dreke të shijëshme, pas verës, pas kafesë, i rehatuar për bukuri në një kolltuk të butë, i rrethuar nga njerëz me edukatë e të përzemërt, Nekludovi ndjente një kënaqësi përherë e më të thellë. Kur më në fund gjeneralesha, e lutur nga inglizi, u ul në pjano bashkë me ish drejtorin e departamentit dhe luajti, bashkë me të, me një mjeshtëri të rrallë sinfoninë e pestë të Bethovenit, Nekludovin e pushtoi një gjëndje shpirtërore të cilën kishte kohë pa e provuar: ai ishte plotësisht i kënaqur nga vetja si një njeri që kupton për herë të parë se sa i mirë është.

Pjanua nuk kishte si të bëhej më e mirë dhe ekzekutimi i sinfonisë nuk linte asgjë për të dëshiruar. Këtë përshtypje pati të paktën Nekludovi, që e njihte mirë këtë sinfoni dhe e dëgjonte përherë me qejf. Duke dëgjuar andanten e mrekullueshme, ai ndjeu një të shpuar në hundë nga ngashërimi që e pushtoi për veten e tij dhe për tërë njerëzit.

Pasi e falenderoi të zonjën e shtëpisë për kënaqësinë e rrallë që i kishte dhënë rast të provonte përsëri pas kaq kohësh, Nekludovi po matej të merrte leje që të largohej, kur, atë çast, e bija e gjeneralit iu afrua atij me një çehre të vendosur dhe, duke u skuqur në fytyrë, i tha:

— Ju më pyetët për fëmijët; mos doni t'i shikoni?

— Ajo kujton se të gjithë mezi ç'presin t'ja shikojnë fëmijët — tha e ëma duke e vënë në lojë, me një buzë-

qeshje, atë mungesë takti që vinte re tek e bija. — E ç'i duhet princit t'i shikojë?

— Përkundrazi, kam shumë qejf t'i shikoj, — tha Nekludovi, i prekur nga ajo dashuri e tepruar për fëmijtë tek ajo nënë e re dhe e lumtur. — M'i tregoni, ju lutem!

— Po e shpie princin t'i tregojë ata camërdhokët e saj, — foli me zë të lartë e duke qeshur gjenerali që nga cepi matanë tryezës, ku po luante letrat bashkë me të dhëndrin, me pronarin e minierës së arit dhe me adjutantin. — E po borxhi duhet paguar. . .

E bija e tij ndërkaq, e çqetësuar nga gjykimi që do të jepej për së shpejti mbi fëmijët e saj, i printe Nekludovit me hapa të shpejta në dhomat e fjetjes. Në dhomën e tretë, me një tavan të lartë, me një tapiseri të bardhë, të ndriçuar nga një llambë e vogël me një abazhur të errët, qenë vendosur pranë njeri tjetrit dy shtretër të vegjël. Ndërmjet tyre, që ulur dadua e fëmijëve, një grua siberiane, me një trup të ëmët, me mollëza të këcyera, me një fytyrë të padjallëzuar e të butë, me një pelerinë të bardhë, të shkurtër, hedhur krahëve. Nëna u ndal përpara shtratit të parë dhe u kërrus mbi një vajzë nja dy vjeç, me flokë të gjatë, kaçurrel e të shpupuritura, që flinte e qetë me gojën hapur, me kokën mbështetur mbi jastëk.

— Ja, k'o është Katja, — tha e ëma e saj duke ndrequr kuvertën e kaltërt me vija, punuar me dorë, që kishte shkarë, duke zbuluar një këmbë të vogël, të bardhë. — A është ndopak e mirë?. . . Dhe s'është as dy vjeç. . .

— S'ka si të bëhet më e mirë!

— Kurse ky këtu është Vasjuku. Emrin e ka nga gjyshi. Kreit tjetër tip, apo jo? Tamam siberian.

— Hej, ç'djalë i bukur! — ja bëri Nekludovi duke soditur fëminë që flinte përmbys.

— Vërtet? — pyeti e ëma me një buzagaz kuptimplot.

Nekludovi solli ndërmënd zinzhirat, kokat e rruara, rrahjet, korruptimin, Krilcovin duke dhënë shpirt, Katjushën dhe, bashkë me të, gjithë të kaluarën e saj. Ndjeu se ja kishte zili asaj nëne të re. Ja, një lumturi të tillë, një lumturi të pastër, siç mendonte se ishte ajo që kishte përpara syve, deshte edhe ai për veten e tij.

Pasi i lavdëroi disa herë me radhë fëmijët, duke ditur se kështu i bënte qejfin edhe s'ëmës së tyre, që mezi ç'kishpritur gjersa t'ja mburrte, ai u kthye bashkë me të në dhomën e pritjes, ku inglizi qe bërë gati me kohë që të shkonin

bashkë në burg, ashtu siç qenë marrë vesh. Nekludovi u përshëndet me të gjithë dhe u largua bashkë me inglizin.

Moti ndërkaq kishte ndryshuar. Binte një borë e shpeshtë, me fjolla të trasha, që kish mbuluar tani tej e përtej edhe rrugën, edhe çatinë, edhe pemët e kopshtit, edhe shkallën, edhe karrocën, edhe kurrizet e kuajve. Nekludovi, pasi i tha karrocierit të inglizit se ku do të shkonin, hipi vetëm në karrocën e tij me kolltuk të butë, që ecte me zor nga bora, me ndjenjën e rëndë të një detyre që duhej kryer.

XXV

Ndërtesa e zymtë e burgut me rojën dhe fenerin e ndezur nën çemerin e portës, me gjithë çarçafin e bardhë të borës, që mbulonte tanimë gjithçka: edhe shkallët, edhe çatinë, edhe muret, të linte, kur e shikoje, një pështypje akoma më të zymtë se në mëngjes me ato dritaret e saj të ndriçuara në të gjithë pjesën e fasadës.

Drejtori me pamje madhështore doli në derë dhe, pasi lexoi, nën dritën e fenerit autorizimin që i lëshohej Nekludovit dhe englezit për të vizituar burgun, ngriti, i habitur, supet e tij të fuqishme. Por, duke zbatuar urdhërin, që i ishte dhënë, i ftoi vizitorët që ta ndiqnin brënda. U priu në fillim në oborr dhe pastaj që andej, nëpër ca shkallë e nëpërmjet një dere në të djathtë, në zyrën e tij. Si i ftoi të uleshin, i pyeti ç'urdhëronin nga ai. Kur Nekludovi i shprehu rishtas dëshirën që të takohej me Maslloven, ai i dha urdhër një gardiani që ta sillte menjëherë atje dhe, ndërkaq, u bë gati t'u përgjigjej pyetjeve që englezi filloi t'i bënte pa humbur kohë nëpërmjet Nekludovit.

— Për sa veta është parashikuar burgu? — pyeti englezi — Sa të burgosur ndodhen tani në të? Sa burra, sa gra, sa fëmijë? Sa të dënuar me punë të detyruar, sa të internuar, sa nga ata që ndjekin vullnetarisht t'afërmit e tyre? Sa të sëmurë?

Nekludovi i përkthente fialët e englezit dhe ato të drejtorit pothuaj përmënç dhe pa i kuptuar, i tronditur aq sa nuk e kish pritur, nga takimi i afërt me Katjushën. Kur, përmes frazave që po i përkthente englezit, ai dëgjoi një zhurmë hapash që po afroheshin dhe kur, pas pak, dera e zyrës u hap dhe u përsërit një skenë tanimë e rëndomtë

për të: hyrja e gardianit dhe dhënja në prag pas tij e Katjushës veshur me rroba të burgut dhe me shami në kokë, atë e pushtoi një mërzi e thellë.

«Unë dua të roj, dua edhe unë të kem familjen time, fëmijët e mi, dua edhe unë një jetë njerëzore!» — mendoi ai për një çast, ndërsa ajo hynte në dhomë me sytë përdhe e me hapa të shpejta.

Ai u ngrit dhe bëri disa hapa që t'i dilte përpara. Fytyra e saj iu duk këtë radhë atij e rreptë dhe e shëmtuar. Ishte po ajo fytyrë qe kish patur në takimin e parë, kur e kish qortuar. Ajo skuqej e zbehej, gishtërinjtë e saj përdridhnin me ngërç një cep të bluzës, ndërsa sytë e saj herë ngriheshin dhe e shikonin, herë rrëzoheshin përdhe.

— E dini që ju është marrë parasysh lutja për falje? — e pyeti Nekludovi.

— Po, ma tha gardiani.

— Kështuqë, me t'ardhur shkresa, ju mund të dilni dhe jeni e lirë të vendoseni ku të doni. Do ta mendojmë bashkë se si. . .

Por ajo nuk e la të fliste.

— Unë nuk kam pse të mendohem, — tha — Atje ku do të jetë Vladimir Ivanoviçi, atje do të jem edhe unë.

Ndonëse dukej shumë e tronditur, ajo i tha të gjitha këto duke e shikuar Nekludovin në sy dhe me një zë të qartë, të vendosur, sikur t'i kishte pregatitur që më parë këto fjalë.

— Ehë, kështu!

— Po, kështu, Dimitri Ivanoviçi, gjersa ai do që të rrojmë bashkë. . . — ajo e preu një hop fjalën si e trembur dhe pastaj filloi përsëri me një frymë, si një njeri që ngutet të ndreqi një gabim që i ka shpëtuar padashur — . . . që unë të ndodhem pranë tij, ç'kërkoj unë më mirë? Ky është fat për mua. Çdua tjetër unë?. . .

«Nga të dyjat një: ose kjo është dashuruar me Simonsonin dhe as që e ka dashur kurrë atë sakrificë që unë mendoja se po bëja për të mirën e saj, ose vazhdon të më dojë akoma dhe heq dorë nga unë vetëm për të mirën time, duke l dhur fatin e saj me atë të Simonsonit» — mendoi Nekludovi dhe u skuq nga turpi.

— Nëqoftëse ju e dashuroni. . . — nisi të thotë.

— E dashuroj, s'e dashuroj, kjo s'ka rëndësi. . . Unë këto tani i kam lënë. . . Pastaj Vladimir Ivanoviçi nuk është si të gjithë.

— Po, s'do mënd, — tha Nekludovi — Ai është një njeri i rrallë dhe unë mendoj. . .

Ajo u hodh dhe ja preu fjalën përsëri, sikur të kish frikë se mos thoshte ndonjë fjalë të tepërt duke mos i lënë kohë asaj që të thoshte të gjitha ato që donte të thoshte.

— Ju do të më falni, Dimitri Ivanoviç, nëqoftëse nuk bëj ashtu siç doni ju, — tha ajo duke e parë drejt e në sy me atë vështrimin e saj vëngërosh — S'ke ç'i bën, duket kështu qe thënë. Edhe ju keni nevojë të rroni.

Ajo po i përsëriste ato që ai i kishte thënë vetes pak më parë, por tani të tjera mendime kalonin në kokën e tij, të tjera ndjenja e pushtonin. Ai e ndjente veten të turpëruar, jo vetëm, por i vinte keq për të gjitha ato që humbiste duke humbur Katjushën.

— Unë këtë nuk e pritja, — tha.

— Pse të vuani edhe ju me mua? Mjaft vuajtët, — tha ajo duke buzëqeshur në një mënyrë të çuditëshme.

— Unë nuk kam vuajtur, unë e kam ndjerë veten shumë mirë dhe jam gati t'ju ndihmoj përsëri, po të jetë e mundur.

— Ne, — ajo tha «ne» dhe ngriti sytë mbi Nekludovin, — nuk kemi nevojë për asgjë. Ju edhe kaq shumë keni bërë për mua. Sikur të mos ishit ju. . . — ajo diç donte të thoshte, po befas iu mor zëri.

— Ju mua s'keni pse të më falenderoni, — tha Nekludovi.

— Përse t'i zëmë në gojë këto gjëra? Le t'ja lëmë zotit të na gjykojë, — tha ajo ndërsa sytë i shëndritnin nga lotët.

— Sa grua e mirë që jeni! — tha ai.

— Unë e mirë? — tha ajo përmes lotëve dhe një buzëqeshje e mjerë i ndriçoi fytyrën.

— Are Jou ready? [1] — pyeti atë çast englezi.

— Directly [2] — u përgjegj Nekludovi dhe e pyeti Katjushën për Krilcovin.

Ajo e mposhti tronditjen që e kish pushtuar dhe i tregoi e qetë të gjitha ato sa dinte: Krilcovi qe dobësuar shumë gjatë rrugës dhe e kishin shtruar menjëherë në spital. Maria Pavllovna qe bërë shumë merak për të; kishte kërkuar që të rrinte pranë tij në spital, po nuk e kishin lejuar.

— Atëhere unë po shkoj. . . — tha ajo duke vënë re inglizin që po priste.

---

1) Jeni gati? (angl.)

2) Jatani. (angl.)

— Nuk po ju them lamtumirë, prapë do shihemi, — tha Nekludovi.

— Më falni, — bëlbëzoi ajo me një fije zëri.

Sytë e tyre u takuan dhe si n'atë vështrimin e saj vëngërosh e të çuditshëm ashtu dhe n'atë buzëqeshjen e vrerosur me të cilën ajo kishte dashur ta nënvizonte fjalën «më falni», Nekludovi kuptoi se nga të dy hipotezat e mundura mbi shkakun e vendimit që kish marrë Katjusha, duhej pranuar si e vërtetë e dyta: ajo e donte atë, Nekludovin, dhe mendonte se, po të lidhej me të, do t'ja prishte atij jetën, kurse, duke ndjekur Simonsonin, e çlironte atë një herë e mirë nga një barrë e rëndë. Ajo tani ishte e lumtur që kishte mundur të bënte më në fund atë që kish dashur, por prapseprapë vuante tmerrësisht duke u ndarë prej tij.

Si i shtrëngoi dorën, ajo i ktheu krahët me një lëvizje të shpejtë dhe u largua.

Nekludovi ktheu kokën nga englezi, që ishte gati të shkonte me të, por ai në atë çast diç po shënonte në bllokun e tij. Nekludovi, që të mos e bezdiste, vajti e u ul mbi një divan të vogël druri rrëzë murit. Befas një lodhje e tmerrshme e pushtoi dhe ai e ndjeu se nuk e kishin lodhur netët pa gjumë, vuajtjet e udhëtimit, tronditjet shpirtërore. Jo, e kishte lodhur jeta! Duke u mbështetur në shpinën e divanit në të cilën qe ulur, ai mbylli sytë dhe një gjumë i rëndë, prej të vdekuri, e pushtoi menjëherë.

— E po, mos dëshironi tani të vizitoni qelitë? — pyeti drejtori i burgut.

Nekludovi u zgjua, hapi sytë e u habit kur kuptoi se ku ndodhej. Englezi ndërkaq u kishte dhënë fund shënimeve në bllok. Nekludovi, i lodhur dhe indiferent u ngrit dhe e shoqëroi.

XXVI

Pasi kaluan nëpër një koridor të qelbur, ku vunë re dy të burgosur që po përmirnin përdhe, drejtori, englezi dhe Nekludovi, të shoqëruar nga gardianët e burgut, hynë në qelinë e parë, ku mbaheshin të dënuarit me punë të detyruar. Të gjithë të burgosurit kishin rënë të flinin mbi disa shtretër prej dërrase të vendosur në mes të dhomës. Bëheshin nja shtatëdhjetë vetë. Për mungesë vendi, qenë shtrirë kokë më kokë e brinjë më brinjë. Porsa u hap dera, të gjithë bro-

të
m[illegible] e ndjenjën mbi shtrat. Vetëm dy të burgosur akoma qen-
s[illegible]onin të shtrirë. Njeri ishte një djalosh me fytyrë të sku-
ur nga ethet; tjetri — një plak që rënkonte or'e çast.

Englezi pyeti a kishte shumë kohë ai djaloshi që ishte sëmurë. Drejtori u përgjegj se që atë mëngjes; kurse plaku kishte kohë që vuante nga stomaku por e kishin lënë aty meqënëse në infermeri nuk kishte vend. Englezi tundi kokën në shenjë qortimi dhe tha se deshte t'u thoshte të burgosurve nja dy fjalë. Ai iu lut Nekludovit t'ja përkthente ato që do të thoshte. U muarr vesh se englezi, përveç qëllimit të udhëtimit të tij, që ishte përshkrimi i burgjeve dhe i vendeve të internimit në Siberi, kishte edhe një qëllim tjetër: të predikonte shpëtimin e shpirtit me anë të besimit dhe të pendesës.

— U thoni atyre që Krishti i ka përdëllyer ata dhe i ka dashur; ai ka vdekur për shpëtimin e tyre. Po të jetë se do të besojnë në këtë, ata do të shpëtojnë. — Ndërsa ai fliste të gjithë të burgosurit qëndronin në këmbë të heshtur përpara shtretërve të tyre duke mbajtur drejtqëndrim. — U thoni atyre, — vazhdoi ai, — se të gjitha këto janë thënë në këtë libër. Ka nga ata që dinë të lexojnë?

Ata që dinin të lexonin ishin ndo njëzet veta. Englezi mori nga një valixhe e vogël që mbante në dorë disa kopje të Dhjatës së Re. Disa dhjetra duar me thonj pis, u zgjatën për nga ai duke u shtyrë. Englezi shpërndau në atë qeli dy libra të ungjillit dhe u nis për në qelinë tjetër që vinte pas saj.

E njëjta gjë u përsërit edhe këtu. Edhe këtu po ai ajër i rëndë, po ajo erë e qelbur. Ashtu si në qelinë e parë, në krye të dhomës, ndërmjet dritareve qe varur një ikonë. Edhe këtu të burgosurit qenë ngjeshur njeri mbi tjetrin dhe, po ashtu si në qelinë e parë, ata u ngritën të gjithë në këmbë duke marrë drejtqëndrim, me përjashtim të tre vetave që vazhduan të rrinin mbi shtretërit e tyre. Dy nga këta u ngritën e ndënjën mbi shtrat, kurse i treti asqë u tund nga vendi dhe asqë e ktheu kokën për të parë se kush kishte hyrë. Që të tre ata qenë të sëmurë. Englezi duke shqiptuar prapë po ato fjalë shpërndau edhe këtu dy libra të ungjillit.

Në qelinë e tretë dëgjohej një zhurmë njerëzish që grindeshin e rriheshin. Drejtori i ra murit dhe thirri: «Qetësi!». Kur dera e qelisë u hap, përsëri zbritën nga shtretërit, me përjashtim të disa të sëmurëve dhe dy të tjerëve që po rriheshin, duke kapur shoshoqin nga mjekra e flokët. Ata

u ndanë vetëm kur panë drejtorin që po u afrohej. Njeri-ha kishte bërë copë hundën dhe që mbushur tërë gjak e jarg tjetri mblidhte qimet që i qenë shkulur nga mjekra.

— Ku është këtu përgjegjësi? — pyeti me të rreptë drejtori.

Menjëherë përpara tij doli një i burgosur me trup të pashëm e të fuqishëm.

— Nuk bëhen dot zap, shkëlqesi!

— I bëj unë zap, — tha drejtori duke u mvrenjtur.

— Waht did they fight for? [1]) — pyeti englezi.

Nekludovi e pyeti përgjegjësin cili kishte qenë shkaku i grindjes.

— Për pecet e këmbëve u zunë, — tha përgjegjësi duke buzëqeshur. — Ky i ra, ai ja ktheu.

Nekludovi i tregoi englezit si kishte qenë puna.

— Unë do të deshja t'u them atyre nja dy fjalë, — tha englezi duke iu drejtuar drejtorit.

Nekludovi ja përktheu. Drejtori tha: «Mundeni». Atëhere englezi nxorri nga xhepi ungjillin e tij të lidhur me lëkurë.

— Ju lutem, u përktheni atyre këto që do të them, — i tha ai Nekludovit. — Ju u grindët dhe u rrahët, kurse Krishti, i cili vdiq për shpëtimin tonë, na ka treguar një udhë tjetër për zgjidhjen e konflikteve tona. I pyetni ata, ju lutem, a e dinë se si duhet vepruar, sipas ligjit të Krishtit, me ata që na fyejnë ofendojnë?

Nekludovi përktheu fjalët e englezit.

— E po duhet që t'i qahemi drejtorit se pastaj ai merr masa. Apo jo? — u hodh e tha një i burgosur duke parë vëngër nga ajo anë ku ngrihej madhështor trupi i pashëm i drejtorit.

— Shtroje në dru e s'të fyen dot më! — u hodh e tha një tjetër.

U dëgjuan disa të qeshura aprovimi për fjalët që kishte thënë i burgosuri i dytë. Nekludovi i përktheu englezit përgjegjet.

— U thoni atyre se, sipas ligjit të Krishtit, duhet bërë krejt e kundërta: nëqoftëse të qëllojnë në njerën faqe, kthe edhe tjetrën, — tha englezi duke treguar dhe vetë me gjest.

Nekludovi ua përktheu.

— Ai do të bënte mirë ta provonte një herë vetë, — tha dikush nga të burgosurit.

1) Përse u zunë? (angl.)

— Po sikur ai të të qëllojë edhe në atë tjetrën, ç'të mbetet atëhere për t'i kthyer akoma? — tha njeri nga të sëmurët që rrinte shtrirë.

— Po ja, do të presësh sa të të bëjë përshesh!

— Punë me mënd, s'ke ç'thua! — ja priti dikush tjetër nga pas dhe ja shkrepi të qeshurit. Një gaz i papërmbajtur e pushtoi tërë qelinë; qeshi me të gajasur bile edhe ai i burgosuri me hundën e dërmuar. Qeshën edhe të sëmurët.

Po englezi nuk e humbi dhe iu lut Nekludovit t'u thoshte atyre se ajo që duket e pamundur, bëhet e mundur për ata që besojnë.

— Po për të pirë, a pinë? Pa i pyetni.

— I ke rënë më të! — u dëgjua një zë.

Në këtë qeli, të sëmurë qenë katër. Kur englezi pyeti përse të sëmurët nuk mblidheshin të gjithë në një dhomë të përbashkët, drejtori u përgjegj se ata vetë nuk deshnin. Veç kësaj, sipas të thënave të tij, nuk kishin ndonjë sëmundje ngjitëse dhe infermieri i vizitonte rregullisht duke u bërë të gjitha mjekimet për të cilat kishin nevojë.

— Bëhen dy javë sot që nuk ja kemi parë bojën, — u dëgjua një zë.

Drejtori nuk foli fare dhe hyri në qelinë tjetër. U hap përsëri një derë, të burgosurit u ngritën në këmbë të heshtur dhe englezi shpërndau përsëri ato ungjijet e tij. Po kjo ndodhi edhe në qelinë e pestë, në të gjashtën dhe në qelitë e tjera të venaosura nga të dy anët e koridorit të gjatë.

Nga qelitë e të burgosurve me punë të detyruar vizitorët bashkë me drejtorin kaluan me radhë nëpër qelitë ku ndodheshin të internuarit. E njëjta gjë përsëritej kudo: kudo po ata njerëz të ftohtë, të uritur, të sëmurë, të poshtëruar, me fytyrë bishash të egërsuara.

Englezi, si shpërndau një numër të caktuar ungjijsh, hoqi dorë jo vetëm nga ato, por edhe nga fjalët që u drejtonte të burgosurve. Ajo pamja e zymtë, e rëndë dhe, sidomos, ai ajri i qelbur, mbytës, që qarkullonte aty, ja kishin shuar me sa duket energjinë dhe ai hynte e dilte nëpër qelitë duke thënë vetëm një «all right» [1]) të thatë, sa herë që drejtori i raportonte përmbi numërin dhe gjëndjen e të burgosurve. Nekludovi ecte si nëpër gjumë dhe ishte kaq i lodhur e i dërmuar sa nuk kishte as fuqi të vazhdonte më tutje.

---

1) Oll rait — mirë.

XXVII

Në një nga qelitë ku mbaheshin të internuarit, Nekludovi vuri re i habitur atë plakun që kishte parë po atë mëngjes mbi trap. Plaku leshator e me rrudha, me një këmishë të ndytë bojë hiri të shqyer përmbi sup, me një palë pantallona n'atë ngjyrë, këmbëzbathur, qe ulur buzë një shtrati. Ai u hodhi një vështrim të rreptë e pyetës atyre që hynë. Trupi i tij i dërmuar, përmes të çarave të këmishës së ndytë, dukej kaq i dobët e i pafuqishëm sa ta këpuste shpirtin; por fytyra kishte një shprehje akoma më të gjallë e të përqëndruar se sa në trap. Ashtu si në qelitë e tjera, edhe këtu, të burgosurit u ngritën në këmbë dhe muarrën drejtqëndrim, porsa panë drejtorin; vetëm plaku vazhdonte të rrinte ulur.

— Në këmbë! — iu çkreh drejtori.

Plaku asqë lëvizi fare, por vetëm buzëqeshi me përçmim.

— Ata, që të janë ngritur në këmbë, janë shërbëtorët e tu. Por unë nuk jam shërbëtori yt. Ja tek është tek ty vula. . . — tha plaku duke i treguar me dorë drejtorit ballin.

— Çfarë? — filloi t'i kanosej drejtori dhe iu afrua, sikur deshte ta rrihte.

— Unë e njoh këtë njeri, — u ngut t'i thoshte drejtorit Nekludovi. — Përse e kanë arrestuar?

— Na e ka dërguar policia se nuk është gjetur në rregull me dokumentat. Ne u themi që të mos na i dërgojnë, po s'na e vënë veshin, — tha drejtori duke e vështruar plakun shtrëmbër.

— Duket edhe ti qënke në ushtërinë e antikrishtit? — ju drejtua plaku Nekludovit.

— Jo, unë kam ardhur këtu për një vizitë — tha Nekludovi.

— Aha, atëhere paske ardhur të bësh sehir se qysh ai që mohon krishtin i mundon njerëzit? E po çka, çka, kulloti sytë. Po ja të them unë: i ka mbledhur njerëzit nga janë e s'janë e i ka kyçur në kafaz! Dhe sa, ka kyçur thua ti? Një stan të tërë! Ja, kështu, në vënd që t'i lërë të nxjerrin bukën e gojës me djersën e ballit, vete i kyç në kafaz dhe i ushqen, i biri i botës, si derrat e i lë pa punë saqë vijnë e bëhen tamam mu si bishat.

— Çfarë thotë? — pyeti englezi.

Nekludovi i tha që plaku kritikonte drejtorin që i mbante njerëzit në burg.

— Pa pyeteni: si duhet vepruar, sipas tij, me ata që e shkelin ligjin? — tha englezi.

Nekludovi e përktheu pyetjen.

Plaku qeshi në një mënyrë të çuditëshme duke kërcëllitur ato dhëmbët e tij të shëndoshë e të bardhë si rruaza.

— Ligji! — përsëriti ai me përbuzje në fillim; ai u grabiti të gjithëve ç'kishin e nuk kishin, u mori njerëzve tokën, pasurinë, i vuri nën vete, i çfarosi të gjithë ata që guxonin të ngrinin krye dhe pastaj na shkroi një ligjë që këtej e tutje të mos grabiste më njeri, të mos vriste më njeri. Pse nuk e shkroi më parë atë ligjë?

Nekludovi përktheu. Inglizi qeshi.

— Mirëpo, sidoqoftë, si duhet vepruar tani me hajdutët dhe me vrasësit? Pa pyeteni.

Nekludovi ja përktheu plakut pyetjen. Plaku u mvrenjt dhe mori në fytyrë një çehre të rreptë.

— I thuaj atij që të heqi nga vetja atë vulën e antikrishtit dhe s'ka për të patur më as hajdutë, as vrasës. Ja, kështu thuaji!

— He is crazy [1]) — tha englezi kur Nekludovi i përktheu fjalët e plakut dhe doli nga qelia duke ngritur supet.

— Ti bëj tënden, leri ata! Çdo njeri le të jetë ai që është. Zoti e di se kë duhet të dënojë e kë duhet të falë, ne nuk e dimë, — tha plaku — Bëhu vet zot i vetes tënde dhe ahere do mos kesh më nevojë për zotër. Shko, shko, — shtoi çehrengrysur duke i pështënditur sytë nga Nekludovi, i cili po ngurronte të dilte. — E pe tani se si antikrishti e ushqen njerëzinë me morra. Ç'do më? Shko, shko!

Kur Nekludovi doli në koridor, englezi, po qëndronte bashkë me drejtorin përpara derës së hapur të një qelie bosh dhe po e pyeste përse shërbente ajo qeli. Drejtori i shpjegoi se ajo ishte dhoma e të vdekurve.

— O! — ja bëri inglizi kur Nekludovi ja përktheu dhe tha se kishte dëshirë ta shikonte.

Dhoma e të vdekurve ishte një qeli e zakonshme dhe jo fort e madhe. Në mur qe varur një llambë e vogël që ndriçonte dobët ca thasë, hedhur njërin mbi tjetrin në një qoshe, ca dru dhe katër kufoma shtrirë mbi katër shtretër. Kufoma e parë, me një këmishë prej cohe të ashpër, me peca në këmbë, ishte ajo e një burri trupmadh, me një mjekër të vogël me majë e me kokën rruar mespërmes. Trupi tanimë

---

1) Ai është i marrë (ingl.)

qe nxirë, duart ngjyrë mavi dukej që kishin qenë mbledhur mbi krahëror, por tani qenë hapur; po ashtu të hapura qenë edhe këmbët e zbathura me patomat që ngriheshin përpjetë një mbi një. Pranë tij qe shtrirë një grua plakë, veshur me një fund e me një bluzë të bardhë, këmbëzbathur, me flokë të sheshta të mbledhura në një gërshetë të shkurtër e të hollë, me një fytyrë tërë rrudha, të imtë, të verdhë dhe me një hundë të vogël me majë. Pas plakës, vinte kufoma e një burri tjetër me ca rroba si në ngjyrë të jargavanit. Kjo ngjyrë diç i kujtoi Nekludovit.

Ai iu afrua më afër dhe nisi ta vështronte me kujdes.

Pa një mjekër të vogël, të hollë, të pashtruar, një hundë të fortë, të bukur, një ballë të bardhë, të lartë, ca flokë të rralla, kaçurrel. Ai dalloi në to tiparet e një njeriu të njohur e nuk u zuri besë syve të tij. E kishte parë dje atë fytyrë të ndezur nga inati, kurse tani ajo ishte e qetë, e ngrirë dhe tmerrësisht e bukur.

Po, ai ishte Krilcovi ose, më mirë të themi, gjurma që kish mbetur nga jeta e tij materiale.

«Përse vuajti ky? Përse rrojti? A e ka kuptuar vallë tani? — mendoi Nekludovi, dhe iu duk se kjo pyetje nuk kishte përgjegje, se në botë nuk kishte asgjë tjetër veç vdekjes dhe një brëngë e hidhur e pushtoi.

Pa u përshëndetur me englezin, ai iu lut një gardiani ta përcillte jashtë dhe, duke ndjerë se kishte nevojë të ndodhej vetëm për të menduar me nge mbi të gjitha ato që kishte parë atë mbrëmje, u nis e shkoi në hotel.

XXVIII

Në vënd që të shtrihej në shtrat e të flinte, Nekludovi u shall për një kohë të gjatë lart e poshtë nëpër dhomë. Marëdhëniet e tij me Katjushën kishin marrë fund. Ajo s'kishte më nevojë për të. «Sa keq, sa turp!» — mendonte ai me vete. Po nuk ishte kjo që e mundonte tani. Tani e mundonte, më tepër se kurrë, një çështje tjetër, që kërkonte prej tij një zgjidhje sa më të shpejtë.

Tërë ajo ligësi e tmerëshme, të cilën ai e kish parë dhe e kish njohur gjatë asaj kohe dhe veçanërisht atë ditë, n'atë burg të llahtarshëm, tërë ajo ligësi që kishte marrë në qafë ndër mijëra e mijëra të tjerë edhe Krilcovin e shkretë, tri-

umfonte, sundonte dhe nuk shihej asnjë mundësi jo vetëm për ta mposhtur, por as për të shpresuar se ajo mund të mposhtej një ditë.

Përpara syve të tij dilnin si të gjallë ata qindra e mijëra njerëz, të poshtëruar, të mbyllur në një atmosferë të qelbur nga ca gjeneralë, nga ca prokurorë e nga ca drejtorë burgjesh mospërfillës. Atij i kujtohej ai plaku i lirë, i çuditshëm, i marrë siç thonin, që shkrehej kundra autoriteteve dhe, ndërmjet kufomave, ajo fytyra e bukur e verdhë si dylli e Krilcovit që kish vdekur i vrerosur. I bëri përsëri vetes pyetjen në ishte ai, Nekludovi, i marrë apo qenë të marrë njerëzit që hiqeshin si të zgjuar dhe që i kishin bërë të gjitha ato. Kësaj pyetjeje i duhej gjetur sa më parë një përgjegje.

Si u lodh së ecuri lart e poshtë nëpër dhomë, ai u ul në divan dhe hapi padashur një ungjill të vogël që englezi i kishte dhuruar për kujtim. «Thonë se këtu ka një zgjidhje për të gjitha çështjet» — mendoi ai, pastaj e hapi ungjillin dhe nisi të lexojë atje ku e kishte hapur. Ungjilli sipas Matheut, kreu i XVIII-të.

1. Nd'atë orë erthnë nxënësit te Jesuj, e i thanë: Vallë cili është më i madh ndë mbretëritë e qiejvet?

2. Edhe Jesuj thirri pranë vetes së tij një çun të vogël, edhe e qëndroi atë ndë mest t'atyre, e tha:

3. Me të vërtetë po ju them juve, në mos kthefshi e të bëheni posi çunat e vegjël, nuk do të hyni në mbretërinë e qiejvet;

4. Kush të përunj, pra, vetën e tij posi ky çun i vogël, ky është më i madh në mbretërinë e qiejvet;

«Po, po, kështu është», — mendoi ai duke sjellur ndërmënd se si edhe ai vetë aq më tepër e kishte ndjerë veten të qetë e të lumtur sa më tepër qe zvogluar në sy të njerëzve.

5. Edhe kush të presë një të këtillë çun të vogël me emrin tim, më ka priturë mua;

6. Po kush të skandhalisnjë nië nga këta të vegiëlitë që më mbesojnë, është më mirë për atë të varetë një gur mulliri mbi qafët t'ati, edhe të kredhetë në fund të detit.

«Ç'hyn këtu: **kush do të presë?** Dhe ç'do të thotë: **me emrin tim?** — i bëri ai pyetje vehtes, duke ndjerë që këto fjalë nuk i thonin asgjë. Dhe ç'hyn këtu guri i mullirit dhe fundi i detit? Jo, këtu sikur diç mungon: s'është e qartë, s'është e saktë» — mendoi ai duke siellur ndërmënd se si kaq herë në jetë të tij kishte filluar të lexonte ungjillin dhe

gjithmonë paqartësira të tilla e kishin detyruar të hiqte dorë. Ai lexoi gjithashtu vargun 7,8,9 e 10 ku flitej për skandalet që do të bëheshin në botë, mbi dënimin në gjehenet të zjarrit ku do të hidheshin njerëzit dhe për ca ëngjëj të fëmijëve që shikojnë faqen e atit qiellor. «Sa keq që është thënë në një mënyrë kaq të ngatërruar! — mendoi ai. — Kuptohet nëpër të se këtu ka diçka shumë të vlefshme».

11. Sepse i Bir'i njeriut erdhi të shpëtonjë të humburin, — vazhdoi ai të lexonte më tej.

12. Ç'u duket juve? në pastë ndonjë njeri njëqind dhën, edhe t'i humbasë një nga ato, a nukë le të nëndëdhjet'e nëndat, e vete ndëpër male të kërkojë të humburën?

13. Edhe ndëqoftëse e gjen, me të vërtetë po ja them juve, se gëzohet më tepër për atë se për të nëndëdhjet'e nëndat, që s'kanë humbur.

14. Kështu nuk është e dashur përpara Atit tuaj, që është në qiejt, të humbasë një nga këta të vegjëlit.

«Po, nuk është e dashur nga ati që të humbasin, po ja po humbasin me qindra e mijëra dhe s'ke si i shpëton», mendoi ai.

21. Atëhere i erdhi pranë Pjetri, e tha: Zot, sa herë të më fëjejë im vëlla, edhe t'ja falë atij? gjer më shtatë herë?

22. Jesuj i thotë atij: Nuk të them, gjer më shtatë herë, po gjer mbë shtatëdhjetë herë shtatë.

23. Prandaj mbretëria e qiejvet gjau me një njeri mbret, që deshi të shohë llogaritë me shërbëtoret e tij.

24. Edhe kur zuri të shohë llogari, i prunë një borxhli që i kishte borxh dhjetë mijë tallanda.

25. Edhe ai, si nuk kishte t'i lanjë, i zoti urdhëroi të shitet ai, edhe gruaja e ati, edhe të bijtë, edhe gjithë ç'kishte, edhe të lahet borxhi.

26. Po shërbëtori i ra ndër këmbë, e i lutej, duke thënë: Zot, bëhu zëmërgjërë me mua, edhe do t'i laj të gjitha.

27. Edhe të zot, si iu dhëmb për atë shërbëtor, e lëshoi edhe ja la borxhin.

28. Po ai shërbëtor si dolli, gjeti një nga shokët e tij shërbëtor që i kishte borxh atij njëqind dinare; edhe si e zuri ta mbyste, duke thënë: Lajmë borxhin që më ke.

29. Atëhere, pra, shoku i tij shërbëtor i ra ndër këmbë, e i lutej, dyke thënë: Bëhu zëmërgjerë me mua, edhe do t'i laj të gjitha.

30. Edhe ai nuk donte, po shkoi edhe e vuri ndë burk, gjersa t'i lante borxhin.

31. Edhe shokët e tij shërbëtorë, kur panë se ç'u be, u helmuan fort; edhe erdhën e i rrëfyen të zot gjithë sa u bënë.

32. Atëhere i zoti e thirri pranë, e i tha: Shërbëtor i lik, gjith' atë borxh ta lash ty, sepse m'u lute;

33. Nukë duhej edhe ti ta përdëlleje shokun tënd shërbëtor, sikundër të përdëlleva edhe unë ty?

— Thua kjo të jetë? Vetëm kjo? — thirri befas Nekludovi duke lexuar këto fjalë. Dhe një zë i brëndshëm, që dilte nga burimet më të thella të qënies së tij, iu përgjegj: «Po, vetëm kjo!».

Dhe Nekludovit i ndodhi ajo që u ndodh shpesh herë njerëzve që bëjnë një jetë shpirtërore. Ndodhi që një mendim që i ishte dukur në fillim si diçka pa kuptim, si një paradoks dhe bile si një shaka, duke gjetur një dëshmi përherë e më të gjallë në jetë, befas iu paraqit atij si një e vërtetë nga më të thjeshtat, nga më të sigurtat. Kështu ai tani fitoi bindjen se e vetmja mënyrë dhe mënyra më e sigurt për të shpëtuar nga ajo ligësi e tmerëshme, nga e cila vuanin njerëzit, ishte që njerëzit të pranonin se ishin fajtorë përpara zotit dhe, prandaj, ta quanin veten të paaftë për të dënuar dhe për të ndrequr njerëz të tjerë. Për të ishte tanimë krejt e qartë, se tërë ai mjerim i llahtarshëm që atij i kishin zënë sytë nëpër burgje dhe se tërë ajo gjakftohësi e vetsiguri e çmëndur e atyre që e kishin shkakëtuar këtë mjerim, rridhte vetëm ngaqë njerëzit donin të bënin një punë të pamundur: të ndreqnin të keqen duke qënë vetë të këqij. Njerëz të përdhosur donin të ndreqnin të tjerë si veten dhe mendonin t'ia arrinin këtij qëllimi në një mënyrë thjesht mekanike. Po ç'dilte nga kjo? Nga kjo dilte vetëm që njerëz nevojtarë dhe t'interesit, duke e bërë profesionin e tyre këtë dënim dhe, korruptoheshin vetë gjer në pikën e fundit dhe korruptonin parreshtur të gjithë ata që u binin në dorë. Tani për të ishte krejt e qartë ku e kishte burimin tërë ai tmerr, që ai kishte parë dhe se çfarë duhej bërë për të shpëtuar prej tij.

Përgjegja të cilën ai s'kishte mundur ta gjente, ishte pikërisht ajo që Krishti i kishte dhënë Pjetrit: t'i falësh, t'i falësh njëqindmijë herë ata që të fyejnë sepse nuk ka të tillë njerëz që të mos kenë bërë ndonjë faj dhe që prandaj të kenë të drejtë të dënojnë dhe të ndreqin.

«Po nuk është e mundur që kjo të jetë kaq e thjeshtë!» — i thoshte vetes Nekludovi. Por, në të njëjtën kohë,

ai shikonte, pa mundësi që të gabohej, se sado e çuditëshëme që mund t'i qe dukur atij kjo në fillim, i prirur siç ishte nga zakoni të besonte në të kundërtën, kjo ishte e vetmja zgjidhje, jo vetëm teorike por edhe praktike e kësaj çështjeje. Teza e kundërt që shprehej zakonisht me këtë pyetje: e po si u bëhet atyre që kryejnë krime? Mos vallë duhen lënë pa dënuar? tani nuk e gjënte më Nekludovi të papregatitur. Kjo tezë do të kishte patur vlerë sikur të provohej që dënimi i pakëson krimet, i ndreq kriminelët; por kur provohej krejt e kundërta, dhe kur ishte e qartë se nuk është në dorë të njeriut ta ndreqi njeriun, atëhere puna më e arësyeshëme që ne mund të bëjmë është që të mos bëjmë më një gjë që jo vetëm nuk sjell asnjë dobi, por është përkundrazi e dëmshme dhe, përveç kësaj, e turpëshme dhe çnjerëzore. «Ju keni shekuj me radhë që po i dënoni njerëzit që i cilësoni si kriminelë. E po si, i ndreqët? Jo, nuk i ndreqët! Jo vetëm, po e shtuat numurin e tyre me të gjithë ata kriminelë që korruptohen me anë të dënimeve si edhe me të gjithë kriminelët zyrtarë, siç janë gjykatësit, prokurorët, hetuesit dhe gardianët, të cilët janë ngarkuar të merren posaçërisht me dënimin e njerëzve». Nekludovi arriti të kuptojë tani se shoqëria dhe rendi shoqëror në përgjithësi mbahej në këmbë jo për hir të kriminelëve legalë, të cilëve u ishte besuar gjykimi dhe dënimi i njerëzve, po sepse, me gjithë tërë këtë korruptim, tek njerëzit nuk qe shuar akoma ndjenja e keqardhjes dhe e dashurisë për vllezërit e tyre.

Duke shpresuar se në ungjill do ta gjente të shprehur edhe këtë mendim, Nekludovi nisi ta lexonte atë që nga fillimi. Duke lexuar predikimin mbi malë, i cili i kishte lënë përherë mbresë të madhe, ai pa për herë të parë në të jo më mendime të bukura abstrakte dhe kërkesa të tepruara që njerëzit nuk janë në gjëndje t'i përmbushin, por disa urdhëresa të thjeshta, të qarta dhe praktikisht të mundura, të cilat, nëqoftëse do të zbatoheshin, (dhe fare lehtë mund të zbatoheshin) do të vendosnin një rend krejt të ri në shoqërinë njerëzore që jo vetëm do të sillte vetvetiu zhdukjen e dhunës përpara së cilës Nekludovi revoltohej aq shumë, por do të realizonte shkallën më të lartë të lumturisë, të cilën njerëzit janë të aftë ta aprovojnë: mbretërinë e zotit mbi tokë.

Urdhëresat qenë pesë.

U hëresa e parë (Math. V, 21-26) i mëson njeriut që ... nuk duhet të vrasë, por as nuk duhet të zemërohet ... vëllanë e tij, që nuk dunet të përbuzë njeri e ta quaj «ra... duhet të pajtohet me këdo që është grindur përpara s... bëjë dhuratën e tij zotit, d.m.th. përpara se të falet.

Urdhëresa e dytë (Math. V, 27-32) i mëson njeriut që o vetëm të mos bjerë në kurvëri, por të shmanget nga çdo kënaqësi që vjen nga bukuria e fëmrës dhe, kur të lidhet një herë me një grua, të mos e tradhëtojë atë kurrë.

Urdhëresa e tretë (Math. V, 33-37) i ndalon njeriut të premtojë ndonjë gjë me be.

Urdhëresa e katërt (Math. V, 38-42) e mëson njeriun që jo vetëm të mos ja kthejë tjetrit sy për sy, por kur ta qëllojnë në njërën faqe të kthejë dhe tjetrën, t'i falë fyerjet që i janë bërë, t'i durojë në paqë dhe të mos i mohojë njeriu atë që ai i kërkon.

Urdhëresa e pestë (Math. V, 43-48) e udhëzon njeriun që jo vetëm të mos i urrejë armiqtë dhe të mos luftojë kundër tyre, por edhe t'i dojë, t'i ndihmojë e t'u shërbejë.

Nekludovi nguliti sytë në flakën e llambës dhe ndënji ashtu pa lëvizur. Duke menduar mbi të gjitha gabimet, me të cilat është e mbushur jeta e jonë, ai e përfytyroi qartë këtë jetë, ashtu siç do të ishte sikur njerëzit të edukoheshin sipas këtyre rregullave dhe, ashtu siç nuk i ndodhte prej kohësh, një entusiazëm i papërshkruar ja pushtoi shpirtin sikur, pas kaq vuajtjesh e mundimesh, ta kishte gjetur më në fund qetësinë dhe besimin e ëndërruar.

Ai nuk fjeti tërë atë natë dhe, ashtu siç u ngjet rëndom njerëzve që lexojnë ungjillin, duke lexuar, ai kuptoi për herë të parë përmbajtjen e vërtetë të shumë fjalëve që i kish lexuar kaq e kaq herë pa i vënë re. Ai thithte në veten e tij, ashtu si sfungjeri thith ujin, atë dituri të rallë dhe atë gëzim të pashteruar që u zbulon njerëzve ky libër dhe të gjitha ato sa lexonte i dukeshin të njohura, i dukej se vërtetonin dhe kthjellonin disa gjëra që ai i kish ditur edhe më parë, por si në tym dhe pa u besuar.

Tani ai jo vetëm ishte plotësisht i bindur se, duke iu përmbajtur këtyre urdhëresave, njerëzit do të arrinin shkallën më të lartë të lumturisë, për të cilën ishin të aftë, por ai ishte plotësisht i bindur edhe se s'kishte asgjë tjetër

shi[illegible]ri
për t[illegible] bërë përveç përmbushjes së këtyre urdhëresave, se në to qëndronte i vetmi kuptim i arësyeshëm i jetës njerëzore dhe se çdo shmangëje prej tyre ishte një vetim që sillte menjëherë me vete si pasojë denimin[illegible]ke e kështe një pasojë e të gjithë doktrinës dhe me një forcë e[illegible]e një qartësi të veçantë shprehej në paravolinë e vreshtarëve. Vreshtarët mendonin se vreshtat në të cilat i kishte dërguar pë[illegible] t'i punuar i zoti, qenë prona e tyre, se të gjitha sa ndodhe[illegible] shin në vreshtë, qenë për ta, dhe se s'u takonte të bëni[illegible] tjetër veç të shijonin jetën e tyre në ato vreshta, duke harruar të zotin dhe duke i vrarë të gjithë ata që ua zinin në gojë, duke kujtuar bashkë me të edhe detyrimet që kishin ndaj tij.

«Po këtë bëjmë edhe ne — mendonte Nekludovi — duke rrojtur me shpresë se jemi vetë zot të jetës sonë dhe se ajo na është dhënë që ta shijojmë. Që kjo është thjeshtë marrëzi, s'ka dyshim se, gjersa kemi ardhur këtu, dikush na ka dërguar dhe s'na ka dërguar kot. Kurse ne kujtojmë se duhet të rrojmë për të bërë qejf dhe, natyrisht, nuk e ndjejmë veten në rregull ashtu siç nuk e ndjen ai punëtori që nuk bën punën që i kanë ngarkuar. Po mjafton që njerëzit t'i përmbushin këto urdhëresa dhe do të vijë mbi dhe mbretëria e qiejve dhe njerëzit do t'arrijnë kulmin e lumturisë.

«Kërkoni mbretërinë e qiejve dhe drejtësinë e saj dhe të tjerat do t'u jepen juve me të tepër». Kurse ne kërkojmë ato të tjerat dhe natyrisht nuk i gjejmë.

Ja, pra, edhe vepra e jetës sime. Porsa mbaroi njëra, filloi tjetra».

Që atë natë filloi për Nekludovin një jetë krejt e re, jo edhe aq ngaqë ai hyri në kushte të tjera jetese, se sa ngaqë të gjitha ato që i kishin ndodhur gjer atëhere muarrën për të një kuptim krejt tjetër nga ai që kishin patur më parë. Se si do të përfundojë kjo periudhë e re në jetën e tij, koha do ta tregojë.

(1899)

FUND